SAHÎHU-L-BUHÂRI

Në gjuhën shqipe

Libri 1.

Përktheu: Mehdi Polisi

Sahîhu-l-Buhâri në gjuhën shqipe - libri 1.

Titulli i origjinalit:

صحيح البخاري

Përktheu:
Mehdi POLISI

Redaktor profesional:
Bahri ef. ALIU

Redaktor gjuhësor:
Mahmud HYSA

Korrektor:
Mehdi POLISI

Redaktor teknik:
Nysret S. SIMNICA

Realizimi kompjuterik:

nip shuli prishtinë

SAHÎHU-L-BUHÂRI

Në gjuhën shqipe

Libri 1.
1-348
HADITHE

Përktheu:
Mehdi Polisi

Prishtinë
1994

Dhe thuaj: "Punoni, All-llahu do ta shohë punën tuaj, (atë do ta shohin) edhe Pejgamberi i Tij edhe besimtarët...".

et-Tevbe: 105.

Hadithi pas Kur'anit burim themelor i Islamit

Kur'ani është Fjala e All-llahut xh.sh., që përmes melekut Xhibril i është shpallur Pejgamberit të Tij, Muhammedit a.s. në kohëzgjatje prej 23 vjetësh. Hadithi 1 ndërkaq është gjithçka që Muhamedi a.s. ka folur, ka vepru ar dhe ka pëlqyer, Me fjalë të tjera, përmes Hadithit shprehet e tërë jeta he veprimtaria e Pejgamberit.a. Nga kjo shihet qartë se Kur'ani dhe Hadithi janë burimet themelore të Islamit. Prandaj, nuk është për t'u habitur fare pse interesimi për njohjen sa më të thellë të Kur'anit dhe të Hadithit nga ana e dijetarëve islamë, por edhe më gjerë, prej kohësh ka qenë dhe vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes.

Meqenëse Hadithi është një fushë e gjerë, bile do të thonim shumë e gjerë, do të japim vetëm disa njohuri të rëndësishme, me shpresë se do të jenë në dobi të lexuesit.

1. Vlera dhe rëndësia e Hadithit.

Vlerën dhe rëndësinë e madhe të Hadithit e vë në dukje në radhë të parë vetë Kur'ani. Sa për ilustrim po i përmendim vetëm disa ajete të Kur'anit famëlartë që flasin drejtpërdrejt për këtë qëllim:

"Ai (Muhammedi) nuk flet sipas dëshirës së vet".

(en-Nexhm, 3).

"O ju që keni besuar! Përuluni All-llahut dhe përuluni Pejgamberit..."

(en-Nisâ', 59).

---

1 Sinonim i termit Hadith është termi Sunnet. Fjala Sunnet është më e përgjithshme dhe më e papërcaktuar, sepse Sunnet në kuptimin e përgjithshëm do të thotë "traditë" që nënkupton edhe traditën paraislame. Megjithatë, përdorimi i njërit term në vend të tjetrit, kur përdoren me kuptimin e sipërpërmendur, nuk do të ishte kurrfarë gabimi, sepse thënë shkurt, tërë Sunneti i Muhammedit a.s., që përfshin fjalën, veprën dhe pëlqimin e tij, shprehet përmes Hadithit

"Kush i nënshtrohet All-llahut dhe Pejgamberit të Tij, do të jetë me ata të cilëve All-llahu u ka dhënë shumë begati: me Pejgamberët, me të drejtët, me dëshmorët (shehidët) dhe me njerëzit tjerë të mirë! Ata janë shokë të mrekullueshëm".

(en-Nisâ', 69).

"Me të vërtetë ju e keni shembull të mrekullueshëm Pejgamberin e All-llahut..."

(el-Ahzâb), 21).

"Thuaj** (o Muhammed): **nëse ju e doni All-llahun, më pasoni mua** (ndiqeni rrugën time), **e All-llahu do t'ju dojë juve dhe do t'ua fal gabimet** (gjynahet) **tuaja. All-llahu është falës dhe mëshirues i madh".

(Ali Imrân, 31).

"... atë që ua jep Pejgamberi, atë merreni, e atë që ua ndalon lëreni..."

(el-Hashr, 7).

Vlera dhe rëndësia e Hadithit mund të shihet edhe në sa vijon:

Çdonjëri që e lexon Kur'anin me vëmendje, do të vërejë se në të për disa çështje flitet në mënyrë të përgjithshme, d.m.th. pa hyrë në hollësi të problemit përkatës. Për shembull, sado që në shumë ajete të Kur'anit urdhërohet falja e namazit, askund nuk shpjegohet mënyra e faljes e as nuk jepen hollësi të tjera. Edhe dhënia e zeqatit urdhërohet në shumë ajete por, megjithatë, përveç përcaktimit se kush duhet ta japë zeqatin dhe kujt duhet t'i jepet ai, në asnjë ajet nuk thuhet më konkretisht se cila pasuri i nënshtrohet zeqatit dhe sa duhet ndarë nga pasuria e cila arrin shkallën e duhur (nisabin). Ka edhe shembuj të tjerë. [2] Zbërthimin dhe stërhollimin e dispozitave të këtilla të Kur'anit dhe mënyrën e zbatimit të tyre praktik, në përputhje me mësimet dhe detyrën që i ishte dhënë nga ana e All-llahut xh.sh., në mënyrë të përpiktë e bëri Muhammedi a.s. Kjo do të thotë se pa shpejgimin e hollësishëm të çështjeve të caktuara nga ana e tij, shumë gjëra nuk do të kishin mundur të kuptohen drejt e aq më pak të zbatohen në jetën praktike. Pra, roli

2 Ibrahim Džananović, *Pitanje derogacije u šerijatskom pravu*, Zbornik Radova IslamskogTeološkog Fakulteta u Sarajevu 1/1982, Sarajevo, 1982,f.177-189.

dhe detyra e Muhammedit a.s. si Pejgamber ka qenë, në radhë të parë, të shpjegojë Shpalljen e All-llahut xh.sh., që shihet qartë në ajetin e Kur'anit:

"... dhe Ne ta kemi dërguar ty Shpalljen** (Kur'anin) **që t'ua shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur..."

(en-Nahl, 44),

ose, ajeti tjetër

"... atë që ua jep Pejgamberi, atë merreni, atë që ua ndalon, atë lëreni..."

(el-Hashr, 7).

Po qe se këtyre ajeteve ua shtojmë edhe ajetin:

"Ai (Muhammedi) nuk flet sipas dëshirës së vet".

(en-Nexhm, 3),

mund të themi me bindje të thellë se Muhammedi a.s., përveç që është shpjegues i parë i Kur'anit, ai ka dhënë edhe disa zgjidhje që nuk gjenden në Kur'an, por këto zgjidhje mund të kuptohen vetëm atëherë kur është dashur të shpjegohen ato çështje të përgjithshme të Kur'anit. Megjithatë, kjo duhet të kuptohet se Hadithi gjithnjë është në lidhshmëri të ngushtë dhe të plotë me Kur'anin.

Shembuj tipik që flasin për vlerën dhe rëndësinë e Hadithit, respektivisht që tregojnë se Hadithi, pas Kur'anit, është burim themelor i Islamit, janë edhe fjalët e Muhammedit a.s., që me rastin e Haxhit Lamtumirës, para masës, ndër të tjera, ka thënë edhe këto fjalë: **"Ua kam lënë atë që ju do t'i përmbaheni, që asnjëherë të mos hutoheni e të mos humbeni, pra, ua kam lënë Librin e All-llahut** (Kur'anin) **dhe fjalët e Pejgamberit të Tij** (Hadithin)", ose rasti i Muadh b. Xhebelit, të cilin vetë Muhammedi a.s. e ka caktuar për mësues të Fesë islame në Jemen. Mirëpo, për ta marrë mendimin e tij Muhammedi a.s. sikur e vlerësoi atë, duke i thënë: **"Ku do të mbështetesh për ndonjë çështje kontestuese?" "Në Kur'an"** i që përgjigjur ai. **"Po nëse nuk gjendet në Kur'an?"** që pyetja tjetër. **"Në Hadith"** që përgjigjur ai... [3].

---

3 Malik Ibn Nebi, *Kur'anski Fenomen,* Izdavač: Starešinstvo Islamske Zajednice Bosne i Hercegovine, Hrvatske i Slovenije, Štampa "Ognjen Prica" - Zagreb (pa datë), f. 55.

Nga sa u tha më lart, shihet qartë se muslimanët janë të detyruar t'u nënshtrohen urdhërave të All-llahut xh.sh. dhe të shkojnë rrugës së mësimeve të Muhammedit a.s., sepse ai gjatë mësimeve të tij si Pejgamber, ka qenë në lidhje të drejtpërdrejtë me Shpelljen.

2. Mënyra e transmetimit të Hadithit dhe përmbledhjet e tij.

Të parët që i kanë transmetuar Hadithet e Muhammedit a.s. janë As-habët - shokët e Muhammedit a.s. Këta madje janë burimi më i sigurt i Hadithit, sepse jo vetëm që i kanë dëgjuar drejtpërdrejt fjalët e Muhammedit a.s., por ata kanë pasë rast ta përcjellin edhe punën e tij praktike. Pas tyre transmetimin e Hadithit e kanë bërë Tabi'inët - brezi i parë pas Muhammedit a.s., të cilët i kanë marrë hadithet drejtpërdrejt nga As-habët, për të vazhduar pastaj Tebei-t-Tabi'inët - brezi i dytë pas Muhammedit a.s., të cilët janë njoftuar drejtpërdrejt nga Tabi'inët. Kështu pra ka vazhduar ky zinxhir i transmetimit të Hadithit.

Hadithi që në krye të herës është transmetuar njëkohësisht në dy mënyra: gojarisht dhe përmes shkrimit. Pra, As-habët, përveç që i kanë mësuar hadithet përmendsh, por edhe i kanë shkruar. Këtë konstatim e theksojnë të gjitha burimet islame. Sipas shënimeve që i gjejmë në "Sahihun" e Buhariut,[4] mënyra e transmetimit dhe e mësimit të hadithit ka shkuar në këtë mënyrë: muhaddithi, ose thënë ndryshe, mësuesi i hadithit, gjatë mësimit, qe ai i organizuar, ose në mënyrë individuale, ua ka treguar hadithin nxënësve të tij, të cilët, përveç që e kanë mësuar përmendsh, ata edhe e kanë shkruar atë. Pastaj, ndonjë nga nxënësit e citonte ose e lexonte hadithin para mësuesit (para muhaddithit), e në rast të ndryshimit më të vogël, mësuesi e përmirësonte atë, pikërisht ashtu si e kishte dëgjuar nga Muhammedi a.s. Pasi të ishte vërtetuar plotësisht saktësia e hadithit, muhaddithi, jepte leje për transmetimin e mëtutjeshëm të tij.

Derisa për As-habët ishte e mjaftueshme dhe e arsyeshme që gjatë transmetimit të hadithit ta përmendnin vetëm emrin e Pejgamberit a.s., për transmetuesit e brezave të mëvonshëm, për shkak të largësisë (distancës)

4 Shih në këtë libër, pjesa: *Lidhur me diturinë* (hadithin), f. 120-121.

kohore, kjo nuk mjaftonte, prandaj filluan të përmendin jo vetëm emrin e Pejgamberit a.s., por edhe emrat e atyre prej të cilëve e kishin zënë hadithin, d.m.th. tërë senedin - emrat e të gjithë transmetuesve sipas radhitjes së tyre. Që transmetimi i hadithit të shkonte më tutje, transmetuesi i fundit, për shembull, e paraqiste hadithin me tërë senedin e tij, deri te burimi - te Pejgamberi a.s., shpeshherë edhe me ndonjë shënim, duke i përdorur shprehjet: *"Më (ose na) ka treguar...", "më (na) ka njoftuar...", "Më (na) ka lajmëruar...", "kam dëgjuar nga...", ose shkurt "nga..."* [5]. Çdo transmetues, gjatë transmetimit të hadithit, duhej patjetër ta përdorte ndonjërën nga këto shprehje, që, sipas muhaddithëve, secila nga këto shprehje ka vlerë të njëjtë për transmetimin e hadithit. Me këto shprehje, natyrisht, bëhet me dije se transmetuesit e hadithit janë takuar, kanë biseduar dhe në atë rast e kanë dëgjuar hadithin përkatës nga njëri-tjetri.

Se Hadithi ka filluar të shkruhet qysh në kohën e Muhammedit a.s. flasin burimet themelore islame, por, megjithatë, hadithi që e transmeton Ebu Sei'd el-Hudriu, që përfshihet në "Sahihun" e Muslimit [6]: *"Mos shkruani nga unë asgjë përveç Kur'anit. Kush ka shkruar nga unë diçka përveç Kur'anit, le ta fshijë atë. Transmetoni nga unë* (gojarisht), *sepse për këtë nuk ka gjynah. Dhe kush më shpif mua duke më bërë gënjeshtar* (kush thotë diçka kinse unë e kam thënë), *ai do ta gjejë vendin e vet në Xhehennem",* u ka dhënë shkas dijetarëve për të diskutuar lidhur me këtë çështje. Edhe pse ky hadith flet në mënyrë mjaft të përgjithshme për ndalimin e shkrimit të Hadithit, pjesa dërrmuese e dijtarëve, duke komentuar hadithin në fjalë, janë të mendimit se ndalimi i shkrimit të Hadithit i përket vetëm ditëve të para të Shpalljes, sepse Muhammedi a.s. - thonë dijetarët -, duke i njohur mirë rrethanat e përgjithshme të kohës, por edhe përgatitjen dhe aftësitë e njerëzve, ka pasë frikë që fjalët e tij të mos përzihen me tekstin e Kur'anit. Mendojmë se lidhur me këtë çështje përkufizimin më të qëlluar e ka dhënë islamologu i mirënjohur bashkëkohor prof. Muhammed Hamidullahu.[7] Duke e komentuar hadithin e lartpërmendur ky thotë se për të gjetur një zgjidhje më të mirë, sa i përket

---

5 Këtu: *Shprehjet e muhaddithit,* f. 117.

6 Sipas: *Sahîh-i Buhârî Muhtasarı Tecrîd-i Sarih ve Tercemesı Şerhi, Birinci Cilt* (vëllimi i parë), *Mukaddime* (Hyrje),Ankara, 1984, f.39.

7 Dr. Muhammed Hamidullah, *Uvod u Islam*, III izdanje, Sarajevo, 1989. f. 40.

ndalimit të shkrimit të Hadithit, duhet patur parasysh se: ndalesa ka qenë individuale, që ka të bëjë me ata që sapo kanë mësuar të shkruajnë, ose me ata që sapo e kanë pranuar Islamin, që nuk kanë qenë në gjendje dhe nuk kanë qenë të aftë të bëjnë dallimin në mes Kur'anit dhe Hadithit. Për këta individë - vazhdon Hamidullahu - është hequr ndalesa pasi kanë përparuar në dituri; ndalesa ka pasë për qëllim të pengojë shkruarjen e Hadithit në kopjet e Kur'anit, që të largohet përzierja e tekstit të Kur'anit me atë të Hadithit; ndalesa - thotë Hamidullahu - ndoshta kishte të bënte me ndonjë fjalim të caktuar. Shpresojmë se nuk do të gabonim po qe se këtyre pikave do t'ua shtonim edhe faktin se Muhammedi a.s. me këtë, që në fillim ka pasë për qëllim të tregojë se Kur'ani është Fjala e All-llahut xh.sh. dhe për nga fuqia që ka, asgjë nuk mund të krahasohet me të, prandaj as fjalët e tij.

Për të vërtetuar qëndrimin se Hadithi ka filluar të shkruhet që për së gjalli të Muhammedit a.s., nga rastet e shumta po i shkëpusim disa:

- Në vitin e çlirimit të Mekkes, Pejgamberi a.s. ka mbajtur një fjalim të gjatë para masës. Pasi e mbaroi fjalimin e tij, i qe afruar një person nga Jemeni, duke kërkuar nga Pejgamberi që atë fjalim t'ia japë me shkrim, me ç'rast Pejgamberi a.s. e urdhëroi ndonjërin nga As-habët, duke i thënë: *"Shkruajani filanit!"*. [8]

- Ebu Hurejre në një rast ka thënë: *"Asnjë nga As-habët e Pejgamberit a.s. nuk ka tubuar më shumë hadithe se unë, përveç Abdullah b. Amr b. el-Asit, sepse ai i ka shkruar, kurse unë nuk i kam shkruar"*. [9]

- Në "Sunenin" e Ebu Davudit [10] qëndron tregimi i Abdullah b. Amr b. el-Asit: *"Kam shkruar çdo gjë që kam dëgjuar nga Pejgamberi a.s. Këtë deshën të ma ndalojnë kurejshitët, duke më thënë se ti po shkruan çdo gjë, por dije se Pejgamberi është njeri dhe flet edhe kur është i gëzuar, edhe kur është i hidhëruar. Për këtë arsye, unë për një kohë hoqa dorë nga të shkruarit e haditheve. Më vonë ia tregova rastin Pejgamberit a.s. Ai, duke sinjalizuar*

8 *Shahihu-l-Buhari*, shih këtu, hadithi 112, f. 175.

9 *Po aty*, hadithi, 113, f. 176.

10 Sipas, *Sahîh-i Buhâri... Mukaddime*, f.43.

me gisht (nga goja e vet) *tha: "Shkruaj, sepse, po betohem në All-llahun se nga kjo* (d.m.th. nga goja ime) *nuk del asgjë, përveç të vërtetës".*

Abdullah b. Amr b. el-Asi nga shënimet e mbledhura të haditheve më vonë bëri një përmbledhje të cilën e quajti "Sahife Sadika".

- Në "Sunnein" e Tirmidhiut [11] është përfshirë hadithi që transmetohet nga Ebu Hurejre, i cili tregon se një person nga Ensarët kishte ardhur te Pejgamberi a.s. dhe i ishte ankuar, duke i thënë: "O Resulullah! Unë prej teje dëgjoj shumë gjëra, por kot, sepse nuk mund t'i mbaj në mend të gjitha". Pejgamberi a.s. i qe përgjigjur: *"Shërbehu me dorën tënde të djathtë".*

Gjurmimi, tubimi, ruajtja, të mësuarit përmendsh dhe të shkruarit e haditheve vazhdoi edhe pas vdekjes së Muhammedit a.s., bile me një hov të shtuar. Këtë punë intenzive dhe të rëndësishme e kërkonin rrethanat e ndryshme të kohës: pakësimi i numrit të As-habëve që i dinin hadithet përmendsh, zgjerimi i kufijve të shtetit islam, shpërndarja e dijetarëve nëpër qendra të ndryshme, luftat e shpeshta etj. Dijetarët nuk kursenin për këtë qëllim asgjë. Kështu për shembull, Xhabir b. Abdullahu për të mësuar vetëm një hadith ka udhëtuar në këmbë plotë një muaj. [12].

Por jo vetëm kaq. Me kalimin e kohës lindi nevoja që hadithet të përfshihen në përmbledhje të veçanta. Ç'është e vërteta këtë punë kishin filluar ta bënin As-habët, të cilët jetuan edhe pas vdekjes së Muhammedit a.s. si: "Aliu [13], Xhabir b. Abdullah Ensariu, [14] Ebu Hurejre, [15] Abdullah b. Abbasi etj".

---

11 Po aty, f.43

12 Sahihu-l-Buhari, në këtë libër: *Gjurmimi për dituri*, f. 141.

13 Po aty, *Të shkruarit e shkencës*, hadithi 111, f. 173.

14 Xhabir b. Abdullahu në veprën të cilën e quajti "Sahife" e përshkruan Haxhxhin lamtumirës. Kjo vepër ishte shumë e njohur në kohën e Tabi-inëve. Pa ndryshime është përfshirë më vonë në "Sahihun" e Muslimit. (Sipas, *Sahîh-i Buhârî Muhtasarî... Mukaddime*, f. 44; Muhammed Hamidullah, *Uvod u Islam*, f. 38).

15 Ebu Hurerje ia kishte lënë veprën e vet në dorëshkrim nxënësit të vet Hemmam b. Munebbihut. Të gjithë ata hadithe që gjendeshin në atë vepër, më vonë qenë përfshirë në "Gjashtë Sahihët" (Sipas, *Sahîh-i Buhârî Muhtasarî... Mukaddime*, f. 44; Muhammed Hamidullah, Muhammed a.s. 2, f.49.

Megjithatë, nevojën e madhe për mbledhjen dhe për përfshirjen e hadi-theve në vëllime të veçanta e hetuan brezi i Tabi'inëve dhe i Tebei-t-Tabi'inëve.

Vlen të theksohet posaçërisht se këtë çështje e kishte ngritur, nëse mund të themi kështu, në shkallë institucionale halifja Emevit Umer b. Abdu-l-Az-izi, i cili sipas shënimeve që i jep Buhariu i kishte shkruar letër kadiut dhe valiut të Medines, Ebu Bekr b. Hazmit (120/737) [16] më këtë përmbajtje: *"Shiko dhe gjurmo! A ka ndonjë hadith tjetër të Pejgamberit a.s.* (nëse ka) *shkruaje, sepse frikohem se ajo dituri mos po zhduket, e dijetarët mos po shkojnë* (vdesin). *Pranoi vetëm hadithet e Pejgamberit a.s. Le të përhapet dijenia dhe le të ligjërohet ajo vazhdimisht, që të mësohet edhe ai që nuk di, sepse dijenia nuk do të shkatërrohet derisa ajo nuk do të jetë e fshehtë".* [17] Mirëpo këtë punë të nxitur nga halifja Umer, Ebu Bekr b. Hazmi nuk kishte arritur ta bënte, por me insistimin (këshillimin) e tij, këtë punë do ta vazhdojë ta bëjë nxënësi i tij Muhammed b. Muslim b. Shihab ez-Zuhriu (124/741).[18] Prej kësaj kohe e deri në fillim të vitit 200/815 hartohen një varg përmble-dhjesh të hadithеve nëpër të gjitha qendrat e shtetit islam: Në Mekke, në Medine, Në Basra, në Damask, në Kufe etj, prej të cilave më e njohura është "Muvatta'" e Malik b. Enes Asbahiut (179/795), [19] e cila për një kohë pas Kur'anit ishte vepra më e çmueshme islame.

Disa vjet më vonë, ose thënë më drejt, pas vitit 200/815, muhaddithinët vazhduan të bëjnë përmbledhje hadithesh, por tash me një metodologji tjetër, pra duke i radhitur hadithet sipas rendit alfabetik të senedit të tyre. Prandaj përmbledhjet e këtilla, u quajten "Musned". Për një kohë të shkurtër u hartuan shumë "Musnede", por më i njohuri ndër ta është ai i Imam Ahmed b. Hambel esh-Shejbaniut (241/855).

Të flasësh për transmetimin e hadithit, respektivisht për përhapjen e diturisë, e të mos përmendësh dy hadithe, që sipas mendimit tonë kanë

---

16 Ky numër tregon vitin e vdekjes. Numri i parë tregon vitin sipas hixhretit, kurse i dyti, vitin sipas erës sonë.

17 *Sahihu-l-Buhari,* shih në këtë libër, f. 163.

18 Sipas: *Sahîh-i Buhârî Muhtasarî... Mukaddime,* f. 48.

19 *Po aty,* f. 49.

rëndësi dhe peshë të posaçmë edhe në ditët e sotme, mendojmë se kjo çështje do të mbetej disi e paplotësuar:

E para: Muhammedi a.s., duke e ditur rëndësinë e diturisë dhe domosdoshmërinë e përhapjes së saj, në shumë raste i ka porositur As-habët që të mësojnë dhe t'i mësojnë të tjerët, e në fund të fjalimit të tij që e mbajti me rastin e Haxhxhit Lamtumirës, kur merrnin pjesë rreth njëqind e dyzetmijë haxhillarë, [20] ndër të tjera ka thënë edhe këtë: *"... Çdonjëri që është i pranishëm këtu le ta njoftojë atë që nuk është i pranishëm, sepse mund të ndodhë që ai, që nuk është i pranishëm këtu ta kuptojë më mirë se ai që ia kumton".* [21]

E dyta: Pejgamberi a.s., për t'ua tërhequr vërejtjen njerëzve, që fjalët e tij të mos keqpërdoren, por të thuhen në mënyrë besnike dhe të shpejgohen drejt, ka thënë hadithin: *"Kush më bën mua shpifje duke më bërë gënjeshtar* (thotë diçka kinse unë kam thënë) *do ta gjejë vendin e vet në Xhehennem".* Ky hadith është përfshirë në "Sahihun" e Buhariut dhe transmetohet nga disa senede. [22]

Mund të themi se këta dy hadithe janë në lidhshmëri të plotë me njëri-tjetrin. Me hadithin e parë tregohet se përhapja e diturisë është detyrim islam (farz), kurse me të dytin vihet në dukje fakti se hadithi, respektivisht dituria duhet të përcillet dhe të shpejgohet në mënyrë të përpiktë e të saktë, e jo sipas interesave personale, partiake, kohore etj. Disa As-habë, sidomos ata të gjeneratës së parë si: Ebu Bekri, [23] Zubejr b.el-Avvani, Ebu Ubejde b.el-Xherrahu, por edhe disa të mëvonshëm si: Enes b. Maliku, [24] Ebu

---

20 Muhammed Hamidullah, *Uvod u Islam*, Sarajevo, 1989, f. 42.

21 *Sahihu-l-Buhari*, shih në këtë libër, hadithi 104, f.168.

22 *Po aty*, hadithet 106,107,108,109, f.170/172.

23 Që të kenë kujdes njerëzit gjatë transmetimit të hadithëve, Ebu Bekri ua tërhoqi vërejtjen me këto fjalë: "Ju po transmetoni shumë hadithe nga Pejgamberi s.a.v.s. Në transmetimet tuaja bëhen shumë ndryshime. Ata që do të vijnë pas jush do të bëjnë edhe më shumë ndryshime..." (Sipas, *Sarîh-i Buhârî Muhtasarî... Mukaddime*, f. 54.)

24 Enes b. Maliku është shrpehur kështu: Hadithi "Kush më bën mua shpifje..." është hadithi që më ka ndaluar t'ju tregoj edhe më shumë hadithe".Enesi, megjithatë, është nga As-habët që kanë transmetuar shumë hadithe.

Hurejre [25] etj., duke u mbështetur në këtë hadith në fillim, kanë qenë shumë të matur dhe të rezervuar në transmetimin e tepërt të haditheve, duke u frikuar nga ndonjë gabim i mundshëm. Kjo, megjithatë, duhet kuptuar si vërejtje për gjeneratat e mëvonshme, sepse edhe këta kanë transmetuar mjaft hadithe, bile Ebu Hurejre është As-habi që ka transmetuar më së shumti hadithe.

Mirëpo, më vonë, gjatë dy-tri shekujve të parë pas vdekjes së Muhammedit a.s. nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm, filluan të qarkullojnë edhe "hadithe" të improvizuar dhe të rrejshëm. Rrugët, mënyrat dhe arsyet e krijimit të "hadithëve" të këtillë janë të ndryshme. Për shembull, dikush, duke dashur të theksojë më tepër ndonjë vepër të mirë, ose të mohojë ndonjë vepër të keqe, pra, për t'i bërë më bindëse ato, i ka ndërlidhur aty edhe fjalët e veta, e që pastaj ia ka përshkruar Pejgamberit a.s., ose, për shembull, në luftat frakcioniste, për të argumentuar qëndrimet e veta, secila anë i ka marrë si argument vetëm pjesët e hadithit që do të ishin në interes të partisë së vet. Pastaj, dolën në qarkullim edhe shumë tregime të ashtuquajtur "israilijat" dhe "nasranijat" [26] etj. Prandaj, para dijetarëve islamë, sidomos para muhaddithëve, për t'i ndarë hadithet e vërtetë nga tregimet e trilluar dhe të rrejshëm, qe shtruar një detyrë sa e vështirë aq edhe e rëndësishme. Që kjo punë të arrinte suksesin e duhur, për ulemanë ishte e qartë se çështjet duhej analizuar rrënjësisht: senedi i hadithit, d.m.th. personat që e transmetojnë hadithin, nga njëra anë dhe metni, d.m.th. teksti i hadithit, nga ana tjetër. Kështu lindi një degë e re në kuadër të hadithit që quhej "Nakdu-r-Rixhal" (Vështrimi kritik i transmetuesve). Duhej njohur jo vetëm emrat e transmetuesve të Hadithit dhe rrethanat e tyre jetësore: ku ka jetuar, si ka jetuar etj., por ka qenë e rëndësishme të vërtetohej, në radhë të parë, besueshmëria e çdo transmetuesi, sinqeriteti i tyre, vetëdija fetare e morale, fuqia intelektuale, karakteri i tyre, pastaj raporti në mes tyre d.m.th. duhej vërtetuar se a kanë pasë rast dhe mundësi që transmetuesit të mësojnë nga njëri-tjetri.[27] Lidhur me këtë u

---

25 "Sikur të mos ishin dy ajetet e Kur'anit (fjala është për ajetet 159-160 të sures Bekare) unë nuk do të kisha transmetuar asnjë hadith" thotë Ebu Hurejre (shih në këtë libër, hadithi 118, f. 181.

26 Husein Đozo, *Potreba i pokušaji savremene interpretacije i egzegeze Kur'anske misli*, Zbornik Radova Islamskog Teološkog Fakulteta u Sarajevu 1/1982, Sarajevo, 1982, f.12.

27 Nerkez Smailagiq, *Leksikon Islama*, Sarajevo, 1990, f. 221.

hartuan aq vepra biografike, që, siç do të thoshte Sami Frashëri në parathënien e Kamus el-A'lamit, po të përmenden vetëm titujt e tyre do të bëheshin katalogje të shumtë.

Nga ky përshkrim kronologjik që u tha më lart, tregohet qartë se hadithet kanë filluar të shkruhen që në kohën e Muhammedit a.s. Në fillim ata vetëm janë shkruar nga As-habët, më vonë filluan të përfshihen në përmbledhje të veçanta, së pari në formë broshurash, për t'u përfshirë pastaj edhe në përmbledhje më të mëdha. Këto përmbledhje kanë rëndësi të veçantë, sepse hadithet kështu kanë mundur të ruhen në mënyrë më besnike dhe kështu të shërbejnë si mbështetje kryesore për kompilimin e përmbledhjeve më të kompletuara. Në të vërtetë përmbledhjet e deritashme të haditheve, përveç të metave metodologjike të përgatitjes së tyre, në to, sikurse u tha më lart, kanë mundur lehtë të depërtojnë edhe "hadithe" të improvizuar të rrejshëm aq më tepër kur dihet se kjo ka qenë punë individuale.

Në shekullin e tretë hixhri (d.m.th. në shek. 9) qenë krijuar të gjitha kushtet për kompilimin e përmbledhjeve më të kompletuara të hadithit. Tani filluan të bëhen përmbledhje të haditheve të radhitura jo sipas rendit alfabetik ose në ndonjë mënyrë tjetër të papërshtatshme të senedit, por sipas tematikës së tyre. Kjo ishte metoda më aplikative dhe më e përshtatshme që një çështje, e trajtuar nga shumë anë, të marrë formë ligjore dhe të pranohet nga të gjitha qarqet.

Përmbledhjet më të rëndësishme, më të plotfuqishme dhe më të pranuara nga të gjitha qaraqet islame, sidomos nga muhaddithët, të cilët janë më kompetentët për vlerësime në këtë fushë, janë gjashtë librat, të njohura me emrin e përbashkët "El-Kutubu-s-Sitte", por, njihen edhe me emrin "Sihahu-s-Sitte", d.m.th. gjashtë përmbledhjet më të sakta dhe më të vërteta të Hadithit, të cilat, pas Kur'anit, janë burimet kryesore të Islamit. Ato janë:

1. "Sahihu" i Buhariut, i njohur me emrin "Sahihu-l-Buhari" (194-256/810-870).

2. "Sahihu" i Muslim b. el-Haxhxhaxh el-Kushejriut (204-261/819-874).

3. "Suneni" i Ebu Davud Sulejman b. el-Esh'as es-Sixhistaniut (202-275/817-888).

4. "Suneni" i Ebu Isa Muhammed b. Isa Et-Tirmidhiut (209-279/824-892).

5. "Suneni" i Ebu Abdu-r-Rahman Ahmed b. Shu'ajb en-Nesaiut (216-304/831-916).

6. "Suneni" i Ebu Abdullah b. Maxhes (209-273/824-886).

"Sahihu" i Buhariut dhe "Sahihu" i Muslimit njihen me emrin e përbashkët "Sahihajn", ose"Sahihan", d.m.th. "Dy Sahihët".

Katër përmbledhjet tjera quhen "Sunen" meqë kryesisht përmbajnë hadithe që flasin për sunnetin (traditën) e Muhammedit a.s. dhe për normat e sheriatit islam, pra për norma juridike islame.

Vlen të theksohet se edhe në mes këtyre gjashtë përmbledhjeve ka një nuansë dallimi. Sipas vlerësimeve të deritashme, "Sahihu" i Buhariut e zë kryet e vendit. Për këtë do të bëjmë fjalë veçanërisht.

3. Kategoritë e haditheve

Nga detyrat parësore të dijetarëve islamë, në radhë të parë të muhaddithëve ishte që çështjes së Hadithit t'i qasen edhe nga një aspekt tjetër; të bëjnë klasifikimin e haditheve, meqë, sikurse u tha më lart, në rrethana të ndryshme kishin dalë në qarkullim edhe "hadithe" me qëllime tendencioze, të trilluar dhe të rrejshëm.

Kategorizimi i haditheve është çështje shumë e rëndësishme, madje e domosdoshme në shkencën e Hadithit, sepse ndarja e haditheve në kategori, vetvetiu do të nënkuptonte shkallën e besueshmërisë dhe të saktësisë së haditheve, e me këtë, natyrisht, do të dihej qartë se cili hadith do të ishte i pranueshëm plotësisht, cili do të pranohej me ndonjë rezervë dhe cili do të refuzohej tërësisht.

Në mbështetje të literatirës që kemi, [28] kemi vënë re se muhaddithët, për të bërë kategorizimin e haditheve, kanë pasur për bazë disa kritere:

a. në çfarë shkalle është cilësia e transmetuesve (râvive)?

b. numri i transmetuesve (të besueshëm) është i shumtë ose i paktë?

---

28 Për ndarjen e haditheve në kategori jemi mbështetur kryesisht në: *Sahih-i Buhari Muhtasari... Mukaddime* (shih literaturën në fund).

c. a ka mosndërprerje, respektivisht ndërprerje të hallkave të zinxhirit të senedit (ose isnadit)?

Në vazhdim do të ndalemi në secilin nga këto pika, por pa pretendim se do ta trajtojmë hollësisht këtë çështje.

A. Duke pasur parasysh cilësinë e transmetuesve, d.m.th. shkallën e besueshmërisë së tyre, ose, duke patur parasysh mosndërprerjen, respektivisht ndërprerjen e hallkave të zinxhirit të senedit, hadithet ndahen në: *Sahih, hasen* dhe *da'if* (zaif).

Hadithi Sahih: është hadithi i cili është transmetuar nga senedi i pakëputur, i pandërprerë, që transmetuesi me transmetuesin të jenë në lidhshmëri të plotë me njëri-tjetrin prej fillimit deri në fund, por me kusht që të gjithë transmetuesit të jenë shumë të besueshëm, në mes tyre të mos ketë asnjë transmetues që në besueshmërinë e tij të ketë sado pak dyshim. Prandaj, për të qenë një hadith sahih (plotësisht i vërtetë) duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Hadithi duhet të jetë i transmetuar me senedin e pakëputur. Të gjithë personat që transmetojnë hadithin duhet të jenë të përmendur dhe të njohur, në radhë të parë si muhaddithë.

- Të gjithë transmetuesit që e transmetojnë hadithin përkatës, pa kurrfarë përjashtimi duhet të jenë të besueshëm, të drejtë, të sinqertë dhe si të tillë të jenë shumë të njohur nga të tjerët, pra askush të mos dyshojë në sinqeritetin e tyre. Ata që nuk i kanë këto karakteristika dhe këto cilësi, nuk mund të konsiderohen si njerëz të besueshëm.

- Të gjithë transmetuesit duhet ta transmetojnë hadithin në mënyrë të besueshme, pa ndryshimin edhe më të vogël të tekstit (metnit), pra ashtu si e ka thënë Pejgamberi a.s. Çdo ndryshim i vogël i hadithit, do t'ia humbte karakterin e hadithit sahih.

- Të jetë i pranueshëm si sahih nga të gjitha qarqet islame.

Hadithi Hasen: është hadith i besueshëm, i sigurt, por natyrisht, jo i nivelit të hadithit sahih, sepse në mes transmetuesve mund të gjendet ndonjë element papajtueshmërie edhe në qoftë ai element shumë i vogël, i parëndësishëm. Këtë dallim bile mund ta vërejë vetëm syri i muhaddithit. Edhe hadithi hasen është kategori e besueshme e Hadithit dhe është shumë i përhapur prandaj edhe i pranueshëm.

Hadith da'if (zaif): është hadithi që nuk i përmban karakteristikat e hadithit sahih dhe të hadithit hasen. Me fjalë të tjera, hadithet da'if janë hadithet, besueshmëria e të cilëve seriozisht mund të vehet në dyshim, si në metnin (tekstin) si në senedin e tij. Në grupin e hadithit da'if bëjnë pjesë hadithet: mudraxh, metruk, mevdu' etj. Hadithet da'if, sikurse u tha më sipër, janë paraqitur në mënyra të ndryshme. Kur transmetuesi në mes fjalëve të Pejgamberit a.s. ka futur edhe fjalët e veta për të vërtetuar më bindshëm ndonjë vepër të mirë ose për ta mohuar ndonjë vepër të keqe, ose kur tërë thënien e vet ia përshkruan Pejgamberit a.s. quhet *mevdu'*. Kur transmetuesi transmeton hadithin me një sened të ndryshueshëm, duke mos shkuar sipas radhitjes ose e ndryshon tekstin (metnin) e hadithit, duke e nxjerrë një pjesë para tjetrës quhet mudrexh. Nuk e shohim të udhës të flasim për hadithet tjerë të kësaj kategorie.

B. Sipas numrit të transmetuesve që marrin pjesë në transmetimin e Hadithit, respektivisht, sipas rrugëve (turuk) dallohen:

Hadithi Mutevatir: është hadithi që transmetohet nga shumë anë, nga shumë senede dhe nga transmetuesit më të besueshëm. Ky lloj i hadithëve është më i besueshëm, prandaj çdo hadith mutevatir është sahih. Sipas mendimit të disave, mohimi i hadithit mutevatir e nxjerr personin nga Islami.

Meshhur: sipas muhaddithëve, meshhur është hadithi i cili transmetohet nga më së paku tre senede, transmetuesit e të cilit janë shumë të besueshëm. Sipas disave, transmetuesi i parë, pra As-habi në të tri senedet është i njëjti person. I afërt me të është hadithi mustefiz.

Aziz: është hadithi që transmetohet së paku nga dy transmetues.

Ahad (ose *Vahid*): quhet hadithi që transmetohet vetëm nga një person, në brezin e Tabiinëve.

Garib: është hadithi i cili transmetohet nga një person, pavarësisht se në cilin brez. Hadithit garib i thonë edhe ferd, që mund të jetë mutlak dhe nisbi.

Meqë transmetohen nga njerëzit më të besueshëm të gjithë hadithet e kësaj kategorie janë hadithe sahih.

C. Në bazë të asaj se kujt i referohet hadithi, përkatësisht ku mbështetet senedi, hadithet ndahen në:

Merfû': quhet hadithi, senedi i të cilit mbështetet te Pejgamberi a.s. drejtpërdrejt, respektivisht, kur As-habi në mënyrë të qartë thotë (si për fjalë

si për vepër si për pëlqim); *"E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë...", "Na ka treguar Pejgamberi s.a.v.s. këtë...", "Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.... kështu", "nga Pejgamberi s.a.v.s....; ose, "E kam parë Pejgamberin s.a.v.s. duke punuar këtë...", "Vërtet, Pejgamberi s.a.v.s. vepronte kështu..."; ose, "Në praninë e Pejgamberit s.a.v.s. kam punuar këtë...", "Në praninë e Pejgamberit a.s. filani ka vepruar kështu..."* etj. Pra vargu i transmetuesve shkon deri te Pejgamberi a.s.

Mevkûf: është hadithi që senedi i tij ndalet te fjala, te vepra ose te porosia e As-habëve, p.sh. *Ibni Abbasi ka thënë kështu,* ose *ka vepruar kështu,* ose *këtë gjë e ka shpejguar kështu.*

Maktû': është hadithi, senedi i të cilit mbështetet te fjala, te vepra ose te porosia e Tabi'inëve ose te Tebei-t-Tabi'inët.

Ç. Në bazë të mosndërprerjes, respektivisht të ndërprerjes së senedit, hadithet ndahen në:

Muttasil: është hadithi, senedi i të cilit është i plotë dhe i pakëputur, i pandërprerë, d.m.th. është hadithi të cilin e transmeton muhaddithi duke i përmendur një nga një me radhë të gjithë transmetuesit e hadithit deri te Pejgamberi a.s. ose deri te As-habët, ose edhe deri te Tabi'inët. Quhet edhe *Mevsul.*

Ali: është hadithi, senedi i të cilit është i plotë, por i shkurtër.

Mu'an'an: quhet hadithi, senedi i të cilit lidhet me parafjalën "'an" (d.m.th. "nga, prej").

Mursel: Hadithi që transmeton ndonjë nga Tabi'inët drejtpërdrejt nga Pejgamberi a.s. pa e përmendur emrin e As-habit, quhet *Mursel.*

Munkati': është hadithi, senedi i të cilit nuk është i plotë, përkatësisht mungon transmetuesi në brezin e Tebei-t-Tabi'inëve.

Mu'dal: është hadithi që i mungojnë dy ose më shumë transmetues në mes të senedit.

Mubham: quhet hadithi kur transmetuesi nuk përmenden me emra në sened, por me "nga filani, e ky nga filani".

Për ta rrumbullakuar këtë çështje, vlen të theksohet se për kategorizimin e Hadithit janë bërë vepra të veçanta, që do të thotë se kjo lëmi është shumë

e gjerë. Madje edhe për definicionet e tyre, dijetarët islamë nuk kanë mendime të njëjëta. [29]

Buhariu dhe Sahihu i tij

Ebu Abdullah Muhammed b. Ismail b. Ibrahim b. el-Mugire b. el-Xhu'fi el-Buhariu, biografinë e të cilit e shënon edhe Sami Frashëri në Kamus al-A'lam [30], u lind në Buhara në vitin 194/810. Pasi i mori mësimet e para dhe pasi u pajis me dije solide, Buhariu që në moshën fëmijërore, me tërë qenien e vet, u dha pas mësimit të diturive islame, sidomos pas Hadithit. Ai që në moshën 10 vjeçare qe bërë hafiz i Kur'anit, kurse në moshën 16 vjeçare, sipas biografëve, i dinte përmendsh mbi 60 mijë hadithe. Në pyetjen e njërit, ai qe përgjigjur: "Di edhe më tepër se kaq, bile nëse më pyet edhe për As-habët dhe Tabi'inët që i transmetojnë hadithet, për secilin prej tyre mund të të përgjigjem se kur kanë lindur, kur kanë vdekur, prej nga rrjedhin, sa kanë qenë të besueshëm dhe marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin". Kjo do të thotë se të mbajturit mend ishte veçori e tij e jashtëzakonshme. Në moshën 16 vjeçare shkoi në Mekke dhe në Medine, ku pat rast të mësojë Hadithin nga dijetarët më në zë të kësaj fushe. Mirëpo, për të hulumtuar dhe për t'u specializuar edhe më në këtë fushë islame, ai i shëtiti edhe kryeqendrat tjera të shtetit islam. Pasi qëndroi një kohë të gjatë në Horasan, Irak, Sham, Hixhaz, Misir etj., dhe pasi mësoi dhe pasi shfrytëzoi përvojën e muhaddithëve të famshëm, numri i të cilëve e kalonte njëmijëshin, në mesin e të cilëve ishin edhe Ahmed b. Hambeli, Ebu Nu'ajm Isfihaniu, el-Humejdiu, Ebu-l-Jemane, Ibni Râhûje, Ibnu Ebi Shejbe etj., u kthye në Bagdad. Zgjuarësinë, zotësinë dhe njohurinë që e kishte për Hadithin ia pranuan të gjithë bashkëkohanikët e tij, saqë kishte të tillë që thonin se "Hadithi që nuk e di Buhariu nuk është hadith". [31] Kah fundi i jetës së vet u kthye në vendlindje, në Buhara, mirëpo, meqenëse nuk u pajtua me valiun e Buharasë, Halid b. Ahmedin, i cili e detyronte që t'i mësojë vetëm fëmijët e tij, Buahriu, duke mbrojtur qëndrimin se në Islam të gjithë janë të barabartë, qe i shtrënguar ta lëshojë Buharanë.

---

29 Nerkez Smailagiq, *vep. e cituar*, f. 222.

30 Samy-bej Frasheri, Kamus al-A'lam, 2, Stamboll, 1889, f. 1251.

31 *Po aty*, f. 1251.

Shkoi në fshatin Hertenk të rrethinës së Samarkandit dhe aty, natën e Fitr-Bajramit, në vitin 256/870, në moshën 62 vjeçare, vdiq.

Buhariu shkroi shumë vepra të njohura për Hadithin, për historinë për biografinë e As-habëve, Tabi'inëve, respektivisht për transmetuesit e Hadithit etj., që mund të shihen në sa vijon: "El-Edebu-l-Mufred", "Kitabu esmâ-i Sahabe", "Kitabu ef'ali-l-ibâd", "Kitabu bed'i-l-mahlukat", "Tarihu-l-Buhara", "Kitabu-l-kiraeti halfel-Iman", "Kitabu-th-Thelathijat", "el-Xhami'u-l-Kebir", "el-Xhami'u-s-Sagir", "Târîhu-th-Thikâti ve-d-Du'afâi min ruvât-i-Hadîthi" etj.

Megjithatë, vepra e tij më e vlefshme dhe më e rëndësishme, vepra që e bëri Buhariun të pavdekshëm, vepra për të cilën Buhariu shpenzoi më shumë kohë (16 vjet), vepra e cila, pas Kur'anit, është burim themelor i Islamit, Vepra që përfshin vetëm hadithet sahih, është përmbledhja e haditheve "el-Xhami'u-s-Sahih", e njohur sot me emrin "Sahihu-l-Buhari", apo e njohur ndër besimtarët shqiptarë si "Buhari Sherifi".

Megjithëse deri në kohën e Buhariut, sikurse u tha më lart, ishin bërë një mori përmbledhjesh të haditheve, prapëseprapë, hetohej nevoja e madhe për hartimin e një përmbledhje vetëm të *haditheve sahih*. Idenë për hartimin e një përmbledhje të tillë e kishte dhënë Is-hak b. Râhûje, mësues i Buhariut. Kur një ditë pranë tij ishin disa muhaddithë, në mesin e të cilëve edhe unë - thotë Buhariu - ai tha: *"Ah sikur t'i tubonit në një libër vetëm hadithet e Pejgamberit a.s., d.m.th. vetëm hadithet sahih!"* Këto fjalë të tij ndikuan thellë te unë, thotë Buhariu, prandaj ia fillova punës menjëherë. Nga 600.000 hadithe që i kisha mbledhur, duke e analizuar secilin prej tyre në mënyrë të veçantë, i ndava vetëm hadithet sahih. Asnjë hadith nuk e kam radhitur në këtë përmbledhje - vazhdon Buhariu- pa marrë abdest e pa falur dy reqate namaz-nafile, duke e lutur All-llahun xh.sh. të më frymëzojë e të më ndihmojë në zgjedhjen e haditheve sahih. Për përgatitjen e kësaj përmbledhje kam shpenzuar 16 vjet dhe krahas tekstit të hadithit e kam shënuar edhe senedin e tij, d.m.th. emrat e të gjithë transmetuesve, numri i të cilëve arrin në mbi 1000, thotë Buhariu.

Buhariu e ka ndarë Sahihun e vet sipas tematikës në 97 libra, siç i quan ai kitabe, që flasin për fillimin e Shpalljes, besimin (imanin), diturinë, abdestin, namazin, haxhxhin, shitblerjen, komentimin e disa ajeteve të Kur'anit, për kadanë dhe kaderin, për trashëgiminë, për respektin ndaj njëri-tjetrit, për marrëdhëniet në familje etj., me një fjalë tema nga tërë jeta

e njeriut. Librat (kitabet) janë të ndarë në njësi (bâb-e) dhe tërë përmbledhja përfshinë 3450 njësi (bâbe). Bâb-i mund të ketë një ose më shumë hadithe. Çdo bâb është i titulluar, mirëpo ka edhe përjashtime. Sipas shënimeve që i gjejmë te "Fet-hu-l-Bâri..." të Ibni Haxher el-Askalaniut, në Sahihun e Buhariut janë përfshirë rreth 8000 hadithe, prej tyre 2761 janë të papërsëritur. Sipas disa muhaddithëve, ndërkaq, të papërsëritur janë rreth 4000 hadithe. Në këtë përmbledhje Buhariu ka dhënë edhe disa shpjegime të nevojshme gjuhësore.

Me ndarjen e hadithеve sipas tematikës së tyre Buhariu i vuri themelet e shkencës së Hadithit, rrugën e të cilit e ndoqi edhe Muslimi, i cili e la pas vetes përmbledhjen e hadithеve me emrin *Sahihu-l-Muslim.* Të dyja këto përmbledhje u quajtën me një emër *"Sahihajn"* (Dy Sahihët). Buhariu në zgjedhjen e hadithеve sahih, kishte kritere shumë të rrepta. Ai, sipas fjalëve të Hazimit dhe Ismailit, është shrehur kështu: *"Hadithet sahih që nuk i kam përfshirë në librin tim janë më shumë se ata që i kam përfshirë këtu",*[32] ose në një rast tjetër thotë: *"Në këtë libër nuk kam shkruar hadith tjetër përveç hadithеve sahih. Edhe hadithet sahih që nuk i kam shkruar janë më shumë se ata që i kam shkruar këtu. Ata i kam lënë me qëllim që të mos e zgjeroj* (ngarkoj) *për së tepërmi këtë libër".* Për këtë arsye pra, hadithet sahih që nuk janë përfshirë në Sahihun e Buhariut dhe të Muslimit, do të përfshihen në Sunenet e Ebu Davudit, Tirmidhiut, Nesaiut dhe të Ibni Maxhes.

Vlen të theksohet se merita e Buhariut dhe e hartuesve të Sahihëve të tjerë nuk qëndron aq shumë në atë se ata për herë të parë bënë ndarjen e hadithеve që ishin në qarkulllim , se cilët nga ai numër ishin të vërtetë e cilët jo të vërtetë, sa në atë se ata i kanë mbledhur të gjithë ata hadithe të cilët deri në atë kohë përgjithësisht dhe plotësisht kanë qenë të pranuar si të besueshëm nga të gjitha shkollat burimore islame.[33]

Duke pasë parasysh kohën, gjuhën dhe stilin e hadithеve, e me qëllim që ata të kuptohen më mirë dhe më drejtë, për Sahihun e Buhariut (dhe për të tjerët) janë bërë studime dhe komente të shumtë dhe të gjithanshëm nga ana e muhaddithëve. Natyrisht, secili koment dhe studim ka vlerën dhe peshën e

32 *Sahih-i Buhari Muhtasari, Tecrid-i Sarih Tercemesi ve Şerhi,* Ankara 1984, f. 63.

33 Nerkez Smailagiq, *vep. e cituar,* f. 223.

vet, por komenti më i plotë, më gjithpërfshirës, sipas vlerësimeve të dijetarëve islamë, pa dyshim është *"Fet-hu-l-Bâri bisherhi-l-Buhari"* i Ahmed b. Ali b. Haxher el-Askalaniut. Kjo vepër e Aksalaniut të cilën e kemi në dorë është përfshirë në 13 vëllime, duke mos e llogaritur vëllimin e veçantë të hyrjes. Hyrjen e këtij komenti Askalaniu e ka shkruar më 1411, kurse komentin ka filluar ta shkruajë 1414 për ta përfunduar më 1438.

Sahihu-l-Buhari është përkthyer në shumë gjuhë, ndonëse ende jo në tërësi.

Në gjuhën turke, krahas përkthimit të 1646 haditheve të zgjedhur nga *Sahihu-l-Buhari* nga ana e Konjali Mehmed Vehbiut, të përfshirë në katër vëllime me titull *"Sahih-i Buhari Tecridi Sarihi Muhtasarı"* të botuar më 1966, është edhe verzioni i zgjeruar me titull *"Sahih-i Buhari Muhtasarı Tecridi Sarih Tercemesi ve Şerhi"*, përkthyer nga Ahmed Naimi dhe Kâmil Mirasi. Ky version përbën 13 vëllime, ku janë të përfshirë 2189 hadithe. Vëllimi i 13-të përfshinë indeksin të përgatitur nga Muxhteba Ugur dhe M. Xhemal Sofuoglu. Është botuar në Ankara dhe ka përjetuar disa ribotime. Ne e kemi në dorë botimin e vitit 1984 (botimi i gjashtë). Në vëllimin e parë përfshihet një studim i thellë për shkencën e Hadithit që kap rreth 500 faqe, përkthyer nga gjuha arabe nga ana e Ahmed Naimit. Përveç përkthimit të tekstit të hadithit jepen edhe shpejgimet e nevojshme.

Interesimi për mësimin dhe studimin e *Sahihu-l-Buhariut* te boshnjakët është i kahmotshëm, që para Luftës së Parë Botërore. Megjithatë, punën më të madhe në këtë gjuhë e bëri Hasan ef. Shkapuri i cili arriti të përkthejë gati gjysmën e Sahihut të Buhariut që e përfshiu në katër libra me një koment shumë të vlefshëm. Mjerisht këtë punë të vlefshme ef. Shkapuri nuk arriti ta përfundojë plotësisht sepse e ndërpreu vdekja.

Në gjuhën shqipe, ndërkaq, deri më tash, sa jemi në dijeni, nuk është bërë ndonjë përpjekje që *Sahihu-l-Buhari,* kjo vepër madhështore, të përkthehet në tërësi. Nevoja e përkthimit të kësaj përmbledhje të famshme të hadithe sahih në gjuhën shqipe, pa dyshim, është e madhe, sidomos këto vitet e fundit, kur në qarkullim, për arsye të ndryshme, po dalin lloj-lloj broshurash të përkthyera. Përkthimi i burimeve themelore të Islamit: i Kur'anit (për fat të mirë tash kemi disa përkthime në gjuhën shqipe) dhe i Hadithit do t'ia mundësonte shqiptarëve muslimanë që Islamin ta mësojmë dhe ta kuptojnë nga rrënja, aq më tepër kur dihet se numri i lexuesve fatmirësisht, është në rritje. Duke e hetuar këtë zbrazëti, grupi punues i përbërë prej shtatë vetëve

i hyri realizimit të këtij projekti - përkthimit të Sahihu-l-Buhariut - dhe në fazën e parë, sipas ndarjes që e kemi bërë pritet të dalin nga shtypi 8 libra, që krahas tekstit origjinal në gjuhën arabe do ta kenë edhe përkthimin. Radhitja e tyre është:

Libri 1, Mehdi Polisi; Libri 2. Abdullah Hamidi; Libri 3 dhe 4 Feti Mehdiu; Libri 5, Ismail Ahmedi; Libri 6, Ruzhdi Lata; Libri 7, Isa Memishi; Libri 8, Bahri Aliu.

Sa është i vlefshëm përkthimi dhe mësimi i *Sahihu-l-Buhariut* mjafton të theksohen fjalët e fakihut të mirënjohur boshnjak, Husein Gjozo: "Mendoj, thotë ai, se në çdo shtëpi tonën, krahas përkthimit të Kur'anit duhet të qëndrojë edhe përkthimi i Sahihu-l-Buhariut. Kjo do të ishte mirënohje e vërtetë dhe ndihmë e parë".

Prishtinë, 30 qershor 1994 *Mehdi POLISI*

Disa shënime për përgatitjen e Librit të parë

- Kjo vepër që po i ofrohet lexuesit shqiptar përbëhet nga pjesët që flasin për: Fillimin e Shpalljes, besimin (imanin), diturinë, abdestin, larjen (guslin), menstruacionin dhe tejemmumin. Përfshin 242 njësi (bâbe) me gjithsje 348 hadithe.

- Vargun e transmetuesve (senedin) e kemi përkthyer me një stil më të lirë, natyrisht, duke e ruajtur radhitjen e tyre.

- Ajetet e Kur'anit i kemi përkthyer aq sa qëndrojnë në tekstin origjinal. Në fund të përkthimit të tyre e kemi shënuar emrin e sures dhe numrin e ajeteve, me qëllim që lexuesi ta gjejë më lehtë në Kur'an. Në tekstin origjinal, në të shumtën e rasteve, ajetet janë dhënë të shkëputur d.m.th. është dhënë një pjesë e ajetit; nganjëherë fillimi i ajetit, nganjëherë fundi e nganjëherë vetëm mesi, varësisht nga tematika e çështjes për të cilën bëhet fjalë.

- Për arsye që të kuptohet më lehtë, herë-herë kemi qenë të shtrënguar të japim shpjegime brenda tekstit të përkthyer. Ata shpjegime i kemi futur në kllapa.

- Terminologjinë islame, për shkak të ruajtjes së besnikërisë së saj, e kemi përdorur kryesisht si në origjinal, ose ashtu sikurse njihet te ne. Që të kuptohet më mirë, termat islame të përdorur në këtë libër i kemi shpjeguar në formë të fjalorit.

- Komentin e kemi marrë kryesisht nga *"Sahihul-Buhari"* të Hasan ef. Shkapurit, ndonëse e kemi konsultuar edhe komentin e *"Fet-hu-l-Bâri bi-sherhi Sahihu-l-Buhari"* të el-Askalaniut dhe komentin nga "Sahih-i Buhari Muhtasari..." (shih literaturën).

Gjatë punës sonë, natyrisht kemi hasur në vështirësi. Megjithatë, vullneti dhe angazhimi ynë i pakursyer bëri të mundur që të tejkalojhen ato vështirësi dhe kështu lexuesi shqiptar për herë të parë ta ketë në dorë këtë vepër të rëndësishme dhe shumë të çmueshme. Jam i vetëdijshëm për gabimet e mundshme. Vërejtjet dhe sugjerimet e lexuesit të sinqertë do të ndihmojnë përsosjen e vepres me rastin e ribotimit.

Dëshiroj me këtë rast të falënderoj përzemërsisht të gjithë ata që patën durim ta lexojnë këtë vepër në dorëshkrim, sidomos recenzentin profesional, Bahri ef. Aliun, recenzentin gjuhësor, prof. Mahmud Hysën dhe redaktorin teknik, Nysret S. Simnicën, pa angazhimin e të cilëve kjo vepër nuk do të ishte kështu si është.

M.P.

صحيح البخاري

لأبي عبد الله محمد بن إسماعيل بن إبراهيم
ابن المغيرة بن بردزبه البخاري الجعفي
رضي الله تعالى عنه ونفعنا به
آمين

الجزء الأول

1. Fillimi i Shpalljes

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

١ - كتاب بدء الوحي

قال الشيخُ الإمامُ الحافِظُ أبو عبدِ اللهِ محمدُ بنُ إسْمٰعِيلَ بنِ إبراهيمَ بنِ المُغِيرَةِ البُخارِيُّ رَحِمَهُ اللهُ تعالىٰ آمين

باب كيف كان بدء الوَحْيِ إلىٰ رسولِ اللهِ ﷺ

وقَوْلِ اللهِ جَلَّ ذِكْرُهُ ﴿ إنّا أوْحَيْنا إليكَ كما أوْحَيْنا إلى نُوحٍ والنَّبِيِّينَ مِنْ بَعْدِهِ ﴾

Bismi-l-Lahi-r-Rahmani-r-Rahim

1. Fillimi i Shpalljes

Eruditi, prijësi dhe hafizi, Ebu Abdullah Muhammd b. Ismail b. Ibrahim b. Mugire el-Buhari, All-llahu i Madhërueshëm e mëshiroftë atë, Amin! ka thënë:

"Si i ka filluar Shpallja Pejgamberit s.a.v.s.!".

E, (lidhur me këtë) **All-llahu i Madhërueshëm** (në Kur'an) **thotë:**

Ne ta kemi dërguar ty Shpalljen, siç ia kemi dërguar Nuhit dhe Pejgamberëve pas tij...".[1]

(en-Nisâ', 163).

1 Shkaku i shpalljes së ajeteve 163-166 të sures en-Nisâ' është kërkesa e ithtarëve të shpalljes të mëparshme që Muhammedi a.s. t'ua dërgojë Shpalljen e plotë përmjëherë,

١ - حدثنا الحميدي عبد الله بن الزبير قال حدثنا سفيان قال حدثنا يحيى بن سعيد الأنصاري قال أخبرني محمد بن إبراهيم التيمي أنه سمع علقمة بن وقاص الليثي يقول سمعت عمر بن الخطاب رضي الله عنه على المنبر قال: سمعت رسول الله ﷺ يقول « إنما الأعمال بالنيات ، وإنما لكل امرئ ما نوى : فمن كانت هجرته إلى دنيا يصيبها ، أو إلى امرأة ينكحها ، فهجرته إلى ما هاجر إليه »

1. Na ka treguar Humejdi Abdullah b. Zubejri, këtij Sufjani, këtij Jahja b. Se'id Ensariu, e këtë e kishte njoftuar Muhammed b. Ibrahim Tejmiu se e ka dëgjuar Alkame b. Vekkas Lejthiun duke thënë: E kam dëgjuar Umer b. Hattabin r.a. kur në minber tha se e kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s, duke thënë:

"Veprat çmohen vetëm sipas qëllimeve. Çdonjërit i takon vetëm ajo për të cilën ka menduar (ka për qëllim). **Kush shpërngulet me qëllim që të arrijë të mira në këtë botë, ose për shkak të femrës me të cilën do të martohej, shpërngulja e tij do të jetë ajo për të cilën edhe është shpërngulur".**[2]

---

ashtu si ka vepruar Musai a.s. All-llahu xh.sh. me ajetet e sipërshënuara dëshmon qart se Muhammedi a.s. është Pejgamber dhe se Shpallja i është dërguar në të njëjtën mënyrë siç u është dërguar edhe Pejgamberëve të tjerë të mëparshëm.

Në ajet, në vedin e parë është përmendur pejgamberia e Nuhit, para të cilit kanë qenë Pejgamberët: Ademi, Shiti dhe Idrizi. Kjo me siguri, se ai është babi i dytë i njerëzimit dhe se njerëzimi (pas vërshimit të përgjithshëm - tufanit) fillon nga tre bijtë e tij: Samit, Hamit dhe Jafetit, të cilët vërshimin e përgjithshëm e përjetuan në anije së bashku me bashkëshortet dhe babain e tyre, Nuhin.

2 Të gjithë Pejgamberët kanë thirrur në parimet themelore të fesë. Në mesin e këtyre parimeve është edhe kjo se veprat e njerëzve çmohen sipas qëllimeve të tyre të sinqerta. Fjala *bi-n-nijjât* do të thotë "qëllim i sinqertë".

Shkaku i hadithit të sipërshënuar ka të bëjë me rastin e një njeriu i cili kërkoi të martohet me një vajzë me emrin Ummu Kajs. Ajo e refuzoi atë përderisa nuk shpërngulet për në Medine. Duke dashur të martohet me të, ai më në fund u shpërngul dhe u martua.

Disa mendojnë se ky rast lidhet me martesën e Ummu Sulejmes dhe Ensariut, Ebu Talhait, i cili ende nuk e kishte pranuar Islamin. Kjo femër e kishte refuzuar propozimin e Ebu Talhait, duke i thënë: "Ti je jomusliman, e unë muslimane. Feja nuk më lejon që të martohem me ty. Sapo të përqafosh Islamin, do të martohemi. Pranimi i Islamit nga ana yte, le të jetë dhurata ime bashkëshortore. Asgjë tjetër nuk kërkoj".

باب * ٢ - حدثنا عبد الله بن يوسف قال أخبرنا مالك عن هشام بن عروة عن أبيه عن عائشة أم المؤمنين رضي الله عنها أن الحارث بن هشام رضي الله عنه سأل رسول الله ﷺ فقال: يارسول الله كيف يأتيك الوحي؟ فقال رسول الله ﷺ «أحيانا يأتيني مثل صلصلة الجرس وهو أشده علي فيفصم عني وقد وعيت عنه ماقال، وأحيانا يتمثل لي الملك رجلا فيكلمني فأعي ماأقول». قالت عائشة رضي الله عنها: ولقد رأيته ينزل عليه الوحي في اليوم الشديد البرد فيفصم عنه وإن جبينه ليتفصد عرقا

2. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, ky nga Maliku, ky nga Hisham b. Urve, ky nga babai i tij, ky nga Aishja r.a., nëna e besimtarëve, e cila transmeton se Harith b. Hishami r.a. e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"O Resulullah, si të vjen ty Shpallja (Vahji)?"

Pejgamberi s.a.v.s. i qe përgjigjur atij:

"Herë-herë më vjen si tingujt e ziles. Kjo për mua është mënyra më e vështirë e Shpalljes, e më ndërpritet pasi ta kem mbajtur në mend atë që më është thënë. Dhe, herë-herë meleku (Xhibrili) **më paraqitet në formë njeriu. Ai më flet dhe unë e mbaj në mend atë që më thotë".**

Aishja r.a. është shprehur kështu:

Sipas kësaj, ky hadith nuk ka të bëjë vetëm me braktisjen e Mekkes dhe shkuarjen në Medine, por edhe me lënien e mosbesimit dhe të shoqërisë së pamoralshme, duke iu bashkkuar rrethit fetaro-moral, rregullimit demokratik të shoqërisë me karakter të mësimeve islame.

Ibni Batali mendon se akti i shpërnguljes për shkak martese është përmendur këtu se, pikërisht, raste të tilla kanë ndodhë. Në periudhën paraislame arabët nuk kanë dashur të martohen me robëreshat e liruara, përkatësisht me robërit, bile-bile, edhe me fëmijët e tyre. Të liruarit janë konsideruar si qytetarë të rendit të dytë. Megjithatë, në Islam të gjithë njerëzit në mes tyre janë vëllezër të barabartë, dhe prejardhja fisnore nuk guxon të mbizotërojë në asnjë sferë të jetës njerëzore. Duke u mbështetur në këto mësime, shumë idhujtarë e braktisën Mekken, u transferuan në Medine dhe e pranuan Islamin, duke dashur që në rrethin me vizione të gjera të botës femërore, të martohen me ato të cilat vetë i zgjedhin.

Muhammedi a.s. në një rast ka thënë: "Shpërblimi i Hixhretit është hequr dhe është ndërprerë me çlirimin e Mekkes, kurse shpërblimi për luftë në rrugën e All-llahut dhe për qëllime të mira e të sinqerta vazhdon edhe më tutje".

"E kam parë atë (Pejgamberin s.a.v.s) **duke i zbritur atij Shpallja në ditët shumë të ftohta, dhe kur i ndërpritej** (Shpallja), **vërtet, ballin ende e kishte qull me djersë".**

باب * ٣ - حدثنا يحيى بن بكير قال حدثنا الليث عن عقيل عن ابن شهاب عن عروة بن الزبير عن عائشة أم المؤمنين أنها قالت : أول ما بدئ به رسول الله ﷺ من الوحي الرؤيا الصالحة في النوم ، فكان لا يرى رؤيا إلا جاءت مثل فلق الصبح . ثم حبب إليه الخلاء ، وكان يخلو بغار حراء فيتحنث فيه - وهو التعبد - الليالي ذوات العدد ، قبل أن ينزع إلى أهله ويتزود لذلك ، ثم يرجع إلى خديجة فيتزود لمثلها ، حتى جاءه الحق وهو في غار حراء ، فجاءه الملك فقال : اقرأ . قال : ما أنا بقارئ . قال : فأخذني فغطني حتى بلغ مني الجهد ، ثم أرسلني فقال : اقرأ . قلت : ما أنا بقارئ . فأخذني فغطني الثانية حتى بلغ مني الجهد ، ثم أرسلني فقال : اقرأ . فقلت : ما أنا بقارئ . فأخذني فغطني الثالثة ، ثم أرسلني فقال : ﴿اقرأ باسم ربك الذي خلق ، خلق الإنسان من علق . اقرأ وربك الأكرم﴾ فرجع بها رسول الله ﷺ يرجف فؤاده ، فدخل على خديجة بنت خويلد رضي الله عنها فقال : زملوني زملوني . فزملوه حتى ذهب عنه الروع ، فقال لخديجة وأخبرها الخبر : لقد خشيت على نفسي . فقالت خديجة كلا والله ما يخزيك الله أبدا ، إنك لتصل الرحم ، وتحمل الكل ، وتكسب المعدوم ، وتقري الضيف ، وتعين على نوائب الحق . فانطلقت به خديجة حتى أتت به ورقة بن نوفل بن أسد بن عبد العزى - ابن عم خديجة - وكان امرءا تنصر في الجاهلية ، وكان يكتب الكتاب العبراني ، فيكتب من الإنجيل بالعبرانية ما شاء الله أن يكتب ، وكان شيخا كبيرا قد عمي ، فقالت له خديجة : يا ابن عم اسمع من ابن أخيك . فقال له ورقة : يا ابن أخي ماذا ترى ؟ فأخبره رسول الله ﷺ خبر ما رأى . فقال له ورقة : هذا الناموس الذي نزل الله على موسى ، يا ليتني فيها جذعا ، ليتني أكون حيا إذ يخرجك قومك . فقال رسول الله ﷺ : أو مخرجي هم ؟ قال نعم ، لم يأت رجل قط بمثل ما جئت به إلا عودي ، وإن يدركني يومك أنصرك نصرا مؤزرا . ثم لم ينشب ورقة أن توفي ، وفتر الوحي

3. Na ka treguar Jahja b. Bukejri, këtij Lejthi, ky nga Ukajli, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Urve b. Zubejri, ky nga Aishja, nëna e besimtarëve, e cila ka thënë:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. për herë të parë ka filluar të marrë Shpalljen, ishin ato ëndrra të mira, që i përjetonte në gjumë. Nuk ka pasur ndonjë ëndërr që nuk do t'i dilte qartë si agimi i mëngjesit. Pastaj ai u dashura në vetminë. Vetmohej në shpellën Hira dhe aty ruhej (nga gabimet) **dhe lutej** (bënte vazhdimisht ibadet) **me net të tëra, para se të**

zbriste te familja e tij që të furnizohej me ushqim për këtë qëllim. Pastaj, kthehej te Hatixhja dhe furnizohej si më parë. (Kështu veproi) **derisa i erdhi E VËRTETA kur ai ndodhej në shpellën Hira.**

I erdhi meleku dhe i tha: **"Ikre"**, d.m.th. **"Lexo, mëso!"**

"Nuk di të lexoj", i qe përgjigjur (Pejgamberi s.a.v.s.).

"Më mori, tha ai (Muhammedi), **dhe më shtrëngoi aq sa më kaploi mundimi, e pastaj më lëshoi dhe më tha: "Ikre"**, d.m.th. **"Lexo, mëso!"**

"Nuk di të lexoj", i thashë, **e ai** (Xhibrili) **më mori dhe për herë të dytë më shtrëngoi derisa më kapi mundimi, pastaj më lëshoi dhe më tha:**

> ***"Ikre'..."**, d.m.th. "Lexo në emër të Zotit tënd, i cili ka krijuar (çdo gjë). **Ka krijuar njeriun prej gjaku të ngjizur. Lexo, se Zoti yt është më bujari".***
>
> *(el-Alak, 1-3).*

Pastaj, Pejgamberi s.a.v.s. u kthye, e duke iu dridhur zemra (nga frika), hyri te Hatixhe b. Huvejlidi r.a. të cilës i tha: **"Më mbuloni! Më mbuloni!"**. E mbuluan derisa i kaloi frika. Pasi ia tregoi ndodhinë Hatixhes, tha: **"Po frikohem!"** Ndërkaq, Hatixhja ia ktheu: **"Jo, për Zotin, kurrsesi!" All-llahu nuk të turpëron dhe nuk të lëshon ty asnjëherë, sepse ti i viziton të afërmit, po u ndihmon jetimëve dhe atyre që nuk janë të aftë, u jep të varfërve, je mikpritës dhe po u ndihmon atyre të cilët e mbrojnë të vërtetën".**

Atëherë Hatixhja e çoi te djali i mixhës së vet, Vereka b. Neufel b. Esed b. Abdi Uzza. Ky njeri e kishte pranuar krishterizmin në kohën e xhahilijetit. E dinte mirë shkrim-leximin hebrej dhe përshkuante (transkriptonte) nga Inxhili në gjuhën hebreje, atë që All-llahu xh.sh. donte të shkruhej. Ishte plak i këputur (shumë i moshuar) dhe, vërtet, ishte verbuar.

Hatixhja i tha (Verekait):

"O djal i xhaxhait, dëgjo diç nga djali i vëllait tënd!"

Verekai i tha (Muhammedit a.s.)

"O djali i vëllait tim, ç'është ajo që ke parë?"

Pejgamberi s.a.v.s. ia shpjegoi Verekait ndodhinë që e kishte përjetuar. E, Verekai i tha:

"Ai është Nâmûsi, të cilin All-llahu ia dërgoi Musait. Ah ta kisha fatin të isha i ri në ditët e thirrjes sate. Ah ta kisha fatin të isha gjallë kur populli yt do të dëbojë".

"A thua do të më dëbojë"? pyeti (Pejgamberi s.a.v.s.).

"Po, - tha ai, - sepse, asnjëherë askush nuk ka sjellur diç të ngjashme si ti, e që nuk është sulmuar. Po të jem gjallë, do të ndihmoj ty sa të mundem".

Nuk kaloi shumë kohë pas kësaj, Verekai vdiq. Edhe Shpallja për një kohë pushoi.

٤ ـ قال ابنُ شهابٍ : وأخبرَنى أبو سَلَمَةَ بنُ عبدِ الرَّحمٰنِ أنَّ جابرَ بنَ عبدِ اللهِ الأنصارىَّ قال ـ وهُو يحدِّثُ عن فَتْرَةِ الوَحْىِ ـ فقالَ فى حَدِيثِهِ « بَيْنا أنا أمْشِى ، إذْ سَمِعْتُ صَوْتًا منَ السماءِ ، فَرَفَعْتُ بَصَرِى فإذا المَلَكُ الذى جاءنى بحِراءَ جالسٌ على كُرْسِىٍّ بَيْنَ السماءِ والأرضِ ، فَرُعِبْتُ منه ، فَرَجَعْتُ فقلت : زَمِّلونى . فأنزلَ اللهُ تعالى ﴿ يا أيُّها المُدَّثِّرُ ، قُمْ فَأَنْذِرْ ـ إلى قوله ـ والرُّجْزَ فاهْجُرْ ﴾ . فَحَمِىَ الوَحْىُ وتَتابَعَ » . تابَعَهُ عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ وأبو صالحٍ ، وتابَعَهُ هِلالُ بنُ رَدَّادٍ عن الزُّهْرِىِّ ، وقال يُونُسُ ومَعْمَرٌ « بَوادِرُهُ »

4. Ka thënë Ibni Shihabi: Më ka njoftuar Ebu Seleme b. Abdu-r-Rahmani se, me të vërtetë, Xhabir b. Abdullah Ensariu ka thënë: Ai (Pejgamberi s.a.v.s.) në një fjalim të tij, duke folur për pushimin (ndërprerjen e përkohshme) e Shpalljes ndër të tjera ka thënë:

"Unë, duke ecur (një ditë), **dëgjova një zë nga qielli. E ngrita shikimin lart dhe pashë të njëjtin melek i cili më vinte në shpellën Hira; rrinte ulur në një pozitë në mes qiellit dhe tokës. U ktheva** (në shtëpi) **dhe ashtu i frikuar, thashë: "Më mbuloni!"**

E për këtë shkak All-llahu i Madhëruesëm shpalli ajetet e Kur'anit:

"O ti i mbuluar (Muhammed)! Çohu dhe lajmëroi!"

deri te ajeti *"Dhe nga të këqijat largohu!"*

(el-Meddeththir, 1-5).

Prej këtij momenti, Shpallja vazhdoi t'i arrijë rregullisht.

(Vargu tjetër i transmetuesve për hadithin e lartpërmendur) është: Jahjain e ndjek Abdullah b. Jusufi dhe Ebu Salihu, këta i ndjek Hilal b. Reddadi,

duke transmetuar nga Zuhriu. Ndërkaq, Junusi dhe Ma'meri kanë thënë: **"I janë dridhur nënsqetullat"** [3]

---

3 Muhammedi a.s. para Shpalljes u është përmbajtur me përpikëri parimeve të fesë së Ibrahimit a.s. dhe të Pejgamberëve të tjerë, sepse të gjithë ata kanë mësuar besimin në një Zot. Pas përgatitjeve të gjata dhe të pandërprera shpirtërore në shpellën Hira, Xhibrili ia porositi Muhammedit a.s. Shpalljen e parë. Ndodhi kjo më 27, e sipas disave më 17 të muajit Ramazan, të hënën, ku në radhë të parë theksohet rëndësia e dijes, e penës dhe e besimit në një Zot.

Përqafimi dhe shtrëngimi i Muhammedit a.s. nga ana e Xhibrilit tregon për detyrën e rëndë dhe me përgjegjësi, të cilën duhet pranuar me seriozitetin më të madh. Duket se Muhammedi a.s. u vu para tri sprovave, pas të cilave pasoi fitorja dhe suksesi përfundimtar. Sprova e parë ishte izolimi trevjeçar dhe bllokimi i të gjithë muslimanëve në Mekke. Idhujtarët e Mekkes i ndërprenë të gjitha marrëdhëniet: tregtare, martesore, familjare dhe miqësore me muslimanët. Muslimanët vdisnin nga uria, por, megjithatë, pa u luhatur fare, e duruan atë shtypje. Sprova e dytë ishte sulmi i gjithanshëm dhe i vazhdueshëm; keqtrajtimi fizik i disa muslimanëve dhe përdorimi i mjeteve dhe metodave të ndryshme për t'ua shtënë frikën atyre dhe sprova e tretë ishte dëbimi i muslimanëve nga Mekka.

Droja e Muhammedit a.s. në shpellën Hira shpjegohet edhe me faktin se: është frikuar se nuk do të jetë në gjendje të mbajë barrën e Shpalljes së All-llahut xh.sh. dhe në tërësi ta arsyetojë detyrën që i ishte besuar dhe se nuk do t'i durojë sulmet dhe presionet e armiqve të tij. Ekziston edhe mundësia që të jetë frikuar edhe nga madhështia e Xhibrilit.

Për trembjen e madhe shpirtërore, Muhammedit a.s. i nevojitej pushim i gjatë. Për këtë shkak pasoi pushimi trevjeçar i Shpalljes, i cili e këndelli, i dha fuqi, vrull dhe dëshirë të flaktë për vazhdimin e Shpalljes së paralajmëruar.

Ëndrrat e vërteta i filluan në muajin rebi-ul-evvel, kurse Shpallja në Ramazan. Në periudhën e pushimit të Shpalljes, Xhibrili, megjithatë, ka pasë kontakte me Muhammedin a.s., por asgjë nuk e ka porositur përderisa psikologjikisht nuk e kishte përgatitur dhe nuk e kishte aftësuar për Shpallje të rregullt. Pesë ajetet e para të sures *"Ikre"*, pa dyshim janë fillim i Shpalljes, kurse sureja *"el-Muddeththir"* është e dyta, e cila pasoi, pikërisht, pas pushimit trevjeçar.

Lidhur me kronologjinë e shpalljes së ajeteve, Kurejbi shënon: "Në shënimet e Ibni Abbasit kemi parë këtë radhitje të Shpalljes (Kur'anit): *"el-'Alak* (pesë ajetet e para), *"el-Lejl"*, *"en-Nûn"*, *"el-Muzemmil"*, *"el-Muddeththir"*, *"el-Leheb"*, *"et-Tekvîr"*, *"el-A'la"*, *"ed-Duhâ"*, *"el-Inshirâh"*, *"el-'Asr"*, *"el-'Adijât"*, *"el-Kevther"*, *"et-Tekâthur"*, *"El-Felek"*, *"en-Nâs"* dhe disa sure të shpallura në Mekke. Në Medine janë shpallur gjithsej 28 sure".

Hazreti Aishja dhe disa As-habë të tjerë vërtetojnë se pesë ajetet e para të sures *"el-'Alak"* janë ajete të para të Shpalljes, e pastaj disa ajete të para të sures *"en-Nûn"*. Më pastaj janë shpallur suret *"el-Muzemmil"* dhe *"ed-Duhâ"*, e pastaj ajetet e mbetura të sures *"el-'Alak"*.

باب * ٥ - حدثنا موسى بن إسمٰعيل قال حدثنا أبو عوانة قال حدثنا موسى بن أبي عائشة قال حدثنا سعيد بن جبير عن ابن عباس في قوله تعالى ﴿لا تحرك به لسانك لتعجل به﴾ قال: كان رسول الله ﷺ يعالج من التنزيل شدة، وكان مما يحرك شفتيه، فقال ابن عباس فأنا أحركهما لكم كما كان رسول الله ﷺ يحركهما. وقال سعيد أنا أحركهما كما رأيت ابن عباس يحركهما - فحرك شفتيه - فأنزل الله تعالى ﴿لا تحرك به لسانك لتعجل به إن علينا جمعه وقرآنه﴾ قال جمعه لك في صدرك وتقرأه ﴿فإذا قرأناه فاتبع قرآنه﴾ قال فاستمع له وأنصت ﴿ثم إن علينا بيانه﴾ ثم إن علينا أن تقرأه. فكان رسول الله ﷺ بعد ذلك إذا أتاه جبريل استمع، فإذا انطلق جبريل قرأه النبي ﷺ كما قرأه

5. Na ka treguar Musa b. Ismaili, këtij.i ka treguar Ebu Avane, këtij Musa b. Ebu Aishe, këtij Se'id b. Xhubejri nga Ibni Abbasi, i cili për (duke e komentuar) Fjalën e All-llahut të Madhërueshëm:

"Mos e shqipto ti (Muhammed) **atë** (Kur'anin) **me gjuhën tënde** (për ta zënë) **atë me të shpejtë"**, tha:

"Pejgamberi s.a.v.s. shumë përpiqej për ta mbajtur në mend Shpalljen dhe për këtë shkak, i lëvizte buzët gjithnjë". Duke e thënë këtë, Ibni Abbasi vazhdoi:

"Edhe unë po i lëviz buzët para jush, ashtu siç i lëvizte Pejgamberi s.a.v.s.", kurse Se'idi i ka thënë (Musait):

"Ja, edhe unë po i lëviz buzët ashtu siç e kam parë Ibni Abbasin duke i lëvizur", dhe menjëherë filloi t'i lëviz buzët e tij.

All-llahu i Madhërueshëm, lidhur me këtë, shpalli ajetin e Kur'anit:

"Mos e shqipto ti (Muhammed) atë (Kur'anin) me gjuhën tënde (për ta zënë) atë me të shpejtë. Me të vërtetë Ne na përket tubimi dhe leximi i tij".

(el-Kijâmetu, 16-17).

Nga përmbajtja e ajeteve të para të Kur'anit (Shpalljes) kuptohet qartë se para leximit të Kur'anit është e domosdoshme të lexohet "Bismi-l-Lahi-r-Rahmani-r-Rahim" (besmelja), që personin e trembur shumë, nuk duhet provuar derisa të qetësohet psikologjikisht, kurse të padisponuarit duhet bërë përpjekje t'i kthehet disponimi.

E Ibni Abbasi (këtë ajet) e ka shpjeguar:

"Të është tubuar (Kur'ani) **në gjoksin tënd dhe ti me lehtësi do ta lexosh atë".** Pastaj, ajetin:

"Dhe, kur ta lexojmë Ne atë (përmes Xhibrilit), përcille ti (Muhammed) leximin e tij".

(el-Kijâmetu, 18).

Ibni Abbasi e komenton: **"Dëgjoje dhe hesht!"** Ndërkaq, ajetin:

"Pastaj, Ne do ta shpjegojmë atë".

(el-Kijâmetu, 19),

(Ibni Abbasi) e komenton: **"Vërtet, detyra jonë është që ti pastaj me lehtësi ta mësosh atë".**

Pas kësaj, sa herë që vinte Xhibrili, Pejgamberi s.a.v.s. vetëm do ta dëgjonte, e kur shkonte ai, Pejgamberi s.a.v.s. i përsëriste (ajetet e Kur'anit), pikërisht ashtu si i kishte lexuar Xhibrili.

باب * ٦ ـ حدثنا عبدان قال أخبرنا عبد الله قال أخبرنا يونس عن الزهري . ح . وحدثنا بشر ابن محمد قال أخبرنا عبد الله قال أخبرنا يونس ومعمر عن الزهري نحوه قال : أخبرني عبيد الله بن عبد الله عن ابن عباس قال : كان رسول الله ﷺ أجود الناس ، وكان أجود ما يكون في رمضان حين يلقاه جبريل ، وكان يلقاه في كل ليلة من رمضان فيدارسه القرآن ، فلرسول الله ﷺ أجود بالخير من الريح المرسلة

6. Na ka treguar Abdani, këtij Abdullahu, këtij Junusi, i cili ka transmetuar nga Zuhriu, kurse sipas një vargu tjetër të transmetuesve, qëndron: Na ka treguar Bishr b. Muhammedi, këtij Abdullahu që ka thënë (ashtu siç u tha më lart) se e ka njoftuar Junusi dhe Ma'meri, duke transmetuar nga Zuhriu, ky nga Ubejdullah b. Abdullahu, ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. ishte njeriu më shpirtgjerë (i xhymertë) **e më bujar, e më shpirtgjerë ishte në muajin Ramazan, kur i vinte Xhibrili, e Xhibrili i vinte çdo mbrëmje të muajit Ramazan dhe ia mësonte Kur'anin. Pejgamberi s.a.v.s. për punë të mira ishte më zemërgjerë se era e dërguar".**[4]

4 Shpirtgjerësia e Muhammedit a.s. i ka përtëri dhe u ka dhënë forcë të varfërve, sikurse shiu i vlefshëm që gjallëron tokën e thatë. Ramazani është muaji më i madhëruar për muslimanët, muaji i rilindjes shpirtërore, muaji i shpalljes së parë të Kur'anit, muaji i agjërimit, në të cilin është edhe nata e Kadrit (Lejlet-ul-Kadr).

باب * ٧ ــ حدثنا أبو اليمان الحكم بن نافع قال أخبرنا شعيب عن الزهري قال أخبرني عبيد الله بن عبد الله بن عتبة بن مسعود أن عبد الله بن عباس أخبره أن أبا سفيان بن حرب أخبره أن هرقل أرسل إليه في ركب من قريش، وكانوا تجاراً بالشام في المدة التي كان رسول الله ﷺ مادّ فيها أبا سفيان وكفار قريش، فأتوه وهم بإيلياء، فدعاهم في مجلسه وحوله عظماء الروم، ثم دعاهم ودعا بترجمانه فقال: أيكم أقرب نسباً بهذا الرجل الذي يزعم أنه نبي؟ فقال أبو سفيان: فقلت أنا أقربهم نسباً. فقال: أدنوه مني، وقربوا أصحابه فاجعلوهم عند ظهره. ثم قال لترجمانه: قل لهم إني سائل هذا الرجل، فان كذبني فكذبوه. فوالله لولا الحياء من أن يأثروا علي كذباً لكذبت عنه. ثم كان أول ما سألني عنه أن قال: كيف نسبه فيكم؟ قلت هو فينا ذو نسب. قال فهل قال هذا القول منكم أحد قط قبله؟ قلت لا. قال فهل كان من آبائه من ملك؟ قلت

لا. قال: فأشراف الناس يتبعونه أم ضعفاؤهم؟ فقلت: بل ضعفاؤهم. قال: أيزيدون أم ينقصون؟ قلت: بل يزيدون. قال: فهل يرتد أحد منهم سخطة لدينه بعد أن يدخل فيه؟ قلت: لا. قال: فهل كنتم تتهمونه بالكذب قبل أن يقول ما قال؟ قلت: لا. قال: فهل يغدر؟ قلت: لا، ونحن منه في مدة لا ندري ما هو فاعل فيها. قال ولم يمكني كلمة أدخل فيها شيئاً غير هذه الكلمة. قال: فهل قاتلتموه؟ قلت: نعم. قال: فكيف كان قتالكم إياه؟ قلت: الحرب بيننا وبينه سجال، يصيب منا ونصيب منه. قال: ماذا يأمركم؟ قلت يقول اعبدوا الله وحده ولا تشركوا به شيئاً، واتركوا ما يقول آباؤكم. ويأمرنا بالصلاة والصدق والعفاف والصلة. فقال للترجمان: قل له سألتك عن نسبه فذكرت أنه فيكم ذو نسب، فكذلك الرسل تبعث في نسب قومها. وسألتك هل قال أحد منكم هذا القول؟ فذكرت أن لا، فقلت لو كان أحد قال هذا القول قبله لقلت رجل يأتسي بقول قيل قبله. وسألتك هل كان من آبائه من ملك؟ فذكرت أن لا، قلت فلو كان من آبائه من ملك قلت رجل يطلب ملك أبيه. وسألتك هل كنتم تتهمونه بالكذب قبل أن يقول ما قال؟ فذكرت أن لا، فقد أعرف أنه لم يكن ليذر الكذب على الناس ويكذب على الله. وسألتك أشراف الناس اتبعوه أم ضعفاؤهم؟ فذكرت أن ضعفاءهم اتبعوه، وهم أتباع الرسل. وسألتك أيزيدون أم ينقصون؟ فذكرت أنهم يزيدون، وكذلك أمر الإيمان حتى يتم. وسألتك أيرتد أحد سخطة لدينه بعد أن يدخل فيه، فذكرت أن لا، وكذلك الإيمان حين تخالط بشاشته القلوب. وسألتك هل يغدر؟ فذكرت أن لا، وكذلك الرسل لا تغدر. وسألتك بما يأمركم؟ فذكرت أنه يأمركم أن تعبدوا الله ولا تشركوا به شيئاً وينهاكم عن عبادة الأوثان ويأمركم بالصلاة والصدق والعفاف، فان كان ما تقول حقاً فسيملك موضع قدمي

هاتين . وقد كنتُ أعلمُ أنه خارجٌ لم أكنْ أظنُّ أنه منكم ، فلو أنّى أعلمُ أنّى أخلصُ إليه لتجشّمتُ لقاءه ، ولو كنتُ عندَهُ لغسلتُ عن قدَمِه

ثمّ دعا بكتابِ رسولِ اللهِ ﷺ الّذى بعثَ بِهِ دِحيَةُ إلى عظيمِ بُصرى ، فدفعَه إلى هِرَقْلَ ، فقرأه ، فاذا فيه :

بسم الله الرحمن الرحيم

مِنْ مُحمدٍ عبدِ اللهِ ورسولِه إلى هِرَقْلَ عظيمِ الرُّوم . سلامٌ على مَنِ اتّبعَ الهُدى . أمّا بعدُ فانّى أدعُوكَ بدِعايةِ الإسلام ، أسْلِمْ تَسْلَمْ يُؤْتِكَ اللهُ أجرَكَ مرّتين . فانْ تَوَلّيتَ فانّ عليكَ إثمَ الأريسيين ﴿ ويا أهلَ الكتابِ تعالَوْا إلى كلمةٍ سَواءٍ بَيْنَنا وبَيْنَكم أنْ لا نَعبُدَ إلاّ اللهَ ولا نُشْرِكَ بِهِ شيئاً ولا يَتّخِذَ بعضُنا بعضاً أرباباً مِنْ دُونِ اللهِ ، فانْ تَوَلّوْا فقولوا اشْهَدُوا بأنّا مسلمون ﴾

قال أبو سُفيانَ : فلما قال ما قال ، وفرَغَ مِن قِراءةِ الكتاب ، كَثُرَ عندَهُ الصَّخَبُ ، وارتفعتِ الأصواتُ ، وأُخرِجْنا . فقلتُ لأصحابى حين أُخرِجنا : لقد أمِرَ أمرُ ابنِ أبى كَبْشَةَ ، إنه يخافُه مَلِكُ بنى الأصفَرِ . فما زلتُ مُوقِناً أنه سيَظهرُ حتى أدخَلَ اللهُ عليّ الإسلام

وكانَ ابنُ الناطُورِ ـ صاحبُ إيلياءَ وهِرَقْلَ ـ سُقُفًّا على نَصارَى الشامِ يُحدِّثُ أنّ هِرَقلَ حين قَدِمَ إيلياءَ أصبحَ يوماً خَبيثَ النفسِ ، فقال بعضُ بَطارِقَتِه : قد استَنكرْنا هَيْئَتَك . قال ابنُ الناطُورِ : وكان هِرَقْلُ حَزّاءً يَنظُرُ فى النّجومِ ، فقال لهم حينَ سألوه : إنى رأيتُ اللّيلةَ حينَ نظرتُ فى النجومِ مَلِكَ الخِتانِ قد ظَهَرَ ، فمَنْ يَختَتِنُ من هذه الأمّة ؟ قالوا : ليسَ يَختَتِنُ إلاّ اليهودُ ، فلا يُهِمَّنَّكَ شأنُهم ، واكتُبْ إلى مَدائنِ مُلْكِكَ فيَقتُلوا مَنْ فيهم مِنَ اليهود . فبينما هم على أمرِهم أُتِيَ هِرَقْلُ برَجُلٍ أرسَلَ به مَلِكُ غَسّانَ يُخبِرُ عن خَبَرِ رَسُولِ اللهِ ﷺ . فلمّا استخبرَهُ هِرَقلُ قال : اذهَبوا فانظروا أمُختَتِنٌ هوَ أم لا ؟ فنظروا إليه ، فحدّثوه أنه مُختَتِن ، وسألَه عنِ العَرَبِ فقال : هم يَختَتِنون . فقال هِرَقْلُ : هذا مُلْكُ هذه الأمّةِ قد ظهر . ثمّ كتبَ هِرَقلُ إلى صاحبٍ له بِرُومِيَةَ ، وكانَ نَظِيرَهُ فى العلم . وسارَ هِرَقلُ إلى حِمْصَ ، فلم يَرِمْ حِمصَ حتى أتاهُ كتابٌ مِن صاحبِهِ يُوافِقُ رأىَ هِرَقلَ على خُروجِ النبىّ ﷺ وأنه نبىٌّ . فأذِنَ هِرَقلُ لعُظَماءِ الرُّومِ فى دَسْكَرَةٍ له بِحِمْصَ ، ثم أمرَ بأبوابِها فغُلِّقَتْ ، ثم اطّلَعَ فقال : يا مَعْشَرَ الرُّوم ، هلْ لكُمْ فى الفَلاحِ والرُّشْدِ وأنْ يَثبُتَ مُلْكُكُمْ فتُبايِعوا هذا النبىَّ ؟ فحاصُوا حَيْصَةَ حُمُرِ الوَحْشِ إلى الأبوابِ فوَجَدُوها قد غُلِّقَتْ ، فلمّا رأى هِرَقلُ نَفْرَتَهُمْ وأيِسَ مِنَ الإيمانِ قال : رُدُّوهُمْ عَلَىّ . وقال : إنى قلتُ مَقالَتِى آنِفاً أختَبِرُ بها شِدّتَكُمْ على دِينِكُمْ ، فقد رأيتُ . فسجَدوا له ورَضُوا عنه ، فكانَ ذلكَ آخِرَ شأنِ هِرَقْلَ . رواه صالحُ بنُ كَيْسانَ ويُونُسُ ومَعْمَرٌ عنِ الزُّهرِىّ

7. Na ka treguar Ebu-l-Jeman Hakem b. Nafiu, duke transmetuar nga Shu'ajbi, ky nga Zuhriu, ky nga Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe b. Mes'udi; këtij i ka thënë Abdullah b. Abbasi se e ka njoftuar Ebu Sufjan b. Harbi se Herakleu ka dërguar pas tij (Ebu Sufjanit) përfaqësues te një karavan të kurejshitëve, të cilët kishin ardhë si tregtarë në Sham (Damask) mu në kohën kur Pejgamberi s.a.v.s. kishte lidhur marrëveshje paqësore me Ebu Sufjanin dhe me pabesimtarët tjerë të fisit Kurejsh. Ata (Ebu Sufjani me shokët e vet) erdhën në Jerusalem. Herakleu i thirri në rezidencën e tij, e te ai kishin qenë edhe krerët (paria) bizantinë. Kur Herakleu i thirri ata, e thirri edhe përkthyesin e vet dhe (përmes tij) pyeti:

"Cili prej jush është më i afërt për nga origjina me atë njeri që vërteton për vete se është Pejgamber?"

"Unë, i thashë, jam më i afërt me të për nga afria farefisnore", tha Ebu Sufjani.

"Ma afroni, tha ai (Herakleu), **edhe shokët e tij afroni, por ata radhitni pas tij!"**

Pastaj, Herakleu iu drejtua përkthyesit të vet: **"Thuaju atyre se unë do ta pyes këtë** (duke menduar në Ebu Sufjanin) **për atë njeri** (për Muhammedin a.s.) **dhe çka që të më gënjejë, ju tregoni se po gënjen!"**

(Ebu Sufjani) tha: **"Për Zotin, po të mos turpërohesha se do të mund të më zbulonin** (shokët e mi) **se gënjej, unë për të edhe do të gënjeja diçka".** Pyetja e parë që ma shtroi ishte:

"Si çmohet origjina e tij në mesin tuaj?"

"Ndër ne ai njifet se ka origjinë të ndershme", i thashë.

"A ka folë ndonjë prej jush ndonjëherë para tij kështu?" pyeti.

"Jo, nuk ka folë", u përgjigja.

"A ka qenë mbret ndonjë nga të parët e tij?" pyeti (Herakleu).

"Jo, nuk ka qenë", i thashë.

"A e përkrahin atë njerëzit e lartë apo masat e gjera?" pyeti ai.

"Masat e gjera, gjithsesi", i thashë.

"Numri i tyre rritet apo pakësohet?" pyeti.

"Nuk pakësohet, por, përkundrazi, rritet", i thashë.

"A e lëshon fenë e tij (Islamin) **ndonjë pasi ta ketë pranuar duke e urrejtur atë",** pyeti.

"Jo", i thashë.

"A e keni fajësuar për rrenë, para se të fillojë të shpall atë që po shpall tash?", pyeti.

"Jo", u përgjigja.

"A e then fjalën e dhënë?" pyeti.

"Jo, por tash jemi në një marrëveshje paqësore me të, e nuk e dimë se si do të veprojë", u përgjigja.

Ebu Sufjani pastaj tha (thotë transmetuesi): **"Përveç këtyre fjalëve që i thashë, asnjë përgjigje nuk më dha mundësi që për të të hedh çfarëdolloj dyshimi".**

Herakleu vazhdoi të pyes:

"A keni luftuar kundër tij?"

"Po", i thashë.

"Po si ka qenë rezultati i luftës me të?" pyeti.

"Lufta në mes nesh dhe atij ka qenë me përfundime të ndryshme, nganjëherë fitonte ai, e nganjëherë fitonim ne", i thashë.

"Çka ju urdhëron?" pyeti Herakleu.

"Na urdhëron, i thashë: **"Adhuroni vetëm All-llahun, mos i bëni shok Atij , lëreni atë që u thonë përindët tuaj; na urdhëron namazin, sinqeritetin, virtytet e larta morale dhe bashkimin".**

Pasi i bëri të gjitha këto pyetje, (Herakliu) i tha përkthyesit të vet: Thuaj këtij (Ebu Sufjanit):

Të pyeta për origjinën e tij (të Muhammedit), **e ti më the se ai në mesin tuaj njihet se ka prejardhje të ndershme. Ajo është dukuri te të gjithë Pejgamberët; ata paraqiten nga familja më e lartë e popullit të tyre.**

Të pyeta: a ka folur diçka të ngjashme ndonjëherë para tij ndokush prej jush, e ti u shprehe se jo, nuk ka folur. Po të them se po të kishte folur dikush diçka të ngjashme para tij, do të thoja se është njeri që lakmon fjalët e thëna përpara tij.

Të pyeta: a ka qenë mbret ndonjë nga të parët e tij; më the se nuk ka qenë, e unë po të them se po të kishte qenë mbret ndonjë nga të parët e tij, do ta mendoja se ai është njeri, i cili kërkon pushtetin e babait të vet.

Të pyeta: a keni dyshuar se rren para se ka filluar të flasë atë që flet tash. U përgjigje, jo. Kam bindje të fortë se kur nuk e ka gënjyer popullin, si do të mund ta gënjejë All-llahun!

Pastaj, të pyeta: a e përkrahin njerëzit e lartë, apo masat popullore, e ti m'u përgjigje se e përkrahin masat e gjera. Po të them se pjesa dërrmuese e tyre kanë qenë përkrahës të Pejgamberëve.

Të pyeta: Numri i tyre shtohet, apo pakësohet. Ti më përmende se numri i tyre shtohet. Ashtu është çështja e fesë dhe e besimit, derisa ajo bëhet e plotë.

Pastaj të pyeta: a e ka lëshuar ndonjë fenë e tij (Islamin), duke e urrejtur atë, pasi ta ketë pranuar një herë. Ti u përgjigje jo, nuk e ka lëshuar. Po të them se ashtu është besimi (imani) **kur dashamirësia e tij përzihet dhe mbizotëron zemrat e besimtarëve.**

Të pyeta: a e then ai fjalën e dhënë. Më the, nuk e then. Të tillë janë Pejgamberët, ata nuk e thejnë fjalën.

Të pyeta: çka ju urdhëron, e ti u përgjigje se ju urdhëron ta adhuroni All-llahun dhe Atij të mos i bëni shok; ju ndalon t'i adhuroni idhujt dhe ju urdhëron namazin, sinqeritetin dhe vetitë e larta morale. Prandaj, *nëse këta që i the janë të vërteta, ai së shpejti do të zotërojë tokën nën* këto këmbët e mia. Unë, vërtet, e kam ditë se është paraqitur (Pejgamber), **por nuk kam menduar** (nuk kam besuar) **se pikërisht është nga mesi juaj. Po ta di se, me të vërtetë do të jem i pranuar nga ai, do të përpiqesha që të takohem me të. E, po të isha pranë tij, do t'ia kisha larë edhe këmbët.**

Pastaj, Herakleu e kërkoi letrën e Pejgamberit s.a.v.s. që ia kishte dërguar kryetarit të Busrës nëpërmjet Dihjes, i cili tashmë ia kishte dërguar Herakleut. Herakleu e lexoi letrën në të cilën shkruante:

Bismi-l-Lahi-r-Rahmani-r-Rahim!

Nga Muhammedi, rob i All-llahut dhe Pejgamber i Tij,

Herakleut, mbretit të Bizantit.

Shpëtimi i takon atij që ndjek rrugën e drejtë. Po të ftoj me ftesë islame: pranoje Islamin, do të jesh i lumtur dhe i shpëtuar! All-llahu do të japë ty shpërblim të dyfishtë, e nëse nuk e pranon këtë ftesë, do të mbash në qafën tënde gjynahun e bujqve (të varfërve) të tu".

(Letra vazhdon me ajetin e poshtëshënuar)

"O ithtarë të Librit (Ehli-Kitab), afrojuni dhe ndiqni fjalën që është e njejtë edhe për ju edhe për ne: të mos adhurojmë askënd tjetër përveç All-llahut, të mos i bëjmë shok Atij, të mos e konsiderojmë njëri-tjetrin zot, në vend të All-llahut, po nëse ata këtë e hedhin poshtë, thuaju atyre: Bëhuni dëshmitarë se ne, me të vërtetë, jemi muslimanë!"

(Ali Imrân, 64).

Ebu Sufjani vazhdoi të tregojë: Kur Herakleu tha atë që kishte për të thënë dhe kur e mbaroi leximin e letrës, filloi zhurma rreth tij dhe u ngrit tensioni. Ne na nxorrën nga ai tubim. (Kur mbeta vetëm me shokët e mi) u thashë atyre: **"Fama e Ibni Ebu Kebshes** (Muhammedit) **me të vërtetë është rritur, e ja, i frikohet edhe mbreti i rasës së verdhë - Bizantit** (Beni Asfar - emërtim i arabëve për bizantinët)".

"Prej këtij çasti kam pasur bindjen e thellë se ai, me të vërtetë do të ngadhnjejë. All-llahu edhe mua më bëri të pranoj Islamin", tha Ebu Sufjani.

Ibni-n-Naturi, mëkëmbës i Jerusalemit (Ilijës), mik i Herakleut dhe peshkop i të krishterëve të Sirisë, ka thënë: Kur arriti Herakleu në Jerusalem, ishte i mërzitur, prandaj disa nga patrikët i thanë: **"Të shohim paksa të mërzitur".**

Herakleu, tha Ibni-n-Naturi, ishte astrolog dhe i vërente yjet. Kur e pyetën (çka shikon), u përgjigj: **"Kur i shikoja yjet një natë, kam vënë re se mbreti i popullit, që bëhet synet, po korr fitore. E kush bëhet synet?"**, pyeti.

"Askush nuk bëhet synet përveç hebrenjve. Mos të të brengos pozita e tyre. Shpalle nëpër qytetet e mbretërisë sate që të gjithë hebrenjtë të vriten", i thanë ata.

Derisa ata ende ishin duke biseduar, Herakleut ia sollën njeriun të cilin e kishte dërguar mbreti i Gassanës të lajmërojë për Pejgamberin s.a.v.s. Kur Herakleu e pranoi në bisedë atë, tha: **"Shkoni dhe shikojeni a është bërë synet apo jo?"** Ata e shikuan dhe e lajmëruan Herakleun se është bërë synet. Ai vazhdoi ta pyes edhe më për arabët, e njeriu u përgjigj: **"Ata bëhen synet".** Atëherë Herakleu tha: **"Ai** (Muhammedi) **është mbreti i këtij populli, pikërisht, është paraqitur".**

Pastaj Herakleu i shkroi letër një miku të tij në Romë, i cili në dijeni ishte i barabartë me të, e pastaj u nis për në qytetin Hims. Derisa Herakleu ishte ende në Hims, i erdhi letër nga miku i tij, përmbajtja e së cilës pajtohej me mendimin e Herakleut, lidhur me paraqitjen e Pejgamberit s.a.v.s. dhe se ai, me të vërtetë, është Pejgamber i All-llahut. Herakleu, prandaj, i thirri në rezidencën e tij në Hims autoritetet e Bizantit dhe urdhëroi që së pari t'i mbyllin dyert. Doli para masës dhe tha: **"O popull i Bizantit! A dëshironi shpëtim!? A dëshironi rrugë të drejtë!? A dëshironi pushtet tuajin të gjatë!?** (Nëse pajtoheni) **atëherë bëhuni ithtarë të këtij Pejgamberi!".**

Kur i dëgjuan këto fjalë, ata u vërsulën kah dera sikur gomarë të egër. Mirëpo, dyert ishin të mbyllura. Kur Herakleu shikoi mllefin e tyre për këtë besim, tha: **"Kthehuni nga unë!"** e pastaj vazhdoi: **"Pak më parë e mbajta fjalimin tim për të vërtetuar qëndrueshmërinë dhe besnikërinë tuaj ndaj fesë suaj dhe, ja, tash jam bindur".** Ata kur i dëgjuan këto fjalë, u përulën dhe u pajtuan me të.

Ishte ky fundi i rastit të Herakleut. Këtë e transmetojnë Salih b. Kajseni, Jusufi dhe Ma'meri nga Zuhriu. [5]

5 Përveç përmbajtjes së qartë të letrës së Muhammedit a.s. dërguar Herakleut, nga teksti merret vesh:
- nevoja e përmbajtejs në korrespondencë, përdorimi i stilit të mirë, shprehja për paqë dhe thirrja në mënyrë të butë, duke u mbështetur në ajetin: "Në rrugë të Zotit tënd thirr me këshilla të bukura dhe të urta"!

2. Besimi (Imani)

بسم الله الرحمن الرحيم

٢ - كتاب الإيمان

باب قولِ النبيِّ ﷺ « بُنِيَ الإسلامُ عَلى خَمْس »

وهو قولٌ وفِعلٌ . ويَزِيدُ وينْقُصُ . قال الله تعالى ﴿ لِيَزْدادوا إيماناً مَعَ إيمانِهِمْ - وزِدْناهُمْ هُدًى - ويَزِيدُ اللهُ الَّذِينَ اهتَدَوا هُدًى - والَّذِينَ اهتَدَوا زادَهُمْ هُدًى وآتاهُمْ تَقْواهُمْ - ويَزْدادَ الَّذِينَ آمَنوا إيماناً ﴾ وقولُه ﴿ أيُّكُمْ زادَتْهُ هٰذِهِ إيماناً فأمّا الَّذِينَ آمَنوا فزادَتْهم إيمانا ﴾ وقولُه جلَّ ذِكرُهُ ﴿ فاخْشَوْهُمْ فزادَهم إيمانا ﴾ وقولُه تعالىٰ ﴿ وما زادَهُمْ إلا إيماناً وتَسْلِيما ﴾ . والحُبُّ فى اللهِ والبُغْضُ فى اللهِ مِنَ الإيمان . وكَتَبَ عُمَرُ بنُ عبدِ العزيزِ إلى عَدِيِّ بنِ عَدِيٍّ : إنَّ للإيمانِ فَرائضَ وشَرائعَ وحُدودًا وسُنَنًا ، فَمَنِ استَكْمَلَها استَكْمَلَ الإيمانَ ، ومَنْ لم يَستَكْمِلْها لم يَستَكْمِلِ الإيمانَ ، فإن أعِشْ فسأبيِّنُها لكم حتى تعملوا بها ، وإنْ أمُتْ فما أنا على صُحبَتِكم بحريص . وقال إبراهيمُ ﴿ ولٰكِنْ لِيَطْمَئِنَّ قلبي ﴾ . وقال مُعاذٌ : اجْلِسْ بِنا نُؤْمِنْ ساعةً . وقال ابنُ مَسْعودٍ : اليقينُ الإيمانُ كلُّه . وقال ابنُ عُمَرَ : لا يَبْلُغُ العَبْدُ حقيقةَ التَّقْوىٰ حتىٰ يَدَعَ ما حاكَ فى الصَّدْرِ . وقال مُجاهِدٌ ﴿ شَرَعَ لَكُمْ . . . ﴾ : أوصَيْناكَ يا مُحَمَّدُ وإيّاهُ دِينًا واحِدًا . وقال ابنُ عَبّاسٍ ﴿ شِرْعَةً ومِنْهاجًا ﴾ : سَبيلا وسُنَّة

Bismi-l-Lahi-r-Rahmani-r-Rahim

2. Besimi (Imani)

Fjala e Pejgamberit s.a.v.s. "Islami është ngritur në pesë shtylla

Ai është fjalë dhe punë, edhe forcohet edhe dobësohet."

All-Ilahu i Madhëruesheëm thotë:

"... për t'ua forcuar *(edhe më tepër)* besimin, krahas besimit që kanë...".[1]

(el-Fet-h, 4).

***"... dhe Ne ua kemi forcuar atyre bidnjen** (imanin)".*

(el-Kehf,13).

"All-llahu ua shton** (forcon) **imanin atyre, të cilët me të vërtetë janë në rrugë të drejtë..."

(Merjem, 76).

"Dhe atyre të cilët janë në rrugë të drejtë, Ai ua ka forcuar** (shtuar) **besimin dhe u ka dhënë devotshmëri".

(Muhammed, 17).

"... dhe t'u shtohet besimi** (imani) **atyre që besojnë...".

(el-Muddeththir, 31).

(Pastaj) Fjalët e All-llahut të Madhërueshëm janë:

"Cilit prej jush kjo** (sure) **ia ka shtuar** (forcuar) **imanin? Me të vërtetë, atyre të cilët kanë besuar ua ka frocuar imanin".

(et-Tevbe, 124).

Pastaj, All-llahu i Madhërueshëm thotë:

"...frikohuni! e, kjo ua ka forcuar imanin** (besimin) **atyre ...".[2]

(Ali Imrân, 173).

Fjala e All-llahut të Madhërueshëm është:

---

1 Përfaqësuesit e shkollave burimore islame konsiderojnë se besimi mund të forcohet, por edhe mund të dobësohet. Disa dijetarë islamë mendojnë se besimi është i pandryshueshëm, disa të tjerë mendojnë se ai vetëm mund të forcohet, kurse disa të tjerë vërtetojnë të kundërtën.
Ibni Abbasi ka thënë: "Besimi është forcuar duke iu shpallur gradualisht Muhammedit a.s. parimet: namazi, agjërimi, zeqati, haxhxhi, lufta në rrugën e All-llahut dhe kryerja e tyre me bindje të fortë".

2 Ky ajet i referohet ekspeditës ushtarake dhe përleshjes me mekkasit nën komandën e Ebu Sufjanit, të cilët kanë dalë në Bedër vitin tjetër pas luftës së Uhudit. Ishte ky viti i thatë dhe jo i frytshëm dhe Ebu Sufjani, me daljen nga Mekka, qëndroi në Merri - Zahran, prej ku e dërgoi Nuajm b. Mes'ud Xhu'fiun dhe disa vandalë të tjerë të fisit Abdu-l-Kajs që t'ia pamundësojnë Muhammedit a.s. lëvizjen dhe ardhjen në këtë luftë. Propaganda dhe kërcënimet e tyre vetëm sa ua shtuan muslimanëve besimin dhe heroizmin, prandaj, menjëherë, së bashku me Muhammedin a.s., u nisën për në Bedër, me 70 kalorës.

"... e kjo atyre vetëm ua ka forcuar besimin dhe përuljen".
(el-Ahzâb, 22).

Dashuria (ndaj dikujt) në emër të All-llahut dhe urrejtja në emër të All-llahut janë pjesë të besimit (imanit).

Umer b. Abdu-l-Azizi i ka shkruar Addî b. Addiut: **"Besimi** (imani) **përbëhet nga detyrimet** (farzet), **nga mënyra e kryerjes së atyre detyrimeve** (sipas ligjeve të sheriatit), **nga kufizimet** (ndalesat) **dhe nga sunneti i Pejgamberit s.a.v.s. Kush i kryen ato në mënyrë të plotë, ai e ka plotësar besimin e vet, e kush nuk i ka kryer ato në mënyrë të plotë, nuk e ka përkryer besimin. Po të jem gjallë, do t'ua shpjegoj e do t'ua sqaroj sesi do të veproni ju me to, e nëse vdes, e unë nuk lakmoj të jem edhe gjatë në mesin tuaj".**[3]

Ibrahimi ka thënë: **"Por, le të qetësohet** (bindet) **zemra ime!".**

Muadhi: **"Rri me mua një çast ta thellojmë besimin, duke gjetur argumente".**[4]

Ibni Mes'udi: **"el-jekîn" është besimi i patundshëm i gjithë asaj që u tha më lart".**

Ibni Umeri: **"Njeriu nuk e arrin shkallën e lartë të besimit përderisa nuk përpiqet të largojë nga vetja edhe dyshimin më të vogël që e shtrëngon në gjoks".**

---

3 Halifja Umer b. Abdu-l-Azizi nga dinastia e Emevijve (99-101 hixhri) ka pasë për qëllim që me letrën e tij që ia ka dërguar Addiut t'ia tërheqë vërejtjen atij se besimi forcohet dhe dobësohet, varësisht nga kryerja e detyrave të ndryshme fetare.
Ai që e kryen farzin, ka besim të mirë, por ai që i kryen edhe vaxhibet, edhe sunnetet, madje edhe mustehabet, do të ketë besim më të mirë, më të fortë dhe më të përkryer.

4 Muadh b. Xhebeli është njëri nga muslimanët e parë. Gëzonte autoritet të madh te Muhammedi a.s. dhe te shoqëria islame përgjithësisht. Kishte vetëdije të lartë islame dhe konsiderohej evlija. Ka marrë pjesë në shumë lufta, bashkë me Muhammedin a.s., bile në shumë prej tyre ka komanduar.
Duke marrë parasysh sakrificat e tij për Islamin, në njërën anë dhe, njohjen e mirë të gjuhës arabe, nga ana tjetër, s'ka mundësi që fjalën "nu'minu" ta ketë kuptuar tekstualisht "të besojmë", por vetëm ashtu siç është përdorur në përkthim "ta thellojmë besimin".

Muxhahidi: Ka shpallur për ju: **"O Muhammed, të kemi shpallur ty dhe atij** (Nuhit) **një fe"**, kurse Ibni Abbasi ka komentuar: **"Fenë,** (sheriatin) **drejtimin dhe sunnetin".**

بابٌ دُعاؤُكُمْ إيمانُكم

٨ - حدثنا عُبَيْدُ اللهِ بنُ موسىٰ قال أخبرَنا حَنْظَلَةُ بنُ أبي سُفْيانَ عن عِكْرِمَةَ بن خالدٍ عن ابنِ عُمَرَ رضي اللهُ عنهما قال: قال رسولُ اللهِ ﷺ « بُنِيَ الإسلامُ عَلى خَمْسٍ : شَهادَةِ أنْ لا إلٰهَ إلاّ اللهُ، وأنَّ محمداً رسولُ اللهِ، وَإقامِ الصلاةِ، وإيتاءِ الزَّكاةِ، والحَجِّ، وصَوْمِ رَمَضانَ »

Lutja juaj është besimi juaj

8. Na ka treguar Ubejdullah b. Musa, këtij Handhale b. Ebu Sufjani, ky nga Ikrime b. Halidi, ky nga Ibni Umeri r.a., i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"Islami ndërtohet në pesë shtylla: dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç All-llaut dhe se, vërtet, Muhammedi është Pejgamberi i Tij; falja e namazit; dhënia e zeqatit; haxhxhi (haxhillëku) **dhe agjërimi i Ramazanit".**

بابٌ أمورِ الإيمان، وقولِ اللهِ تعالىٰ ﴿ لَيسَ البِرَّ أنْ تُوَلُّوا وُجوهَكُمْ قِبَلَ المَشْرِقِ والمَغْرِبِ، ولٰكِنَّ البِرَّ مَنْ آمَنَ باللهِ واليَوْمِ الآخِرِ والمَلائكةِ والكِتابِ والنَّبِيِّينَ وَآتَى المالَ عَلى حُبِّهِ ذَوِي القُرْبىٰ واليَتامىٰ والمَساكِينَ وابنَ السَّبِيلِ والسائلينَ وفي الرِّقابِ وأقامَ الصَّلاةَ وآتَى الزَّكاةَ والمُوفونَ بِعَهْدِهِمْ إذا عاهَدُوا والصابِرينَ في البأساءِ والضَّرّاءِ وحِينَ البَأسِ أولٰئِكَ الَّذِينَ صَدَقُوا وأولٰئِكَ هُمُ المُتَّقونَ - قد أفلَحَ المُؤْمِنون ﴾ الآية

Pjesët përbërëse të besimit (imanit)

Fjala e All-llahut të Madhërueshëm është:

*"**Mirësi** (besim i përkryer) **nuk është t'i ktheni ju fytyrat tuaja kah lindja dhe perëndimi, por mirësi është kur** (njeriu) **e beson All-llahun, Ditën e Kijametit, Meleqët, Librin, Pejgamberët dhe** (mirësi) **është kur** (njeriu) **me vullnetin e vet, u jep nga pasuria: të dashurve të vet, të afërmve, bonjakëve, varfanjakëve, udhëtarëvet - musafirëvet** (që kanë ngelur pa të holla), **lypësvet dhe robërvet** (për t'u luruar); **e mirësi** (besim i përkryer) **është edhe falja e namazit,*

***dhënia e zeqatit dhe kryerja e obligimit të tyre, kur marrin përsipër diçka; e** (mirësi dhe besim i përkryer), **është edhe të durosh skamjen, sëmundjen dhe të gjitha të papriturat. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që i druajnë All-llahut** (ruhen prej gjynaheve)".*[5]

(el-Bekare, 177)

Pastaj ajeti:

"Me të vërtetë, kanë shpëtuar besimtarët e vërtetë".

(el-Mu'minun, 1)

٩ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ محمدٍ قال حدثنا أبو عامرٍ العَقَدِيُّ قال حدثنا سُلَيمانُ بنُ بلالٍ عن عبدِ اللهِ بنِ دينارٍ عن أبي صالحٍ عن أبي هُرَيرةَ رضي اللهُ عنه عنِ النبيِّ ﷺ قال « الإيمانُ بِضْعٌ وسِتُّونَ شُعْبَةً ، والحَياءُ شُعْبَةٌ مِنَ الإيمانِ »

9. Na ka treguar Abdullah b. Muhammedi, këtij Ebu Amir Akadiu, këtë e kishte njoftuar Sulejman b. Bilali nga Abdullah b. Dinari, ky nga Ebu Salihu, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

---

5 Shkalla e parë e besimit (imanit) është besimi në Shpalljen e All-llahut xh.sh. (Kur'anin), kurse shkalla më e lartë dhe e përsosur arrihet me kryerjen praktike të detyrimeve (farzeve) të përmendura në ajetin e sipërpërmendur. Kibla e parë e muslimanëve është Bejtu-l-Mukaddesi në Jerusalem. Kur Muhammedi a.s. dhe muslimanët filluan të kthehen kah Qabja, hebrenjtë, të cilët gjatë lutjeve të tyre kthehen kah perëndimi, dhe të krishterët kah lindja, thonin se mirësi dhe besim i vërtetë është ai që bëhet duke u kthyer andej kah kthehen ata. Ajeti i sipërpërmendur e hedh poshtë këtë konstatim, duke theksuar se besimi i përkryer nuk qëndron mu në të kthyerit, kah lindja a kah perëndimi, e as në kryerjen formale të detyrimeve, por qëndron pikërisht në kryerjen e sinqertë të të gjitha detyrimeve të përmendura në ajetin e sipërpërmendur.

Ebu Dherri tregon se një njeri e ka pyetur atë për besimin, e ky ia ka cituar vetëm ajetin e sipërshënuar. Personi i bëri vërejtje se nuk e pyeti për mirësinë (birr) që përmendet në ajet, por vetëm për besimin e përkryer (imanin). Ebu Dherri, prandaj, vazhdoi:

- Edhe te Pejgamberi a.s. ka shkuar një njeri, siç ke ardhë ti te unë, dhe e ka pyetur për imanin, ashtu siç më pyet ti mua. Muhammedi a.s. pyetjes së tij i qe përgjigjur, ashtu si të përgjigjem unë ty, pra, duke ia lexuar ajetin e sipërpërmendur. Megjithatë, edhe ai nuk qe i kënaqur me përgjigjen, ashtu siç nuk je edhe ti. Muhammedi a.s. atëherë i propozoi atij që të qëndrojë pranë tij, e pastaj i tha:

"Besimtar i vërtetë është ai që kënaqet nga çdo vepër e mirë që e bën, për të cilën shpreson dhe beson se All-llahu xh.sh. do ta shpërblejë, dhe brengoset nga çdo vepër e keqe, duke u frikuar nga dënimi i All-llahut xh.sh."

"Besimi i përkryer (imani) **përbëhet nga gjashtëdhjetë e sa degë** (pjesë). **Edhe turpi është pjesë e besimit** (imanit)".

بابُ المُسْلِمُ مَنْ سَلِمَ المُسْلِمونَ مِنْ لِسانِهِ وَيَدِهِ

١٠ – حدثنا آدَمُ بنُ أبي إياسٍ قال حدثنا شُعْبَةُ عن عبدِ اللهِ بنِ أبي السَّفَرِ وَإسماعيلَ عنِ الشَّعْبيِّ عن عبدِ اللهِ ابن عَمْرٍو رضي اللهُ عنهما عن النبيِّ ﷺ قال « المُسْلِمُ مَنْ سَلِمَ المُسْلِمونَ مِن لِسانِهِ وَيَدِهِ ، والمهاجِرُ مَنْ هَجَرَ ما نَهى اللهُ عنه » . قال أبو عبدِ اللهِ وقال أبو مُعاوِيَةَ : حدثنا داودُ عن عامِرٍ قال : سَمِعْتُ عبدَ اللهِ عنِ النبيِّ ﷺ . وقال عبدُ الأعلى : عن داودَ عن عامِرٍ عن عبدِ اللهِ عنِ النبيِّ ﷺ

Musliman është ai që nga gjuha dhe dora e tij janë të qetë muslimanët

10. Na ka treguar Adem b. Ebu Ijasi, ky nga Shu'be, ky nga Abdullah b. Ebu Seferi dhe Ismaili, këta nga Sha'biu, ky nga Abdullah b. Amri r.a., e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili ka thënë:

"Musliman i vërtetë është ai që nga gjuha dhe dora e tij janë të qetë muslimanët e tjerë, kurse shpërngulës (muhaxhir) **i vërtetë është ai i cili e largon atë që All-llahu xh.sh. e ka ndaluar".**[6]

Ebu Abdullahu (Buhariu) (për hadithin e lartpërmendur jep edhe këtë varg të transmetuesve): Na ka treguar Ebu Muaviu, duke thënë, na ka treguar Davudi, duke transmetuar nga Amiri, i cili ka thënë: e kam dëgjuar Abdullahun se transmeton nga Pejgamberi s.a.v.s.; kurse Ebu-l-A'lai transmeton nga Davudi, ky nga Amiri, ky nga Abdullahu, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s.

بابُ أيُّ الإسلامِ أفضَلُ ؟

١١ – حدثنا سَعيدُ بنُ يَحيى بنِ سَعيدٍ القُرَشِيُّ قال حدثنا أبي قال حدثنا أبو بُرْدَةَ بنُ عبدِ اللهِ بنِ أبي بُرْدَةَ عن أبي بُرْدَةَ عن أبي موسى رضي اللهُ عنه قال « قالوا : يا رسولَ اللهِ ، أيُّ الإسلامِ أفضَلُ ؟ قال : مَنْ سَلِمَ المسلمونَ مِنْ لِسانِهِ ويَدِهِ »

6 Me hadithin e sipërpërmendur kërkohet sjellja dhe veprimi i mirë me njerëzit, duke përdorur metoda të duarduarshme për t'u afruar me njëri-tjetrin. Muslimani i mirë nuk bën vepra të këqija as me fjalë, as me punë, por brenda mundësive të veta përpiqet për largimin e veprave të këqija.

Cili musliman është më i vlefshëm?

11. Na ka treguar Se'id b. Jahja b. Se'id Kurejshiu, këtij babai i vet, këtij Ebu Burde b. Abdullah b. Ebu Burde, ky nga Ebu Burde, ky nga Ebu Musai r.a., i cili ka thënë se e kanë pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"O Resulullah, cili është muslimani më i vlefshëm?". Ai u është përgjigjur: **"Ai, që nga gjuha dhe dora e tij janë të qetë muslimanët e tjerë".**

باب إطعامُ الطَّعامِ مِنَ الإسلام

١٢ – حدثنا عَمْرُو بنُ خالدٍ قال حدثنا اللَّيثُ عن يَزيدَ عن أبي الخَيرِ عن عبدِ اللهِ بنِ عَمْرٍو رضي اللهُ عنهما أنَّ رَجُلاً سأل النبيَّ ﷺ: أيُّ الإسلامِ خَيْرٌ؟ قال: «تُطْعِمُ الطَّعامَ، وَتَقْرَأُ السَّلامَ عَلى مَن عَرَفْتَ وَمَن لم تَعْرِف»

Të ushqesh (të uriturit) është pjesë e Islamit

12. Na ka treguar Umer b. Halidi, këtij i kishte thënë Lejthi, duke transmetuar nga Jezidi, ky nga Ebu-l-Hajri, ky nga Abdullah b. Amri r.a. se një njeri e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"Çka është më së miri të punohet sipas Islamit?". Pejgamberi s.a.v.s. u përgjigj: **"Ta ushqesh të uriturin dhe t'i japësh selam** (ta përshëndesësh) **atij që e njeh dhe që nuk e njeh".**[7]

باب مِنَ الإيمانِ أنْ يُحِبَّ لأخيهِ ما يُحِبُّ لِنَفْسِه

١٣ – حدثنا مُسَدَّدٌ قال حدثنا يَحيى عن شُعبةَ عن قَتادةَ عن أنَسٍ رضي اللهُ عنه عنِ النبيِّ ﷺ

وعن حُسَيْنٍ المُعَلِّمِ قال: حدثنا قَتادةُ عن أنَسٍ عن النبيِّ ﷺ قال «لا يُؤْمِنُ أحَدُكُمْ حتى يُحِبَّ لأخيهِ ما يُحِبُّ لِنَفْسِه»

---

7 Me këtë hadith, Muhammedi a.s. i kushton vëmendje të posaçme humanitetit, shoqërimit me njëri-tjetrin, që, pa dyshim, është në interes të të dy palëve dhe në interes të shoqërisë në përgjithësi. Bile, thekson se kjo është pjesë përbërëse e besimit islam.

Është pjesë e besimit (imanit) t'ia dëshirosh vëllait tënd atë që ia dëshiron vetes

13. Na ka treguar Museddedi, këtij i ka treguar Jahjai, ky nga Shu'be, ky nga Katade, ky nga Enesi r.a., e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., ose: nga Husejni, ky nga Katade, ky nga Enesi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Asnjëri nga ju nuk do të jetë besimtar i mirë derisa nuk ia dëshiron vëllait të vet atë që e dëshiron për vete".[8]

بَابُ حُبُّ الرَّسُولِ ﷺ مِنَ الْإِيمَانِ

١٤ – حَدَّثَنَا أَبُو الْيَمَانِ قَالَ أَخْبَرَنَا شُعَيْبٌ قَالَ حَدَّثَنَا أَبُو الزِّنَادِ عَنِ الْأَعْرَجِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ قَالَ « فَوَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِهِ لَا يُؤْمِنُ أَحَدُكُمْ حَتَّى أَكُونَ أَحَبَّ إِلَيْهِ مِنْ وَالِدِهِ وَوَلَدِهِ »

Dashuria ndaj Pejgamberit s.a.v.s. është pjesë e besimit (imanit)

14. Na ka treguar Ebu-l-Jemane, këtij i ka treguar Shu'ajbi, këtij Ebu-z-Zinadi, ky transmeton nga A'rexhi, e ky nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Betohem në Atë, në duart e të cilit është jeta ime, se asnjë nga ju nuk do të jetë besimtar i vërtetë, derisa unë nuk do të jem më i dashur se prindët dhe fëmijët e tij".

١٥ – حَدَّثَنَا يَعْقُوبُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ قَالَ حَدَّثَنَا ابْنُ عُلَيَّةَ عَنْ عَبْدِ الْعَزِيزِ بْنِ صُهَيْبٍ عَنْ أَنَسٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ . ح . وَحَدَّثَنَا آدَمُ قَالَ حَدَّثَنَا شُعْبَةُ عَنْ قَتَادَةَ عَنْ أَنَسٍ قَالَ : قَالَ النَّبِيُّ ﷺ « لَا يُؤْمِنُ أَحَدُكُمْ حَتَّى أَكُونَ أَحَبَّ إِلَيْهِ مِنْ وَالِدِهِ وَوَلَدِهِ وَالنَّاسِ أَجْمَعِينَ »

---

8 Enesi, i biri i Malikut nga fisi Nadir i ka bërë shërbime Muhammedit a.s. rreth 10 vjet dhe ka mësuar përmendsh 1286 hadithe. Prej tyre, 83 i ka përfshirë Buhariu në përmbledhjen e tij të hadithëve, 91 Muslimi, kurse të tjerët janë përfshirë në përmbledhjet e tjera të muhaddithinëve të famshëm.

Në një rast nëna e tij e ka lutur Muhammedin a.s. t'i japë uratë Enesit. Pejgamberi a.s. ia plotësoi dëshirën asaj, me fjalët: "O Zot, bëre të fatshëm, të pasur dhe me trashëgimtarë; jepi jetë të gjatë dhe falia gabimet!" Lutja (duaja) u pranua. Enesi kishte një kopsht, i cili mbillej dhe korrej dy herë në vit, ndërsa gjatë jetës së vet i ka përcjellur në varr 102 anëtarë të familjes së vet. Ka jetuar mbi 100 vjet; vdiq në vitin 93, sipas hixhretit.

15. Na ka treguar Ja'kub b. Ibrahimi, këtij Ibni Ulejje, ky transmeton nga Abdu-l-Aziz b. Suhejbi, ky nga Enesi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. (sipas një senedi tjetër): Na ka treguar Ademi, ky nga Shu'be, ky nga Katade, ky nga Enesi, i cili ka treguar se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Asnjë nga ju nuk do të jetë besimtar (i mirë) derisa unë nuk do të jem më i dashur te ai se prindët e tij, fëmija i tij dhe njerëzia për-gjithësisht".[9]

باب حلاوة الإيمان

١٦ — حدثنا محمد بن المثنى قال حدثنا عبد الوهاب الثقفي قال حدثنا أيوب عن أبي قلابة عن أنس عن النبي ﷺ قال « ثلاث من كن فيه وجد حلاوة الإيمان : أن يكون الله ورسوله أحب إليه مما سواهما ، وأن يحب المرء لا يحبه إلا لله ، وأن يكره أن يعود في الكفر كما يكره أن يقذف في النار »

Kënaqësia e besimit (imanit)

16. Na ka treguar Muhammed b. Muthennai, këtij i ka treguar Abdu-l-Vehhab Thekafiu, këtij Ejjubi, duke transmetuar nga Ebu Kilabe, ky nga Enessi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili ka thënë:

"Ai që i ka tri cilësi, e përjeton kënaqësinë e besimit (imanit): **që All-llahu xh.sh. dhe Pejgamberi i Tij të jenë te ai më të dashur se çdo gjë tjetër; të dojë çdokënd, por vetëm në emër të All-llahut; të urrejë kthyerjen në mosbesim** (qufër), **ashtu siç urren të hidhet në zjarr".**[10]

---

9 Muslimanët e gjeneratës së parë Muhammedin a.s. dhe Islamin i kanë dashur më shumë se prindërit, se pasuria dhe se fëmijët e tyre. Ata për Islamin dhe bashkësinë islame kanë sakrifikuar çdo gjë, nuk e kanë kursyer as veten. Fatin dhe ardhmërinë e tyre e kanë parë në bashkësinë e tyre të fuqishme dhe të lumtur dhe me padurim pritnin që për të mirën dhe suksesin e fesë të japin edhe jetën e tyre. Këtu do të duhej të merrej shembull, sepse, aq sa parimet e fesë do të zbatohen më me këmbëngulje, për aq do të jetë më e lumtur dhe më e mirë edhe ardhmëria jonë.

10 Ndjenja e kënaqësisë së besimit (imanit), sipas Tirmidhiut është që muslimani ta përjetojë kënaqësinë dhe lumturinë gjatë kryerjes së urdhërave të All-llahut xh.sh., që në mënyrë të palëkundshme dhe të vendosur t'i durojë të gjitha vështirësitë dhe, që feja të jetë për të mbi të gjitha interesat e kësaj bote.

Dashuria ndaj All-llahut xh.sh. dhe Pejgamberit të Tij është pjesë e besimit (imanit). Dashurinë e sinqertë ndaj All-llahut xh.sh., ndaj Pejgamberit të Tij dhe njerëzve të tjerë

باب علامة الإيمان حب الأنصار

١٧ - حدثنا أبو الوليد قال حدثنا شعبة قال أخبرني عبد الله بن عبد الله بن جبر قال: سمعت أنسا عن النبي ﷺ قال « آية الإيمان حب الأنصار، وآية النفاق بغض الأنصار »

Dashuria ndaj Ensarëve është shenjë e besimit

17. Na ka treguar Ebu-l-Velidi, ky nga Shu'be, ky nga Abdullah b. Abdullah b. Xhebri që ka thënë se e kam dëgjuar Enesin kur ka transmetuar nga Pejgamberi s.a.v.s. këtë:

"Dashuria ndaj Ensarëve është shenjë e besimit, ndërsa shenja e hipokrizës (dyfytyrshmërisë) **është urrejtja ndaj Ensarëve".**[11]

باب ١٨ - حدثنا أبو اليمان قال أخبرنا شعيب عن الزهري قال أخبرني أبو إدريس عائذ الله بن عبد الله أن عبادة بن الصامت رضي الله عنه - وكان شهد بدرا، وهو أحد النقباء ليلة العقبة - أن رسول الله ﷺ قال وحوله عصابة من أصحابه « بايعوني على أن لا تشركوا بالله شيئا، ولا تسرقوا، ولا تزنوا، ولا تقتلوا أولادكم، ولا تأتوا ببهتان تفترونه بين أيديكم وأرجلكم، ولا تعصوا في معروف. فمن وفى منكم فأجره على الله، ومن أصاب من ذلك شيئا فعوقب في الدنيا فهو كفارة له، ومن أصاب من ذلك شيئا ثم ستره الله فهو إلى الله: إن شاء عفا عنه، وإن شاء عاقبه ». فبايعناه على ذلك

18. Na ka treguar Ebu-l-Jemani, i cili tha se e ka njoftuar Shu'ajbi nga Zuhriu, këtë e kishte njoftuar Ebu Idris Aidhullah b. Abdullahu se Ubade b.

---

dhe, urrejtjen ndaj mosbesimit, mund ta shfaqë vetëm njeriu me besim të fortë dhe të përsosur, njeriu që është mësuar me fe, e cila i është bërë e pandashme, që i ka hyrë thellë në shpirt dhe i është bërë ideal i jetës. Personi me tipare të tilla, pa dyshim, do të ndjejë kënaqësinë e besimit dhe do të jetë i lumtur në kryerjen e detyrimeve (farzeve) të cilat i ka urdhëruar All-llahu i Madhëruesëm.

11 Ensarët janë banorët e parë autoktonë të Medines që e përqafuan Islamin. Këta e pritën me krenari dhe krahëhapur Muhammedin a.s. dhe muhaxhirët e tjerë nga Mekka. Për të mirën dhe sukseset e Islamit, Ensarët e kanë sakrifikuar veten, pasurinë dhe familjet e tyre. Këta edhe sot e gjithë ditën janë shembull në gjithë botën. Këta mund t'i urrejë vetëm ai që nuk ka besim (iman) të plotë dhe që nuk di për angazhimet e tyre vetëmohuese.

Samiti r.a., i cili kishte marrë pjesë në luftën e Bedrit dhe është njëri nga paria e fisit të vet që kishte marrë pjesë në bisedimet e natës së Akabes, ka treguar se:

Pejgamberi s.a.v.s., e kur rreth tij ishte një grup i As-habëve, ka thënë:

"**Zotohuni** (betohuni) **se nuk do t'i bëni shok All-llahut, se nuk do të vidhni, se nuk do të bëni kurvni** (zina), **se nuk do t'i mbytni fëmijët tuaj, se nuk do t'i bëni shpifje tjetrit me ndonjë gënjeshtër për ta dobësuar** (nënçmuar) **para jush dhe se nuk do t'i kundërshtoni** (gjërat) **që janë plotësisht të njohura** (urdhërat e All-llahut). **Ai që i kryen detyrimet, do të shpërblehet te All-llahu xh.sh., ndërsa ai që nuk e plotëson ndonjë nga këto pika do të dënohet në këtë botë** (sipas sheriatit). **Dhe, dënim për të është mosbesimi. Ai që diçka nuk respekton nga kjo** (shkel, cënon), **e All-llahu ia mbulon, ajo është dëshirë e All-llahut, nëse dëshiron e fal, e nëse dëshiron e dënon".**

Edhe ne në këtë u zotuam (u betuam).[12]

بَابٌ مِنَ الدِّينِ الفِرَارُ مِنَ الفِتَنِ

١٩ – حَدَّثَنَا عبدُ اللهِ بنُ مَسْلَمَةَ عن مالكٍ عن عبدِ الرَّحمنِ بنِ عبدِ اللهِ بنِ عبدِ الرَّحمنِ بنِ أبي صَعْصَعَةَ عن أبيهِ عن أبي سَعيدٍ الخُدْرِيِّ أنَّه قال: قال رسولُ اللهِ ﷺ «يُوشِكُ أن يكونَ خَيْرَ مالِ المُسْلِمِ غَنَمٌ يَتْبَعُ بها شَعَفَ الجِبالِ، وَمَواقِعَ القَطْرِ، يَفِرُّ بِدِينِهِ مِنَ الفِتَنِ»

12 Ubade b. Samiti e shpjegoi hollësisht rrjedhën e mbledhjes së dytë të Muhammedit a.s. në Akabe, ku merrnin pjesë edhe 12 personalitete eminentë nga Jathribi (Medina). Të gjithë ata, menjëherë, e pranuan Islamin. Bashkë me këta, në Medine qe dërguar edhe Mus'ab b. Umeri, në cilësinë e mësuesit të parë për ata që sapo e kishin pranuar Islamin.
Ubade b. Samiti është Ensari i famshëm nga fisi Hazrexh. Ka prezentuar në mbledhjen e parë dhe në mbledhjen e dytë, të mbajtur në Akabe; ka marrë pjesë në luftën e Bedrit; në lidhjen e marrëveshjes paqësore me mekkasit në Hudejbi, si dhe në shumë aksione ushtarake.
Ka qenë njëri nga kadijtë e parë të Palestinës. Hazreti Umeri e ka dërguar në Siri në cilësinë e kadiut dhe të mësuesit të Fesë islame. Në Siri u vendos në qytetin e Humsit. Më vonë u kthye në Palestinë dhe aty vdiq. Është varrosur te Bejtu-l-Mukaddesi.

Ikja nga ngatërresat është pjesë e besimit

19. Na ka treguar Abdullah b. Mesleme, këtij Maliku, ky nga Abdu-r-Rahman b. Abdullah b. Abdu-r-Rahman b. Ebu Sa'sa, ky nga babai i vet, e ky nga Ebu Se'id el-Hudriu, i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.: **"Ndoshta pasuria më e mirë e muslimanit do të jetë bagëtia** (kopeja) **me të cilën ai do të shkojë nëpër majet e maleve dhe vendet ku mblidhet uji** (lugjet, koritat e ujit të shiut), **duke ikur me fenë e tij nga ngatërresat".**[13]

باب قولِ النبيِّ ﷺ « أنا أعلَمُكم بالله » ، وأنَّ المعرفةَ فعلُ القلب ، لقولِ اللهِ تعالىٰ :
﴿ ولٰكِن يُؤاخِذُكم بما كَسَبَتْ قلوبُكم ﴾

٢٠ — حدثنا محمدُ بنُ سَلامٍ قال أخبرَنا عَبْدَةُ عن هِشامٍ عن أبيهِ عن عائشةَ قالت : كانَ رسولُ اللهِ ﷺ إذا أمرَهم أمرَهم من الأعمالِ بما يُطيقون . قالوا : إنّا لسْنا كهيئتِكَ يا رسولَ اللهِ ، إنَّ اللهَ قد غفرَ لكَ ما تقدَّمَ من ذنبِكَ وما تأخَّرَ . فيَغضَبُ حتى يُعرَفَ الغضبُ في وجهِهِ ثم يقول : إنَّ أتقاكُم وأعلَمَكم باللهِ أنا »

Fjala e Pejgamberit s.a.v.s.

"Unë kam më tepër dituri në njohjen e All-llahut", e njohja e këtillë është vepër e shpirtit.

Fjala e All-llahut të Madhërueshëm është:

"...por, All-llahu do t'ju marrë juve në përgjegjësi (do t'ju dënojë) për atë që kanë bërë shpirtat tuaj...".

(el-Bekare, 225).

20. Na ka treguar Muhammed b. Selami, këtij i ka treguar Abde, këtij Hishami, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. u ka urdhëruar diçka shokëve të vet, ua ka urdhëruar vetëm atë që kanë mundur ta mbajnë (ta realizojnë)".

---

13 Me këtë hadith vihet në dukje levërdia e blektorisë; ana pozitive e saj në formimin e cilësive shpirtërore dhe morale të njeriut.

"O Pejgamber i All-llahut, ne nuk jemi sikur ti! i kanë thënë. All-llahu ty t'i ka falë gabimet e mëparshme, por edhe ato të mëvonshmet".

Ai për këtë u zemërua, saqë zemërimi vërehej në fytyrën e tij, e pastaj tha: **"Unë jam më i devotshëm** (takva) **dhe di më shumë se ju për All-llahun".**[14]

بابٌ مَنْ كَرِهَ أَنْ يَعُودَ فِي الْكُفْرِ كَمَا يَكْرَهُ أَنْ يُلْقَى فِي النَّارِ مِنَ الإِيمَانِ

٢١ – حَدَّثَنَا سُلَيْمَانُ بْنُ حَرْبٍ قَالَ حَدَّثَنَا شُعْبَةُ عَنْ قَتَادَةَ عَنْ أَنَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ « ثَلاَثٌ مَنْ كُنَّ فِيهِ وَجَدَ حَلاَوَةَ الإِيمَانِ : مَنْ كَانَ اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَحَبَّ إِلَيْهِ مِمَّا سِوَاهُمَا ، وَمَنْ أَحَبَّ عَبْداً لاَ يُحِبُّهُ إِلاَّ لِلَّهِ ، وَمَنْ يَكْرَهُ أَنْ يَعُودَ فِي الْكُفْرِ بَعْدَ إِذْ أَنْقَذَهُ اللَّهُ كَمَا يَكْرَهُ أَنْ يُلْقَى فِي النَّارِ »

---

14 Forca e bindjes islame shprehet në fuqinë e të kuptuarit të qenies së All-llahut xh.sh. Sa më tepër bindje të fortë të ketë njeriu, aq më thellë e kupton qenien e All-llahut xh.sh. Në hadithin e sipërpërmendur, prandaj, theksohet se Muhammedi a.s. është më i udhëzuari në njohjen e All-llahut xh.sh. dhe s'ka dyshim se ai kishte bindje më të forta fetare dhe ide kuptimplote për njohjen e All-llahut xh.sh.

Me këtë hadith vihet në dukje se të kuptuarit dhe njohja e qenies së All-llahut xh.sh. është pjesë përbërëse e besimit islam. Hadithi e hedh poshtë qëndrimin e sektit keramit, se imani përbën vetëm përcaktimin e rregullave islame.

Edhe Buhariu e hedh poshtë qëndrimin e keramitëve, duke konsideruar se besimi i vërtetë është vepër e shpirtit, pa të cilin nuk ka besim (iman) të plotë. Ky rast u shërben si argument atyre që thonë se besimi i njeriut mund të forcohet ose të dobësohet.

Besimtarët kanë pasë dhe do të kenë mendime të llojllojshme për qenien e All-llahut, ndërsa Muhammedi a.s. ka qenë në nivelin më të lartë në njohjen e All-llahut xh.sh. Bindja fetare dhe forca në besim mund të jenë më të forta ose më të dobëta, varësisht nga të kuptuarit e qenies së All-llahut të Madhërueshëm dhe nga kryerja e urdhrave të Tij.

Nga hadithi i sipërpërmendur mund të nxirret ky përfundim:

- veprat e mira e ngrenë njeriun në shkallën më të lartë shpirtërore e morale dhe njëkohësisht e ruajnë nga veset e llojllojshme dhe nga rënia e tij morale;
- manifestimet e arsyeshme fetare, të cilat kryhen në mënyrë të vazhdueshme, kanë vlerë të veçantë për ngritjen morale të njerëzve;
- nuk duhet mbështetur në veprat e mira të kryera më parë, por ato duhet vazhduar gjithnjë në jetë;
- Islami është fe logjike dhe për njerëzit e dobishme.

Kush urren që të kthehet në mosbesim (kufër), siç urren që të hidhet në zjarr, është pjesë e besimit (imanit)

21. Na ka treguar Suljeman b. Harbi, ky nga Shu'be, ky nga Katade, ky nga Enesi r.a., e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Te ai që ka tri gjëra, do të ndihet kënaqësia e besimit: te ai i cili nuk ka më të dashur se All-llahun dhe Pejgamberin e Tij, te ai i cili e do tjetrin vetëm për hir të All-llahut dhe, te ai i cili urren të kthehet në mosbesim (kufër), **pasi e shpëtoi All-llahu, ashtu siç urren të hudhet në zjarr"**.

باب تفاضُلِ أهلِ الإيمانِ فى الأعمال

٢٢ — حدثنا إسماعيلُ قال حدَّثنى مالكٌ عن عمرِو بنِ يحيى المازنىِّ عن أبيه عن أبى سعيد الخُدْرِىِّ رضىَ اللهُ عنهُ عنِ النبىِّ ﷺ قال « يَدْخُلُ أهلُ الجَنَّةِ الجَنَّةَ وَأهلُ النَّارِ النَّارَ ، ثمَّ يقولُ اللهُ تعالى أخرِجوا مَنْ كانَ فى قلبِهِ مِثقالُ حَبَّةٍ مِنْ خَرْدَلٍ مِنْ إيمانٍ ، فيُخْرَجونَ منها قد اسوَدّوا فيُلقَوْنَ فى نهرِ الحيا ـ أوِ الحياةِ ، شكَّ مالكٌ ـ فينبُتونَ كما تَنبُتُ الحِبَّةُ فى جانبِ السَّيلِ ، ألم تَرَ أنَّها تخرُجُ صَفراءَ مُلتَوِيَةً » ؟

قال وُهَيبٌ : حدَّثنا عَمْرٌو « الحياةِ » . وقال « خَرْدَلٍ مِنْ خَيرٍ »

Shpërblimi i besimtarëve (bëhet) sipas veprave të tyre

22. Na ka treguar Ismaili, duke transmetuar nga Maliku, ky nga Amr b. Jahja el-Maziniu, ky nga babai i vet, ky nga Ebu Se'id el-Hudriu r.a., e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili ka thënë:

"Në Xhennet do të hyjnë besimtarët, kurse në Xhehennem pabesimtarët".

Pastaj, All-llahu i Madhëruesëm do të thotë:

"Nxirreni (nga zjarri-Xhehennemi) **të gjithë ata, në zemrat e të cilëve ka pasë besim të peshës së një thelbi të hardelit** (bizele)".

Dhe, kur të jenë nxirë në tërësi do të nxirren nga aty (nga zjarri) dhe do të hidhen në lumin e turpit, ose në lumin e jetës - dyshon Maliku. Pastaj do të mbijnë sikur fara në bregun e lumit. A nuk e ke parë se ajo, me të vërtetë, del e verdhë dhe e përdredhur?

Vuhejbi ka thënë: Na ka treguar Amri: **"... el-hajati"**, d.m.th. "... në lumin e jetës" dhe vazhdoi: **"hardelin min hajrin"**, d.m.th. "të bëjë mirë sa pesha e një hardeli".[15]

٢٣ – حدثنا محمدُ بنُ عُبَيدِ اللهِ قال حدَّثنا إبراهيمُ بنُ سَعْدٍ عنْ صالحٍ عنِ ابنِ شِهابٍ عنْ أبي أُمامةَ بنِ سَهْلٍ أنَّهُ سَمِعَ أبا سَعيدٍ الخُدْرِيَّ يقول : قال رسولُ اللهِ ﷺ « بَيْنا أنا نائمٌ رَأيتُ النَّاسَ يُعْرَضونَ عليَّ وعليهم قُمُصٌ ، منها ما يبلُغُ الثُّدِيَّ ، ومنها ما دُونَ ذٰلكَ . وَعُرِضَ عليَّ عُمَرُ بنُ الخطَّابِ وَعليه قميصٌ يَجُرُّهُ . قالوا : فما أوَّلْتَ ذٰلكَ يا رسولَ اللهِ ؟ قال : الدِّينَ »

23. Na ka treguar Muhammed b. Ubejdullahu, këtij Ibrahim b. Sa'di, ky nga Salihu, ky ng Ibni Shihabi, e ky nga Ebu Umame b. Sehli, i cili ka dëgjuar nga Ebu Se'id el-Hudriu se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Kam parë në ëndërr disa njerëz. Ata më janë paraqitur qartë. Kishin veshur këmisha, disave u vinin deri në gjoks (gji), **e disave nën gjoks. M'u paraqit edhe Umer b. Hattabi. Ai e kishte këmishën e cila i shkonte për toke".**

"O Resulullah, si e shpjegon ti këtë?" e pyetën të pranishmit.

"Me fe (sipas shkallës së besimit)", u përgjigj.[16]

باب الحَياءِ مِنَ الإيمانِ

٢٤ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال : أخبرَنا مالكُ بنُ أنَسٍ عنِ ابنِ شِهابٍ عنْ سالمِ بنِ عبدِ اللهِ عنْ أبيه أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ مَرَّ على رجُلٍ منَ الأنصارِ – وهُوَ يَعِظُ أخاهُ في الحياءِ – فقالَ رسولُ اللهِ ﷺ « دَعْهُ ، فإنَّ الحَياءَ مِنَ الإيمانِ »

---

15 Përmbajtja e hadithit të sipërshënuar e hedh poshtë qëndrimin e sekti murxhie, i cili mendon se gabimtari (gjynahqari) nuk do të hyjë në Xhehennem, po qe se vetëm beson. Ky hadith e demanton edhe mendimin e mu'tezilëve që konsiderojnë se gabimtari do të qëndrojë në Xhehennem gjithnjë për gabimet që i ka bërë.

16 Në mes besimtarëve ka edhe shkallëzim (grada), varësisht nga veprat e tyre të mira, nga puna dhe vetëmohimi për interesa fetare-islame. Kjo do të thotë se veprat e mira dhe aktiviteti njerëzor janë pjesë përbërëse të besimit.

Me hadithin e lartshënuar theksohet shkalla e lartë fetare e Hazreti Umerit; e mund të lëvdohen edhe njerëzit e tjerë fetarë, nëse te ata nuk do të krijohej ndonjë shkas për huti ose për mendjemadhësi.

Turpi është pjesë e besimit

24. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Malik b. Enesi, këtij Ibni Shihabi, këtij Salim b. Abdullahu, këtij babai i tij se Pejgamberi s.a.v.s. ka kaluar pranë një Ensariu, i cili e këshillonte dhe e qortonte vëllain e vet për turpin.

Pejgamberi s.a.v.s. i tha: **"Lëre, mos e nga! Turpi, vërtet, është pjesë e besimit".**[17]

باب ﴿ فَإِنْ تَابُوا وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ فَخَلُّوا سَبِيلَهُمْ ﴾

٢٥ — حدثنا عبدُ اللهِ بنُ محمدٍ المُسْنَدِيُّ قال حدثنا أبو رَوْحٍ الحَرَمِيُّ بنُ عُمَارَةَ قال حدثنا شُعْبَةُ عن واقِدِ ابنِ محمدٍ قال : سَمِعْتُ أبي يُحَدِّثُ عن ابنِ عُمَرَ أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ قال « أُمِرْتُ أنْ أُقاتِلَ الناسَ حتَّى يَشْهَدُوا أنْ لا إلَهَ إلاَّ اللهُ ، وأنَّ محمداً رسولُ اللهِ ، ويُقِيمُوا الصلاةَ ، ويُؤْتُوا الزَّكاةَ . فإذا فَعَلُوا ذلكَ عَصَمُوا مِنِّي دِماءَهُمْ وأموالَهُمْ إلاَّ بِحَقِّ الإسلامِ ، وحسابُهُمْ عَلَى اللهِ »

"Nëse pendohen, nëse falin namazin, e nëse japin zeqatin, lërini të vazhdojnë rrugën e tyre"[18] (et-Tevbe, 5)

25. Na ka treguar Abdullah b. Muhammed Musnediu, këtij Ebu Revh Haremijj b. Umare, këtij Shu'be, këtij Vakid b. Muhammedi, i cili ka thënë: E dëgjova babain tim, kur e transmetonte hadithin nga Umeri, duke thënë se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

---

17 Në pjesën paraprake janë theksuar gradat e besimtarit në bazë të veprave të tyre të mira. Me këtë hadith, ndërkaq, vihet në dukje se turpi e ngre njeriun në një shkallë të lartë morale, e ruan nga rënia morale dhe e bën qenie shoqërore me dobi të përgjithshme.

18 Përkthimi i tërësishëm i këtij ajeti është: "Kur të kalojnë muajt e mëdhenj, atëherë mbytni idhujtarët (mushrikët) kudo që t'i takoni, zini robër, rrethoni dhe bëniu pusi kudo! E, nëse pendohen, nëse e falin namazin dhe nëse japin zeqatin, atëherë lërini të qetë. Se, All-llahu, me të vërtetë, është falës dhe mëshirues".
Ky ajet është shpallur si përgjigje ndaj idhujtarëve (mushrikëve) të Mekkes dhe të fiseve të tjera arabe, të cilët me vetëdashjen e tyre i kanë thyer marrëveshjet paqësore të lidhura me muslimanët. Për shkak të thyerjes së njëanshme të fjalës së dhënë, All-llahu i Madhërueshëm e ka urdhëruar Muhammedin a.s. që edhe ai t'i hedhë poshtë ato marrëveshje, posa të kalojnë muajt e shenjtë: dhu-l-ka'de, dhu-l-hixhxhe, muharremi dhe muaji rexheb, në të cilët nuk ishte e lejueshme të luftohet.

"Më është urdhëruar që të luftojë kundër njerëzve derisa ata të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është Pejgamberi i Tij; derisa të fillojnë të falin namazin e të japin zeqatin. Kur ta bëjnë këtë, do t'ua garantoj jetën (gjakun) **e tyre dhe pasuritë e tyre, por vetëm sipas të drejtës islame. Ndërkaq, llogaria përfundimtare i përket All-llahut xh.sh.".**[19]

بابُ مَنْ قال إنَّ الإيمانَ هُوَ العَمَلُ ، لِقَوْلِ اللهِ تعالىٰ ﴿ وتلكَ الجَنَّةُ الَّتي أُورِثْتُموها بِما كُنتُمْ تَعْمَلون ﴾ . وقال عِدَّةٌ مِنْ أهلِ العِلمِ في قولِهِ تعالىٰ ﴿ فوَ رَبِّكَ لَنَسْأَلَنَّهُم أجمعينَ عَمَّا كانوا يَعْمَلون ﴾ : عن قولِ لا إلٰهَ إلاَّ اللهُ . وقال ﴿ لِمِثْلِ هٰذا فَلْيَعْمَلِ العامِلون ﴾

٢٦ – حدَّثنا أحمدُ بنُ يونُسَ وموسىٰ بنُ إسماعيلَ قالا حدثنا إبراهيمُ بنُ سَعدٍ قال حدثنا ابنُ شِهابٍ عن سَعيدِ بنِ المُسَيَّبِ عن أبي هُرَيرةَ أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ سُئِلَ : أيُّ العَمَلِ أفضَلُ ؟ فقال : إيمانٌ باللهِ ورَسولِهِ . قيل : ثم ماذا ؟ قال : الجهادُ في سبيلِ اللهِ . قيل : ثُمَّ ما ذا ؟ قال : حَجٌّ مَبْرور

Besimi, pa dyshim, është punë

Fjala e All-llahut të Madhërueshëm:

"... Ai është Xhenneti të cilin ua kam dhuruar trashëgim për atë që keni punuar (besuar)".

(el-A'râf, 43).

Një numër i madh i dijetarëve islamë, Fjalën e All-llahut të Madhërueshëm:

"Pasha Zotin, të gjithë do t'i pyesim hollësisht (do t'i marrim në përgjegjësi) për atë që kanë punuar".

(el-Isrâ', 17)

e kanë komentuar me fjalët: **"Nuk ka zot përveç All-llahut"**. E, ngjashmërisht me këtë Ai ka thënë: **"Le të punojnë punëtorët!"**, d.m.th. **"Besimtarët le të besojnë në mënyrë të sinqertë!"**[20]

---

19 Neveviu thotë se me këtë hadith vihet në pah se duhet dënuar personi i cili me qëllim dhe pa arsye e lë faljen e namazit, duke e ditë se është detyrim i shkallës së parë (farz) për çdo musliman.

20 Më parë u theksua se veprat (e mira) e njerëzve janë pjesë përbërëse të besimit. Me këtë hadith hidhet poshtë mendimi i murxhive, e në hadith theksohet pra se imani është punë.

26. Na ka treguar Ahmed b. Junusi dhe Musa b. Ismaili, këtyre u kishte treguar Ibrahim b. Sa'di, këtij i kishte thënë Shihabi, këtij Se'id b. Musejjebi, ky nga Ebu Hurejre se Pejgamberin s.a.v.s. e kanë pyetur:

"Cila punë është më e vlefshme?"

"Besimi në All-llahun dhe në Pejgamberin e Tij", qe përgjigjur.

Mandej i është thënë: **"E çka pastaj?"**.

"Lufta në rrugën e All-llahut", qe përgjigjur.

Përsëri e kanë pyetur: **"E tjetër?"**

"Haxhillëku që për shkak të përkushtimit ndaj tij, bëhet pa gabime", qe përgjigjur Pejgamberi a.s.v.s.[21]

Murxhijtë pohojnë se personi që dëshmon besimin në All-llahun xh.sh. vetëm me gjuhë, hyn në Xhennet, edhe nëse nuk i kryen obligimet fetare në praktik.
Ajeti i cituar këtu, e demanton në tërësi këtë mendim, duke vënë në dukje se besimi i sinqertë është kusht për të hyrë në Xhennet dhe se puna (vepra) është pjesë e tij e pandashme. Aktiviteti dhe puna e njeriut janë pjesë përbërëse të besimit (imanit). Shprehjet foljore të ajetit: "ta'lemûne, ja'lemûne" janë përdorur në vend të "tu'minûne, ju'minûne", d.m.th. "Për atë që besoni", respektivisht "që besojnë".

21 Nga hadithi i lartshënuar mund të nxirret ky përfundim:
- me veprat e mira arrihet shkalla e lartë fetare-morale;
- besimi i vërtetë është të besosh me zemër dhe të shprehësh me gjuhë ekzistimin e All-llahut; të besosh e të dëshmosh se Muhammedi a.s. është Pejgamberi i Tij, të pranosh Shpalljen e All-llahut dhe të veprosh sipas saj;
- pas besimit në All-llahun dhe në Shpalljen e Tij, vjen aktiviteti dhe përhapja e mësimeve të Kur'anit, e pastaj kryerja e haxhillëkut pa gabime dhe me përkushtim të plotë.
Nuk ka kundërthënie në mes këtij dhe hadithit të mëparmë të cilin e transmeton Ibni Mes'udi, ku i jipet përparësi namazit të detyrueshëm që falet në kohën e duhur. Në hadithin të cilin e transmeton Ebu Musai i është dhënë përparësi muslimanit, nga dora dhe gjuha e të cilit janë të qentë muslimanët e tjerë. Ndërkaq, në disa hadithe të tjerë u jipet përparësi disa aktiviteteve të tjera.
Numërimi dhe dhënia përparësi njërës përballë tjetrës, duhet patur parasysh, në radhë të parë, rastet dhe rrethanat në të cilat Muhammedi a.s. i ka dhënë porositë përkatëse, pastaj, edhe personave që ua ka dhënë ato porosi. Kështu, për shembull, Muhammedi a.s. në një rast ka thënë se të kryerit e Haxhxhit për njeriun i cili nuk e ka kryer më parë, është më i mirë dhe më i vlefshëm se pjesëmarrja në dyzet lufta. Për atë që vetëm një herë e ka kryer këtë detyrë, është më mirë të marrë pjesë në një ekspeditë ushtarake sesa të shkojë në haxhillëk dyzet herë.

بابٌ إذا لم يَكُنِ الإسلامُ عَلَى الحَقِيقَةِ، وكان عَلَى الاسْتِسْلامِ أو الخَوْفِ مِنَ القَتْلِ، لقولِهِ تعالى ﴿ قالَتِ الأعْرابُ آمَنّا. قُلْ لم تُؤْمِنوا، ولكِنْ قولوا أسْلَمْنا ﴾ فإذا كان على الحَقِيقَةِ فهُوَ على قولِهِ جَلَّ ذِكْرُهُ ﴿ إنَّ الدِّينَ عِندَ اللهِ الإسْلامُ ﴾

٢٧ — حدثنا أبو اليمانِ قال أخبرنا شُعَيْبٌ عنِ الزُّهْرِيِّ قال أخبرنا عامِرُ بنُ سَعدِ بنِ أبي وَقّاصٍ عن سَعدٍ رضي اللهُ عنه أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ أعْطى رَهْطاً ـ وسعدٌ جالسٌ ـ فترَكَ رسولُ اللهِ ﷺ رجُلا هُوَ أعْجَبُهم إليَّ. فقلتُ: يا رسولَ اللهِ مالَكَ عن فُلانٍ؟ فوَ اللهِ إنّي لأراهُ مُؤْمِناً. فقال: أو مُسْلِماً فسَكَتُّ قليلا. ثمَّ غَلَبَني ما أعْلَمُ مِنه فعُدْتُ لِمَقالَتي فقلتُ: مالَكَ عن فُلانٍ؟ فوَ اللهِ إني لأراهُ مُؤْمِناً فقالَ: أوْ مُسْلِماً. ثمَّ غَلَبَني ما أعْلَمُ مِنه فعُدْتُ لِمَقالَتي، وعادَ رسولُ اللهِ ﷺ. ثمَّ قال: يا سَعدُ، إنّي لأُعْطِي الرَّجُلَ وغيرُهُ أحَبُّ إليَّ منهُ، خَشْيَةَ أنْ يَكُبَّهُ اللهُ في النارِ. ورواه يونُسُ وصالِحٌ ومَعْمَرٌ وابنُ أخي الزُّهْرِيِّ عنِ الزُّهْرِيِّ

Kur Islami (imani) nuk është i sinqertë, por sipërfaqësor, ose nga frika prej vdekjes

All-llahu i Madhëruesheëm (në Kur'an) thotë:

"Beduinët thanë: "Ne besojmë". Thuaju atyre: "Nuk keni besuar!" Por thoni: "Ne kemi pranuar Islamin...!".[22]

(el-Huxhurât, 14)

---

22 Përkthimi i mëtutjeshëm i ajetit është:
"... meqë në zemrat tuaja ende nuk ka hyrë Feja islame si duhet. E, nëse i përuleni All-llahut dhe Pejgamberit të Tij, nuk do t'ju pakësohet asgjë prej veprave tuaja. Me të vërtetë All-llahu është falës dhe mëshirues".
"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë All-llahun dhe Pejgamberin e Tij, dhe pastaj, pa farë dyshimi, luftojnë në rrugën e All-llahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Këta janë besimtarë të sinqertë".
Shkaku i shpalljes së ajetit të posapërmendur qe ardhja e disa anëtarëve të fisit Beni Esed ibni Huzejme te Muhammedi a.s. për t'i kërkuar ndihmë materiale, meqë ky vit qe me thatësira të mëdha. Ata e kishin besuar All-llahun xh.sh. dhe Muhammedin a.s. si Pejgamber të Tij vetëm sipërfaqësisht. Këtë qëndrim e kishin edhe për Shpalljen që kishte zbritur deri atëherë. Meqë nuk i kishin besuar këto në mënyrë të vërtetë, ata bënin çrregullime, krijonin tollovi dhe i nënçmonin muslimanët. Lidhjen dhe bindjen e tyre për Islam e theksuan vetëm për të marrë sa më tepër ndihmë materiale.
Ajeti e hedh poshtë qëndrimin e sektit keramite dhe murxhie, të cilët pohojnë se besimi (imani) përbëhet vetëm nga dëshmia (me gjuhë), pa besuar me zemër. Ky qëndrim, pra,

E kur besimi është i sinqertë, ai është ashtu sikurse qëndron te fjala e All-llahut të Madhërueshëm:

"Fe e vërtetë te All-llahu është vetëm Islami...".

(Ali Imrân, 19).

27. Na ka treguar Ebu-l-Jemani, këtij i ka thënë Shu'ajbi nga Zuhriu, këtij Amir b. Sa'd b. Ebu Vekkasi, ky nga Sa'di r.a., i cili ka treguar:

Pejgamberi s.a.v.s. u ka ndarë lëmoshë (sadaka) disa njerëzve. Aty kishte ndodhur edhe Sa'di. Pejgamberi s.a.v.s. e la njërin (pa i dhënë sadaka). Ai për mua (thotë Sa'di) ishte më i dashur (në atë grup), prandaj i thashë:

"O Resulullah, ç'është puna me filanin? Për Zotin, unë atë e di si besimtar!"

"Mos thuaj ashtu, (thuaj) **edhe musliman"**, tha (Pejgamberi).

Unë heshta pak. Por, nuk u durova sepse e njihja atë, prandaj e përsërita fjalën:

"O Resulullah, ç'është puna me filanin? Për Zotin, unë e njoh atë për besimtar".

"Mos thuaj, ashtu, (thuaj) **edhe musliman"**. tha.

Unë heshta pak. Por, nuk munda të përmbahem, sepse i dija cilësitë e tij, prandaj përsëri e pyeta:

"O Resulullah, çështë puna me filanin? Për Zotin, unë e di atë besimtar!"

"(Thuaj) **edhe musliman"**, tha (Pejgamberi s.a.v.s.)

Përsëri heshta, por ajo që dija për të, më shtyu të përsëris të njëjtën pyetje. Edhe Pejgamberi s.a.v.s. e përsëriti të njëjtën përgjigje. Pejgamberi s.a.v.s. pastaj tha:

"O Sa'd, unë i ndava sadaka (lëmoshë) **atij njeriu, ndonëse tjetri më ishte më i dashur, duke u frikuar që All-llahu të mos e hedh në zjarr".**

---

nuk është në pajtueshmëri me mësimet e Kur'anit, sipas të cilit zemra është bazë e të besuarit, kurse organi folës (gjuha) është vetëm mjet me të cilin manifestohet besimi. Qëndrimin e sekteve të përmendura më sipër, e kanë hedhë poshtë të gjithë dijetarët islamë, të cilët njëzërit theksojnë se dyfytyrëshi nuk është musliman, sepse vetëm formalisht manifeston përkatësinë e tij islame.

Ky hadith transmetohet edhe nga: Junusi, Salihu, Ma'meri, nga djali i vëllait tim, Zuhriu, transmetuar nga Zuhriu.[23]

بَابُ إِفْشَاءِ السَّلَامِ مِنَ الْإِسْلَامِ . وَقَالَ عَمَّارٌ : ثَلَاثٌ مَنْ جَمَعَهُنَّ فَقَدْ جَمَعَ الْإِيمَانَ : الْإِنْصَافُ مِنْ نَفْسِكَ ، وَبَذْلُ السَّلَامِ لِلْعَالَمِ ، وَالْإِنْفَاقُ مِنَ الْإِقْتَارِ

٢٨ – حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ قَالَ حَدَّثَنَا اللَّيْثُ عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي حَبِيبٍ عَنْ أَبِي الْخَيْرِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو أَنَّ رَجُلًا سَأَلَ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ : أَيُّ الْإِسْلَامِ خَيْرٌ ؟ قَالَ : تُطْعِمُ الطَّعَامَ وَتَقْرَأُ السَّلَامَ عَلَى مَنْ عَرَفْتَ وَمَنْ لَمْ تَعْرِفْ

Përshëndetja (dhënia selam) është pjesë e Islamit

Ammari ka thënë: **"Ai që i ka bashkuar tri cilësi, e ka kompletuar** (plotësuar) **besimin: drejtësinë, i përshëndet** (u jep selam) **njerëzve dhe jep sadaka** (lëmoshë), **kur edhe vetë është nevojtar"**.

---

23 Muhammedi a.s. i pat dhënë sadaka (lëmoshë) personit që posa e kishte pranuar Islamin, duke dashur që ta përvetësojë sa më mirë për bashkësinë islame dhe për ta ndarë nga idhujtaria. Ndërkaq, personi për të cilin interesohej Sa'di e kishte pranuar Islamin më herët. Kështu, ndihma materiale për të nuk do të kishte efekt aspak. Ai ishte musliman i mirë, me besim të fortë dhe, edhe pse nuk merrte ndihmë materiale, do të mbetej dhe më tej musliman i mirë.

Nga hadithi mund të nxirret ky përfundim:

- lejohet të rekomandosh për gjëra të dobishme te udhëheqësi, duke paraqitur argumentet përkatëse;
- lejohet të rekomandosh për një gjë disa herë, po qe se ajo sjell dobi; nuk shkakton çrregullim, tollovi, ose nuk është e kundërligjshme;
- duhet të jesh i durueshëm në punë, kurse në kërkesa të arsyeshme këmbëngulës;
- udhëheqësi mund ta shpenzojë pasurinë shoqërore kur mendon se me të vërtetë ka dobi bashkësia islame;
- intervenimi i papranuar nuk duhet të konsiderohet si mossukses dhe nënçmues nga ana e palës;
- refuzimi i kërkesës së palës duhet të arsyetohet;
- manifestimi formal i rregullave (detyrave) fetare pa një besim të sinqertë nuk është i vlefshëm.
- është i lejueshëm betimi i rastësishëm, qëllimmirë (jemin-i lagvijj). Ky betim nuk ka kurrfarë pasojash juridike islame (siaps sheriatit). Ky është betim i rastit, me të cilin betohet personi, duke menduar se ajo për të cilin betohet, vërtetë është ashtu, por më vonë kupton se është ndryshe.

28. Na ka treguar Kutejbe, i cili thotë se na ka njoftuar Lejthi, këtij Jezid b. Ebu Habibi, ky nga Ebu-l-Hajri, ky nga Abdullah b. Amri se një njeri e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"Çka është më së miri të veprohet sipas Islamit?"

Pejgamberi s.a.v.s. i qe përgjigjur:

"Ta ushqesh të uriturin, të përshëndesësh (t'i japish selam) **atë që e njeh dhe që nuk e njeh".**

بابُ كُفْرانِ العَشِيرِ ، وكُفْرٍ دُونَ كُفْرٍ . فيهِ عنْ أبي سَعِيدٍ الخُدْرِيِّ عنِ النبيِّ ﷺ

٢٩ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ مَسْلَمَةَ عنْ مالِكٍ عنْ زَيْدِ بنِ أسْلَمَ عنْ عَطاءِ بنِ يَسارٍ عنِ ابنِ عَبّاسٍ قالَ : قالَ النبيُّ ﷺ « أُرِيتُ النارَ ، فاذا أكثرُ أهلِها النِّساءُ يَكْفُرْنَ . قيلَ : أيَكْفُرْنَ باللهِ ؟ قالَ : يَكْفُرْنَ العَشِيرَ ، ويَكْفُرْنَ الإحْسانَ . لَوْ أحسنتَ إلى إحداهُنَّ الدَّهْرَ ثُمَّ رأتْ منكَ شَيْئاً قالتْ : ما رأيتُ مِنكَ خَيْراً قَطُّ »

Mosrespekti (mosmirënjohja) ndaj bashkëshortit dhe gabimi i shkallës së lartë

Transmetohet nga Ebu Se'id el-Hudriu, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s.

29. Na ka treguar Abdullah b. Mesleme, ky nga Maliku, ky nga Zejd b. Eslemi, ky nga Ata b. Jesari, ky nga Ibni Abbasi, *i cili ka thënë:*

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.: **"Më është paraqitur zjarri** (Xhehennemi) **dhe kam parë në të se shumica ishin gra. Ato kishin bërë qufër** (kishin mbuluar të vërtetën)".

"A kanë bërë qufër ndaj All-llahut?" qe pyetur.

Përgjigja: **"Ato kanë bërë qufër ndaj bashkëshortëve të tyre, kanë bërë qufër ndaj mirësisë. Kur ndonjërës prej tyre gjithë jetën i bën mirë, e më vonë në ty sheh diçka që nuk i pëlqen, do të thotë: "Nuk kam parë prej teje asnjëherë ndonjë të mirë".**[24]

---

24 Fjala "kufrun" do të thotë "mbulojë". Nga rrënja e kësaj fjale rrjedh fjala "kâfir", d.m.th. "bujk", sepse ai e mbulon farën në arë; kurse pabesimtari e mbulon të vërtetën e fesë. "Kufrun", pastaj do të thotë "gaboj, bëj gabim", "të qenët mosmirënjohës për mirësinë që i bëhet dhe të mohuarit e së drejtës së tjetrit".

Mosbesimi ndodh:

- për shkak të ruajtjes së ideve fanatike e konservative të mëparme që i ka pasë personi,

بَابُ الْمَعَاصِي مِنْ أَمْرِ الْجَاهِلِيَّةِ . وَلَا يُكَفَّرُ صَاحِبُهَا بِارْتِكَابِهَا إِلَّا بِالشِّرْكِ ، لِقَوْلِ النَّبِيِّ ﷺ « إِنَّكَ امْرُؤٌ فِيكَ جَاهِلِيَّةٌ » وَقَوْلِ اللهِ تَعَالَى ﴿ إِنَّ اللهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَٰلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ﴾

٣٠ — حَدَّثَنَا سُلَيْمَانُ بْنُ حَرْبٍ قَالَ حَدَّثَنَا شُعْبَةُ عَنْ وَاصِلٍ الْأَحْدَبِ عَنِ الْمَعْرُورِ قَالَ : لَقِيتُ أَبَا ذَرٍّ بِالرَّبَذَةِ وَعَلَيْهِ حُلَّةٌ وَعَلَى غُلَامِهِ حُلَّةٌ ، فَسَأَلْتُهُ عَنْ ذَٰلِكَ فَقَالَ : إِنِّي سَابَبْتُ رَجُلًا فَعَيَّرْتُهُ بِأُمِّهِ ، فَقَالَ لِي النَّبِيُّ ﷺ « يَا أَبَا ذَرٍّ ، أَعَيَّرْتَهُ بِأُمِّهِ ؟ إِنَّكَ امْرُؤٌ فِيكَ جَاهِلِيَّةٌ . إِخْوَانُكُمْ خَوَلُكُمْ ، جَعَلَهُمُ اللهُ تَحْتَ أَيْدِيكُمْ . فَمَنْ كَانَ أَخُوهُ تَحْتَ يَدِهِ فَلْيُطْعِمْهُ مِمَّا يَأْكُلُ ، وَلْيُلْبِسْهُ مِمَّا يَلْبَسُ ، وَلَا تُكَلِّفُوهُمْ مَا يَغْلِبُهُمْ ، فَإِنْ كَلَّفْتُمُوهُمْ فَأَعِينُوهُمْ »

---

për të cilin në Kur'an thuhet: "Me të vërtetë për ata që janë këmbëngulës në mosbesim, është njësoj, ua tërhoqe vërejtjen apo nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë". (el-Bekare, 6).

- për shkak të kokëfortësisë. Këtu bën pjesë mosbesimi i Iblisit, pastaj i Bel'amit, Umejje b. Saltit e të ngjashëm;

- për shkak të mendjemadhësisë. Njeriu i mençur e kupton të vërtetën e fesë, por për shkak të hamendjes (hutisë), e refuzon, sikurse veproi Ebu Talibi;

- besimi formal dhe jo i sinqertë ndodh për shkak të interesave personale. Këtë e kanë bërë hipokritët në ditët e para të përhapjes së Islamit. Ata u lidhën për Islamin vetëm shprehimisht, kurse fshehurazi, punonin dhe vepronin kundër Islamit dhe bashkësisë islame.

Nga ky hadith mund të nxirren edhe këto përfundime:

- është e ndaluar (haram) t'i mohosh të drejtat e tjetrit dhe të jesh mosmirënjohës në dhuratën e dhënë. Personi mosmirënjohës e meriton zjarrin e Xhehennemit. Mosrespekti i gruas ndaj burrit (bashkëshortit) i cili bën vepra të mira dhe kujdeset për të, si dhe mosnjohja e përpjekjeve të tij nga ana e saj, bën pjesë në gabime (gjynahe) të mëdha, thotë Neveviu. Ibni Batali thotë se me hadithin e sipërpërmendur personi bukëshkalë (mosmirënjohës) do të jetë i dënuar, ndërsa ai që pranon ndihmë e ka detyrë fetare e morale t'i falenderohet mirëbërësit;

- shtëpiaku, udhëheqësi i familjes është i detyruar t'i këshillojë anëtarët e familjes, t'i edukojë, t'i ngrejë profesionalisht, të zhvillojë te ata shprehinë e punës dhe të respektojnë të vjetrit;

- bashkëshortja është e detyruar të njohë të drejtën e bashkëshortit të vet, kurse burri t'i kryej detyrat ndaj gruas me përpikëri;

- për punët e dyshimta dhe të paqarta duhet kërkuar ndihmë nga njerëzit me njohuri të plota;

- nuk goxon të mohohet ekzistimi i Xhehennemit dhe përgjegjësia për veprat e bëra;

- gabimi (gjynahu) nuk e sjell personin në mosbesim, por ia dobëson ndjenjën fetare. Për këtë pajtohen të gjithë dijetarët islamë.

Gabimet që bartin karakteristika të xhahilijetit, atë që i bën këta, nuk e bëjnë pabesimtar, përveç idhujtarisë

Fjala e Pejgamberit s.a.v.s.:

"Ti je njeri që në vete ke karakteristika të xhahilijetit".

Dhe, Fjala e All-Ilahut të Madhëruesheëm:

"All-llahu, me siguri, nuk do t'i falë ata që adhurojnë idhujt (që i bëjnë shok Atij), por, do t'i falë gabimet tjera, atij që do".[25]

(en-Nisâ', 116).

---

25 Në pjesën paraprake mosmirënjohja është cilësuar si gabim i madh, kurse në këtë pjesë vihet në dukje dëmi i shfaqjes së veseve; domosdoja e çrrënjosjes së mendjemadhësisë dhe të gjitha gjërat e tjera të dëmshme. Ato janë karakteristika të idhujtarisë dhe duhet evituar gjithsesi.

Sipas mendimit të Ibni Abbasit, shkaku i shpalljes së ajetit të sipërpërmendur është ardhja e Vahshiut, vrasës i Hamzait, mixhës së Muhammedit a.s., te Muhammedi a.s. Kur erdhi te Muhammedi a.s. ai (Vashiu) kërkoi mëshirë dhe mbrojtje për të dëgjuar ndonjë ajet ose sure nga Kur'ani. Muhammedi a.s. ia bëri me dije se nuk ka dëshirë ta shohë afër vetes, por, pasi tashmë është këtu, ia premtoi atij mbrojtjen dhe ia mundësoi që të dëgjojë ajetet nga Kur'ani.

Vahshiu, pastaj deklaoi: "Kam qenë idhujtar dhe pa të drejtë i kam vrarë njerëzit dhe kam bërë kurvëri, prandaj, më intereson se a do të pranojë All-llahu pendimin tim?" Lidhur me interesimin e Vahshiut, është shpallur ajeti: "Ata të cilët i luten vetëm All-llahut, ata të cilët nuk vrasin njerëz që All-llahu i ka ndaluar, përveç në mnyrë të drejtë, dhe ata që bëjnë vepra të mira, do të jenë të falur..."

- I shoh këtu disa kushte, vetëm se unë nuk kam punuar asnjë vepër të dobishme për njerëzit, e te All-llahu të pranueshme (të këndshme), tha Vahshiu. Ma siguro mbrojtjen dhe mëshirën tënde të dëgjoj edhe diçka nga Kur'ani. Pastaj, u shpall ajeti: "All-llahu, me të vërtetë, nuk do t'i falë ata që adhurojnë idhujt, e do t'ia falë gabimet tjera atij që do".

Pastaj, Pejgamberi a.s. e thirri Vahshiun dhe ia citoi ajetin e posapërmendur.

- Ndoshta jam unë nga ata që nuk do të më falë? Më dhuro mbrojtjen tënde të dëgjoj edhe diçka nga Shpallja e All-llahut, tha Vahshiu.

Pastaj, u shpall ajeti, që në përkthim është: "O robët e Mi, mos i humbni shpresat në mëshirën e All-llahut...!"

- Mrekullueshëm! Nuk shoh më asnjë kusht, tha Vahshiu dhe e pranoi Islamin.

Përmbajtja e ajetit i hedh poshtë mendimet e sekteve: rafiije, ibadije dhe të disa harixhive, të cilët thonë se besimtari i cili gabon, do të mbetet gjithnjë në Xhehennem. Ajeti i hedh poshtë mendimet e këtilla, duke theksuar se në Xhehennem, do të jenë vetëm ata që adhurojnë idhujt (ata që i bëjnë shok All-llahut).

30. Na ka treguar Sulejman b. Harbi, këtij i ka treguar Shu'be, këtij Vâsëll el-Ahdedi, këtë e kishte njoftuar Ma'ruri, i cili ka thënë: E takova rastësisht Ebu Dherrin. Ai dhe fëmija i tij kishin veshur tesha të njëjta. E pyeta për këtë, e ai u përgjigj:

(Një herë) jam fjalosur me një njeri, e unë e ofendova dhe e turpërova atë në nënën, prandaj, Pejgamberi s.a.v.s. më tha:

"O Ebu Dherr, a e turpërove dhe e ofendove në nënën? Ti je njeri me shprehi të xhahilijetit (injorancës). **Robërit tuaj, vëllezërit tuaj, All-llahu i ka vënë nën pushtetin tuaj dhe kushdo që të ketë të tillë nën pushtetin e tij, le ta ushqejë ashtu si ushqehet vetë dhe le ta veshë ashtu siç vishet edhe vetë. Mos i ngarkoni deri në rraskapitje, e nëse i ngarkoni, ndihmohuni".**[26]

باب ﴿ وإنْ طائِفتانِ مِنَ المُؤْمِنِينَ اقْتَتَلوا فأصْلِحوا بَيْنَهُما ﴾ فسَمّاهُمُ المُؤْمِنِين

٣١ — حدثنا عبدُ الرَّحْمٰنِ بنُ المُبارَكِ حدثنا حَمّادُ بنُ زيدٍ حدثنا أيوبُ ويُونُسُ عنِ الحسَنِ عنِ الأحْنَفِ بنِ قَيسٍ قال : ذَهبتُ لِأنْصُرَ هٰذا الرَّجُلَ . فلَقِيَنِي أبو بَكرةَ فقال : أينَ تُرِيدُ ؟ قلتُ أنْصُرُ هٰذا الرَّجُلَ . قال : ارْجِعْ . فإنِّي سَمِعْتُ رسولَ اللهِ ﷺ يقول « إذا التَقَى المُسْلِمانِ بسَيْفَيْهِما فالقاتِلُ والمقتولُ في النارِ . قلتُ : يا رسولَ اللهِ هٰذا القاتِلُ ، فما بالُ المقتولِ ؟ قال : إنه كان حَرِيصاً على قتلِ صاحِبِه »

---

26 Nga hadithi i lartpërmendur nxirret ky përfundim:

- është e palejueshme t'i urresh robërit, të bësh padrejtësi mbi ta, t'i ofendosh për shkak të prejardhjes (origjinëse) së tyre. E njëjta gjë vlen edhe për shërbëtorët dhe njerëzit e tjerë të nënshtruar. Islami, përkundrazi, urdhëron që atyre t'u ndihmohet dhe ndaj tyre të ketë mëshirë dhe qëndrim miqësor. Është e ndaluar të fyhen e të nënçmohen personat për shkak të ndonjë të mete të tyre fizike, ose të prindërve të tyre. Është e ndaluar gjithashtu mendjemadhësia dhe lavdërimi i cilësive vetiake, ose të prindërve. Qëndrim human dhe korrekt duhet patur sidomos ndaj të dobtëve dhe të nënshtruarve.

Muslimani është i detyruar të ketë mëshirë edhe ndaj kafshëve, t'i ngarkojë aq sa munden të mbajnë. Vrazhdësia, cinizmi dhe terrorizmi janë vese (karakteristika) të kohës së xhahilijetit (injorancës), të cilat duhet të çrrënjosen dhe të evitohen.

- shërbëtorin, punëtorin dhe të nënshtruarin duhet ushqyer me të njëjtin ushqim, të cilin e han edhe vetë dhe duhet veshur me tesha që të pëlqejnë edhe ti t'i veshësh.
- të ngarkosh njerëzit (me detyra) dhe kafshët (me barrë) përtej mundësisë së tyre, nuk është e lejueshme.
- muslimani duhet të angazhohet maksimalisht për vepra të mira: të pëlqyeshme për All-llahun xh.sh. dhe të dobishme për njerëzit.

"Nëse dy palë besimtarësh përleshen, ndërmjetësoni te ata" (el-Huxhurât, 9).

All-llahu i ka quajtur ata besimtarë.[27]

31. Na ka treguar Abdu-r-Rahman b. Mubareku, këtij i kishte treguar Hammad b. Zejdi, këtij Ejjubi dhe Junusi nga Hasani, këtë e ka lajmëruar Ahnef b. Kajsi i cili ka thënë:

Shkova t'i ndihmoj këtij njeriu, por më takoi Ebu Bekre dhe më tha: **"Kah ia ke mësyer kështu?"**

"T'i ndihmoj këtij njeriu", i thashë.

"Kthehu!" tha Ebu Bekre. Me të vërtetë e kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

"Kur përleshen dy muslimanë të armatosur me shpata, në zjarr (Xhehennem) **do të hyjë edhe vrasësi edhe i vrari.**

"O Resulullah! vrasësi, po, po pse i vrari?" i thashë.

"Për shkak se edhe ai ka lakmuar ta vrasë vëllain e vet musliman", u përgjigj (Pejgabmeri s.a.v.s.).

باب ظُلْمٌ دُونَ ظُلْمٍ

٣٢ - حدثنا أبو الوليد قال حدثنا شعبة . ح . قال وحدثني بشر قال حدثنا محمد عن شعبة عن سليمان عن إبراهيم عن علقمة عن عبد الله قال : لما نزلت ﴿ الذين آمنوا ولم يلبسوا إيمانهم بظلم ﴾ قال أصاب رسول الله ﷺ : أيُّنا لم يظلم ؟ فأنزل الله ﴿ إن الشرك لظلم عظيم ﴾

Zullumi më i madh

32. Na ka tregua Ebu-l-Velidi, këtij Shu'be, e sipas vargut tjetër të transmetuesve: Më ka treguar Bishri, këtij i kishte treguar Muhammedi, këtij

---

27 Nga përmbajtja e ajetit vihet në dukje se të gabuarit nuk e nxjerr besimtarin nga radhët e Islamit, e as që mund të jetë shkak që gabimtari (gjynahqari) të jetë gjithnjë në Xhehennem, përveç atij që i bën shok All-llahut xh.sh. (që beson në idhuj). Në tekstin e ajetit të Kur'anit theksohet nevoja e angazhimit të plotë të çdo muslimani për pajtimin e atyre që janë në ngatërresa, për zhdukjen e veprimeve terroriste, të cilat janë të dëmshme për njerëzit dhe për shoqërinë në përgjithësi.

Shu'be, ky nga Sulejmani, ky nga Ibrahimi, ky nga Alkame, e ky nga Abdullahu, se kur është shpallur ajeti:

"Për ata që besojnë dhe nuk e përziejnë besimin e tyre me zullum...".

(En'âm, 82).

As-habët e pyetën Pejgamberin s.a.v.s.:

"E, cili nga ne nuk ka bërë zullum (nuk ka gabuar)?"

All-llahu i Madhërueshëm (lidhur me zullumin - gabimin më të madh) dërgoi këtë ajet:

"... Me të vërtetë, t'i bësh shok All-llahut është zullumi (gabimi) më i madh".[28]

(Llukman, 13).

باب علامة المنافق

٣٣ – حدثنا سليمانُ أبو الربيع قال حدثنا إسماعيلُ بنُ جعفرٍ قال حدثنا نافعُ بنُ مالكِ بنِ أبي عامرٍ أبو سُهَيلٍ عن أبيه عن أبي هُرَيرةَ عن النبيِّ ﷺ قال « آيةُ المُنافقِ ثلاثٌ إذا حَدَّثَ كَذَبَ ، وإذا وَعَدَ أخلَفَ ، وإذا اؤتُمِنَ خان »

Shenja e dyfytyrësisë (munafikut)

33. Na ka treguar Sulejman Ebu-r-Rebiu dhe ka thënë se atij i kishte treguar Ismail b. Xha'feri, këtij Nafi' b. Malik b. Ebu Amir Ebu Suhejli, ky nga babai i vet, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Shenjat e dyfytyrëshit (munafikut) **janë tri: kur flet, rren, kur premton, nuk e mban fjalën dhe kur diçka i besohet, tradhton".**

---

28 Në këtë ajet fjalën "zulm". As-habët e kanë kuptuar si "gabim, gjynah, mëkat". Fjala "zulm" e kuptuar gabimisht këtu shpjegohet në ajetin tjetër ku ka për qëllim idhujtarinë. Në të vërtetë kjo fjalë në disa ajete dhe hadithe të tjera do të thotë "gabim, gjynah", nganjëherë më i madh, e nganjëherë më i vogël, prandaj, nënkupton edhe "besimin në idhujtari, që besimtarin e nxjerr nga radhët e Islamit".

٣٤ - حدثنا قبيصةُ بنُ عُقْبَةَ قال حدثنا سُفْيانُ عنِ الأعمشِ عنْ عبـــدِ اللهِ بنِ مُرَّةَ عنْ مَسْروقٍ عنْ عبدِ اللهِ بنِ عَمْرٍو أنَّ النبيَّ ﷺ قال « أربعٌ مَنْ كُنَّ فيهِ كانَ مُنافِقاً خالصاً ، وَمَنْ كانتْ فيهِ خَصْلَةٌ مِنهنَّ كانتْ فيهِ خَصْلَةٌ مِنَ النفاقِ حتى يَدَعَها . إذا اؤْتُمِنَ خانَ ، وإذا حدَّثَ كَذَبَ ، وإذا عاهَدَ غَدَرَ ، وإذا خاصَمَ فَجَرَ »

تابعه شُعْبَةُ عنِ الأعمشِ

34. Na ka treguar Kabisa b. Ukbe, ky ka dëgjuar nga Sufjani, ky nga A'meshi, ky nga Abdullah b. Murre, ky nga Mesruku, ky nga Abdullah b. Amri se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Do të jetë dyfytyrësh (munafik) **i vërtetë ai që ka katër karakteristika** (shenja), **e ai që ka vetëm një nga këto katër karakteristika, do të konsiderohet dyfytyrësh përderisa nuk e largon atë: kur i besohet diçka, tradhton, kur flet, rren, kur premton diçka, nuk e realizon, e kur hasmohet** (përlahet), **e kalon kufirin"**.

Kështu e transmeton (këtë hadith) edhe Shu'bja nga A'meshi.[29]

باب قيامُ ليلةِ القَدْرِ مِنَ الإيمانِ

٣٥ - حدثنا أبو اليمانِ قال أخبرَنا شُعَيبٌ قال حدثنا أبو الزِّنادِ عن الأعرَجِ عنْ أبي هُرَيرةَ قال : قال رسولُ اللهِ ﷺ « مَنْ يَقُمْ ليلةَ القَدْرِ إيماناً واحْتِساباً غُفِرَ لهُ ما تَقدَّمَ مِنْ ذَنْبِه »

Të bësh ibadet në Natën e Kadrit (Lejle-i Kadr) është pjesë e besimit

35. Na ka treguar Ebu-l-jemani, këtë e kishte njoftuar Shu'ajbi, këtë Ebu-z-Zinadi, këtë A'rexhi, e këtë Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

---

29 Hadithi i lartshënuar vë në dukje pasojat e dëmshme të të metave (të veseve). Njeriu me shprehi të këqija është i afërt me dyfytyrëshin, për të cilin dijetarët islamë thonë se nuk i përket shoqërisë islame dhe se vendi i tij është në Xhehennem.

Disa dijetarë islamë konsiderojnë se ky hadith vë në dukje në mënyrë të qartë pasojat e veseve të përmendura, sidomos, nëse janë pjesë të pandashme të besimtarit. Në këtë rast ata do të ishin në radhët e dyfytyrëshit dhe si të tillë nuk mund të jenë në radhët e shoqërisë islame. Njerëzit e dhënë pas këtyre veseve janë të barabartë me munafikët. Duke patur parasysh pasojat që sjellin veset e tilla, ato duhet të flaken gjithsesi.

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"Kush e kalon Natën e Kadrit, duke bërë ibadet dhe duke llogaritur (vetëm në shpërblimin e All-llahut), **do t'i falen gabimet e bëra më parë** (ndaj All-llahut)".[30]

باب الجهاد من الإيمان

٣٦ – حدثنا حريز بن حفص قال حدثنا عبد الواحد قال حدثنا عمارة قال حدثنا أبو زرعة بن عمرو بن جرير قال: سمعت أبا هريرة عن النبي ﷺ قال «انتدب الله لمن خرج في سبيله – لا يخرجه إلا إيمان بي وتصديق برسلي – أن أرجعه بما نال من أجر أو غنيمة، أو أدخله الجنة. ولولا أن أشق على أمتي ما قعدت خلف سرية، ولوددت أني أقتل في سبيل الله ثم أحيا، ثم أقتل ثم أحيا، ثم أقتل»

Lufta në rrugën e All-llahut është pjesë e besimit

36. Na ka treguar Haremî b. Hafsi, këtë e ka njoftuar Abdu-l-Vahidi, këtë Umarja, këtë Ebu Zur'a b. Amr b. Xheriri, i cili ka thënë se ka dëgjuar nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. duke thënë:

"All-llahu me kënaqësi do t'ia plotësojë dëshirën atij që niset (në luftë) **në emër të All-llahut: Atë e ka shtyrë të niset për në luftë vetëm duke më besuar Mua dhe Pejgamberët e Mi - se nuk do ta kthej në shtëpi pa dhuratë, ose pasuri lufte të cilën e ka merituar, ose do ta fus në**

30 Pas prezentimit të veprave të cilat janë pjesë përbërëse të besimit islam, vijojnë pjesët të cilat flasin për disa vese të personave të cilat janë rezultat i moralit të dobët, besimit të mangët dhe rezultat i kryerjes së detyrave islame në mënyrë jo të sinqertë.

Në kuadër të temave të prezentuara për besimin (imanin), Buhariu u kthehet disa karakteristikave pozitive të besimtarit, si: ibadetit në Natën e Kadrit, punës dhe angazhimit në rrugën e All-llahut, agjërimit të Ramazanit etj., duke theksuar se ato janë degë të besimit islam dhe pjesë përbërëse të Fesë islame.

Nata "Lejletu-l-Kadr" e ka marrë këtë emër, sepse në të merren vendime për të gjitha ndodhitë, dukuritë dhe ndërrimet në këtë botë; për shkak të vlerës së madhe te All-llahu xh.sh. dhe popullaritetit të saj te muslimanët, sepse në këtë natë filloi shpallja e Kur'anit famëlartë; për shkak se çdo vepër fetare që bëhet në këtë natë, te All-llahu xh.sh. është më e vlefshme se në netët e tjera dhe për shkak se çfarëdo vepre të mirë që bëjnë njerëzit në këtë natë, te All-llahu xh.sh. kanë vlerë më të madhe dhe u takojnë një shkalle më të lartë sesa kur i bëjnë ato në ndonjë kohë tjetër.

Xhennet. Dhe, po të mos i ngarkoja pasardhësit e mi me vështirësi nuk do të ndalesha nga asnjë front dhe do të doja të vdes në rrugën e All-llahut, pastaj të jetoj një kohë e të vdes, e pastaj përsëri të jetoj një kohë e të vdes".[31]

باب تَطَوُّعُ قِيامِ رَمَضانَ مِنَ الإيمان

٣٧ – حدثنا إسماعيلُ قال حدثني مالكٌ عن ابن شهابٍ عن حُمَيدِ بنِ عبدِ الرَّحمٰنِ عن أبي هُرَيرةَ أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ قال « مَنْ قامَ رَمَضانَ إيماناً واحْتِساباً غُفِرَ لهُ ما تَقدَّم مِنْ ذَنْبِه »

Gjallërimi i muajit të Ramazanit është pjesë e besimit

37. Na ka treguar Ismaili, këtë e kishte njoftuar Maliku, këtë Ibni Shihabi, këtë Humejd b. Abdu-r-Rahmani, këtë Ebu Hurejre se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Kush e kalon muajin e Ramazanit në ibadet për shkak besimi (duke e besuar All-llahun) **dhe duke llogaritur vetëm në shpërblimin e Tij, do t'i falen gabimet e mëparshme** (ndaj All-llahut)".[32]

---

31 Nga përmbajtja e hadithit kuptohet:
- domosdoshmëria e angazhimit për ardhshmërinë e fesë së drejtë dhe gatishmëria për të sakrifikuar për një ardhmëri më të mirë dhe më të qetë.
- brengosja e Muhammedit a.s. për muslimanët, duke i ruajtur ata nga detyrat që janë jashtë mundësive të tyre;
- nga detyrat e shumta, duhet të kryhen gjithnjë ato që janë më parësore dhe për shoqërinë më të dobishme;
- domosdoshmëria e largimit të shprehive të këqija, nga njëra anë dhe, udhëzimi për të bërë vepra të mira, nga ana tjetër;
- *lufta kundër armikut që paraqet rrezik për bashkësinë. Shpirti i personit, i cili është* sakrifikuar për përparimin e bashkësisë, hyn në begatitë e Xhennetit dhe jetën në varr e kalon në kënaqësi të plotë, ashtu siç thuhet në Kur'anin famëlartë: "Ata do të jenë të gjallë te All-llahu edhe më tutje dhe do të jenë të furnizuar". Ata do të jenë të gjallë edhe në kujtesën e popullit të vet.

Disa dijetarë islamë mendojnë se me hadithin e lartshënuar aludohet në hyrjen në Xhennet, menjëherë pas dhënies shprit në fushëbetejë, përkatësisht do të jenë në mesin e personave të parë që do të hyjnë në Xhennet. Këta do të hyjnë në Xhennet pa dhënë llogari për veprat e tyre të kësaj bote.

32 Ky hadith ka kuptim deri-diku më të përgjithshëm se ai i mëparshmi. Flet përgjithësisht

بابُ صَوْمُ رَمَضانَ احْتِساباً مِنَ الإيمان

٣٨ – حدثنا ابنُ سَلامٍ قال أخبرَنا محمدُ بنُ فُضَيلٍ قال حدثنا يحيى بنُ سَعيدٍ عن أبي سَلَمَةَ عن أبي هُرَيرةَ قال: قال رسولُ اللهِ ﷺ «مَنْ صامَ رَمَضانَ إيمانا واحْتِسابا غُفِرَ لَهُ ما تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِه»

Agjërimi i Ramazanit për shkak besimi (imani) dhe llogaritja (në shpërblimin e All-llahut) është pjesë e besimit

38. Na ka treguar Ibni Selami, këtë e kishte njoftuar Muhammed b. Fudajli, këtij i ka treguar Jahja b. Se'idi, ky nga Ebu Seleme, ky nga Ebu Hurejre i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"**Kush e agjëron muajin e Ramazanit, duke besuar dhe duke llogaritur** (vetëm në shpërblimin e All-llahut), **do t'i falen gabimet e bëra më parë** (ndaj All-llahut)".[33]

بابُ الدِّينُ يُسْر، وقولُ النبيِّ ﷺ «أحبُّ الدِّينِ إلى اللهِ الحَنِيفِيَّةُ السَّمْحة»

٣٩ – حدثنا عبدُ السَّلامِ بنُ مُطَهِّرٍ قال حدثنا عُمَرُ بنُ عَلِيٍّ عن مَعْنِ بنِ محمدٍ الغِفارِيِّ عن سَعيدِ بنِ أبي سَعيدٍ المَقْبُرِيِّ عن أبي هُرَيرةَ عنِ النبيِّ ﷺ قال «إنَّ الدِّينَ يُسْرٌ، وَلَنْ يُشادَّ الدِّينَ أحَدٌ إلاَّ غَلَبَه، فَسَدِّدوا وقارِبوا، وأبْشِروا، واسْتَعِينوا بالغَدْوَةِ والرَّوْحَةِ وشيءٍ مِنَ الدُّلْجَة»

---

për faljen e gabimeve, por dijetarët islamë mbajnë qëndrimin se kjo ka të bëjë vetëm me gabimet e vogla ndaj All-llahut xh.sh. Cënimin e te drejtës së tjetrit All-llahu xh.sh. nuk e fal. Për këtë shkeljesh duhet kërkuar falje drejtpërdrejt nga i dëmtuari.

Për thënien "kush e kalon Ramazanin me ibadet..." shumë dijetarë islamë mendojnë se fjala është për personin i cili e fal namazin e taravisë, e disa thonë se kush fal çfarëdo namazi qoftë, në cilëndo kohë qoftë të Ramazanit (ditën ose natën), qoftë me xhemat, qoftë personalisht.

33 Hadithi i sipërpërmendur e vë theksin në agjërimin e tërësishëm të muajit të Ramazanit. Personat e sëmurë, të cilët kanë dëshirë të agjërojnë, por për shkak të sëmundjes, ose për arsye të tjera nuk kanë agjëruar, janë të falur, me kusht që pasi të shërohen ta agjërojnë. Këta persona janë të njëjtë me ata që, për shkak të shëndetit të tyre të ligë, namazin e falin prej ulur, e që shpërblehen njësoj si ata që falen në mënyrë të rëndomtë.

Me shprehjet "duke besuar në All-llahun dhe duke llogaritur vetëm në shpërblimin e Tij..." (mendohet) në lidhjen e ngushtë të besimit me agjërimin, sepse agjërimi sipërfaqësor dhe sa për sy e faqe nuk është i vlefshëm.

Feja është e lehtë

Pejgamberi s.a.v.s. është shprehur në këtë mënyrë:

"Feja më e dashur te All-llahu është ajo që mësohet lehtë"[34]

39. Na ka treguar Abdu-s-Selam b. Mutahhari, ky nga Umer b. Aliu, ky nga Ma'n b. Muhammed el-Xhifariu, ky nga Se'id b. Ebu Se'id el-Makburiu, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Feja Islame është fe e lehtë. Në këtë fe asnjë nuk duhet të përpiqet tepër, e që nuk do të ngadhnjejë në të. Bëhuni të matur dhe mos e teproni. Gëzohuni dhe kërkoni ndihmën e All-llahut xh.sh. në mëngjes, në mbrëmje dhe pak para natës!"[35]

---

34 Titulli i kësaj pjese vë në dukje Islamin si fe të lehtësimeve të shumta. Kështu, për shembull, i sëmuri, në vend në këmbë, mund të falet ulur ose shtrirë; në mungesë të ujit për të marrë abdest, ose për t'u pastruar (për gusël) mund të shërbehet me tejemmum (me dhé të pastër); kush nuk është i aftë të shkojë në haxhillëk, mund të çojë bedel (zëvendës); udhëtari mund ta prishë agjërimin në Ramazan dhe ta plotësojë kur të kthehet në shtëpi, për aq sa e ka prishur, d.m.th. ditë për ditë; agjërimin e prish edhe i sëmuri, i cili do ta plotësojë kur të shërohet; plaku i shtyrë në moshë, dhe i rraskapitur, ndërkaq, për ta plotësuar agjërimin, jep pasuri (blerje) për çdo ditë të prishur në shumën e sadaka-i fitrit.
Me titullin e lartpërmendur të kësaj pjese, mbase, dëshirohet të theksohet renomeja në Islam që nuk ka qenë e njohur për fetë e tjera, në të cilat lutja ka mundur të bëhet vetëm në mënyrë kolektive dhe në vendet e caktuara (vetëm në faltore); pastrimi fetar nuk ka mundur të bëhet duke u fërkuar në tokë (fjala është për tejemmum); pjesa e teshës së ndyer me nevojën e madhe të njeriut nuk ka mundur të lahet me ujë, por duhej të pritej dhe të hidhet. Ndërkaq, pendimi ka qenë i vlefshëm vetëm me aktin e vetëvrasjes. Nga këto dhe vështirësi të ngjashme All-llahu xh.sh. i liroi muslimanët, sikurse thuhet në Kur'an: "All-llahu nuk iu ka lënë në fe asnjë vështirësi...".
Thënia e Muhammedit a.s. tregon se nga të gjitha Shpalljet, te All-llahu xh.sh. fe më e dashur është Islami, feja e lehtësisë dhe e tolerancës dhe vepra më të dashura te All-llahu janë ato që besimtari i kryen lehtë, pa mundim dhe pa vështirësi.

35 Ky hadith vë në pah nevojën e maturisë dhe arsyes për çdo punë, prandaj edhe në lutje. Ngarkesa e tepërt nuk sjell dobi, por, përkundrazi sjell lodhje dhe plogështi, e që njeriu më vonë nuk do të jetë në gjendje t'i kryej edhe detyrat themelore fetare (por jo vetëm fetare).
Hatabiu thotë se hadithi në fjalë ndalon faljen e namazit ditë e natë dhe urdhëron faljen e namazeve të detyrueshme në mënyrë të matur, që njeriut do t'i japin zemër, do t'i japin fuqi dhe vrull për punë në fusha të ndryshme njerëzore.

بابُ الصَّلاةُ مِنَ الإيمانِ ، وقولُ اللهِ تعالى ﴿ وما كانَ اللهُ لِيُضيعَ إيمانَكم ﴾ يعني صلاتَكم عندَ البيتِ

٤٠ - حدثنا عَمرُو بنُ خالدٍ قال حدثنا زُهَيرٌ قال حدثنا أبو إسحاقَ عنِ البَراءِ أنَّ النبيَّ ﷺ كانَ أوَّلَ ما قَدِمَ المَدينةَ نَزَلَ عَلَى أجدادِهِ - أو قال أخوالِهِ - مِنَ الأنصارِ ، وأنَّه صَلَّى قِبَلَ بَيتِ المَقدِسِ سِتَّةَ عَشَرَ شَهراً ، أو سَبعةَ عَشَرَ شهراً ، وكانَ يُعجِبُهُ أنْ تَكونَ قِبلَتُه قِبَلَ البَيتِ ، وأنَّه صَلَّى أوَّلَ صَلاةٍ صَلَّاها صَلاةَ العَصرِ ، وصَلَّى معَهُ قَومٌ ، فَخَرَجَ رَجُلٌ مِمَّنْ صَلَّى معَهُ فَمَرَّ عَلَى أهلِ مَسجِدٍ وَهُم راكِعونَ فقال : أشهَدُ باللهِ لَقَدْ صَلَّيتُ معَ رسولِ اللهِ ﷺ قِبَلَ مَكَّةَ ، فَدارُوا - كما هُم - قِبَلَ البَيتِ . وكانتِ اليَهودُ قَدْ أعجَبَهُم إذْ كانَ يُصَلِّي قِبَلَ بَيتِ المَقدِسِ ، وأهلُ الكِتابِ ، فلمَّا وَلَّى وَجْهَهُ قِبَلَ البيتِ أنكَرُوا ذلكَ

قال زُهَيرٌ حدثنا أبو إسحاقَ عنِ البَراءِ في حَديثِهِ هذا أنَّه ماتَ عَلَى القِبلةِ قَبلَ أنْ تُحوَّلَ رِجالٌ وَقُتِلوا ، فلم نَدْرِ ما نَقولُ فيهم ، فأنزَلَ اللهُ تعالى ﴿ وما كانَ اللهُ لِيُضيعَ إيمانَكُم ﴾

Namazi është pjesë përbërëse e besimit (imanit)

All-llahu i Madhërueshëm (në Kur'an) thotë:

"All-llahu nuk do të lejojë të humbet besimi juaj..." d.m.th. "...namazi juaj... (që është bërë duke u kthyer kah Bejtu-l-Mukaddesi)".

(el-Bekare, 143).

40. Na ka treguar Amr b. Halidi, këtë e kishte njoftuar Zuhejri, këtë Ebu Is-haku, duke transmetuar nga Berai:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. erdhi në Medine, së pari qëndroi te gjyshërit ose te dajallarët e tij Ensarë, siç thotë Ebu Is-haku, dhe gjashtëmbëdhjetë ose shtatëmbëdhjetë muaj e fali namazin duke u drejtuar kah Bejtu-l-Mukaddesi (në Jerusalem), **por duke dëshiruar gjithnjë që Kiblja të jetë kah Qabja. Namazi i parë që e fali, duke u drejtuar kah Qabja ishte namazi i iqindisë. Me të u falen disa njerëz. Njëri nga ata që faleshin**

Hadithi tërheq vëmendjen në kujdesin që duhet të ketë njeriu edhe ndaj vetvetes. Nuk është e pëlqyeshme që të ngarkohet njeriu deri në rraskapitje. Duhet mbajtur një qëndrim mesatar për çdo punë, pra edhe në manifestimet fetare. Ata janë namaze të detyrueshme dhe, nëse kryehen në mënyrë të sinqertë në emër të All-llahut xh.sh., do ta ushqejnë shpirtin e besimtarit dhe do ta bëjnë të lumtur dhe të dobishëm për bashkësinë.

me të, doli dhe kaloi pranë një xhamie. Derisa ata ishin duke u falur, ishin në ruqu, bërtiti: "Betohem në All-llahun, tash jam falur me Pejgamberin s.a.v.s. i kthyer kah Mekka".

Atëherë edhe këta, pa e prishur namazin, u kthyen kah Qabja, sikur edhe ata më parë. Hebrenjtë dhe ithtarët e tjerë të Librit u entuziazmuan pse ata u kthyen kah Bejtu-l-Mukaddesi, e kur me fytyrë u kthyen kah Qabja, nuk e pëlqyen këtë.

Zuhejri ka thënë:

Na ka treguar Ebu Is-haku, e ky nga Berai, i cili në fjalimin e tij ka thënë edhe këtë:

"Para se të ndryshojë Kiblja (i pari) **që është kthyer kah ajo** (Kiblja) **ka vdekur** (duke falur namazin). **Kishte edhe disa që ishin vrarë. Nuk kemi ditur ç'të themi për ata.**

Pastaj All-llahu i Madhëruesheëm ka shpallur këtë ajet të Kur'anit:

*"... E, se, **All-llahu nuk ua humb besimin tuaj** (namazin, që keni falë më parë kah Bejtu-l-Mukaddesi)...".*[36]

(el-Bekare, 143)

---

36 Në bazë të këtij hadithi, Buhariu thekson se falja e namazit është pjesë e pandashme dhe përbërëse e besimit islam.

Muhammedi a.s. arriti në Medine më 12 rebiu-l-evvel, ditë e hënë, mu në pikë të vapës. Ibni Abbasi tregon se Pejgamberi a.s. u nis nga Mekka ditën e hënë, e në Medine, respektivisht në Kubâ arriti ditën e hënë (të dytën) gjithashtu. Sipas kësaj, udhëtimi i tij zgjati 15 ditë, duke i llogaritur edhe tri ditët që i kaloi me Ebu Bekrin në shpellën Thevr. Muhammedi a.s. nuk ka shkuar rrugës kryesore, por kah një rrugë qorre rreth bregdetit, e cila ishte shumë më e gjatë se rruga kryesore. Më 8 të muajit rebiu-l-evvel, 13 vjet të pejgamberisë së tij, arriti në lagjen e quajtur Kubâ, tre mila larg Medines. Katër ditët e para: të hënën, të martën të mërkurën dhe të enjten banoi te Beni Amr b. Avfi. Këtu u ngrit një mesxhid, në ndërtimin e të cilit mori pjesë edhe Pejgamberi a.s. Ditën e xhuma (të premten) u nis për në Medine dhe në lagjen Beni Seleme e fali namazni e xhumasë. Pas dite doli nëpër Medine, duke qëndruar paksa para shtëpive të disa medinasve dhe para shtëpive të të afërmve të vet nga nëna, e pastaj, banoi nja shtatë muaj te shtëpia e Ebu Ejjub Ensariut.

Jo larg shtëpisë së Ebu Ejjubit iu dha një truall dhe së bashku me muslimanët e ngriti xhaminë, minberin e së cilës e ktheu kah Bejtu-l-Mukaddesi. Pranë xhamisë ndërtoi edhe dhoma për vete dhe për familjen e vet. Ndërsa banonte te Ebu Ejjub Ensariu, e dërgoi Zejdin dhe Ebu Nafiun, robër të tij të liruar, për në Mekke, të cilët ia sollën vajzat: Fatimen

dhe Ummu Gulthumen dhe bashkëshortet: Sevdën dhe Aishen. Me dëshirën e All-llahut xh.sh., Qabja pas 16 muajsh u bë Kible, që Muhammedi a.s. kaherë lakmonte. Mihrabin e xhamisë së vet, Muhammedi a.s. menjëherë e ktheu në drejtim të Mekkes, ndërsa në vend të mihrabit të vjetër e ndërtoi derën.

Leja për të kthyer Kiblen në drejtim të Qabes i erdhi në muajin rexheb në vitin 2 hixhri, kur Muhammedi a.s. ka qenë në reqatin e tretë të namazit të iqindisë, në të cilin ai menjëherë u kthye kah Qabja. Namazi i parë që u fal në drejtim të Qabes është pra namazi i iqindisë, të cilin ishte duke e falur edhe Ubbad b. Nehiku (ose Ubad b. Bishri). Meqë nuk e dinin këtë ndërrim, muslimanët e tjerë ende faleshin të kthyer kah Bejtu-l-Mukaddesi në Jerusalem. Këtë e bënë banorët e lagjes Beni Seleme të cilët në namazin e iqendisë kanë qëndruar diçka më gjatë, ashtu që Ubbadi, i cili u përmend më lart, ua tërhoqi vërejtjen për domosdonë e kthyerjes kah Mekka dhe ata, menjëherë, duke u falur, u kthyen kah Qabja.

Në një hadith të transmetuar nga Bukejr b. Eshexhi, Ebu Davudi thekson se në momentin e ndërrimit të Kibles në Medine kishte 9 xhami, duke e numëruar edhe atë të Muhammedit a.s. dhe në të gjitha është falur dhe është thirrë ezani, pikërisht kur është dëgjuar zëri i ezanit të Bilal Habeshiut, muezinit të xhamisë së Muhammedit a.s.

Nga hadithi mund të përfundohet:

- derogimi (zëvendësimi) i normave juridike të mëhershme me të rejat më të përshtatshme. Normat e ajetit të mëparshëm mund të derogohet me normën e ajetit të mëvonshëm; kurse norma e hadithit me hadithin e mëvonshëm ose me Kur'an. Fahrudin Raziu thotë se Imam Shafiu dhe shumica e dijetarëve tanë, e sipas një versioni edhe Imam Ahmedi, nuk lejojnë derogimin e hadithit mutevatir me ajetin e Kur'anit. Megjithatë, pjesa dërmuese e dijetarëve, Imam Maliku dhe Ebu Hanife kanë mendim krejtësisht të kundërt. Kjo lagje dijetarësh mbajnë qëndrimin se falja e namazit duke u kthyer kah Bejtu-l-Mukaddesi nuk është caktuar me Kur'an. Ky është fakt i hadithit mutevatir, por Kiblja, megjithatë, është ndërruar me ajetin: "... dhe kudo që të gjendeni, ktheni fytyrat tuaja nga ajo anë...!" (el-Bekare, 144).

Dijetarët e drejtimit Shafiit mendojnë se këtu bëhet fjalë për zëvendësimin e rregullave të përgjithshme të mëparme të Kur'anit me normat e përcaktuara të mëvonshme dhe se ajo normë e mëhershme e Kur'anit përbëhej nga ajo që është lënë në dëshirën e falësit të kthehet andej kah dëshiron vetë, e që në mënyrë të qartë merret vesh nga ajeti i Kur'anit i cili është shpallur më herët: "Nga cila do anë që të ktheheni, andej është fytyra e Zotit tuaj...".

Hanefitë mendojnë se praktika e ngulitur dhe normat e mëparshme mund të ndryshohen edhe me arsyetimin e një personi të sigurtë, siç qe rasti i muslimanëve të xhamisë Beni Seleme në Medine. Derogimi ka ekzistuar edhe më herët, prej Ademit a.s. deri te Muhammedi a.s.

- përdorimi i normave të mëparshme është i vlefshëm përderisa nuk zëvendësohen me të rejat;

- falësi mendon dhe gjykon vetë për anën e Kibles. Nëse falësi merr qëndrim të ri për

بَابُ حُسْنُ إِسْلامِ الْمَرْءِ

٤١ – قال مالِكٌ أَخبَرَنِي زَيدُ بنُ أَسْلَمَ أَنَّ عَطاءَ بنَ يَسارٍ أَخبَرَهُ أَنَّ أَبا سَعِيدٍ الْخُدْرِيَّ أَخبَرَهُ أَنَّهُ سَمِعَ رَسولَ اللهِ ﷺ يَقول « إِذا أَسلَمَ الْعَبْدُ فَحَسُنَ إِسلامُهُ يُكَفِّرُ اللهُ عنه كُلَّ سَيِّئَةٍ كان زَلَفَها ، وكان بعدَ ذٰلكَ القِصاصُ : الْحَسَنَةُ بِعَشْرِ أَمْثالِها إِلى سَبْعِمِائَةِ ضِعْفٍ ، والسَّيِّئَةُ بِمِثْلِها ، إِلاَّ أَنْ يَتَجاوَزَ اللهُ عنها »

Mirësia e Islamit ndaj njeriut

41. Maliku ka thënë se e ka njoftuar Zejd b. Eslemi, këtë A'ta b. Jesari, këtë e ka njoftuar Ebu Se'id el-Hudriu, i cili ka thënë se e ka dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s., duke thënë:

"Kur njeriu e pranon Islamin dhe kur detyrimin islam e kryen në mënyrë të sinqertë, All-llahu xh.sh. do t'ia falë (ia mbulon) **të gjitha veprat e këqija të cilat i ka punuar, e pastaj do ta shpërblejë me shpërblimin përkatës. Veprat e mira shpërblehen me dhjeta shpërblime, bile edhe deri më shtatëqind herë, kurse vepra e keqe dënohet vetëm aq sa i përgjigjet, po qe se All-llahu edhe atë nuk e fal".**

---

anën e Kibles gjatë namazit, ktheht në atë anë, duke e vazhduar pjesën tjetër të namazit (*pa e prishur namazin*), por kjo vlen për raste kur nuk e dinë anën e Kiblës;

- falja e namazit, i kthyer kah Qabja, është një nga kushtet themelore të namazit;
- namazi i falur më parë, pa u kthyer kah Qabja, nuk duhet të falet rishtas, sepse këtë nuk e kanë bërë as banorët e Kubâsë, të cilët, namazin e iqindisë, të akshamit dhe të jacisë, i kanë falur duke qenë të kthyer kah Kiblja e mëparme (ndonëse Kiblja është ndërruar në namazni e iqindisë). Ata qenë kthyer kah Qabja, pikërisht të nesërmen, në namazin e sabahut, kur tashmë u njoftuan se Qabja është Kiblja e muslimanëve;
- është e lejueshme dëshira e zjarrtë për normat e reja, të cilat do të jenë të dobishme për shoqërinë, por të jenë të mbështetura në burimet e Sheriatit;
- fama e lartë e personalitetit të Muhammedit a.s. te All-llahu xh.sh. që ia plotësoi atë dëshirë të cilën me shpirt e ka dashtë;
- brenga dhe përpjekja e muslimanëve në mbrojtjen dhe në zbatimin këmbëngulës të normave fetare-islame.

٤٢ — حدثنا إسحٰقُ بنُ مَنصورٍ قال حدثنا عبدُ الرَّزّاقِ قال أخبرَنا مَعْمَرٌ عنْ هَمّامٍ عنْ أبي هُرَيرةَ قال : قال رسولُ اللهِ ﷺ « إذا أحسَنَ أحَدُكُم إسلامَهُ فكلُّ حَسَنةٍ يَعْمَلُها تُكْتَبُ لهُ بعَشْرِ أمثالِها إلى سَبْعِمِائةِ ضِعْفٍ ، وكلُّ سَيِّئةٍ يَعْمَلُها تُكْتَبُ لهُ بِمِثْلِها »

42. Na ka treguar Is-hak b. Mensuri, këtij i kishte treguar Abdu-r-Rezaku, këtij Ma'meri, ky nga Hemmami, ky nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"Kur ndonjë nga ju i kryen detyrat e veta islame në mënyrë të drejtë, çdo vepër e mirë të cilën e kryen, shënohet me dhjeta (dhjetëfishohet), **bile deri në shtatëqindfish, dhe çdo punë e keqe që e ka bërë i shënohet aq sa ka bërë".**[37]

37 Falja e namazit në mënyrë të vazhdueshme, bashkë me detyrimet (farzat) e tjera fetare e përtërijnë shpirtërisht njeriun dhe te ai formohet besimi i fortë dhe i përkryer, i cili e ngre mbi ëndjen materiale. Personi që i është përkushtuar Islamit bën mirësi në çdo hap. All-llahut xh.sh., ndërkaq, i lutet sikur e sheh Atë.

Përmbajtja e hadithit është në pajtueshmëri të plotë me ajetin: "Kush punon vepër të mirë, do të shpërblehet dhejtëfish. Kush punon vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas mëkatit (gjynahut) dhe, atyre nuk do t'u bëhet kurrfarë padrejtësie". (el-en'âm, 160).

Në ajetin tjetër është theksuar se shpërblimi për veprën e mirë, mund të jetë edhe për shtatëqind herë më i madh. Shpërblimi i precizuar deri në dhjetë, gjegjësisht deri në shtatëqind herë për veprën e mirë, tregon për mëshirën e pakufishme të All-llahut xh.sh. ndaj besimtarëve dhe për shpërblimin e veprave të mira, i cili do të jetë shumë më i madh. Disa dijetarë islamë, këto ajete i kutpojnë fjalë për fjalë dhe mendojnë se ai shpërblim, me të vërtetë, do të jetë në masën e theksuar.

Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- nuk është i drejtë mendimi i Harixhive dhe bashkëmendimtarëve të tyre se gabimet e nxjerrin besimtarin nga Islami dhe se gjynahqari do të qëndrojë në Xhehennem gjithnjë;
- All-llahu nuk është i detyruar t'ua falë gabimet njerëzve. Nëse ua fal, kjo lidhet ngushtë me Dëshirën dhe Mëshirën e Tij. E dënon atë që do, dhe e fal atë që do;
- gjynahqari nuk do të dënohet domsodo për gabimet e tij, sepse ajo varet nga dëshira e All-llahut xh.sh.;
- hidhet poshtë mendimi i atyre që mohojnë mundësinë e forcimit, përkatësisht, të dobësimit të besimit.

بابٌ أَحَبُّ الدِّينِ إِلَى اللهِ أَدْوَمُه

٤٣ - حدثنا محمدُ بنُ المُثَنَّى حدثنا يحيى عنْ هِشامٍ قال أخبرَني أبي عنْ عائشةَ أنَّ النبيَّ ﷺ دَخَلَ عليها وعِنْدَها امرأةٌ . قال : مَنْ هٰذِهِ ؟ قالت : فُلانةُ - تَذْكُرِ مِنْ صَلاتِها - قال « مَهْ ، عليكم بما تُطِيقون ، فواللهِ لا يَمَلُّ اللهُ حتَّى تَمَلُّوا » . وكانَ أَحَبَّ الدِّينِ إليه ما دامَ عليه صاحِبُه

Vepra më e dashur te All-llahu xh.sh. është ajo që bëhet vazhdimisht në emër të Tij

43. Na ka treguar Muhammed b. Muthennai, ky nga Jahjai, ky nga Hishami, i cili ka thënë: Më ka njoftuar babai im, këtë Aishja se me të vërtetë Pejgamberi s.a.v.s. ka hyrë te ajo (te Aishja), kur aty kishte qëlluar një grua. Dhe pyeti:

"Kush është kjo?"

"Është filania", tha Aishja. Tregon diçka rreth namazit të saj.

"Lërini (këto fjalë), (gjithnjë) **bëni ato punë që u shkojnë për dore". Për Zotin! All-llahu nuk mërzitet** (nuk brengoset) **përderisa ju nuk brengoseni** (për punën tuaj), **tha Pejgamberi s.a.v.s. Te Ai vepra më e dashur është ajo që njeriu vazhdimisht e bën në emër të Tij".**[38]

---

38 Kjo pjesë ka lidhje logjike me pjesën paraprake. Dashuria dhe ndjenja ndaj All-llahut xh.sh. vërehet në kryerjen e namazit me rregull, në mënyrë të vazhdueshme, me punën e vazhdueshme të veprave të mira dhe me largimin e veseve.

Hadithi i sipërpërmendur shpreh vlerën e punës së vazhdueshme dhe maturinë e domosdoshme, po qoftë edhe në namaz. Hazreti Aishja e pat lavduar Havlen nga fisi Esed, si grua më fetare e Medines, e cila tërë natën e kalonte duke u lutur, kurse Muhammedi a.s. tha se vepra më e mirë është ajo që njeriu mund ta kryejë në mënyrë të vazhdueshme, ashtu siç është paraparë. Vepra e vazhdueshme dhe e matur është ideal i njerëzve të mençur.

Nga hadithi mund të përfundohet:

- është e lejueshme të përdoren fjalët me kuptim alegorik, si p.sh. "All-llahu nuk do të mërzitet nga të dhënët shpërblim..."

- lejohet betimi i rastësishëm. Ky betim nuk çmohet si i qortuar, nëse me të arrihen të bëhen vepra të mira dhe të dobishme, e të frenon nga punët e dëmshme e të ndaluara;

- bën të ditur vlerën e madhe të vazhdimësisë në punë dhe nxit durim në çdo aktivitet njerëzor. Punët e imta dhe të vogla (të dobishme), të cilat kryhen rregullisht dhe në vazhdimësi, janë më të vlefshme se veprat e mëdha, që kryhen me ndërprerje të gjatë

بابٌ زِيادَةِ الإيمانِ وَنُقصانِهِ ، وقولِ اللهِ تعالى ﴿ وزِدْناهُمْ هُدًى ـ ويزدادَ الذينَ آمَنوا إيمانًا ﴾ وقال ﴿ اليومَ أكملتُ لكم دِينَكُمْ ﴾ فإذا تَرَكَ شيئًا من الكمالِ فهوَ ناقِصٌ

٤٤ — حدثنا مسلمُ بن إبراهيمَ قال حدثنا هِشامٌ قال حدثنا قَتادةُ عنْ أنسٍ عنِ النبيِّ ﷺ قال « يَخرُجُ مِنَ النارِ مَنْ قال لا إلهَ إلاّ اللهُ وفي قَلبِهِ وَزْنُ شَعيرةٍ مِن خَيرٍ . وَيَخرُجُ منَ النارِ مَنْ قال لا إلهَ إلاّ اللهُ وفي قَلبِهِ وزنُ بُرَّةٍ مِنْ خَيرٍ ، ويَخرُجُ مَنَ النارِ منْ قال لا إلهَ إلاّ اللهُ وفي قَلبِهِ وَزْنُ ذَرَّةٍ مِنْ خَيرٍ »

قال أبو عبدِ اللهِ : قال أبانُ حَدَّثنا قَتادةُ حدثنا أنَسٌ عنِ النبيِّ ﷺ « مِنْ إيمانٍ » مَكانَ « مِنْ خَيرٍ »

Të forcuarit dhe të dobësuarit e besimit

All-llahu i Madhëruesh ëm thotë:

"... dhe Ne ua kemi forcuar atyre bindjen (imanin)".
(el-Kehf, 13).

"... dhe t'u shtohet besimi (imani) atyre që besojnë...".
(el-Muddeththir, 31).

"...Sot ua përsosa dispozitat e fesë suaj...".
(el-Mâide, 3).

Nëse diçka lihet anash nga ajo përsosje, atëherë do të ketë mangësi në të (thotë Buhariu).

44. Na ka treguar Muslim b. Ibrahimi, këtij i kishte treguar Hishami, këtij Katade, ky nga Enesi, i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

---

kohore. Falja e namazit të detyrueshëm për çdo ditë, kryerja e veprave të mira të thjeshta mund të jenë më të vlefshme se veprat e mëdha që bëhen kohëpaskohe. Lutja e rregullt dhe e matur te All-llahu xh.sh. është më e dashur se lutja ditë e natë në një periudhë të caktuar, pastaj të ndërpritet, të fillojë, e kështu me radhë;

- Pejgamberi a.s. i ka rekomanduar vetëm veprat e mira të cilat kryhen në kontinuitet. Puna e tepruar e rraskapit njeriun dhe e detyron shpejt ta lëshojë atë plotësisht ose pjesërisht, e me këtë të humb edhe shpërblimin përfundimtar. Ka ajete në të cilët vihet në dukje se All-llahu xh.sh. i qorton njerëzit të cilët ngarkohen tepër në kryerjen e veprave të mira për një afat të shkurtër, e pastaj i lëshojnë dhe në fund aspak nuk i përfillin;

- të kalosh tërë natën në lutje është më shumë e qortuar se e lavduar. Disa dijetarë thonë se këtu nuk ka dëm, po qe se nuk pengon faljen e namazit të sabahut në kohë.

"Do të dalë nga zjarri (Xhehennemi) **ai që dëshmon: "Nuk ka zot përveç All-llahut" dhe në zemrën e të cilit ka vepra të mira sa pesha e një kokërre të elbit. Do të dalë nga zjarri** (Xhehennemi) **ai që dëshmon: "Nuk ka zot përveç All-llahut" dhe në zemrën** (shpirtin) **e të cilit ka vepra të mira sa pesha e një kokërre të grurit. Do të dalë nga zjarri** (Xhehennemi) **ai i cili dëshmon: "Nuk ka zot përveç All-llahut" dhe në zemrën e të cilit ka vepra të mira sa pesha e një atomi".**

Ebu Abdullahu (Buhariu) transmeton se Ebani ka thënë, këtij i kishte thënë Katade, e këtij Enesi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: fjala **"të mira"**, përdoret me kuptim **"besim-iman"**.[39]

٤٥ – حدثنا الحسن بن الصباح سمع جعفر بن عون حدثنا أبو العميس أخبرنا قيس بن مسلم عن طارق بن شهاب عن عمر بن الخطاب أن رجلا من اليهود قال له : يا أمير المؤمنين ، آية في كتابكم تقرءونها لو علينا معشر اليهود نزلت لاتخذنا ذلك اليوم عيدا . قال : أي آية ؟ قال ﴿ اليوم أكملت لكم دينكم ، وأتممت عليكم نعمتي ، ورضيت لكم الإسلام دينا ﴾ قال عمر : قد عرفنا ذلك اليوم والمكان الذي نزلت فيه على النبي ﷺ : وهو قائم بعرفة ، يوم جمعة

---

39 Në pjesën paraprake u theksua qëndrimi i All-llahut xh.sh. ndaj atyre që kryejnë vepra të mira në vazhdimësi. Në këtë pjesë, ndërkaq, theksohet forcimi, respektivisht dobësimi i bindjes fetare. S'ka dyshim se me kryerjen e veprave të mira dhe fetare në vazhdimësi, forcohet dhe rritet besimi (imani), kurse në të kundërtën ai dobësohet dhe zvogëlohet. Këtë qëndrim Buhariu e argumenton me tre ajetet e sipërpërmendur. Dy ajetet e para flasin fjalë për fjalë për forcimin e besimit, ndërsa me të tretin, ngjashmërisht, kuptohet edhe dobësimi i besimit, nëse detyrat fetare të detyrueshme (farzet) nuk kryhen në mënyrë të vazhdueshme dhe me këmbëngulësi.

Fjalën "mirë" të përdorur në hadith, duhet marrë me kuptimin "besim" i gjithë asaj që i është shpallur Muhammedit a.s., pastaj të shprehurit dhe zbatimi praktik i detyrimeve (farzeve) fetare,

Nga hadithi mund të përfundohet.

- krahasimi i besimit me thelpinjtë e drithërave mendohet në shkallët e fuqisë së besimit; në forcimin, respektivisht në dobësimin e tij;
- të besuarit fshehurazi, pa u shprehur publikisht, nuk mjafton, por edhe të shperhurit publikisht, pa besim të sinqertë, nuk mjafton.

45. Na ka treguar Hasan b. Sabbahu se ka dëgjuar nga Xha'fer b. Avni, i cili ka thënë se i ka treguar Ebu-l-Umejsi, këtij ia transmeton Kajs b. Muslimi, këtij Tarik b. Shihabi, e ky nga Umer b. Hattabi r.a. se një hebre i ka thënë (Umerit):

"O kryetar i besimtarëve! Në Librin tuaj (në Kur'an) **ka një ajet të cilin ju e lexoni. Po të na ishte shpallur ai ajet neve, hebrenjve, ne atë ditë do ta shpallnim për ditë feste".**

Cili është ai ajet, e pyeti Umeri:

"...Sot ua përsosa dispozitat e fesë suaj dhe ua plotësova dhuntinë Time ndaj jush. Jam i kënaqur që Islami të jetë fe e juaja...".
(el-Mâide, 3)

u përgjigj ai.

"Ne, vërtet, e dimë edhe ditën edhe vendin që i qe shpallur Pejgamberit s.a.v.s., e ajo ishte dita e premte, derisa qëndronte në Arafat",[40] tha Umeri (b. Hattabi).

---

40 Përgjigja e Hazreti Umerit është shenjë e përpjekjes së tij në mbajtjen në mend dhe në ruajtjen e fjalës së All-llahut xh.sh.; paralajmërimi në përmbajtjen e rëndësishme të ajetit në fjalë, po edhe ndaj situatës në të cilën ndodhej Muhammedi a.s.
Neveviu deklaratën e Umerit e shpjegon: "Nuk e kemi lënë pas dore respektin e madhërisë së asaj dite, e as vendin në Arafat, ku është shpallur ajeti i sipërpërmendur, e vizita e këtij vendi bën pjesë në manifestimet kryesore të haxhillëkut".
Ajeti i lartpërmendur është shpallur në Arafat, ditën e premte, pas namazit të iqendisë. Ajo ishte ditë e manifestimit të dyfishtë e haxhillarëve të tubuar në Arafatë, ditë e manifestimit të së premtes, programi i së cilës u ndërlidh në plan-programin e përgjithshëm të manifesitmit të haxhillëkut. Respektimi i këtyre festave është i njohur edhe kur ato bien në të njëjtën ditë, kur edhe manifestimin e tyre e bëjmë me respekt të veçantë. Këtë manifestim të jashtëzakonshëm të haxhillëkut, disa e quajnë "Haxhxhu-l-ekber" - "Haxhi më i madh".
Ajeti në fjalë i është shpallur Muhammedit a.s. në vitin 10 hixhri, në Haxhxhin lamtumirës më 9 dhu-l-hixhxhe. Kjo është një ditë e caktuar për qëndrimin e lodhur të haxhillarëve në Arafat, ditë e përgatitjes së manifestimit të solemnitetit të Bajramit, në të cilin manifestim ndjenja fetare përjeton kulminacionin e vet. Haxhillarët, të entuziazmuar me përjetimet fetare jetojnë në disponimin festor tri-katër ditë, e pastaj, i kërkojnë falje njëri-tjetrit (marrin hallallëk) dhe nisen, secili për në vendin e vet. Në ditën e shpalljes për plotësimin e normave të Islamit, janë mobilizuar të gjitha fuqitë aktive të muslimanëve në manifestimin e besnikërisë së tyre ndaj atyre normave.

باب الزَّكاةُ مِنَ الإسلام ، وقولُه :

﴿ وما أُمِروا إلاّ ليَعْبُدوا اللهَ مُخْلِصينَ لهُ الدِّينَ حُنَفاء ، وَيُقيموا الصَّلاةَ وَيُؤْتوا الزَّكاةَ ، وَذٰلِكَ دِينُ القَيِّمة ﴾

٤٦ — حدّثنا إسماعيلُ قال حدّثني مالِكُ بنُ أنَسٍ عنْ عَمِّهِ أبي سُهَيلِ بن مالكٍ عنْ أبيهِ أنَّهُ سَمِعَ طَلْحَةَ بنَ عُبَيدِ اللهِ يقولُ : جاء رَجُلٌ إلى رسولِ اللهِ ﷺ مِنْ أهلِ نَجْدٍ ثائرُ الرأسِ يُسْمَعُ دَوِيُّ صَوتِهِ ولا يُفْقَهُ ما يقولُ ، حتىٰ دَنا ، فاذا هُوَ يَسْألُ عنِ الإسلام ، فقال رسولُ اللهِ ﷺ خَمسُ صَلَواتٍ في اليَومِ واللَيلةِ . فقال : هَلْ عَلَيَّ غَيرُها ؟ قال : لا . إلاّ أنْ تَطَوَّعَ . قال رسولُ اللهِ ﷺ : وَصِيامُ رَمَضانَ . قالَ : هلْ عَلَيَّ غَيرُهُ ؟ قال : لا ، إلاّ أن تَطَوَّعَ . قال وَذَكَرَ له رسولُ اللهِ ﷺ الزَّكاةَ ، قال : هلْ عَلَيَّ غَيرُها ؟ قال : لا ، إلاّ أن تَطَوَّعَ . قال فأدْبَرَ الرَّجُلُ وَهُوَ يقولُ : وَاللهِ لا أزيدُ عَلَى هٰذا ولا أنقُصُ . قال رسولُ اللهِ ﷺ : أفْلَحَ إنْ صَدَقَ

Zeqati është pjesë e Islamit

Fjala e All-llahut është:

"E, janë urdhëruar ata** (ithtarët e Shpalljeve të mëparshme) **që t'i luten** (t'i bëjnë ibadet) **vetëm All-llahut, duke u larguar nga paganizmi, të besojnë në mënyrë të sinqertë, të falin namazin e të japin zeqatin dhe, ajo është fe e drejtë".[41]

(el-Bejjine, 5).

46. Na ka treguar Ismaili, këtij i kishte treguar Malik b. Enesi, këtij mixha i vet, Ebu Suhejl b. Maliku, këtij babai i vet i cili e ka dëgjuar Talha b. Ubejdullahun duke thënë:

---

41 Forca dhe shkalla e besimit shprehet në aktivitetin kuantitativ (sasior) të veprave të mira të besimtarit. Zeqati është degë dhe ai që e kryen këtë detyrim islam (farz), pa dyshim, ka besim më të fortë sesa ai që e lë pas dore.

Me ajetin e sipërcituar Buhariu vërteton mendimin e vet të shprehur në titullin e kësaj pjese. Fjala "din", do të thotë "fé, besim", e, përmban në vete edhe Fenë Islame, parimet themelore të së cilës janë të shprehura në Kur'an: "Fe e vërtetë te All-llahu është vetëm Feja Islame".

Në ajetin e sipërpërmendur janë theksuar tri parime të Islamit: besimi i sinqertë dhe i vërtetë në All-llahun, i cili është themel i aktiviteteve të tjera të besimtarit; falja e namazit, është shtyllë e Islamit dhe, dhënia e zeqatit, bazë e sigurimit material të bashkësisë. Me kryerjen e rregullt të këtyre detyrimeve (farzeve) shprehet besimi i drejtë dhe i fortë i muslimanit.

Pejgamberit s.a.v.s. i erdhi një njeri nga Nexhdi me qëllim hakmarrjeje. Dëgjohej shushurima e zërit të tij, por nuk kuptohej se ç'fliste, derisa u afrua. E kur pyeti për Islamin, Pejgamberi s.a.v.s. u përgjigj:

"Pesë kohë të namazit brenda ditës dhe natës".

"E, diçka tjetër për mua përveç tij (përveç pesë kohëve të namazit)?" pyeti ai.

"Jo, vetëm nëse do vullnetarish", u përgjigj (Pejgamberi).

Pastaj Pejgamberi s.a.v.s. tha: **"Agjërimi i Ramazanit".**

"Diçka tjetër përveç tij (agjërimit të Ramazanit)**?"** pyeti ai.

"Jo, vetëm nëse do vullnetarisht", u përgjigj Pejgamberi.

Pejgamberi s.a.v.s. ia përmendi edhe zeqatin (tha transmetuesi).

"Diçka tjetër përveç tij (zeqatit)**?"** pyeti ai.

"Jo, vetëm nëse do vullnetarisht", u përgjigj Pejgamberi.

Atëherë u kthye njeriu, thotë transmetuesi, dhe tha:

"Për Zotin, nuk kam as çka të shtoj, e as çka të pakësoj".

Pejgamberi s.a.v.s. (pasi e dëgjoi), u shpreh me këto fjalë:

"Nëse e ka thënë të vërtetën ka shpëtuar".[42]

---

42 Sipas tekstit të hadithit të lartpërmendur, zeqati bie në parimet themelore të Islamit. Nga hadithi nxirret përfundimi:
- namazi është bazë e Islamit;
- falja e pesë kohëve të namazit brenda ditës dhe natës është detyrim (farz) për çdo musliman moshërritur dhe të shëndoshë;
- dhënia e zeqatit, kur pasuria arrin në shkallën e caktuar (nisabin) është detyrim parësor (farz) për muslimanin;
- falja e namazit të Bajrameve është detyrim i shkallës së dytë (vaxhib);
- agjërimi i muajit të Ramazanit është detyrim parësor (farz);
- zeqati u takon të varfërve;
- haxhillëkun në Qabe, Muhammedi a.s. nuk e ka përmendur, sepse, ose nuk i është urdhëruar deri atëherë, ose, personi që ia ka shtruar pyetjet, nuk ka qenë i detyruar ta bëjë atë, për shkak të pozitës së tij të dobët materiale. Kryerja me rregull e këtyre detyrimeve që u përmendën këtu, e bëjnë të lumtur njeriun në këtë botë dhe të shpëtuar në botën tjetër.
- është gjë e lavdueshme dhe e këshillueshme të shkosh nga një vend në tjetrin për të

باب اتباع الجنائز من الإيمان

٤٧ - حدثنا أحمد بن عبد الله بن علي المنجوفي قال حدثنا روح قال حدثنا عوف عن الحسن ومحمد عن أبي هريرة أن رسول الله ﷺ قال « من اتبع جنازة مسلم إيماناً واحتساباً ، وكان معه حتى يصلى عليها ويفرغ من دفنها . فإنه يرجع من الأجر بقيراطين كل قيراط مثل أحد . ومن صلى عليها ثم رجع قبل أن تدفن فإنه يرجع بقيراط »

تابعه عثمان المؤذن قال : حدثنا عوف عن محمد عن أبي هريرة عن النبي ﷺ . . نحوه

Përcjellja e xhenazes është pjesë përbërëse e besimit (imanit)

47. Na ka treguar Ahmed b. Abdullah b. Ali el-Menxhufiu, këtij i ka treguar Revhu, këtij Avfi, ky nga Hasani dhe nga Muhammedi, e këta nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Kush e përcjell muslimanin e vdekur për shkak të besimit të tij të fortë (duke besuar sinqerisht) **dhe, duke llogaritur** (vetëm në shpërblimin e All-llahut) **do të jetë me të derisa të falet namazi i xhenazes dhe të mbarojë varrimi i tij dhe, me të vërtetë, ai do të kthehet me shpërblimin prej dy kiratesh** (masë për matjen e sevapeve, sasinë e saj e di vetëm All-llahu xh.sh.). **Secili prej këtyre kirateve ka peshën e malit Uhud. Kush ia fal xhenazen të vdekurit, por që kthehet para se ai të varroset, do të kthehet me një kirat".**

Në sendin e dytë Revhu transmeton nga Uthmani, ky nga Muedhini, ky nga Avfi, ky nga Muhammedi, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s.[43]

---

kërkuar dituri dhe për të marrë informata nga personat e aftë dhe kompetentë;
- të besuarit dhe të zbatuarit e manifestimeve fetare pa menduar janë veprime të vlefshme.

43 Hadithi i lartpërmendur nxit për faljen e namazit të xhenazes së muslimanit, për përcjelljen dhe për varrimin e tij.
Muhammedi a.s. i ka urdhëruar muslimanët për të vizituar njeri-tjetrin, me fjalët: "Shkoni e vizitoni edhe atë që ju ka lënë: bëni mirë edhe atij që ju ka privuar nga diçka! Mos u

بابٌ خوف المؤمن من أن يحبط عمله وهو لا يشعر . وقال إبراهيم التيمي : ما عرضت قولي على عملي إلا خشيت أن أكون مكذبا . وقال ابن أبي مليكة . أدركت ثلاثين من أصحاب النبي ﷺ كلهم يخاف النفاق على نفسه ، ما منهم أحد يقول إنه على إيمان جبريل وميكائيل . ويذكر عن الحسن : ما خافه إلا مؤمن ، ولا أمنه إلا منافق . وما يحذر من الإصرار على النفاق والعصيان من غير توبة ، لقول الله تعالى ﴿ ولم يصروا على ما فعلوا وهم يعلمون ﴾

٤٨ — حدثنا محمد بن عرعرة قال حدثنا شعبة عن زبيد قال : سألت أبا وائل عن المرجئة ، فقال : حدثني عبد الله أن النبي ﷺ قال « سباب المسلم فسوق وقتاله كفر »

Frika e besimtarit (muslimanit), që të mos i rrënohen veprat, e ai të mos e hetojë, është pjesë e besimit

Ibrahim Tejmiu ka thënë:

"Nuk kam thënë asgjë për punën time, e të mos jem frikuar se do të gënjej (do të jem gënjeshtar)".

Ibni Ebu Mulejke, ndërkaq ka thënë:

"I kam njohur tridhjetë As-habë të Pejgamberit s.a.v.s. Të gjithë ata frikoheshin në vetvete nga dyfytyrësia. Asnjë prej tyre nuk thoshte se besimi (imani) **i tyre është në nivel të besimit të Xhibrilit dhe Mekailit".**[44]

---

shkapërderdhni dhe mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit!"

Nga hadithi shihet se është më mirë të shkohet pas sesa para xhenazes; se është më mirë të shkohet në këmbë sesa me mjete transportuese (përveç rasteve të jashtëzakonshme). Falja e namazit të xhenazes është detyrim kolektiv i dorës së parë (farz-i kifaje) i muslimanit, ndërsa për pjesëmarrjen në përcjelljen e të vdekurit musliman fitohet shpërblim i madh nga All-llahu xh.sh.

44 Ndërsa në pjesën paraprake është theksuar shpërblimi për ata që, në emër të All-llahut xh.sh. marrin pjesë sinqerisht në manifestimet fetare të xhenazës, këtu shprehen të metat e mundshme që mund të ndikojnë në zvogëlimin e shpërblimit, bile edhe në anulimin e tij, e që besimtarët të mos i hetojnë.

Me titullin e kësaj pjese, Buhariu dëshiron ta hedh poshtë krejtësisht mendimin e murxhive, të cilët mendojnë se All-llahu xh.sh. nuk do ta dënojë gabimtarin (gjynahqarin) për shkelje të detyrimeve, po qe se vetëm ka dëshmuar se: "Nuk ka zot përveç All-llahut

Përmendet nga Hasani:

"All-llahut i frikohet vetëm besimtari (i vërtetë), **e nuk i frikohet dyfytyrëshi** (munafiku). **Ai** (dyfytyrëshi) **nuk insiston në largimin dhe evitimin e dyfytyrësisë dhe gabimeve, bile edhe nuk pendohet".**

---

dhe se Muhammedi është Pejgamber i Tij". Sipas mendimit të tyre, veprat e mira nuk humbin vetëm për shkak të gabimit dhe se imani (besimi) i gabimtarit është i njëjtë me imanin e atij që është fetar (që s'ka gabime). Këtë mendim e hodhën poshtë të gjithë As-habët dhe muxhtehidinët e mëvonshëm, të cilët, krahas besimtarisë cilësuese, kanë shprehur druajtje dhe frikë gjithnjë, që shpërblimi për veprat e tyre të mira, të mos u humbet, për shkak të ndonjë lëshimi të mundshëm. Kështu, kanë jetuar gjithnjë në mes frikës nga dënimi i All-llahut xh.sh. dhe shpresës në mëshirën e Tij.

Kadi Ijadi ka thënë: "Murxhitë mendojnë ndryshe nga harixhitë dhe mutezilët. Harixhitë pohojnë se gabimi e nxjerr (e largon) besimtarin nga imani dhe e çon në mosbesim, kurse mutezilët janë të mendimit se besimtari kur gabon mbetet vetëm gabimtar. Megjithatë, edhe njëri edhe tjetri drejtim mendojnë se gabimtari për gabimet e veta, do të mbetet gjithnjë në Xhehennem, pra nuk do të dalë asnjëherë nga ai dhe nuk do ta shohë mëshirën e All-llahut xh.sh.

Murxhitë dalin me qëndrim tjetër. Këta mendojnë se gabimet nuk e dëmtojnë besimtarin. Për ta, me rëndësi është të ketë iman. Grupi i skajshëm i murxhive mendon se për besimtarin është e mjaftueshme vetëm të besojë dhe me zemër të pranojë ekzistimin e All-llahut xh.sh., kurse shkelja, e bile mospranimi i normave të tjera fetare, nuk do të ndikojë negativisht në imanin e besimtarit. Disa nga ata thonë: "Iman është vetëm të besosh me zemër, e me gjuhë të dëshmosh ekzistimin e All-llahut xh.sh. Murxhitë janë ndarë shumë herët në grupe, janë ndarë në pesë grupe dhe në qëndrimet e tyre kanë shkuar aq larg sa që nëjri-tjetrin e konsiderojnë pabesimtarë.

Shokët e Pejgamberit a.s., ndonëse kishin besim të sinqertë, ata kanë jetuar me frikë, që veprat e tyre të mos humben, ose të mjegullohen me ndonjë lëshim mundësisht të pahetueshëm. Njeriu për nga natyra është qenie që gabon dhe nuk mund të jetë i sigurtë asnjëherë për besimin dhe për fatin e tij përfundimtar deri në momentin e fundit të jetës së tij. Vetëm meleqët, si qenie shpirtërore, janë të pagabueshme te All-llahu xh.sh., dhe, prandaj, mund të jenë të sigurtë në besimin e tyre.

Në pyetjen e Aishes, për përmbajtjen e ajetit: "... edhe ata që ndajnë nga ajo që u është dhënë, e zemrat u dridhen...", Muhammedi a.s. përgjigjet me fjalët: "Ata janë që falin namazin gjithnjë, që agjërojnë dhe që ndajnë zeqat, e përsëri kanë drojën e All-llahut xh.sh. se këto nuk do të vlejnë te Ai.

Ajetin: "All-llahu ua ka nxjerrë parasysh ato, që ata nuk kanë shpresuar dhe nuk kanë menduar...", As-habët e kanë kuptuar se ato janë veprat e këqija të njerëzve, të cilat ata i kanë çmuar si të mira dhe fisnike.

Punët e mira duhet të bëhen, në radhë të parë, në emër të All-llahut xh.sh.

E, Fjala e All-llahut të Madhërueshëm është:

*"... **Dhe nuk heqin dorë nga ajo** (vazhdojnë me këmbëngulësi) **që e kanë bërë, dhe ata e dinë** (që është gabim)".*[45]

(Ali Imrân, 135).

48. Na ka treguar Muhammed b. Ar'are, këtij i ka treguar Shu'be, ky nga Zejdi, i cili ka thënë:

- E kam pyetur Ebu Vailin për murxhitë, e ai tha: Më ka treguar Abdullahu se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Ta turpërosh (ofendosh) **muslimanin është mëkat, ndërsa ta mbysësh atë, është mosbesim** (qufër)".

٤٩ ـ أخبرنا قُتَيْبَةُ بنُ سَعِيدٍ حدَّثنا إسماعيلُ بنُ جعفرٍ عن حُمَيدٍ عنْ أنسٍ قال: أخبرَني عُبادةُ بنُ الصامتِ أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ خَرَجَ يُخبِرُ بليلةِ القَدْرِ، فتلاحى رَجُلانِ مِنَ المُسلِمينَ، فقال: إنِّي خَرَجْتُ لأُخبِرَكُمْ بليلةِ القَدْرِ، وإنَّه تلاحى فلانٌ وفلانٌ فرُفِعَتْ، وعسى أنْ يكونَ خيراً لكم، التَمِسوها في التاسعةِ والسابعةِ والخامسةِ»

49. Na ka treguar Kutejbe b. Se'idi, këtij Ismail b. Xha'feri, këtij Humejdi, këtij Enesi, e këtë e kishte njoftuar Ubade b. Samiti se Pejgamberi s.a.v.s. ka dalë t'i njoftojë As-habët për Natën e Kadrit (Lejletu-l-Kadr), kur atje përlaheshin dy muslimanë.

---

45 Në mesin e shumë ajeteve, deklarata e Hasan Basriut mbështetet edhe në këtë ajet: "Për besimtarët të cilët i frikohen vendit në të cilin do të qëndrojnë para Zotit të tyre, do të kenë dy parajse".

Nga Hasan Basriu janë transmetuar edhe fjalët: "Për Zotin! Nuk ka patur asnjë besimtar të mirë në të kaluarën që nuk është frikuar nga pasojat e dyfytyrësisë, e as që do të ketë në të ardhmen, ashtu siç nuk ka patur dyfytyrësh asnjëherë, e që nuk ka qenë i pashqetësuar dhe i pabrengosur për fatin e vet, e as që do të ketë në të ardhmen".

Hasan Basriu shpesh thoshte: "Dyfytyrësh është ai që nuk frikohet nga dyfytyrësia dhe jeton pa brenga për besimin e vet".

Për këtë shkak Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Kam dalur t'ju njoftoj për Natën e Kadrit, e pasi përlaheshte filani e filani, ajo është ngritur. E ndoshta kjo do të jetë më mirë për ju. Tashmë, kërkojeni ju atë (Natën e Kadrit) **në të shtatën, në të nëntën ose në të pestën** (pas natës së njëzetë të Ramazanit)".[46]

بابُ سُؤالِ جِبْرِيلَ النبيَّ ﷺ عنِ الإيمانِ ، والإسْلامِ ، والإحْسانِ ، وعِلْمِ الساعةِ . وبيانِ النبيِّ ﷺ له . ثمَّ قال : جاءَ جِبريلُ عليهِ السلامُ يُعَلِّمُكُمْ دِينَكُمْ . فَجَعَلَ ذٰلكَ كُلَّهُ دِينًا . وما بَيَّنَ النبيُّ ﷺ لِوَفْدِ عبدِ القَيْسِ مِنَ الإيمانِ . وقولِهِ تعالىٰ ﴿ ومَنْ يَبْتَغِ غيرَ الإسلامِ دِينًا فلَنْ يُقْبَلَ منه ﴾

---

46 Me titullin që ia jep kësaj pjese Buhariu e hedh poshtë mendimin e murxhive, të cilët pohojnë se nuk duhet të frikohet besimtari nga pasojat e gabimeve, po qe se vetëm e beson All-llahun xh.sh.

Me ajetin e sipërshënuar lavdohen ata që i luten All-llahut për faljen e gabimeve të veta, që i kanë bërë nga mosdija dhe, qortohen ata që gabojnë gjithnjë dhe nuk kërkojnë falje nga All-llahu xh.sh. Të tillët duhet të kenë frikë më shumë sesa ata që pendohen për gabimet e tyre kohë pas kohe.

Përkthimi i ajetit në tërësi është: "Dhe ata, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm (zullum) vetes, e kujtojnë All-llahun dhe kërkojnë falje për gabimet e tyre. E kush fal gabime përveç All-llahut; Dhe, ata nuk heqin dorë nga ajo që e kanë bërë, e ata e dinë këtë (që është gabim)".

Me hadithin e lartshënuar Muhammedi a.s. mendon në zënkën e Ka'b b. Malikut me Abdullah b. Hadredin për pagesën e borxhit. Ajeti i dytë dhe ajeti i tretë i sures "el-Huxhurat" në përkthim thekson: "O ju që keni besuar! Mos i ngritni zërat tuaj mbi zërin e Pejgabmerit dhe mos bisedoni me të me zë të lartë, ashtu si bisedoni zëshëm me njëri-tjetrin, në mënyrë që mos t'u humbin veprat tuaja, e që ju të mos i hetoni". "Me të vërtetë, ata që ulin zërin në praninë e Pejgamberit të All-llahut, ata janë, që zemrat e tyre All-llahu i ka kalitur për besim. Për ta ka falje dhe shpërblim të madh".

Grindja e njerëzve, ashpërsia dhe paturpshmëria e tyre janë të dëmshme si për individët, si për shoqërinë në përgjithësi. Këto janë vese dhe karakteristika të njerëzve të prapambetur. Zënka e As-habëve të posapërmendur në xhami qe shkak që shenjat e Natës së Kadrit të flaken. Kjo i brengosi të pranishmit, prandaj, Muhammedi a.s. deri-diku e përcaktoi kohën e saj, duke thënë: "Pritnie atë në të 25-tën, 27-tën ose në të 29-tën natë të Ramaznit!"

٥٠ – حدثنا مُسَدَّدٌ قال حدثنا إسماعيلُ بنُ إبراهيمَ أخبرنا أبو حَيَّانَ التَّيميُّ عن أبي زُرْعَةَ عن أبي هُرَيرةَ قال : كانَ النبيُّ ﷺ بارزاً يوماً للناسِ ، فأتاهُ رَجُلٌ فقالَ : ما الإيمانُ ؟ قال : الإيمانُ أنْ تؤمنَ باللهِ ، وَمَلائِكَتِهِ ، وبِلقائِهِ ، وَرُسُلِهِ ، وتؤمنَ بالبَعْثِ . قال : ما الإسلامُ ؟ قال : الإسلامُ أنْ تَعْبُدَ اللهَ ولا تُشْرِكَ بِهِ ، وَتُقيمَ الصَّلاةَ ، وَتُؤَدِّيَ الزَّكاةَ المَفْروضةَ ، وتَصومَ رَمضانَ . قال : ما الإحْسانُ ؟ قال : أنْ تَعبُدَ اللهَ كأنَّكَ تَراهُ ، فإنْ لم تَكُنْ تَراهُ فإنَّهُ يراكَ . قال : مَتَى الساعةُ ؟ قال : ما المسئولُ عنها بأعلمَ مِنَ السائلِ . وسأُخبِرُكَ عن أشراطِها : إذا وَلَدَتِ الأَمَةُ رَبَّها ، وإذا تَطاوَلَ رُعاةُ الإبلِ البُهْمِ في البُنْيانِ ، في خَمْسٍ لا يَعْلَمُهنَّ إلاَّ اللهُ . ثمَّ تَلا النبيُّ ﷺ ﴿ إنَّ اللهَ عِنْدَهُ عِلْمُ الساعةِ ﴾ الآيةَ . ثمَّ أدْبَرَ . فقال رُدُّوهُ . فلم يَرَوا شَيْئاً . فقال : هٰذا جِبْريلُ جاء يُعَلِّمُ الناسَ دِينَهُم . قال أبو عبدِ اللهِ : جَعلَ ذٰلكَ كُلَّهُ مِنَ الإيمانِ

Xhibrili e pyet Pejgamberin s.a.v.s. për imanin, Islamin, mirësinë dhe Ditën e Kijametit

Pejgamberi s.a.v.s. ia shpjegoi atij, pastaj tha:

"Erdhi Xhibrili a.s. t'ua mësojë juve fenë tuaj dhe gjithë këtë e bëri me fe. Dhe, gjithçka që i paraqiti delegacionit të Abdu-l-Kajsit është pjesë përbërëse e besimit".

E, Fjala e All-llahut të Madhëruesh ëm është:

"Kush kërkon fe tjetër përveç Islamit, ajo nuk do t'i pranohet...?".

(Ali Imran, 85).

50. Na ka treguar Museddedi, këtij i kishte treguar Ismail b. Ibrahimi, këtij Ebu Hajjan et-Tejmiu, ky nga Ebu Zur'a, e ky nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

Një ditë Pejgamberi s.a.v.s. doli në mesin e njerëzve; iu afrua atij një njeri dhe e pyeti:

"Çka është besimi (imani)**?"**.

"Besim (iman) **është të besosh All-llahun, Meleqët e Tij, takimin me** Të (në Ditën e Kijametit), **të besosh Pejgamberët e Tij dhe ringjalljen"**, u përgjigj (Pejgamberi s.a.v.s.).

"Po çka është Islami?" pyeti ai.

"Islami është ta adhurosh (t'i bësh ibadet) **All-llahun, të mos i përshkruash shok Atij, të falësh namazin, të japësh zeqatin dhe të agjërosh Ramazanin"** u përgjigj Pejgamberi s.a.v.s.

"Po çka është mirësia (ihsani)?" pyeti ai.

"Ta adhurosh All-llahun sikur e sheh Atë. Nëse ti nuk e sheh Atë, Ai, pa dyshim, të sheh ty", u përgjigj.

"Kur do të jetë Dita e Kijametit", pyeti njeriu.

Lidhur me këtë pyetje Pejgamberi s.a.v.s. tha:

"I pyeturi nuk është në dijeni më të madhe për këtë çështje se pyetësi. Vetëm po të tregoj ty për shenjat e tij: kur robëresha të lind pronarin (d.m.th. zotëriun) **e saj; kur barinjtë e deveve zeshkane me mburrje do të shtyhen në ndërtimin e pallatit. Ajo** (Dita e Kijametit) **është një nga pesë fshehtësitë që nuk i di askush, përveç All-llahut xh.sh".**

Pastaj Pejgabmeri s.a.v.s. citoi ajetin e Kur'anit:

"Me të vërtetë për Çastin (Ditën e Kijametit) di vetëm All-llahu...".

(Llukman, 34).

Pastaj njeriu u nis të shkojë, (e Pejgamberi s.a.v.s.) tha:

"Kthejeni atë!"

Meqë ata nuk e panë më atë (sepse u flak para syve të tyre), Pejgamberi s.a.v.s. tha:

"Ai është Xhibrili a.s., ka ardhë t'ua mësojë njerëzve fenë e tyre".

Ebu Abdullahu (Buhariu) ka thënë: **E gjithë kjo është pjesë e besimit (imanit)".**[47]

---

47 Bamirësi është kur njeriu në mënyrë të rregullt i kryen detyrat e veta ndaj vetes, ndaj bashkësisë, ndaj farefisit, e sidomos ndaj All-llahut xh.sh. dhe njerëzve t'u jetë mirënjohës për mirëbërjen e tyre ndaj tij. Pasi të gjitha dhuntitë e All-llahut xh.sh. i janë lënë njeriut, ato, mendjen dhe vetëdijen tonë të shëndoshë do ta udhëzojnë për ta falënderuar All-llahun xh.sh. gjithnjë. Për këtë tërhoqi vëmendjen edhe Muhammedi a.s., me fjalët: "... t'i lutesh All-llahut sikur e sheh Atë...".

Të gjitha punët njerëzore bëhen në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme. Punët e këqija janë të duarduarshme. Njeriu, si qenie e vetëdijshme, duhet ta dijë se është

gjithnjë nën përcjelljen dhe mbikëqyrjen e All-llahut xh.sh., e nëse ka besim të plotë se All-llahu xh.sh. e shikon, e përcjell dhe e di mendimin e tij njerëzor, atëherë do të jetë e mjaftueshme për t'u larguar nga punët e këqija, që e çojnë në gabime dhe, poashtu, do të jetë e mjaftueshme që t'i lutet All-llahut xh.sh. me përkushtimin më të madh dhe obligimin e tij ndaj All-llahut dhe ndaj njerëzve të tjerë ta kryejë në mënyrë të rregullt dhe të vetëdijshme.

Veprat e mira dhe fetare janë shprehje dhe pasqyrim të besimit në All-llahun xh.sh., në shpërblimet e Tij, në bindjen se Ai sheh, përcjell gjithçka dhe di çdo lëvizje të qenies njerëzore. Kush e pranon All-llahun xh.sh., e nuk i kryen urdhërat e Tij, atij i mungon bindja e nevojshme për domosdoshmërinë e veprimit të bamirësisë, i mungon koncepti ndaj Madhërisë së All-llahut xh.sh.

Nëse njeriu mendon për botën e ardhshme dhe jetën në të, për momentet e vdekjes, për jetën në varr, për ringjalljen, për përgjegjësinë, dënimin dhe shpërblimin për veprat e bëra, pa dyshim, do të përpiqet me tërë qenien e vet që të bëjë sa më tepër vepra të mira, duke u ruajtur, njëkohësisht, nga veprat e këqija.

Neveviu thotë se pjesa e hadithit: "Që All-llahut t'i lutesh sikur e sheh Atë..." paraqet një themel të besimit Islam, një nga themelet e mësimit Islam, shtyllë të sinqeritetit të njerëzve dhe thesar moral e shpritëror të pashterrshëm të besimtarit".

Kadi Ijadi thotë: "Ky hadith i përfshin të gjitha bazat e besimit dhe detyrat (obligative) të punëve të sinqerta, domosdoshmërinë e kryerjes së veprave të mira dhe largimin nga të këqijat. Me këtë hadith, po ashtu, janë shprehur të gjitha principet e shkencës islame". Pjesa e hadithit: "Kur robëresha të lind zotëriun..." dijetarët islamë e komentojnë në mënyra të ndryshme. Pjesa më e madhe me këtë mendojnë në shtrirjen e pushtetit islam në vende të largëta në të cilat autoktonët e nënçmojnë pushtetin e zotërinjve të tyre, e shumë gra vijnë nën varësinë robëruese të "pushtuesit" me të cilët, si robëresha, fillojnë të lindin fëmijë. Fëmijët e këtillë të lindur nga nënat robëresha dhe qytetarët e lirë kanë status të njerëzve të lirë; ata janë trashëgimtarë të drejtpërdrejtë të baballarëve të vet dhe si zotërinj të këtillë në të cilin ka zotëruar çdo gjë edhe babai i tyre, ata janë zotërinj të tërë pasurisë së babait, prandaj edhe robëreshat, në mesin e të cilave janë edhe nënat e tyre, nëse zotëria e saj nuk e ka liruar.

Ajniu i thekson edhe këto mendime:

- dëshira për para mund ta shpie njeriun deri në atë shkallë që ta shesë robëreshën, e cila i ka lindur atij fëmijë, qoftë me të, qoftë me ndonjë mashkull tjetër. Duke kaluar kështu nga prona e njërit zotëri në pronën e tjetrit, në fund, duke u blerë, bie në pronën e birit të saj, e ai , pa dije se e ka nënë, sillet me të sikur me robëreshat e tjera. Kjo mund të merret nga shkaqet që Islami ua ndaloi zotërinjve shitjen e robëreshave me të cilën tashmë ka lindur fëmijë.
- mendohet, ndoshta në fëmijën e robëreshës të cilën zotëria i vet e ka liruar, për shkak se ajo i ka lindur fëmijë. Pasi kjo grua u bë e lirë, duke iu falënderuar lidnjes së fëmijës, ai për këtë arsye krenohet dhe sillet ndaj nënës së vet si zotëria ndaj robëreshës;
- Muhammedi a.s. nën parashenjat e shkatërrimit të botës ka menduar ndoshta edhe në

بَابٌ * ٥١ - حَدَّثَنَا إبراهيمُ بنُ حَمْزَةَ قال حدَّثنا ابراهيمُ بنُ سَعْدٍ عنْ صالحٍ عنْ ابنِ شِهابٍ عنْ عُبَيْدِ اللهِ بنِ عبدِ اللهِ أنَّ عبدَ اللهِ بنَ عَباسٍ أخبَرَهُ قال: أخبَرَنِي أبو سُفيانَ أنَّ هِرَقْلَ قال لهُ: سَأَلْتُكَ هل يَزِيدُونَ أمْ يَنقُصونَ فزَعَمتَ أنَّهم يَزِيدونَ، وكذٰلكَ الإيمانُ حتّى يَتِمَّ. وسألتُكَ هَلْ يَرْتَدُّ أحَدٌ سَخْطَةً لِدِينِهِ بَعْدَ أنْ يَدْخُلَ فيه؟ فزَعَمتَ أنْ لا، وكذٰلكَ الإيمانُ حينَ تُخالِطُ بَشاشَتُه القُلوبَ لا يَسْخَطُه أحَدٌ

51. Na ka treguar Ibrahim b. Hamza, këtij Ibrahim b. Sa'di, këtij Salihu, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Ubejdullah b. Abdullahu se Abdullah b. Abbasi i ka thënë: Më ka thënë Ebu Sufjani se Herakleu i ka thënë:

"Të kam pyetur se numri i muslimanëve shtohet apo pakësohet, e ti u përgjigje: shtohet. Ashtu vazhdon të shtohet besimi derisa të plotësohet".

"Të kam pyetur se a e lëshon ndokush fenë, pasi ta ketë pranuar njëherë, duke e urrejtur atë?"

---

fëmijët e paedukuar, të cilët sillen me prindërit e tyre, si sillen tregtarët me robërit e vet, zakonisht e kushtëzon çrregullimin e sistemit shoqëror dhe shkatërrimin e përgjithshëm të bashkësisë;

- rasti mund të lidhet edhe me robin e mitur, i cili më vonë lirohet, vjen në pozitë të lartë shoqërore dhe bëhet zotëri me famë i kohës së vet, e që trupërohet nga statusi i mëparshëm i nënës së vet dhe sillet ndaj saj në mënyrë johumane.

Një pjesë e hadithit aludon në përhapjen e pushtetit islam në anët përreth, në migrimin e bujqve nëpër qytete dhe në mospërfilljen (lënien pas dore) të blegtorisë dhe të degëve të tjera bujqësore.

Kurtubiu mendon se me një pjesë të hadithit mendohet në një kthesë revolucionare në shoqëri, në të cilën do të dëmtohet shumkush. Ato janë kohët në të cilat njerëzit e paditur vijnë në pushtet, pastaj, këta e gëlltisin pasurinë, duke çuar një jetë luksoze, ngrenë vila në mënyrë të paligjshme.

Nga hadithi mund të nxirren edhe këto përfundime:

- themeli i imanit (besimit) është besimi në All-llahun xh.sh., melekët, takimi me All-llahun xh.sh. në Ditën e Gjykimit; besimi në Pejgamberët; besimi në ringjalljen dhe në përgjegjësinë për veprat e bëra;
- melekët mund t'i paraqiten njeriut në cilëndo formë. Kështu, Xhibrili, kur ia sillte Shpalljen Muhammedit a.s., zakonisht i paraqitej në formën e shokut të tij, Duhjes, herën tjetër në formën e ndonjë shoku tjetër, kurse dy herë i është paraqitur në formën e vet;
- besimi dhe zbatimi praktik i normave islame përbën një tërësi të pandashme. Kryerja e detyrimeve (farzeve) në mënyrë të rregullt, të qenët mirëbërës janë shenja të njerëzve me besim të fortë.

U përgjigje, "**jo**".

"**Ashtu është edhe besimi** (imani) **kur mirësia e tij përzihet me shpirtin, atë më askush nuk e urren**".

باب فضل من استبرأ لدينه

٥٢ – حدثنا أبو نعيم حدثنا زكريا عن عامر قال سمعت النعمان بن بشير يقول : سمعت رسول الله ﷺ يقول « الحلال بين ، والحرام بين ، وبينهما مشبهات لا يعلمها كثير من الناس . فمن اتقى الشبهات استبرأ لدينه وعرضه ، ومن وقع في الشبهات كراع يرعى حول الحمى يوشك أن يواقعه . ألا وإن لكل ملك حمى ، ألا إن حمى الله في أرضه محارمه . ألا وإن في الجسد مضغة إذا صلحت صلح الجسد كله ، وإذا فسدت فسد الجسد كله ، ألا وهي القلب »

Virtyti i atij që përpiqet deri në fund ta ruajë pastërtinë e fesë së vet

52. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi, këtij ia ka transmetuar Zekerijai, këtij Amri, këtij Nu'man b. Beshiri, i cili ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"**Hallalli është i qartë, edhe harami është i qartë. Në mes tyre** (hallallit dhe haramit) **ka gjëra të dyshimta, të cilat nuk i dinë shumë njerëz. Kush ruhet nga punët e dyshimta, e ruan pastërtinë e fesë së vet dhe nderin e tij, e kush bie në punë të dyshimta, është i njëjtë me bariun i cili e ruan bagëtinë e vet përreth vendit të ndaluar në të cilin ajo mund të hyjë në çdo çast. Dijeni se çdo mbret e ka ndalesën e vet, e, kini kujdes se, ndalesa e All-llahut në tokën e tij është çështje të cilën Ai e ka ndaluar. Poashtu, dijeni se çdo trup ka pjesë mishi, e kur është e sëmurë** (ajo pjesë) **i sëmurë është krejt trupi. Ja, ajo** (pjesë mishi) **është zemra!**".[48]

---

48 Me këtë hadith theksohet domosdoja e përballimit të gjithçkait që e dobëson besimin. Bamirësia e forcon besimin, prandaj, konsiderohet pjesë përbërëse e besimit islam.

Në veprimtarinë islame, krahas detyrave të domosdoshme, bie edhe të larguarit nga veprat të cilat dyshohet se janë të ndaluara. Të ruhesh nga veprat të cilat janë të dëmshme për nderin, fytyrën dhe të drejtën e tjetrit është shenjë e turpit, për të cilin Muhammedi a.s. ka thënë se është pjesë e besimit islam. Dijetarët islamë konsiderojnë se ky hadith është bazë për shkencën islame dhe përfshin një të tretën e mësimit islam. Tërheq

باب أداء الخمس من الإيمان

٥٣ - حدثنا علي بن الجعد قال أخبرنا شعبة عن أبي جمرة قال: كنت أقعد مع ابن عباس يجلسني على سريره، فقال أقم عندي حتى أجعل لك سهماً من مالي. فأقمت معه شهرين، ثم قال: إن وفد عبد القيس لما أتوا النبي ﷺ قال: من القوم - أو من الوفد؟ - قالوا: ربيعة. قال مرحباً بالقوم - أو بالوفد - غير خزايا ولا ندامى. فقالوا: يا رسول الله، إنا لا نستطيع أن نأتيك إلا في الشهر الحرام، وبيننا وبينك هذا الحي من كفار مضر، فمرنا بأمر فصل نخبر به من وراءنا، وندخل به الجنة. وسألوه عن الأشربة. فأمرهم بأربع ونهاهم عن أربع: أمرهم بالإيمان بالله وحده، قال: أتدرون ما الإيمان بالله وحده؟ قالوا الله ورسوله أعلم، قال: شهادة أن لا إله إلا الله وأن محمداً رسول الله، وإقام الصلاة، وإيتاء الزكاة، وصيام رمضان، وأن تعطوا من المغنم الخمس. ونهاهم عن أربع: عن الحنتم، والدباء، والنقير، والمزفت - وربما قال: المقير - وقال: احفظوهن، وأخبروا بهن من وراءكم

Dhënia e një të pestës është pjesë e besimit

53. Na ka treguar Ali b. Xha'di, ky nga Shu'be, ky nga Ebu Xhemre, i cili ka thënë:

Kam pasë ndenjur me Ibni Abbasin i cili më uli në shtratin e vet dhe më tha: **"Rri te unë derisa të të jap ty një pjesë të pasurisë sime!"**

---

vëmendjen e fitimit korrekt (në tregti), në pastërtinë e ushqimit, në veshjen dhe në jetën e rregulluar dhe morale. Në hadith theksohet domosdoja që çdo qëndrim yni të jetë në harmoni me mësimet islame. Muslimani është i detyruar të mësojë sa më tepër normat e fesë së vet dhe të di çka është e lejueshme dhe çka është e ndaluar. Zemra dhe mendja e shëndoshë janë themele të aktivitetit njerëzor dhe atyre duhet t'u kushtohet kujdes i veçantë.

Neveviu thotë: "Ka vepra të cilat pa dyshim janë të lejueshme, si: të ngrënët bukë, pemë, perime, të pirët ujë e të ngjashme; ndërkaq, ka punë, të cilat janë të ndaluara gjithsesi, si: pirja e alkoolit, e gjakut, kurvëria (zinaja), rrena e të ngjashme. Megjithëkëtë, ka edhe vepra për të cilat nuk dinë shumë njerëz se në cilin nga këta dy grupe bëjnë pjesë. Kështu, për shembull, lepuri i gjuajtur me pushkë lejohet të hahet. Mirëpo, si të veprohet me lepurin e plagosur me plumb, që duke ikur, kërcen nga shkëmbi dhe gjuetari e gjen më vonë atë të vrarë? Tani lind dyshimi se si është vrarë ai lepur: nga plumbi apo ngase ra nga shkëmbi. Në rastin e parë lepuri lejohet të hahet, në rastin e dytë nuk lejohet.

Pasi me të qëndrova dy muaj, më tha: **"Kur Pejgamberit s.a.v.s. i erdhi delegacioni i Abdu-l-Kajsit** (një fis)", ai e pyeti"

"Cili popull jeni ju", respektivisht, **"cili delegacion?"**

"Jemi nga (fisi) **Rebi'a"**, u përgjigjen ata.[49]

"Mirë se keni ardhur o njerëz ose delegacion (dyshim i transmetuesit) **pa të meta dhe pa nevojë pendimi"**, u tha Pejgamberi s.a.v.s.

"O Resulullah, ne mund të vijmë te Ti vetëm në ndonjë muaj të shenjtë, sepse në mes nesh dhe teje është lagja e pabesimtarëve Mudar. Prandaj, na urdhëro neve me një urdhër të prerë të cilin do t'ia përcjellim atyre që kanë mbetur pas nesh dhe i cili do të na çojë në Xhennet", i thanë Pejgamberit s.a.v.s.

---

49 Fisi Abdu-l-Kajs ka banuar në Hixhër dhe delegacioni i tij i përbërë nga 14 anëtarë erdhi te Muhammedi a.s. në Medine në vitin 8 hixhri, mu në kohën kur bëheshin përgatitje për çlirimin e Mekkes. Në krye të delegacionit ishte i pari i fisit, Mundhir b. Aidhi, i quajtur Eshbah, kurse anëtarët ishin: Amr b. Merxhumi, Ubejde b. Humami, Harith b. Shuajbi, Muzejjid b. Maliku, Munkidh b. Hajjani, Harith b. Habibi, Suhari, Utbe b. Harbeti, Xhuhejm b. Kasemi, Rusejmi nga familja Adevije, Xhuvejhu nga familja Kinda, Zari b. Aidhi dhe Kajs b. Nu'mani. Disa historianë mendojnë se në atë delegacion kishte edhe anëtarë të tjerë, e disa mendojnë se kishte 45 anëtarë.

Nga bisedat e zhvilluara në mes tyre shihet se këta njerëz e kishin pranuar Islamin që më herët, e tash kishin ardhë të dëgjojnë edhe diç të re për të. Prandaj, Muhammedi a.s. i priti me mirëseardhje dhe u tha atyre se nuk kanë për çka të pendohen dhe të brengosen për jetën e tyre të mëparshme të idhujtarisë.

Sipas theksimeve të Ajniut, shkaku i këtij takimi ishte Mundhir b. Hajjani, i cili kishte ardhë nga Hixhri në Medine për punët e veta tregtare. Kur Muhammedi a.s. kaloi pranë tij, ai qe çuar në këmbë dhe pas kësaj bisede të rastësishme, e pranoi Islamin. Pak më vonë e pat mësuar suren "Fâtiha" dhe disa sure të tjera të shkurtëra të Kur'anit dhe qe kthyer në Hixhër. Muhammedi a.s. i dërgoi letër fisit Abdu-l-Kajs përmes këtij personi, por ky, duke u frikësuar nga fisi i vet, e mbajti letrën vetë dhe deshi ta fshehë. Megjithatë, bashkëshortja e tij, bijë e Mundhir b. Aidhit, të parit të fisit Abdu-l-Kajs, ia gjeti këtë letër dhe, derisa ai një ditë falte namazin fshehurazi dhe lexonte me zë një sure, ajo bashkë me babain e vet iu afruan, e, kur e dëgjuan përmbajtjen e sures, e pranuan Islamin. Mundhiri, pastaj, e mori letrën dhe ia paraqiti parisë së fisit, ua shpjegoi atyre, të cilët menjëherë e pranuan Islamin. Në këtë tubim ata morën qëndrim të dërgojnë te Muhammedi a.s. një delegacion, përmes të cilit të shprehin besnikërinë e tyre ndaj Islamit dhe, njëkohësisht, të marrin udhëzime të hollësishme për të.

E pyetën edhe për pijen.

Pejgamberi s.a.v.s. i urdhëroi për katër gjëra dhe ua ndaloi katër gjëra. I urdhëroi të besojnë në një të vetmin All-llah dhe i pyeti: **"A e dini çka është besimi në All-llahun?"**

"All-llahu dhe Pejgamberi i Tij e dinë më së miri", thanë ata.

"Të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është Pejgamber i Tij, të falësh namazin, të japësh zeqatin, të agjërosh muajin e Ramazanit dhe të japësh një të pestën (1/5) **e pasurisë së zënë në luftë"**, tha Pejgamberi s.a.v.s.

Ndërkaq, nga katër gjërat që ua ndaloi atyre janë pijet (që rrijnë) **në testi, në kungull të ujit, në pagur** (matare), **në varell ose në koritën e lyer me rrëshirë ose - sikur thotë nganjëherë transmetuesi - në koritën e katranosur.**

"Mbani në mend këto dhe tregojuni atyre që janë pas jush",[50] u tha Pejgamberi s.a.v.s.

---

50 Anëtarët e delegacionit e patën pyetur Muhammedin a.s. për lëngun e hurmës dhe të rrushit të cilat i mbanin në enë të ndryshme. Muhammedi a.s. ua ndaloi jo vetëm pirjen e alkoolit, por edhe pirjen e lëngjeve nga: testia, shtamba, paguri (matarja) dhe nga enë të tjera prej qeramike; pastaj nga: kungulli i ujit, nga varelli (vozgë e vogël), bucela, korita e thellë e lyer me katran ose me rrëshirë dhe nga enë të tjera në të cilat lëngu mund të kthehet në alkool shpejt, lehtë dhe pa u hetuar.

Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- kontaktet e njerëzve me njëri-tjetrin janë vepra të rekomandueshme, sepse mund të kenë dobi për mbarë shoqërinë.
- lejohet të merret pagë (rrogë) për ta mësuar dikënd. Ebu Xhemreti ka marrë rrogë për dy muaj nga kryetari i Basres, Ibni Abbasi, sepse i ka dhënë këshilla dhe ka qenë përkthyes i persishtes para se të vinin persianët në Basra;
- është e rekomandueshme t'i shprehësh mikut mirëseardhje;
- lejohet t'i nxisësh njerëzit për të mësuar dhe për të kërkuar dijeni, pavarësisht nga mosha e tyre;
- *manifestimet themelore të Islamit janë:* të dëshmosh besimin në All-llahun xh.sh. dhe në Pejgamberin e Tij, të falësh namazin, të japësh zeqatin, të agjërosh Ramazanin dhe t'i japësh shoqërisë 1/5 e pasurisë së zënë në luftë;
- Muhammedi a.s. e ndaloi pirjen e lëngut jo të freskët (të ndenjur) nga enët prej qeramike, nga druri dhe materiali tjetër, sepse lëngu në këto enë mund të kthehet shpejt dhe pa u hetuar në pije dehëse.

بابٌ ما جاء إنَّ الأعمالَ بالنِّيَّةِ والحِسبةِ ، ولِكلِّ امرىءٍ ما نَوَى . فدخَلَ فيهِ الإيمانُ والوُضوءُ والصلاةُ والزَّكاةُ والحجُّ والصومُ والأحكامُ . وقال اللهُ تعالىٰ ﴿ قل كلٌّ يعملُ علىٰ شاكِلتِهِ ﴾ : علىٰ نيَّتِهِ . نَفَقةُ الرَّجُلِ على أهلِهِ - يحتسِبُها - صَدقةٌ . وقال : ولٰكن جِهادٌ ونيَّةٌ

"Veprat çmohen sipas qëllimit dhe sinqeritetit"

Dhe **"çdo njeriu i takon ajo për të cilën ka pasë për qëllim", ku hyjnë: besimi** (imani), **abdesti, namazi, zeqati, haxhillëku, agjërimi dhe normat** (parimet) **tjera jetësore.**

All-llahu i Madhërueshëm (në Kur'an) thotë:

"Thuaj, çdo gjë vepron sipas mënyrës së vet".

(el-Isrâ', 84)

D.m.th. sipas qëllimit të tij. Njeriu të shpenzojë për familjen e vet i llogaritet sadaka dhe ka thënë (Pejgamberi s.a.v.s.): **"... por** (shpërblim) **ka edhe lufta në rrugën e All-llahut dhe qëllimi i mirë** (nijeti)".[51]

Ebu Hanife dhe dijetarët e tjerë të kësaj shkolle konsiderojnë se përmbajtja e kësaj pjese të hadithit ka qenë në fuqi në ditët e para të paraqitjes së Islamit, sepse më vonë Muhammedi a.s. ka thënë: "Thartoni hurmat dhe rrushin në çdo enë dhe pini lëngun e tyre, por mos i pini (ato lëngje) nëse janë kthyer në pije dehëse;

- është e rekomandueshme të kërkohet shpjegim i hollësishëm për ndonjë çështje nga ekspertët. Atyre që interesohen për shkencën dhe kërkojnë këshilla profesionale, duhet t'u kushtohet kujdes i posaçëm dhe mikpritje;
- është gjë e lavdueshme të lavdërosh njeriun e zellshëm në punë, nëse te ai lavdia nuk do të krijojë huti (mendjemadhësi) dhe çrregullim në bashkësi dhe,
- imani dhe islami përbëjnë tërësi të pandashme. Veprat e mira e të vlefshme, do t'ia mundësojnë gabimtarit të përjetojë Xhennetin, pasi të kryej dënimin.

51 Në pjesën e mëparme bëhej fjalë për veprat të cilat ia mundësonin besimtarit hyrjen në Xhennet, këtu, ndërkaq, theksohet se te All-llahu xh.sh. janë të vlefshme vetëm ato punë që bëhen në emër të Tij. Veprat e mira që bëhen me munafikllëk (dyfytyrësi) nuk kanë vlerë te All-llahu xh.sh.

Vepra e njeriut çmohet dhe gjykohet vetëm sipas qëllimit. Hadithi i përmendur, i dhënë në mënyrë të shkurtuar në tërësi është: "Pas çlirimit të Mekkes nuk ka shpërblim për ata që shpërngulen nga ajo, por ka shpëblim lufta në rrugën e All-llahut dhë qëllimi i mirë".

Tejmiu ka deklaruar se qëllimi i mirë dhe i sinqertë në vepër, është më i vlefshëm nganjëherë se vetë puna dhe se punët pa qëllim të sinqertë janë të pavlefshme te All-llahu xh.sh. Duket se Muhammedi a.s. të ketë thënë: "Kush vendos të bëjë vepër të mirë dhe

٥٤ — حدثنا عبد الله بن مسلمة قال أخبرنا مالك عن يحيى بن سعيد عن محمد بن ابراهيم عن علقمة بن وقاص عن عمر أن رسول الله ﷺ قال « الأعمال بالنية ، ولكل امرىء ما نوى ، فمن كانت هجرته إلى الله ورسوله فهجرته إلى الله ورسوله ، ومن كانت هجرته لدنيا يصيبها أو امرأة يتزوجها فهجرته إلى ما هاجر إليه »

54. Na ka treguar Abdullah b. Mesleme, këtij Maliku, këtij Jahja b. Sa'di, këtij Muhammed b. Ibrahimi, këtij Alkame b. Vekkasi, ky nga Umeri, i cili ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Veprat vlerësohen sipas qëllimit dhe çdo njeriu i përket ajo për të cilën mendon (ka për qëllim). **Kush është shpërngulur për All-llahun dhe për Pejgamberin e Tij, shpërngulja e tij është në emër të All-llahut dhe të Pejgamberit të Tij, ndërkaq, ai që është shpërngulur për shkaqe të mira** (interesa) **të kësaj bote, ose për shkak të ndonjë gruaje, me të cilën do të martohej, shpërngulja e tij është në emër të asaj që është shpërngulur".**

٥٥ — حدثنا حجاج بن منهال قال حدثنا شعبة قال أخبرني عدي بن ثابت قال سمعت عبد الله بن يزيد عن أبي مسعود عن النبي ﷺ قال « إذا أنفق الرجل على أهله يحتسبها فهو له صدقة »

---

nuk e bën, i llogaritet sikur e ka bërë dhjetë herë". Po ashtu, është shënuar se Muhammedi a.s. ka thënë: "Qëllimi i sinqertë i besimtarit është më i mirë se puna e tij".

Autorët islamë konsiderojnë se edhe për punët bujqësore (ekonomike) të kësaj bote do të fitohet shpërblimi i All-llahut xh.sh., nëse qëllimi i tyre përfundimtar ka pasë peshë morale-fetare. Kështu, për shembull, është sevap të ushqehesh, duke dashur që me të të ruash fuqinë fizike të nevojshme për kryerjen e rregullt të namazit, agjërimit dhe për vepra të tjera të këndshme te All-llahu xh.sh., e për njerëzit, të dobishme. Të flesh është sevap, nëse me të dëshiron të freskohesh për të kryer detyrat fetare dhe shoqërore në mënyrë më të vetëdijshme dhe më me këmbëngulësi. Shpërblimin e All-llahut xh.sh. e kanë edhe ata të cilët kanë lidhë kurorë (janë martuar), duke pasë qëllim që me të ta ruajnë moralin, nderin dhe fytyrën, kurse trashëgimtarët e vet t'i ndërtojnë si anëtarë shembullorë të bashkësisë shoqërore.

55. Na ka treguar Haxhxhaxh b. Minhâli, këtij Shu'be, këtij Adî b. Thabiti, ky kishte dëgjuar nga Abdullah b. Jezidi, ky nga Ebu Mes'udi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili ka thënë:

"**Kur njeriu përpiqet ta furnizojë familjen e vet,** (duke llogaritur në shpërblimin e All-llahut), **ajo punë është mirësi për të** (sadaka)".

٥٦ – حدثنا الحَكَمُ بنُ نافعٍ قال أخبرنا شُعَيبٌ عنِ الزُّهْرِيِّ قال : حدَّثني عامرُ بنُ سَعدٍ عن سعدِ ابنِ أبي وَقَّاصٍ أنَّه أخبرَهُ أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ قال « إنَّكَ لنْ تُنْفِقَ نَفَقَةً تَبْتَغي بها وجهَ اللهِ إلاَّ أُجِرْتَ عليها ، حتَّى ما تَجعلُ في فِي امرأتِكَ »

56. Na ka treguar **Hakem b. Nafiu,** këtij i ka tregar Shu'ajbi nga Zuhriu i cili ka thënë se i ka treguar Amir b. Sa'd b. Ebu Vekkasi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"**Me të vërtetë nuk bën asnjë shpenzim, kur me të kërkon kënaqësin e All-llahut. Përkundrazi, për këtë vetëm do të shpërblehesh. Bile** (do të shpërblehesh) **edhe për kafshatën që ia shtie në gojë gruas sate".**

باب قولِ النبيِّ ﷺ « الدينُ النَّصيحةُ للهِ ولرسولِهِ ولأئمَّةِ المسلمينَ وعامَّتِهم » ، وقولِهِ تعالى : ﴿ إذا نَصَحوا للهِ ورسولِهِ ﴾

٥٧ – حدثنا مُسَدَّدٌ قال حدَّثنا يحيى عن إسماعيلَ قال حدَّثني قَيسُ بنُ أبي حازمٍ عنْ جَريرِ بنِ عبدِ اللهِ قال : بايَعْتُ رسولَ اللهِ ﷺ على إقامِ الصلاةِ ، وإيتاءِ الزَّكاةِ ، والنُّصحِ لِكلِّ مُسلمٍ

"Fe (besim) është të mendosh sinqerisht All-llahun, Pejgamberin e tij, udhëheqësin e muslimanëve dhe populltin e tyre"

Është hadithi i Pejgamberit s.a.v.s. Ndërkaq,

All-llahu i Madhëruesëm ka thënë:

"**Kur sinqerisht e mendojnë** (besojnë) **All-llahun dhe Pejgamberin e Tij...".**

57. Na ka treguar Museddedi, këtij i kishte treguar Jahjai, këtij Ismaili, këtij Kajs b. Ebu Hazimi, ky nga Xherir b. Abdullahu, i cili ka thënë:

"Ia kam dhënë betimin (i jam zotuar) **Pejgamberit s.a.v.s. se do të fal namaz, do të jap zeqat dhe, sinqerisht do t'ia mendoj të mirën çdo muslimani".**[52]

---

52 Në pjesën paraprake është theksuar se veprat e njerëzve çmohen vetëm sipas qëllimi të tyre dhe se ato te All-llahu xh.sh. janë të vlefshme e të plotfuqishme nëse janë kryer sinqerisht në emër të All-llahut xh.sh. Kush vepron në pajtueshmëri të plotë me ligjet e All-llaut xh.sh. dhe me udhëzimet e Pejgamberit a.s., ai, pa dyshim, largohet nga të gjitha punët që Feja islame i ndalon, ai, pa dyshim, do ta besojë sinqerisht All-llahun xh.sh. dhe njerëzve do t'ua mendojë të mirën, ashtu si vetvetes.

Nga përmbajtja e hadithit mund të nxirren rregulla të shumta islame. Ky hadith ka zënë vend në të gjitha koleksionet e haditheve të muhadithinëve eminentë. Muslimi shënon se Muhammedi a.s. ka thënë: "Fe (besim) është të mendosh të mirën".

- Kujt? - e patën pyetur të pranishmit.

- All-llahut, Shpalljes së Tij, Pejgamberit të Tij,; eprorëve të muslimanëve dhe popullit të tyre, - qe përgjigjur ai.

Komentatorët e famshëm të hadithit kanë theksuar:

- t'ia mendosh sinqerisht të mirën All-llahut xh.sh. do të thotë: të besosh All-llahun xh.sh. sipas cilësive të Tij, t'i krysh me përkushtim dhe rregullisht detyrat ndaj Tij, t'u largohesh veprave të këqija, t'i pranosh dhuntitë e All-llahut xh.sh. dhe për ta të falenderohesh sinqerisht. E gjithë kjo, megjithatë, do të thotë, t'ia mendosh të mirën vetvetes, sepse All-llahut xh.sh., nuk i duhet.

- t'ia mendosh të mirën Shpalljes së All-llahut xh.sh., do të thotë: të besosh se Kur'ani është Fjalë e All-llahut xh.sh. ta çmosh atë dhe ta përdorësh në jetën praktike, ta studiosh atë dhe t'i përhapësh mësimet e tij.

- t'ia mendosh të mirën Pejgamberit a.s. do të thotë: ta besosh si Pejgamber të All-llahut xh.sh., të veprosh sipas urdhërave të tij: të bësh atë që ai e urdhëron dhe të largohesh nga ajo që ai e ndalon, t'u përmbahesh dhe t'i përhapësh mësimet e tij, ta respektosh e të jesh i gatshëm të sakrifikosh për të dhe për fjalën e tij, të angazhohesh në kryerjen e detyrave që ai i ka kryer dhe t'i mësosh edhe të tjerët t'i kryejnë, të pajisesh me karakterin e tij, ta çmosh origjinën e tij, As-habët e tij, e pastaj ta çmosh çdo njeri fisnik dhe të mirë.

- t'ua mendosh të mirën sinqerisht eprorëve muslimanë, do të thotë: t'u ndihmosh në zbatimin e se drejtës, t'i përkrahësh në luftën e e në rrugën e All-llahut xh.sh. dhe t'u tërhiqet vërejtja në mënyrë të sjellshme për lëshimet e bëra.

- t'ua mendosh të mirën muslimanëve do të thotë: t'i udhëzosh në punë të mbara dhe të dobishme të kësaj dhe të botës tjetër, t'i nxisësh për punë të mira e të urrejnë të keqen. T'ua mendosh të mirën njerëzve është bazë e mësimeve të Islamit. Të mirën t'ia mendosh edhe vetes. Kjo shprehet në kryerjen e sinqertë të detyrave ndaj All-llahut xh.sh., ndaj njerëzve dhe ndaj bashkësisë në përgjithësi.

Betimin në namaz dhe në zeqat Muhammedi a.s. e ka kushtëzuar me betimin në të menduarit të mirën ndaj njerëzve. T'ua mendosh të mirën njerëzve është pjesë përbërëse

٥٨ - حدثنا أبو النُّعمانِ قال حدَّثنا أبو عَوانةَ عن زِيادِ بنِ عِلاقةَ قال سمعتُ جَرِيرَ بنَ عبدِ اللهِ يقولُ يومَ ماتَ المُغيرةُ بنُ شُعبةَ ، قامَ فحَمِدَ اللهَ وأثنى عليهِ وقال : عليكم بتقوى اللهِ وحدَهُ لا شَريكَ لهُ ، والوقارِ والسَّكينةِ ، حتَّى يأتيَكم أميرٌ ، فإنَّما يأتيكمُ الآنَ . ثمَّ قال : استَعفوا لأميرِكم ، فإنَّهُ كانَ يُحِبُّ العَفوَ . ثم قال : أما بعدُ فإنِّي أتيتُ النبيَّ ﷺ قلتُ : أبايِعُكَ على الإسلامِ ، فشَرَطَ عليَّ « والنُّصحِ لِكلِّ مُسلمٍ » ، فبايَعتُه على هذا ، ورَبِّ هذا المسجدِ إنِّي لناصحٌ لَكم . ثمَّ استَغفرَ ونزلَ

58. Na ka treguar Ebu-n-Nu'mani, këtij i ka treguar Ebu Avane, ky nga Zijad b. Ilaka, i cili ka thënë:

E kam dëgjuar Xherir b. Abdullahun në ditën kur vidq Mugire b. Shu'be. Së pari u ngrit dhe e falenderoi All-llahun xh.sh., e pastaj tha: **"Frikojuni vetëm All-llahut, i cili nuk ka shok, bëhuni krenarë dhe të qetë, derisa të vijë një komandant. Ai do të ju vijë së shpejti".**

Pastaj, tha: **"Kërkoni falje** (lutuni) **për komandantin tuaj, sepse All-llahu xh.sh. dëshiron të falë!"** E tash, vazhdon ai, një herë kam shkuar te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i kam thënë: **"Ty të betohem** (të zotohem) **në Islam"**, kurse ai më kushtëzoi: **"Edhe t'ia mendosh sinqerisht të mirën çdo muslimani"**. Unë edhe në atë u zotova. Me të vërtetë ua mendoj të mirën juve!"

Pastaj kërkoi falje dhe u ul.

---

e Islamit, e njëjtë si ato virtyte që u përmendën më sipër.

Xheriri e ka pranuar Islamin në prag të muajit Ramazan në vitin 10 hixhri, 40 ditë para vdekjes së Muhammedit a.s.. Gjatë luftës së Aliut me Muaviun, u shpërngul nga Medina për në Kufe, ku u vendos përgjithmonë. Ishte nga elita e As-habëve. Ishte ndër njerëzit më të ditur, shumë i sinqertë dhe fetar i vetëdijshëm. Para se të blente diçka, i thoshte shitësit:

"Kjo që po e blej është më e dashur për mua se ajo që ta jap ty, prandaj, zgjidhe atë që për ty është më e mirë".

3. Dituria

بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ

٣ - كتاب العلم

باب فضل العلم ، وقول الله تعالىٰ ﴿ يَرْفَعِ اللهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنكُمْ وَالَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ دَرَجَاتٍ ، وَاللهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴾ وقوله عزَّ وجلَّ ﴿ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا ﴾

Bismi-l-Lahi-r-Rahmani-r-Rahim

3. Dituria

Vlera e diturisë (shkencës)

All-llahu i Madhëruesh ëm thotë:

"...All-llahu i ngre në shkallë të lartë ata të cilët besojnë në mesin tuaj dhe ata të cilëve u është dhënë dijenia. All-llahu di se çka punoni ju".

(el-Muxhâdele, 11)

Fjala e All-llahut është edhe:

"... o Zot, ma shto diturinë!"[1]

(Tâhâ, 114)

---

1 Islami i kushton rëndësi të posaçme diturisë, meqë është bazë për përparimin e njerëzve në këtë dhe lumturi në botën tjetër. Në ajetin e parë theksohet se All-llahu xh.sh. do t'i nderojë dhe do t'i ngrejë në shkallë të lartë njerëzit e dijshëm dhe do t'i shpërblejë me

باب مَنْ سُئِلَ عِلْمًا وَهُوَ مُشْتَغِلٌ فِي حَدِيثِهِ فَأَتَمَّ الْحَدِيثَ ثُمَّ أَجَابَ السَّائِلَ

٥٩ - حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ سِنَانٍ قَالَ حَدَّثَنَا فُلَيْحٌ . ح

وحَدَّثَنِي إِبْرَاهِيمُ بْنُ الْمُنْذِرِ قَالَ حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ فُلَيْحٍ قَالَ حَدَّثَنِي أَبِي قَالَ : حَدَّثَنِي هِلَالُ بْنُ عَلِيٍّ عَنْ عَطَاءِ بْنِ يَسَارٍ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ : بَيْنَمَا النَّبِيُّ ﷺ فِي مَجْلِسٍ يُحَدِّثُ الْقَوْمَ جَاءَهُ أَعْرَابِيٌّ فَقَالَ : مَتَى السَّاعَةُ ؟ فَمَضَى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يُحَدِّثُ . فَقَالَ بَعْضُ الْقَوْمِ : سَمِعَ مَا قَالَ فَكَرِهَ مَا قَالَ ، وَقَالَ بَعْضُهُمْ : بَلْ لَمْ يَسْمَعْ . حَتَّى إِذَا قَضَى حَدِيثَهُ قَالَ : أَيْنَ أُرَاهُ السَّائِلُ عَنِ السَّاعَةِ ؟ قَالَ : هَا أَنَا يَا رَسُولَ اللَّهِ . قَالَ : « فَإِذَا ضُيِّعَتِ الأَمَانَةُ فَانْتَظِرِ السَّاعَةَ » . قَالَ : كَيْفَ إِضَاعَتُهَا ؟ قَالَ : « إِذَا وُسِّدَ الأَمْرُ إِلَى غَيْرِ أَهْلِهِ فَانْتَظِرِ السَّاعَةَ »

Ai që është pyetur për dituri

E, ai ishte i zënë me fjalimin e tij dhe, pasi e mbaroi fjalimin, iu përgjigj atij që e pyeti:

59. Na ka treguar Muhammed b. Sinani, këtij i kishte treguar Fulejhu, e sipas një vargu tjetër të transmetuesve, më ka treguar Ibrahim b. Mundhiri, këtij Muhammed b. Fulejhu, këtij babai i vet, këtij Hilal b Aliu, ky nga Ata b. Jesari, ky nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

Derisa Pejgamberi s.a.v.s. në një rast ishte duke folur para popullit, erdhi një beduin dhe pyeti: **"Kur do të jetë Çasti i Kijametit?"**

Pejgamberi s.a.v.s., megjithatë, vazhdoi të flasë. Disa njerëz (të pranishëm aty) thanë se Pejgamberi s.a.v.s. e dëgjoi se çka e pyeti ai, por nuk i pëlqeu ajo që ai pyeti, kurse disa të tjerë thanë se Pejgamberi s.a.v.s. nuk e dëgjoi fare.

---

pozita më të larta se të tjerët, si në këtë botë, si në botën tjetër, kurse ajeti i dytë, vë theksin në atë se Muhammedi a.s. e lakmonte shkencën më shumë se pasurinë. Ai kërkonte gjithnjë t'i shtohej dijenia dhe përpiqej gjithnjë t'i shtohej mëth i të diturve.

Edhe Musai a.s., posa dëgjoi se Hidri ishte më i dijshëm se ai, u nis ta kërkojë atë dhe iu nënshtrua kushteve të tij, duke dashur të mësojë gjëra të reja. Prej tij Musai a.s. mësoi shumë fshehtësi.

Në disa hadithe shihet në mënyrë të qartë se njerëzit e dijshëm, për nga autoriteti qëndrojnë menjëherë pas Pejgamberëve, se janë trashëgimtarë të Pejgamberëve të All-llahut xh.sh.; mësues të Shpalljes së All-llahut xh.sh.

Kur Pejgamberi s.a.v.s. e mbaroi fjalimin e tij, si duket, pyeti:

"Ku është ai që, mendoj se pyeti për Çastin e Kijametit?"

"Ja, unë, o Resulullah", u përgjigj beduini.

"Momentin e Kijametit prite, kur të zhduket siguria" u përgjigj.

"Si do të shkatërrohet?" ishte pyetja tjetër.

"Kur t'i besohet detyra atij që nuk është për të i aftë dhe kompetent, prite Ditën e Kijametit", tha (pejgamberi s.a.v.s.).[2]

باب مَن رَفَعَ صَوْتَهُ بالعِلْمِ

٦٠ – حدثنا أبو النُّعمانِ عارِمُ بنُ الفَضلِ قال حدَّثَنا أبو عَوانَةَ عنْ أبي بِشْرٍ عن يوسُفَ بنِ ماهَكَ عن عبدِ اللهِ بنِ عمرٍو قال : تَخلَّفَ عنَّا النبيُّ ﷺ في سَفْرَةٍ سافَرْناها ، فأدْرَكَنا وقد أرْهَقَتْنا الصلاةُ ونحنُ نَتَوَضَّأُ ، فجَعَلْنا نَمْسَحُ على أرْجُلِنا ، فنادَى بأعْلَى صَوْتِهِ « ويْلٌ للأعْقابِ مِنَ النارِ » مَرَّتَيْنِ أو ثلاثًا

---

2 Në pjesën paraprake u theksua vlera e njerëzve të dijshëm, e në këtë pjesë jipen udhëzime për qëndrimin ndaj atyre që kërkojnë dituri. Çasti vendimtar, në kuptimin figurativ, në çrregullimin e sistemit shoqëror, mund të jetë lënia e punëve njerëzve jokompetentë, të pandërgjegjshëm dhe të pamoralshëm. Njerëzit e këtillë, do t'i bënin bisht besimit që u është dhënë dhe me punën e vet do ta shpinin shoqërinë në anarki dhe në shkatërrim. Besimin ndaj njerëzve duhet vërtetuar. Detyrat shoqërore duhet t'u besohen atyre që janë meritorë. Në të kundërtën bëhet gabim i madh. Çrregullimi, ngecja e shoqërisë zakonisht janë pasoja të mosdijes së njerëzve përgjegjës.

Muhammedi a.s. nuk u përgjigj menjëherë në pyetjen e shtruar, sepse qe i zënë me biseda dhe përgjigje të pyetjeve të shtruara më parë nga ana e As-habëve. Disa mendojnë se për pyetjen që iu bë, ai ka pritur Shpalljen e All-Ilahut xh.sh.

Nga hadithi nxirret përfundimi:

- pyetjeve duhet t'u përgjigjesh në mënyrë të hollësishme;
- dijetarit duhet t'i drejtohesh në kohë të përshtatshme dhe të lirë;
- gjatë përgjigjeve dhe shpjegimeve duhet të tregosh maturi dhe butësi, po edhe në qofshin pyetjet pa vend, e personi, i papërshtatshëm dhe i vrazhdë;
- pala mund të kërkojë shpjegime të hollësishme, derisa çështja të bëhet e qartë dhe e kuptueshme;
- dijetari përgjigjet shkurt, e sipas nevojës edhe më gjatë;
- përparësi për t'iu përgjigjur kanë ata që paraqitën të parët.

Ai që e ngre zërin e tij për dijeni

60. Na ka treguar Ebu-n-Nu'man Arim b. Fadili, këtij i kishte treguar Avane, ky nga Ebu Bishri, ky nga Jusuf b. Maheku, ky nga Abdullah b. Amri, i cili ka thënë:

Në një udhëtim që e patëm, Pejgamberi s.a.v.s. mbeti pas nesh. Na mbërrini kur koha për faljen e namazit, ishte kah mbarimi. Ne morëm abdest dhe filluam t'u japim mes-h këmbëve (filluam t'i lajmë këmbët me shumë pak ujë), prandaj, (Pejgamberi a.s.) me një zë të lartë, bërtiti dy a tri herë:

"Mjerë thembrat (që do të digjen) **nga zjarri i Xhehennemit!".**[3]

باب قول المحدث « حدثنا » أو « أخبرنا » و « أنبأنا » . وقال لنا الحميدي : كان عند ابن عيينة حدثنا وأخبرنا وأنبأنا وسمعت واحداً . وقال ابن مسعود : حدثنا رسول الله ﷺ وهو الصادق المصدوق . وقال شقيق عن عبد الله : سمعت النبي ﷺ كلمة . وقال حذيفة حدثنا رسول الله ﷺ حديثين . وقال أبو العالية : عن ابن عباس عن النبي ﷺ فيما يروي عن ربه . وقال أنس : عن النبي ﷺ يرويه عن ربه عز وجل . وقال أبو هريرة : عن النبي ﷺ يرويه عن ربكم عز وجل

3 Disa muhaddithë mendojnë se ca As-habë kanë dashur vetëm t'i fshijnë këmbët me dorë të lagur (t'u japin mes-h), ashtu siç kanë vepruar me kryet, që të përgatiten më shpjet për namazin e iqindisë, koha e të cilit ka qenë kah mbarimi. Disa mendojnë se ca prej tyre kanë dashur t'i lajnë këmbët vetëm sipërfaqësisht, duke dashur të ruajnë ca ujë për të pirë dhe për nevoja të tjera. Muhammedi a.s. ua tërhoqi vërejtjen për pasojat e rënda të një veprimi të tillë dhe se këmbët duhet larë sikurse pjesët e tjera të trupit (gjatë abdestit).
Nga hadithi mund të konkludohet:
- larja e këmbëve gjatë abdestit është detyrim parësor (farz). Larja e këmbëve sipërfaqësisht, ose fshirja e tyre me dorë të lagur nuk është i vlefshëm;
- gjymtyrët e abdestit duhet të lahen mirë. Lënia pa larë e një pjese sado të vogël e bën abdestin jo të plotë dhe të pavlefshëm;
- këshillimi për ndonjë lëshim eventual të ndonjë parregullsie dhe shkelje ligjore mund të bëhet në mënyrë të matur dhe me zë të lartë;
- njerëzit e dijshëm e kanë për detyrë t'i mësojnë të padijshmit dhe t'ua tërheqin vërejtjen për pasojat nga mosdija.

"Na ka treguar", ose, **"na ka njoftuar"**, ose, **"na ka lajmëruar".**

Humejdiu na ka thënë:

Ibni Ujejne i ka përdorë shprehjet: **"Na ka treguar", "na ka njoftuar", "na ka lajmëruar"** dhe **"kam dëgjuar njërin".**

Ibni Mes'udi ka thënë: **"Na ka treguar Pejgamberi s.a.v.s. e ai është i sinqertë dhe i drejtë. Atij, sinqerisht i besohet".**

Shekiku, duke transmetuar nga Abdullahu, është shprehur: **"Kam dëgjuar nga Pejgamberi s.a.v.s. një fjalë"**, kurse Hudhejfja ka thënë: **"Pejgamberi s.a.v.s. na ka treguar dy hadithe".**[4]

Ebu-l-Âlije, duke transmetuar nga Ibni Abbasi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. transmeton nga Zoti i tij".

Enesi ka thënë: **"Nga Pejgabmeri s.a.v.s., e ai transmeton nga Zoti i tij i Madhërueshëm".**

Ebu Hurejre thotë: **"Nga Pejgamberi s.a.v.s., e ai transmeton nga Zoti juaj i Madhërueshëm".**[5]

---

4 Buhariu i thekson shprehjet e sipërshënuara, duke dashur të vë në dukje se ato janë sinonime dhe shprehje terminologjike, të cilat në shkencën e hadithit kanë vlerë të njëjtë. Në mes këtyre shprehjeve nuk ka ndonjë dallim të theksuar në kuptim. Prandaj, disa As-habë si dhe disa muhaddithë të mëvonshëm i kanë përdorur në mënyrë të barabartë për transmetimin e hadithëve.

5 Me shembujt e lartpërmendur Buhariu thekson se në vargun e transmetuesve të hadithit njëri nga tjetri, mund të përdoret edhe parafjala *"nga, prej"* (ar. *'an*), në vend të shprehjes së plotë "kam dëgjuar", "na ka treguar", "na ka njoftuar" etj. Këto janë hadithe të vlefshëm dhe të plotëfuqishëm, të njohur në shkencën e hadithit si "hadithe mu'an'an", nga vetë parafjala "an", d.m.th. "nga, prej" nënkuptohet se transmetuesit e hadithit janë takuar dikund, kanë biseduar dhe në atë rast kanë dëgjuar hadithin përkatës nga njëri-tjetri. Parafjala "'an", e ka të njëjtën rëndësi edhe në hadithin "kudsijj".

٦١ — حدثنا قتيبة حدثنا إسماعيل بن جعفر عن عبد الله بن دينار عن ابن عمر قال : قال رسول الله ﷺ « إن من الشجر شجرة لا يسقط ورقها ، وإنها مثل المسلم ، حدثوني ما هي ؟ فوقع الناس في شجر البوادي . قال عبد الله : ووقع في نفسي أنها النخلة ، فاستحييت . ثم قالوا : حدثنا ما هي يا رسول الله . قال : هي النخلة »

61. Na ka treguar Kutejbe, këtij Ismail b. Xha'feri, ky nga Abdullah b. Dinari, ky nga (Abdullah) Ibni Umeri, i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"Është një pemë (dru) **të cilës nuk i bien gjethet. Është e njëjtë me muslimanin. Më thuani cila është ajo?".**

Njerëzit menduan për ndonjë pemë të shkretëtirës. Abdullahu tha:

"Unë kam menduar se ajo pemë (dru) **është hurma, por kam pasur turp të them".**

Pastaj të pranishmit thanë: **"O Pjegamber i All-llahut, na thuaj cila është ajo pemë?"**

Pejgamberi s.a.v.s. u përgjigj:

"Ajo pemë (dru) **është hurma".**[6]

---

6 Në senedin e hadithit të lartshënuar janë përdor shprehjet "na ka treguar", "na ka njoftuar" e të ngjashme. Këto shprehje janë përdorur edhe në shumë hadithe të tjerë.

Abdullah b. Umeri ka marrë pjesë në atë mbledhje, por ka pasë turp që, si fëmijë dhjetëvjeçar, të përgjigjet në pyetjen e parashtruar dhe me këtë t'i turpërojë të moshuarit.

Muhammedi a.s. e krahasoi hurmën me muslimanin, sepse ajo është e dobishme për njerëzit, sikur muslimani për shoqërinë. Hurma është pema më e dobishme e Lindjes, jeton gjatë dhe fruti i saj përdoret edhe kur është i njomë edhe kur është i thatë, kurse lëvozhgat e saj përdoren për ushqimin e deves. Druri i hurmës përdoret për ndërtimtari dhe për djegie, pastaj edhe për përpunimin e enëve prej druri.

Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- është e arsyeshme të shtrosh pyetje nganjëherë, me qëllim që të provohet dijenia dhe njëkohësisht të jetë nxitje për angazhimin e të menduarit;
- me njerëzit e famshëm dhe të moshuar duhet të sillesh mirë dhe të flasësh me maturi; respektivisht të flasësh sa më pak;
- turpi është karakteristikë pozitive e njeriut. Varësisht nga situata, mund të jesh më i lirë. Kështu, Umerit i ka ardhë keq që fëmija, për shkak të turpit të tepruar, nuk qe

باب طرح الإمام المسألة على أصحابه ليختبر ما عندهم من العلم

٦٢ – حدثنا خالد بن مخلد حدثنا سليمان حدثنا عبد الله بن دينار عن ابن عمر عن النبي ﷺ قال « إن من الشجر شجرة لا يسقط ورقها وإنها مثل المسلم ، حدثوني ماهي ؟ قال فوقع الناس في شجر البوادي . قال عبد الله : فوقع في نفسي أنها النخلة . ثم قالوا : حدثنا ماهي يا رسول الله ؟ قال : هي النخلة

Të parashtruarit e pyetjeve para dëgjuesve për të provuar dijen e tyre

62. Na ka treguar Halid b. Mahledi, këtij Sulejmani, këtij Abdullah b. Dinari, ky nga Ibni Umeri, i cili ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Është një pemë, gjethet e së cilës nuk bien; ajo i ngjan muslimanit. Më tregoni, cila është ajo?"

Abdullahu ka thënë: **"Njerëzit menduan për ndonjë pemë të shkretëtirës, kurse mua më shkoi mendja se ajo** (pemë) **është hurma".**

Pastaj të pranishmit pyetën: **"O Resulullah, na thuaj cila është ajo?"**

Pejgamberi s.a.v.s. u përgjigj:

"Ajo pemë është hurma".

---

përgjigjur në pyetjen e parashtruar;

- njeriu mund të merret dhe mund të përdorë fjalë të urta, proverba, sepse kështu, e aftëson të menduarit;

- njeriu i kthjellët, edhe pse mund të jetë i pamësuar (i pashkolluar) nganjëherë mund të përgjigjet më mirë se i mësuari. Mendja edhe mendjemprehtësia janë dhunti të All-llahut xh.sh., e Ai ua jep atyre që do;

- hurma është pema më e dobishme në Lindje. Në Kur'an përmendet me emrin "pemë e mirë". Feja e forcon shpirtin dhe moralin e njerëzve, kurse hurma e ruan jetën dhe fuqinë fizike. Veprat e mira të besimtarit janë të ngjashme me frutet e hurmës.

باب ما جاء فى العلم ، وقوله تعالى ﴿ وقل رب زدنى علما ﴾

القراءة والعرض على المحدث . ورأى الحسن والثورى ومالك القراءة جائزة . واحتج بعضهم فى القراءة على العالم بحديث ضمام بن ثعلبة قال للنبى ﷺ : آلله أمرك أن تصلى الصلوات ؟ قال نعم . قال فهذه قراءة على النبى ﷺ ، أخبر ضمام قومه بذلك فأجازوه . واحتج مالك بالصك يقرأ على القوم فيقولون : أتشهدنا فلان ، ويقرأ ذلك قراءة عليهم . ويقرأ على المقرئ فيقول القارىء : أقرأنى فلان . حدثنا محمد بن سلام حدثنا محمد بن الحسن الواسطى عن عوف عن الحسن قال : لا بأس بالقراءة على العالم . وأخبرنا محمد بن يوسف الفربرى وحدثنا محمد بن إسماعيل البخارى قال حدثنا عبيد الله بن موسى عن سفيان قال : إذا قرىء على المحدث فلا بأس أن تقول : حدثنى . قال : وسمعت أبا عاصم يقول عن مالك وسفيان : القراءة على العالم وقراءته سواء

Lidhur me diturinë (hadithin)

All-llahu i Madhëruesh ëm thotë:

"...dhe thuaj, o Zot ma shto mua diturinë".

(Tâhâ, 114).

Të lexuarit dhe të paraqiturit e tekstit të hadithit para muahaddithit.

Hasani, Thevriu dhe Maliku kanë konstatuar se të lexuarit e tekstit të hadithit para muhaddithit është i lejueshëm. Të lexuarit e tekstit (të hadithit) para dijetarit disa perj tyre e mbështesin me hadithin që e transmeton Dimam b. Tha'lebe, i cili e kishte pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"A të ka urdhëruar ty All-llahu të falim namaze?"

"Po", i qe përgjigjur Pejgamberi s.a.v.s.

Dhe ky është citimi (leximi) **i tekstit para Pejgamberit s.a.v.s., tha ai** (Dimam b. Tha'lebe.

Dimami në këtë mënyrë ia ka transmetuar popullit të vet dhe ata ia kanë pranuar (lejuar) këtë.[7]

---

7 Dimam b. Tha'lebe në vitin 9 hixhri i priu delegacionit të fisit të vet dhe gjatë bisedës i parashtroi pyetje Muhammedit a.s., i cili i qe përgjigjur vetëm me "po" ose "jo". Dimami edhe pyetjet edhe përgjigjet ia transmetoi tekstualisht fisit të vet dhe shtoi: "All-llahu e ka dërguar Pejgamber këtu dhe i ka dhënë Librin, e unë tash ua kam sjellur çka urdhëron e çka ndalon. Për Zotin, unë nuk lëviz nga vendi, derisa ju, burra e gra të pranoni Islamin".

Maliku këtë e argumenton me letrën që u lexohet njerëzve. Ata pastaj të thonë: **"Na ka dëshmuar filani"**, e ajo vetëm u lexohet atyre. Teksti mund t'i lexohet ndonjërit, i cili, pastaj t'ia lexojë tjetrit, e ky lexues të thotë: **"Ma ka lexuar filani"**.[8]

Na ka treguar Muhammed b. Selami, këtij Muhammed b. Hasan el-Vasiti, ky nga Avfi,e ky nga Hasani, i cili ka thënë:

"Nuk ka diçka të keqe (dëm) **që teksti** (i hadithit) **të lexohet para dijetarit"**.[9]

Na ka treguar Muhammed b. Jusuf Firebriu, këtij Muhammed b. Ismail el-Buhariu, ky nga Ubejdullah b. Musai, ky nga Sufjani, i cili ka thënë:

Kur para muhaddithit lexohet (teksti i hadithit), nuk ka diçka të keqe që pastaj të thuhet: **"Më ka treguar..."**.

E kam dëgjuar Ebu Asimin, thotë Buhariu, i cili transmeton nga Maliku dhe Sufjani: **"Të cituarit** (të lexuarit) **e tekstit të hadithit para dijetarit dhe leximi i tij i mëtutjeshëm** (të tjerëve) **ka të njëjtën vlerë"**.[10]

---

8 Ibni Batali thotë: "Të bazohesh në dëshmitarë gjatë riprodhimit të ndonjë teksti, ose në thënien e ndonjërit, është argumenti më i sigurtë dhe dokumenti më bindës për besnikërinë e rastit përkatës".
Ibni Vehbi thotë se Malikut i është sjellur një tekst dhe është pyetur: "A mund të thuhet se ti e ke thënë ose e ke transmetuar"?
- Mundet, - qe përgjigjur Maliku.
Nxënësit e Malikut pohojnë se nuk e kanë parë Malikun asnjëherë që ai, personalisht, ta ketë lexuar përmbledhjen e tij të hadithëve. Përmbledhjen e tij "Muvetta" ia kanë lexuar gjithnjë nxënësit e tij. Maliku nuk ka qenë asnjëherë ithtar i mendimit që teksti i hadithit duhet domosdo të dëgjohet vetëm nga goja e Muhammedit a.s.
Mjafton që muhaddithi ta shikojë tekstin e hadithit, ose vetëm të lexohet para tij dhe ai të lejojë se i njëjti mund të përshkruhet dhe të thuhet se ai e ka thënë, ose e ka transmetuar.

9 Të njëjtin qëndrim e tregoi Ahmed b. Hambeli në "Musnedin" e tij, lidhur me rastin që vijon: "Një njeri i ka thënë Hasan Basriut se banesa e tij është larg xhamisë dhe se kundërthëniet në tekstet e hadithit vështirë i pranon, prandaj, do të kishte dëshiruar që me rastin e ardhjes në ligjërata t'i lexojë hadithet e veta".
Hasan Basriu i qe përgjigjur: "Nuk jam kundër, do t'i lexoja unë ty, ti mua".
- A mund të them pastaj që m'i ka treguar Hasan Basriu? - pyeti njeriu.
- Po, thuaj! m'i ka treguar Hasan Basriu.

10 Një lagje muhaddithësh nuk e përfillin mendimin e Buhariut". Disa pohojnë se teksti i

٦٣ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال : حدَّثنا الليثُ عنْ سعيدٍ – هو المَقْبُرِيُّ – عنْ شَرِيكِ بنِ عبدِ اللهِ بنِ أبي نَمِرٍ أنَّه سَمِعَ أنَسَ بنَ مالكٍ يقول : بَيْنَا نحنُ جُلوسٌ معَ النبيِّ ﷺ في المسجدِ دَخَلَ رَجُلٌ على جَمَلٍ فأناخَهُ في المسجدِ ثمَّ عَقَلَهُ ثمَّ قال لهم : أيُّكُمْ محمدٌ – والنبيُّ ﷺ مُتَّكِئٌ بَيْنَ ظَهْرَانَيْهِمْ – فقلنا : هذا الرجُلُ الأبيضُ المُتَّكِئُ ، فقال له الرجُلُ : ابنَ عبدِ المطَّلِبِ . فقال له النبيُّ ﷺ : قد أجَبْتُكَ : فقال الرجلُ للنبيِّ ﷺ : إني سائِلُكَ فمُتَشَدِّدٌ عليكَ في المَسألةِ ، فلا تَجِدْ عليَّ في نَفْسِكَ . فقال : سَلْ عمَّا بَدا لكَ . فقال : أسألُكَ بِرَبِّكَ ورَبِّ مَنْ قَبْلَكَ ، آللهُ أرسلَكَ إلى الناسِ كُلِّهِمْ ؟ فقال : اللهمَّ نَعَم . قال : أنشُدُكَ باللهِ ، آللهُ أمَرَكَ أنْ نُصَلِّيَ الصَّلَواتِ الخَمْسَ في اليومِ والليلةِ ؟ قال : اللهمَّ نَعَم . قال : أنشُدُكَ باللهِ ، آللهُ أمَرَكَ أنْ نَصومَ هذا الشهرَ مِنَ السَّنَةِ ؟ قال : اللهمَّ نَعَم . قال : أنشُدُكَ باللهِ ، آللهُ أمَرَكَ أنْ تأخُذَ هذه الصَّدَقَةَ مِنْ أغنيائِنا فتَقْسِمَها على فُقَرائِنا ؟ فقال النبيُّ ﷺ : اللهمَّ نَعَم . فقال الرَّجُلُ : آمَنْتُ بما جِئْتَ بهِ . وأنا رسولُ مَنْ وَرائي مِن قَومي ، وأنا ضِمامُ بنُ ثَعْلَبَةَ أخو بني سَعْدِ بنِ بَكْرٍ . رواه مُوسى وعليُّ بنُ عبدِ الحميدِ عنْ سُلَيمانَ عن ثابتٍ عن أنسٍ عنِ النبيِّ ﷺ بهذا

63. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtë e kishte njoftuar Lejthi, këtë Se'id Makburiu, këtë Sherik b. Abdullah b. Ebu Nemiri, i cili e kishte dëgjuar Enes b. Malikun, duke thënë:

Derisa rrinim me Pejgamberin s.a.v.s. në xhami, erdhi një njeri hypur në deve. E ndali aty (deven) dhe e lidhi, e pastaj u drejtua kah ne dhe pyeti: **"Cili nga ju është Muhammedi"?**

Pejgamberi s.a.v.s. qëndronte i mbështetur në mesin e tyre, prandaj ne u përgjigjem:

"Ky njeri i bardhë, i mbështetur"!

Pastaj, njeriu iu drejtua (Pejgamberit s.a.v.s.):

"O djali i Abdu-l-Muttalibit"!

---

hadithit i cituar ose i lexuar nga vetë muhaddithi, ose nga ligjëruesit, është më i vlefshëm dhe më i besueshëm se hadithi që i është cituar muhaddithit tekstualisht, e ai pasi ta ketë dëgjuar ka dhënë vetëm pëlqimin e vet se i njëjti hadith mund t'i transmetohet tejtrit më tutje.

Mendimin e Buhariut e kanë mbështetur Maliku, Sufjani dhe muhaddithët e Hixhazit, Kufes dhe të Medines.

"Të përgjigjem", tha Pejgamberi s.a.v.s.

Ai vazhdoi: **"Do të pyes ty dhe në çdo pyetje do të jem i ashpër, por mos m'u hidhëro"!**

"Pyet ç'të duash! i tha Pejgamberi s.a.v.s.

Po të pyes, pashë Zotin tënd dhe Zotin e atyre para teje (thuaj): **"A të ka dërguar ty All-llahu për gjithë botën** (njerëzimin)".

"Po, pa dyshim", iu përgjigj Pejgamberi s.a.v.s.

Pashë All-llahun: **"A të ka urdhëruar All-llahu të falim pesë kohët e namazit gjatë një dite dhe një nate"**, pyeti ai.

"Po, për Zotin", iu përgjigj.

Pashë All-llahun, tha përsëri njeriu: **"A të ka urdhëruar All-llahu të agjërojmë muajin e Ramazanit për çdo vit"?**

"Po, pa dyshim", u përgjigj.

Pashë All-llahun: **"A të ka urdhëruar All-llahu që nga pasanikët tanë të marrësh këtë sadaka** (zeqat) **dhe t'ua ndash të varfërve tanë"?** pyeti.

"Po, për Zotin", iu përgjigj Pejgamberi s.a.v.s.

Pastaj njeriu tha: **"Besoj në gjithë atë që e ke sjellë** (nga All-llahu xh.sh.). **Unë jam Dimam b. Tha'lebe, vëllai i Beni Sa'd b. Bekrit, përfaqësues i populllit tim, i cili ka mbetur pas meje".**

Këtë hadith kështu e ka transmetuar edhe Musai dhe Ali b. Abdu-l-Hamidi nga Sulejmani, ky nga Thabiti, ky nga Enesi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s.[11]

---

11 Për kohën e kalimit të Dimamit në Islam historianët kanë mendime të ndryshme. Buhariu dhe disa të tjerë mendojnë se Dimami e ka pranuar Islamin para takimit me Muhammedin a.s.

Dialogun e sipërpërmendur Buhariu e merr si argument për plotfuqishmërinë e tekstit të hadithit, i cili As-habit ose ligjëruesit vetëm i është prezentuar dhe ai e ka miratuar se i njëjti (hadith) mund t'u transmetohet të tjerëve më tutje.

Nga hadithi mund të konkludohet:

- *duhet t'i besohet muslimanit të pashkolluar, i cili nuk di ta shprehë besimin e vet me* argumente. Muhammedi a.s. u pajtua me qëndrimet e Dimamit, duke mos kërkuar nga ai të di t'i arsyetojë;

بابُ ما يُذْكَرُ فِي المُنَاوَلَةِ ، وكِتَابِ أَهْلِ العِلْمِ بِالعِلْمِ إِلَى البُلْدَانِ

وقال أنسٌ : نَسَخَ عُثمانُ لِلمَصاحِفِ فَبَعَثَ بِها إِلَى الآفاقِ ، ورَأَى عبدُ اللهِ بنُ عُمرَ ويحيى بنُ سَعِيدٍ ومالِكٌ ذٰلِكَ جائِزاً . واحتجَّ بعضُ أهلِ الحِجازِ فِي المُنَاوَلَةِ بِحَدِيثِ النبيِّ ﷺ حَيثُ كَتَبَ لِأَمِيرِ السَّرِيَّةِ كِتاباً وقال : لا تَقْرَأْهُ حتّى تَبْلُغَ مَكانَ كذا وكذا ، فلما بَلَغَ ذٰلِكَ المَكانَ قَرَأَهُ عَلَى الناسِ وأَخْبَرَهُم بِأَمرِ النبيِّ ﷺ

Transmetimi i hadhitheve në mënyrë autoritative dhe të shkruarit e tyre

Enesi ka thënë: "(Halifja) **Uthmani është angazhuar të shkrueht Mus-hafi (Kur'ani) dhe të dërgohet në vende të tjera"**, kurse Abdullah b. Umeri, Jahja b. Se'idi dhe Maliku këtë veprim e kanë konsideruar të arsyeshëm.

Disa dijetarë të Hixhazit (të shkruarit e hadhitheve) e arsyetojnë me rastin e Pejgamberit s.a.v.s., i cili i kishte shkruar një komandanti letër dhe i kishte thënë:

"Mos e lexo derisa të arrish në filan e filan vend"!

Kur arriti ai në atë vend, ua lexoi njerëzve (popullit) letrën dhe i njoftoi për urdhërin e Pejgamberit s.a.v.s.[12]

- informimi i njeriut të besueshëm është i vlefshëm (i plotfuqishëm). Fisi Beni Sa'd e pranoi pa ndonjë vërejtje porosinë e Muhammedit a.s. përmes Dimamit;
- në shoqëri duhet të sillesh mirë, në mënyrë njerëzore;
- epitetet dhe ofiqet: i bardhë, i zi, i lartë, i ulët e të ngjashme, mund t'u jipen njerëzve vetëm me lejen e tyre;
- është e lejueshme t'i përbetohesh dikujt, duke dashur nga ai të të njoftojë për gjendjen e vërtetë, e disa deklarata nganjëherë duhet të vërtetohen te autori;
- para hyrjes në temë, duhet paraqitur hyrje gjegjëse, me të cilën bashkëbiseduesi të inkuadrohet më lehtë në të;
- njerëzit duhet të thirren me emrin e tyre të plotë, e jo me ofiqe, ose me emra të deformuar.

12 Në terminologjinë e shkencës së hadithit fjala "munâvelet" do të thotë se ligjëruesi citon ose paraqet tekstin e hadithit përkatës, përkatësisht, deklaratën deri te autori, e pastaj të shënojë se prej tash dëgjuesit mund t'ua transmetojnë të tjerëve. Këtë shënim të transmtuesit Buhariu e konsideron kusht për transmetimin e drejtë të mëtejmë të besueshmërisë së hadithit.

٦٤ — حدثنا إسماعيل بن عبد الله قال حدثني إبراهيم بن سعد عن صالح عن ابن شهاب عن عبيد الله بن عبد الله بن عتبة بن مسعود أن عبد الله بن عباس أخبره أن رسول الله ﷺ بعث بكتابه رجلا وأمره أن يدفعه إلى عظيم البحرين، فدفعه عظيم البحرين إلى كسرى، فلما قرأه مزقه، فحسبت أن ابن المسيب قال: فدعا عليهم رسول الله ﷺ أن يمزقوا كل ممزق

64. Na ka treguar Ismail b. Abdullahu, këtij i kishte treguar Ibrahim b. Sa'di, këtij Salihu, këtij Ibni Shihabi, këtij Ubejdullah b. Utbe b. Mes'udi se Abdullah b. Abbasi e kishte lajmëruar këtë se Pejgamberi s.a.v.s. e kishte dërguar një njeri me letrën e tij dhe e kishte urdhëruar që (letrën) t'ia dorëzojë mëkëmbësit të Bahrejnit, e që ky t'ia dërgojë mbretit të Persisë. Ky (mbreti) pasi e lexoi, e shkyu.

(Ibni Shihabi, i cili ishte njëri nga transmetuesit) tha: Mendoj se e kam dëgjuar nga Ibni Musejjebi, duke thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. i malloki që edhe ata të jenë plotësisht të shkatërruar.[13]

Transmetimi i hadithit dhe i diturive të tjera me shkrim, është punë e vlefshme. Metoda e transmetimit është: transmetuesi i hadithit, t'ia paraqesë dikujt hadithin me shkrim, bashkë me senedin, deri te autori, me vërejtje ose pa të, që ai mund t'ua transmetojë të tjerëve më tutje, duke thënë "më ka treguar filani e filani....".

Komandant i grupit të përmendur në hadithin në fjalë ishte Abdullah b. Xhahshi, vëllai i Zejnebes, bashkëshortes së Muhammedit a.s. Pejgamberi a.s. e dërgoi këtë grup të përbërë prej 8 vetësh muhaxhirë në drejtim të Mekkes për të vështruar situatën; e dërgoi në ditët e para të muajit rexheb të viti 8 hixhri.

Muhammedi a.s. në atë rast ia dorëzoi me shkrim komandantit të njësisë edhe instruksionet, duke i thënë që letrën ta hapë pasi të arrijë në vendin e caktuar, e pastaj të punojë sipas përmbajtjes së letrës. Vëzhguesit nuk reaguan ndaj kësaj. Komandanti e hapi letrën në vendin e caktuar dhe i njoftoi shokët se duhet të lëshohen në luginën e Mekkes dhe Taifit dhe atje të vëzhgojnë situatën dhe përgatitjet e Kurejshitëve. Vëzhguesit e kësaj njësie e vranë një njeri dhe dy i zunë robër. Muhammedi a.s. i qortoi ata për këtë vepër, meqë ishte muaji rexheb, në të cilin paqa dhe siguria ishin të garantuara.

13 Në vitin 7 hixhri, Muhammedi a.s. u dërgoi mesazhe mbretërve të vendeve fqinje. Një nga ata mesazhe është edhe letra që përmendet në hadithin e lartshënuar që i është dërguar guvernatorit të Bahrejnit, Mundhir b. Savait, përmes Ala b. Hadremit, me vërejtje që ai

٦٥ — حدثنا محمد بن مقاتل أبو الحسن أخبرنا عبد الله قال أخبرنا شعبة عن قتادة عن أنس بن مالك قال : كتب النبي ﷺ كتابا ـ أو أراد أن يكتب ـ فقيل له : إنهم لا يقرءون كتابا إلا مختوما ، فاتخذ خاتما من فضة نقشه : محمد رسول الله . كأني أنظر إلى بياضه في يده ، فقلت لقتادة : من قال نقشه محمد رسول الله ؟ قال : أنس

65. Na ka treguar Muhammed b. Mukatil Ebu-l-Hasani, këtij Abdullahu, këtij Shu'be, këtij katade, këtij Enes b. Maliku, i cili ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. ka shkruar letër, ose ka dashur të shkruajë, por i është thënë se ata do ta lexojnë letrën vetëm nëse është e vulosur". Atëherë, e ka marrë unazën e argjentë në të cilën ishte gdhendur: **"Muhammedi, Pejgamber i All-llahut"**. Më vjen sikur po e shoh unazën në dorën e tij.

Pastaj, e kam pyetur Kataden, tha Shu'be: **"Kush ka thënë se në unazë qëndronte: "Muhammedi, Pejgamber i All-llahut".**

Ai, Enesi, u përgjigj, (Katade).[14]

---

t'ia dërgojë mbretit të Persisë, Perviz b. Hurmuz b. Enushirvanit. Mbreti e lexoi letrën, pastaj e grisi dhe e hodhi, e atë që ia dorëzoi letrën e përbuzi dhe e përzuri. Muhammedi a.s. për shkak të sjelljes së tillë, e mallkoi atë.

Pas një kohe Pervizi i shkroi Bezanit, kryetarit të Jemenit, të shkojë në Hixhaz, të vëzhgojë punën e një Kurejshiti që mëson fenë e re dhe bashkimin e popullit arab. Prandaj, nëse nuk e lë atë veprim do t'i prehet koka menjëherë dhe t'i dërgohet mbretit. Bazani, duke e çuar në vend urdhërin e mbretit, i dërgoi Muhammedit a.s. letër përmes dy njerëzve të besuar. Me këtë letër ia tërhiqte vërejtjen për pasojat e rënda. Pasi e lexoi letrën, Muhammedi a.s. i thirri të dy delegatët të pranojnë Islamin dhe u tha ta lajmërojnë kryetarin e tyre se mbretin Perviz tashmë e ka vrarë djali i tij, Shirevejhu mu para agimit të ditës së martë, më 10 Xhumade-l-ûlâ të viti 7 hixhri dhe se mbretëria e tij është para shkatërrimit. Bizani pasi u bind për vërtetësinë e këtij informacioni, e pranoi Islamin me disa shokë të tjerë. Pra, jeta e Pervizit përfundoi mu ashtu si e mallkoi Muhammedi a.s.

Nga hadithi mund të përfundohet:

- dijeninë duhet përhapur gojarisht, me shkrim dhe me metoda të tjera të përshtatshme;
- është e lejueshme të mallkosh armikun i cili përpiqet të zhdukë lirinë e përhapjes së fesë, lirinë e të menduarit dhe tubimin e marrëveshjen e njerëzve.

14 Muslimi në koleksionin e vet të haditheve thekson se Muhammedi a.s. në vitin 7 hixhri ka vendosur t'i dërgojë mesazh mbretit të Persisë, të Bizantit dhe të Etiopisë. As-habët i patën thënë se ata do ta lexojnë mesazhin vetëm nëse është i vërtetuar me vulë. Prandaj,

باب مَنْ قَعَدَ حيثُ يَنتهي به المَجْلِسُ ، ومَنْ رأى فُرْجَةً في الحَلْقةِ جلسَ فيها

٦٦ — حدثنا إسماعيلُ قال حدثني مالكٌ عن إسحاقَ بنِ عبدِ اللهِ بنِ أبي طلحةَ أن أبا مُرَّةَ مولى عقيلِ بنِ أبي طالبٍ أخبرَهُ عن أبي واقدٍ اللَّيثيِّ أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ بينما هوَ جالسٌ في المسجدِ والناسُ معهُ إذْ أقبلَ ثلاثةُ نفرٍ ، فأقبلَ اثنانِ إلى رسولِ اللهِ ﷺ وذهبَ واحدٌ . قال فوقفا على رسولِ اللهِ ﷺ ، فأمَّا أحدُهما فرأى فُرْجَةً في الحَلْقةِ فجلسَ فيها ، وأمَّا الآخرُ فجلسَ خلفَهُمْ ، وأمَّا الثالثُ فأدبرَ ذاهباً . فلمَّا فرَغَ رسولُ اللهِ ﷺ قال : ألا أُخبرُكم عن النَّفرِ الثلاثةِ ؟ أمَّا أحدُهم فآوى إلى اللهِ فآواه ، وأما الآخرُ فاستحيا فاستحيا اللهُ منه ، وأما الآخرُ فأعرضَ فأعرضَ اللهُ عنه »

Ai që ka arritë i fundit në një tubim shkencor dhe ai që ka parë vend të lirë në sallë dhe aty ulet

66. Na ka treguar Ismaili, ky nga Maliku, ky nga Is-hak b. Abdullah b. Ebu Talhai, ky nga Ebu Murre, rob i liruar i Akil b. Ebu Talibit, ky nga Ebu Vakid el-Lejthiu, i cili ka thënë:

Derisa Pejgamberi s.a.v.s. ende rrinte në xhami me njerëzit, erdhën tre persona: dy nga ata u drejtuan kah Pejgamberi s.a.v.s., kurse njëri shkoi. Transmetuesi tha se ata (të dy) u ndalën para Pejgamberit s.a.v.s. Njëri prej tyre pa një vend të zbrazët në mesin e dëgjuesve dhe aty u ul, tjetri u ul pas tyre. Sa i përket të tretit, ai e ktheu shpinën dhe shkoi.

Kur Pejgamberi s.a.v.s., e përfundoi fjalimin tha:

"Dëgjoni, do t'ju tregoj për gjendjen e këtyre tri personave: I pari i fshehet (ruhet) **All-llahut, dhe All-llahu e vendos atë në strehimore** (në vend të sigurtë); **i dyti, përmbahet nga turpi, edhe All-llahu është i përmbajtur** (nga dënimi i tij). **Sa i përket të tretit që e ktheu shpinën, edhe All-llahu ia kthen shpinën".**[15]

---

urdhëroi t'i bëhet unaza me vulë, në të cilën do të shënohej ai tekst që u përmend në hadithin e lartshënuar. Nga hadithi mund të përfundohet:

- lejohet korrespondenca me jomuslimanët dhe me ta të kihet marrëdhënie të mira ndërfqinjësore.
- i lejohet mashkullit të mbajë unazë të gravuar me emrin e tij, me përmbajtje të mirë, po edhe me emrin e All-llahut xh.sh.

15 Fjalitë e fundit të hadithit kanë domethënie alegorike. Ai që qe përmbajtur për shkak të turpit dhe që qe ulur pak më larg nga Muhammedit a.s. nuk ka pasë mundësi t'i dëgjojë

باب قول النبي ﷺ « رُبَّ مُبَلَّغٍ أَوْعَى من سامع »

٦٧ — حدثنا مُسَدَّدٌ قال : حدثنا بِشْرٌ قال حدثنا ابنُ عَوْنٍ عن ابنِ سِيرِينَ عن عبدِ الرحمٰنِ بنِ أبي بَكْرَةَ عن أبيهِ ذَكَرَ النبيُّ ﷺ قَعَدَ عَلَى بَعِيرِهِ وأَمْسَكَ إنسانٌ بِخِطَامِهِ ـ أو بِزِمَامِهِ ـ قال : أَيُّ يَوْمٍ هذا ؟ فَسَكَتْنا حتى ظَنَنَّا أنه سَيُسَمِّيهِ بِغَيْرِ اسْمِهِ قال : أليسَ يومَ النَّحرِ ؟ قلنا : بَلَى . قال : فأيُّ شَهرٍ هٰذا ؟ فَسَكَتْنا حتى ظَنَنَّا أنه سَيُسَمِّيهِ بِغَيْرِ اسْمِهِ ، فقال : أليسَ بِذِي الحِجَّةِ ؟ قلنا : بَلَى . قال : فإنَّ دِماءَكُمْ وأَمْوالَكُمْ وأَعْراضَكُمْ بَيْنَكُمْ حَرامٌ كَحُرْمَةِ يومِكُمْ هٰذا ، فِي شَهرِكُمْ هٰذا ، فِي بَلَدِكُمْ هٰذا . لِيُبَلِّغِ الشاهِدُ الغائِبَ ، فإنَّ الشاهِدَ عَسَى أن يُبَلِّغَ مَنْ هُوَ أَوْعَى لَهُ منه

"Shumë nga ata të cilëve u tregohet diçka përmes tjetrit mund të kuptojnë më mirë se dëgjuesi i drejtpërdrejtë"

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.

67. Na ka treguar Museddedi, këtij Bishri, ky nga Ibni Avni, ky nga Ibni Sirini, ky nga Abdu-r-Rahman b. Ebu Bekre, e ky nga babai i vet, i cili ka thënë:

---

të gjitha mirë. All-llahu xh.sh. ia ka kufizuar atij të zë dituri. Ai që qe hidhëruar dhe që qe larguar pa arsye, duke mos dashur të ulet as pranë xhamisë, mbeti i padijshëm. Nga hadithi mund të përfundohet:

- dëgjuesi i ligjëratës shkencore do të jetë nën mëshirën e All-llahut xh.sh., me fuqi të plotë shpirtërore dhe me vullnet sikur bart fuqi të paparë;
- Ibni Batali konstaton se detyra parësore e ligjëruesit është që dëgjuesit t'i vendosë në mënyrë që ligjërata të dëgjohet më mirë;
- nuk duhet patur turp në kërkimin e diturisë. Turpi i tepruar e pengon ngritjen profesionale;
- ai që u ik ligjëratave dhe i lëshon ato pa arsye, vetëm se nuk ka vend për t'u ulur në radhët e para, ai tërheq në vete zemërimin e All-llahut xh.sh. dhe me vetëdashje hyn në radhët e të paditurve;
- muslimani duhet të ketë njohuri themelore nga të gjitha disiplinat shkencore;
- dëgjuesi duhet të ulet sa më afër ligjëruesit, për t'i dëgjuar, për t'i kuptuar dhe për t'i mbajtur në mend më mirë ligjëratat;
- lejohet të lavdohen publikisht njerëzit që punojnë mirë, me rregull; që kanë rezultate dhe që kanë moral të lartë, dhe të qortohen ata që punojnë vepra jashtëligjore dhe të dëmshme për njeriun dhe për shoqërinë në përgjithësi;
- njeriu ulet në shoqëri atje ku i përgjigjet dhe ku sheh vend të lirë. Vlerën e vet, vendin dhe rolin në shoqëri duhet ta çmojë objektivisht;
- dëgjuesit i plotësojnë vendet e para gjatë dëgjimit të ligjëratave, ashtu siç plotësohen vendet e zbrazta gjatë faljes kolektive (me xhemat) të namazit.

Pejgabmeri s.a.v.s. kishte hipur në deve (gjatë Haxhit lamtumirës). Kapistrën e deves ia mbante një njeri. Pas pak pyeti:

"Cila ditë është kjo?"

Ne heshtëm, duke menduar se do ta quante me një emër tjetër e jo me emrin e saj.

"A nuk është kjo dita e therjes së kurbanit", peyti.

"Po, pa dyshim", thamë.

"Cili muaj është ky?" pyeti.

Ne përsëri heshtëm dhe menduam se do ta quante me një emër tjetër.

"A nuk është dhu-l-hixhxhe?" tha ai.

"Po", thamë.

Pastja tha:

"Gjaku juaj, pasuria juaj, nderi juaj, janë të shenjta, dhe të paprekshme, sikurse që është e shenjtë kjo ditë e juaja, në këtë qytetin tuaj, në këtë vendin tuaj. Çdonjëri që është i pranishëm le ta njoftojë atë që nuk është këtu (i pranishëm), **sepse mund të ndodh që, ai që nuk është i pranishëm, ta kuptojë më mirë se ai që ia kumton".**[16]

---

16 Buhariu e sjell vetëm atë pjesë të hadihit që, për nga përmbajtja, i përgjitjet temës së pjesës së parashtruar. Muhammedi a.s. në vitin 10 hixhri e bëri Haxhxhin Lamtumirës, ku mbajti fjalim më të gjatë para masës, duke thekusar në mes tjerash se vjedhjen, plaçkitjen e pasurisë së tjetrit, pastaj marrjen e nderit të tjetrit, Islami i ndalon rreptësish. Të gjitha këto janë të shenjta, siç janë të shenjta edhe ditët e bajrameve dhe qyteti i Mekkes.

Pas çdo pyetje që i shtrohej, Muhammedi a.s. heshtte pak, mendohej, e pastaj vetë përgjigjej, duke u sinjalizuar të pranishëmve rëndësinë e urdhërave të paraqitura dhe evitimin e shprehive të këqija nga e kaluara. Në kohën paraislame, shumë arabë kanë bërë vjedhje, plaçkitje dhe e kanë çmuar fare pak jetën dhe pasurinë e tjetrit. Muhammedi a.s. me tonin më të këndshëm dhe të lartë ua tërhoqi vërejtjen e pacënueshmërisë së pasurisë së tjetrit.

Nga hadithi nxirret ky përfundim:

- njerëzit e ditur janë të detyruar t'i mësojnë të paditurit, dhe t'u mbajnë mësime sipas nivelit dhe përgatitjes së tyre; kjo është detyrë morale e dijetarëve dhe urdhër i All-llahut xh.sh., që dijeninë të cilën e kanë arritur të mos e fshehin;
- ka mundësi që dijetarët e mëvonshëm të bëhen më të ditur se të përparshmit;

بابُ العِلْمُ قبلَ القولِ والعملِ ، لقولِ اللهِ تعالى ﴿ فاعْلَمْ أنه لا إلهَ إلاّ اللهُ ﴾ فبدأَ بالعِلْمِ . وأنَّ العُلماءَ هم وَرَثَةُ الأنبياءِ ، وَوَرَّثوا العِلْمَ ، مَنْ أخَذَهُ أخَذَ بِحَظٍّ وافِرٍ ، ومَنْ سَلَكَ طَرِيقاً يَطْلُبُ بِهِ عِلْماً سَهَّلَ اللهُ له طَرِيقاً إلى الجَنَّةِ . وقالَ جلَّ ذِكْرُه ﴿ إنَّما يَخْشَى اللهَ مِنْ عِبادِهِ العُلَماءُ ﴾ . وقالَ ﴿ وما يَعْقِلُها إلاَّ العالِمُونَ ﴾ . ﴿ وقالوا لو كُنَّا نَسْمَعُ أو نَعْقِلُ ما كُنَّا في أصحابِ السَّعِيرِ ﴾ . وقالَ ﴿ هَلْ يَسْتَوِي الَّذِينَ يَعْلَمُونَ والَّذِينَ لا يَعْلَمُونَ ﴾ . وقالَ النبيُّ ﷺ « مَنْ يُرِدِ اللهُ بِهِ خَيْراً يُفَقِّهْهُ ». وإنَّما العِلْمُ بالتَّعَلُّمِ . وقالَ أبو ذَرٍّ : لَوْ وَضَعْتُمُ الصَّمْصامَةَ على هٰذِهِ - وأشارَ إلى قَفاهُ - ثم ظَنَنْتُ أنِّي أُنْفِذُ كَلِمَةً سَمِعْتُها مِنَ النبيِّ ﷺ قبلَ أن تُجِيزُوا عليَّ لأَنْفَذْتُها . وقالَ ابنُ عَبّاسٍ : كُونُوا رَبّانِيِّينَ حُلَماءَ فُقَهاءَ . ويُقالُ : الرَّبّانِيُّ الذي يُرَبِّي الناسَ بِصِغارِ العِلْمِ قبلَ كِبارِهِ

Dijenia para fjalës dhe punës

All-llahu i Madhëruesh ëm (në Kur'an) thotë:

"Dije, All-llahu është vetëm një".

(Muhammed, 19)

Fillon me shkencë (me dituri).

Pejgamberi s.a.v.s. thotë:

"... kurse dijetarët janë trashëgimtarë të Pejgamberëve. Ata kanë lënë trashëgim dijeninë (shkencën) **dhe, ai që do ta arrijë atë, ka arritë fat të madh. Kush niset në rrugë, për të këruar dijeni, All-llahu do t'ia lehtësojë rrugën për në Xhennet".**[17]

- në evitimin e shprehive të këqija duhet të jesh i palodhshëm, këmbëngulës dhe të japësh përpjekjen maksimale në përmirësimin e jetës fetare-morale të njerëzve;
- gjatë ligjëratës, ligjëruesi duhet të qëndrojë në vendin më të lartë me qëllim që dëgjuesit ta shohin e ta dëgjojnë më mirë.

17 Hadithin e sipërpërmendur Buhariu e ka sjellur vetëm pjesërisht, në pajtueshmëri me temën e parashtruar. I tërë hadithi, sipas shënimeve të Tirmidhiut, në përkthim është: "Kush niset në rrugë për të kërkuar dijeni, melekët do t'ia shkruajnë krahët e tyre me kënaqësi. Për dijetarët bëjnë dua (lutje) gjithçka në qiell dhe në tokë, bile edhe peshqit në ujë. Përparësia e dijetarëve ndaj të tjerëve është sikur shkëlqimi i hënës së plotë kundruall yjeve. Dijetarët janë trashëgimtarë të Pejgamberëve, të cilët u kanë lënë trashëgim vetëm dijeninë, e jo arin dhe argjentin. Kush e merr dijeninë, e ka marrë fatin më të madh.

All-llahu xh.sh., pastaj thotë:

"All-llahut i frikohen nga robërit e Tij vetëm dijetarët". [18]
(Fâtir, 28)

"... por (udhëzimet) i kuptojnë vetëm të diturit".
(el-Ankebût, 43).

"Ata (jobesimtarët) thonë: Sikur ne të dëgjonim dhe t'i mbanim në mend këshillat, nuk do të gjendeshim në mesnin e atyre që janë në Xhehennem".
(el-Mulk, 10)

"A janë të barabrtë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?"
(ez-Zumeru, 9).

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Atij që All-llahu ia dëshiron të mirën, do ta udhëzojë në fe (besim)"

dhe **"Dijenia arrihet vetëm duke mësuar"**.

Edu Dherri ka thënë:

---

18 Zamahsheriu mendon se dijetarë të mirëfilltë janë ata të cilët besojnë All-llahun xh.sh., që e njohin Fuqinë e Tij, Dijeninë e pafund të Tij, Drejtësinë e Tij dhe i kryejnë urdhërat e Tij me përkushtim të plotë.
Muhammedi a.s. ka thënë: "Ai që në mesin tuaj e njeh All-llahun xh.sh. më shumë, ai i frikohet Atij më shumë".
Kur'ani nuk i ndan dijetarët në fetarë dhe jofetarë, prandaj nga ajetet dhe hadithet e lartpërmendur është e logjikshme të mendohet në dijetarë të të gjitha disiplinave shkencore.
Astronomi, duke i studiuar ligjet e lëvizjeve të trupave qiellorë, vjen në përfundim se ekziston një fuqi që i drejton ato. Biologu, duke e studiuar pëlhurën (lëvozhgën) e bimëve, të ushqyerit e tyre përmes rrënjëve, e frymëmarrjen e tyre përmes gjetheve, do të vijë në përfundim se ato i drejton një fuqi me vetëdije. Mjeku, duke u thelluar në shkencën e anatomisë, psikologjisë dhe në ligjshmëritë e tjera të organizmave të ndërlikuara të qenieve të gjalla, do të kuptojë domosdonë e ekzistencës së një qenie më të përsosur, Zotin e të gjitha krijesave.
Ligjet e natyrës në këtë botë janë rezultat i dëshirës së Qenies më të lartë të kuptueshme. Njerëzit sa më tepër të kenë njohuri objektive për ligjet e natyrës, aq më tepër do të kenë frikë, dhe respekt ndaj krijuesit të tyre. Të tillët, kudo që të gjenden, do të ndihen sikurse janë në parajsë, e kulmi i kënaqësisë së tyre është në Xhennet, i cili, sipas mësimeve të Kur'anit, është përgatitur për besimtarët, të cilët kanë drojën e All-llahut xh.sh.

"Kur të ma vini shpatën e mprehtë në këtë, duke treguar në qafën e vet, mendoj se, para se të ma preni, unë do ta thoja, qoftë edhe një fjalë, që e kam dëgjuar nga Pejgamberi s.a.v.s.".[19]

Ibni Abbasi, ndërkaq, ka thënë:

"Bëhuni edukatorë të mirë, mendimtarë, juristë (fukaha) **dhe, përgjithësisht njerëz të ditur".**

Thuhet: **"Edukatori i mirë është ai që edukon botën, duke filluar nga dijenia fillestare e deri te ajo më e larta".**

باب ما كانَ النبيُّ ﷺ يَتَخَوَّلُهُم بالمَوْعِظَةِ والعِلمِ كَيْ لا يَنفِروا

٦٨ ـ حدثنا محمدُ بنُ يوسُفَ قال: أخبرنا سُفيانُ عن الأعمشِ عن أبي وائلٍ عن ابنِ مَسعودٍ قال: كانَ النبيُّ ﷺ يَتَخَوَّلُنا بالمَوْعِظَةِ في الأيّامِ كَراهةَ السَّآمةِ علينا

Si i pajiste Pejgamberi s.a.v.s. me këshilla dhe me dijeni, për të mos u shpërndarë ata

68. Na ka treguar Muhammed b. Jusufi, këtij Sufjani, ky nga A'meshi, ky nga Ebu Vaili, ky nga Ibni Mes'udi, i cili ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. na pajiste me këshilla (ligjërata) gjatë ditëve, duke mos na lënë asnjëherë të mërzitemi".[20]

٦٩ ـ حدثنا محمد بن بَشّارٍ قال: حدّثنا يحيى بن سَعيدٍ قال حدّثنا شُعْبَةُ قال حدثني أبو التَّيّاحِ عن أنسٍ عن النبيِّ ﷺ قال «يَسِّروا ولا تُعَسِّروا، وبَشِّروا ولا تُنَفِّروا»

---

19 Me rastin e haxhillëkut Ebu Dherri mbajti një ligjëratë publikish. Gjatë ligjëratës iu afrua një njeri me emrin Mirsed dhe i tha:
"A nuk është e ndaluar për ty të mbash ligjëratë"?
Ebu Dherri nuk qe pajtuar me politikën e Muaviut dhe të disa bashkëmendimtarëve të tij. Prandaj, që i shtrënguar të shpërngulet nga Medina në Rebez. Muaviu ia kishte ndaluar tërësisht mbajtjen e ligjëratave, por ai, sikurse shihet nga teksti i thënies së tij, nuk ia vari veshin ndalesës së Muaviut.

20 Muhammedi a.s. mbante ligjërata dhe këshilla në xhami gjatë ditës, zakonisht pas faljes së namazit. Ai i zgjidhte gjithnjë temat aktuale, të dobishme dhe me interes për shoqërinë. Ligjëratat i kishte të shkurtëra dhe të qarta, prandaj dëgjuesit i mbanin në mend.

69. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari, këtij i kishte treguar Jahja b. Se'idi, ky nga Shu'be, ky nga Ebu Tejjahu, ky nga Enesi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Lehtësoni dhe mos vështirësoni! Gëzoni dhe mos shpërndani (duani dhe mos urreni)".[21]

بَابُ مَنْ جَعَلَ لِأَهْلِ الْعِلْمِ أَيَّامًا مَعْلُومَةً

٧٠ – حدثنا عُثْمَانُ بْنُ أَبِي شَيْبَةَ قال : حدثنا جَرِيرٌ عن مَنْصُورٍ عن أَبِي وَائِلٍ قال : كان عبدُ اللهِ يُذَكِّرُ النَّاسَ فِي كُلِّ خَمِيسٍ ، فقال له رجُل : يا أَبَا عبدِ الرحمٰنِ لَوَدِدْتُ أَنَّكَ ذَكَّرْتَنَا كُلَّ يَوْمٍ . قال : أَمَا إِنَّهُ يَمْنَعُنِي مِنْ ذٰلِكَ أَنِّي أَكْرَهُ أَنْ أُمِلَّكُمْ ، وَإِنِّي أَتَخَوَّلُكُمْ بِالْمَوْعِظَةِ كَمَا كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يَتَخَوَّلُنَا بِهَا مَخَافَةَ السَّآمَةِ عَلَيْنَا

Të caktuarit e kohës së ligjëratës për dëgjues

70. Na ka treguar Uthman b. Ebu Shejbe, këtij Xheriri, këtij Mensuri, ky nga Ebu Vaili, i cili ka thënë:

"Abdullahu i mësonte njerëzit çdo të enjte, prandaj një person i tha atij: O Ebu Abdu-r-Rahman, me të vërtetë, do të doja të na mësoje për çdo ditë".

Ai u përgjigj: **"Ajo që ma ndalon këtë është se nuk kam dëshirë që t'ua bëj të mërzitshëm** (mësimin). **Unë ju pajis me dijeni, ashtu siç na pajiste neve Pejgamberi s.a.v.s. Ai frikohej se mos na kalojë** (mësimi) **në monotoni".**

بَابُ مَنْ يُرِدِ اللهُ بِهِ خَيْرًا يُفَقِّهْهُ فِي الدِّينِ

٧١ – حدثنا سَعِيدُ بْنُ عُفَيْرٍ قال حدثنا ابْنُ وَهْبٍ عن يُونُسَ عن ابْنِ شِهَابٍ قال : قال حُمَيْدُ بْنُ عبدِ الرحمٰنِ سَمِعْتُ مُعَاوِيَةَ خَطِيبًا يقولُ : سَمِعْتُ النَّبِيَّ ﷺ يقول « مَنْ يُرِدِ اللهُ بِهِ خَيْرًا يُفَقِّهْهُ فِي الدِّينِ . وَإِنَّمَا أَنَا قَاسِمٌ ، وَاللهُ يُعْطِي . وَلَنْ تَزَالَ هٰذِهِ الْأُمَّةُ قَائِمَةً عَلَى أَمْرِ اللهِ لَا يَضُرُّهُمْ مَنْ خَالَفَهُمْ حَتَّى يَأْتِيَ أَمْرُ اللهِ »

---

21 Ky hadith e plotëson kuptimin e hadithit paraprak, duke i dhënë ligjëruesit edhe udhëzime të tjera për punë. Ligjëratat duhet të zhvillohen në kohë të përshtatshme. Temat duhet të jenë aktuale dhe me përmbajtje të duarduarshme, e në radhë të parë fetare-morale, të cilat e tërheqin dëgjuesin. Të shprehurit e dënimit të All-llahut xh.sh. duhet të shoqërohet me të shprehurit e Mëshirës së Tij. Të shprehurit e tyre duhet të jenë të matura.

Atij që All-llahu ia do të mirën e udhëzon në parimet e fesë

71. Na ka treguar Se'id b. Ufejri, këtij Ibni Vehbi, këtij Junusi, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Humejd b. Abdu-r-Rahmani, i cili ka thënë

E kam dëgjuar Muaviun duke thënë: E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. kur thoshte:

"Atij që All-llahu ia do të mirën, e udhëzon t'i kuptojë parimet e fesë. Unë vetëm shpërndaj (dijeni), **kurse All-llahu e jep atë. Ky popull le të vazhdojë të mbesë në rrugën e All-llahut, e nuk do të mund ta dëmtojnë ata që e kundërshtojnë, përderisa nuk vjen urdhëri i All-llahut".**[22]

باب الفهم في العلم

٧٢ — حدثنا علي حدثنا سفيان قال: قال لي ابن أبي نجيح عن مجاهد قال: صحبت ابن عمر إلى المدينة فلم أسمعه يحدث عن رسول الله ﷺ إلا حديثا واحدا قال: كنا عند النبي ﷺ، فأتي بجمار فقال «إن من الشجر شجرة مثلها كمثل المسلم. فأردت أن أقول هي النخلة، فإذا أنا أصغر القوم فسكت. قال النبي ﷺ «هي النخلة»

Të kuptuarit e shkencës

72. Na ka treguar Aliu, këtij Sufjani, këtij Ibni Ebu Nexhihu, duke transmetuar nga Muxhahidi, i cili ka thënë:

E kam shoqëruar Ibni Umerin deri në Medine. Nuk e kam dëgjuar atë të thotë diçka më tepër nga Pejgamberi s.a.v.s. përveç një hadithi: Ishim te

---

22 Nga ky hadith mund të nxirret përfundimi:
- vendimi i dijetarëve islamë për një çështje duhet të ketë peshë ligjore;
- dijetarët janë të detyruar të angazhohen maksimalisht në përhapjen e diturisë;
- të diturit kanë përparësi kundruall të paditurve dhe njerëzit duhet të çmohen sipas dijenisë dhe aktivitetit të tyre moralo-shoqëror;
- Islami e çmon çdo degë të diturisë në mënyrë të barabartë, sidomos shkencat islame-juridike, sepse ato ndikojnë më shumë te njerëzit që t'i kryejnë detyrat e All-llahut xh.sh., ndaj vetes dhe ndaj njerëzve të tjerë me një përgjegjësi më të madhe.
- thënia e Muhammedit a.s. sot është realitet, sepse, vërtet, Islami është përhapur në të gjitha anët e botës.

Pejgamberi s.a.v.s.. Kur atij i kishin sjellë një palcë nga hurma, ai (Pejgamberi s.a.v.s.) tha:

"Në mesin e pemëve, ka një pemë e cila shumë i ngjan muslimanit".

Kam dashur të them se ajo pemë është hurma, mirëpo, meqë isha më i riu nga të pranishmit, heshta.

"Ajo është hurma", tha Pejgamberi s.a.v.s.

بابُ الاغْتِباطِ فِي العِلْمِ والحِكْمَةِ . وقال عُمَرُ تَفَقَّهُوا قبلَ أن تَسُودوا . قال أبو عبدِ اللهِ : وبعد أن تَسودوا . وقد تَعلَّمَ أصحابُ النبيِّ ﷺ في كِبَرِ سِنِّهِمْ

٧٣ - حدثنا الحميدي قال : حدثنا سفيانُ قال حدثني إسماعيلُ بنُ أبي خالدٍ - على غيرِ ما حدثناهُ الزُّهريُّ - قال : سمعتُ قَيسَ بنَ أبي حازمٍ قال سمعتُ عبدَ اللهِ بنَ مسعودٍ قال : قال النبيُّ ﷺ « لا حَسَدَ إلاَّ في اثنتينِ : رَجُلٌ آتاهُ اللهُ مالاً فسُلِّطَ على هَلَكَتِهِ في الحقِّ ، ورَجُلٌ آتاهُ اللهُ الحكمةَ فهوَ يَقْضي بها ويُعَلِّمُها »

Kënaqësia në dijeni dhe në urtësi

Umeri r.a. ka thënë:

"Mësoni para se të zgjidheni kryetarë (eprorë)".[23] Ebu Abdullahu (Buhariu) ka thënë: (Mësoni) **edhe pasi të bëheni kryetar. As-habët e Pejgamberit s.a.v.s. kanë mësuar edhe në moshën e tyre të shtyer.**

73. Na ka treguar Humejdiu, këtij Sufjani, këtij Ismail b. Ebu Halidi, kurse Zuhriu ka thënë: kam dëgjuar nga Kajs b. Ebu Hazimi, ky nga Abdullah b. Mes'udi, i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"Mund të kesh zili në dy raste: ndaj njeriut të cilit All-llahu i ka dhënë pasuri dhe atë (pasuri) **e shpenzon në rrugë të drejtë dhe ndaj njeriut, të cilit All-llahu i ka dhënë dituri, që gjykon sipas saj dhe i mëson edhe të tjerët".**

---

23 Dijenia arrihet në ditët e rinisë. Martesa, pleqëria dhe çfarëdo obligimi tjetër në shtëpi, ose në shoqëri e pengon ngritjen profesionale të personit.

بابُ ما ذُكِرَ فى ذَهابِ مُوسىٰ ﷺ فى البحرِ إلى الخَضِرِ وقولِهِ تعالىٰ ﴿ هَلْ أَتَّبِعُكَ عَلىٰ أَنْ تُعَلِّمَنِ مِمَّا عُلِّمْتَ رُشْدًا ﴾

Çka është thënë për shkuarjen e Musait s.a.v.a. nëpër det deri te Hidri

All-llahu i Madhëruesh ëm (në Kur'an) thotë:

"...A të pasoj ty, për të më mësuar mua me një pjesë të dijenisë së mrekullueshme që t'u ka dhënë ty?".[24]

(el-Kehf, 66).

٧٤ – حدثني محمد بن غرير الزهري قال حدثنا يعقوب بن إبراهيم قال حدثني أبي عن صالح عن ابن شهاب حدث أن عبيد الله بن عبد الله أخبره عن ابن عباس أنه تمارى هو والحر بن قيس بن حصن الفزاري في صاحب موسى، قال ابن عباس هو خضر. فمر بهما أبي بن كعب فدعاه ابن عباس فقال: إني تمارينا أنا وصاحبي هذا في صاحب موسى الذي سأل موسى السبيل إلى لقيه، هل سمعت النبي ﷺ يذكر شأنه؟ قال: نعم، سمعت رسول الله ﷺ يقول «بينما موسى في ملأ من بني إسرائيل جاءه رجل فقال: هل تعلم أحدا أعلم منك؟ قال موسى: لا. فأوحى الله إلى موسى: بلى، عبدنا خضر. فسأل موسى السبيل إليه، فجعل الله له الحوت آية، وقيل له: إذا فقدت الحوت فارجع فإنك ستلقاه. وكان يتتبع أثر الحوت في البحر. فقال لموسى فتاه: أرأيت إذ أوينا إلى الصخرة فإني نسيت الحوت، وما أنسانيه إلا الشيطان أن أذكره. قال: ذلك ما كنا نبغي. فارتدا على آثارهما قصصا، فوجدا خضرا، فكان من شأنهما الذي قص الله عز وجل في كتابه».

---

24 Jahja b. Muini thekson: "Kush kërkon pozitë udhëheqëse, e humb mundësinë për përsosje profesionale".

Muhammedi a.s. ka thënë: "A dëshironi t'ju them kush i njeh normat fetare?

- Po, - iu përgjigjën As-habët.

- Po, - iu përgjigjën të pranishmit.

- Ai që nuk e humb shpresën në mëshirën e All-llahut xh.sh., që jeton në mes frikës së dënimit të All-llahut xh.sh. dhe shpresës së mëshirës së Tij. Nuk ka dobi në namaz, nëse besimtari nuk është mësuar ta kryejë mirë atë, po edhe në shkencë nuk ka dobi nëse ajo nuk është kuptuar si duhet.

74. Na ka treguar Muhammed b. Gurejr ez-Zuhriu, këtij i kishte treguar Jakub b. Ibrahimi, këtij babai i vet, këtij Salihu, ky nga Ibni Shihabi, i cili ka treguar se Ubejdullah b. Abdullahu ka treguar, duke transmetuar nga Ibni Abbasi, se ai dhe Hurr b. Kajs b. Hisn Fezariu kanë diskutuar për rastin e Musait dhe shokut të tij, për të cilin Ibni Abbasi, me bindje të thellë, tha se ai është Hidri (Hëzri). Në atë moment, pranë tyre, rastësisht, kaloi Ubej b. Ka'bi, e Ibni Abbasi e *thirri dhe i tha*:

"Unë dhe ky shoku im po diskutojmë për shokun e Musait. Musai a.s. ka pyetur dhe ka kërkuar mënyrën që të takohet me të. E, ti a e ke dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. ndonjëherë që të flasë diçka për këtë çështje"?

"Po, e kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. kur thoshte: Derisa Musai a.s. ka qenë te një i pari i Beni Israilëve, i ka ardhë një njeri dhe e ka pyetur: A di ndonjë më të ditur se ti"?

"Jo", ka thënë Musai a.s.

Atëherë All-llahu xh.sh. i shpalli Musait: **"Po, pa dyshim është robi ynë, Hidri".**

Pastaj, Musai kërkoi rrugë dhe mënyrë që të shkojë te ai, e All-llahu i Madhërueshëm ia bëri peshkun shenjë (argument) dhe i është thënë: **"Kur ta humbësh peshkun, kthehu prapa dhe, sigurisht, do ta takosh atë"!** Ai e vëzhgonte me kujdes nëpër det peshkun, për të cilin i ishte thënë. Më pastaj, Musait i tha përcjellësi i tij:

> ***"A të kujtohet kur arritëm (zbritëm) te ai shkëmbi"? Unë, vërtet, e harrova peshkun. Vetëm shejtani (djalli) më ka shpënë në harresë, për të ta kujtuar ty atë...".***
>
> *(el-Kehf, 63).*

> *(Musai) tha: **"E, kjo është ajo që po kërkojmë. Prandaj u kthyen nëpër gjurmët e veta duke i treguar njëri-tjetrit".***
>
> *(el-Kehf, 64).*

Dhe, kështu e gjetën Hidrin. Ky është rasti i Musait me Hidrin, për të cilin All-llahu i Madhërueshëm tregon në Librin e Tij (në Kur'an).[25]

---

25 Për takimin e Musait a.s. me Hidrin (Hëzrin) dhe për rastin e tyre të mëtutjeshëm shih

باب قول النبي ﷺ « اللهم علمه الكتاب »

٧٥ — حدثنا أبو معمر قال حدثنا عبد الوارث قال حدثنا خالد عن عكرمة عن ابن عباس قال : ضمني رسول الله ﷺ وقال « اللهم علمه الكتاب »

Fjala e Pejgamberit s.a.v.s. "O Zot, mësoja atij librin (diturinë)"

75. Na ka treguar Ebu Ma'meri, këtij Abdu-l-Varithi, ky nga Halidi, ky nga Ikrime, e ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. më përqafoi dhe më shtrëngoi, duke thënë:

"O Zot, mësoja Librin (diturinë)".[26]

Suren el-Kehf, 60-83).

Para se të ndahen, Musai e luti Hidrin që ta mësojë çka do qoftë, e Hidri i tha: "Mos kërko dijeni vetëm për ta përsëritur atë, por kërko dijeni për ta zbatuar në jetën e përditshme".

Disa dijetarë mendojnë se Hidri është gjallë ende. Pjesa dërmuese e dijtarëve, megjithatë, mendojnë se Hidri, ndonëse ka qenë evlija në kohën e Musait a.s., edhe ai u është nënshtruar ligjeve të kësaj bote, sepse edhe ai ka vdekur pas një kohë të caktuar.

Ky mendim mbështetet në mësimet e Kur'anit të Madhërueshëm:

"Dhe nuk i kemi dhënë asnjërit para teje jetë të përhershme (në këtë botë)..." Po në këtë frymë është edhe hadithi i Muhammedit a.s.: "... në fillim të shekullit të ardhshëm nuk do të jetë asnjë nga ata që tash janë në faqe të dheut".

Nga kjo del se, edhe nëse Hidri ka jetuar gjatë, ai, fundja, ka vdekur si të gjithë të tjerët.

Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- rekomandohet diskutimi i vërtetë për të gjitha çështjet, e për çështjet e diskutueshme duhet t'u drejtohemi ekspertëve;
- njeriu duhet të mësoj gjithnjë, të ngrihet profesionalisht dhe kështu të jetë i dobishëm për shoqërinë përgjithësisht;
- dijetari nuk duhet të jetë mendjemadh, por modest;
- për udhëtime të gjata duhet të furnizohesh me pajisje të domosdoshme, sidomos me ushqim;
- për shkencë duhet sakrifikuar;
- njoftimi i personit të besueshëm është i vlefshëm.

26 Mund të nxirret përfundimi:

- duhet bërë përpjekje për të mësaur nga të gjitha degët shkencore, siodmos nga ato islame;
- ledhatimi i fëmijëve, përshëndetja me të afërmit ose me miqtë kur vijnë në vizitë, ose kur kthehen nga udhëtimi, janë gjëra të lavdueshme.

باب متى يصح سماع الصغير ؟

٧٦ - حدثنا إسماعيل بن أبي أويس قال حدثني مالك عن ابن شهاب عن عبيد الله بن عبد الله بن عتبة عن عبد الله بن عباس قال : أقبلت راكبا على حمار أتان - وأنا يومئذ قد ناهزت الاحتلام - ورسول الله ﷺ يصلي بمنى إلى غير جدار، فمررت بين يدي بعض الصف ، وأرسلت الأتان ترتع فدخلت في الصف ، فلم ينكر ذلك علي

Kur është i vlefshëm mendimi i të miturit?

76. Na ka treguar Ismail b. Ebu Uvejsi, këtij i kishte treguar Maliku, këtij Ibni Shihabi, ky nga Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe, e ky nga Abdullah b. Abbasi, i cili ka thënë:

"Jam nisur me një kafshë samari (gomar). **Gati isha i moshës madhore. Pejgamberi s.a.v.s. falej** në **Mine jashtë mureve** (në hapësirë). **Kalova përballë një safi** (rreshti). **E lëshova kafshën të kulloste dhe hyra në saf (rresht).** (Për këtë veprim që e bëra) **asnjë nuk ma zuri për të madhe".**[27]

---

27 Në hadithin paraprak Muhammedi a.s. ka kërkuar mendjemprehtësi për Ibni Abbasin, kurse në këtë hadith theksohet vlera e plotë e deklaratës të cilën e jep personi që është në prag të moshës madhore, sepse mosha nuk është faktor vendimtar dhe i vetëm për të qenë deklarata e plotfuqishme, por këtu hynë edhe inteligjenca, të kuptuarit dhe të mabjturit mend e personit. Jahja b. Ma'ni konsideron se për vlerën e transmetimit të deklaratave të të tjerëve, transmetuesi duhet të ketë 15 vjet, sepse, Ibni Umerin, As-habët e kanë kthyer nga Lufta e Uhudit me pretekst se ishte i ri, ndonëse ai atëherë i kishte 14 vjet.

Nga hadithi mund të nxirret ky përfundim:

- deklaratat e sakta të djaloshit të mençur janë të vlefshme (të pranueshme). I njëjti kriter është te robërit, te gabimtarët dhe te jomuslimanët;
- djali i mençur mund t'i mbajë në mend mirë nga jeta e tij shumë ngjarje dhe t'ua tregojë të tjerëve në mënyrë të besueshme;
- gjatë ligjëratës dëgjuesi mund të kalojë përpara dhe të ulet në vende të zbrazta;
- të kaluarit e kafshës para atij që fal namazin, nuk ia prish namazin;
- namazi i të miturit është i vlefshëm;
- heshtja e Muhammedit a.s. është pëlqim;
- sutra (shkopi mbrojtës para namazit) i imamit, është njëkohësisht sutra për të gjithë që falën pas tij.

٧٧ — حدثني محمدُ بنُ يوسُفَ قال حدثنا أبو مُسْهِرٍ قال حدثني محمدُ بنُ حَرْبٍ حدثني الزُّبَيْدِيُّ عنِ الزُّهْرِيِّ عن محمودِ بنِ الرَّبيعِ قال : عَقَلْتُ منَ النبيِّ ﷺ مَجَّةً مَجَّها في وَجْهي وأنا ابنُ خَمْسِ سِنينَ مِنْ دَلْوٍ

77. Më ka treguar Muhammed b. Jusufi, ky nga Ebu Mus-hiri, ky nga Muhammed b. Harbi, ky nga Zubejdi, ky nga Zuhuriu, ky nga Muhammed b. Rebiu, i cili ka thënë:

"Kur i kisha pesë vjet, më kujtohet se Pejgamberi s.a.v.s. një herë mori ujë (në gojë) **nga kova dhe më stërpiku në fytyrë".**[28]

باب الخروج في طلب العلم

ورَحَلَ جابرُ بنُ عبدِ اللهِ مَسيرةَ شَهْرٍ إلى عبدِ اللهِ بنِ أُنَيْسٍ في حديثٍ واحدٍ

٧٨ — حدثنا أبو القاسمِ خالدُ بنُ خَلِيٍّ قال حدثنا محمدُ بن حربٍ قال : قال الأوزاعيُّ أخبرنا الزُّهريُّ عنْ عُبيدِ اللهِ بنِ عبدِ اللهِ بن عُتْبةَ بنِ مَسْعودٍ عنِ ابنِ عباسٍ أنه تمارَى هوَ والحُرُّ بنُ قيسِ بنِ حِصْنٍ الفَزَارِيُّ في صاحبِ موسى ، فمرَّ بهما أُبَيُّ بنُ كعبٍ فدعاهُ ابنُ عباسٍ فقال : إني تمارَيتُ أنا وصاحبي هذا في صاحبِ موسى الذي سألَ السبيلَ إلى لُقيِّهِ ، هل سمعتَ رسولَ اللهِ ﷺ يذكرُ شأنَهُ ؟ فقال أبيٌّ نعم سمعتُ النبيَّ ﷺ يذكرُ شأنَهُ يقول « بينما موسى في مَلأٍ من بني إسرائيلَ إذْ جاءهُ رجلٌ فقال : أتعلمُ أحداً أعلمَ منكَ ؟ قال موسى : لا . فأوحى اللهُ عزَّ وجلَّ إلى موسى : بلى ، عبدُنا خَضِرٌ . فسألَ السبيلَ إلى لُقيِّهِ ، فجعلَ اللهُ لهُ الحوتَ آيةً ، وقيلَ له : إذا فَقَدْتَ الحوتَ فارجعْ فإنكَ ستلقاهُ ، فكانَ موسى ﷺ يتتبعُ أثرَ الحوتِ في البحرِ . فقال فتى موسى لموسى : أرأيتَ إذْ أوَينا إلى الصخرةِ فإني نسيتُ الحوتَ ، وما أنسانيهِ إلا الشيطانُ أنْ أذكرَهُ . قال موسى : ذلكَ ما كنا نبغي . فارتدا على آثارِهما قَصَصاً ، فوجدا خَضِراً . فكانَ مِنْ شأنِهما ما قصَّ اللهُ في كتابِهِ »

28 Nga hadithi konkludohet:
- punët në të cilat ka marrë pjesë Muhammedi a.s. kanë qenë të uruara dhe përparimtare;
- fëmija i zhvilluar formalisht, mund të mbajë në mend shumë gjëra dhe, të kujtuarit e ngjarjeve të veta ka rëndësi të madhe;
- kontakti dhe shakaja e matur e të rriturve me fëmijët ndikon pozitivisht në edukimin e mëtejmë të fëmijëve. Kështu, fëmijët me të cilët ka patur kontakt Muhammedi a.s. kanë qenë shembull, e në vitet e burrërisë, personalitete të famshëm.

Gjurmimi për dituri

Xhabir b. Abdullahu ka bërë një udhëtim një muajsh në këmbë, për te Abdullah b. Unejsi, vetëm për të mësuar një hadith.

78. Na ka treguar Ebu-l-Kasim Halid b. Halijj, këtij Muhammed b. Harbi se Evzaiu ka thënë: Na ka njoftuar Zuhriu, duke transmetuar nga Ubejdullah b. Abdullah b.Utbe b. Mes'udi , ky nga Ibni Abbasi se ai dhe Hurr b. Kajsi b. Hisn Fezariu kanë biseduar për bashkudhëtarin e Musait, e pranë tyre, rastësisht, ka kaluar Ubejj b. Ka'bi, të cilin Ibni Abbasi e ka thirrë dhe i ka thënë: **"Ja, unë dhe ky shoku im po diskutojmë rreth bashkudhëtarit të Musait, e që Musai ka kërkuar mënyrën të takohet me të. Po ti, a e ke dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. ta ketë përmendur këtë rast?"**

"Po", tha Ubeji, e kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

"Derisa Musai ishte te njëri nga të parët e Beni Israilëve, i ka ardhë një njeri dhe e ka pyetur: **A di ndonjë njeri më të ditur se ti?"**

"Jo", i është përgjigjur Musai.

Pastaj All-llahu i Madhërueshëm e ka frymëzuar Musain:

"Po, gjithsesi, është robi ynë, Hidri".

Për këtë arsye, Musai filloi të gjejë mënyrën të takohet me të dhe, All-llahu xh. sh., ia bëri peshkun shenjë (argument), duke i thënë (Musait): **"Kur ta humbësh peshkun, kthehu prapa dhe me siguri do ta takosh atë."**

Musai e përcolli me kujdes nëpër det gjurmën e peshkut. Përcjellësi (shoku) i tha Musait:

> ***"Shiko! A të kujtohet kur arritëm të ai shkëmbi? Unë vërtet e harrova peshkun. Vetëm shejtani (djalli) më ka shpënë në harresë, për të ta kujtuar ty atë...".***
>
> *(el-Kehf, 63).*

E, Musai tha:

> ***"E, mu kjo është ajo që po e kërkojmë. Prandaj, u kthyen** (që të dy) **nëpër gjurmët e veta duke i treguar njëri-tjetrit".***
>
> *(el-Kehf, 64).*

Kështu, e gjetën Hidrin. Ky është rasti i Musait a.s. me Hidrin për të cilin All-llahu i Madhërueshëm tregon në Librin e Tij.

بَابُ فَضْلِ مَنْ عَلِمَ وَعَلَّمَ

٧٩ ـ حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الْعَلَاءِ قَالَ حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ أُسَامَةَ عَنْ بُرَيْدِ بْنِ عَبْدِ اللهِ عَنْ أَبِي بُرْدَةَ عَنْ أَبِي مُوسَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ « مَثَلُ مَا بَعَثَنِي اللهُ بِهِ مِنَ الْهُدَى وَالْعِلْمِ كَمَثَلِ الْغَيْثِ الْكَثِيرِ أَصَابَ أَرْضًا، فَكَانَ مِنْهَا نَقِيَّةٌ قَبِلَتِ الْمَاءَ فَأَنْبَتَتِ الْكَلَأَ وَالْعُشْبَ الْكَثِيرَ، وَكَانَتْ مِنْهَا أَجَادِبُ أَمْسَكَتِ الْمَاءَ فَنَفَعَ اللهُ بِهَا النَّاسَ فَشَرِبُوا وَسَقَوْا وَزَرَعُوا، وَأَصَابَتْ مِنْهَا طَائِفَةً أُخْرَى إِنَّمَا هِيَ قِيعَانٌ لَا تُمْسِكُ مَاءً وَلَا تُنْبِتُ كَلَأً. فَذَلِكَ مَثَلُ مَنْ فَقِهَ فِي دِينِ اللهِ وَنَفَعَهُ مَا بَعَثَنِي اللهُ بِهِ فَعَلِمَ وَعَلَّمَ، وَمَثَلُ مَنْ لَمْ يَرْفَعْ بِذَلِكَ رَأْسًا وَلَمْ يَقْبَلْ هُدَى اللهِ الَّذِي أُرْسِلْتُ بِهِ ». قَالَ أَبُو عَبْدِ اللهِ: قَالَ إِسْحَقُ: وَكَانَ مِنْهَا طَائِفَةٌ قَيَّلَتِ الْمَاءَ قَاعٌ يَعْلُوهُ الْمَاءُ، وَالصَّفْصَفُ الْمُسْتَوِي مِنَ الْأَرْضِ

Vlera e atij që mëson për (vete) dhe që i mëson të tjerët

79. Na ka treguar Muhammed b. Alai, këtij Hammad b. Usame, ky nga Burejd b. Abdullahu, ky nga Ebu Burde, ky nga Ebu Musai, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili thotë:

"Udhëzimi (Kur'ani) **dhe dijenia me të cilat All-llahu i Madhëruesh**ë**m më ka dërguar janë si shiu i madh i cili bie në tokë". Toka pjellore pranon ujin dhe prodhon barin dhe shumë gjelbërime të tjera, kurse toka jopjellore e mban në vete ujin.** (Prej kësaj toke) **All-llahu bën që njerëzit ta shfrytëzojnë atë: të pijnë, t'u japin kafshëve të pinë dhe të mbjellin;** (shiu) **bie, ndërkaq, edhe nëpër vende të tjera: nëpër shkretëtira, të cilat nuk pranojnë e as që mbajnë ujë në vete dhe nuk prodhojnë kurrfarë bari** (bereqeti).

Ky është shembull për atë që e ka njohur ligjin e All-llahut dhe e shfrytëzon atë (Kur'anin) **të cilin All-llahu ma ka dërguar mua, prandaj, mëso dhe të tjerët mësoi. Është shembull, poashtu, për atë që për këtë nuk e ka çarë kokën fare, e as që e ka pranuar udhëzimin e All-llahut me të cilën jam dërguar.**

Ebu Abdullahu (Buhariu) thotë se Is-haku ka thënë: **"...dhe ka një lloj toke, e cila "pi ujë",** (në vend "pranon ujë").

"**Kâ'un**" është tokë e rrafshët në të cilën qëndron (fle) uji, kurse "**safsafun**" është rrafshirë.[29]

باب رفع العلم، وظهور الجهل. وقال ربيعة: لا ينبغي لأحد عنده شيء من العلم أن يضيع نفسه

٨٠ – حدثنا عمران بن ميسرة قال حدثنا عبد الوارث عن أبي التياح عن أنس قال: قال رسول الله ﷺ «إن من أشراط الساعة أن يرفع العلم، ويثبت الجهل، ويشرب الخمر، ويظهر الزنا»

Çrrënjosja e diturisë dhe paraqitja e mosdijes

Rebi'a ka thënë: "**Nuk guxon të zhduket** (të humbet) **ai që ka sado pak dituri**".

80. Na ka treguar Imran b. Mejsere, këtij Abdu-l-Varithi, këtij Ebu-t-Tejjahu, ky nga Enesi, i cili ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

---

29 Në këtë hadith krahasohen me llojet e tokës personat, të cilët e kanë pranuar Islamin, i kanë mësuar rregullat e tij dhe këto rregulla ua transmetojnë të tjerëve. Sipas hadithit janë tri lloje të tokës, të cilave u përgjigjen tri lloje të njerëzve: i pari, mëson dhe, edhe të tjerët i mëson; i dyti, pranon diturinë dhe edhe mëson aq sa ka nevojë, por nuk ia transmeton tjetrit dhe i treti, nuk mëson, prandaj, mbetet i padishëm. Ky i fundit i ngjan tokës jopjellore.

Nga krahasimi i sipërpërmendur Neveviu vjen në përfundim se ekzistojnë tri kategori njerëzish, të cilët janë të ngjashëm me kategoritë e tokave të përmendura më lartë. Një lloj e pranon ujin, e shfrytëzon atë dhe pas thatësisë vishet me gjelbërim, bën bereqet, bar, që i përdorin edhe njerëzit edhe kafshët. Kësaj toke i përgjigjen njerëzit, të cilët pranojnë këshilla, mësojnë vetë dhe i mësojnë të tjerët. Këta janë të dobishëm si për vete si për të tjerët. Lloji tjetër i tokës vetëm për vete është jopjellore dhe e padobishme; ajo është e dobishme për të tjerët, sepse mban lagështinë dhe ujin e tepërt, të cilin e *shfrytëzojnë njerëzit, bimët dhe kafshët. Kësaj toke i përngjajnë njerëzit të cilët nuk e* shfrytëzojnë në mënyrë të mjaftueshme diturinë që e kanë. Ata e ruajnë diturinë e tyre, por, fundja, ua japin të tjerëve, të cilët e shfrytëzojnë për interes të vetin ose të shoqërisë në përgjithësi. Këta njerëz janë të dobishëm pjesërisht dhe meritojnë kujdes përkatës. Lloji i tretë i tokës është plotësisht jopjellore, nuk pranon ujë, e as që mban për vete. Kësaj toke i ngjajnë njerëzit, të cilët janë të pangritur shpirtërisht, të paditur dhe të prapambetur. Këtyre nuk u intereson dija, nuk mësojnë dhe nuk kanë çka t'u tregojnë të tjerëve.

"Shenjat (simptomet) **e Kijametit janë: çrrënjosja** (zhdukja) **e diturisë, jetësimi i mosdijes, pirja e alkoholit dhe prostitucioni** (zinaja)".[30]

٨١ – حدثنا مُسَدَّدٌ قال حدثنا يحيى عن شُعبةَ عن قَتادةَ عن أنسٍ قال : لأُحَدِّثَنَّكم حديثًا لا يُحَدِّثُكم أحدٌ بعدي ، سَمِعْتُ رسولَ اللهِ ﷺ يقول « مِنْ أشراطِ الساعةِ أنْ يَقِلَّ العِلْمُ ويَظْهَرَ الجَهْلُ ، ويَظْهَرَ الزِّنا ، وتَكْثُرَ النساء ، ويَقِلَّ الرِّجالُ حتى يكونَ لخمسينَ امرأةً القَيِّمُ الواحِدُ »

81. Na ka treguar Museddedi, këtij Jahjai, këtij Shu'be, këtij Katade, e këtij Enesi, i cili ka thënë:

Do t'ju tregoj një Hadith të cilin, përveç meje, askush nuk do t'ua tregojë: E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

"Shenjat e Çastit (Kijametit) **janë: çrrënjosja e diturisë, paraqitja e mosdijes, prostitucioni** (zinaja) **dhe shtimi i tepërt i grave dhe pakësimi i meshkujve për aq sa një burrë të jetë për pesëdhjetë gra".**[31]

---

30 Në pjesët e mëparme u bë fjalë për virtytet e dijetarit, e këtu bëhet fjalë për mosinteresimin e njerëzve ndaj shkencës dhe mospërfilljen për mësuarjen e rinisë.
Me deklaratën e tij Rebia ua tërheq vërejtjen njerëzve të ditur që të angazhohen deri në fund për t'i mësuar të tjerët; që njohurinë e tyre mos e fshehin, por t'ua transmetojnë të tjerëve, përndryshe do të mbeten anonimë dhe kështu do të humbin veten.
Aftësitë e veta dhe njohuritë profesionale dijetarët duhet t'ua përcjellin të tjerëve, e sidomos rinisë. Muhammedi a.s. i ka theksuar vetëm disa simptome të shkatërrimit të shoqërisë. Të kesh njërën nga këto simptome (vese) do të thotë se po shkon drejt greminës, e t'i kesh të katërtat, do të thotë je zhytur (je fundosur)në greminë. Mosdija është armiku më i madh i njeriut. Shkenca do të ekzistojë, por do të vdesin dijetarët gradualisht, e kur nuk do të ketë dijetarë, populli do t'i zgjedhë për udhëheqës të paditurit; atyre do t'u drejtohet populli për këshilla, e ata do t'u përgjigjen. Kështu, bota do të zhytet në humnerë.

31 Hadithin e lartpërmendur Malik b. Enesi e ka transmetuar në Basra, duke dashur me këtë t'i tregojë rinisë se duhet të mësojë dhe të ngrihet profesionalisht dhe tërhoqi vërejtjen në pasojat e dëmshme për fenë, për moralin, për ruajtjen e nderit të familjes dhe për pasurinë e fituar me nder. Mosdija e vështirëson të kuptuarit objektiv të jetës dhe të fesë; alkooli e shkatërron shëndetin, pasurinë familjen dhe famën; pakësimi i meshkujve sjell çrregullimin e strukturës gjinore të shoqërisë, kurse amoraliteti sjell shkatërrimin e familjes.
Zvogëlimi i numrit të meshkujve është rezultat i luftave, çrregullimeve shoqërore dhe luftës vëllavrasëse, pas së cilës, zakonisht, mbretëron skamja, uria, amoraliteti dhe

باب فضل العلم

٨٢ – حدثنا سعيدُ بنُ عُفَيرٍ قال : حدثني اللَّيثُ قال حدثني عُقيلٌ عن ابنِ شهاب عن حمزةَ بنِ عبدِ اللهِ ابنِ عُمَرَ أنَّ ابنَ عمرَ قال : سمعتُ رسولَ اللهِ ﷺ قال « بَيْنا أنا نائمٌ أُوتيتُ بقَدَحِ لَبَنٍ فشربتُ حتَّى إنِّي لأَرَى الرِّيَّ يَخرُجُ في أظفاري ، ثمَّ أعطَيتُ فضلي عُمَرَ بنَ الخطَّابِ » قالوا : فما أوَّلتَهُ يا رسولَ اللهِ ؟ قال « العلم »

Rëndësia e diturisë (shkencës)

82. Na ka treguar Se'id b. Ufejri, këtij Lejthi, këtij Ukajli, këtij Ibni Shihabi, ky nga Hamza b. Abdullah b. Umeri se Ibni Umeri ka thënë:

E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

"Derisa fleja, më kanë sjellur një gotë qumësht. Aq kam pirë sa që kam hetuar se më është shuar etja, sikur ajo (etja) **nëpër thonjë më dilte. Atë që më mbeti ia dhashë Umer b. Hattabit".**

"O Resulullah, si e shpjegon ti këtë?" i thanë.

"Me shkencë", tha Pejgamberi s.a.v.s.[32]

باب الفُتيا وهُوَ واقِفٌ على الدابَّةِ وغيرِها

٨٣ – حدثنا إسماعيلُ قال حدثني مالكٌ عن ابنِ شهابٍ عن عيسى بنِ طلحةَ بنِ عُبيدِ اللهِ عن عبدِ اللهِ بنِ عَمرِو بنِ العاصِ أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ وَقَفَ في حَجَّةِ الوَداعِ بِمِنًى للناسِ يَسألونَهُ فجاءَهُ رجلٌ فقال : لم أَشعُرْ فحَلَقتُ قبلَ أن أَذبَحَ . فقال : اذبَحْ ولا حَرَجَ . فجاءَ آخَرُ فقال : لم أَشعُرْ فنَحَرتُ قبلَ أن أَرمِيَ . قال : ارمِ ولا حَرَجَ . فما سُئِلَ النبيُّ ﷺ عن شيءٍ قُدِّمَ ولا أُخِّرَ إلَّا قال : افعل ولا حَرَجَ

---

epidemi të ndryshme. Kjo, me fjalë të tjera, sjell dobësimin e fuqisë së bashkësisë.

32 Pirjen e qumështit në ëndërr Muhammedi a.s. e krahasoi me mësimin dhe grumbullimin e njohurive, duke pasë parasysh dobinë e tyre përafërsisht të njëjtë për individin dhe për shoqërinë. Qumështi është ushqim për trupin, kurse shkenca për shpirtin. Qumështi është ushqim shumë i dobishëm për zhvillimin fizik të trupit dhe fuqisë trupore, kurse shkenca (dija) për ngritjen shpirtërore.

Pjesa e fundit e hadithit e vë theksin në mendjemprehtësinë, largpamësinë, dijeninë dhe përvojën e Hazreti Umerit.

Të dhënët përgjigje duke qenë hipur në deve ose në ndonjë kafshë tjetër

83. Na ka treguar Ismaili, këtij Maliku, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Isa b. Talha b. Ubejdullahu, ky nga Abdullah b. Amr b. el-Asi, i cili ka treguar se Pejgamberi s.a.v.s. gjatë Haxhxhit lamtumirës ka mbetur në Mine për shkak të njerëzve të cilët i kanë parashtruar pyetje. Ndër të tjerë, një njeri iu afrua dhe e pyeti:

"Meqë nuk kam ditë, jam rruar para se të ther (kurban)?"

Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj:

"Nuk ka gabim (gjynah), **ther kurban tash!"**

Pastaj iu afrua një njeri tjetër dhe e pyeti:

"Meqë nuk kam ditë, kam prerë (kurban) **para se të hedh guralecat** (në Mine)?.

(Pejgamberi s.a.v.s.) iu përgjigj:

"Nuk ka gabim (dëm), **hidh** (tash)"!

Pejgamberi s.a.v.s. nuk është pyetur për asgjë që është bërë më vonë, në vend që të bëhej më herët, e të mos jetë përgjigjur:

"Bëre tash, nuk ka dëm!".[33]

باب من أجاب الفتيا بإشارة اليد والرأس

٨٤ - حدثنا موسى بن إسماعيل قال حدثنا وهيب قال حدثنا أيوب عن عكرمة عن ابن عباس أن النبي ﷺ سئل في حجته فقال: ذبحت قبل أن أرمي، فأومأ بيده قال: ولا حرج. قال: حلقت قبل أن أذبح، فأومأ بيده: ولا حرج

33 Nga hadithi i lartpërmendur nënkuptohet:

- rekomandohet të pyetet eksperti për problemet e paqarta, si në shtëpi si jashtë saj;
- gjatë mbajtjes së ligjëratës, ose gjatë dhënies së përgjigjeve, ligjëruesi duhet të jetë në vend të lartë, me qëllim që ta shohin dhe ta dëgjojnë më mirë dëgjuesit;
- shkuarja me rend gjatë kryerjes së detyrimeve të haxhillëkut është sunnet ose vaxhib. Dijetarët e shkollës shafiite dhe hambelite konsiderojnë se radhitja përkatëse është sunnet, kurse Ebu Hanife dhe Maliku e konsiderojnë vaxhib. Këta të fundit thonë se, nëse bëhet ndonjë çrregullim në radhitje, atëherë duhet të përsëritet prerja e kurbanit.

Të përgjigjurit, duke sinjalizuar me dorë dhe me krye

84. Na ka treguar Musa b. Ismaili, këtij Vuhejbi, këtij Ejjubi, ky nga Ikrime, e ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë se Pejgamberi s.a.v.s. në Haxhxhin lamtumirës është pyetur nga dikush:

"Kam prerë kurban para se të hedh guralecat?"

Ai, pastaj, sinjalizoi me dorë dhe tha:

"Nuk ka dëm (gabim)**".**

Një tjetër pyeti:

"Kam rruar kokën para se të pres kurban?"

Pejgamberi s.a.v.s., përsëri sinjalizoi me dorë dhe tha:

"Nuk ka gabim (gjynah)**".**

٨٥ – حدثنا المكيُّ بنُ إبراهيمَ قال: أخبرنا حنظلةُ بنُ أبي سفيانَ عن سالمٍ قال: سمعتُ أبا هُريرةَ عنِ النبيِّ ﷺ قال «يُقبَضُ العِلمُ، ويَظهرُ الجهلُ والفِتَنُ، ويَكثُرُ الهَرْجُ». قيل: يا رسولَ اللهِ وما الهَرْجُ؟ فقال: هٰكذا بيدِه فحرَّفَها، كأنَّه يُريدُ القَتْلَ

85. Na ka treguar Mekkijj b. Ibrahimi, ky nga Handhale b. Sufjani, ky nga Salimi, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Do të bie interesimi për dituri, do të paraqitet mosdija dhe ngatërresat. Edhe çrregullimi (herxhi) **do të shumëfishohet".**

"O Resulullah, çka është "herxhi?" pyeti dikush.

"Kështu", e lëvizi dorën, bile e përmbysi, sikur kishte për qëllim therje (prerje).

٨٦ – حدثنا موسى بن إسماعيلَ قال حدثَنا وُهَيبٌ قال حدثَنا هِشامٌ عنْ فاطمةَ عن أسماءَ قالت: أتيتُ عائشةَ وهيَ تُصلِّي، فقلتُ: ما شأنُ الناسِ؟ فأشارتْ إلى السماءِ، فإذا الناسُ قِيامٌ فقالت: سُبحانَ اللهِ. قلتُ: آيةٌ. فأشارتْ برأسِها – أي نعم – فقمتُ حتى تجلاَّنِي الغَشْيُ، فجعلتُ أصبُّ عَلَى رأسِي الماءَ. فحَمِدَ اللهَ عزَّ وجلَّ النبيُّ ﷺ وأثنى عليهِ ثمَّ قال: ما مِنْ شيءٍ لم أكُنْ أُريتُه إلاَّ رأيتُه في مَقامي، حتَّى الجنةُ والنارُ. فأُوحِيَ إليَّ أنَّكم تُفتَنُونَ في قُبورِكم مِثْلَ، أو قريبَ – لا أدري أيَّ ذلكِ قالتْ أسماءُ – مِنْ فِتنةِ المسيحِ الدَّجَّالِ، يُقال: ما عِلمُكَ بهذا الرَّجُلِ؟ فأمَّا المؤمنُ، أو الموقِنُ – لا أدري بأيِّهما قالت أسماءُ – فيقولُ هُوَ محمدٌ رسولُ اللهِ جاءَنا بالبيِّناتِ والهُدَى، فأجَبْنا واتَّبَعْنا، هوَ محمدٌ (ثلاثًا). فيقال: نَمْ صالحًا، قد عَلِمْنا إنْ كنتَ لَموقِنًا به. وأمَّا المنافِقُ، أو المُرتابُ – لا أدري أيَّ ذلكَ قالتْ أسماءُ – فيقولُ: لا أدري، سمعتُ الناسَ يقولونَ شيئًا فقُلتُه

86. Na ka treguar Musa b. Ismaili, këtij Vuhejbi, këtij Hishami, ky nga Fatimja, e kjo nga Esmaja, e cila tregon:

Kam ardhë te Aishja, e cila ishte duke u falur. E pyeta:

"Ç'ngjet me këtë popull (nga çka frikohet)?" Ajo sinjalizoi me kokë kah qielli. Kur të gjithë qëndruan në namaz, (Aishja) tha: **"Subhanallah!"**

"A është kjo ndonjë shenjë?" e pyeta. Ajo më sinjalizoi me kokë **"po"**. Për këtë shkak edhe unë qëndrova (në namaz). Qëndrova derisa më ra të fikët. Fillova ta lag kokën me ujë.

(Pas namazit) Pejgamberi s.a.v.s. e falënderoi All-llahun e Madhërueshëm dhe tha:

"Nuk ka asgjë që nuk më është treguar dhe që nuk e kam parë duke qenë në këtë pozitë, bile (i kam parë) **Xhennetin dhe Xhehennemin".**

Më është shpallur (jam frymëzuar) **se në varret tuaja do të provoheni sikurse, ose së shpejti, nuk di se cilën shprehje e ka përdorë Esmaja, thotë transmetuesi, me provën e Dexhallit. Do të pyetet** (ndokush në varr):

"Çka di për atë njeri (d.m.th. për Pejgamberin s.a.v.s.)?"

Sa i përket besimtarit, përkatësisht atij që është i bindur në besim, nuk e di se cilën nga këto dy shprehje i ka përdor Esmaja, dyshon transmetuesi, do të përgjigjet: "Ai është Muhammedi, Pejgamber i All-llahut, i cili na ka sjellë neve argumente dhe udhëzime të qarta. Ne i jemi përgjigjur thirrjes së tij dhe e ndjekim rrugën e tij. Ai është Muhammedi!" do të thotë tri herë.

Atëherë do t'i thuhet atij: **"Fli qetë! E kemi ditë se me bindje të thellë e ke besuar atë".**

Dyfytyrëshi (munafiku), **ndërkaq, ose ai i cili ka dyshuar në Shpalljen, nuk e di se cilën shprehje e përdori Esmaja, do të shprehet kështu:"Nuk di. Kam dëgjuar se njerëzit diçka flisnin për të** (për Muhammedin), **po edhe unë kam folur ashtu për të".**[34]

---

34 Nga hadithi mund të nxirret përfundim:

- Xhenneti dhe Xhehennemi, pa dyshim, ekzistojnë. Për këtë flasin shumë ajete dhe hadithe. Edhe dijetarët islamë në këtë çështje janë të një mendjeje.

باب تحريض النبي ﷺ وفد عبد القيس على أن يحفظوا الإيمان، والعلم ويخبروا من وراءهم.
وقال مالك بن الحويرث: قال لنا النبي ﷺ «ارجعوا إلى أهليكم فعلموهم».

٨٧ — حدثنا محمد بن بشار قال حدثنا غندر قال حدثنا شعبة عن أبي جمرة قال: كنت أترجم بين ابن عباس وبين الناس، فقال: إن وفد عبد القيس أتوا النبي ﷺ فقال: من الوفد — أو من القوم — قالوا: ربيعة. فقال: مرحبا بالقوم — أو بالوفد — غير خزايا ولا ندامى. قالوا: إنا نأتيك من شقة بعيدة، وبيننا وبينك هذا الحي من كفار مضر، ولا نستطيع أن نأتيك إلا في شهر حرام، فمرنا بأمر نخبر به من وراءنا ندخل به الجنة. فأمرهم بأربع، ونهاهم عن أربع: أمرهم بالإيمان بالله عز وجل وحده، قال: هل تدرون ما الإيمان

Mu'tezilët kanë qëndrim tjetër. Ata mendojnë se Xhenneti dhe Xhehennemi ende nuk ekzistojnë, por do të krijohen në ditën kur do të jepet llogaria. Qëndrimin e Ademit dhe të Havës në Xhennet e komentojnë si të banimit të zakonshëm në një kopsht të pasur në një skaj të botës, me lloj-lloj pemësh, perimesh dhe me pasuri të tjera materiale.

Disa dijetarë islamë mendojnë se Xhenneti dhe Xhehennemi ekzistojnë diku jashtë sistemit diellor. Disa të tjerë konsiderojnë se përkufizimi hapësiror nuk mund të përcaktohet saktësisht. Theksohet se disa hebrenj kanë biseduar me H. Umerin për këtë çështje dhe e kanë pyetur: "Nëse Xhenneti ekziston në këtë botë, e ku është Xhehennemi?"

"Ku është dita, kur bie nata, përkatësisht ku është nata, kur paraqitet dita?" qe përgjigjur H. Umeri.

- dënimi në varr është realitet. Ky është mendim unanim i shkollave islame;
- paraqitja e dexhallit (gënjeshtarit), i cili me propagandën e vet i udhëzon njerëzit në rrugë të gabuar, është fakt real. Historia është plot dexhallë. Mashtrues ka pasë dhe do të ketë sa të jetë bota.
- falja e namazit me xhemat, para zënies së diellit dhe të hënës, është sunnet. Në këtë namaz mund të marrin pjesë edhe gratë.
- lejohet që falësin e namazit ta pyesësh për ndonjë çështje të rëndësishme dhe urgjente, e ai të përgjigjet me një lëvizje të vogël të kokës;
- në namaz nuk guxon të flasësh asgjë, përveç citimit të teksteve të caktuara nga Kur'ani në gjuhën arabe;
- veprimi me një dorë dhe shumë i vogël në namaz, nuk e prish namazin;
- me lexim më me zë, gruaja mund t'ua tërheq vëmendjen të pranishmëve për rrezikun eventual, por është më mirë ta bëjë këtë duke i rënë dorës së majtë me të djathtën;
- pasi të kryhet namazi është me interes të mbahen ligjërata;
- namazin nuk e prish alivanosja momentale, nga e cila nuk humbet vetëdija, ndërsa alivanosja totale dhe e gjatë, natyrisht, falësit do t'ia prishte namazin.

باللهِ وحدَه ؟ قالوا : اللهُ ورسولُه أعلمُ . قال : شهادةُ أنْ لا إلَهَ إلاَّ اللهُ وأنَّ محمداً رسولُ اللهِ . وَإقامُ الصلاةِ ، وإيتاء الزكاةِ ، وصومُ رَمضانَ ، وَتُعطوا الخُمُسَ مِنَ المَغْنَمِ . ونهاهم عن الدُّبّاءِ ، والحَنْتَمِ ، والمُزَفَّتِ ـ قال شُعبةُ : رُبَّما قال النَّقيرِ ، وربَّما قال المُقيَّرِ . قال : احفظوه وأخبروه مَنْ وراءكم

Ndikimi i Pejgamberit s.a.v.s. në delegacionin e Abdu-l-Kajsit t'i mbajë në mend parimet e besimit dhe të diturisë dhe t'i lajmërojë ata pas tyre

Malik b. Huvejrithi ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. ka urdhëruar: **"Kthehuni kah familjet tuaja dhe mësoni ata!"**

87. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari, këtij Gunderi, këtij Shu'be, e këtij Ebu Xhumre, i cili ka thënë:

Kam qenë përkthyes në mes Ibni Abbasit dhe palës tjetër dhe vazhdoi: **"Pejgamberit s.a.v.s. i erdhi delegacioni i fisit të Abdu-l-Kajsit të cilit i tha: " Delegacion i cilit fis, ose i cilit popull jeni?"**

Ata u përgjigjën: **"I (fisit) Rebi'a".**

(Pejgamberi s.a.v.s.) tha: **"Mirë se keni ardhë! Popull, ose delegacion, i cili s'ka pse të turpërohet e as të pendohet!"**

Ata thanë: **"Ne kemi ardhë nga një vend i largët. Në mes nesh dhe teje është fisi pabesimtar Mudar, prandaj, ne mund të vijmë vetëm në ndonje muaj të shenjtë. Na urdhëro çka t'i njoftojmë ata pas nesh dhe çka do të na ndihmojë për të hyrë në Xhennet".**

(Pejgamberi s.a.v.s.) **i urdhëroi për katër detyra, ndërsa ua ndaloi katër vese. I urdhëroi të besojnë në një të vetmin All-llah, duke i pyetur: "A dini si shprehet besimi në All-llahun?".**

Ata u përgjigjën: **"Këtë më së miri e di All-llahu dhe Pejgamberi i Tij".**

Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. u tha:

"Me dëshminë se nuk ka zot tjetër përveç një All-llahu dhe se Muhammedi, me të vërtetë, është Pejgamberi i Tij; me faljen e namazit; me dhënien e zeqatit; me agjërimin e muajit të Ramazanit dhe me dhënien e një të pestës së pasurisë së zënë në luftë."

Ua ndaloi: (lëngjet e prishura nga të ndenjurit) **në kungullin e ujit, në testi në bardak** (poç) **të lyer më katran** (rrëshirë).

Sipas Shu'bes, nganjëherë ka thënë **"në koritë"**, e nganjëherë **"në fuçinë e katranosur"**.

Në fund u tha: **"Mbajeni në mend këtë, ua transmetoni atyre pas jush"**.[35]

باب الرحلة في المسألة النازلة وتعليم أهله

٨٨ – حدثنا محمد بن مقاتل أبو الحسن قال أخبرنا عبد الله قال أخبرنا عمر بن سعيد بن أبي حسين قال حدثني عبد الله بن أبي مليكة عن عقبة بن الحارث أنه تزوج ابنة لأبي إهاب بن عزيز فأتته امرأة فقالت: إني قد أرضعت عقبة والتي تزوج. فقال لها عقبة: ما أعلم أنك أرضعتني. ولا أخبرتني. فركب إلى رسول الله ﷺ بالمدينة، فسأله، فقال رسول الله ﷺ: كيف وقد قيل؟ ففارقها عقبة، ونكحت زوجا غيره.

Udhëtimi për të gjetur përgjigje për pyetjet e dhëna dhe të mësuarit e familjes

88. Na ka treguar Muhammed b. Mukatil Ebu-l-Hasani, këtij Abdullahu, këtij Umer b. Se'id b. Ebu Husejni, këtij Abdullah b. Mulejke, këtij Ukbe b. Harithi se ky ishte martuar me vajzën e Ebu Ihab b. Azizit. Për këtë arsye te ky erdh një grua e cila i tha:

"Unë i kam dhënë gji Ukbes dhe asaj me të cilën është martuar."

35 Ibni Batali thotë se çdo musliman i cili mëson ose dëgjon diç nga tjetri, është i detyruar t'ia përcjellë atë dije tjetrit. Në ditët e para të përhapjes së Islamit, kjo është konsideruar detyrë e dorës së parë vetiake, kurse brengosja për ngritjen kulturore-arsimore të anëtarëve të familjes, detyrë edhe më e madhe.

"Nuk e di se më ke dhënë gji, e as që më ke lajmëruar për këtë", i tha Ukbja.

Ai, atëherë, ia mësyu udhëtimit, i hipi deves dhe u nis për në Medine te Pejgamberi s.a.v.s. E pyeti për rastin. Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj: **"Si mund të ndodhë kjo** (të martohesh me të), **e flitet se e ke motër** (nga qumështi)!"

Ukbja menjëherë u nda nga ajo. Edhe ajo u martua me një burrë tjetër.[36]

36 Nga hadithi konkludohet;
- muslimani është i detyruar t'u largohet punëve për të cilat nuk është i sigurtë se janë të lejushme dhe është i obliguar të kërkojë dituri deri sa të jetë gjallë;

Sha'biu ka thënë: "Udhëtimi nga veriu i Sirisë në Jug të Jemenit nuk duhet të konsiderohet i kotë, nëse mëson bile një fjalë, e cila do të jetë e dobishme.

Sipas mendimit të Ahmed Ibni Hambelit, dëshmimi i mëndeshës se i ka dhënë gji fëmijës së huaj është i vlefshëm, kurse Maliku thotë: "Dëshmimi i mëndeshës është i vlefshëm (i plotfuqishëm), nëse për këtë veprim të saj janë të njoftuar të afërmit e fëmijës ose fqinjët e saj. Dëshminë e këtillë të mëndeshës, sipas rastit konkret, Ebu Hanife nuk e konsideron aspak të vlefshëm. Muhammedi a.s. ia tërhoqi vërejtjen Ukbes vetëm për t'iu larguar veprës së natyrës së dyshimtë, e jo që ka qenë plotësisht i sigurtë në deklaratën e mëndeshës.

Disa juristë të shkollës shafiite mendojnë se dëshmia e mëndeshës nuk mund të merret për bazë, nëse ajo e paraqet këtë për të marrë ndonjë kompenzim për mundin e saj, ose për ndonjë interes tjetër personal. Në të kundërtën, dëshmia e mëndeshës duhet të merret parasysh, por, nëse nuk argumentohet mjaftueshëm, mund të hidhet poshtë (të mos pranohet). Që dëshmia të jetë e vlefshme dhe e drejtë, duhet të deklarojnë dy meshkuj të njohur, ose një mashkull dhe dy femra.

بَابُ التَّنَاوُبِ فِي الْعِلْمِ

٨٩ - حدثنا أبو اليمانِ أخبرنا شُعَيبٌ عنِ الزُّهْرِيِّ . ح . قال أبو عبدِ اللهِ وقال ابنُ وَهبٍ أخبرنا يونُسُ عنِ ابنِ شِهابٍ عن عُبَيدِ اللهِ بنِ عبدِ اللهِ بنِ أبي ثَورٍ عن عبدِ اللهِ بنِ عبَّاسٍ عن عُمَرَ قال : كنتُ أنا وجارٌ لي مِنَ الأنصارِ في بني أُمَيَّةَ بنِ زيدٍ - وهي مِن عَوالي المدينةِ - وكنَّا نَتَناوَبُ النُّزولَ عَلَى رسولِ اللهِ ﷺ ، يَنزِلُ يَوماً وأنزِلُ يوماً ، فإذا نَزَلتُ جِئتُه بخَبَرِ ذٰلكَ اليومِ مِنَ الوحيِ وغيرِه ، وإذا نَزَلَ فَعَلَ مِثلَ ذٰلكَ . فنَزَلَ صاحِبي الأنصاريُّ يومَ نَوبَتِهِ ففَرَبَ بابي ضَرباً شَديداً فقال : أثَمَّ هوَ ؟ ففَزِعتُ ، فخَرَجتُ إليهِ فقال : قد حدثَ أمرٌ عظيمٌ . . قال فدخلتُ على حفصةَ فإذا هي تبكي ، فقلتُ : طلَّقكُنَّ رسولُ اللهِ ؟ قالت : لا أدري . ثمَّ دخلتُ على النبيِّ ﷺ فقلتُ وأنا قائمٌ : أطلَّقتَ نساءَكَ ؟ قال : لا . فقلتُ : اللهُ أكبرُ

Vizita e vazhdueshme (njëra pas tjetrës) për diturí (shkencë)

89. Na ka treguar Ebu-l-Jemani, këtij ia kishte transmetuar Shu'ajbi, këtij Zuhriu, e sipas një vargu tjetër të transmetuesve, Ebu Abdullahu (Buhariu) thotë se Ibni Vehbi ka deklaruar se atij ia ka transmetuar Junusi, këtij Ibni Shihabi, ky nga Ubejdullah b. Abdullah b. Ebu Thevri, ky nga Abdullah b. Abbasi, e ky nga Umeri i cili ka thënë:

Unë dhe fqiu im Ensar (nga Ensarët) kemi banuar në vendin Beni Umejje b. Zejd. Ky vend ishte në Avali të Medines (Avali ishte katund në Medine), prandaj zbritnim (shkonim) te Pejgamberi s.a.v.s. herë njëri, e herë tjetri. Ai zbriste një ditë, e të dytën unë. Kur zbritja unë, atë ditë sillja lajme për Shpalljen e All-llahut xh. sh. dhe për të tjerat. Edhe ai kur zbriste, e bënte të njëjtën. Një ditë, sipas radhës, shkoi shoku im Ensar. (Kur u kthye) trokiti rreptë te dera ime, duke thënë: **"Ai** (duke menduar në mua) **a është këtu?"** Unë u frikova, dola para tij. Më tha: **"Ka ndodhur një gjë e madhe! Hyra te Hafsa, ajo qante".** E pyeta: **"Ju ka lëshuar juve Pejgamberi s.a.v.s.?", "Nuk e di"**, tha.

Pastaj hyra te Pejgamberi s.a.v.s. dhe, duke qëndruar në këmbë e pyeta: **"A i ke lëshuar gratë tua"**

"Jo", tha.

Pastaj, thashë: "**All-llahu është më i madhi**".[37]

بَابُ الغَضَبِ فِي المَوْعِظَةِ وَالتَّعْلِيمِ إِذَا رَأَى مَا يَكْرَهُ

٩٠ ـ حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ كَثِيرٍ قَالَ أَخْبَرَنَا سُفْيَانُ عَنِ ابْنِ أَبِي خَالِدٍ عَنْ قَيْسِ بْنِ أَبِي حَازِمٍ عَنْ أَبِي مَسْعُودٍ الأَنْصَارِيِّ قَالَ: قَالَ رَجُلٌ يَا رَسُولَ اللَّهِ لاَ أَكَادُ أُدْرِكُ الصَّلاَةَ مِمَّا يُطَوِّلُ بِنَا فُلاَنٌ. فَمَا رَأَيْتُ النَّبِيَّ ﷺ فِي مَوْعِظَةٍ أَشَدَّ غَضَبًا مِنْ يَوْمِئِذٍ فَقَالَ: «أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّكُمْ مُنَفِّرُونَ، فَمَنْ صَلَّى بِالنَّاسِ فَلْيُخَفِّفْ، فَإِنَّ فِيهِمُ المَرِيضَ وَالضَّعِيفَ وَذَا الحَاجَةِ»

Zemërimi gjatë këshillimit dhe të mësuarit kur hetohet diçka e keqe

90. Na ka treguar Muhammed b. Kethiri, këtij Sufjani, këtij Ibni Ebu Halidi, ky nga Kajs b. Ebu Hazimi, ky nga Ebu Mes'ud el-Ensariu, i cili ka thënë se një njëri i ka thënë Pejgamberit s.a.v.s.:

"O Resulullah, filani aq na zgjat namazin saqë shpesh më vjen ta lë atë (namazin)".

Asnjëherë nuk e kam parë Pejgamberin s.a.v.s. më të zemëruar në fjalimin e tij sa atë çast kur tha:

"O ju njerëz! ju me të vërtetë jeni shkapërderdhës (të xhematit). **Kush fal namazin para njerëzve** (kush bëhet imam), **le ta lehtësojë atë**

---

37 Në këtë hadith theksohet se As-habët kanë vënë rend për të marrë pjesë në ligjëratat e Muhammedit a.s. rregullisht dhe ato t'ua transmetojnë familjeve dhe të afërmve të tyre. Dëshira për dijeni te ata ishte më e fuqishme se çdo vështirësi. Rruga e gjatë, shpenzimet materiale dhe mundimet fizike nuk kanë mundur t'ua thejnë dëshirën për hulumtimin e dijenisë.

Nga hadithi nxirret përfundimi:

- dijeninë duhet kërkuar gjithnjë.
- për suksese në dijeni, duhet patur durim, qetësi shpirtërore dhe koncentrim mendor;
- thënia e ndonjë mashkulli të besueshëm në shumë raste është e vlefshme;
- hadithet e Muhammedit a.s. As-habët ua kanë transmetuar fjalë për fjale të tjerëve;
- në shtëpi të huaj hyret me paralajmërim, ose me lejen e të zotit të saj;
- njohuritë duhet zgjëruar me lexim të pandërprerë;
- është e arsyeshme të shprehësh hidhërim të matur ndaj anëtarëve të familjes, për shkak të të metave ose të sjelljeve të tyre të papërmbajtura.

(namazin), **sepse, në mes tyre** (xhematit) **ka ndonjë që është i sëmurë, shëndetlig dhe nevojtar!"**.[38]

٩١ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ محمدٍ قال حدثنا أبو عامرٍ قال حدثنا سُلَيمانُ بنُ بلالٍ المَدِينِي عن رَبيعةَ بنِ أبي عبدِ الرحمٰنِ عن يَزيدَ مولى المُنبَعِثِ عن زَيدِ بنِ خالدٍ الجُهَنِيِّ أنَّ النبيَّ ﷺ سَأَلَهُ رَجُلٌ عن اللُّقَطَةِ فقال « اعرِفْ وِكاءَها – أو قال : وِعاءَها ، وعِفاصَها ، ثمَّ عَرِّفْها سَنَةً ثمَّ استَمتِعْ بها ، فان جاء ربُّها فأدِّها إليه » قال : فَضالَّةُ الإبلِ ؟ فَغَضِبَ حتى احمَرَّت وَجْنَتاهُ – أو قال : احمَرَّ وَجهُهُ – فقال « وَمالَكَ ولها ؟ معَها سِقاؤُها وحِذاؤُها تَرِدُ الماءَ وَتَرْعى الشَّجَرَ ، فذَرْها حتى يَلْقاها رَبُّها » قال : فَضالَّةُ الغَنَمِ ؟ قال « لكَ أو لِأَخِيكَ أو للذِّئبِ »

91. Na ka treguar Abdullah b. Muhammedi, këtij Ebu Amiri, këtij Sulejman b. Bilal el-Mediniu, ky nga Rebi'a b. Ebu Abdu-r-Rahmani, ky nga Jezidi, rob i liruar i el-Munbeithit, ky nga Jezid b. Halid Xhuhejniu se një njeri e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s. për një gjë të gjetur. Pejgamberi s.a.v.s. i është përgjigjur atij:

"Mbaje në mend rrypin (gjalmin) **e saj ose kutinë e saj dhe strajcën e saj** (këllëfin) **dhe shpalle atë** (publikisht) **një vit, pastaj shërbehu me të, e nëse vjen zotëriu i saj, ti jepja!"**

"E, devja e humbur?" pyeti njeriu.

Ai (Pejgamberi s.a.v.s.) aq u zemërua, saqë faqet iu skuqen, ose, si tha transmetuesi, fytyra iu skuq dhe tha:

"Çka ke ti me të! Ajo ka me vete lugun e vet të ujit (rezervoarin) **dhe mbathjen e vet; vjen te uji dhe bren** (zgrap) **drunjtë, prandaj, lëre atë, derisa ta gjejë zotëriu i saj!"**

"E, bagëtia e humbur?" pyeti përsëri njeriu.

"Ajo është ytja. e shokut tënd ose e ujkut", u përgjigj.[39]

---

38 Nga hadithi përfundohet:
- mospjesmarrja në faljen e namazit me xhemat mund të arsyetohet me zgjatjen e tepërt të namazit nga ana e imamit.

39 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- gjënë e gjetur duhet lajmëruar një vit, për çdo ditë nga dy herë;
- nëse pronari e përshkruan drejt gjënë e gjetur, ose enën (torbën, strajcën) në të cilën ka qenë ajo, ajo mund t'i dorëzohet menjëherë atij. Megjithatë, ai nuk mund ta detyrojë,

derisa nuk ia përshkruan hollësisht, sepse Muhammedi a.s. në një hadith tjetër ka thënë: "Pala duhet ta argumentojë hollësisht pohimin e vet".

Maliku dhe Shafiu mendojnë se sendi i gjetur duhet t'i kthehet pronarit, posa ta njohë enën (torbën) ose gjalmin, siç është thënë në hadithin e lartpërmendur.

Maliku thotë se sendin ose lëndën delikate, e cila mund të prishet në rrugë, ai që e gjen më mirë është ta marrë. Dijetarët e shkollës shafiite, ndërkaq, kanë mendime të ndryshme: një grup thotë se ai që e gjen sendin është mirë ta marrë, grupi tjetër thotë se e ka për detyrë ta marrë, kurse grupi i tretë thotë se ai që e gjen sendin e ka për detyrë ta marrë, nëse konsideron se po të qëndrojë ende në rrugë, vërtet do të prishet.

Ahmed Ibni Hambeli mendon se, megjithatë, është më mirë ta lësh edhe më tutje në rrugë, sepse pronari më parë do ta gjejë. Në komentin e Tahaviut qëndron: gjëja e humbur, nëse jeni të sigurtë se do të shkatërrohet duke ndenjur në rrugë, të merret është më mirë, sesa të lihet skaj rrugës.

Në "Hulâsatu-l-Fetâvâ" qëndron: "nëse gjësë së humbur i kërcënohet rreziku nga prishja totale, është detyrë parësore (farz) të merret e përndryshe ai që e gjen të sillet sipas mendimit të vet. Këtë mendim e mbështesin shumica e dijetarëve islamë.

- deven, kalin, mushkën, gomarin që humbin nuk duhet kapur, sepse këto kafshë janë të afta të mbrohen nga armiku i tyre;

Përfaqësuesit e shkollës hanefite mendojnë se kafshët shtëpiake të humbura lejohet të kapen dhe të ruhen, sepse janë kafshë të cilat mund të dëmtohen dhe të shkatërrohen lehtë;

- paraqitja e gjësë së humbur, e humb vlerën, kur gjetësi formon bindje se nuk do të mund ta gjejë pronarin. Imami Muhammed, duke përcjellur mendimin e mësuesit të vet, Ebu Hanifes, mendon se gjëja e gjetur me vlerë deri në 10 dirhem, duhet të shpallet publikisht disa ditë, prej 10 e më tepër, një vit, ndërsa Imam Ahmedi, Maliku dhe Shafiu mbajnë qëndrimin se gjënë e humbur duhet shpallur një vit, pavarësisht nga vlera e saj.

Nga Ebu Hanifja rrjedh mendimi se gjënë e humbur me vlerë prej 1 dirhemi duhet ta lajmërosh një ditë, prej tri derhemë, tri ditë, prej 10 dirhemë, një javë, prej 10-200, një muaj, e prej 200 e më tepër dirhemësh, një vit. Nëse gjehet hurma ose ndonjë lloj tjetër e pemëve, ai që e gjen, do ta marrë, e ta ndajë sadaka.

Në "el-Hidaje" theksohet: "Gjëja e gjetur, për të cilën, zakonisht e di që i zoti i saj nuk do ta kërkojë, lejohet të merret e të shfrytëzohet për nevoja vetiake, pa e lajmëruar atë, por duhet patur parasysh se, megjithatë, ajo është e pronarit të vjetër.

Në Sunenin e Ebu Davudit theksohet se Muhammedi a.s. ka lejuar që nga rruga mund të merret shkopi, kamxhiku ose litari i shkurtër dhe, ai që i gjen këto, t'i përdorë, e gjërat e gjetura të pavlerë, për të cilat jemi të sigurt se pronari nuk do t'i kërkojë, nuk ka nevojë të lajmërohen;

- ai që e gjen gjënë, ka të drejtë ta shfrytëzojë, nëse është i varfër dhe nëse i duhet.

Shafiu thotë se gjënë e gjetur, mund ta përdorë ai që e gjen, qoftë i varfër ose i pasur.

Hatabiu, duke u bazuar në hadithin e lartpërmendur, thotë se gjënë e gjetur duhet lajmëruar një vit. Gjatë asaj kohe gjetësi mund ta përdorë për nevojat e veta, me kusht

٩٢ — حدثنا محمد بن العلاء قال حدثنا أبو أسامة عن بُرَيد عن أبي بُردة عن أبي موسى قال : سُئل النبيُّ ﷺ عن أشياء كرِهها ، فلمّا أكثِرَ عليه غضِبَ ثم قال للناس : سَلُوني عمّا شِئتُم قال رجُلٌ : مَن أبي ؟ قال : أبوكَ حُذافةُ . فقام آخرُ فقال : مَن أبي يا رسولَ اللهِ ؟ فقال : أبوكَ سالمٌ مولى شَيْبةَ . فلمّا رأى عُمرُ ما في وجهِهِ قال : يا رسولَ اللهِ إنّا نتوبُ إلى اللهِ عزّ وجلّ

92. Na ka treguar Muhammed b. el-Alai, këtij Ebu Usamja, këtij Burejdi, ky nga Ebu Burde, ky nga Ebu Musai, i cili ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. qe pyetur për disa gjëra të papëlqyeshme dhe kur ato u shpeshtuan, ai u zemërua dhe tha: **"Më pyetni çka të doni!"**

"Cili është babai im?" e pyeti dikush.

"Babai yt është Hudhafja", u përgjigj.

"Cili është babai im?" e pyeti një tjetër.

"Babai yt është Salimi, rob i liruar i Shejbës" tha.

Kur Uumeri vërejti në fytyrën e tij zemërimin, tha:

"O Resulullah, i drejtohemi All-llahut të Madhërueshëm të na i fal gabimet!"

باب من بَرَكَ على رُكبَتَيهِ عندَ الإمام أو المُحدِّث

٩٣ — حدثنا أبو اليمانِ قال أخبرَنا شُعَيبٌ قال : أخبرَني أنسُ بنُ مالكٍ أنّ رسولَ اللهِ ﷺ خَرَجَ فقام عبدُ اللهِ بنُ حُذافةَ فقال : مَنْ أبي ؟ فقال : أبوكَ حُذافةُ . ثم أكثَرَ أنْ يقولَ « سَلُوني » . فبَرَكَ عُمرُ على رُكبَتَيهِ فقال : رَضِينا باللهِ ربًّا ، وبالإسلامِ دِينًا ، وبمحمدٍ ﷺ نبيًّا . فسَكَتَ

---

që ajo t'i kthehet pronarit të paraqitur, nëse nuk e kalon një vit, në të kundërtën, gjetësi ia pagon vlerën pronarit të saj.

Maliku thotë: "Kur të kaloj koha e paraqitjes (lajmërimit), është mirë që në emër të gjësë së gjetur të ndahet sadaka, duke llogaritur edhe kompenzimin e përdorimit të saj njëvjeçar.

Evzaiu mendon se gjënë e gjetur me vlerë, duhet dorëzuar arkës shtetërore, kurse juristët e shkollës hanefite thonë se pas kalimit të kohës njëvjeçare, duhet t'i ndahet të varfërve, si sadaka e zakonshme.

Rënia në gjunj para imamit ose ligjëruesit

93. Na ka treguar Ebu-l-Jemani këtij Shu'ajbi, këtij Zuhriu, ky nga Enes b. Maliku se (një ditë) kur Pejgamberi s.a.v.s. kishte dalë para njerëzve, Abdullah b. Hudhafe ishte ngritur dhe e kishte pyetur:

"Cili është babai im?"

"Babai yt është Hudhafja", i qe përgjigjur.

Pasi u shtuan pyetjet, tha: **"Më pyetni ende".**

Për këtë arsye, Umeri ra në gjunj dhe tha: **"Ne jemi të kënaqur që All-llahu është Zot; Islami fe dhe, Muhammedi s.a.v.s. Pejgamber!"**

Pastaj Pejgamberi s.a.v.s. u qetësua.[40]

بابٌ من أعادَ الحديثَ ثلاثاً ليُفهَمَ عنه فقال : « ألا وقولُ الزُّورِ » ، فما زالَ يُكرِّرُها .

وقال ابنُ عُمرَ : قال النبيُّ ﷺ « هَل بَلَّغْتُ » ؟ ثلاثاً

Përsëritja e deklaratave tri herë me qëllim që të kuptohen më mirë

Dhe ka thënë: "... Ja, edhe dëshmia e rrejshme..." që vazhdimisht përsëritet.

Ibni Umeri ka thënë se Pejgamberi s.a.v.s. (kur ka dashur të theksojë diçka) tri herë ka përsëritur: **"A ju kam njoftuar mirë?"**

٩٤ — حدثنا عَبْدَةُ قال حدثنا عبدُ الصَّمَدِ قال حدثنا عبدُ اللهِ بنُ المُثَنَّى قال حدثنا ثُمامَةُ بنُ عبدِ اللهِ عن أنسٍ عنِ النبيِّ ﷺ أنه كان إذا سَلَّمَ سَلَّمَ ثلاثاً ، وإذا تَكلَّمَ بكلمةٍ أعادَها ثلاثاً

40 Durimi dhe sjellja shembullore e Muhammedit a.s. ndaj dëgjuesve, duhet të jetë shembull për të gjithë pedagogët.

Hazreti Umeri, në një mënyrë, e ndaloi shtruarjen e pyetjeve të pavend dhe me këtë tërhoqi vëmendjen në vënien e disiplinës së domosdoshme, në rendin dhe respektin ndaj ligjëruesit.

94. Na ka treguar Abde, këtij Abdu-s-Samedi, këtij Abdullah b. Muthennai, këtij Thumame b. Abdullahu, ky nga Enesi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. **se ai** (Pejgamberi), **kur do të përshendeste, përshëndeste nga tri herë, kur do të fliste diçka, e përsëriste nga tri herë.**

٩٥ – حدثنا عبدةُ بنُ عبدِ اللهِ حدثنا عبدُ الصمدِ قال حدثنا عبدُ اللهِ بنُ المثنّى قال حدثنا ثُمامةُ بنُ عبدِ اللهِ عن أنسٍ عنِ النبيِّ ﷺ أنه كان إذا تكلّم بكلمةٍ أعادَها ثلاثاً حتّى تُفهمَ عنه ، وإذا أتى على قومٍ فسلّمَ عليهم سلّمَ عليهم ثلاثاً

95. Na ka treguar Abde b. Abdullahu, këtij Abdu-s-Samedi, këtij Abdullah b. Muthennai, ky nga Thumame b. Abdullahu, ky nga Enesi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. **se ai** (Pejgamberi), **kur diçka fliste, e përsëriste tri herë, që të kuptohej më mirë, e kur dilte para masës, përshëndeste tri herë.**

٩٦ – حدثنا مُسدَّدٌ قال حدثنا أبو عَوانةَ عن أبي بِشْرٍ عن يوسفَ بنِ ماهكَ عن عبدِ اللهِ بنِ عمرٍو قال : تخلّفَ رسولُ اللهِ ﷺ في سَفَرٍ سافرْناه ، فأدرَكَنا وقد أرهقَتْنا الصلاةُ صلاةَ العصرِ ونحنُ نتوضّأُ ، فجعَلْنا نَمسَحُ على أرجُلِنا ، فنادَى بأعلى صَوتِهِ « وَيلٌ لِلأعْقابِ منَ النارِ » مرّتَيْنِ أو ثلاثاً

96. Na ka treguar Museddedi, këtij Ebu Avane, këtij Ebu Bishri, ky nga Ebu Jusuf b. Mahiku, ky nga Abdullah b. Amri, i cili ka thënë:

"Në një udhëtim që e bëmë së bashku, Pejgamberi s.a.v.s. mbeti prapa. Na mbërrini kah mbarimi i kohës së namazit të iqindisë. Ne kishim marrë abdest dhe u bënim mes-h këmbëve (i lanim me shumë pak ujë), **e ai** (Pejgamberi s.a.v.s.) **me një zë të lartë bërtiti dy a tri herë: "Mjerë për thembrat** (që do të digjen) **nga zjarri i Xhehennemit".**[41]

---

41 Nga përmbajtja e hadithit të dytë shihet se Muhammedi a.s. së pari ka përshëndetur (ka dhënë selam) kur afrohej në shoqëri, si paralajmërim për të kërkuar leje të hyjë në mesin e shoqërisë; së dyti, kur tashmë ka hyrë dhe është ulur në mesin e shoqërisë dhe, së treti, kur është ndarë nga shoqëria. Kjo ka qenë praktika e përhershme e Muhammedit a.s.

بَابُ تَعْلِيمِ الرَّجُلِ أَمَتَهُ وَأَهْلَهُ

٩٧ - أَخْبَرَنَا مُحَمَّدٌ - هُوَ ابْنُ سَلَامٍ - حَدَّثَنَا الْمُحَارِبِيُّ قَالَ حَدَّثَنَا صَالِحُ بْنُ حَيَّانَ قَالَ : قَالَ عَامِرٌ الشَّعْبِيُّ حَدَّثَنِي أَبُو بُرْدَةَ عَنْ أَبِيهِ قَالَ : قَالَ رَسُولُ اللهِ ﷺ « ثَلَاثَةٌ لَهُمْ أَجْرَانِ : رَجُلٌ مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ آمَنَ بِنَبِيِّهِ وَآمَنَ بِمُحَمَّدٍ ﷺ ، وَالْعَبْدُ الْمَمْلُوكُ إِذَا أَدَّى حَقَّ اللهِ وَحَقَّ مَوَالِيهِ ، وَرَجُلٌ كَانَتْ عِنْدَهُ أَمَةٌ فَأَدَّبَهَا فَأَحْسَنَ تَأْدِيبَهَا ، وَعَلَّمَهَا فَأَحْسَنَ تَعْلِيمَهَا ، ثُمَّ أَعْتَقَهَا فَتَزَوَّجَهَا ، فَلَهُ أَجْرَانِ »

ثُمَّ قَالَ عَامِرٌ : أَعْطَيْنَاكَهَا بِغَيْرِ شَيْءٍ ، قَدْ كَانَ يُرْكَبُ فِيمَا دُونَهَا إِلَى الْمَدِينَةِ

Detyra e njeriut për ta mësuar shërbetoren dhe familjen e tij

97. Na ka njoftuar Muhammed b. Selami, këtij Muharibiu, këtij Salih b. Hajjami, këtij Amir esh-Sha'biu, ky nga Ebu Burde, duke transmetuar nga babai i vet, i cili ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Tri lloj të njerëzve do të kenë nga dy shpërblime: ithtari i Librave të mëparshme, i cili i ka besuar Pejgamberit të tij dhe e beson edhe Muhammedin s.a.v.s.; robi (shërbetori) **i cili e kryen detyrën e tij ndaj All-llahut xh.sh., edhe ndaj zotëriut të tij dhe, njeriu i cili ka pasë shërbetore** (robëreshë) **të cilën e ka rritur dhe e ka mësuar mirë dhe, kështu, e ka përmirësuar edukimin e saj arsimor, pastaj e ka liruar dhe e ka martuar. Këta do të kenë nga dy shpërblime".**

Pastaj Amir esh-Sha'biu ka thënë: **"Ta kemi dhënë këtë sqarim, pa asfarë kompenzimi. Për njohuritë, bile më të vogla shkohet madje deri në Medine."**[42]

---

42 Amir Sha'biu e ka përcjellur këtë hadith në Horasan, me kërkesën e vendasve, të cilët e kanë pyetur për pasojat e veprimit të njeriut i cili e rrit robëreshën, e liron, e pastaj martohet me të.

Nga hadithi merret vesh:

- All-llahu xh.sh. e shpërblen bamirësinë dyfish;
- gjatë paraqitjes së dijenisë dhe dhënies së shpjegimeve, mund të theksohet rëndësia e saj. Kjo te dëgjuesit zgjon interesimin për dijeni dhe për thellimin e problemit;
- gjeneratat e para të muslimanëve kanë shkuar nga një qytet në tjetrin, nga një vend në tjetrin, vetëm e vetëm të dëgjojnë ndonjë hadith, ose vetëm për t'u njoftuar saktësisht për

باب عظة الإمام النساء وتعليمهن

٩٨ ـ حدثنا سليمان بن حرب قال حدثنا شعبة عن أيوب قال: سمعت عطاء قال سمعت ابن عباس قال: أشهد على النبي ﷺ ـ أو قال عطاء أشهد على ابن عباس أن رسول الله ﷺ ـ خرج ومعه بلال فظن أنه لم يسمع، فوعظهن وأمرهن بالصدقة فجعلت المرأة تلقي القرط والخاتم، وبلال يأخذ في طرف ثوبه

وقال إسماعيل عن أيوب عن عطاء وقال عن ابن عباس: أشهد على النبي ﷺ

Mbajtja e ligjëratave para grave dhe të mësuarit e tyre

98. Na ka treguar Sulejman b. Harbi, ky nga Shu'be,ky nga Ejjubi ky nga Atai, ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë:

"Kam qenë i pranishëm te Pejgamberi s.a.v.s., ose vetë Atai ka thënë: Mbështetem në Ibni Abbasin se Pejgamberi s.a.v.s. duke menduar se gratë nuk do të mund të dëgjojnë, ndonëse me të ishte Bilali, doli para tyre; e mbajti ligjëratën dhe tha që të japin lëmoshë (sadaka). (Këto fjalë patën ndikim të madh), **prandaj, një grua ia hodhi qaforen dhe unazën, e, Bilali i mblodhi në skajin e teshës së vet"**.

Hadithin e sipërshënuar Ismaili e ka transmetuar nga Ejjubi, ky nga Atai, ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë: **"Kam qenë prezent te Pejgamberi s.a.v.s."**[43]

---

ndonjë çështje;
- atëbotë Medinja ishte qendër e diturisë islame.

43 Nga hadithi i sipërpërmendur mund të kuptohet:
- ligjëratat duhet t'u organizohen edhe grave. Atyre t'u mësohen rregullat islame, detyrat e amvisërisë së mirë dhe nënave shembullore, duke zhvilluar te ato ndjenjën e dhembshurisë dhe të së drejtës sociale.
- imami mban përgjegjësinë për ngritjen kulturore-morale të xhematit të vet;
- ndarja e sadakasë është e vlefshme edhe pa ecuri të posaçme të pranim-dorëzimit;
- sadakaja e shpëton besimtarin nga zjarri i Xhehennemit dhe i largon shumë gjëra të pakëndshme të kësaj bote;
- gruaja ka të drejtë të ndajë sadaka nga pasuria personale, pa lejen e burrit. Maliku mendon se gruaja ka të drejtë të ndajë sadaka pa lejen e burrit vetëm në shumën e një të tretës së pasurisë së vet, përndryshe është i domosdoshëm pëlqimi i burrit. Ky pëlqim mund të jetë edhe në formë të heshtjes, siç është rasti në hadithin e lartpërmendur.

باب الحِرْصِ على الحَدِيث

٩٩ ـ حدثنا عبدُ العزيزِ بنُ عبدِ اللهِ قال : حدثني سُليمانُ عن عمرِو بنِ أبي عمرٍو عن سَعيدِ بنِ أبي سَعيدٍ المَقْبُرِيِّ عن أبي هُرَيرةَ أنه قال : قيلَ يا رسولَ اللهِ مَنْ أسعدُ الناسِ بِشَفاعَتِكَ يومَ القيامةِ ؟ قال رسولُ اللهِ ﷺ « لقد ظننتُ يا أبا هُرَيرةَ أن لا يَسْأَلَني عن هذا الحديثِ أحدٌ أوَّلَ منكَ ، لِما رأيتُ من حِرصِكَ على الحديث . أسعدُ الناسِ بشفاعتي يومَ القيامةِ من قال لا إلهَ إلاَّ اللهُ خالِصاً مِن قَلبِه ، أو نفسِه »

Dëshira e flaktë për ta mësuar Hadithin

99. Na ka treguar Abdu-l-Aziz b. Abdullahu, këtij i ka treguar Sulejmani, këtij Amr b. Ebu Amri, ky nga Se'id b. Ebu Se'id el-Makburiu, e ky nga Ebu Hurejre, i cili tregon:

Është thënë: **O Resulullah, cili do të jetë në Ditën e Kijametit më së shumti nën mbrojtjen tënde?"**

Pejgamberi s.a.v.s. tha:

"O Ebu Hurejre, e kam ditë se para teje asnjë nuk do të më pyes për këtë çështje, sepse kam vënë re dëshirën tënde të zjarrtë për hadithe. Në Ditën e Kijametit mbrojtja ime (shefaati) **do të jetë për atë i cili nga zemra, sinqerisht, ose nga shpirti ka thënë:**

"Nuk ka zot përveç All-llahut".[44]

---

44 Sipas përmbajtjes së këtij hadithi, mbështetjen (shefaatin) e Pejgamberit a.s. në Ditën e Gjykimit do ta kenë vetëm njerëzit me besim dhe me punë të sinqertë. Muhammedi a.s. në një hadith tjetër ka thënë: "Çdo Pejgamberi i është dhënë e drejta për të zgjedhur diçka. Unë kam zgjedhur për vete të drejtën për mbrojtjen e ummetit (trashëgimtarëve) tim. Shpresoj se mbrojtja ime (shefaati) do të jetë e dobishme për ummetin tim, i cili, më të vërtetë dhe sinqerisht i ka bërë ibadet All-llahut xh. sh."

Shefaatin (ndërmjetësimin)e mohojnë harixhitët dhe disa mutezilë. Ajetet dhe hadithet që bëjnë fjalë për mbrojtjen e gabimtarëve në Ditën e Gjykimit, ata i shpjegojnë ndryshe nga dijetarët e shkollës burimore islame.

Sipas mendimit të dijetarëve të katër shkollave burimore islame, me shefaatin (ndërmjetësimin) e Pejgamberit a.s. ndaj atyre që kanë bërë gabime, vetëm do të realizoheshin cilësitë e All-llahut xh.sh.: "Mëshirëplotë, Mëshirues, Falës" etj., të cilat përmenden në Kur'an me qindra herë.

Nga hadithi kuptohet:

باب كيف يُقبَضُ العِلمُ . وكتبَ عمرُ بنُ عبدِ العزيزِ إلى أبي بكرِ بن حَزْمٍ : انظُرْ ما كانَ من حديثِ رسولِ اللهِ ﷺ فاكْتُبْهُ ، فإني خِفتُ دُروسَ العِلمِ وذَهابَ العُلَماءِ . ولا تقبَلْ إلاّ حديثَ النبيِّ ﷺ . ولْتُفْشوا العِلمَ . ولْتَجْلِسوا حتى يُعَلَّمَ مَن لا يَعلَمُ ، فإنَّ العِلمَ لا يَهْلِكُ حتّى يَكونَ سِرًّا . حدَّثَنا العَلاءُ بنُ عبدِ الجبّارِ قال حدَّثَنا عبدُ العزيزِ بنُ مُسلِمٍ عن عبدِ اللهِ بنِ دِينارٍ بذلك . يعني حديثَ عمرَ بنِ عبدِ العزيزِ إلى قولِهِ « ذهابَ العُلماءِ »

Si ngushtohet (bie interesimi) shkenca

Umer b. Abdu-l-Azizi ka shkuar te Ebu Bekr b. Hazmi dhe i ka thënë: **"Shiko! A ka ndonjë Hadith tjetër të Pejgamberit s.a.v.s.** (nëse ka) **shkruaje, sepse frikohem se ajo shkencë mos po zhduket, e dijetarët mos po vdesin** (shkojnë). **Pranoi vetëm Hadithet e Pejgamberit s.a.v.s.. Le ta përhapin shkencën** (dijen) **dhe le ta ligjërojnë atë vazhdimisht, që të mësohet edhe ai që nuk di, sepse dijenia nuk do të shkatërrohet** (ngushtohet) **derisa ajo nuk do të jetë e fshehtë".**

Na ka treguar el-Alâ b. Abdu-l-Xhebbari, këtij i ka treguar Abdu-l-Aziz b. Muslimi, ky nga Abdullah b. Dinari, i cili ka treguar të njëjtin hadith, sikurse Umer b. Abdu-l-Azizi deri te fjalët **"...dhe dijetarët të mos shkojnë".**

- mundësia e hyrjes së besimtarit në Xhennet pa dhënien e llogarisë së hollësishme për punën e tij në këtë botë. Ndërmjetësimi i Muhammedit a.s. shtrihet edhe te gabimtarët të cilët me veprat e tyre e meritojnë Xhehennemin;
- Ndërmjetësimi (shefaati) i gjynahqarëve mund të jetë nga melekët, Pejgamberët dhe evlijatë. Ndërmjetësimi mund të jetë edhe për ngritjen e shkallës së shpërblimit të besimtarit të mirë edhe në vetë Xhennetin;
- njerëzit duhet të sakrifikojnë për dituri, për shkollim dhe për përhapjen e diturisë, sepse, kështu arrihet shpërblimi i All-llahut xh.sh.;
- ditura (shkenca) është ideal i Islamit. Ta fshehësh diturinë është gjynah, e të mësosh të tjerët është nga veprat më fisnike dhe më të dashura të All-llahut xh.sh.;
-ndërmjetësimi (shefaati) i Muhammedit a.s. është i sigurtë dhe mbështetet në argumente të forta.

١٠٠ – حدثنا إسماعيل بن أبي أويس قال حدثني مالك عن هشام بن عروة عن أبيه عن عبد الله بن عمرو بن العاص قال : سمعت رسول الله ﷺ يقول « إن الله لا يقبض العلم انتزاعاً ينتزعه من العباد ، ولكن يقبض العلم بقبض العلماء حتى إذا لم يبق عالماً اتخذ الناس رؤوساً جهالاً فسئلوا فأفتوا بغير علم فضلوا وأضلوا »

قال الفربري حدثنا عباس قال حدثنا قتيبة حدثنا جرير عن هشام نحوه

100. Na ka treguar Ismail b. Uvejsi, këtij Maliku, këtij Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, e ky nga Abdullah b. Amr b. el-Asi, i cili ka deklaruar:

E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

"All-llahu nuk do ta zhdukë shkencën me heqjen e saj nga përdorimi, por shkencën (dijeninë), **sigurisht, do ta heqë me zhdukjen e dijetarëve. Dhe, kur nuk do të ketë dijetarë, njerëzit do t'i zgjedhin për kryetarë të paditurit. Populli do t'i pyes, e, ata do të japin shpjegime** (fetfa) **pa ndonjë dijeni. Ashtu ata, edhe vetë do të bien në katastrofë e, *edhe të tjerët do t'i largojnë nga udha e drejtë*".**

Firebriu ka thënë:

Këtë na ka thënë edhe Abbasi: **"Na ka treguar Kutejbe, i cili ka treguar ashtu siç ia ka transmetuar atij Xheriri nga Hishami".**[45]

---

45 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- mundësia e ngecjes së shkencës dhe mundësia e pakësimit të dijatarëve me arsim të lartë;
- theksimi se të paditurit dhe të paaftët nuk duhet të vihen në pozita udhëheqëse dhe të rëndësishme të shoqërisë;
- nxitja në përhapjen dhe në peshën e diturisë dhe thellimi i përhershëm në njohuritë shkencore;
- dhënia e fetfasë është çështje me përgjegjësi, prandaj kjo detyrë nuk mund t'u besohet njerëzve të paaftë dhe të pandërgjegjshëm.

باب هل يُجعَلُ للنساء يومٌ عَلَى حِدَةٍ فى العلم ؟

١٠١ — حدثنا آدم قال حدثنا شُعبةُ قال حدثنى ابنُ الأصبهانى قال سمعتُ أبا صالحٍ ذَكوانَ يُحدِّثُ عن أبى سَعيدٍ الخُدْرِىِّ : قالت النساء للنبىِّ ﷺ غَلَبَنا عليكَ الرِّجالُ ، فاجعل لنا يوماً مِنْ نَفسِكَ . فوَعَدَهُنَّ يوماً لَقِيَهُنَّ فيه فوَعَظَهُنَّ وأمَرَهُنَّ ، فكانَ فيما قال لهنَّ « ما مِنكُنَّ امرأةٌ تُقَدِّمُ ثلاثةً مِن وَلَدِها إلاَّ كانَ لها حِجاباً مِنَ النار » . فقالت امرأةٌ : واثنَين ؟ فقال : واثنين

A mundet grave t'u caktohet kohë e veçantë për të fituar dituri

101. Na ka treguar Ademi, këtij i ka treguar Shu'be, këtij Ibni Asbahaniu, ky e ka dëgjuar nga Ebu Salih Dhekvani, ky nga Ebu Se'id el-Hudriu, i cili ka thënë:

Gratë i kanë thënë Pejgamberit s.a.v.s.:

"Meshkujt na e kanë bërë të pamundur pjesëmarrjen (për shkak të kallaballëkut) **në ligjëratat tua, prandaj, caktoje një ditë vetëm për ne"**. Ai , pastaj, caktoi një ditë vetëm për ato. Ua mësoi dhe ua caktoi urdhërat. Në mes tjerash u tha: **"Çdo grua nga ju, e cila i çon në ahiret tre fëmijët e vet** (përpara saj), **do t'i ketë një mbrojtje kundër zjarrit të Xhehennemit".**

"E dy?" tha njëra.

"Edhe dy" u përgjigj ai.

١٠٢ — حدثنا محمدُ بن بَشّارٍ قال : حدثنا غُندَرٌ قال حدثنا شُعبةُ عن عبدِ الرحمٰنِ بنِ الأصبهانىِّ عن ذَكوانَ عن أبى سَعيدٍ الخُدْرِىِّ عنِ النبىِّ ﷺ بهذا

وعن عبدِ الرحمٰنِ بنِ الأصبهانىِّ قال سمعتُ أبا حازمٍ عن أبى هريرة قال « ثلاثةٌ لم يَبلُغوا الحِنثَ »

102. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari, këtij Gunderi, këtij Shu'be, ky nga Abdu-r-Rahman b. Asbehaniu, ky nga Dhekvani, ky nga Ebu Se'id el-Hudriu, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. (njëlloj sikurse Hadithi që u tha më sipër) dhe nga Abdu-r-Rahman b. el-Asbahaniu, i cili ka thënë:

"E kam dëgjuar Ebu Hazimin, e ky Ebu Hurejren, duke thënë: **"...tre fëmijë që nuk kanë arritë moshën madhore".**[46]

باب من سمع شيئاً فراجع حتى يعرفه

١٠٣ – حدثنا سعيد بن أبي مريم قال أخبرنا نافع بن عمر قال: حدثني ابن أبي مليكة أن عائشة زوج النبي ﷺ كانت لا تسمع شيئاً لا تعرفه إلا راجعت فيه حتى تعرفه، وأن النبي ﷺ قال «من حوسب عذب» قالت عائشة فقلت: أوليس يقول الله تعالى ﴿فسوف يحاسب حساباً يسيراً﴾ قالت: قال «إنما ذلك العرض، ولكن من نوقش الحساب يهلك»

Kush ka dëgjuar diçka dhe e ka përsëritur derisa ta mësojë mirë atë

103. Na ka treguar Se'id b. Ebu Merjem, këtij i ka treguar Nafi' b. Umeri, ky nga Ibni Ebu Mulejke, se Aishja, bashkëshortja e Pejgamberit s.a.v.s., kur ka dëgjuar diçka e që nuk e ka kuptuar si duhet, është kthyer në atë çështje derisa e ka kuptuar mirë. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Atij që i kërkohet llogaria e hollësishme (në Ditën e Gjykimit), **ai është i dënuar".**

E, unë i kam thënë, thotë Aishja: **A nuk thotë All-llahu i Madhëruesh**ëm (në Kur'an):

"Dhe do të japë llogari lehtë".

(el-Inshikâk, 8).

Ai (Pejgamberi s.a.v.s.) u përgjigj, tha Aishja:

"Ajo, në të vërtetë, është të shprehurit (e besimtarit për një llogari sipërfaqësore). **por ai, të cilit llogaria do t'i shqyrtohet në mënyrë të hollësishme, do të shkatërrohet".**[47]

---

46 Nga hadithi kuptohet:

- u lejohet femrave të bëjnë pyetje gjithnjë dhe gjithkund për rregullat fetare. U lejohet të pyesin edhe për punët dhe jetën e tyre;
- është e arsyeshme dhe e domosdoshme të caktohet një vend i caktuar dhe kohë e përshtatshme për zhvillimin e mësimit të femrave;
- fëmijët e vegjël të vdekur e kanë vendin në Xhennet dhe me ndërmjetësimin e tyre te All-llahu xh.sh. do të tërheqin në të edhe prindërit e tyre gjynahqarë (gjynahe të vogla).

47 Atij që do t'i bëhet llogaria në mënyrë të hollësishme në Ditën e Gjykimit dhe që do t'i

باب لِيُبَلِّغِ العِلمَ الشاهِدُ الغائِبَ . قالَه ابنُ عباسٍ عنِ النبيِّ ﷺ

١٠٤ ـ حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يُوسُفَ قال حدثني الليثُ قال حدثني سَعيدٌ عن أبي شُرَيحٍ أنه قال لِعَمرِو ابنِ سَعيدٍ ـ وهُو يَبعثُ البُعوثَ إلى مَكةَ ـ ائذَنْ لي أيُّها الأميرُ أحدِّثْكَ قولاً قامَ بهِ النبيُّ ﷺ الغَدَ مِنْ يومِ الفَتحِ ، سَمِعَتْهُ أذُناي وَوَعاهُ قلبي ، وأبصَرَتْهُ عيناي حينَ تَكلَّمَ بهِ : حَمِدَ اللهَ وأثنَى عليهِ ثُمَّ قال : إنَّ مَكةَ حَرَّمَها اللهُ ولَمْ يُحَرِّمْها الناسُ ، فلا يَحِلُّ لامرئٍ يُؤمِنُ باللهِ واليومِ الآخِرِ أنْ يَسفِكَ بها دَماً ، ولا يَعضِدَ بها شَجَرةً . فإنْ أحدٌ تَرَخَّصَ لِقتالِ رسولِ اللهِ ﷺ فيها فقولوا : إنَّ اللهَ قد أذِنَ لِرسولِهِ ولَمْ يَأذَنْ لكم ، وإنَّما أذِنَ لي فيها ساعةً مِنْ نهارٍ ، ثُمَّ عادَتْ حُرْمَتُها اليومَ كَحُرْمَتِها بالأمسِ ، ولْيُبَلِّغِ الشاهدُ الغائبَ » . فقيلَ لأبي شُرَيحٍ : ما قال عَمرٌو ؟ قال : أنا أعلَمُ منكَ يا أبا شُرَيحٍ ، لا يُعيذُ عاصِياً ، ولا فارّاً بدَمٍ ، ولا فارّاً بِخَرْبَةٍ

"I pranishmi le t'la përcjellë diturinë atij që nuk është i pranishëm"

Transmeton Ibni Abbassi nga Pejgamberi s.a.v.s.

---

merret parasysh çdo shkelje, atij do t'i gjenden të meta të shumta të meritueshme për dënim, ose së paku për qortim. Po edhe shqyrtimi i hollësishëm i veprave të mira do të nxirrte në shesh se shumë prej tyre i kanë bërë jo në emër të All-llahut xh.sh. por në emër të ndonjë interesi të kësaj bote, që mund të mos arrijnë shpërblimin e All-llahut xh.sh. dhe në vend të tij të fitojnë dënimin. Duke i patur parasysh të gjitha këto, një numër i vogël do të kalonte pa ndonjë dënim. Mëshira e All-llahut xh.sh. megjithatë, është e pakufishme, e duhet shpresuar se ato mangësi të njerëzve do të falen.

Me ajetin e sipërpërmendur bëhet me dije se besimtarët e mirë do të merren në llogari vetëm formalisht për fëmijët e tyre, pas së cilës mund të shpresohet në faljen e All-llahut xh.sh. Megjithatë, përmbajtja e hadithit tërheq vërejtjen për llogarinë e hollësishme të çdo vepre njerëzore në veçanti, pavarësisht nga falja dhe mëshira, që vetvetiu nënkupton një lloj dënimi.

Nga hadithi shihet:

- dëshira e zjarrtë e Aishes për dijeni dhe për mësim dhe gadishmëria e Muhamnedit a.s. për t'i mësuar të tjerët.
- dhënia e llogarisë në Ditën e Gjykimit për veprat e bëra është realitet.
- ajetet e Kur'anit dhe hadithet e Pejgamberit a.s. mund të kuptohen në mënyra të ndryshme nganjëherë, bile edhe gabimisht;
- kriteret e vlerësimit të veprave njerëzore në Ditën e Gjykimit, do të jenë të duarduarshme: disa prej tyre do të vlerësohen hollësisht disa, sipërfaqësisht, e disa do të lirohen.

104. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Lejthi, këtij Se'idi, ky nga Ebu Shurejhu, i cili i ka thënë Amr b. Se'idit, kur i dërgonte aradhat kah Mekka:

"O komandant, më lejo të paraqes fjalimin të cilin e ka mbajtur Pejgamberi s.a.v.s. ditën e nesërme, pas çlirimit të Mekkes, të cilin e kam dëgjuar personalisht, e kam përjetuar dhe e kam shikuar me sytë e mi. Pasi e falënderoi All-llahun e Madhërueshëm, tha:

"All-llahu i Madhërueshëm është Ai i cili e ka bërë Mekken të shenjtë; atë nuk e kanë bërë njerëzit të shenjtë. Për këtë arsye, asnjërit që beson në All-llahun dhe në botën e ardhshme (ahiret) **nuk i lejohet që në të të derdhë gjak dhe të presë dru. Nëse e lejon ndonjë këtë vetëm për atë se Pejgamberi s.a.v.s. ka luftuar në të,** thuani atij: **"All-llahu ia ka lejuar atë vetëm Pejgamberit s.a.v.s., e juve jo." Mua ma ka lejuar në të vetëm nje pjesë** (çast) **të ditës, kurse sot e ka kthyer statusin e paprekshmërisë së saj, e ka kthyer shenjtërinë e saj, ashtu siç ishte edhe dje. Ata që janë të pranishëm, le t'ua transmetojnë këtë atyre që nuk janë të pranishëm!"**

Dikush e ka pyetur Ebu Shurejhun: **"E, si është përgjigjur Amri?"**

"Unë atë e di më mirë se ti, o Ebu Shurejh, por ajo (Mekka) **nuk i bën strehim atij që varet, as atij që ka ikur që në të të fshehet për shkak të derdhjes së gjakut të huaj, e, as atij që ka ikur për shkak se ka shkaktuar çrregullime, vjedhje** (dhe gjëra të tjera të ndyta)", i qe përgjigjur Amri.

١٠٥ - حدثنا عبدُ اللهِ بنُ عبدِ الوهّابِ قال حدّثنا حمّادٌ عن أيوبَ عن محمدٍ عن ابنِ أبي بَكْرَةَ عن أبي بكرة ذُكِرَ النبيُّ ﷺ قال « فإنَّ دِماءَكُمْ وأموالَكُمْ - قال محمدٌ : وأحسِبُهُ قال وأعراضَكُمْ - عليكُمْ حرامٌ كحُرْمَةِ يومِكُمْ هذا ، في شهرِكُمْ هذا . ألا ليُبَلِّغِ الشاهِدُ منكُمُ الغائبَ » . وكان محمدٌ يقول : صَدَقَ رسولُ اللهِ ﷺ ، كان ذلك « ألا هل بَلَّغْتُ » مرّتين

105. Na ka treguar Abdullah b. Abdu-l-Vehhabi, këtij Hammadi, ky nga Ejjubi, ky nga Muhammedi, ky nga Ibni Ebu Bekre, ky nga babai i vet, Ebu Bekre, i cili transmeton se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë **"...edhe gjaku juaj, edhe pasuria juaj"**, e, unë mendoj,thotë Muhammedi, se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **"...edhe nderi juaj është i shenjtë, siç është e shenjtë kjo dita juaj ne këtë muajin tuaj. Pra, çdonjëri që është i pranishëm le t'ia tregojë atij që nuk është i pranishëm!"**

Muhammedi (transmetuesi i hadithit) ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. e ka thënë të vërtetën. Ai, ashtu, dy herë është shprehur: **"Ja, a u kam njoftuar mirë?"**.[48]

---

48 Në pjesën paraprake thksohet rasti i dëgjuesit që i drejtohet ligjëruesit me qëllim që ta kuptojë më mirë përmbajtjen e ligjëratës, kurse në këtë pjesë theksohet nevoja që çdo fjalë e ligjëruesit t'u përcillet atyre që nuk janë të pranishëm në ligjëratë.

Nga hadithi nxirret përfundimi:

- në bisedë me më të moshuarit dhe me udhëheqësit duhet të sillemi me kujdes dhe me maturi;
- në përhapjen e diturive islame duhet bërë përpjekje të mëdha.

Ibni Batali mendon se përpjekja për përhapjen e diturive islame është detyrë e dorës së parë për muslimanët (farz-i kifaje);

- ndalohet lufta në territorin e qytetit të Mekkes. Disa dijetarë mendojnë se është e ndaluar të merret aksion luftarak në Mekke, bile edhe kundër kryengritësve që janë fshehur në të. Pjesa më e madhe e dijetarëve kanë mendim tjetër. Ata lejojnë aksione të tilla luftarake, sepse organet gjegjëse e kanë për detyrë të ndalojnë veprimet kundërligjore, të mundësojnë zbatimin (përdorimin) e ligjit të Alí-llahut xh.sh. dhe të mbrojnë të drejtën e muslimanëve.

Ebu Hanife mendon se kryengritësi (zollumqari), i cili është fshehur në Mekke, ka të drejtë të plotë të azilantit dhe këtë nuk duhet dënuar derisa gjendet në të.

Ibni Abbasi, Atai dhe Shafiu mendojnë se kryengritësi, i cili ka bërë grabitje, vjedhje, prostitucion në territorin e Haremit të Mekkes, duhet të dënohet dhe dënimi mund të ekzekutohet në Mekke, e nëse shkeljet e posapërmendura i ka bërë jashtë Mekkes, dënimi nuk mund të kryhet në Mekke, por jashtë saj.

Ibni Zubejri, Hasan Basriu dhe Muxhahidi janë të mendimit se kryengritësi për veprën e bërë jashtë Mekkes, mund të kapet në Mekke, të nxirret nga kjo dhe atje të dënohet me dënimin e merituesshëm.

Amr b. Seidi mendon se ndaj të tillit mund të kryhet dënimi edhe në Mekke.

Ebu Hanife, Maliku dhe një lagje dijetarësh mendojnë se për veprat penale të përmendura më lartë që janë kryer në Mekke, kryesin e tyre duhet dënuar me dënimin përkatës në të holla, sikurse edhe për ato vepra që i ka kryer jashtë Mekkes, e pastaj të strehohet. Për këtë rast, Shafiu ka mendim tjetër.

- Muhammedi a.s. ndërmori aksion ushtarak me qëllim që ta çlirojë Mekken, e jo që të derdh gjak në të dhe të vrasë banorët e saj. Ai e çliroi Mekken për disa orë, më 20 Ramazan të vitit 8 hixhri dhe, menjëherë shpalli falje të përgjithshme, barazi dhe liri për të gjithë qytetarët;
- në Mekke dhe në territorin e Haremit askush nuk guxon të presë drunj, bile as shkurre. Ai që pret shumë drunj, e ka për detyrë të therë një kafshë të madhe në emër të kurbanit, e kush pret pak drunj, duhet të presë bagëti të imtë. Ky është qëndrimi i Malikut, i Ibni Abbasit dhe i Ibni Zubejrit.

بَابُ إِثْمِ مَنْ كَذَبَ عَلَى النَّبِيِّ ﷺ

١٠٦ - حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ الْجَعْدِ قَالَ أَخْبَرَنَا شُعْبَةُ قَالَ أَخْبَرَنِي مَنْصُورٌ قَالَ سَمِعْتُ رِبْعِيَّ بْنَ حِرَاشٍ يَقُولُ : سَمِعْتُ عَلِيًّا يَقُولُ : قَالَ النَّبِيُّ ﷺ « لَا تَكْذِبُوا عَلَيَّ ، فَإِنَّهُ مَنْ كَذَبَ عَلَيَّ فَلْيَلِجِ النَّارَ »

Gjynahu i atij që i bën shpifje (duke e bërë gënjeshtar) Pejgamberit s.a.v.s.

106. Na ka treguar Ali b. Xha'di, këtij i ka treguar Shu'be, këtij Mensuri, i cili ka dëgjuar nga Rib'ijj b. Hirashi, ky nga Aliu, i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"Mos më bëni shpifje (duke më bërë gënjeshtar)**! Ai që më bën shpifje mua** (duke më bërë gënjeshtar)**, pa dyshim, do të futet në Xhehennem!".**

Ebu Hanife mendon se për secilin rast, duhet konstatuar vlera reale e drurit të prerë dhe sipas vlerës së konstatuar të prehet kurbani përkatës.

Shafiu lejon të kullosë bagëtia barin e Haremit, kurse Ebu Hanifja e kundërshton këtë, sepse edhe bari është një lloj gjelbërimi dhe zbukurimi i Haremit.

- Mekka ka qenë e shenjtë edhe në kohën e Ibrahimit a.s. dhe të Pejgamberëve të tjerë. Muhammedit a.s. i është lejuar diçka, që trashëgimtarëve të tij u është ndaluar.
- derogimi në Islam është realitet dhe dukuri logjike;
- lejohet diskutimi për përdorimin e rregullave islame, e kundërthëniet në interpretimin e atyre rregullave janë të mundshme:
- Ebu Shurejhu ishte këmbëngulës në realizimin e urdhërave të Pejgamberit a.s. Dijetari me vetiniciativë dhe në mënyrë të sjellshme duhet t'i bëjë vërejtje udhëheqësit për padrejtësitë e tij eventuale:
- klasifikimin e veprave në të lejueshme dhe në të palejueshme e bën vetëm All-llahu xh.sh.. Njerëzit këtu muk mund të bëjnë përmirësim.

١٠٧ ـ حدثنا أبو الوليد قال حدثنا شعبة عن جامع بن شداد عن عامر بن عبد الله بن الزبير عن أبيه قال : قلت للزبير : إني لا أسمعك تحدث عن رسول الله ﷺ كما يحدث فلان و فلان . قال : أما إني لم أفارقه ، ولكن سمعته يقول « من كذب علي فليتبوأ مقعده من النار »

107. Na ka treguar Ebu-l-Velidi, këtij ia ka transmetuar Shu'beja ky nga Xhami' b. Sheddadi, ky nga Amir b. Abdullah b. ez-Zubejri, e ky nga babai i vet, i cili ka thënë:

I kam thënë Zubejrit: **"Nuk dëgjoj që ti të transmetosh hadithe nga Pejgamberi s.a.v.s., siç transmeton filani e filani!"**

Sa më përket mua, unë nuk jam ndarë nga Pejgamberi s.a.v.s., por e kam dëgjuar duke thënë:

"Kush bën shpifje ndaj meje (më bën gënjeshtar) **do të hyjë në Xhehennem!"**

١٠٨ ـ حدثنا أبو معمر قال حدثنا عبد الوارث عن عبد العزيز قال أنس : إنه ليمنعني أن أحدثكم حديثا كثيرا أن النبي ﷺ قال « من تعمد علي كذبا فليتبوأ مقعده من النار »

108. Na ka treguar Ebu Ma'meri, këtij Abdu-l-Varithi, ky nga Abdul-l-Azizi, ky nga Enesi, i cili është shprehur me këto fjalë: Më pengon të transmetoj shumë Hadithe, meqë Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Kush bën shpifje për mua me dashje, do t'ia (sigurojë) **vendin vetes në Xhehnnem!"**.[49]

---

49. Hadithet e sipërpërmendur vënë në dukje se thëniet duhet t'u përcillen të tjerëve në mënyrë të saktë dhe fjalë për fjalë. Përndryshe, bëjnë shpifje dhe rrejnë. Ata do të dënohen edhe nga All-llahu xh.sh., edhe nga njerëzit.
Nga hadithi nxirret përfundimi:
- ndalohet rrepësisht t'i bësh shpifje Muhammedit a.s. Kjo vepër e shëmtuar bën pjesë në gjynahet e mëdha. Disa dijetarë të shkollës shafiite thonë se ai që i bën shpifje Muhammedit a.s. del nga radhët islame. Neveriu thotë: "Shpifja ndaj Muhammedit a.s. hyn në gjynahet e mëdha".
- transmetimi jo i saktë i haditheve të Muhammedit a.s. është njësoj si shpjegimi i shtrembëruar e me qëllim i rregullave të sheriatit.

١٠٩ ـ حدثنا مكي بن ابراهيم قال حدثنا يزيد بن أبي عبيد عن سلمة قال : سمعت النبي ﷺ يقول « من يقل علي ما لم أقل فليتبوأ مقعده من النار »

109. Na ka treguar Mekkijj b. Ibrahimi, ky nga Jezid b. Ebu Ubejdi, ky nga Selemja, i cili ka thënë: E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. kur thoshte:

"Kush ma mvesh mua atë që unë nuk e kam thënë, le të përgatitet për në Xhehennem!"

١١٠ ـ حدثنا موسى قال حدثنا أبو عوانة عن أبي حصين عن أبي صالح عن أبي هريرة عن النبي ﷺ قال « تسموا باسمي ، ولا تكتنوا بكنيتي . ومن رآني في المنام فقد رآني ، فإن الشيطان لا يتمثل في صورتي . ومن كذب علي متعمداً فليتبوأ مقعده من النار »

110. Na ka treguar Musa, ky nga Ebu Avane, ky nga Ebu Hasini, ky nga Ebu Salihu, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Vëni (mbani) **emrin tim, por mos e vëni ofiqin tim! Kush me sheh në ëndërr, ai, pa dyshim, më ka parë, sepse, shejtani nuk mund të paraqitet në formën time. E, kush më bën shpifje me dashje** (duke më bërë gënjeshtar), **le ta gjejë vendin e vet në Xhehennem!"**.[50]

- ai që ia transmeton tjetrit hadithin e Muhammedit a.s., duke dyshuar në besnikërinë e tij, ai hyn në grupin e gabimtarëve (gjynahqarëve) të mëdhenj. Muhammedi a.s. ka thënë: "Ai që ia përcjell tjetrit thënien time, duke e ditur se nuk është e imja, ai është gënjeshtar".
- gjatë transmetimit të ndonjë hadithi me burim (sened) ose me domethënie të dyshimtë, nuk duhet të theksohet se atë e ka thënë Muhammedi a.s. Për hadithe të tillë duhet thënë: "Thuhet se, mendohet se, duket se" e të ngjashme;
- duhet patur kujdes për anën gjuhësore, stilistike, përmbajtësore dhe logjike të hadithit. Hadith me gabime gramatikore, me stil të dobët dhe me kuptim jologjik, Muhammedi a.s. nuk ka thënë asnjëherë.

Transmetuesit e hadithit duhet ta njohin gjuhën letrare arabe të kohës së Muhammedit a.s. dhe duhet patur parasysh se dyfytyrëshit me qëllim të caktuar kanë shpifur hadithe, për të arsyetuar qëndrimet e tyre. Këto gjëra kanë ndodhur sidomos në kohën e çrregullimeve politike e shoqërore dhe gjatë luftës së Aliut me Muaviun.

50 Hadithin për shpifjen kundër Muhammedit a.s. shumë dijetarë e fusin në grupin e hadithëve "mutevâtir".

بَابُ كِتَابَةِ الْعِلْمِ

١١١ – حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ سَلَامٍ قَالَ : أَخْبَرَنَا وَكِيعٌ عَنْ سُفْيَانَ عَنْ مُطَرِّفٍ عَنِ الشَّعْبِيِّ عَنْ أَبِي جُحَيْفَةَ قَالَ : قُلْتُ لِعَلِيٍّ هَلْ عِنْدَكُمْ كِتَابٌ ؟ قَالَ : لَا إِلَّا كِتَابُ اللهِ ، أَوْ فَهْمٌ أُعْطِيَهُ رَجُلٌ مُسْلِمٌ ، أَوْ مَا فِي هٰذِهِ الصَّحِيفَةِ . قَالَ قُلْتُ : فَمَا هٰذِهِ الصَّحِيفَةُ ؟ قَالَ : الْعَقْلُ ، وَفَكَاكُ الْأَسِيرِ ، وَلَا يُقْتَلُ مُسْلِمٌ بِكَافِرٍ

Të shkruarit e shkencës

111. Na ka treguar Muhammed b. Selami, këtij Vekiu, këtij Sufjani, këtij Mutarrifi, ky nga Sha'biu, e ky nga Ebu Xhuhajfe, i cili ka thënë: E kam pyetur Aliun:

"A ka ndonjë libër të veçantë te ju?"

"Jo, përveç Librit të All-llahut, ose mendjemprehtësisë së muslimanëve, ose që është në këtë fletë", u përgjigj.

Buhariu, hadithin e parë e solli përmes një vargu të As-habëve shumë të famshëm, në të cilin shpifja kundër Muhammedit a.s. është e ndaluar rreptësisht, kurse për shpifësin është caktuar vendi në Xhehennem. Me hadithin tjetër shprehet besnikëria dhe këmbëngulësia e As-habëve gjatë transmetimit të hadithit. Nga hadithi i tretë shihet se As-habët mjaft me rezervë i kanë transmetuar hadithet, duke u frikuar se me pahir mund të bëjnë lëshime dhe në vend të shpërblimit të fitojnë dënimin.

Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- Ofiqi i Muhammedit a.s. "Ebu-l-Kasim" nuk duhet t'i vëhet askujt. Xhabiri thekson se Muhammedi a.s. ka thënë që emri i tij të mos i vihet atij që e mban ofiqin e tij, e mos t'i vihet ofiqi i tij atij që mban emrin e tij;

Tirmidhiu, duke transmetuar nga Ebu Hurejre, ka theksuar se Muhammedi a.s. ka ndaluar që muslimani të ketë emrin Muhammed dhe ofiqin Ebu-l-Kasim njëkohësisht.

Shumë dijetarë mendojnë se hadithi që e sjell Buhariu është deroguar dhe se Muhammedi a.s. në zbatimin e tij nuk ka insistuar asnjëherë me këmbëngulje. Muhammedi a.s. këtë hadith e ka thënë kur dikush, duke shkuar ai rrugës, ka thirrë: "O Ebu-l-Kasim"! Muhammedi a.s. është kthyer dhe është përgjigjur, e ky i ka kërkuar falje, se ai e thirr ndonjë tjetër, i cili po ashtu e kishte emrin "Ebu-l-Kasim".

Ibni Xheriri mendon se ofiqi i Muhammedit a.s., për arsye respekti ndaj Pejgamberit a.s., nuk duhet t'u jepet të tjerëve dhe ashtu duhet kuptuar hadithin e lartpërmendur, e jo si ndalesë të prerë.

- muslimanët mund ta vënë emrin Muhammed;
- ëndrra është rrenë, kurse All-llahu xh.sh. ekziston. Ëndrra nuk mund të jetë bazë për ndonjë veprim,ose rezultat i ndonjë qëndrimi.

"E, çka ka në atë fletë?" e pyeta, thotë (Ebu Xhuhajfja).

"Regullat për dëmshpërblimin, për lirimin e robërve dhe (qëndron se) **nuk vritet muslimani për pabesimtarin** (qafirin)", u përgjigj (Aliu).[51]

---

51 Ali b. Ebu Talibi është djalë i axhës dhe dhëndërr i Muhammedit a.s. Nëna e tij, Fatimja e Esad b. Hashim b. Abdi Menafit është e para nga fisi hashimit, e cila është martuar për hashimit. Aliu pra, edhe për nga nëna edhe për nga babai është hashimit. Ajo është nga gratë e para të Mekkes që e pranoi Islamin, e me mulimanët e tjerë u shpërngul në Medine dhe këtu vdiq, derisa Muhammedi a.s. ishte gjallë. Muhammedi a.s. personalisht ia fali namazin e xhenazes, hyri në varr dhe e lëshoi në tokë.

Muhammedi a.s. i pat thënë Aliut: "Ti je vëllai im në këtë dhe në botën tjetër". Shpesh e thirrte vëllam. Aliu është njëri nga dhjetë As-habët, për të cilët Muhammedi a.s. është shprehur publikisht se do të gjenden në Xhennet dhe është njëri nga gjashtë anëtarët e Këshillit të bashkësisë islame, i cili e ka udhëhequr shtetin islam në ditë e para pas vdekjes së Muhammedit a.s. Aliu është njëri nga Hulefai-r-Rashidinët: ishte shumë i ditur, fetar i madh dhe luftar i jashtëzakonshëm; i pari nga të rinjtë që e pranoi Islamin; ka marrë pjesë në të gjitha luftat, bashkë me Muhammedin a.s., përveç në luftën e Tebukut, sepse Muhammedi a.s. e kishte emëruar komandant dhe kryetar të Medines. Në luftën e Uhudit mori 16 plagë, kurse në luftën e Hajberit e mbajti flamurin luftarak.

Në dituri shte i pashoq. I mësoi përmendsh 500 hadithe, prej të cilëve 86 i shënon Nesaiu, Ibni Maxhe dhe Ahmed b. Hambeli në përmbledhjet e tyre. Në "Sahihun" e tij, Buhariu i përfshiu 9, kurse Muslimi 15 hadithe; hadithet e tjera, ndërkaq, të transmetuar nga Aliu, janë përfshirë në përmbledhje të tjera.

Pas vrasjes se Uthmanit u bë halife (35-40 hixhri) dhe e udhëhoqi shtetin islam pesë vjet. Të premten, më 17 Ramazan Abdurrahman b. Mulxhemi, me shpatë të helmuar, e plagosi rëndë mu para xhamisë. Vdiq më 19 Ramazan në Kufe, në moshën 63 vjeçare, d.m.th. në vitin 40 hixhri.

Ebu Xhuhejfe ia parashtroi pyetjet Aliut nën ndikimin shiit të cilët kanë thënë se Muhammedi a.s. shumë çështje fetare ia ka thënë vetëm familjes së vet, e sidomos Aliut. Përgjigja e Aliut është e qartë dhe thotë se Muhammedi a.s. gjatë tregimit të Shpalljes nuk e ka veçuar askënd, por ka dashtë që të gjithë muslimanët t'i mësojnë në mënyrë të barabartë rregullat islame.

Nga hadithi nxirret përfundimi:

- Muhammedi a.s. ua ka shpjeguar Shpalljen të gjithëve në mënyrë të barabartë, vetëm se njerëzit nuk kanë mundur ta mbajnë në mend dhe ta mësojnë njëlloj.
- për shpjegimin e çështjeve të paqarta duhet të pyeten ekspertët.
- Hazreti Aliu letrën përkatëse e ka pasë në dorëzën e shpatës.

١١٢ - حدثنا أبو نعيم الفضل بن دكين قال حدثنا شيبان عن يحيى عن أبي سلمة عن أبي هريرة أن خزاعة قتلوا رجلا من بني ليث عام فتح مكة بقتيل منهم قتلوه، فأخبر بذلك النبي ﷺ فركب راحلته فخطب فقال: « إن الله حبس عن مكة القتل - أو الفيل. شك أبو عبد الله - وسلط عليهم رسول الله ﷺ والمؤمنين. ألا وإنها لم تحل لأحد قبلي، ولم تحل لأحد بعدي. ألا وإنها حلت لي ساعة من نهار. ألا وإنها ساعتي هذه حرام: لا يختلى شوكها، ولا يعضد شجرها، ولا تلتقط ساقطتها إلا لمنشد. فمن قتل فهو بخير النظرين: إما أن يعقل، وإما أن يقاد أهل القتيل ». فجاء رجل من أهل اليمن فقال: اكتب لي يا رسول الله. فقال « اكتبوا لأبي فلان ». فقال رجل من قريش: إلا الإذخر يا رسول الله، فإنا نجعله في بيوتنا وقبورنا. فقال النبي ﷺ « إلا الإذخر ». قال أبو عبد الله: يقال يقاد بالقاف. فقيل لأبي عبد الله أي شيء كتب له؟ قال: كتب له هذه الخطبة

112. Na ka treguar Ebu Nu'ajm el-Fadl b. Dukejni, këtij i ka treguar Shejbani, këtij Jahjai, ky nga Ebu Seleme, e ky nga Ebu Hurejre, i cili tregon:

Fisi Huza'a (në vitin e çlirimit të Mekkes) e ka vrarë një njeri nga fisi Benu Lejth, për hakmarrje, që fisi Lejth më parë e kishte vrarë. Kur për këtë ngjarje është njoftuar Pejgamberi s.a.v.s. i hipi deves se tij dhe udhëtoi për atje. Pastaj, mbajti fjalimin:

"All-llahu e ka ndaluar vrasjen në Mekke, ose grupin (tufën) **e elefantëve, dyshon Ebu Abdullahu se cilën nga këto dy shprehje ai i ka përdorë, ndërsa e ka autorizuar Pejgamberin s.a.v.s. dhe besimtarët të marrin pushtetin ne duart e tyre, duke i këshilluar** (duke u folur): **Dijeni, kjo nuk ka qenë e lejueshem për asnjë para meje dhe nuk do të jetë e lejueshme për asnjë pas meje! Ajo ishte e lejushme në një çast** (moment) **të ditës! Dijeni, Mekka në këtë çastin tim** (kur jam duke ju folur) **është e shenjtë dhe e paprekshme; gjembat** (shkurret) **nuk shkulen dhe drunjtë nuk prehen, kurse gjënë e humbur në të e merr vetëm ai, i cili shprehet publikisht dhe e kërkon** (si të vetën)! **Atij që i është vrarë dikush ka të drejtë të zgjedhë dy kushte:ose që vrasësi t'i paguajë dëmshpërblimin** (të vrarit), **ose të largohet nga aty".**

Atëherë iu afrua (Pejgamberit s.a.v.s.) një njeri nga Jemeni dhe i tha: **"O Resulullah, shkruama këtë!"**

Pejgamberi s.a.v.s. urdhëroi, duke thënë:

"Shkruajani filanit!"

Ndërkaq, një nga kurejshitët iu afrua (Pejgamberit s.a.v.s.) dhe i tha:

"Përveç kallamit, o Resulullah, sepse ne e shfrytëzojmë atë për të mbuluar shtëpitë dhe varret tona?"

Pejgamberi s.a.v.s. tha :

"Përveç kallamit! Përveç kallamit!".[52]

Pastaj, i është thënë Ebu Abdullahut: **"Çka i është dhënë me shkrim atij** (jemenasit)?"

"I është dhënë me shkrim fjalimi (me këtë plotësim)", iu përgjigj.

١١٣ – حدثنا عَلِيُّ بنُ عبدِ اللهِ قال حدَّثنا سُفيانُ قال حدَّثنا عمرٌو قال أخبرني وَهْبُ بنُ مُنَبِّهٍ عن أخيهِ قال سمعتُ أبا هُرَيرةَ يقول : ما مِنْ أصحابِ النبيِّ ﷺ أحَدٌ أكثرُ حَدِيثًا عنهُ مِنِّي ، إلاَّ ما كان من عبدِ اللهِ ابنِ عمرو فانه كان يكتُبُ ولا أكتُبُ . تابَعَهُ مَعْمَرٌ عن هَمَّامٍ عن أبي هُرَيرةَ

113. Na ka treguar Ali b. Abdullahu, këtij i ka treguar Sufjani, këtij Amri, këtij Vehb b. Munebbihu, ky nga vëllai i vet, i cili ka thënë: E kam dëgjuar Ebu Hurejren duke thënë:

---

52 Nga hadithi vihet në përfundim:

- shkenca duhet të përhapet edhe me anë të shkrimit. Hazreti Uthmani ka urdhëruar të shkruhen disa kopje të Mus-hafit dhe të dërgohen në qendra të tjera islame. Muhammedi a.s. ka pasë sekretarë të përhershëm për të shkruar Kur'anin, kurse të shkruarit e hadithëve nuk ka qenë e lejueshme vetëm në ditët e para të përhapjes se Islamit, duke u frikuar që njerëzit e paditur ta përziejnë me tekstin e Kur'anit.
- muslimanët e çliruan Mekken pa përleshje dhe pa gjakderdhje;
- në Haremin e Qabes u ndalua prerja e drunjve dhe prishja e gjelbërimit dhe e stolive të tjera;
- Shafiu, Ahmedi dhe Ebu Jusufi janë të mendimit se Muhammedi a.s. është konsultuar me As-habët për të gjitha punët për të cilat nuk ka patur Shpallje, ndërsa pjesa më e madhe e dijetarëve thonë se pikërisht këtë e ka bërë vetëm kur ka ndërmarr aksione luftarake, duke u mbështetur në ajetin: "Për punë konsultoju me ta...".
- trashëgimtari ka të drejtë të zgjedhë: ose të kërkojë dëmshpërblim në para, ose largimin e dorasit, kurse dorasi nuk e ka këtë të drejtë;
- Shafiu mendon se dorasi që e kryen veprën me paramendim dënohet: ose me largim ose me dëmshpërblim. Maliku thotë se të dënohet dorasi është vaxhib, kurse dëmshpërblimi është vetëm kompenzim (zëvendësim), nëse për këtë pajtohen trashëgimtarët e të vrarit. Trashëgimtarët kanë të drejtë ta falin vrasësin (dorasin).

"Asnjë nga As-habët e Pejgamberit s.a.v.s. nuk ka pasë (nuk ka tubuar) **më shumë Hadithe se unë, përveç Abdullah b. Amrit, sepse ai i ka shkruar,** (hadithet) **ndërsa unë nuk i kam shkruar".**

(Në senedin tjetër: Vehb b. Munebbihu këtë hadith e transmeton nga Ma'meri, ky nga Hemmami, e ky nga Ebu Hurejre).

١١٤ - حدثنا يحيى بن سليمان قال حدثني ابن وهب قال أخبرني يونس عن ابن شهاب عن عبيد الله ابن عبد الله عن ابن عباس قال: لما اشتد بالنبي ﷺ وجعه قال «ائتوني بكتاب أكتب لكم كتابا لا تضلوا بعده» قال عمر إن النبي ﷺ غلبه الوجع، وعندنا كتاب الله حسبنا. فاختلفوا، وكثر اللغط. قال: قوموا عني، ولا ينبغي عندي التنازع. فخرج ابن عباس يقول: إن الرزية كل الرزية ما حال بين رسول الله ﷺ وبين كتابه

114. Na ka treguar Jahja b. Sulejmani, këtij Ibni Vehbi, këtij Junusi, këtij Ibni Shihabi, ky nga Ubejdullah b. Abdullahu, e ky nga Ibni Abbasi, i cili tregon:

Kur Pejgamberit s.a.v.s. i është keqësuar sëmundja, ka thënë:

"Ma sillni letrën të shkruaj për ju librin, pas të cilit nuk do të hutoheni (nuk do të humbni rrugën e drejtë)**!"**

Umeri, atëherë ka thënë: **"Pejgamberin s.a.v.s. e ka kapluar sëmundja. E kemi Shpalljen e All-llahut dhe ajo është e mjaftueshme".**

As-habët nuk kishin të njëjtin mendim. Shushuritja (për këtë çështje) u shtua prandaj, Pejgamberi s.a.v.s., u ka thënë:

"Shkoni nga unë! Kjo grindje nuk është e nevojshme te unë!"

Ibni Abbasi doli duke thënë: **"Me të vërtetë, dëm i madh, bile dëm i përgjithshëm që iu bë e pamundur Pejgamberit s.a.v.s. për ta shkruar librin e tij".**[53]

---

53 Kjo mbledhje e As-habëve të Muhammedit a.s. është mbajtur ditën e enjte, katër ditë para se të ndërrojë jetë Muhammedi a.s. Në këtë mbledhje është bërë fjalë për personin i cili do të mund të udhëheq bashkësinë islame. Në mbledhje ishte i pranishëm edhe Umeri. Ai ishte largpamës dhe e dinte se në Kur'an mund të gjenden zgjidhje për të gjitha çështjet aktuale. Në Kur'an thuhet: " Në këtë Libër Ne asgjë nuk kemi lënë mangët" dhe

باب العمل والعبادة بالليل

١١٥ – حدثنا صدقة أخبرنا ابن عيينة عن معمر عن الزهري عن هند عن أم سلمة . وعمرو ويحيى بن سعيد عن الزهري عن هند عن أم سلمة قالت : استيقظ النبي ﷺ ذات ليلة فقال « سبحان الله ماذا أنزل الليلة من الفتن ، وماذا فتح من الخزائن . أيقظوا صواحبات الحجر ، فرب كاسية في الدنيا عارية في الآخرة »

Shkenca dhe këshillimi (ligjërata) gjatë natës

115. Na ka treguar Sadeka, këtij i ka treguar Ibni Ujejne, ky nga Ma'meri, ky nga Zuhriu, ky nga Hindja, kjo nga Ummu Seleme dhe Amri këta nga Jahja b. Se'idi, ky nga Zuhriu, ky nga Hindja, kjo poashtu nga Ummi Seleme, e cila ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. është zgjuar një natë dhe ka thënë:

"Subhanallah! Sa ngatërresa dhe çrregullime kanë ngjarë (rënë) **sonte, sa thesare** (të diturisë) **janë hapur! Zgjojini gratë e dhomave të tjera! Shumë** (gra) **të veshura me stoli në këtë botë, do të jenë të zhveshura në botën tjetër!".**[54]

"Kur'ani është sqarim për çdo gjë." Umeri pat bërë vërejtje, sikurse shihet më sipër, duke patur parasysh normat e Kur'anit dhe gjendjen shëndetësore të Muhammedit a.s., e jo që dyshoi në saktësinë e vendimit të Muhammedit a.s.

Shumica e dijetarëve vlerësojnë se Muhammedi a.s. ka qenë i pagabueshëm vetëm në punët që ishin të lidhura drejtpërdrejt me Shpalljen, kurse në punët e kësaj bote ka mundur të gabojë dhe të harrojë si çdo njeri.

Nga hadithi nxirret përfundimi:

- është i gabueshëm pohimi i shiitëve se Aliu ka pasë porosi me gojë ose me shkrim nga Muhammedi a.s. për t'u bërë udhëheqës i bashkësisë islame. Po të kishte Aliu ndonjë dokument nga Muhammedi a.s. ai do t'ua kishte treguar As-habëve;
- Hazreti Umeri, me largpamësinë e tij, e kuptoi drejt situatën dhe ngjarjet shoqërore konkrete sipas rregullave të Kur'anit;
- udhëheqësi para se të vdesë mund të propozojë zëvendës personin për të cilin mendon se është i aftë të udhëheqë punët e rëndësishme;
- vendimi unanim i dijetarëve për ndonjë çështje të padyshimtë ka fuqi ligjore.

54 Në pjesën paraprake bëhej fjalë për shkrimin dhe shënimin e haditheve, kurse këtu theksohet nevoja e mësimit dhe e përhapjes së shkencës me anë të ligjëratave të përhershme jo vetëm ditën, por edhe natën.

Një natë, te Ummu Selemja Muhammedi a.s. u zgjua para agimit dhe urdhëroi të vinë

بَابُ السَّمَرِ فِي الْعِلْمِ

١١٦ - حدثنا سَعِيدُ بْنُ عُفَيْرٍ قَالَ حَدَّثَنِي اللَّيْثُ قَالَ حَدَّثَنِي عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ خَالِدٍ عَنِ ابْنِ شِهَابٍ عَنْ سَالِمٍ وَأَبِي بَكْرِ بْنِ سُلَيْمَانَ بْنِ أَبِي حَثْمَةَ أَنَّ عَبْدَ اللَّهِ بْنَ عُمَرَ قَالَ : صَلَّى بِنَا النَّبِيُّ ﷺ الْعِشَاءَ فِي آخِرِ حَيَاتِهِ ، فَلَمَّا سَلَّمَ قَامَ فَقَالَ « أَرَأَيْتَكُمْ لَيْلَتَكُمْ هَذِهِ ، فَإِنَّ رَأْسَ مِائَةِ سَنَةٍ مِنْهَا لَا يَبْقَى مِمَّنْ هُوَ عَلَى ظَهْرِ الْأَرْضِ أَحَدٌ »

Diskutimi për dituri gjatë natës

116. Na ka treguar Se'id b. Ufejri, këtij i ka treguar Lejthi, këtij Abdur-Rahman b. Halidi, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Salimi dhe nga Ebu Bekr b. Sulejman b. Ebu Hathme, ky nga Abdullah b. Umeri i cili ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. kah fundi i jetës së vet na e fali namazin e jacisë. Kur dha selam, u ngrit dhe tha:

"A e vërejtët këtë natë tuajën? Me të vërtetë, prej tash, e deri në shekullin e ardhshëm nuk do të jetë asnjë nga ata që tash janë në sipërfaqe të tokës".[55]

---

bashkëshortet tjera, të cilave ua tregoi ëndrrën e lartshënuar. Kjo ëndërr pas vdekjes së tij u bë realtitet. Deri në gjysmën e shekullit të parë sipas hixhretit muslimanët u shtrinë thuajse në gjysmën e botës që njihej deri atëherë, kurse në mes të atij shekulli filluan çrregullimet politike dhe lufta në mes As-habëve më të famshëm. Në ato lufta u vranë njerëz në zë, si: Aliu, djemtë e tij Hasani dhe Husejni, Zubejr b. Avvami etj.

Hadithi aludon edhe në gratë të cilat do të jetojnë në jetë luksoze, do të veshin fustane të tejdukshme dhe të shtrenjta. Kjo, pa dyshim, do të sjellë rënien e moralit dhe rënien e interesimit për të bërë vepra të mira.

Në hadith theksohet edhe fakti se bota islame, me në fund, do të forcohet. Pushteti i saj do të shtrihet në shumë vende të pasura dhe muslimanët do të pasurohen, por në atë begati materiale dhe të famshme të mos bëjnë luks të tepruar (salltanet). Begatia materiale e kësaj bote mund të jetë sprovë dhe mund ta dëmtojë njeriun edhe në këtë edhe në botën tjetër. Animin e grave për veshje luksoze dhe të tejdukshme, Muhammedi a.s. që atëherë e kishte vërejtur dhe mu në pikë të natës i tuboi bashkëshortet e veta t'ua tërheqë vërejtjen për pasojat e rrezikshme të një kulture të atillë.

55 Muhammedi a.s. paralajmëroi për jetën e shkurtër të gjeneratës së vet, pra edhe faktin se njerëzit sa më tepër të angazhohen për të bërë vepra të mira dhe të përgatiten për ditën në të cilën do të jepen llogaritë, kur nuk do të ndihmojë as njerëzia, as pasuria. Begatitë materiale të kësaj bote janë të kalueshme, kurse jeta mesatare e njerëzve është nën njëqind vjet. Prandaj duhet përgatitur për jetën në varr, të cilës nuk i ka shpëtuar asnjë.

١١٧ - حدثنا آدمُ قال حدثنا شُعبةُ قال حدثنا الحَكَمُ قال : سمعتُ سَعيدَ بنَ جُبَيرٍ عن ابنِ عبّاسٍ قال : بِتُّ فى بَيتِ خالَتى مَيمونَةَ بنتِ الحارثِ زَوجِ النبىِّ ﷺ ، وكانَ النبىُّ ﷺ عِندَها فى لَيلَتِها ، فصلّى النبىُّ ﷺ العِشـــاءَ ، ثمّ جاءَ إلى مَنزِلِهِ فصلّى أربعَ ركعاتٍ ، ثمّ نامَ . ثمّ قامَ ، ثمّ قال : نامَ الغُلَيِّمُ ـ أو كلمةً تُشبِهُها ـ ثم قامَ ، فقُمتُ عن يَسارِهِ فجَعَلَنى عن يَمينِهِ . فصلّى خَمسَ رَكَعاتٍ ، ثمّ صلّى رَكعَتَينِ ، ثمّ نامَ حتّى سَمِعتُ غَطِيطَهُ ـ أو خَطِيطَهُ ـ ثمّ خَرَجَ إلى الصلاةِ

117. Na ka treguar Ademi, ky nga Shu'be, ky nga Hakemi, ky ka dëgjuar nga Se'id b. Xhubejri, e ky nga Ibni Abbasi i cili ka thënë:

"Kam kaluar natën në dhomën e tezes sime, Mejmunes, vajzë e Harithit, bashkëshorte e Pejgamberit s.a.v.s. Atë natë te ajo ishte edhe Pejgamberi s.a.v.s.. Pejgamberi e fali namazin e jacise (në xhami), **erdhi në shtëpi, i fali edhe katër reqate, e pastaj ra të flejë. Më vonë u zgjua dhe tha: "A ka flejtë djaloshi?", ose përdori shprehje të ngjashme. Pastaj, u çua dhe fali namaz. U çova edhe unë, unë qëndrova në anën e tij të majtë, por ai më vendosi në anën e djathtë. I fali pesë reqate, pastaji fali edhe dy dhe ra të flejë pse e kam dëgjuar krikëllimën e tij. Pastaj,** (pasi u zgjua) **shkoi në xhami për të falur namazin e sabahut.** [56]

---

56 Hadithi përkatës i nxit besimtarët që sa më shpesh të organizojnë ligjërata edukative-arsimore, duke shfrytëzuar për këto edhe ndenjet e mbrëmjeve, e në rast mungese të dritës të shfrytëzohet edhe hëna. Pjesëmarrja në tubime të këtilla është shumë e dobishme për arsimimin dhe edukimin e njerëzve. Maliku thotë: "Të marrët me shkencë për ngritjen profesionale dhe edukative, bie në punët më të vlefshme të njeriut"

Nga hadithi nxirret përfundimi:

- dëshira e madhe dhe intelegjenca e fortë e Abdullah b. Abbasit, i cili si fëmijë, tërë natën e ka përcjellur punën e Pejgamberit, e pastaj u ka treguar të tjerëve në mënyrë të besueshme;
- namazin nafile mund ta falësh me xhemat;
- gjesti i vogël me dorë në namaz nuk e prish namazin;
- namazi i atij që falet pas personit i cili nuk e ka bërë nijet se do të bëhet imam është i vlefshëm;
- kur falesh me imam duhet të qëndrosh në anën e tij të djathtë, e nëse qëndron në të majtën, imami me dorën e djathtë ta tërheq vërejtjen të kalosh në anën e tij të djathtë;
- namazi i fëmijës është i vlefshëm;
- namazi i Muhammedit a.s. që e falte natën përbëhej prej 11 reqateve. Kemaniu mendon

باب حفظ العلم

١١٨ — حدثنا عبدُ العزيزِ بنُ عبدِ اللهِ قال حدّثني مالكٌ عن ابنِ شهابٍ عن الأعرجِ عن أبي هُريرةَ قال: إنَّ الناسَ يقولون: أكثرَ أبو هُريرةَ. ولولا آيتانِ في كتابِ اللهِ ما حدّثتُ حديثاً. ثمّ يتلو ﴿إنَّ الذينَ يكتمونَ ما أنزلنا منَ البيّناتِ — إلى قوله — الرحيمُ﴾. إنَّ إخواننا منَ المهاجرينَ كانَ يشغلُهمُ الصفقُ بالأسواقِ، وإنَّ إخواننا منَ الأنصارِ كانَ يشغلُهمُ العملُ في أموالِهم. وإنَّ أبا هُريرةَ كانَ يلزمُ رسولَ اللهِ ﷺ بشبعِ بطنِه، ويحضرُ ما لا يحضرون، ويحفظُ ما لا يحفظون

Të mësuarit e diturisë përmendsh

118. Na ka treguar Abdu-l-Aziz b. Abdullahu, këtij i ka treguar Maliku, ky nga Ibni Shihabi, ky nga A'rexhi, e ky nga Ebu Hurejre, i cili tregon se populli thoshte:

"**Ebu Hurejre është më i frytshmi** (në transmetimin) **e haditheve: e unë nuk do të kisha thënë asnjë hadith, po të mos ishin këto dy ajete në Librin e All-llahut** (në Kur'an). Pastaj i citoi:

"Me të vërtetë, ata që fshehin argumentet Tona të qarta, që i kemi shpallur Ne...".

(el-Bekare, 159)

Deri te fjala,

"...se Unë jam pranues i pendimeve dhe mëshirues".

(el-Bakare,160)

Derisa vëllezërit tanë muhaxhirë ishin të zënë e të preokupuar me shitblerje nëpër tregje, e vëllezërit tanë Ensarë ishin të zënë me punë në pasuritë e tyre, Ebu Hurejre, duke qenë i ngirë, qëndronte pranë Pejgamberit s.a.v.s. Ishte i pranishëm aty ku ata nuk ishin dhe mësonte përmendsh atë që ata nuk e mësonin.[57]

---

se ky namaz përbëhej prej 6 reqateve nafile, tre reqate të namazit të vitrit dhe dy reqate sunnet të sabahut.

57 Ebu Hurejre banonte në një dhonë të xhamisë së Muhammedit a.s. dhe, prandaj kishte rastin të dëgjojë çdo ligjëratë të tij. Ai qëndronte pranë Muhammedit a.s. edhe gjatë mbajtjes së panairëve, kur As-habët tjerë bënin tregti. Për të mirën e diturisë, për

١١٩ - حدثنا أحمدُ بنُ أبي بكرٍ أبو مُصْعَبٍ قال حدثنا محمدُ بن إبراهيمَ بنِ دينارٍ عن ابنِ أبي ذِئبٍ عن سعيدٍ المَقْبُرِيِّ عن أبي هُرَيرةَ قال : قلتُ يا رسولَ اللهِ ، إني أسمعُ منكَ حديثاً كثيراً أنساهُ . قال : ابسُطْ رِداءَكَ . فبَسَطْتُه . قال : فغَرَفَ بيدَيهِ ثمَّ قال : ضُمَّهُ ، فضَمَمْتُه ، فما نَسيتُ شيئاً بعدَه

حدثنا إبراهيمُ بنُ المنذرِ قال : حدَّثنا ابنُ أبي فُدَيكٍ بهذا . أو قال : غَرَفَ بيدِه فيه

119. Na ka treguar Ahmed b. Ebu Bekr Ebu Mus'abi, këtij Muhammed b. Ibrahim b. Dinari, ky nga Ibni Ebu Dhi'bi, ky nga Se'id el-Makburiu, e ky nga Ebu Hurejre, i cili i ka thënë Pejgamberit s.a.v.s.

"O Resulullah, unë, me të vërtetë, prej teje dëgjoj shumë hadithe, të cilët, përsëri i harroj!"

"Shtroje gunën tënde", tha ai.

Unë e shtrova gunën, kurse ai (Pejgamberi s.a.v.s.) rrëmbeu diçka me duart e tij, e hodhi mbi të dhe tha: **"Mbështillu me të!"** , tregon Ebu Hurejre.

U mbështolla dhe pas kësaj asgjë nuk harrova.

Na ka treguar Ibrahim b. Mundhiri, ky ka dëgjuar nga Ibni Ebu Fudejku të njëjtën gjë, ose ka thënë: **"...rrëmbeu diçka me duart e tij dhe e hodhi në gunë..."**.[58]

١٢٠ - حدثنا إسماعيلُ قال حدثني أخي عن ابنِ أبي ذِئبٍ عن سعيدٍ المَقْبُرِيِّ عن أبي هُرَيرةَ قال : حَفِظْتُ من رسولِ اللهِ ﷺ وِعاءينِ : فأمَّا أحدُهما فبَثَثْتُه ، وأمَّا الآخَرُ فلو بَثَثْتُه قُطِعَ هذا البُلعُوم

---

bashkësinë e vet dhe për t'i shërbyer Muhammedit a.s. e la anash fitimnin e pasurisë materiale, I njihte shumë mirë rregullat e Kur'anit dhe i shpjegonte ato drejt.
Nga hadithi shihet se:
- muslimani duhet të mësojë gjithnjë dhe dijeninë e tij t'ua përcjellë të tjerëve;
- Ebu Hurejre ka sakrifikuar çdo gjë për të mësuar hadithe;
- është e lejueshme të theksohen vërejtjet, por duke u ruajtur nga mendjemadhësia.

58 Ebu Hurejrja i bëri këto pyetje në xhami me rastin e një ligjërate të Muhammedit a.s. Pejgamberi e urdhëroi atë ta shtrijë gunën e vet, e pastaj, simbolikisht, rrëmbeu diçka dhe e shkundi në të. Kjo ishte dhënie simbolike e diturisë, por kjo u bë realitet, sikurse ka thënë vetë Ebu Hurejrja më vonë.

120. Na ka treguar Ismaili, këtij i ka trguar vëllai i tij, këtij Ibni Ebu Dhi'bi, ky nga Se'id Makburiu, e ky nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

"Kam mbajtur në mend nga Pejgamberi s.a.v.s. dy lloj dijenish: Njërën prej tyre ua kam treguar. Sa i përket tjetrës, po t'ua kisha treguar atë, do të më pritej ky laring (fyt)".[59]

باب الإنصات للعلماء

١٢١ - حدثنا حجاج قال حدثنا شعبة قال أخبرني علي بن مدرك عن أبي زرعة عن جرير أن النبي ﷺ قال له في حجة الوداع : استنصت الناس . فقال : « لا ترجعوا بعدي كفاراً يضرب بعضكم رقاب بعض »

T'i dëgjosh dijetarët

121. Na ka treguar Haxhxhaxhi, këtij i ka treguar Shu'be, këtij ia ka transmetuar Ali b, Mudriku, ky nga Ebu Zur'a, ky nga Xheriri, se Pejgamberi

---

59 Ebu Hurejrja, pa dyshim, është më i frytshmi në transmetimin e hadithëve. Ai i ka shprehur haptazi hadithet që kanë të bëjnë me detyrimet fetare (namaz, haxhxh, zeqat etj.) dhe që kanë të bëjnë me të drejtën e sheriatit, ndërsa hadithet që flasin për situatën shoqërore-politike dhe për pandërgjegjshmërinë e udhëheqësve nuk i ka treguar haptazi, për shkak të sigurisë së vet personale. Shqetësimet politike dhe sprovat e ardhshme të botës islame, Ebu Hurejre i thoshte në mënyrë alegorike. Kështu në një rast pat thënë: "O Zot, më ruaj në ditët e para të viteve të gjashtëdhjeta të këtij shekulli dhe nga pushteti i fëmijëve." Këtu aludonte në pushtetin e Jezid b. Muaviut, i cili erdhi në pushtet në vitin 60 hixhri, një vit pas vdekjes së Ebu Hurejres.

Ebu Hurejrja e pranoi Islamin në vitin 7 hixhri. Ka marrë pjesë në luftën kundër hebrenjve në Hajber. Para se ta pranojë Islamin quhej Abdu-sh-shems, e kur kaloi në Islam e mori emrin Abdullah dhe Abdurrahman. Nëna e tij quhej Mejmune. Për vetveten thoshte: "Jam rritur si jetim, kam ikur nga Mekkja si i varfër dhe kam qenë shërbetor i Busres, vajzës së Gazvanit, me të cilën më vonë, me dëshirën e All-llahut xh.sh. jam martuar. E falënderoj All-llahun xh.sh. që fenë e bëri mbështetje dhe bazë të jetës, kurse Ebu Hurejren, udhëheqës në shkencën e Hadithit. Dikur kam qenë çoban, kam pasë mace me të cilën kam luajtur, prandaj, ja, me thirrin "Ebu Hurejre", d.m.th. "babai i maces".

Ebu Hurejrja ka transmetuar rreth 5000 hadithe. Në "Sahihun" e tij Bahariu i ka përfshi 93; Muslimi 190, kurse të tjerët janë përfshirë në përmbledhjet tjera të hadithëve.

Vdiq në vitin 59 hixhri, në moshën 78 vjeçare dhe është varrosur në Beki.

s.a.v.s. në Haxhin Lamtumirës (Haxhxhetu-l-Vedâ') i ka urdhëruar atij, duke i thënë:

"Qetësoi njerëzit dhe le të dëgjojnë"! (pasi u qetësua masa) tha:

Mos u ktheni në pabesimtarë pas meje, e që njëri-tjetrit t'i bini në qafë". [60]

بابُ ما يُسْتَحَبُّ لِلعالِمِ إذا سُئِلَ أيُّ النَّاسِ أعْلَمُ فيَكِلُ العِلمَ إلى اللهِ

١٢٢ — حدثنا عبدُ اللهِ بنُ محمدٍ قال حدثنا سُفيانُ قال حدثنا عَمرٌو قال أخبرني سَعيدُ بنُ جُبَيرٍ قال :

قلتُ لابنِ عبّاسٍ إنَّ نَوفًا البِكالِيَّ يَزعُمُ أنَّ موسى ليسَ بموسى بني إسرائيلَ إنَّما هوَ موسى آخَرُ . فقال : كَذَبَ عَدوُّ اللهِ ، حدثنا أبيُّ بنُ كَعبٍ عنِ النبيِّ ﷺ : « قامَ موسى النبيُّ خَطيبًا في بني إسرائيلَ ، فسُئِلَ : أيُّ الناسِ أعلَمُ ؟ فقال : أنا أعلَمُ . فعَتَبَ اللهُ عليهِ إذْ لم يَرُدَّ العِلمَ إليهِ ، فأوحى اللهُ إليهِ أنَّ عبدًا مِن عِبادي بمَجمَعِ البَحرَينِ هوَ أعلَمُ مِنكَ . قال : يا ربِّ وكيفَ بهِ ؟ فقيلَ له : احمِلْ حُوتًا في مِكتَلٍ ، فإذا فَقَدتَهُ فهوَ ثَمَّ . فانطَلَقَ وانطَلَقَ بفَتاهُ يُوشَعَ بنِ نُونٍ ، وحَمَلا حُوتًا في مِكتَلٍ ، حتّى كانا عندَ الصَّخرةِ وضَعا رؤوسَهما ونامَا ، فانسَلَّ الحوتُ مِنَ المِكتَلِ فاتَّخَذَ سَبيلَهُ في البَحرِ سَرَبًا ، وكانَ لموسى وفَتاهُ عَجَبًا . فانطَلَقا بَقِيَّةَ لَيلَتِهِما ويَومِهِما ، فلمّا أصبَحَ قال موسى لِفَتاهُ : آتِنا غَداءَنا ، لقَد لَقِينا مِن سَفَرِنا هٰذا نَصَبًا . ولم يَجِدْ موسى مَسًّا مِنَ النَّصَبِ حتّى جاوَزَ المكانَ الّذي أُمِرَ بهِ . فقال له فَتاهُ : أرأيتَ إذْ أوَينا إلى الصخرةِ فإنّي نَسيتُ الحُوتَ . قال موسى : ذٰلكَ ما كُنّا نَبغي . فارتَدّا على آثارِهما قَصَصًا ، فلمّا انتَهَيا إلى الصخرةِ إذا رَجُلٌ مُسَجًّى بثَوبٍ ـ أو

60 Dituria është pasuri me vlerë shumë të madhe. Kur dijetari tregon diçka duhet të dëgjohet me kujdes, me qëllim që të mbahet në mend ajo që ai e thotë. Hadithi në fjalë tërheq vërejtjen në kryerjen e vazhdueshme të detyrave fetare dhe për marrëdhëniet e mira ndërnjerëzore. Njerëzit kanë origjinë të njëjtë dhe dallimet në të menduar nuk duhet të jenë shkak për ngatërresa dhe çrregullime.

Njerëzit e ditur duhet respektuar; para tyre të flitet sa më pak, me qëllim që atyre t'u lihet më shumë kohë dhe mundësi për të shprehur këshilla edukative.

قال : تَنَجَّى بِنَوْبِهِ ـ فَسَلَّمَ موسىٰ ، فقال الخَضِرُ : وأَنَّى بأرضِكَ السلامُ ؟ فقال : أنا موسى . فقال : موسىٰ بنى إسرائيلَ ؟ قال : نعم . قال هل أتَّبِعُكَ عَلَى أنْ تُعَلِّمَنِي مِمَّا عُلِّمْتَ رُشْدا . قال : إنَّكَ لن تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرا . يا موسىٰ إنِّي عَلَى عِلمٍ من عِلمِ اللهِ عَلَّمَنِيهِ لا تَعْلَمُهُ أنتَ ، وأنتَ عَلَى عِلمٍ عَلَّمَكَهُ لا أعْلَمُـــهُ . قال : سَتَجِدُنِي إنْ شاء اللهُ صابِراً ولا أعْصِي لكَ أمرا . فانطلقا يَمْشِيانِ على ساحِلِ البحرِ ليسَ لَهُما سَفِينةٌ ، فمرَّتْ بهما سَفِينةٌ ، فكلَّموهُمْ أنْ يَحمِلوهُما ، فعُرِفَ الخَضِرُ فحَملوهُما بِغَيرِ نَوْلٍ . فجاء عُصفورٌ فوَقَعَ على حَرْفِ السَّفِينةِ ، فنَقَرَ نَقرةً أو نَقرَتَيْنِ فى البحرِ . فقال الخَضِرُ : يا موسىٰ ، ما نَقَصَ عِلمِي وعِلمُكَ مِن عِلمِ اللهِ إلاَّ كَنَقْرةِ هٰذا العُصفورِ فى البحرِ . فعَمَدَ الخَضِرُ إلى لَوْحٍ مِن ألْواحِ السَّفِينةِ فنَزَعَهُ . فقال موسىٰ : قَوْمٌ حَمَلونا بِغَيرِ نَوْلٍ عَمَدْتَ إلى سَفِينتِهِم فخَرَقْتَها لتُغْرِقَ أهلَها . قال : ألَمْ أقُلْ لكَ إنَّكَ لنْ تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صبرا . قال : لا تُؤاخِذْنِي بما نَسِيتُ . فكانَتِ الأُولىٰ مِن موسىٰ نِسيانا . فانطلقا ، فإذا غُلامٌ يَلْعَبُ مع الغِلمانِ ، فأخَذَ الخَضِرُ برأسِهِ مِنْ أعْلاهُ فاقْتَلَعَ رأسَهُ بيدِهِ . فقال موسىٰ : أقَتَلْتَ نَفْساً زَكِيَّةً بغَيرِ نفسٍ ؟ قال : ألَمْ أقُلْ لكَ إنَّكَ لنْ تَسْتَطِيعَ معِيَ صبرا ؟ (قال ابنُ عُيَينةَ : وهٰذا أوكَدُ) . فانطلقا حتَّى أتَيا أهلَ قريةٍ استَطْعَما أهلَها فأبَوْا أنْ يُضَيِّفوهُما . فوَجَدا فيها جِداراً يُرِيدُ أنْ يَنْقَضَّ فأقامَه ، قال الخَضِرُ بيَدِهِ فأقامَه . فقال له موسىٰ : لوْ شِئْتَ لا تَخَذْتَ عليهِ أجْرا . قال : هٰذا فِراقُ بَينِي وبَينِكَ . قال النبيُّ ﷺ : يَرحَمُ اللهُ موسىٰ ، لَوَدِدْنا لو صَبَرَ حتَّى يُقَصَّ علينا مِن أمرِهما »

Kur dijetari pyetet "Ksh është më i dituri" është mirë që përgjigja t'i lehet All-llahut

122. Na ka treguar Abdullah b. Muhammedi, këtij i ka treguar Sufjani, këtij Amri, këtë e ka njoftuar Se'id b. Xhubejri, **i cili** ka thënë:

I kam thënë Ibni Abbasit se Nevf el-Bikaliu konsideron se Musai nuk është ai Musai i Beni Israilëve, por është një . usa tjetër? Ka gënjyer armiku i All-llahut, tha Ibni Abbasi. Neve na ka treguar Ubejj b. Ka'bi nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

Pejgamberit Musa, duke u mbajtur fjalim Beni Israilëve, i është shtruar pyetja: **"Kush është më i dijshmi?"**. Ai u përgjigj: **"Unë jam më i dijshmi"**.

All-llahu i Madhëruesëm e qortoi (për këtë) se atë njohuri nuk ia la Atij, prandaj i shpalli: **"Është një rob nga robërit e Mi aty ku bashkohen dy detet, ai është më i ditur se ti"**.

"O Zot si të takohem më të?" tha Musai.

I është thënë: **"Mbaje një peshk në torbë dhe ku ta humbësh atë, aty është ai".**

(Musai a.s.) u nis për rrugë. Me të u nis edhe djaloshi i tij (bashkudhëtari) Jusha b. Nuni. Ky e mbante peshkun në torbë derisa arritën te shkëmbi (vendi ku bashkohen dy detet). U mbështetën për shkëmbi dhe i zuri gjumi. Peshku pa u dëgjuar doli nga torba (strajca), vazhdoi rrugën kah deti duke hapur rrugë. Kjo për Musain dhe bashkudhëtarin e tij ishte mrekulli. Vazhduan të udhëtojnë edhe atë pjesë të ditës e të natës që u kishtë mbetur. Kur zbardhi drita, Musai i tha djaloshit (përcjellësit) të vet: **"Na jep atë sillën** (ushqimin) **tonë, sepse, jemi lodhur nga ky udhëtim i ynë"**. Musai (a.s.), megjithatë, nuk e hetoi lodhjen derisa nuk e kaloi vendin që i ishte thënë. Atëherë i tha përcjellësi (shërbetori): **"Shiko! kur zbritëm te ai shkëmbi, unë e harrova peshkun"**, kurse Musai i tha: **"Zaten, ai është vendi të cilin e gjurmojmë** (e kërkojmë)**, prandaj, u kthyen nëpër gjurmët e veta** (nga kishin ardhur) **duke i treguar njëri-tjetrit".**

Kur arritën te ai shkëmb, aty e panë një njeri të mbuluar me tesha, ose, siç thotë transmetuesi, ishte mbuluar me teshat e tij. Musai a.s. i dha selam, kurse Hidri (Hëzri) i tha: **"Prej ku në vendin tënd selam?"**

"Unë jam Musai", i tha.

"Musai i Beni Israilëve?" e pyeti (Hidri).

"Po", u përgjigj Musai.

Pastaj, Musai (a.s.) i tha: **"A mund të të përcjell, për të më mësuar mua me një pjesë të dijenisë së mrekullueshme që t'u ka dhënë ty?"**

(Hidri) iu përgjigj: **"Ti nuk mund të durosh** (në shoqëri) **me mua. Unë kam të tillë dijenie që ma ka dhuruar All-llahu i Madhëruesëm nga dijenia e Tij, ti nuk e di atë, kurse ti ke të tillë dijenie të cilën All-llahu ta ka dhuruar, e që unë nuk e di** (nuk e njoh)".

(Musai) i tha: **"Do të më gjesh të durueshëm, në dashtë All-llahu e ty nuk do të kundërshtoj asgjë".**

Pastaj, meqë nuk e kishin anijën e tyre, e vazhduan udhëtimin duke ecur bregut të detit. Rastësisht, kaloi një anije pranë tyre. Filluan të bisedojnë me pronarët e anijeve, për t'u bërë shërbim këtyre. Hidrin e njihnin, prandaj i bënë shërbim falas. (Duke udhëtuar me anije) erdhi një shpend, u lëshua në buzë të anijes dhe me sqepin e tij i shpoi një ose dy vrima.

Hidri tha: **"O Musa, dijenia ime dhe e ytja, në krahasim me dijeninë e All-llahut është e vogël, sa vrima e këtij shpendi ndaj detit".**

Pastaj, Hidri shkoi e u mbështet te një dërrasë e anijes dhe filloi ta zhbirojë atë.

Musai i tha: **"Njerëzit na bënë shërbim pa të holla** (falas) **e ti po i prish anijet e tyre dhe don t'i mbysësh udhëtarët e saj!"**

Hidri: **"A nuk të thashë se ti nuk do të mundesh të durosh me mua?"**

Musai: **"Mos më qorto, për atë që kam harruar".** Kjo ishte harresa e parë e Musait (a.s.).

Pastaj, vazhduan udhëtimin. Kur e takuan një fëmijë që luante me fëmijët e tjerë, Hidri e rrëmbeu për koke dhe me dorën e tij ia hoqi kokën. Prandaj, Musa i tha: **"Pse e mbyte njeriun e pafajshëm që nuk ka mbytur asnjë!"**

Hidri, përsëri tha: **"A nuk të thashë unë se ti nuk mund të durosh** (në shoqëri) **me mua?"**

Ibni Ujejne ka thënë se ky është sinjalizimi i theksuar.

E vazhduan përsëri udhëtimin. Arritën te një lagje, nga banorët e se cilës kërkuan ushqim. Banorët e asaj lagjeje nuk deshën t'u ndihmonin. Në atë fshat panë një mur i cili ishte duke u rrëzuar. Hidri e drejtoi atë.

Kur Musai i tha : **"Po të doje, për këtë** (vepër) **do të merrje ndonjë shpërblim!"**, Hidri iu përgjigj: **"Kjo është ndarja në mes meje dhe teje".**

Pejgamberi s.a.v.s. (pasi e tregoi tregimin deri këtu) tha:

"All-llahu e mëshiroftë Musain. Me të vërtetë do të ishim të kënaqur sikur të duronte Musai deri sa të na tregohej neve (nga All-llahu) **tregimi *për këta të dy*".**[61]

---

61 Musai shkoi pas Hidrit kur erdhi në shkretirën Tih. Kur doli nga anija në bregun e Detit të Zi dhe kur e mbyti djaloshin, Hidri e vazhdoi udhëtimin drejt Antiohisë dhe bashkë me Musain dhe me përcjellësin e tij arritën, diku kah mbrëmja, në vendin Ubullu, e sipas disave në Nazaret të Jerusalemit. Nata ishte shumë e ftohtë, kurse vendasit nuk u shprehën mirëseardhje, prandaj qenë të shtrënguar të mbështeten te një mur që posa do të rrëzohej. Njerëzit me frikë kalonin afër tij. Salebiu thekson se ai ishte muri i dy jetimëve të lagjes. Hidri e drejtoi atë derisa të rriten jetimët, sepse prindët e tyre kishin fshehur në të pasuri. Ibni Abbasi pohon se Hidri e rrëzoi atë mur dhe përsëri e ndërtoi. Pasi e mbaroi punën,

باب من سأل وهو قائم عالماً جالساً

١٢٣ ـ حدثنا عثمانُ قال أخبرنا جريرٌ عن منصورٍ عن أبي وائلٍ عن أبي موسىٰ قال: جاء رجلٌ إلى النبيِّ ﷺ فقال: يا رسولَ اللهِ، ما القتالُ في سبيلِ اللهِ؟ فإنَّ أحدَنا يقاتِلُ غضباً ويُقاتِلُ حَمِيَّةً. فرفعَ إليه رأسَهُ ـ قال: وما رفعَ إليه رأسَهُ إلاَّ أنَّهُ كان قائماً ـ فقال: «مَنْ قاتَلَ لِتكونَ كلمةُ اللهِ هيَ العُليا فهوَ في سبيلِ اللهِ عزَّ وجلَّ».

Pyetësi që qëndron në këmbë, e pyet dijetarin që rri ulur

123. Na ka treguar Uthmani, këtij i ka treguar Xheriri, këtij Mensuri, ky nga Ebu Vaili, ky nga Ebu Musai, i cili tregon se te Pejgamberi s.a.v.s. ka ardhë një njeri, dhe e ka pyetur:

"O Resulullah, ç'është lufta në emër të All-llahut? Disa nga ne luftojnë nga zemërimi e disa nga mendjemadhësia (krenaria)".

Ai (Pejgamberi s.a.v.s.) e ngriti kokën kah ai. E ngriti kokën kah ai, thotë (transmetuesi) vetëm për shkak se bashkëbiseduesi (pyetësi) qëndronte në këmbë, e u përgjigj:

Musai i pat propozuar të marrë shpërblim për punën që e bëri. Hidri u hidhërua për këtë, prandaj ia tregoi Musait qëllimin e sjelljeve të veta, e pastaj u nda nga ai dhe vetë vazhdoi udhëtimin.

Nga hadithi shihet se:

- për të kërkuar dituri duhet të shkosh edhe në vende të tjera. Edukimi dhe kultura janë ideale të Islamit;
- të pyesësh njerëzit e ditur për probleme të paqarta; këtë duhet ta bësh për të fituar dituri e jo nga ironia ose dyfytyrësia;
- udhëtari në rast nevoje mund t'i lutet shokut për ndihmë;
- puna e bërë duhet të kompenzohet materialisht. Të udhëtosh me mjetin e huaj pa pagesë, lejohet vetëm me pëlqimin e pronarit të tij;
- vendimi i sjellur në bazë të fakteve konkrete është i vlefshëm (i plotfuqishëm), derisa nuk ka vendime të reja, të panjohura më parë:
- nga dy të këqijat zgjidhet e keqja më e vogël;
- urdhërat e All-llahut xh.sh. duhet të kryhen me përkushtim të plotë, sepse në to ka urtësi dhe dobi për njerëzit, që disa herë nuk mund të kuptohen.

"Kush lufton që Fjala e All-lahut të Madhërueshëm të mbizotërojë, ai është në rrugën e All-llahut të Madhërueshëm".[62]

بابُ السُّؤالِ والفُتيا عندَ رَمي الجِمار

١٢٤ - حدثنا أبو نُعيم، قال: حدثنا عبدُ العزيزِ بنُ أبي سَلَمةَ عنِ الزُّهْريِّ عن عيسى بنِ طَلْحةَ عن عبدِ اللهِ بنِ عَمْرٍو قال: رَأيتُ النبيَّ ﷺ عندَ الجَمْرةِ وهوَ يُسْألُ، فقال رَجلٌ: يا رسولَ اللهِ نَحَرتُ قبلَ أنْ أرمِيَ. قال: ارْمِ ولا حَرَجَ. قال آخَرُ: يا رسولَ اللهِ حَلَقتُ قبلَ أن أنحرَ. قال: انحرْ ولا حَرَجَ. فما سُئلَ عن شيءٍ قُدِّمَ ولا أُخِّرَ إلاَّ قال: افعلْ ولا حَرَجَ.

Pyetjet dhe përgjigjjet ku bëhet hudhja e guralecave

124. Na ka treguar Nu'ajmi, këtij Abdu-l-Aziz b. Ebu Seleme, ky nga Zuhriu, ky nga Isa b. Talhai, e ky nga Abdullah b. Amri, i cili ka thënë: E kam parë Pejgamberin s.a.v.s. kur e pyetnin me rastin e hedhjes së guralecave. Një njeri e pyeti:

"O Resulullah, kam prerë kurban para se të hedh guralecat?"

"Nuk ka dëm (gjynah), **hidh tash,** u përgjigj (Pejgamberi s.a.v.s.)

Tjetri e pyeti: **"O Resulullah, jam rruar para se të pres kurban?"**

"Nuk ka dëm (gjynah), **preje tash!"**, u përgjigj.

Nuk është pyetur për asgjë që është bërë më herët, ose që është shtyrë më vonë, e që (Pejgamberi s.a.v.s.) të mos jetë përgjigjur:

"Nuk ka dëm** (gjynah), **bëre tash!"

---

62 Veprat e bëra çmohen dhe shpërblehen vetëm sipas qëllimit. Sinqeriteti është kusht për shpërblimin e çdo pune. Kush bën vepra të mira për shkak të interesave të tij personale, ose për hatër të tjetrit, nuk mund të llogarisë në shpërblimin e All-llahut xh.sh.

Hadithi tregon stilin e lartë dhe përgjigjen e qartë të Muhammedit a.s. Gjatë pyetje-përgjigjeve bashkëbiseduesit duhet të jenë të kthyer me fytyrë nga njëri-tjetri.

بابُ قولِ اللهِ تعالى ﴿ وما أوتيتُم مِنَ العِلمِ إلاّ قليلا ﴾ [٨٥ الإسراء]

١٢٥ — حدّثنا قيسُ بنُ حفصٍ قال حدّثنا عبدُ الواحدِ قال حدّثنا الأعمشُ سُليمانُ عن إبراهيمَ عن عَلقمةَ عن عبدِ اللهِ قال : بَينا أنا أمشي معَ النبيِّ ﷺ في خَربِ المدينةِ ـ وهُوَ يَتوَكّأُ على عَسيبٍ معَهُ ـ فمرَّ بنَفَرٍ مِنَ اليَهودِ ، فقال بعضُهم لبعضٍ : سَلُوه عنِ الرُّوحِ . وقال بعضُهم لا تَسألوهُ ، لا يَجيءُ فيهِ بشيءٍ تكرَهونَه . فقال بعضُهم لَنَسألَنَّهُ ، فقام رجلٌ منهم فقال : يا أبا القاسمِ ، ما الرُّوحُ ؟ فسَكتَ . فقُلتُ : إنَّهُ يُوحى إليه ، فقمتُ . فلمّا انجلَى عنه فقال ﴿ ويَسألونَكَ عن الرُّوحِ ، قُلِ الرُّوحُ مِن أمرِ رَبّي ، وما أوتُوا مِنَ العِلمِ إلاّ قليلا ﴾ قال الأعمشُ : هٰكذا في قِراءتِنا

"Juve u është dhënë vetëm pak dijeni" (el-Isrâ',85)

Janë fjalët e All-llahut të Madhërueshëm.

125. Na ka treguar Kajs b. Hafsi, këtij i ka treguar Abdu-l-Vahidi, këtij A'mesh Sulejmani, ky nga Ibrahimi, ky nga Alkame, e ky nga Abdullahu, i cili ka thënë:

"(Një ditë) ecnim me Pejgamerin s.a.v.s. nëpër djerrinat (vende jopjellore) e Medines. Ai (Pejgamberi) mbahej në shkopin që e kishte me vete. Kaloi pranë një grupi të jahudive (hebrenjve). Ata (jahuditë) i thanë njëritjetrit: **"Pyetni për shpirtin!"** Njëri nga ata tha: **Mos e pyetni! Do t'iu përgjigjet në atë mënyrë që juve nuk do t'ju pëlqejë!"** Disa thanë: **"Megjithatë, do ta pyesim!"** Atëherë, u ngrit njëri nga mesi i tyre dhe tha: **"O Ebu-l-Kasim! Çka është shpirti?"**

Ai (Pejgamberi s.a.v.s.) heshti, e unë thashë (në vete): **"Po frymëzohet** (i vjen Shpallja)" dhe u ndala.

Kur Shpallja iu ndal, tha:

"Do të pyesin ty për shpirtin. Thuaju: Shpirti është çështje e Zotit tim, e juve u është dhënë vetëm pak dijeni".

(el-Isrâ, 85).

A'meshi ka thënë: Sipas mënyrës sonë të leximit është **"utu"**.[63]

---

63 Hebrenjtë e kanë ditur përmes Tevratit se njerëzit nuk e dinë esencën e shpirtit, prandaj kanë dashur të dëgjojnë mendimin e Muhammedit a.s. Pyetja e hebrenjve nuk ishte e

بابٌ من تَرَكَ بعضَ الاختيارِ مخافةَ أن يَقْصُرَ فهمُ بعضِ الناسِ عنه فيقعوا في أشدَّ منه

١٢٦ — حدثنا عُبيدُ اللهِ بنُ موسى عن إسرائيلَ عن أبي إسحٰق عنِ الأسْوَدِ قال : قال لي ابنُ الزُّبيرِ : كانت عائشةُ تُسِرُّ إليكَ كثيراً ، فما حدَّثتْكَ في الكعبةِ ؟ قلتُ : قالت لي : قال النبيُّ ﷺ « يا عائشةُ لَوْلا قومُكِ حديثٌ عهدُهم ـ قال ابنُ الزُّبيرِ : بكُفْرٍ ـ لنقضتُ الكعبةَ فجعلتُ لها بابَيْنِ : بابٌ يدخُلُ الناسُ ، وبابٌ يَخْرُجونَ » ففعَلَهُ ابنُ الزُّبيرِ

Lënia anash e disa mendimeve nga frika se mos po kuptohen gabimisht dhe për shkak të pasojave të tyre

126. Na ka treguar Ubejdullah b. Musai nga Israili, ky nga Ebu Is-haku, ky nga el-Esvedi, i cili ka thënë:

Ibnu Zubejri më ka thënë: **"Aishja të ka treguar ty shumë fshehtësi, e çka të ka treguar për Qaben"?**

"Më ka thënë", u përgjigja:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë.

"Aishe, ky populli yt, të mos ishte i ri dhe i freskët në kujtesë, e Ibni Zubejri ka thënë, në mosbesim, unë Qaben do ta zgjeroja dhe do t'i kisha vënë dy dyer: njëra nëpër të cilën do të hynin njerëzit dhe tjetra nëpër të cilën do të dilnin".

Atë më vonë e bëri Ibni Zubejri.[64]

---

përpiktë, prandaj edhe përgjigja në ajetin e lartshënuar është e përgjithshme.
Fjal "ruh" në Kur'an përdoret me kuptimet; shpirt, Xhibrili dhe Shpallja e All-llahut xh.sh.

64 Ndërtesa e sotme e Qabes me një ngritje të dyerve mjaft të mëdha mbi tokë, qëndron në themelet e saja të vjetra. Harun er-Reshidi, duke patur parasysh hadithin e lartpërmendur, pat biseduar me Malikun për rrëzuarjen e Qabes dhe për zgjerimin e saj në themelet e Ibni Zubejrit. Në fund të bisedës Maliku i kishte thënë halifes: "O udhëheqës i muslimanëve, të betohem në All-llahun xh.sh., që Qaben të mos e konsiderosh lodër mbretërore. Po ta rrëzonte e po ta ndërtonte çdonjëri sipas qejfit të vet, ajo do ta humbiste shenjtërinë e vet te njerëzit". Historianët bëjnë këtë radhitje kronologjike të ndërtimit të saj, e dalin gjashtë ndërtues: Melekët, Ibrahimi a.s., Amalekitët, fisi Xhumhur, Kurejshitët, ku mori pjesë edhe Muhammedi a.s. Ai e qetësoi mosmarrëveshjen që lindi rreth vendosjes së Gurit të Zi në murin e Qabes. Më kërkesë të atyre që grindeshin, ai e

بابٌ مَنْ خَصَّ بِالعِلمِ قَوْمًا دُونَ قَومٍ كَرَاهِيَةَ أَنْ لا يَفْهَمُوا . وقال عليٌّ : حَدِّثُوا النَّاسَ بِمَا يَعْرِفُونَ ، أَتُحِبُّونَ أَنْ يُكَذَّبَ اللهُ ورسولُه ؟

١٢٧ — حدثنا عُبَيْدُ اللهِ بنُ موسى عن مَعْرُوفِ بنِ خَرَّبُوذٍ عن أبي الطُّفَيلِ عن عليٍّ بذلك

Interesimi për të njoftuar vetëm disa duke u frikuar që të mos e kuptojnë gabimisht disa të tjerë

Aliu ka thënë: **"Tregoni popullit atë që e kupton! A dëshironi të përgënjeshtrohet All-llahu dhe Pejgamberi i Tij"?**

127. Na ka treguar Ubejduallah b. Musai, ky nga Ma'ruf b. Hurrebudhi, ky nga Tufejli, e ky nga Aliu (lidhur me atë që u tha më lartë).

١٢٨ — حدثنا إسحٰقُ بنُ إبراهيمَ قال حدَّثنا مُعاذُ بنُ هِشامٍ قال حدَّثني أبي عن قَتادةَ قال : حدَّثنا أَنَسُ ابنُ مالكٍ أنَّ النبيَّ ﷺ ـ ومُعاذٌ رَدِيفُهُ عَلَى الرَّحْلِ ـ قال : يا مُعاذُ بنَ جَبَلٍ . قال : لَبَّيكَ يا رسولَ اللهِ وسَعْدَيْكَ . قال : يا مُعاذُ . قال : لَبَّيكَ يا رسولَ اللهِ وسَعْدَيْكَ (ثلاثًا) . قال : ما مِنْ أَحَدٍ يَشْهَدُ أن لا إلٰهَ إلَّا اللهُ وأنَّ محمدًا رسولُ اللهِ صِدْقًا مِن قَلْبِهِ إلَّا حَرَّمَهُ اللهُ عَلَى النَّارِ . قال : يا رسولَ اللهِ أَفَلا أُخْبِرُ بِهِ النَّاسَ فَيَسْتَبْشِرُوا ؟ قال : إذًا يَتَّكِلُوا . وأَخْبَرَ بِها مُعاذٌ عِندَ مَوْتِهِ تَأَثُّمًا

---

shtroi gunën e vet, e vuri gurin në të dhe i thirri të parët e fiseve që secili prej tyre të kapë nga një skaj të gunës dhe kështu ta vënë së bashku në mur, prej ku ai me dorën e vet, në moshën 35 vjeçare, e vendosi në vendin përkatës. Ndërtuesi i gjashtë ishte Ibni Zubejri. Ai e zgjeroi pak Qaben dhe, sikurse ësbtë thënë më lart, i ka vënë dy dyer. Në luftën vëllavërasëse, në mes Ibni Zubejrit dhe Haxhxhaxhit, Qabja u dëmtua mjaft, prandaj Haxhxhaxhi ndërmori masa dhe ndërtesa përsëri u ndërtua në formën e sotme.

Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- nganjëherë idetë e dobishme dhe të mira nuk zbatohen, sepse mund të shkaktojnë pasoja të padëshirueshme. Pejgamberi a.s. në rastin konkret e ka theksuar nevojën e zgjerimit të Qabes në themelet e ndërtesës së Ibrahimit a.s., por megjithatë, këtë nuk e bëri, duke u frikësuar nga ngatërresat dhe çrregullimet e atyre që posa e kishin pranuar Islamin.
- udhëheqësi ka të drejtë të vendosë për punët e dobishme për bashkësinë, por edhe t'i lë disa punë për të cilat mendon se janë të dëmshme për shoqërinë. Megjithatë, nuk ka të drejtë të ndërrojë ligjet e sheriatit, si: të lirojë dikënd nga dhënia e zeqatit, t'i ndërrojë normat e të drejtës penale dhe martesore e të tjera, të cilat janë të vërtetuara me Kur'an dhe me hadith.

128. Na ka treguar Is-hak b. Ibrahimi, këtij Muadh b. Hishami, këtij babai i vet, ky nga Katade, ky nga Enes b. Maliku, i cili tregon se Pejgamberi s.a.v.s. ishte ulur në shalë, kurse Muadhi pas tij, të cilit i ka thënë:

"O Muadh b. Xhebel"!

"Urdhëroni, O Resulullah, jam i lumtur që po ju shërbej juve", iu përgjigj Muadhi.

"O Muadh!" tha përsëri.

"Urdhëroni, O Resulullah, jam i kënaqur që po ju shërbej juve", iu përgjigj.

Duke e përsëritur dialogun tri herë, tha (Pejgamberi s.a.v.s.):

"Ai i cili nga thellësia e shpirtit dëshmon se "Nuk ka Zot përveç një All-llahu dhe se Muhammedi është Pejgamberi i Tij, All-llahu do ta ruajë nga zjarri i Xhehennemit".

"O Resulullah, a ta lajmëroj popullin për këtë, që të gëzohet?", pyeti Muadhi.

Pejgamberi s.a.v.s. tha: **"Atëherë do të mbështetet vetëm në këtë "**. Duke pasë frikë se do të bie në gabim për shkak të fshehjes së dijenisë, këtë hadith Muadhi e paraqiti mu para vdekjes së tij.[65]

---

65 Aliu tërheq vërejtjen se dijenia duhet t'u përcillet njerëzve të tjerë, sipas mundësisë së të kuptuarit të tyre dhe me metoda që ata do të mund ta kuptonin më lehtë. Atë që njerëzit nuk mund ta kuptojnë, zakonisht e konsiderojnë të pavërtetë. Së pari është e nevojshme të dihet shkalla e përgatitjes arsimore e dëgjuesve, dëshira dhe rrethanat e tyre, e pas këtyre njoftimeve t'u tregohet vetëm ajo për të cilën ata kanë nevojë dhe mundësi për ta kuptuar.

Duket se besimtari do të shpëtojë nga zjarri i Xhehennemit, duke shprehur shehadetin, bile qoftë edhe para vdekjes. Një numër i madh i dijetarëve këtij qëndrimi i shtojnë: "Nëse pas tij (shehadetit) ka punuar edhe vepra të mira, e largohet nga veprat e këqija dhe të dëmshme." Disa mendojnë se dëshmimi i shehadetit do t'i ndihmojë besimtarit vetëm të mos qëndrojë gjithnjë në Xhehennem, e disa të tjerë mendojnë se do ta shpëtojë besimtarin nga zjarri i Xhehennemit vetëm gjuha, e cila e ka dëshmuar atë dhe balli që i ka bërë sexhde All-llahut xh.sh.

Hasan Basriu mban qëndrimin se nga zjarri i Xhehennemit do të jetë i kursyer ai që dëshmon publikisht Njësinë e All-llahut xh.sh. dhe pejgamberinë e Muhammedit a.s., e pastaj i kryen detyrat ndaj All-llahut, po edhe ndaj bashkësisë dhe njerëzve të tjerë.

١٢٩ — حدثنا مُسَدَّدٌ قال حدثنا مُعْتَمِرٌ قال سمعتُ أنسًا قال : ذُكِرَ لي أنَّ النبيَّ ﷺ قال لمُعاذٍ « مَنْ لَقِيَ اللهَ لا يُشْرِكُ بِهِ شَيْئًا دَخَلَ الجنَّةَ » قال : ألا أُبَشِّرُ الناسَ ؟ قال « لا : إنِّي أخافُ أن يَتَّكِلوا »

129. Na ka treguar Museddedi, këtij i ka treguar Mu'temiri, ky ka dëgjuar nga babai i vet, ky nga Enesi, i cili ka thënë: Më është përmendur se Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë Mu'adhit:

"Ai që e takon All-llahun (në Ditën e Gjykimit), **e që nuk i ka bërë shok Atij, do të hyjë në Xhennet".**

Mu'adhi e kishte pyetur (Pejgamberin s.a.v.s.): **"A ta gëzoj popullin?"**

"Jo, frikohem se mos po mbështeten vetëm në këtë", i qe përgjigjur (Pejgamberi s.a.v.s.).[66]

باب الحياء في العلم ، وقال مجاهد : لا يتعلَّمُ العلمَ مُستحيٍ ولا مُستكبرٌ ، وقالت عائشةُ : نِعْمَ النساءُ نساءُ الأنصارِ ، لم يَمْنَعْهُنَّ الحياءُ أنْ يَتفقَّهْنَ في الدِّينِ

١٣٠ — حدثنا محمد بن سلام قال أخبرنا أبو مُعاوِيَةَ قال حدثنا هِشامٌ عن أبيهِ عن زَيْنَبَ ابنةِ أُمِّ سَلَمَةَ قالت : جاءتْ أُمُّ سُلَيْمٍ إلى رسولِ اللهِ ﷺ فقالت : يا رسولَ اللهِ ، إنَّ اللهَ لا يَسْتَحْيِي مِنَ الحقِّ ، فهلْ عَلَى المرأةِ مِنْ غُسْلٍ إذا احتَلَمَتْ ؟ قال النبيُّ ﷺ : إذا رأتِ الماءَ . فغَطَّتْ أُمُّ سَلَمَةَ ـ تَعْنِي وَجْهَها ـ وقالتْ : يا رسولَ اللهِ ، وَتَحْتَلِمُ المرأةُ ؟ قال : نعم ، تَرِبَتْ يَمِينُكِ ، فبِمَ يُشْبِهُها وَلَدُها ؟

Nga hadithi del se:

- dijenia i përcillet atij që është në gjendje ta kuptojë atë drejt. Çështjet e ndërlikuara nuk duhet t'u thuhen atyre që nuk janë në gjendje t'i kuptojnë e as atyre që mbajnë vetëm njërën anë (janë këmbëngulës në qëndrimet e tyre të njëanshme). Rregullat e rëndësishme dhe ligjëratat e vlefshme duhet të përsëriten;
- në një kafshë mund të hipin dy ose më tepër, duke patur kujdes që kafsha të mos stërngarkohet.

66 Nga hadithi i sipërpërmendur shihet qartë se në Xhennet hyjnë njerëzit të cilët, përveç që besojnë All-llahun xh.sh. i kryejnë edhe detyrat tjera fetare islame. Ai që e beson All-llahun xh. sh., e nuk i kryen urdhërat e Tij, mund të hyjë në Xhennet, po të dojë All-llahu xh.sh. All-llahu xh.sh. mund ta dënojë për mosdëgjueshmëri, por edhe mund ta lirojë nga çdo përgjegjësi. Vetëm All-llahut xh.sh. i takon mbikëqyrja e plotë në këtë botë dhe në botën tjetër; Ai bën çka do.

Turpi gjatë zënies së diturisë

Nexhadiu ka thënë: **"Shkencën** (dijeninë) **nuk e fiton ai që ka turp dhe ai që është kryelartë"**. Aishja ka thënë: **"Gra të shkëlqyeshme janë gratë Ensare, ato nuk i pengon turpi që të mësohen në fe** (besim)".

130. Na ka treguar Muhammed b. Selami, këtij i ka treguar Ebu Muaviu, këtij Hishami, këtij babai i vet, ky nga Zejnebja, vajzë e Ummu Selemes, kjo nga Ummu Selemja, e cila ka thënë:

Ummu Selemja ka ardhë te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e pyeti:

"O Resulullah, All-llahu nuk turpërohet nga e vërteta, prandaj, a është e detyruar gruaja të lahet kur ëndërron (marrëdhënie intime)**?"**

"Vetëm kur sheh lëng", u përgjigj Pejgamberi s.a.v.s.

Ummu Selemja , pastaj, u mbulua në fytyrë dhe tha?

"E, a mund të përjetojë gruaja ejakulimin (në ëndërr)**?"**

"Po, oj e turpshme", tha ai.

"Po si ngjan fëmija e saj?".[67]

١٣١ — حدثنا إسماعيل قال حدثني مالك عن عبد الله بن دينار عن عبد الله بن عمر أن رسول الله ﷺ قال « إن من الشجر شجرة لا يسقط ورقها وهي مثل المسلم ، حدثوني ما هي ؟ فوقع الناس في شجر البادية ، ووقع في نفسي أنها النخلة ، قال عبد الله : فاستحييت . فقالوا يا رسول الله أخبرنا بها . فقال رسول الله ﷺ هي النخلة . قال عبد الله : فحدثت أبي بما وقع في نفسي ، فقال : لأن تكون قلتها أحب إلي من أن يكون لي كذا وكذا

131. Na ka treguar Ismaili, këtij i ka treguar Maliku, ky nga Abdullah b, Dinari, ky nga Abdullah b, Umeri, i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"Është një pemë në mesin e pemëve, gjethet e së cilës nuk bien. Ajo është e ngjashme me muslimanin. Më thuani cila është ajo?"

---

67 Në kërkimin e diturisë nuk duhet patur turp. Gruaja sikurse burri, duhet të lahet, kur pas ëndërrimit, në trupin ose në teshën e saj, sheh gjurmë të ejakulimit. Gruaja derdhet (ejakulon) sikurse mashkulli.

Njerëzit menduan në ndonjë pemë të shkretëtirës, e unë, tha Abdullahu, mendova se është hurma, por u turpërova të them.

Atëherë, As-habët thanë: **"O Resulullah, na thuaj cila është ajo?!"**

"Ajo pemë është hurma", tha Pejgamberi s.a.v.s..

Abdullahu, pastaj tha: **"I kam treguar babait tim se kam pasë ndërmend ta them këtë"**. E, ai tha: **"Ta kishe thënë, do të doja ty më shumë se kjo dhe kjo"**.[68]

بابٌ مَنْ اسْتَحْيَا فَأَمَرَ غَيْرَهُ بِالسُّؤَالِ

١٣٢ – حَدَّثَنَا مُسَدَّدٌ قَالَ حَدَّثَنَا عَبْدُ اللهِ بْنُ دَاوُدَ عَنِ الْأَعْمَشِ عَنْ مُنْذِرٍ الثَّوْرِيِّ عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ الْحَنَفِيَّةِ عَنْ عَلِيٍّ قَالَ : كُنْتُ رَجُلًا مَذَّاءً ، فَأَمَرْتُ الْمِقْدَادَ أَنْ يَسْأَلَ النَّبِيَّ ﷺ ، فَسَأَلَهُ فَقَالَ : فِيهِ الْوُضُوءُ

U turpërua të pyes, prandaj e urdhëroi tjetrin

132. Na ka treguar Museddedi, këtij ia ka transmetuar Abdullah b. Davudi, ky nga A'meshi, ky nga Mundhir eth-Thevriu, ky nga Muhammed b. Hanefiu, e ky prej Aliut, i cili ka thënë:

"Jam nga ata njerëz që kam pasë mezi (lëng), **prandaj e urdhërova Mikdadin që për atë ta pyes Pejgamberin s.a.v.s."**. Ai e pyeti, kurse Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj:

"Në atë rast duhet të marrë vetëm abdest".[69]

---

68 Është gjë e lavdueshme të lakmosh për fatin ose për afirmimin e fëmijës sate, në të gjitha fushat, po sidomos në diturì.

69 Hazreti Aliu ishte dhëndër i Muhammedit a.s., prandaj është turpëruar ta pyesë për marrëdhënie seksuale. Duke dashur përgjigje të sigurtë, për pyetjen përkatëse, Muhammedin a.s. e pyeti Mikdad b, Amr b. Salebi nga fisi Behram el-Kindi. Paraqitja e lagështisë në organin gjenital (lëngu që del para ejakulimit) me pak nxitje e prish abdestin dhe para marrjes abdest duhet (është vaxhib) të lahet edhe organi gjenital.
Ebu Hanife dhe Shafiu mendojnë se me paraqitjen e atij lëngu në organin gjenital me provokim të drejtpërdrejtë, si për shembull, me ledhatim, përqafim, puthje, me shikim të gjinisë tjetër, ose të tërthortë, si me të menduar, duhet të përsëritet abdesti, kurse dijetarët e shkollës malikite mbajnë qëndrimin se abdestin duhet përsëritur vetëm në rast të paraqitjes së lëngut nga nxitja (provokimi)i drejtpërdrejtë.
Mezia është lëng i paraqitur në organin gjenital pas një nxitje të vogël.

بَابُ ذِكْرِ الْعِلْمِ وَالْفُتْيَا فِي الْمَسْجِدِ

١٣٣ — حَدَّثَنِي قُتَيْبَةُ بْنُ سَعِيدٍ قَالَ حَدَّثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ قَالَ حَدَّثَنَا نَافِعٌ مَوْلَى عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ أَنَّ رَجُلًا قَامَ فِي الْمَسْجِدِ فَقَالَ : يَا رَسُولَ اللَّهِ ، مِنْ أَيْنَ تَأْمُرُنَا أَنْ نُهِلَّ ؟ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ « يُهِلُّ أَهْلُ الْمَدِينَةِ مِنْ ذِي الْحُلَيْفَةِ ، وَيُهِلُّ أَهْلُ الشَّامِ مِنَ الْجُحْفَةِ ، وَيُهِلُّ أَهْلُ نَجْدٍ مِنْ قَرْنٍ » . وَقَالَ ابْنُ عُمَرَ : وَيَزْعُمُونَ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ قَالَ « وَيُهِلُّ أَهْلُ الْيَمَنِ مِنْ يَلَمْلَمَ . وَكَانَ ابْنُ عُمَرَ يَقُولُ : لَمْ أَفْقَهْ هَذِهِ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ

Të dhënët mësim dhe shpjegime në xhami

133. Më ka treguar Kutejbe b. Se'idi, këtij i ka treguar Lejth b. Sa'di, këtij Nafiu, rob i liruar i Abdullah b. Umer b. Hattabit, ky nga Abdullah b. Umeri, i cili tregon se një njeri u ngrit në xhami dhe pyeti:

"O Resulullah, prej ku po na urdhëron që haptas të shprehim telbijen?" Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj:

"Medinasit do ta shprehin nga Dhu-l-Hulejfe, sirjanët nga el-Xhuhfe, kurse ata të Nexhdit, nga Karni".

Disa As-habë mendojnë se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Jemenasit do ta shprehin (telbjen) nga Jelemlemi".

Unë këtë nuk e kam kuptuar nga Pejgamberi s.a.v.s. tha Ibni Umeri".[70]

بَابُ مَنْ أَجَابَ السَّائِلَ بِأَكْثَرَ مِمَّا سَأَلَهُ

١٣٤ — حَدَّثَنَا آدَمُ قَالَ حَدَّثَنَا ابْنُ أَبِي ذِئْبٍ عَنْ نَافِعٍ عَنِ ابْنِ عُمَرَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ . وَعَنِ الزُّهْرِيِّ عَنْ سَالِمٍ عَنِ ابْنِ عُمَرَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ ، أَنَّ رَجُلًا سَأَلَهُ : مَا يَلْبَسُ الْمُحْرِمُ ؟ فَقَالَ : « لَا يَلْبَسُ الْقَمِيصَ وَلَا الْعِمَامَةَ وَلَا السَّرَاوِيلَ وَلَا الْبُرْنُسَ وَلَا ثَوْبًا مَسَّهُ الْوَرْسُ أَوِ الزَّعْفَرَانُ ، فَإِنْ لَمْ يَجِدِ النَّعْلَيْنِ فَلْيَلْبَسِ الْخُفَّيْنِ ، وَلْيَقْطَعْهُمَا حَتَّى يَكُونَا تَحْتَ الْكَعْبَيْنِ »

---

70 Në xhami duhet të mbahen ligjërata, të zhvillohen diskutime të arsyeshme dhe të merren vendime.

Në hadith janë përmendur tri mikatë: mikati i medinasve, i sirjanëve dhe i nexhdasve, Ndërkaq, për mikatin e jemenasve Ibni Umeri ka dyshuar. Megjithatë, edhe ky mikat është vërtetuar me hadithin që e ka transmetuar Ibni Abbasi të cilin e përkrahën Buhariu, Muslimi dhe muhaddithë të tjerë. Për banorët e Irakut dhe vendeve përreth tij, mikat është Irku.

Atij që i ka interesuar, i është përgjigjur më gjërësisht se sa e ka pyetur

134. Na ka treguar Ademi, ky nga Ibni Ebu Dhi'bi, ky nga Nafiu, ky nga Ibni Umeri r.a., e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., por edhe nga Zuhriu, sipas senedit tjetër, ky nga Salimi, ky nga Ibni Umeri, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. se një njeri e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"Çka mund të veshë haxhiu kur është me ihram?"

Pejgamberi s.a.v.s i qe përgjigjur:

"Mos vish: këmishë, sarrëk, pantollona, kapuç, e as tesha të ngjyrosura me vers (dyell) **ose safran, pra le të vishen meste dhe të prehen që të vijnë deri nën nyjen e këmbëve".**[71]

---

71 Veshja modeste e haxhiut në haxhillëk i paralajmëron njerëzit për jetë modeste, duke u larguar nga jeta luksoze. Veshja e ihramit e nxit haxhiun që të mendojë gjithnjë në manifestimet e haxhxhit, në jetën fetare shpirtërore dhe në përkushtimin e plotë, kurse ngjyra e bardhë e ihramit ia përkujton veshjen e bardhë të vdekjes me të cilën më në fund do të mbështillet çdo i vdekur dhe do të niset të dalë para All-llahut xh. sh. për të dhënë llogari për veprat e tij.

Në pyetjet e të interesuarit mund të përgjigjesh (tërthorazi), sikurse veproi Muhammedi a.s. në rastin konkret.

Në mungesë të papuçeve ose sandaleve, haxhiu mund të veshë këpucë ose meste, por qafat e tyre të vinë deri nën nyje. Imam Ahmedi, duke iu përmbajtur hadithit që e transmetojnë Ibni Abbasi dhe Xheriri mendon se muhrimi mund të veshë meste edhe pa i prerë qafat e tyre (nën nyje).

Muhrimit i ndalohet të veshë pantollona dhe brekë. Në bazë të hadithit që e transmeton Ibni Abasi: "Kush nuk e ka pjesën e poshtme të veshjes, le të veshë brekë"! Imam Shafiu edhe disa juristë të tjerë, lejojnë veshjen e brekëve, respektivisht të pantollonave, pa ndonjë pasojë juridike islame. Ebu Hanife dhe Maliku, e lejojnë këtë, duke dhënë edhe kompenzim, që vërtetohet me hadithe të tjerë.

Te Badaiu qëndron: "Nëse muhrimi nuk e ka veshjen e poshtme (si fustan), të veshë brekë të gjera, duke i mbështjellur rreth vetes. Kush vesh brekë jo të gjera, duhet të prejë kurban. Nën kushte të njëjta shfrytëzohet edhe këmisha".

"Vers" është bima shumëvjeçare me ngjyrë të verdhë; rritet në Jemen dhe shërben për ngjyrosjen e pëlhurës.

4. Abdesti

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

٤ - كتاب الوضوء

باب ما جاء في الوُضوء، وقولِ الله تعالى [المائدة ٦] ﴿ إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ، وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ ﴾. قال أبو عبد الله: وبَيَّنَ النبيُّ ﷺ أَنَّ فَرْضَ الوُضوء مَرَّةً مَرَّةً، وتَوَضَّأَ أيضاً مَرَّتَيْنِ، وَثَلاثاً، ولم يَزِدْ عَلَى ثَلاث. وكَرِهَ أهلُ العِلمِ الإسرافَ فيه، وأَنْ يُجاوِزوا فِعلَ النبيِّ ﷺ

Bismi-l-Lahi-r-Rahmani-r-Rahim!

4. Abdesti

Çka hyn në abdest

All-llahu i Madhëruesh ëm (në Kur'an) thotë:

"... kur doni të falni namaz lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla dhe fshini kokën me dorë të lagët (merrni mes-h) dhe lani edhe këmbët deri në nyje...".[1]

(Mâide, 6)

---

1 Në pjesën hyrëse të Buharitut bëhej fjalë për Shpalljen, pastaj për besimin islam dhe për rëndësinë e diturisë, e këtu do të mësohen rregullat e manifestimeve fetare-islame që lidhen me besimin islam dhe me diturinë e artitur, të cilat, njëkohësisht janë shprehje e

të besuarit të çdo muslimani.

Meqë në Kur'an dhe në hadithe theksohet pesha dhe rëndësia e namazit dhe, meqë muslimani për çdo ditë, pesë herë, është i lidhur për namaz, Buhariu e vë në faqet e para të përmbledhjes së vet të hadïtheve.

Meqë abdesti është kusht për vlerën e namazit, është logjike që të paraqiten edhe rregullat e hollësishme për abdestin, për pastërtinë e trupit dhe për pastërtinë e teshave dhe të vendit në të cilin muslimani do të falet.

Në Kur'an dhe në Hadith, namazi përmendet me emrin "salât". Kjo fjalë rrjedh nga fjala "salen", d.m.th. "vithe". Personi i cili gjatë përkuljes lëviz me vithe, quhet "musal-li". Lëvizja e vitheve dhe e shpatullave vjen në shprehje sidomos gjatë faljes së namazit, prandaj falësi quhet "musal-li", kurse manifestimi "salât", d.m.th. namaz.

Disa thonë se fjala "musal-li" shpreh kalin e dytë me radhë gjatë garave të vrapimit, i cili e ndjek vazhdimisht kalin para tij, duke e mbajtur kokën gjithnjë në vithet e tij.

Fjala "salât" do të thotë edhe "kërkoj mëshirë, fat, shpëtim", e disa të tjerë mendojnë se do të thotë "shkrij, kalit (metalin)".

Për këto arsye "musal-li" është personi, i cili të gjitha veprimet e namazit i përcjell dhe i kryen me këmbëngulje, duke mos lëshuar asnjë. Gjatë faljes së namazit futen në përdorim të gjitha aftësitë mendore, fizike dhe shpirtërore, të gjitha organet e trupit, e sidomos vithet. Kështu pra namazi vepron në forcimin fizik dhe në ngritjen mendore e shpirtërore.

Me citimin e teksteve të caktuara të Kur'anit, muslimani e lut All-llahun xh.sh. për fatin dhe shpëtimin e tij, i fut në veprim aftësitë e tij mendore deri në fund, i ushtron dhe i ngre ato, që sa më tepër të zhvillohen dhe kështu të dallohet nga kafsha e rëndomtë, përpiqet të aftësohet dhe të bëhet zotëri i botës (natyrës), të udhëheq në të e jo e kundërta. Duke punuar në këtë mënyrë, njeriu bëhet zëvendës i All-llahut xh.sh., zotëri në tokë, e jo rob.

Ai që falet rregullisht, me vetëdije dhe me përkushtim të plotë, e ngre shpirtin dhe zemrën e tij dhe nga këto e eviton disponimin për punë negative dhe të gabueshme, pikërisht si artari, i cili, duke e shkrirë materien (metalin) e artë, ose ndonjë materie tjetër, i eviton nga ai mbeturinat dhe fiton arin e pastër.

Falja e namazit me rregull, me ndërgjegje dhe me përkushtim të plotë ia ndërron pamjen njeriut të prapambetur, sikurse ari i vlefshëm i papërpunuar, i cili kur përpunohet e ndërron pamjen e vet dhe në të mund të ngjitet çdo gjë. Pra, namazi e bën njeriun shumë të vlefshëm për bashkësinë njerëzore dhe më gjerë.

Për të qenë namazi i vlefshëm, së pari duhet pastërtia, sipas normave të parapra islame.

Për t'u hequr dyshimi se ky pastrim (abdesti) duhet të bëhet para çdo namazi, Muhammedi a.s. e shpjegoi praktikisht, sikurse na e transmeton Sulejman b. Burejdi: "Pejgamberi s.a.v.s. në ditën e çlirimit të Mekkes, me një abdest na fali më shumë namaze. Hazreti Umeri e vërejti dhe i tha: "Ke bërë sot diçka që më parë nuk e ke bërë"!

"Këtë e kam bërë me qëllim", u përgjigj Muhammedi a.s.

Pra, abdesti nuk ka nevojë të përsëritet për çdo namaz.

Nga fjalia "lani fytyrat tuaja", kuptohet, pjesa e jashtme e fytyrës. Sipas kësaj, larja e

Ebu Abdullahu (Buhariu) ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. ka shpjeguar se farzi i abdesit është (larja e gjymtyrëve të sipërpërmendura) **vetëm nga një herë. Ai, megjithatë, ka marrë abdest, duke i pastruar** (ata gjymtyrë) **nga dy dhe nga tri herë. Mbi tri herë nuk ka kaluar. Teprimin, dijetarët e kanë konsideruar si të papëlqyeshëm. Kështu e kosniderojnë edhe tejkalimin e praktikës së Pejgamberit s.a.v.s.".**[2]

باب لا تُقبَلُ صَلاةٌ بغير طُهور

١٣٥ — حدثنا إسحٰقُ بنُ إبراهيمَ الحَنظليُّ قال أخبرنا عبدُ الرَّزّاقِ قال أخبرنا مَعمَرٌ عن هَمّامِ بنِ مُنَبِّهٍ أنه سَمِعَ أبا هُرَيرةَ يَقول : قال رسولُ اللهِ ﷺ « لا تُقبَلُ صَلاةُ مَنْ أحدَثَ حتّى يَتوضّأَ » قال رجُلٌ مِن حَضرَمَوْتَ : ما الحَدَثُ يا أبا هُرَيرةَ ؟ قال : فُساءٌ أو ضُراطٌ

---

pjesëve të brendshme të gojës dhe të hundës nuk është e detyrueshme (farz). Lëkura e mjekrës i takon pjesës së jashtme të fytyrës, prandaj duhet të lahet patjetër. Nëse lëkurën e mjekrës e mbulojnë qime të gjata dhe të shpeshta, mjekra e tillë nuk bie më nën nocionin fytyrë, prandaj lëkura e saj (e mjekrës) nuk duhet të lahet domosdo. Në vend të lëkurës do të lahen qimet e mjekrës, kurse lëkura vetëm të fshihet (të përshkohet) me dorë të lagur.

Shprehja "dhe këmbët tuaja" lidhet për shprehjen "dhe duart tuaja" që do të thotë se këmbët duhet të lahen patjetër, siç lahen duart dhe fytyra. Larja e këmbëve përmendet pas dhënies mes-h të kokës (fshirjes së kokës me dorë të lagur) për të treguar në radhitjen logjike të larjes së pjesëve të trupit. Nuk do të ishte kështu, po qe se lidhëza "ve", d.m.th. "dhe" nuk do të tregonte radhitjen e tyre, por vetëm domosdoshmërinë se të gjitha pjesët e përmendura të trupit të lahen si të munden, d.m.th. pa iu përmbajtur ndonjë rendi.

Larja e këmbëve gjatë abdestit është theksuar posaçërisht në disa hadithe.

2 Gjatë marrjes abdest, Muhammedi a.s. disa pjesë të trupit i ka larë zakonisht nga tri herë. Larja e tyre nga një herë është farz, nga dy herë është vaxhib, kurse nga tri herë është sunnet. Muslimanit nuk i ka hije të bëjë atë që nuk e ka bërë Pejgamberi a.s. Sa'di gjatë marrjes abdest e tepronte nganjëherë, sepse disa gjymtyrë i lante më tepër se tri herë. Pejgamberi a.s. e qortoi, duke i thënë se të tepruarit në punë është gjë e përbuzur, prandaj edhe shpenzimi i tepërt i ujit në abdest, bile nëse merr abdest edhe në ujin që rrjedh.

Amr b. Shuajbi ka thënë: Pejgamberi a.s. ishte duke marrë abdest njëherë, e pasi i lau gjymtyrët e abdestit nga tri herë, tha: "Kush i lan më shumë ose më pak se tri herë, ai gabon dhe bën shpërdorim.

Namazi nuk pranohet pa abdest (pa qenë i pastër)

135. Na ka treguar Is-hak b. Ibrahim el-Hanzaliu, këtë e ka njoftuar Abdu-r-Rezzaku, këtë Ma'meri, këtë Hemmam b. Munebbihu, e ky e ka dëgjuar Ebu Hurejren që ka thënë se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Nuk i pranohet namazi atij që ka bërë "hadeth", derisa nuk merr abdest".

"E, çka është "hadethi" o Ebu Hurejre"?, pyeti njëri nga Hadrameuti.

"Të lëshuarit e frymës pa zë (të fendurit) **dhe me zë** (të pordhurit)", u përgjigj ai.[3]

بَابُ فَضْلِ الْوُضُوءِ ، وَالْغُرُّ الْمُحَجَّلُونَ مِنْ آثَارِ الْوُضُوءِ

١٣٦ — حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ بُكَيْرٍ قَالَ حَدَّثَنَا اللَّيْثُ عَنْ خَالِدٍ عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي هِلَالٍ عَنْ نُعَيْمٍ الْمُجْمِرِ قَالَ : رَقِيتُ مَعَ أَبِي هُرَيْرَةَ عَلَى ظَهْرِ الْمَسْجِدِ فَتَوَضَّأَ فَقَالَ : إِنِّي سَمِعْتُ النَّبِيَّ ﷺ يَقُولُ « إِنَّ أُمَّتِي يُدْعَوْنَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ غُرًّا مُحَجَّلِينَ مِنْ آثَارِ الْوُضُوءِ ، فَمَنِ اسْتَطَاعَ مِنْكُمْ أَنْ يُطِيلَ غُرَّتَهُ فَلْيَفْعَلْ »

Vlera e abdestit dhe shkëlqimi i gjymtyrëve nga gjurmët e abdestit

136. Na ka treguar Jahja b. Bukejri, këtij Lejthi, ky nga Halidi, ky nga Se'id b. Ebu Hilali, ky nga Nu'ajm el-Muxhmiri, i cili ka thënë:

Dolëm me Ebu Hurejren për të shikuar pas xhamisë. Ai aty mori abdest dhe tha:

E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

"Në Ditën e Gjykimit, pa dyshim, trashëgimtarët e mi do të thirren (në llogari) **sipas shkëlqimit të gjurmëve të abdestit të cilat kanë mbetur në gjymtyrët** (e abdestit). **Për këtë arsye, kush ka mundësi prej jush që**

---

3 Nga hadithi nxirret përfundimi:
- pastrimi sipas rregullave islame është i domosdoshëm për vlerën e çdo namazi;
- lëshurja e frymës me zë ose pa zë; me qëllim ose pa qëllim e prish abdestin;
- abdest duhet të merret edhe kur e bënë tavaf Qaben, sepse Muhammedi a.s. e ka konsideruar këtë një lloj ibadeti.

ta zgjasë edhe më shumë shkëlqimin e tij (në ballë, në duar dhe në këmbë), **le ta bëjë atë"!**[4]

بَابُ لَا يَتَوَضَّأُ مِنَ الشَّكِّ حَتَّى يَسْتَيْقِنَ

١٣٧ – حدثنا علي قال حدثنا سفيان قال حدثنا الزهري عن سعيد بن المسيب وعن عباد بن تميم عن عمه أنه شكا إلى رسول الله ﷺ الرجل الذي يخيل إليه أنه يجد الشيء في الصلاة، فقال «لا ينفتل - أو لا ينصرف - حتى يسمع صوتا أو يجد ريحا»

Abdesti nuk merret për shkak të dyshimit, por për shkak të bindjes

137. Na ka treguar Aliu, këtij i ka treguar Sufjani, këtij Zuhriu, këtij Se'id b. Musejjebi, ky nga Abbad b. Temimi, ky nga xhaxhai i vet, i cili ka treguar se u ankua te Pejgamberi s.a.v.s. një njeri i cili kishte dyshuar (në vete) se diçka ka hetuar gjatë faljes së namazit, e Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Le të mos e ndërpresë, ose le të mos largohet (nga namazi) **derisa të dëgjojë zë ose të hetojë erë".**[5]

---

4 Pastrimi sipas parimeve islame duhet të bëhet me ndërgjegjen më të lartë, në mënyrë të rrjedhshme dhe të plotë.
Nga hadithi del se:
- është mirë që gjatë larjes së ballit të përfshihet pak edhe koka (mbi ballë); gjatë larjes së duarve (dhe krahëve) të shkohet pak mbi bërryla, kurse gjatë larjes së këmbëve, ato të lahen mbi nyje, sepse gjurmët e abdestit do të bien në sy në Ditën e Gjykimit;
- rekomandohet që muslimani të jetë gjithnjë me abdest; të marrë rregulllisht, ashtu siç ka marrë Muhamnedi a.s.
- muslimani me abdest është i pastër, i regulluar, i respektuar te All-llahu xh.sh. dhe te shoqëria e ndershme;
- gjatë abdestit, këmbët duhet të lahen mirë, e jo vetëm të përshkohen me dorë të lagur;
- hadithi i përcjellur nga një As-hab i besueshëm, është i plotëfuqishëm (i vlefshëm);
- ringjallja në Ditën e Gjykimit është realitet.

5 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- e drejta themelore juridike e sheriatit është: "El-jekinu la jezulu bi-sh-shekki", d.m.th. "gjendjen e mëparshme faktike nuk mund ta anulojë dyshimi". Besimtari, i cili e di se më parë ka marrë abdest dhe që nuk ka bërë asgjë që do t'ia prishte, e mu në prag të faljes së namazit ka dyshuar në atë abdest, konsiderohet se ka abdest dhe nuk është e nevojshme

باب التخفيف في الوضوء

١٣٨ — حدثنا علي بن عبد الله قال حدثنا سفيان عن عمرو قال أخبرني كريب عن ابن عباس أن النبي ﷺ نام حتى نفخ ، ثم صلى - وربما قال اضطجع حتى نفخ ثم قام فصلى . ثم حدثنا به سفيان مرة بعد مرة عن عمرو عن كريب عن ابن عباس قال : بت عند خالتي ميمونة ليلة ، فقام النبي ﷺ من الليل ، فلما كان في بعض الليل قام النبي ﷺ فتوضأ من شن معلق وضوءا خفيفا - يخففه عمرو ويقلله - وقام يصلي ، فتوضأت نحوا مما توضأ ، ثم جئت فقمت عن يساره - وربما قال سفيان : عن شماله - فحولني فجعلني عن يمينه . ثم صلى ما شاء الله ، ثم اضطجع فنام حتى نفخ ، ثم أتاه المنادي فآذنه بالصلاة ، فقام معه إلى الصلاة فصلى ولم يتوضأ . قلنا لعمرو : إن ناسا يقولون إن رسول الله ﷺ تنام عينه ولا ينام قلبه ، قال عمرو : سمعت عبيد ابن عمير يقول : رؤيا الأنبياء وحي . ثم قرأ ﴿ إني أرى في المنام أني أذبحك ﴾ [١٠٢ الصافات]

Lehtësimi në abdest

138. Na ka treguar Ali b. Abdullahu, këtij i ka treguar Sufjani, këtij Amri, këtë e ka njoftuar Kurejbi, ky nga Ibni Abbasi, **i cili tregon se Pejgamberi s.a.v.s. është kotur derisa ka fryrë** (me gojë), **pastaj, është falur, e nganjëherë ka thënë** (transmetuesi): **"ka fjetur derisa ka fryrë** (me gojë), **e pastaj është ngritur dhe ka falë namazin".**

Këtë deklaratë na e ka treguar Ebu Sufjani herë pas here, duke transmetuar nga Amri, ky nga Kurejbi, e ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë:

"Kam bujtur një natë te halla, Mejmunja, dhe, Pejgamberi s.a.v.s., pasi fjeti një pjesë të natës, u zgjua dhe u çua. Pastaj, nga një calik të lëkurës që ishte varur, mori abdest të lehtë (me nga një të larë të

---

ta përsërisë. Këtë të drejtë juridike të sheriatit e mbështesin të gjithë juristët islamë, përveç Malikut.

- besimtari ka arsyetim ligjor ta pyesë dijetarin për çdo rregull të paqartë, kurse dijetari e ka për detyrë t'ia shpjegojë sipas aftësive të tij;
- nuk ka turp në kërkimin e diturisë;
- gjendja aktuale ndryshon vetëm në bazë të fakteve të reja dhe të argumentuara bindshëm, e jo në bazë të dyshimit;
- As-habët e kanë pyetur Muhammedin a.s. për peripetitë e tyre, duke kërkuar nga ai shpjegim të hollësishëm.

gjymtyrëve të abdestit) - **Amri e ka bërë të lehtë marrjen e abdestit dhe e ka zvogëluar larjen e shumëfishtë të gjymtyrëve** (të abdestit) - **dhe u ngrit të falë namazin. Edhe unë mora abdest siç mori ai. Pastaj, erdha dhe qëndrova nga ana e tij e majtë, por ai më nxori dhe më vendosi në anën e tij të djathtë.** (Sufjani shpeshherë e përdor termin "shimal" që ka kuptimin, ndër të tjera edhe "ana e majtë", në vend "jesar" që do të thotë "ana e majtë".). **Pastaj, fali atë që All-llahu e deshte. Pasi u fal, ra të flejë; e zuri gjumi derisa edhe filloi të fryjë** (me gojë). **Pastaj, i erdhi lajmëtari** (muezini) **dhe e njoftoi për namazin. U ngrit me të të falet. Pejgamberi s.a.v.s. u fal, por tash nuk mori abdest** (d.m.th. nuk e përsëriti abdestin).

I thamë Amrit, thotë Sufjani: Njerëzit thonë:

"Me të vërtetë, syri i Pejgamberit s.a.v.s. fle, kurse zemra e tij nuk fle".

E, Amri tha: "E kam dëgjuar Ubejd b. Umejrin duke thënë"

"Ëndërrat e Pejgamberëve janë shpallje-frymëzim (Vahj)".

Pastaj citoi ajetin e Kur'anit:

"... kam parë ëndërr se duhet të të pres...".[6]

(es-Sâffât, 102)

---

6 Nga hadithi del se:
- kotja e lehtë nuk ia ka prishur abdestin Pejgamberit a.s. Por, pas gjumit të vërtetë, Pejgamberi a.s. gjithnjë ka marrë abdest;
- dhembja dhe ndjeshmëria e Muhammedit a.s. ndaj fëmijëve;
- mendjemprehtësia e Ibni Abbasit;
- namazi nafile mund të falet me xhemat, bile edhe me një person të moshës së vogël;
- kur në namazin me xhemat është vetëm një person, ai duhet të qëndrojë në anën e djathtë të imamit;
- abdesti është i vlefshëm, nëse gjymtyrët e abdestit lahen vetëm nga një herë;
- imami duhet ta mësojë xhematin e vet edhe me fjalë (në mënyrë teorike) edhe me vepra (në mënyrë praktike);
- muezini, krahas ezanit, e lajmëron imamin e vet për fillimin e kohës së namazit;
- abdesti që merret për namazin nafile, vlen edhe për kryerjen e veprave të tjera fetare;
- kotja e lehtë nuk ia prish abdestin personit të mbështetur. Gjumi nuk e prish abdestin, por paragjykimi se gjatë gjumit të rëndë ka mundur të ndodhë diçka që e prish abdestin;
- lejohet ta kapësh fëmijën për flokë, për veshi ose për koke, me qëllim të edukimit;
- në ajetin e lartpërmendur shprehen fjalët e Ibrahimit a.s. kur deshi ta bëjë kurban në emër të All-llahut xh.sh., birin e tij, Ismalilin.

باب إسْباغِ الوُضوء . وقال ابنُ عُمَرَ : إسباغُ الوُضوء الإنقاء

١٣٩ — حدثنا عبدُ اللهِ بنُ مَسْلَمَةَ عن مالكٍ عن موسى بنِ عُقْبَةَ عن كُرَيْبٍ مولى ابنِ عبّاسٍ عن أسامةَ ابنِ زَيدٍ أنّهُ سَمِعَهُ يقول : دَفَعَ رسولُ اللهِ ﷺ مِنْ عَرَفَةَ حتى إذا كانَ بالشِّعْبِ نَزَلَ فبالَ ، ثمّ تَوَضّأَ ولم يُسْبِغِ الوُضوء . فقلتُ : الصلاةَ يا رسولَ اللهِ . فقال : الصلاةُ أمامَكَ . فَرَكِبَ . فلمّا جاء المُزْدَلِفَةَ نَزَلَ فتوَضّأَ فأسْبَغَ الوُضوء ثمّ أُقيمَتِ الصلاةُ فصلّى المَغْرِبَ ، ثمّ أناخَ كلُّ إنسانٍ بَعِيرَهُ في مَنْزِلِهِ ، ثمّ أُقيمَتِ العِشاء فصلّى ، ولم يُصَلِّ بينَهما

Marrja e abdestit në mënyrë të drejtë (të plotë)

Ibni Umeri ka thënë: **"Marrja e abdestit në mënyrë të drejtë është pastrim i plotë".**

139. Na ka treguar Abdullah b. Mesleme, duke transmetuar nga Maliku, ky nga Musa b. Ukbe, ky nga Kurejbi, rob i liruar i Ibni Abbasit, e ky nga Usame b. Zejdi, të cilin e ka dëgjuar duke thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. u kthye nga Arafati. Kur arriti te rruga (malore), **zbriti nga devja dhe bëri nevojën e vogël** (prishi abdestin), **e pastaj mori abdest, por nuk mori abdest të plotë. E pyeta: "O Resulullah, namaz do të falësh"?** Ai m'u përgjigj: **"Namazi është para teje", dhe, hipi në deve. Kur arriti në Muzdelife, zbriti nga devja dhe mori abdest. Mori abdest të plotë dhe, pasi u bë ikamet për namaz ai** (Pejgamberi s.a.v.s.) **e fali namazin e akshamit. Pastaj, çdonjëri e la devën e vet para vendqëndrimit të tyre për të zbritur. Pasi u bë ikamet për namazin e jacisë, Pejgamberi s.a.v.s. u fal. Ndërmjet këtyre dy namazeve** (të akshamit dhe të jacisë) **nuk fali asgjë.**[7]

---

7 Haxhillarët e shtynë faljen e namazit të akshamit deri në kohën e jacisë. Nëse haxhiu e fal akshamin, duke u kthyer nga Arafati, në rrugë për Muzdelife, namazi i tij nuk është i vlefshëm, prandaj duhet ta falë përsëri deri në agimin e asaj nate në Muzdelife. Ky është qëndrim i shkollës hanefite.

Imam Zuferi, Maliku dhe juristët e Kufes lejojnë faljen e namazit të akshamit para kohës së jacisë vetëm për haxhiun që ka arsye të plotë. I tilli mund të falë namazin e akshamit para fillimit të kohës së jacisë, por kjo të bëhet pas perëndimit të diellit dhe të mos ketë të skuqur në perëndim.

باب غسل الوجه باليدين من غرفة واحدة

١٤٠ – حدثنا محمد بن عبد الرحيم قال أخبرنا أبو سلمة الخزاعي منصور بن سلمة قال: أخبرنا ابن بلال – يعني سليمان – عن زيد بن أسلم عن عطاء بن يسار عن ابن عباس أنه توضأ فغسل وجهه، أخذ غرفة من ماء فمضمض بها واستنشق، ثم أخذ غرفة من ماء فجعل بها هكذا أضافها إلى يده الأخرى فغسل بهما وجهه، ثم أخذ غرفة من ماء فغسل بها يده اليمنى، ثم أخذ غرفة من ماء فغسل بها يده اليسرى، ثم مسح برأسه، ثم أخذ غرفة من ماء فرش على رجله اليمنى حتى غسلها، ثم أخذ غرفة أخرى فغسل بها رجله – يعني اليسرى – ثم قال: هكذا رأيت رسول الله ﷺ يتوضأ

Larja e fytyrës me duar me një grusht ujë

140. Na ka treguar Muhammed b. Abdu-r-Rahimi, i cili thotë se e ka njoftur Ebu Seleme el-Huza'i Mensur b. Seleme, ky nga Ibni Bilali d.m.th.

Te Mudevveniu qëndron: "Nëse haxhiu fal namazin e akshamit në udhë para se të vijë në Muzdelife, përkatësisht e fal akshamin dhe jacinë së bashku pas perëndimit të diellit në kohën e akshamit, para ardhjes në Muzdelife, është i detyruar t'i përsërisë ato namaze.

Shafiu thotë: "Nëse haxhiu e fal akshamin dhe jacinë së bashku, qoftë në Arafat, qoftë në rrugë për në Muzdelife, ashtu që akshami të falet në mbarim e sipër të kohës së tij, kurse jacinë në fillim të kohës së jacisë, ato namaze janë të vlefshme, edhe pse është shtrembëruar një procedurë e mirë dhe e zakonshme. Të këtij mendimi kanë qenë shumë As-habë, pastaj Evzaiu, Imam Jusufi dhe shumë juristë të tjerë;

- nuk është detyrë e domosdoshme të bashkohet pa ndërprerje kohore falja e namazit të akshamit dhe namazit të jacisë në Muzdelife.

Maliku, Shafiu dhe Ahmedi mendojnë se duhet të këndohet ikamet posaçërisht për aksham e posaçërisht për jaci.

Ebu Hanife, Jusufi dhe Muhammedi, duke patur parasysh hadithin e sipërpërmendur dhe një hadith tjetër të transmetuar nga Xhabiri, Abdullah b. Umeri dhe Ebu Ejub Evzaiu mendojnë se duhet thirrë një ezan dhe duhet bërë një ikamet për faljen e dy namazve të lartpërmendur.

- marrja abdest është ibadet, bile edhe nëse nuk merret për falejen e namazit;
- kthyerja e haxhillarëve nga Arafati për në Muzdelife bëhej me kafshë;
- akshami dhe jacia falen në Muzdelife, njëri pas tjetrit, në mënyrë të njëjtë si namazi i drekës dhe i iqindisë në Arafat.

Sulejmani, ky nga Zejd b. Eslemi, ky nga Ata' b. Jesari, e ky nga Ibni Abbasi, i cili mori abdest kështu:

E lau fytyrën, pastaj, mori një grusht ujë dhe e shpërlau me të gojën dhe thithi (shtiu) **në hundë, pastaj mori një grusht ujë** (me njërën dorë) **dhe e bashkoi me dorën tjetër dhe e lau** (me të dyja) **fytyrën, pastaj mori një grusht ujë dhe e lau me të dorën e djathtë, pastaj mori një grusht ujë dhe e lau me të dorën e majtë** (deri në bërryl), **pastaj me dorë të lagët e përshkoi kokën** (i dha mes-h), **pastaj, mori një grusht ujë e derdhi mbi këmbën e djathtë dhe e lau atë, pastaj, mori një grusht tjetër me ujë dhe e lau me të këmbën, d.m.th. të majtën,** e pastaj tha:

"Kështu e kam parë Pejgamberin s.a.v.s. duke marrë abdest".[8]

باب التسمية على كل حال، وعند الوقاع

١٤١ — حدثنا علي بن عبد الله قال حدثنا جرير عن منصور عن سالم بن أبي الجعد عن كريب عن ابن عباس يبلغ النبي ﷺ قال « لو أن أحدكم إذا أتى أهله قال : بسم الله، اللهم جنبنا الشيطان وجنب الشيطان ما رزقتنا، فقضي بينهما ولد لم يضره »

8 Nga hadithi nxirret përfundimi:
- abdesti është i vlefshëm nëse gjymtyrët e abdestit lahen më së paku nga një herë me nga një grusht ujë;
- goja dhe hunda duhet të shpërlahen së paku me një grusht ujë. Larja e tyre me dorë të djathtë është sunnet. Disa juristë mendojnë se goja duhet të lahet me dorë të djathtë, kurse hunda me dorë të majtë. Me dorën e djathtë duhet të bëhen punët e ndershme, kurse me të majtën punët tjera;
- fytyra duhet të lahet me dy duart me një grusht ujë;
- gjatë larjes së gjymtyrëve çift të trupit, sunnet është që së pari të lahet pjesa e djathtë, duke filuar nga ana e sipërme;
- larja e fytyrës me një grusht ujë është e vlefshme, me kusht që fytyra të lahet në tërësi;
- fshirja e kokës me dorë të lagur (dhënia mes-h), mund të bëhet me lagështinë e mbetur në pëllëmbën e dorës pa e përsëritur lagien e dorës me ujë.

Të thënët Bismi-l-Lahi... në çdo situatë, prandaj edhe para marrëdhënieve seksuale

141. Na ka thënë Ali b. Abdullahu, këtij ia ka transmetuar Xheriri ky nga Mensuri, ky nga Salim b. Ebu Xha'di, ky nga Kurjebi, ky nga Ibni Abbasi, i cili e ka dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

"Kur dikush prej jsuh i afrohet bashkëshortes (për marrëdhënie intime) **të thotë: "Bisi-l-Lahi, O Zoti im, na ruaj neve nga shejtani** (djalli) **dhe largoje shejtanin nga ajo që na ke dhënë** (dhuruar)**", kështu, pra është caktuar të fitohet fëmija** (nga çifti bashkëshortor), **e** (shejtani) **nuk do të mundet t'i bëjë dëm atij".**[9]

باب ما يقولُ عندَ الخلاء

١٤٢ ـ حدثنا آدمُ قال حدَّثنا شُعبةُ عن عبدِ العزيزِ بنِ صُهيبٍ قال : سمعتُ أنساً يقول : كانَ النبيُّ ﷺ إذا دَخلَ الخَلاءَ قال « اللّهمَّ إنّي أعوذُ بكَ منَ الخُبثِ وَالخَبائثِ »

تابَعَهُ ابنُ عَرْعَرَةَ عن شُعبةَ . وقال غُنْدَرٌ عن شُعبةَ « إذا أتى الخَلاءَ » . وقال موسى عن حَمّادٍ « إذا دخَلَ » .

وقال سعيدُ بنُ زيدٍ : حدَّثنا عبدُ العزيزِ « إذا أرادَ أن يَدخُلَ »

Çka duhet thënë para hyrjes në nevojtore

142. Na ka treguar Ademi, këtij i ka treguar Shu'beja, këtij Abdu-l-Aziz b. Suhejbi, i cili ka thënë:

---

9 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- rekomandohet të thuhet Bismi-l-Lahi..." para marrëdhënies seksuale. Imam Gazaliu në veprën e tij "Ihjâu-l-Ulûm" thekson se është mirë që pas "Bismi-l-Lahi..." të lexohet edhe surja "Ihlas", pastaj të bëhet tekbir, të lutet All-llahu xh.sh. për trashëgimtarë shembullorë, e para ejakulimit të lexohet (të citohet): "El-hamdu li-l-Lahi-l-ledhî haleka mine-l-mâi besheren..." deri në fund të ajetit, përkthimi i të cilit është: "Falënderimi i qoftë All-llahut, i cili e ka krijuar njeriun nga materia e ujit të posaçëm..."
- All-llahun xh.sh. duhet përkujtuar gjithnjë dhe gjithkund, nga Ai të kërkohet mbrojtje nga intrigat e armikut dhe të kërkohet fat e lumturi në këtë dhe në botën tjetër;
- rekomandohet të thuash "eudhu-besmelen" kur nis të marrësh abdestin. Ky është mendimi i Malikut, kurse Ebu Hanifja dhe Shafiu për këtë mendojnë se është sunnet, e Imam Ahmed e konsideron vaxhib.

E kam dëgjuar Enesin duke thënë: kur Pejgamberi s.a.v.s. do të hynte në nevojtore, thoshte:

"O Zot, prej Teje kërkoj mbrojtje nga gjithë ajo që është e dëmshme dhe e keqe"!

Ibni Ar'are pajtohet me Ademin në tekstin e hadithit, të cilin ai e transmeton nga Shu'be, kurse Gunderi, duke transmetuar nga Shu'bja, thotë (variantin): **"... kur do të vinte në nevojtore..."**

Musai, duke transmetuar nga Hammadi, ka thënë (variantin): **"... kur do të hynte..."**, kurse, Se'id b. Zejdi ka thënë se Hadithin e sipërpërmendur ia kishte transmetuar Abdu-l-Azizi me fjalët: **"... kur donte që të hyjë..."**.[10]

بَابُ وَضْعِ الْمَاءِ عِنْدَ الْخَلَاءِ

١٤٣ – حَدَّثَنَا عَبْدُ اللهِ بْنُ مُحَمَّدٍ قَالَ حَدَّثَنَا هَاشِمُ بْنُ الْقَاسِمِ قَالَ حَدَّثَنَا وَرْقَاءُ عَنْ عُبَيْدِ اللهِ بْنِ أَبِي يَزِيدَ عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ دَخَلَ الْخَلَاءَ فَوَضَعْتُ لَهُ وَضُوءًا . قَالَ : مَنْ وَضَعَ هَذَا ؟ فَأُخْبِرَ ، فَقَالَ « اللَّهُمَّ فَقِّهْهُ فِي الدِّينِ »

Të vënët ujë në nevojtore

143. Na ka treguar Abdullah b. Muhammedi, këtij i ka treguar Hashim b. Kasimi, këtij ia ka transmetuar Verkai, këtij Ubejdullah b. Ebu Jezidi, e ky nga Ibni Abbasi, cili ka treguar se Pejgamberi s.a.v.s. një herë ka hyrë në nevojtore, kurse unë i vura ujë (para derës). Pastaj, ai ka pyetur për këtë veprim. Kur ishte njoftuar, ka thënë:

"O Zot, udhëzoje në fenë e vërtetë"![11]

---

10 Nga hadithi nxirret përfundimi:
- rekomandohet të përmendet emri i All-llahut xh.sh. para se të hyhet në nevojtore dhe t'i bëhet lutje për ruajtjen nga e keqja e njerëzve shpirtligë. Të përmendurit e emrit të All-llahut xh.sh. në nevojtore Ibni Abbasi e ka konsideruar gjë të përbuzur. Disa juristë islamë mendojnë se emri i All-llahut xh.sh. nuk guxon të përmendet në nevojtore, por atë vetëm duhet mbajtur në mend dhe ashtu t'i lutesh për ruajtje nga të këqijat;
- tekstin e sipërpërmendur Pejgamberi a.s. e ka thënë vetëm të shërbejë si mësim dhe edukim për muslimanët.

11 Nga hadithi mund të përfundohet:

بابٌ لا تُستقبَلُ القِبلةُ بغائطٍ أو بَولٍ، إلاّ عندَ البِناءِ: جِدارٍ أو نحوِه

١٤٤ – حدّثنا آدمُ قال حدّثنا ابنُ أبي ذئبٍ قال حدّثنا الزُّهريُّ عن عَطاءِ بنِ يَزيدَ اللَّيثيِّ عن أبي أيُّوبَ الأنصاريِّ قال: قال رسولُ اللهِ ﷺ «إذا أتى أحدُكم الغائطَ فلا يَستقبِلِ القِبلةَ ولا يُوَلِّها ظَهرَه، شَرِّقوا أو غَرِّبوا»

Gjatë kryerjes së nevojës së madhe dhe nevojës së vogël nuk kthehet kah Kiblja, përveç kur është në ndërtesë, pas murit, e të ngjashme.

144. Na ka treguar Ademi, këtij Ibni Ebu Dhi'bi, këtij Zuhriu këtij Ata' b. Jezid el-Lejthiu, ky nga Ebu Ejjub el-Ensariu, i cili ka thënë.

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"Kur dikush nga ju e kryen nevojën e madhe, të mos kthehet me fytyrë ose me shpinë në drejtim të Kibles. Kthehuni kah lindja ose kah perëndimi"![12]

- t'i kushtosh kujdes dhe t'i bësh shërbim dijetarit është pasqyrim i edukimit islam;
- rekomandohet t'i falënderohesh mirëbërësit;
- Lutja (duaja) e Pejgamberit a.s. u realizua, sepse Ibni Abbasi më vonë u bë njëri nga dijetarët eminentë.

12 Këtë hadith e ka transmetuar Ebu Ejub Ensariu te i cili ka banuar Muhammedi a.s. kur u shpërngul nga Mekka për në Medine. Ai ka marrë pjesë në luftën e Bedrit, në mbledhjen e dytë në Akabe dhe është njëri ndër As-habët më me zë. Ka transmetuar 150 hadithe. Një hadith e ka shënuar Buhariu, kurse të tjerët i kanë shënuar muhaddithët tjerë. Ka qenë shok besnik i Aliut. Vdiq në vitin 50 hixhri, në ekspeditën ushtarake në Stamboll, në të cilën komandonte Jezid b. Muaviu. Në të vërtetë, ky u sëmua gjatë udhëtimit dhe mu para qytetit vdiq. Me porosinë e tij, u varros nën muret e Kalasë së Stambollit, prej ku As-habët zakonisht i fillonin aksionet luftarake kah qyteti i Stambollit. Ajo pjesë e qytetit edhe sot quhet me emrin e tij.

Nga hadithi nxirret përfundimi:

- gjatë kryerjes së nevojës së madhe ose të nevojës së vogël nuk duhet kthyer kah Kiblja me gjoks ose me shpinë, qoftë në ndërtesë, qoftë jashtë saj. Ky është mendim i Ebu Hanifes, Muxhahidit, Sufjanit, Thevriut, Ahmedit dhe Ebu Ejub Ensariut. Disa juristë islamë këtë qëndrim e mbajnë edhe për Bejtu-l-Mukaddesin në Jerusalem.

Maliku, Shafiu, Is-haku dhe Ibni Umeri, duke u mbështetur në një hadith tjetër thonë se kjo vlen vetëm për ata që e kryejnë nevojën jashtë ndërtesës (në fushë).

- Kiblen duhet respektuar gjithnjë. Ibni Tini mendon se në rastin përkatës nuk duhet kthyer kah dielli dhe nga hëna.

باب مَن تبرَّزَ عَلَى لَبِنَتَين

١٤٥ — حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسفَ قال أخبرنا مالكٌ عن يحيى بنِ سعيدٍ عن محمدِ بنِ يحيى بنِ حبانَ عن عمِّهِ واسعِ بنِ حبانَ عن عبدِ اللهِ بنِ عمرَ أنه كانَ يقولُ : إنَّ ناساً يقولون إذا قعدتَ على حاجتِكَ فلا تستقبِلِ القبلةَ ولا بيتَ المقدسِ . فقال عبدُ اللهِ بنُ عمرَ : لقد ارتقيتُ يوماً على ظهرِ بيتٍ لنا ، فرأيتُ رسولَ اللهِ ﷺ على لبنتينِ مستقبلاً بيتَ المقدسِ لحاجتِه . وقال : لعلَّكَ من الذينَ يصلُّونَ على أوراكِهم ، فقلتُ لا أدري واللهِ قال مالكٌ : يعني الذي يصلِّي ولا يرتفعُ عنِ الأرضِ ، يسجدُ وهوَ لا صقٌ بالأرضِ

Kryerja e nevojës duke qëndruar pupas mbi dy qerpiçë (ose të ngjashme)

145. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Maliku, këtij Jahja b. Se'idi, ky nga Muhammed b. Jahja b. Habbani, ky nga xhaxhai i vet Vasi' b. Habbani, e ky nga Abdullah b. Umeri, i cili i ka dëgjuar njerëzit duke thënë:

"Kur të ulesh të krysh nevojën, mos u kthe në drejtim të Kibles, e as në drejtim të Bejtu-l-Mukaddesit (në Jerusalem)"!

Abdullah b. Umeri tregon: **"Një ditë, kam dalur dhe kam qëndruar pas shtëpisë. E kam parë Pejgamberin s.a.v.s. duke qëndruar pupas në dy qerpiça, për të kryer nevojën, i kthyer kah Bejtu-l-Mukaddesi.**

(Ibni Umeri) i tha: **"Ndoshta ti je një nga ata që falen në kofsha** (duke qëndruar ulur)"?

"Për Zotin nuk e di", iu përgjigja.

Maliku ka thënë: **"Domethënë, ai fal** (namazin) **dhe nuk ngrihet nga toka, bën sexhde, duke qëndruar ngjitur** (me bark) **për toke"**.[13]

Qëndrimi islam është që gjatë kryerjes së nevojës, këmisha duhet të ngritet aqë sa ka nevojë; që asgjë të mos flitet, e pastaj të pastrohet me dorë të majtë; të mos kryhet nevoja prej në këmbë dhe në vendin e hapët; në ujë që nuk rrjedh, në breg të lumit, nën pemë dhe afër burimit të ujit; që mashkulli pasi të shurret, ta shkundë mirë organin gjenital derisa ta evitojë gjurmën e shurrës.

13 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
Maliku, Shafiu, Is-haku dhe disa juristë lejojnë që gjatë kryerjes së nevojës në vend të mbyllët të kthehet kah Kibla me fytyrë ose me shpinë. Disa juristë islamë mendojnë se

بَابُ خُرُوجِ النِّسَاءِ إِلَى الْبَرَازِ

١٤٦ – حدثنا يحيى بن بكير قال حدثنا الليث قال حدثني عقيل عن ابن شهاب عن عروة عن عائشة أن أزواج النبي ﷺ كن يخرجن بالليل إذا تبرزن إلى المناصع – وهو صعيد أفيح – فكان عمر يقول للنبي ﷺ : احجب نساءك . فلم يكن رسول الله ﷺ يفعل . فخرجت سودة بنت زمعة زوج النبي ﷺ ليلة من الليالي عشاء ، وكانت امرأة طويلة ، فناداها عمر : ألا قد عرفناك يا سودة . حرصا على أن ينزل الحجاب . فأنزل الله آية الحجاب

Dalja e grave në vend të hapët

146. Na ka treguar Jahja b. Bukejri, këtij i ka treguar Lejthi, këtij Ukajli, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Urve, ky nga Aishja, e cila ka thënë se bashkëshortet e Pejgamberit s.a.v.s. për nevoja fiziologjike dilnin natën deri në lagjen e quajtur Menasi' (është quajtur kështu sepse në të ka pasë nevojtore publike - të hapta), i cili është vend i hapët.

Umeri i ka thënë Pejgamberit s.a.v.s.: "(Thuaju) **le të mbulohen bashkëshortet tua**"! Pejgamberi s.a.v.s., megjithatë, nuk e bëri këtë menjherë. Sevdja, e bija e Zemates, bashkëshorte e Pejgamberit s.a.v.s. e cila ishte shtat-hedhur, kur doli një natë, Umeri i thirri: "**Me të vërtetë të kemi njohur,**

---

ky hadith është deroguar me hadithin e mëparshëm të transmetuar nga Ebu Ejub Ensariu;

- lejohet të shprehurit në mënyrë alegorike;

- As-habët kanë punuar sipas udhëzimeve të Pejgamberit a.s.

- Abdullah b. Umeri nuk e ka lejuar të kthyerit kah Kibla me fytyrë (me gjoks), ose me shpinë duke kryer qoftë nevojën e madhe, qoftë nevojën e vogël në vend të hapët dhe haptazi i ka kritikuar ata që kanë vepruar ashtu;

- Ahmed b. Hambeli mendon se më herët ka qenë e ndaluar të kthehesh kah Bejtu-l-Mukaddesi në Jerusalm, e më vonë është lejuar. Për këtë shkak edhe Ibni Umeri e ka lejuar këtë. Ibni Hambeli qëndrimin e tij e (arsyeton) me rastin të treguar sipas Mervanit, i cili ka deklaruar: Ibni Umeri njëherë e ndali deven, zbriti nga ajo, u ul pupas dhe e bëri shurrën, duke u kthyer kah Kibla. Mervani i tha atij se është e ndaluar të veprosh kështu, kurse Ibni Umeri, iu përgjigj: "Është e ndaluar të veprosh kështu në vende të hapura, në vende pa perde, e nëse në mes teje dhe Kibles ka çfarëdo perde; mur, shkëmb, mal e të ngjashme, atëherë nuk është e ndaluar".

- çdo lëvizje e Muhammedit a.s. është vështruar dhe u është përcjellur besnikërisht gjeneratave të mëvonshme.

oj Sevde"!, duke shprehur dëshirë që të vijë Shpallja për mbulesë. Dhe, me të vërtetë, All-Ilahu i Madhërueshëm shpalli ajetin për mbulesë.[14]

١٤٧ — حدثنا زكرياء قال حدثنا أبو أسامة عن هشام بن عروة عن أبيه عن عائشة عن النبي ﷺ قال « قد أذن أن تخرجن في حاجتكن » قال هشام : يعني البراز

147. Na ka treguar Zekerijai, këtij Ebu Usame, këtij Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, ky nga Aishja, e kjo nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë: **"U është lejuar në të vërtetë të dilni për të kryer nevojat tuaja fiziologjike".**

Hishami ka thënë: **"Domethënë, në nevojtore".**[15]

باب التبرز في البيوت

١٤٨ — حدثنا إبراهيم بن المنذر قال حدثنا أنس بن عياض عن عبيد الله عن محمد بن يحيى بن حبان عن واسع بن حبان عن عبد الله بن عمر قال : ارتقيت فوق ظهر بيت حفصة لبعض حاجتي ، فرأيت رسول الله ﷺ يقضي حاجته مستدبر القبلة مستقبل الشام

---

14 Për mbulesen janë shpallur ajetet 59,53,33 (sipas shkallës së tyre) të sures el-Ahzâb dhe ajeti 31 i sures en-Nûn.

15 Shkuarja e bashkëshorteve të Pejgamberit në nevojtore publike ka qenë e lejueshme derisa nuk janë ndërtuar nevojtoret pranë banesave të tyre.
Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- lejohet që më të riut t'i shprehësh publikisht propozimet dhe dëshirat me qëllime të mira;
- largpamësinë dhe qëndrimin e Umerit e pranoi Muhammedi a.s., kurse All-Ilah xh.sh. shpalli edhe rregulla të veçanta;
- këshillat me vend dhe të matura mund t'i jepen edhe nënës. Kështu, Umeri i bëri vërejtje Sevdës, bashkëshortes së Pejgamberit a.s., e cila, sikurse bashkëshortet tjera të tij, konsiderohet nënë e besimtarëve;
- grave u qe e lejueshme dalja nga shtëpia për kryerjen e nevojave familjare. Ato këtë e kanë bërë edhe pas shpalljes për mbulesën, kurse Muhammedi a.s. i urdhëronte bashkëshortet e veta t'i vizitojnë të afërmit dhe miqtë e tyre në ditët e bajrameve.

Kryerja e nevojës në shtëpi

148. Na ka treguar Ibrahim b. Mundhiri, këtij Enes b. Ijadi, këtij Ubejdullahu, ky nga Muhammed b. Jahja b. Habbani, ky nga Vâsi' b. Habbani, ky nga Abdullah b. Umeri, i cili ka thënë:

"Kam shkuar pas shtëpisë së Hafsës, për shkak të disa nevojave të mia. Aty e pashë Pejgamberin s.a.v.s. duke kryer nevojën, i kthyer me shpinë kah Qabja, kurse me fytyrë kah Sirija (Shami)".

١٤٩ – حدثنا يعقوبُ بنُ إبراهيمَ قال حدّثنا يَزيدُ بنُ هارونَ قال أخبرنا يحيى عن محمدِ بنِ يحيى بنِ حبّانَ أنّ عمّهُ واسعَ بنَ حبّانَ أخبرهُ أنّ عبدَ اللهِ بنَ عُمرَ أخبرهُ قال: لقد ظهرتُ ذاتَ يومٍ على ظهرِ بيتِنا فرأيتُ رسولَ اللهِ ﷺ قاعداً على لَبِنَتَينِ مُستقبِلَ بيتِ المقدسِ

149. Na ka treguar Ja'kub b. Ibrahimi, këtij i ka treguar Jezid b. Haruni, ky nga Muhammed b. Jahja b. Habbani, ky nga xhaxhai i vet Vâsi' b. Habbani, e ky nga Abdullah b. Umeri i cili ka thënë:

"Një ditë u ngjita pas shtëpisë sonë. E pashë Pejgamberin s.a.v.s. sesi qëndronte pupas mbi dy qerpiç, i kthyer me fytyrë kah Bejtu-l-Mukaddesi (në Jerusalem)".

باب الاستنجاء بالماء

١٥٠ – حدثنا أبو الوليدِ هشامُ بنُ عبدِ الملكِ قال حدّثنا شُعبةُ عن أبي مُعاذٍ – واسمُهُ عطاءُ بنُ أبي ميمونةَ – قال سمعتُ أنسَ بنَ مالكٍ يقول: كان النبيُّ ﷺ إذا خرجَ لحاجتِهِ أجيءُ أنا وغُلامٌ معَنا إداوةٌ من ماءٍ. يعني يستنجي به

Largimi i papastërtisë me ujë

150. Na ka treguar Ebu-l-Velid Hisham b. Abdu-l-Meliku, ky nga Shu'be, ky nga Ebu Muadhi, emri i të cilit është Ata' b. Ebu Mejmune, e ky e ka dëgjuar Enes b. Malikun duke thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. ka dalë për të kryer nevojën, kurse unë dhe një djalosh i çuam një enë të vogël (prej lëkure) **me ujë, d.m.th. të pastrohet me të".**[16]

16 Nga hadithi mund të përfundohet:

باب من حُمِلَ معَهُ الماء لِطُهورِهِ

وقال أبو الدَّرْداء : أليسَ فيكم صاحبُ النَّعْلَينِ والطَّهورِ والوِسادِ

١٥١ — حدثنا سُليمانُ بنُ حَربٍ قال حدَّثنا شُعبةُ عن أبي مُعاذٍ ـ هو عَطاء بن أبي مَيمونَةَ ـ قال سمعتُ أنَساً يَقولُ : كان رسولُ اللهِ ﷺ إذا خَرَجَ لحاجتِهِ تَبِعْتُه أنا وغُلامٌ مِنّا معَنا إداوَةٌ من ماء

Mbajtja e ujit me vete për t'u pastruar

Ebu Derdai ka pyetur: "**A nuk keni ju: kujdestar, takëm për nevojtore** (toalet) **dhe jastëk** (diç që vihet nën kokë)"?

151. Na ka treguar Sulejman b. Harbi, këtij Shu'be, ky nga Ebu Muadhi, e ky është, në të vërtetë, Ata' b. Ebu Mejmune, e ky e ka dëgjuar Enesin duke thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. ka dalur për nevojat e veta fiziologjike, kurse unë dhe një djalosh nga ne e përcollëm me një enë me ujë".

باب حَمْلِ العَنَزَةِ معَ الماء في الاستِنجاء

١٥٢ — حدثنا محمدُ بنُ بَشّارٍ قال حدَّثنا محمدُ بن جعفرٍ قال حدَّثنا شُعبةُ عن عَطاء بنِ أبي مَيمونَةَ سَمِعَ أنسَ بنَ مالكٍ يقول : كان رسولُ اللهِ ﷺ يَدخُلُ الخَلاء ، فأحمِلُ أنا وغُلامٌ إداوَةً من ماءٍ وعَنَزَةً ، يَستَنجي بالماء . تابَعَهُ النَّضْرُ وشاذانُ عن شُعبةَ . العَنَزةُ عَصاً عليه زُجٌّ

- nevoja kryhet pak më larg nga njerëzit;
- lejohet që i riu t'i ndihmojë të moshuarit gjatë marrjes së abdestit;
- ena që merret në nevojtore mund të përdoret edhe për abdest;
- uji është mjeti më efikas për pastrim. Përdorimi i mjeteve të tjera vjen në shprehje vetëm në rast të mungesës së ujit.

Pas shpalljes së ajetit: "Fîhi rixhâlun juhibbûne en jetetahherû...", d.m.th. "Në të (në xhami) janë njerëzit të cilët dëshirojnë që të pastrohen mirë..." Muhammedi a.s. i pyeti se për çfarë shkaku All-llahu xh.sh. në Kur'an i thekson ata, e ata pa farë hamendje u përgjigjen: "Sigurisht, për shkak se te ne çdo njeri pastrohet me ujë".

Mbajtja e shkopit dhe e ujit për pastrim

152. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari, këtij Muhammed b. Xha'feri, këtij Shu'beja, ky nga Ata b. Ebu Mejmune, ky e ka dëgjuar Enes b. Malikun, duke thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. hyri në nevojtore (toalet), **kurse unë dhe një djalosh ia kemi mbajtur një shkop dhe një enë të vogël** (prej lëkure) **me ujë. Ai u pastrua me ujë".**

Kështu e transmetojnë këtë hadith edhe Nadri dhe Shadhani nga Shu'be.

"Anezetun" është shkop, më i shkurtër se shigjeta, me një hekur në fund.[17]

بَابُ النَّهْيِ عَنِ الاسْتِنْجَاءِ بِالْيَمِينِ

١٥٣ - حَدَّثَنَا مُعَاذُ بْنُ فَضَالَةَ قَالَ حَدَّثَنَا هِشَامٌ هُوَ الدَّسْتَوَائِيُّ عَنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ عَنْ عَبْدِ اللهِ بْنِ أَبِي قَتَادَةَ عَنْ أَبِيهِ قَالَ : قَالَ رَسُولُ اللهِ ﷺ « إِذَا شَرِبَ أَحَدُكُمْ فَلَا يَتَنَفَّسْ فِي الْإِنَاءِ ، وَإِذَا أَتَى الْخَلَاءَ فَلَا يَمَسَّ ذَكَرَهُ بِيَمِينِهِ ، وَلَا يَتَمَسَّحْ بِيَمِينِهِ »

Pastrimi me dorë të djathtë (pas nevojës), është i papreferueshëm (ndalohet)

153. Na ka treguar Muadh b. Fadale, këtij Hishami, e ky është Destevaiu, duke transmetuar nga Jahja b. Ebu Kethiri, ky nga Abdullah b. Ebu Katade, ky nga babai i vet, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Kur dikush prej jush pi (diçka), **le të mos fryjë në enë, e kur shkon në nevojtore** (toalet), **organin e tij gjenital të mos e kap me dorën e djathtë dhe të mos e pastrojë me dorën e djathtë".**[18]

---

17 Muhamedi a.s. mbante rregullisht një shkop pak më të shkurtër se shpata, në pjesën e poshtme të të cilit kishte një hekur. Historianët mendojnë se mbreti i Etiopisë i kishte dërguar Muhammedit a.s. tri shkopinj të tillë. Njërin prej tyre e kishte ndalur për vete, njërin ia kishte dhënë Aliut, e njërin Umerit.
Muhammedi a.s. këtë shkop e mbante:
- kur të falet jasht ndërtesës, t'i shërbejë si "sutre";
- ta ketë mjet për t'u mbrojtur nga armiqtë dhe nga kafshët e rrezikshme dhe për të bërë gropa në vende të forta për të kryer nevojën dhe kështu të ruhet më mirë nga papastërtia.

18 Me këtë hadith theksohet kujdesi dhe nevoja e pastërtisë në Islam. Sjellja e mirë është

باب لا يُمسِكُ ذَكَرَهُ بِيَمِينِهِ إِذَا بَالَ

١٥٤ - حدثنا محمدُ بنُ يوسُفَ قال حدَّثنا الأوزاعيُّ عن يحيى بنِ أبي كثيرٍ عن عبدِ اللهِ بنِ أبي قتادةَ عن أبيهِ عنِ النبيِّ ﷺ قال « إذا بالَ أحدُكم فلا يأخُذَنَّ ذَكَرَهُ بيَمينِهِ ، ولا يَستَنجِي بيمينِه ، ولا يَتَنفَّسْ في الإناءِ »

Nuk mbahet me dorën e djathtë organi gjenital kur përmjerresh (kur shurresh)

154. Na ka treguar Muhammed b. Jusufi, këtij Evzaiu, këtij Jahja b. Ebu Kethiri, ky nga Abdullah b. Ebu Katade, ky nga babai i vet, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili ka thënë:

"Kur dikush prej jush përmjerret (e bën shurrën), **le të mos e mbajë me dorën e djathtë organin e tij gjenital; le të mos e pastrojë me dorën e djathtë, si dhe le të mos fryjë në enë në të cilën pi".**

باب الاستنجاء بالحجارة

١٥٥ - حدثنا أحمدُ بن محمدٍ المكيُّ قال حدَّثنا عَمرُو بنُ يحيى بنِ سَعيدِ بن عَمرٍو المكيُّ عن جدِّه عن أبي هُريرةَ قال : اتَّبعتُ النبيَّ ﷺ وخَرَجَ لحاجتِهِ ، فكانَ لا يَلتفِتُ ، فدَنَوتُ منه فقال : ائتِني أحجاراً أستَنفِضْ بها - أو نحوَه - ولا تَأتِني بعَظمٍ ولا رَوثٍ ، فأتَيتُه بأحجارٍ بطَرَفِ ثيابي فوَضَعتُها إلى جَنبِه وأعرَضتُ عنه ، فلمَّا قضى أتبَعَهُ بهنَّ

---

e dëshirueshme dhe e lavdueshme gjithnjë dhe kudo, prandaj edhe në të pirët e ujit. Nuk duhet pirë ujë me një fyt (me një hov), por me dy-tri ndërprerje dhe nuk duhet fryrë në enë. Në çastin e frymëmarrjes, për arsye higjienike, estetike, edukative, gotën me ujë duhet larguar nga afërsia e gojës. Barkun e zbrazur duhet mbushur gradualisht.

Në përmbledhjen e vet të hadithëve, Tirmidhiu thekson se Muhammedi a.s. ka thënë: "Mos pini ujë me një të gëlltitur (me një fyt), sikurse devja, por pini në dy tri hove. Në fillim bëni "Bismi-l-Lahi..." dhe në fund "el-hamdu li-Lahi".

Nga hadithi del:

- është e ndaluar që organi gjenital të mbahet, të pastrohet, e të lahet me dorë të djathtë;
- anës së djathtë duhet dhënë përparësi ndaj anës së majtë.

Pastrimi (largimi) i ndyrësisë me gurë

155. Na ka treguar Ahmed b. Muhammed el-Mekkiu, këtij Amr b. Jahja b. Se'id b. Amr el-Mekkiu, ky nga gjyshi i tij, e ky nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

"E kam përcjellur Pejgamberin s.a.v.s. kur shkoi për ta kryer nevojën. Nuk shikoi përreth (nuk i kushtoi kujdes), **prandaj iu afrova. Më tha: Shiko, gjeji disa gurë, me të cilët do ta evitoj papastërtinë, ose shih diçka të ngjashme me ta, por, mos më sjell eshtra e as bajga". Unë shkova dhe me skajin e këmishës sime i solla gurët, i lashë pranë tij dhe u largova. Kur e kreu nevojën, u pastrua me ata gurë.**[19]

باب لا يُستنجى برَوْث

١٥٦ – حدثنا أبو نُعيم قال حدثنا زُهَيرٌ عن أبي إسحقَ قال : ليسَ أبو عُبيدةَ ذكرَهُ، ولكنْ عبدُ الرَّحمٰنِ بنُ الأسودِ عن أبيهِ أنَّه سَمِعَ عبدَ اللهِ يقول : أتَى النبيُّ ﷺ الغائطَ فأمَرَني أن آتِيَهُ بثلاثةِ أحجارٍ، فوجَدتُ حجَرَينِ والتَمستُ الثالث فلم أجِدْهُ، فأخَذتُ رَوثَةً فأتَيتُه بها، فأخَذَ الحجَرَينِ وألقَى الرَّوثَةَ وقال : هٰذا رِكسٌ. وقال إبراهيم بن يوسف عن أبيه عن أبي إسحاق : حدثني عبد الرحمن

Nuk bëhet pastrimi me bajgë

156. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi, këtij Zuhejri, ky nga Ebu Is-haku, i cili ka thënë se këtë hadith nuk ia ka transmetuar Ebu Ubejde, por Abdu-r-Rahman b. Esvedi, ky nga babai i vet, i cili, me të vërtetë e ka dëgjuar Abdullahun, duke thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. shkoi për ta kryer nevojën e madhe, e mua më urdhëroi t'ia çoj tri gurë. Unë i gjeta vetëm dy, të tretin e kërkova, por nuk e gjeta, prandaj, e mora një bajgë dhe ia solla. Ai i mori gurët, kurse bajgën e gjuajti dhe tha:

---

19 Ashti dhe bajga nuk janë të përshtatshme për evitimin e papastërtisë.
Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- guri mund të shërbejë për pastrim pas kryerjes së nevojës;
- t'u ndihmosh të tjerëve në rast nevoje është nder i veçantë për çdo musliman;
- nuk është mirë të shkosh kah njeriu që është duke kryer nevojën.

"Kjo është e papastër"![20]

Ka thënë Ibrahim b. Jusufi, ky nga babai i tij, ky nga Ebu Is-haku; më ka treguar Abdu-r-Rahmani.

باب الوُضوء مرّةً مرّة

١٥٧ – حدّثنا محمدُ بنُ يوسُفَ قال حدّثنا سُفيانُ عن زيدِ بنِ أسْلَمَ عن عَطاءِ بنِ يَسارٍ عنِ ابنِ عبّاسٍ قال : تَوضّأ النبيُّ ﷺ مرّةً مرّة

Të marrët abdest duke i larë gjymtyrët nga një herë

157. Na ka treguar Muhammed b. Jusufi, këtij i ka treguar Sufjani nga Zejd b. Eslemi, ky nga Ata' b. Jesari, e ky nga Ibni Abbasi i cili ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. ka marrë abdest (duke i larë gjymtyrët e abdestit) **nga një herë".**

باب الوُضوء مرّتَين مرّتَين

١٥٨ – حدّثنا حُسَينُ بنُ عيسى قال : حدّثنا يُونُسُ بنُ محمدٍ قال حدّثنا فُلَيحُ بنُ سُليمانَ عن عبدِ اللهِ بنِ أبي بكرِ بنِ عَمرِو بنِ حَزمٍ عن عبّادِ بنِ تَميمٍ عن عبدِ اللهِ بنِ زَيدٍ أنّ النبيَّ ﷺ تَوضّأ مَرّتَين مرّتَين

Pastrimi i gjymtyrëve (të abdestit) nga dy herë

158. Na ka treguar Hysein b. Isai, këtij Junus b. Muhammedi, këtij Fulejh b. Sulejmani, ky nga Abdullah b. Ebu Bekr b. Amr b. Hazmi, ky nga Abbad b. Temimi, ky nga Abdullah b. Zejdi, i cili ka thënë:

---

20 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- bajga e kafshëve nuk mund të përdoret për pastrimin pas kryerjes së nevojës së madhe;
- disa juristë islamë mendojnë se pastrimi me më së paku tri gurë është vaxhib, kurse ata të shkollës hanefite, mendojnë se ajo është mirë. Personi mund të përdorë aq sa ka nevojë.

"**Pejgamberi s.a.v.s. ka marrë abdest** (duke i larë pjesët e trupit të caktuara për abdest) **nga dy herë**".

باب الوضوء ثلاثا ثلاثا

١٥٩ – حدثنا عبدُ العزيزِ بنُ عبدِ اللهِ الأُوَيسيُّ قال حدثني إبراهيمُ بنُ سعدٍ عن ابنِ شهابٍ أنَّ عطاءَ بنَ يزيدَ أخبرَهُ أنَّ حُمرانَ مولى عثمانَ أخبرَهُ أنَّه رأى عثمانَ بنَ عفانَ دعا بإناءٍ فأفرغَ على كفَّيهِ ثلاثَ مرارٍ فغسلَهما ثمَّ أدخلَ يمينَهُ في الإناءِ فمضمضَ واستنشقَ، ثمَّ غسلَ وجهَهُ ثلاثًا، ويديهِ إلى المرفقينِ ثلاثَ مرارٍ، [ثمَّ] مسحَ برأسِهِ ثمَّ غسلَ رجليهِ ثلاثَ مرارٍ إلى الكعبينِ، ثمَّ قال: قال رسولُ اللهِ ﷺ مَن توضَّأَ نحوَ وضوئي هذا، ثمَّ صلَّى ركعتينِ لا يحدِّثُ فيهما نفسَهُ، غُفِرَ لهُ ما تقدَّمَ مِن ذنبِهِ»

Pastrimi (i gjymtyrëve të abdestit) nga tri herë

159. Na ka treguar Abdu-l-Aziz b. Abdullah el-Uvjesiu, këtij Ibrahim b. Sa'di, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Ata' b. Jezidi, ky nga **Humrani**, rob i liruar i Uthmanit, i cili ka treguar se Uthman b. Affani ka kërkuar një enë me ujë (për të marrë abdest): **derdhi** (ka qitë) **ujë tri herë në pëllëmbat e duarve dhe i lau** (duart). **Pastaj, e futi dorën e djathtë në enë** (dhe pasi mori ujë nga ena) **e shpërlau gojën dhe hundën. Pastaj e lau fytyrën tri herë dhe duart deri në bërryla nga tri herë. I dha mes-h kryes** (e fshiu me dorë të lagët) **dhe i lau këmbët tri herë deri në nyje.** Pastaj tha:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"**Kush merr abdest ashtu sikurse unë dhe fal dy reqate namaz, duke u përqëndruar me tërë qenien në namaz, pa menduar fare për ndonjë interes personal, do t'i falen gabimet** (e vogla) **të cilat i ka bërë më parë**".[21]

---

21 Namazi ndikon pozitivisht në ngritjen e personalitetit të njeriut dhe në veprimtarinë e tij, nëse ai kryhet rregullisht dhe me sinqeritet në emër të All-llahut xh.sh.

Nga përmbajtaja e hadithit del se:

- larja e organeve të caktuara për abdest nga një herë është farz, e Muhammedi a.s. porosiste edhe nga tri herë. Përshkrimi i mësipërm vë theksin në radhitjen e larjes së organeve të abdestit. Muhammedi a.s. e ka larë gojën dhe hundën rregullisht. Në rast harrese duhet larë më vonë. Ky është mendim i Hammadit dhe Is-hakut, kurse Maliku

١٦٠ – وعن إبراهيمَ قال : قال صالحُ بنُ كَيْسانَ قال ابنُ شِهابٍ ، ولَكِنْ عُرْوَةُ يحدِّثُ عن حُمرانَ ، فلمَّا توضَّأَ عثمانُ قال : ألا أُحَدِّثُكم حَدِيثًا لولا آيةٌ ما حَدَّثْتُكموهُ ؟ سمعتُ النبيَّ ﷺ يقولُ « لا يتوضَّأُ رَجُلٌ يُحْسِنُ وُضوءَهُ ويُصَلِّي الصلاةَ إلَّا غُفِرَ لهُ ما بينَهُ وبينَ الصلاةِ حتى يُصَلِّيها »

قال عُروةُ : الآيةُ ﴿ إنَّ الَّذينَ يَكْتُمونَ ما أنْزَلْنا مِنَ البَيِّناتِ ﴾ [١٥٩ البقرة]

160. Ibrahimi transmeton se Salih b. Kejsani dhe Ibni Shihabi, kanë thënë, kurse Urve transmeton nga Humrani: Pasi Uthmani mori abdest tha: **"Dëgjoni! do t'ju tregoj një hadith - e, po të mos kishte ndonjë ajet, unë nuk do t'ua tregoja juve** (hadithin)". - E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s., duke thënë:

"Çdonjërit (musliman)**, që në mënyrë të rregullt merr abdes' dhe fal namazin, do t'i falen gabimet** (gjynahet) **gjatë kohës në mes abdestit dhe namazit përkatës, derisa të falë atë namaz".**

---

dhe Shafiu mendojnë se abdesti është i vlefshëm edhe pa i larë ato më vonë. Këtë mendim e mbështet edhe Hazmi. Abdesti dhe namazi është i vlefshëm edhe pa larjen e gojës dhe hundës, i lëshove ato me qëllim ose pa qëllim. Sipas mendimit të Ebu Hanifes, Shafiut dhe shumë dijetarëve të tjerë islamë, larjen e gojës dhe të hundës duhet plotësuar domosdo pastaj, vetëm nëse ato harrohen të lahen gjatë larjes që bëhet për shkak të polucoinit (gjatë guslit).

Ebu Davudi dhe Tirmidhiu kanë shënuar hadithe në të cilët urdhërohet larja e domosdoshme e gojës;

- larja e fytyrës një herë është detyrë e dorës së parë (farz), kurse larja e saj tri herë është praktikë e Muhammedit a.s.;

- sipas mendimit të katër imamëve dhe të numrit më të madh të dijetarëve duhet larë duart domosdo deri në bërryla. Imam Zuferi, Ebu Bekr b. Davudi mendojnë se ajo larje duhet të bëhet deri në bërryla. Dallimi i tyre qëndron vetëm në të kuptuarit dhe shpjegimin e parafjalës "ilâ" në ajetin "... ile-l-merâfiki...", që disa e shpjegojnë "deri në" e të tjerët "deri mbi";

- në rastin konkret Uthmani e ka fshirë me dorë të lagur tërë kokën (i ka dhënë mes-h), duke mos thënë se është farz ose sunnet. Ahmedi dhe Maliku mendojnë se duhet të fshihet me dorë të lagur tërë koka; Ebu Hanife thotë se duhet dhënë mes-h një të katërtës së kokës, kurse Shafiu, bile disa qime flokësh. Fshirja e kokës me dorë të lagur bëhet me një veprim (me një hov), kurse disa të tjerë thonë se duhet bërë në dy-tri veprime.

Radhitja sipas shënimeve të lartpërmendura, përkatësisht t'i përmbahesh asaj radhitje, sipas Malikut është farz, sipas Shafiut, vaxhib, e sipas Ebu Hanifes, sunnet.

Urve thotë: Ajeti që i dedikohet kësaj çështjeje është:

"Me të vërtetë, ata që fshehin argumentet tona të qarta, që i kemi shpallur...".[22]

(el-Bekare, 159)

بَابُ الاسْتِنْثَارِ فِي الْوُضُوءِ

ذَكَرَهُ عُثْمَانُ وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ زَيْدٍ وَابْنُ عَبَّاسٍ - رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ - عَنِ النَّبِيِّ ﷺ

١٦١ - حَدَّثَنَا عَبْدَانُ قَالَ أَخْبَرَنَا عَبْدُ اللَّهِ قَالَ أَخْبَرَنَا يُونُسُ عَنِ الزُّهْرِيِّ قَالَ أَخْبَرَنِي أَبُو إِدْرِيسَ أَنَّهُ سَمِعَ أَبَا هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ « مَنْ تَوَضَّأَ فَلْيَسْتَنْثِرْ ، وَمَنِ اسْتَجْمَرَ فَلْيُوتِرْ »

Thithja dhe nxjerrja e ujit nga hunda gjatë abdestit

Kanë treguar Uthmani, Abdullah b. Zejdi dhe Ibni Abbasi, duke transmetuar nga Pejgamberi s.a.v.s..

161. Na ka treguar Abdani, këtë e kishte njoftuar Abdullahu, këtë Junusi, ky nga Zuhriu, ky nga Ebu Idrisi, i cili e ka dëgjuar Ebu Hurejren kur transmetonte nga Pejgamberi s.a.v.s.:

"Kur ndonjë nga ju merr abdest, le të nxjerrë ujin nga hunda, e kush e largon ndyrësinë (pas kryerjes së nevojës së madhe) **me gurë, le t'i përdorë ata në numrin tek"!**[23]

---

22 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- është detyrim (farz) që dijetari, dijeninë që e ka t'ua përcjellë të tjerëve;
- All-llahu xh.sh. e pranon namazin dhe veprat tjera të mira, nëse janë bërë sinqerisht në emër të Tij. Muslimi në përmbledhjen e tij të hadhitheve thekson: "Kur muslimani fal namazin farz me përkushtim të plotë ndaj All-llahut xh.sh. e më parë të ketë marrë abdest në mënyrë të rregullt, do t'i falen gabimet e vogla të bëra më parë.
Në disa hadithe përmendet falja e gabimeve të besimtarit në mes dy namazeve, bile edhe në mes dy namazeve farz të falur në mënyrë të rregullt.

23 Nga hadithi mund të kuptohet:
- ujin e thithur në hundë duhet nxjerrur përsëri. Kështu ka vepruar gjithnjë Muhammedi a.s. Nxjerrja bëhet me dorë të majtë. Pa pjesmarrjen e dorës, këtë veprim Maliku e quan të përbuzur;
- thithjen e ujit në hundë dhe nxjerrjen prej saj duhet bërë me numër tek;
- larja e gojës është sunnet. Ky është qëndrim i shumicës së dijetarëve. Disa dijetarë si: Ahmedi, Is-haku, Ebu Ubejdi, Eu Thevriu dhe Ibni Mundhiri e konsiderojnë vaxhib;

باب الاستجمار وِتْراً

١٦٢ — حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرَنا مالكٌ عن أبي الزِّنادِ عن الأعْرَجِ عن أبي هُريرةَ أن رسولَ اللهِ ﷺ قال « إذا توَضَّأ أحدُكُمْ فليَجعلْ في أنفِهِ ثمَّ لِيَنْثُرْ . ومَنِ استَجْمَرَ فليُوتِرْ . وإذا استَيقَظَ أحدُكُم مِنْ نَومِهِ فليَغْسِلْ يدَهُ قبلَ أن يُدْخِلَها في وَضوئِهِ ، فإنَّ أحدَكُم لا يَدرِي أينَ باتَتْ يدُهُ »

Largimi i papastërtisë me gurë, me numër tek

162. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij i ka treguar Maliku, ky nga Ebu-z-Zinadi, e ky nga A'rexhi, ky nga Ebu Hurejre se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Kur ndokush nga ju merr abdest, le të thithë ujin në hundë dhe pastaj le ta nxjerrë jashtë, e kush e largon papastërtinë (pas kryerjes së nevojës) **me guraleca, le të përdorë numrin tek. Nëse ndonjë nga ju zgjohet pas fjetjes, le të pastrojë dorën para se ta fusë në ujin e abdestit, sepse, me të vërtetë, asnjë nga ju nuk di se ku e ka pasë dorën në gjumë".**[24]

باب غَسلِ الرِّجْلَينِ ، ولا يَمسَحُ على القَدَمَينِ

١٦٣ — حدثنا موسى قال حدَّثنا أبو عَوانةَ عن أبي بِشْرٍ عن يوسُفَ بنِ ماهكَ عن عبدِ اللهِ بنِ عمرٍو قال : تَخلَّفَ النبيُّ ﷺ عنّا في سَفْرةٍ سافَرْناها ، فأدرَكَنا وقد أرْهَقْنا العصرَ ، فجعَلْنا نَتَوضَّأُ ونَمسَحُ على أرجُلِنا . فنادَى بأعلى صَوتِهِ « وَيلٌ للأعْقابِ منَ النارِ » مرَّتَينِ أو ثَلاثاً

- pastrimi mund të bëhet edhe me guraleca. Ebu Hanife tërheq vërejtjen në domosdonë e pastrimit ideal, e jo në numrin e përdorur të tyre. Prandaj, nëse arrihet pastrimi vetëm me një gur, të tjerët nuk ka nevojë të përdoren.

24 Njeriu nuk e di se ku i ka shkuar dora në gjumë. Për këtë arsye feja dhe higjiena kërkojnë që pas fjetjes të lahen duart dhe fytyra;
- larjen e duarve para marrjes abdest Muhammedi a.s. e ka bërë rregullisht. E kemi për detyrë që edhe ne të veprojmë kështu;
- me dorë të ndyrë nuk duhet të preken gjërat e pastërta;
- pjesa dërrmuese e juristëve islamë mendojnë se larja e duarve pas fjetjes është urdhëruar për shkak të paragjykimit se gjatë fjetjes duart mund të kenë prekur papastërtinë në organet e kryerjes së nevojës.

Larja e këmbëve, e jo vetëm dhënia mes-h shputave

163. Na ka treguar Musai, këtij Ebu Avane, ky nga Ebu Bishri, ky nga Jusuf b. Maliku, ky nga Abdullah b. Amri, i cili tregon se:

"Pejgamberi s.a.v.s. me rastin e një udhëtimi që patëm, mbeti prapa nesh. Na mbërrini para se të mbarojë koha e namazit të iqindisë. Ne morëm abdest, kurse këmbëve u dhamë mes-h (i fshimë me dorë të lagët), **prandaj, me një zë të lartë ai** (Pejgamberi s.a.v.s.) **bërtiti dy a tri herë:**

"Mjerë këmbët (që do të digjen) **nga zjarri i Xhehennemit".**![25]

باب — المَضْمَضَةِ فى الوُضوءِ . قاله ابنُ عبّاسٍ وعبدُ اللهِ بنُ زيدٍ — رضىَ اللهُ عنهم — عن النبىِّ ﷺ

١٦٤ — حدثنا أبو اليَمانِ قال أخبرَنا شُعيبٌ عنِ الزُّهْرىِّ قال أخبرَنى عَطاءُ بنُ يَزيدَ عن حُمرانَ مَولىٰ عُثمانَ بنِ عَفّانَ أنه رَأى عثمانَ دَعا بوَضوءٍ فأفرغَ على يَدَيهِ مِنْ إنائهِ فغَسَلَهما ثَلاثَ مَرّاتٍ ، ثمَّ أدخلَ يَمينَهُ فى الوَضوءِ ، ثمَّ تَمَضْمَضَ واسْتَنْشَقَ واسْتَنْثَرَ ، ثمَّ غَسَلَ وَجْهَهُ ثَلاثاً ، وَيَدَيهِ إلى المِرْفَقَينِ ثلاثاً ، ثمَّ مَسَحَ بِرَأْسِهِ ، ثمَّ غَسَلَ كلَّ رِجْلٍ ثَلاثاً ، ثم قال : رأيتُ النبىَّ ﷺ يتوَضَّأُ نَحوَ وُضوئى هٰذا وقال « مَن تَوَضَّأَ نحوَ وُضوئى هٰذا ، ثمَّ صلَّى رَكْعَتَينِ لا يُحَدِّثُ فيهما نفسَهُ ، غَفَرَ اللهُ له ما تَقَدَّمَ مِن ذَنْبِهِ »

Larja (shpërlarja) e gojës gjatë abdestit

Këtë e ka transmetuar Ibni Abbasi dhe Abdullah b. Zejdi r.a. nga Pejgamberi s.a.v.s.

164. Na ka treguar Ebu-l-Jemani, këtij i ka treguar Shu'ajbi, ky nga Zuhriu, ky nga Ata' b. Jezidi, ky nga Humrani, rob i liruar i Uthman b. Affanit, i cili e ka parë Uthmanin duke marrë abdest dhe tregon: (Uthmani) **kërkoi një enë me ujë: derdhi ujë nga ena në duar dhe i pastroi tri herë. Pastaj, e futi dorën e djathtë në enë** (mori një grusht ujë) **dhe e lau gojën, thithi ujë në hundë dhe e nxorri jashtë, pastaj e lau fytyrën tri herë. I lau edhe duart deri në bërryla tri herë. Pastaj i dha mes-h** (e fshiu me dorë të lagët) **kokës dhe, në fund, i lau këmbët nga tri herë dhe tha:**

---

25 Këmbët, sidomos shputat e tyre, mund të përlyhen më shumë, prandaj duhet t'u kushtohet kujdes i veçantë gjatë abdestit. për të qenë abdesti i vlefshëm, shputat duhet të lahen mirë dhe papastërtinë e mundshme duhet larguar nga ato.

"Kështu e kamë parë Pejgamberin s.a.v.s. duke marrë abdest dhe e kam dëgjuar atë duke thënë:

"Kush merr abdest kështu siç marr unë dhe fal dy reqate namaz, duke përqëndruar vemendjen vetëm në namaz, pa menduar tjetër gjë, All-llahu do t'ia falë gabimet (e vogla) **që i ka bërë më parë".**

باب غَسلِ الأعقابِ . وكان ابنُ سيرينَ يَغسِلُ مَوضِعَ الخاتَمِ إذا تَوضَّأَ

١٦٥ – حدثنا آدمُ بنُ أبي إياسٍ قال حدَّثنا شُعبةُ قال حدَّثنا محمدُ بنُ زِيادٍ قال سَمعتُ أبا هُريرةَ – وكانَ يَمُرُّ بنا والناسُ يَتوَضَّؤونَ مِنَ المِطْهَرةِ – قال : أسْبِغوا الوُضوءَ ، فانَّ أبا القاسمِ قال « وَيلٌ للأعقابِ مِنَ النّارِ »

Larja e shputave (thembrave)

Ibni Sirini kur merrte abdest, i lante edhe vendet nën gishtërinj.

165. Na ka treguar Adem b. Ebu Ijasi, këtë e ka njoftuar Shu'be ky nga Muhammed. b. Zijadi, i cili ka thënë:

E kam dëgjuar Ebu Hurejren kur pat kaluar pranë nesh, e ne duke marrë abdest nga një enë, kur tha:

"Merrni abdest ashtu si duhet!", sepse Ebu-l-Kasimi (Pejgamberi s.a.v.s.) ka thënë:

"Mjerë shputat (që do të digjen) **nga zjarri i Xhehennemit"!**

باب غَسلِ الرِّجلَينِ في النَّعلَينِ ، ولا يَمسَحُ على النَّعلَينِ

١٦٦ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرَنا مالكٌ عن سَعيدٍ المَقْبُرِيِّ عن عُبيدِ بنِ جُرَيجٍ أنه قال لعبدِ اللهِ بنِ عُمرَ : يا أبا عبدِ الرَّحمٰنِ ، رَأيتُكَ تَصنَعُ أربَعاً لم أرَ أحَداً من أصحابِكَ يَصنَعُها . قال : وما هيَ يا ابنَ جُرَيجٍ ؟ قال : رأيتُكَ لا تَمَسُّ مِنَ الأركانِ إلاَّ اليَمانِيَينِ ، ورأيتُكَ تَلبَسُ النِّعالَ السِّبتيَّةَ ، ورأيتُكَ تَصبُغُ بالصُّفرةِ ، ورأيتُكَ إذا كنتَ بمكةَ أهَلَّ الناسُ إذا رأَوُا الهلالَ ولم تُهِلَّ أنت حتى كانَ يومُ التَّرْوِيةِ . قال عبدُ اللهِ : أمّا الأركانُ فاني لم أرَ رسولَ اللهِ ﷺ يَمَسُّ إلاَّ اليمانِيَينِ . وأمّا النِّعالُ السِّبتيَّةُ فاني رأيتُ رسولَ اللهِ ﷺ يَلبَسُ النعلَ التي ليسَ فيها شَعَرٌ ويَتوضَّأُ فيها ، فأنا أُحِبُّ أن أَلبَسَها . وأمّا الصُّفرةُ فاني رأيتُ رسولَ اللهِ ﷺ يَصبُغُ بها ، فأنا أُحِبُّ أن أصبُغَ بها . وأمّا الإهلالُ فاني لم أرَ رسولَ اللهِ ﷺ يُهِلُّ حتى تَنبَعِثَ به راحِلتُه

Këmbët duhet larë, e jo t'u jepet mes-h (të fshihen me dorë të lagët) mbi mbathje

166. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtë e ka lajmëruar Maliku ky nga Se'id el-Makburiu, ky nga Ubejd b. Xhurejxhi, i cili i ka thënë Abdullah b. Umerit:

"O Ebu Abdu-r-Rahman, të kam parë se ke bërë katër punë, që nuk kam parë t'i bëjë asnjë nga shokët e tu".

"Cilat janë ato punë, o Ibni Xhurejxh", pyeti ai.

"Të kam parë se po i prek vetëm dy ruknet jemenase (skajet e Qabes me Gurin e Zi)**, të kam parë se mban mbathje të lëkurës së regjur** (pa qime - meste)**, të kam parë se e përdor ngjyrën e verdhë, e pastaj, kur ke qenë në Mekke, të kam parë se nuk e ke lexuar telbijen, ndërsa njerëzit, e lexonin kur e shihnin hënën e re, tha** (Ibni Xhurejxhi)**".**

Abdullahu (ose Ebu Abdu-r-Rahmani) iu përgjigj:

"Sa i përket skajeve, unë nuk e kam parë Pejgamberin s.a.v.s. të prekë ndonjë skaj (të Qabes)**, përveç këtyre dy skajeve të Jemenit; sa i përket mbathjes nga lëkura e regjur, e kam parë Pejgamberin s.a.v.s. i cili ka veshur mbathje në të cilat nuk kishte qime, e këmbët përsëri i lante, prandaj edhe unë, shikoni, kam dëshirë të vesh asi lloj mbathjeje. Sa i përket ngjyrës së verdhë, edhe për këtë e kam parë Pejgamberin s.a.v.s. se e ka përdorur, prandaj edhe unë dëshiroj ta përdor. Ndërkaq, kur është fjala te telbija, këtë nuk e kam vënë re as te Pejgamberi s.a.v.s., derisa nuk e përgatiste karavanin".**[26]

---

26 "Dy ruknet jemenase të Qabes": mendohet në skajet e Qabes kah ana e Jemenit dhe të Irakut në mes të të cilave është vendosur Guri i Zi (Haxheru-l-Esvedi).
Nga hadithi nxirret përfundimi:
- gjatë kryerjes së haxhxhit, haxhillarët nga respekti i lëmojnë skajet e murit të Qabes kah ana e Jemenit që janë ngritur në themelet e murit të Ibrahimit a.s. dhe në të cilat është vendosur Guri i Zi. Ky meteor, sipas rregullit duhet të lëmohet (të preket), e nëse është e pamundshme për shkak të kallaballëkut, atëherë duart ngrihen në drejtim të tij dhe pastaj puthen. T'i prekësh edhe muret e tjera të Qabes, sikurse kanë vepruar, nuk është detyrë e caktuar sipas rregullit;
- lejohet veshja e këpucëve të lëkurës së fortë e të regjur. Muhammedi a.s. e ka ndaluar ecjen me mbathje të fortë nëpër varreza. Në varreza duhet të mbretërojë qetësi apsolute.

باب التَّيَمُّنِ فى الوُضوء والغُسْلِ

١٦٧ — حدثنا مُسَدَّدٌ قال حدثنا إسماعيلُ قال حدثنا خالدٌ عن حَفْصَةَ بنتِ سِيرِينَ عن أُمِّ عَطِيَّةَ قالت : قال النبيُّ ﷺ فى غَسْلِ ابنَتِهِ « ابْدَأْنَ بِمَيَامِنِها ومَواضِعِ الوُضوءِ مِنها »

Të filluarit nga ana e djathtë gjatë marrjes së abdestit dhe gjatë larjes së përgjithshme (guslit)

167. Na ka treguar Museddedi, këtij ia ka transmetuar Ismaili, ky e ka dëgjuar nga Halidi, ky nga Hafsa b. Sirini, kjo nga Ummu Atijja, e kjo nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili me rastin e larjes së vajzës së tij, tha:

"Filloni nga ana e djathtë e organave të saj, ashtu siç lahet edhe gjatë abdestit"![27]

١٦٨ — حدثنا حَفْصُ بنُ عُمَرَ قال حدثنا شُعبةُ قال أخبرنى أشعثُ بنُ سُلَيمٍ قال سمعتُ أبى عن مَسروقٍ عن عائشةَ قالت : كان النبيُّ ﷺ يُعجِبُهُ التَّيَمُّنُ فى تَنَعُّلِهِ وتَرَجُّلِهِ وطُهورِهِ فى شأنِهِ كُلِّهِ

168. Na ka treguar Hafs b. Umeri, këtij Shu'be, këtij Esh'ath b. Sulejmani, ky nga babai i vet, ky nga Mes'udi, ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. i jepte përparësi anës së djathtë, për mbathjen e këpucëve, për krehje dhe për pastrim të përgjithshëm".[28]

Varrezat janë vendpushim i krijesave të All-llahut xh.sh. dhe terreni i paprekshëm të cilin duhet respektuar deri në fund, të rregullohet dhe të mirëmbahet.
- lejohet përdorimi i ngjyrës së verdhë. Muhammedi a.s. i ka lyer dhe i ka ngjyrosur teshat e veta me safran dhe me vers. E ka ngjyrosur edhe mjekrën;
- disa juristë mendojnë se telbijen është më mirë ta fillosh ta shprehësh në ditët e para të muajit dhu-l-hixhxhe, ndërsa Ebu Hanifja duke iu përmbajtur thënies së Ibni Abbasit, mendon se atë duhet thënë pas mbarimit të reqatit të dytë të namazit nafile duke qenë ulur para se haxhiu të hypë në kafshë. Shafiu, Maliku dhe Ahmedi porosisin që telbia duhet shprehur në mikat kur haxhiu hyp në kafshë dhe dëshiron të niset për në Mekke.

27 Ummu Gulthumen dhe Zejneben, vajza të Pejgamberit a.s. i ka larë Esmaja, vajzë e Umejes, në praninë e Ummu Atijes, e cila e transmeton hadithin e lartpërmendur.

28 Për kryerjen e shumë punëve përdoren makinat përkatëse: për punët më të ndërlikuara, makinat më të mira dhe më precize, kurse për ato më të thjeshtat, mund të përdoren makinat më të thjeshta. Një ndarje të këtillë të punëve duhet zbatuar edhe në jetën tonë

بابُ التماسِ الوَضوءِ إذا حانَتِ الصلاةُ

وقالت عائشةُ : حَضَرَتِ الصُّبحُ فالتُمِسَ الماءُ فلم يُوجَدْ ، فنزلَ التَّيمُّم

١٦٩ — حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال : أخبرنا مالكٌ عن إسحاقَ بنِ عبدِ اللهِ بنِ أبي طلحةَ عن أنسِ ابنِ مالكٍ أنه قال : رأيتُ رسولَ اللهِ ﷺ وحانَتْ صلاةُ العصرِ ، فالتمسَ الناسُ الوَضوءَ فلم يجدوه ، فأُتِيَ رسولُ اللهِ ﷺ بوَضوءٍ فوَضعَ رسولُ اللهِ ﷺ في ذلك الإناءِ يدَهُ وأمرَ الناسَ أن يتوَضَّؤا منه . قال : فرأيتُ الماءَ ينبَعُ من تحتِ أصابعِه ، حتى توضَّؤا من عندِ آخرِهم

Gjurmimi për ujë kur fillon koha e namazit

Aishja ka thënë: **"Filloi koha e namazit të sabahut; shkuan të kërkojnë ujë, por nuk gjetën. Atëherë janë shpallur rregullat e tejemmumit".**

169. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Maliku, ky nga Is-hak b. Abdullah b. Ebu Talhai, ky nga Enes b. Maliku, i cili ka thënë:

"E kam parë Pejgamberin s.a.v.s. kur ka filluar koha e namazit të iqindisë. Njerëzit kërkonin ujë për abdest, por nuk gjetën. Atëherë, Pejgamberit s.a.v.s. i është sjellur pak ujë. Pejgamberi s.a.v.s. e fut dorën në atë enë (me pak ujë) **dhe i urdhëroi njerëzit që prej saj të marrin abdest. E kam parë - vazhdon** (Enes b. Maliku) **ujin sesi buronte nën**

---

të përditshme.

Punët e ndershme dhe precize duhet të bëhen me dorë të djathtë, kurse punët e shëmtuara dhe të thjeshta me dorë të majtë. Anës së djathtë dhe organeve të djathta të trupit duhet t'u jipet përparësi. Sipas Islamit gjatë veshjes së këpucëve, së pari vishet këmba e djathtë, pastaj e majta; gjatë veshjes së teshave, së pari vishet e djathta pastaj e majta; prerja e thonjve, mustaqeve, rroja, qethja, krehja etj. duhet të fillojnë nga e djathta. Gjatë larjes dhe marrjes abdest duhet filluar nga e djathta. Në xhami hyret me këmbën e djathtë dhe dilet me këmbën e majtë. Selami në namaz, së pari jipet në të djathtë e pastaj në të majtë; gjatë përshëndetjes jipet dora e djathtë.

Punët e fëlliqura bëhen me dorë të majtë. Sipas parimeve islame: pas nevojës, pastrohet me dorë të majtë; zhveshja, zbathja fillohen nga ana e majtë. Në nevojtore hyret me këmbë të majtë e dilet me të djathtën.

gishtërinjtë e tij gjatë kohës, derisa mori abdest edhe më i fundit nga ata".[29]

بَابُ الْمَاءِ الَّذِي يُغْسَلُ بِهِ شَعَرُ الْإِنْسَانِ. وَكَانَ عَطَاءٌ لَا يَرَى بِهِ بَأْسًا أَنْ يُتَّخَذَ مِنْهَا الْخُيُوطُ وَالْحِبَالُ. وَسُؤْرِ الْكِلَابِ وَمَمَرِّهَا فِي الْمَسْجِدِ. وَقَالَ الزُّهْرِيُّ: إِذَا وَلَغَ فِي إِنَاءٍ لَيْسَ لَهُ وَضُوءٌ غَيْرُهُ يَتَوَضَّأُ بِهِ. وَقَالَ سُفْيَانُ: هَذَا الْفِقْهُ بِعَيْنِهِ، يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى ﴿فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا﴾ وَهَذَا مَاءٌ. وَفِي النَّفْسِ مِنْهُ شَيْءٌ، يَتَوَضَّأُ بِهِ وَيَتَيَمَّمُ

Uji me të cilin pastrohen flokët e njeriut

Atai nuk e ka konsideruar gjë të keqe (të ndaluar) **që flokët të përdoren** (të shfrytëzohen) **në vend të perit dhe për thurjen e litarit.** (Nuk e ka konsideruar të keqe) **edhe ujin e mbetur të llapëruar nga qeni dhe të kaluarit e qenit pranë xhamisë.**

Zuhriu ka thënë: **"Kur qeni e llapit ujin në enë, e njeriu nuk ka ujë tjetër, përveç tij, le të marrë abdest me të".**

Sufjani: **"Ajo është zgjedhje e drejtë, që e shpreh All-llahu i Madhërueshëm** (në Kur'an):

"... e nëse nuk gjeni kurrfarë uji, atëherë, bëni tejemmum (gjeni dhé të pastër)...".

(el-Mâide, 6)

E ai (uji i llapuar) **përsëri është ujë, por, me të vërtetë, ka diçka të pasigurtë. Prandaj me të mund të merret abdest, por edhe tejemmum".**

١٧٠ – حَدَّثَنَا مَالِكُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ قَالَ حَدَّثَنَا إِسْرَائِيلُ عَنْ عَاصِمٍ عَنِ ابْنِ سِيرِينَ قَالَ: قُلْتُ لِعَبِيدَةَ عِنْدَنَا مِنْ شَعَرِ النَّبِيِّ ﷺ أَصَبْنَاهُ مِنْ قِبَلِ أَنَسٍ – أَوْ مِنْ قِبَلِ أَهْلِ أَنَسٍ – فَقَالَ: لَأَنْ تَكُونَ عِنْدِي شَعَرَةٌ مِنْهُ أَحَبُّ إِلَيَّ مِنَ الدُّنْيَا وَمَا فِيهَا

29 Ky hadith është përcjellur në disa variante: sipas disave, Muhammedit a.s. i kanë sjellur një kusi, kurse sipas disave i kanë sjellur një enë të vogël me ujë, nga e cila ka qenë e mundur të merret vetëm një abdest.

170. Na ka treguar Malik b. Ismaili, këtij i ka treguar Israili, këtij Asimi, e ky nga Ibni Sirini, i cili ka thënë:

"I kam treguar Abides. Ne kemi disa qime të Pejgamberit s.a.v.s. të cilat i kemi marrë nga Enesi, ose nga familja e Enesit".

Ai (Abidja) tha: **"Po të kisha një qime të tij, ajo do të më ishte më e dashur se gjithë bota dhe gjithçka që është në të"!**[30]

١٧١ – حدثنا محمدُ بنُ عبدِ الرحيمِ قال أخبرنا سعيدُ بنُ سُليمانَ قال حدثنا عَبّادٌ عن ابنِ عَونٍ عن ابنِ سِيرِينَ عن أنسٍ أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ لمّا حَلَقَ رأسَهُ كان أبو طَلحةَ أولَ مَن أخَذَ مِن شَعرِهِ

171. Na ka treguar Muhammed b. Abdu-r-Rahimi, këtij Se'id b. Sulejmani, këtij Abbadi, këtij Ibni Avni, ky nga Ibni Sirini, e ky nga Enesi, i cili tregon se i pari që do të merrte ndonjë qime nga flokët e Pejgamberit s.a.v.s. kur ai do të rruhej, do të ishte Ebu Talhai.[31]

١٧٢ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ عن مالكٍ عن أبي الزِّنادِ عن الأعرَجِ عن أبي هُريرةَ قال: إنَّ رسولَ اللهِ ﷺ قال «إذا شَرِبَ الكلبُ في إناءِ أحَدِكم فليَغسِلْهُ سَبعًا»

---

30 Ky hadith e hedh poshtë mendimin e dijetarëve të shkollës shafiite se flokët e ndara nga trupi janë të papastra dhe uji në të cilin bien flokët e qethura bëhet i fëlliqur dhe se me të nuk mund të merret abdest.
Buhariu, Ata b. Rebahu, Ebu Hanife dhe shumë dijetarë të tjerë për këtë çështje kanë mendim të kundërt. Këta lejojnë që me flokët e qethura të punohet peri, litari dhe gjëra të ngjashme, bile nga këta lejohet edhe përdorimi i qimeve të kafshëve të ngordhura, pastaj eshtrat e tyre në të cilët nuk ka gjak, siç janë: dhëmbët, brinjët, thundrat, e të ngjashme me këto.

31 Pejgamberin a.s. e rruante gjithnjë Ma'mer b. Abdullahu, përveç në Hudejbi.
Nga hadithi del:
- rruajtja e kokës është sunnet;
- flokët e qethura janë materie e pastër;
- ngjyrosja e flokëve me kënë është e lejueshme.

172. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, duke transmetuar nga Maliku, ky nga Zinadi, ky nga A'rexhi, e ky nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"Nëse qeni ka pi (ujë etj.) **nga ena e ndonjërit prej jush, le të pastrohet ajo shtatë herë".**[32]

١٧٣ – حدثنا إسحاقُ أخبرنا عبدُ الصمدِ حدثنا عبدُ الرحمنِ بنُ عبدِ اللهِ بنِ دينارٍ سمعتُ أبي عن أبي صالحٍ عن أبي هُريرةَ عنِ النبيِّ ﷺ « أن رجُلا رأى كلباً يأكلُ الثرى منَ العطشِ ، فأخذَ الرجُلُ خُفَّهُ فجعلَ يغرِفُ له بهِ حتى أرْواهُ ، فشكرَ اللهُ لهُ ، فأدخلَهُ الجنَّةَ »

173. Na ka treguar Is-haku, këtij Abdu-s-Samedi, këtij Abdu-r-Rahman b. Abdullah b. Dinari, i cili thotë se e ka dëgjuar babain e vet, ky nga Ebu Salihu, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Me të vërtetë një njeri e ka parë një qen, që nga etja e madhe e lëpinte tokën e lagur. Njeriu e mori (e nxorri) **mestin** (këpucën) **e vet dhe, pasi e mbushi me ujë** (në një pus) **i dha të pijë me të derisa ia shuajti etjen. All-llah xh.sh. e shpërbleu atë** (njeriun) **duke ia dhuruar Xhennetin".**

---

32 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- qeni është i papastër;
- ena të cilën e lëpin qenë, nga e cila ha ose llapit ujë është e papastër dhe para se të përdoret duhet të pastrohet mirë.

Neveviu thotë: "Nga hadithi kuptohet se gjuha e qenit është e papastër. Analogjikisht me këtë, të papastra janë edhe pjesët tjera të trupit të tij dhe me çfarëdo pjese që ta prek enën, ajo duhet të pastrohet mirë.

Sipas mendimit të Kermanisë shitja e qenit është e ndaluar. Qeni është i papastër dhe si i tillë i pavlefshëm, ai është si alkooli dhe nuk mund të jetë mjet për shitblerje".

Neveviu e lejon shitblerjen e qenit me arsyetim se qentë u duhen njerëzve për gjueti dhe për ruajtjen e pasurisë.

Muhammedi a.s. në ditët e para të përhapjes së Islamit ka thënë se ndalohet përdorimi i parave nga shitja e qenve, kurse më vonë këtë disi nuk e ka përmendur.

- Shafiu pohon se enën në rastin konkret duhet larë pikërisht shtatë herë, e kështu duhet vepruar me enën ku bie gjaku, djersa, shurra dhe ndyrësira e qenit.

١٧٤ – وقال أحمدُ بنُ شَبيبٍ حدَّثنا أبي عن يونُسَ عنِ ابنِ شِهابٍ قال حدَّثني حمزةُ بنُ عبد اللهِ عن أبيه قال : كانتِ الكلابُ تبولُ وتُقبلُ وتُدبرُ في المسجدِ في زمانِ رسولِ اللهِ ﷺ فلم يكونوا يرُشُّونَ شيئاً من ذلكَ

174. Ahmed b. Shebibi ka thënë: Më ka treguar babai im, duke transmetuar nga Junusi, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Hamza b. Abdullahu, ky nga babai i vet, i cili ka thënë:

"**Në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. qentë kanë hyrë në xhaminë e tij, janë përmjerrë, kanë dalë, e** (As-habët) **nuk kanë stërpikur në xhami asgjë** (nuk e kanë larë).[33]

١٧٥ – حدَّثنا حفصُ بنُ عُمرَ قال حدَّثنا شُعبةُ عنِ ابنِ أبي السَّفرِ عنِ الشَّعبيِّ عن عَديِّ بنِ حاتمٍ قال : سألتُ النبيَّ ﷺ فقال « إذا أرسلتَ كلبَكَ المعلَّمَ فقتَلَ فكُلْ ، وإذا أكلَ فلا تأكُلْ فإنَّما أمسَكَهُ على نفسِه » . قلتُ أُرسِلُ كلبي فأجدُ معه كلباً آخرَ . قال : فلا تأكُلْ ، فإنَّما سمَّيتَ على كلبِكَ ولم تُسمِّ على كلبٍ آخرَ

175. Na ka treguar Hafs b. Umeri, këtij Shu'bja, këtij Ibni Ebu Seferi, ky nga Sha'biu, ky nga Adijj b. Hatimi, i cili ka thënë: E kam pyetur Pejgamberin s.a.v.s. e ai më është përgjigjur:

---

33 Xhamia e Pejgamberit a.s. atëkohë gjithnjë rrinte e hapur; në të ka mundur të hyjë çdokush në çdo kohë-natën dhe ditën - prandaj ka ekzituar mundësia që në të të kenë hyrë qentë dhe kafshët tjera dhe të përmjerren. Megjithatë, Muhammedi a.s. e as vetë transmetuesi i hadithit, nuk kanë qenë të bindur se lagështia eventuale është pikërisht nga shurra e qenit me ç'rast do të bënin pastrim të plotë, ashtu siç i ka thënë Muhammedi a.s. një fshatari, teshën e të cilit e kishte shurrë qeni.
Hatabiu mendon se qentë nuk janë shurrur në xhami, por jashtë saj.
Ebu Hanife pohon se sipërfaqja e tokës, e ndyrë me çfarëdo ndyrësie, bëhet e pastër kur ta ketë terë dielli dhe nxehtësia dhe në të mos vërehet gjurma e papastërtisë përkatëse. Në sipërfaqe të tokës së këtillë namazi është i vlefshëm. Pa dyshim, ky është shkaku që As-habët nuk e kanë larë sipërfaqen e tokës në xhaminë e Pejgamberit a.s.

"Kur ta lëshosh qenin tënd të mësuar dhe ai vetëm e mbyt gjahun, ti haje atë (gjahun), **e nëse e ka kafshuar** (i ka nxjerrë copë), **ti mos e ha atë, sepse ai e ka mbajtur për vete atë** (gjahun)".

Pastaj, e pyeta: **"E lëshova qenin tim, e së bashku me të e kam gjetur edhe një qen tjetër"?**

(Pejgamberi s.a.v.s.) tha:

"Mos e ha (atë gjah), **sepse ti ke bërë Bismi-l-Lahi... vetëm kur e ke lëshuar qenin tënd, e jo edhe qenin tjetër".**[34]

---

34 Buhariu mendon se uji i mbetur nga llapitja e qenit është i pastër, sepse Muhammedi *a.s. ia lejoi Adiut të hajë gjahun e mbytur me qen të mësuar*, duke mos ia kushtëzuar që vendin e kafshuar ta lajë më parë. Maliku shton edhe këtë: "Si do të mund të hahej kafsha e gjuajtur me qenin e mësuar po të ishte pështyma e tij (e qenit) e papastër"?

Përdorimi i nocionit "qen" nënkupton çdo lloj qeni, pa dallim ngjyre dhe race.

Imam Ahmedi nuk lejon që qeni i zi të përdoret për gjueti. Sigurisht se kjo është nga paragjykimi i botës së atëhershme ndaj ngjyrës së zezë dhe të përvojës së hidhët të asaj ngjyre.

Kur lëshohet qeni i mësuar në gjueti, duhet lexuar "besmelen". Që të jetë gjahu i lejueshëm të hahet (hallall) duhet plotësuar këto kushte: qeni i mësuar të lëshohet në gjueti nga ana e pronarit të tij; qeni duhet të jetë i mësuar dhe i ushtruar për gjueti dhe gjahun nuk fillon ta hajë; kur lëshohet qeni në gjueti, përkatësisht kur tërheq këmbëzën e pushkës ose shigjetën, duhet të shprehë patjetër "besmelen".

Të shprehurit e besmeles në rastin konkret, Shafiu e konsideron sunnet. Prandaj, gjahu lejohet të hahet edhe nëse gjuetari nuk ka bërë "bismi-l-Lahi..." qoftë me dashje, qoftë me harresë.

Zahiritë këtë veprim e konsiderojnë të domosdoshëm (vaxhib) dhe, nëse gjuetari nuk e ka shprehur besmelen në kohën e caktuar, gjahu nuk lejohet të hahet.

Ebu Hanifja merr qëndrim të mesëm. Ai pohon se gjahu nuk mund të hahet, nëse gjuetari me qëllim nuk e përmend emrin e All-llahut xh.sh., por, nëse harrohet eventualisht, ngrënia e gjahut është e lejueshme.

Gjahu lejohet të hahet, e gjuajti atë muslimani ose jomuslimani, vetëm nëse veprohet sipas rregullave të caktuara. Gjahu i qenit të mësuar (i zagarit), i cili ka shkuar në gjueti pa mbikëqyrjen e gjuetarit nuk lejohet të hahet.

بابٌ مَنْ لم يرَ الوُضوءَ إلاّ مِنَ المَخْرَجَيْنِ من القُبُلِ والدُّبُرِ . وقولِ اللهِ تعالى ﴿ أَوْ جاءَ أَحَدٌ منكم مِنَ الغائطِ ﴾ . وقال عطاءٌ فيمَنْ يَخْرُجُ مِنْ دُبُرِهِ الدُّودُ أو مِن ذَكَرِهِ نحوُ القَملةِ : يُعيدُ الوُضوءَ . وقال جابرُ بنُ عبدِ اللهِ : إذا ضحك في الصلاةِ أعادَ الصلاةَ ولم يُعِدِ الوُضوءَ . وقال الحَسَنُ : إنْ أَخَذَ مِن شَعَرِهِ وأظفارِهِ أو خَلَعَ خُفَّيهِ فلا وُضوءَ عليهِ . وقال أبو هُريرةَ : لا وُضوءَ إلاّ مِن حَدَثٍ . ويُذكَرُ عن جابرٍ أنَّ النبيَّ ﷺ كان في غَزوةِ ذاتِ الرِّقاعِ فَرُمِيَ رجلٌ بسَهمٍ فنَزَفَهُ الدَّمُ فركَعَ وسجدَ ومضى في صلاتِهِ . وقال الحسَنُ : ما زالَ المسلمونَ يُصلُّونَ في جِراحاتِهِمْ . وقال طاوُسٌ وعمدُ بنُ عليٍّ وعَطاءٌ وأهلُ الحِجازِ : ليس في الدَّمِ وُضوءٌ . وعَصَرَ ابنُ عُمرَ بَثْرَةً فخرجَ منها الدَّمُ ولم يتوضَّأْ . وبَزَقَ ابنُ أبي أوفى دَماً فمضى في صلاتِهِ . وقال ابنُ عُمرَ والحسَنُ فيمَنْ يَحتجِمُ : ليسَ عليه إلاّ غَسلُ مَحاجِمِهِ .

Ata që konsiderojnë se abdestin duhet përsëritur vetëm kur diçka del në njërën nga dy jashtëqitjet - prapa ose para

All-llahu i Madhëruesheëm thotë:

"... ose nëse dikush nga ju vjen nga nevojtorja...".

(el-Mâide, 6).

Atai ka thënë: **"Atij që nga jashtëqitja e prapme i del si krimb, ose nga organi gjenital i del sikur morr** (një pikë sado e vogël) **duhet ta përsërisë abdestin".**[35]

Xhabir b. Abdullahu: **"Kur dikush në namaz qeshet** (pa zë)**, do ta përsërisë atë** (namazin)**, por jo edhe abdestin".**[36]

---

35 Duke komentuar hadithin e sipërshënuar Ibni Mundhiri thotë: juristët janë të një mendimi se nevoja e madhe dhe nevoja e vogël, lëshuarja e frymës me zë ose pa zë, polucioni i pahetueshëm pas nxitjes së mëparme dhe gjakderdhja e çrregulluar e grave, e prishin abdestin, ndërsa për daljen si krimb, kanë mendime të ndryshme.
Autori i Kudurisë thekson: "Dalja si krimb i vogël nga hunda, goja ose veshi nuk e prishin abdestin".

36 Mendimin e sipërshënuar e mbështesin të gjithë juristët islamë. Ebu Hanifja mendimin e sipërpërmendur e mbështet në hadithin të cilin e transmeton Ebu Mulejhu nga babai i vet: Jemi falur me Pejgamberin a.s. Një njeri shkurtpamës, duke u falur, ra në një gropë. Pejgamberi a.s. pas kryerjes së namazit tha: "Ai që qeshi me zë, le të marrë abdest përsëri".
Sipas juristëve të shkollës hanefite të qeshurit pa zë në namaz, e prish vetëm namazin, kurse të qeshurit me zë, të cilin e dëgjon personi afër tij, e prish edhe abdestin".

Hasani: "**Nëse dikush pret** (shkurton) **flokët ose thonjtë e tij, ose i heq mestet, nuk është i detyruar të përsërisë abdestin**".[37]

Ebu Hurejre: "**Abdesti përsëritet vetëm në rast "hadethi":**[38]

Transmetohet nga Xhabiri se Pejgamberi s.a.v.s. ka marrë pjesë në luftën në Dhati-r-Rika, ku një As-hab u godit me shigjetë; i rrodhi gjak, ai bëri ruqu, bëri sexhde dhe ashtu e vazhdoi namazin e tij edhe më tutje".[39]

Hasani: "**Muslimanët kanë vazhduar të falen me plagët e tyre**".[40]

Tavusi, Muahmmed b. Aliu, Atai dhe dijetarë të tjerë të Hixhazit thonë: "**Në rast se del gjak, abdesti nuk duhet të përsëritet**".[41]

---

37 Juristët e Irakut, Hixhazit, pastaj Hammadi, Muxhahidi dhe shumë të tjerë pohojnë se në rastin e lartshënuar, duhet përsëritur abdestin, kurse Shafiu, Atai dhe Nehaiu mendojnë se vendet përkatëse duhet lagur me dorë të lagur.
Hanefitë mendojnë se nuk duhet përsëritur abdestin pas rrojes së kokës, pas prerjes së mustaqeve, prerjes së thonjve dhe pas heqjes së mesteve për një kohë të shkurtër. Ibni Xheriri ndërkaq, ka mendim të kundërt, kurse Ibrahim Nehaiu mendon se ata vende vetëm duhet lagur me ujë.
Lidhur me heqjen e mesteve janë pesë mendime: Ahmedi, Shafiu dhe disa juristë të tjerë mendojnë se duhet përsëritur tërë abdestin, sipas Malikut dhe Lejthit, duhet larë vetëm këmbët, sipas Ebu Hanifes, Thevriut dhe shumë dijetarëve, duhet përsëritur larjen e këmbëve kur do të merrte abdest përsëri, sipas Hasan Basriut, Katades dhe Nehaiut, në këto raste nuk duhet përsëritur abdestin, por duhet larë këmbët, sikurse kur merr abdest.

38 "Hadethi" paraqitet gjatë kryerjes së nevojës së madhe dhe të vogël; marrëdhënieve seksuale (ejakulimit), gjumit, alivanosjes, çmendurisë e të ngjashme.

39 Lufta në Dhat-i Rika ka ndodhur në vitin 4 hixhri (...).

40 Paraqitja e mendimit të Hasan Basriut nuk e vërteton qëndrimin e Buharisë. Nga fjalët e tyre kuptohet vetëm ajo se As-habët janë falur me plagë. Plaga zakonisht lidhet dhe vetë paraqitja e gjakut në plagë si dhe vetë plaga nuk e prishin abdestin, përveç nëse ai gjak shpërndahet rreth plagës.

41 Hanefitë e pranojnë vërtetësinë e qëndrimit të Tavusit, por kanë vërejtur se edhe Tavusi nuk është falur kur i ka rrjedhur gjak. Ebu Hanifja në një rast ka thënë: "Tabiinët, ku bën pjesë edhe Tavusi, janë derëz sikur ne. Ata janë përpjekur të gjejnë rregulla dhe ata sjellin vendime sa më të përshtatshme, e ky është edhe qëllimi ynë. Prandaj, qëndrimi i tyre ne nuk na pengon. Përkundrazi, ne kemi për detyrë, sikurse ata, për zgjedhje më të drejta dhe, sa më tepër të jenë logjike dhe të arsyeshme, aq më tepër duhet zbatuar ato.

Abdullah b. Umeri e shtrydhi puçrrën nga e cila i doli pak gjak, por abdestin nuk e përsëriti.[42]

Ibni Ebu Evfau ka pështyrë gjak dhe ka vazhduar të falë namazin.[43]

Ibni Umeri dhe Hasani kanë thënë: **"Atij të cilit i merret gjak, është i detyruar të pastrojë vetëm vendet nga të cilët i është marrë gjaku".**[44]

١٧٦ – حدثنا آدمُ بنُ أبي إياسٍ قال حدثنا ابن أبي ذئبٍ عن سعيدٍ المقبُريّ عن أبي هُريرةَ قال : قال النبيُّ ﷺ « لا يزالُ العبدُ في صَلاةٍ ما كانَ في المسجدِ يَنتَظِرُ الصلاةَ ما لم يُحدِثْ » . فقالَ رجُلٌ أعجميٌّ : ما الحَدَثُ يا أبا هُريرةَ ؟ قال : الصوتُ (يعني الضُّرْطةَ)

176. Na ka treguar Adem b. Ebu Ijasi, këtij Ibni Ebu Dhi'bi ky nga Se'id el-Makburiu, ky nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

"Njeriu është në namaz derisa është në xhami dhe e pret namazin e që nuk i është paraqitur "hadethi".

"Po çka është "hadethi" o Ebu Hurejre"?, pyeti njëri.

"Zë, d.m.th. frymë e lëshuar me zë (pordhë)",[45] u përgjigj.

---

42 Thënia e Ibni Umerit e vërteton qëndrimin e hanefive, të cilët mendojnë se gjaku i posadalur nga varra nuk e prish abdestin, e kjo ndodh në shtrydhjen e puçrrave. Abdestin e prish gjaku që shpërndahet nëpër lëkurë rreth plagës.

43 Ibni Ebu Evfai është njëri nga As-habët e fundit të cilët kanë vdekur në Kufe në moshën 78 vjeçare. Ebu Hanifja pak e ka mbajtur në mend. Rasti i përmendur më sipër nuk e vërteton qëndrimin e Buhariut, e as që mund të përforcojë mendimin e juristëve të shkollës hanefite. Sipas mendimit të hanefitëve, gjaku i pështyrë nga zgavra e gojës së njeriut nuk e prish abdestin, nëse ai mezi hetohet në pështymë.
Ibni Sirini i tha shkokut të vet, i cili e hetoi gjakun në pështymë, të pështyjë edhe një herë, e nëse pështyma e ndërron ngjyrën e vet të zakonshme, duhet të përsëritet abdesti.

44 Thëniet e sipërshënuara e vërtetojnë dukshëm qëndrimin e hanefive. Nëse gjatë marrjes së gjakut nuk ka kurrfarë shpërndarje të gjakut nëpër lëkurën e shpuar ky veprim nuk e prish abdestin, e nëse gjaku shpërndahet nëpër lëkurë, personi e humb abdestin. Gjaku i mbetur në vendin e shpuar evitohet me ujë ose me mjet tjetër të përshtatshëm. Në rastin konkret Ibni Umeri këtë e ka bërë me guralecë, kurse Lejthi, me gishtin e tagur.

45 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- të presësh faljen e namazit duke qenë me abdest është virtyt i lartë i njeriut që i

١٧٧ – حدثنا أبو الوليد قال حدثنا ابن عيينة عن الزهري عن عباد بن تميم عن عمه عن النبي ﷺ قال « لا ينصرف حتى يسمع صوتا أو يجد ريحا »

177. Na ka treguar Ebu-l-Velidi, ky nga Ebu Ujejne, ky nga Zuhriu ky nga Abbad b. Temimi, ky nga axha i tij, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili ka thënë:

"Ai që fal namazin, le të mos dalë nga namazi, derisa nuk dëgjon farë zëri, ose nuk heton erë të keqe"!

١٧٨ – حدثنا قتيبة بن سعيد قال حدثنا جرير عن الأعمش عن منذر أبي يعلى الثوري عن محمد بن الحنفية قال : قال علي كنت رجلا مذاء فاستحييت أن أسأل رسول الله ﷺ فأمرت المقداد بن الأسود فسأله فقال « فيه الوضوء » . ورواه شعبة عن الأعمش

178. Na ka treguar Kutejbe b. Se'idi, këtij i ka treguar Xheriri, këtij A'meshi, ky nga Mundhir Ebu Ja'la eth-Thevriu, ky nga Muhammed b. Hanifijje, i cili ka thënë:

Ka thënë Aliu: **"Unë jam njeri që, pas një nxitje, menjëherë dhe shpesh më paraqitet lëngu** (mezia) **në organin gjenital. Kam pasë turp që për të ta pyes Pejgamberin s.a.v.s., prandaj e kam shtyrë Mikdad b. Esvedin ta pyes Pejgamberin s.a.v.s. Ai i është përgjigjur:**

"Në atë rast duhet të përsëritet vetëm abdesti".

Këtë Hadith e transmeton edhe Shu'be nga A'meshi.

---

përkushtohet Islamit me tërë qenien. Koha e kaluar në sexhade, duke pritur fillimin e kohës së namazit është ibadet.

- të lëshuarit e frymës dhe çdo gjë që lidhet me të, e prish abdestin.

١٧٩ — حدثنا سعدُ بنُ حفصٍ حدثنا شيبانُ عن يحيى عن أبي سلمةَ أنَّ عطاءَ بنَ يسارٍ أخبرَهُ أنَّ زيدَ ابنَ خالدٍ أخبرَهُ أنه سألَ عثمانَ بنَ عفانَ رضيَ اللهُ عنه قلتُ : أرأيتَ إذا جامعَ فلم يُمنِ ؟ قال عثمانُ : يتوضأُ كما يتوضأُ للصلاةِ ويغسلُ ذكرَهُ . قال عثمانُ : سمعتُه من رسول الله ﷺ . فسألتُ عن ذلك عليًّا والزُّبيرَ وطلحةَ وأبيَّ بنَ كعبٍ رضيَ اللهُ عنهم فأمروه بذلك

179. Na ka treguar Sa'd b. Hafsi, këtij Shejbani, ky nga Jahjai, ky nga Ebu Seleme, ky nga Ata b. Jesari, ky nga Zejd b. Halidi, i cili tregon se personalisht e ka pyetur Uthman b. Affanin:

"Çka mendon ti, kur njeriu ka marrëdhënie seksuale me bashkëshorten, e nuk ka polucion (nuk derdh farën, spermën)?

"Organin e tij gjenital ta pastrojë dhe të marrë vetëm abdest, siç merr për namaz. Kështu e kam dëgjuar nga Pejgamberi s.a.v.s., tha Uthmani.

Për këtë, pastaj e kam pyetur edhe Aliun, Zubejrin, Talhanë dhe Ubejjin r.a. Edhe ata thanë të njëjtën gjë.

١٨٠ — حدثنا إسحاقُ قال أخبرنا النَّضرُ قال أخبرنا شُعبةُ عن الحكمِ عن ذكوانَ أبي صالحٍ عن أبي سعيدٍ الخدريِّ أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ أرسلَ إلى رجلٍ من الأنصارِ فجاء ورأسُهُ يقطرُ . فقال النبيُّ ﷺ : لعلَّنا أعجلناك ؟ فقال : نعم . فقال رسولُ اللهِ ﷺ « إذا أُعجِلْتَ ـ أو قُحِطْتَ ـ فعليك الوضوء »

تابعَهُ وهبٌ قال : حدثنا شُعبةُ . قال أبو عبدِ اللهِ : ولم يقُلْ غُندرٌ ويحيى عن شُعبةَ « الوضوء »

180. Na ka treguar Is-hak b. Mensuri, këtij Nadri, këtij Shu'be, ky nga Hakemi, ky nga Dhekvan b. Salihu, ky nga Ebu Se'id Hudriu, i cili tregon se Pejgamberi s.a.v.s. ka dërguar një njeri pas një Ensari, i cili ka ardhë, me kryet (floket) ende të lagët (i pikonte ujë).

Pejgamberi s.a.v.s. i tha:

"Ndoshta të kemi bërë të shpejtosh"?

"Po", iu përgjigj ai.

Me këtë rast Pejgamberi s.a.v.s. tha:

"Kur je në nguti ose je përmbajtur nga polucioni (derdhja e spermës pa kontakt), **je i detyruar të përsërisësh vetëm abdestin"**.[46]

Vehbi pajtohet me tekstin e Nadirit dhe tha se Shu'bja ia ka treguar të njëjtin Hadith.

Ebu Abdullahu (Buhariu) ka thënë: "Gunderi dhe Jahjai, duke transmetuar këtë Hadith nga Shu'be, nuk e kanë përmendur dot shprehjen **"vudu"** d.m.th. **"abdest"**.

بَابُ الرَّجُلِ يُوَضِّئُ صَاحِبَهُ

١٨١ - حَدَّثَنِي مُحَمَّدُ بْنُ سَلَامٍ قَالَ أَخْبَرَنَا يَزِيدُ بْنُ هَارُونَ عَنْ يَحْيَى عَنْ مُوسَى بْنِ عُقْبَةَ عَنْ كُرَيْبٍ مَوْلَى ابْنِ عَبَّاسٍ عَنْ أُسَامَةَ بْنِ زَيْدٍ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ لَمَّا أَفَاضَ مِنْ عَرَفَةَ عَدَلَ إِلَى الشِّعْبِ فَقَضَى حَاجَتَهُ . قَالَ أُسَامَةُ بْنُ زَيْدٍ : فَجَعَلْتُ أَصُبُّ عَلَيْهِ وَيَتَوَضَّأُ . فَقُلْتُ : يَا رَسُولَ اللَّهِ أَتُصَلِّي ؟ فَقَالَ : الْمُصَلَّى أَمَامَكَ

Ndihma ndaj tjetrit në abdest

181. Më ka treguar Muhammed b. Selami, këtij Jezid b. Haruni ky nga Jahjai, ky nga Musa b. Ukbe, ky nga Kurejbi, rob i liruar i Ibni Abbasit, ky nga Usame b. Zejdi, i cili tregon se Pejgamberi s.a.v.s. duke u kthyer nga Arafati u ndal te një dhiare, për ta kryer nevojën. Pastaj, unë, tregon Usame b. Zejdi, i shtiva (i qita) ujë dhe ai mori abdest.

"O Resulullah, a do të falesh"?, e pyeta.

---

46 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- lejohet të merret qëndrim sipas shumë rrethanave dhe (shenjave) reale;
- sipas mendimit të Uthmanit, Aliut, Zubejr b. Avvanit, Talhait, Sa'd b. Ebu Ka'bit, Ebu Ejub Ensariut, Ata b. Rebahut, Ebu Selemes, Hisham b. Urves dhe A'meshit, kontakti seksual me bashkëshorten pa farë polucioni nuk e detyron personin në larje të përgjithshme (gusël).

Ibni Hazmi ka thënë: "Sipas rastit të sipërpërmendur, larjen e konsiderojnë të domosdoshme: Aishja, Ebu Bekri, Umeri, Abdullah b. Umeri, e më vonë mendimin e tyre e kanë mbështetur edhe: Uthmani, Aliu, Ibni Mes'udi, Ibni Atai dhe shumë As-habë të tjerë. Këtë mendim e mbështesin edhe: Ebu Hanifja, Maliku, Shafiu, Ahmedi, Nehaiu dhe Sufjan Thevriu.

Neveviu thekson se qëndrimi i të gjithë dijetarëve islamë është që pas marrëdhënies seksuale duhet larë patjetër (të bëhet gusël), po edhe nëse nuk ka polucion (derdhje të spermes).

"Vendi për t'u falur është para teje", u përgjigj.[47]

١٨٢ - حدثنا عمرو بن علي قال حدثنا عبد الوهاب قال سمعت يحيى بن سعيد قال : أخبرني سعد بن إبراهيم أن نافع بن جبير بن مطعم أخبره أنه سمع عروة بن المغيرة بن شعبة يحدث عن المغيرة بن شعبة أنه كان مع رسول الله ﷺ في سفر وأنه ذهب لحاجة له وأن مغيرة جعل يصب الماء عليه وهو يتوضأ ، فغسل وجهه ويديه ومسح على الخفين

182. Na ka treguar Amr b. Aliu, këtij Abdu-l-Vehhabi, ky ka dëgjuar nga Jahja b. Se'idi, këtë e ka lajmëruar Sa'd b. Ibrahimi, ky nga Nafi' b. Xhubejr b. Mut'imi, ky nga Urve b. Mugire b. Shu'be, i cili transmeton nga Mugire b. Shu'be, i cili ka udhëtuar së bashku me Pejgamberin s.a.v.s.. Gjatë udhëtimit Pejgamberi s.a.v.s. është kthyer në një anë ta kryej nevojën. Mugirja, më pastaj i shtiu ujë për abdest. Ai mori abdest duke larë fytyrën dhe duart. Kokës i dha mes-h (e fshiu me dorë të lagët), e ashtu u dha mes-h edhe mesteve.

باب قراءة القرآن بعد الحدث وغيره . وقال منصور عن إبراهيم : لا بأس بالقراءة في الحمام ، ويكتب الرسالة على غير وضوء . وقال حماد عن إبراهيم : إن كان عليهم إزار فسلم ، وإلا فلا تسلم

Të lexuarit e Kur'anit pasi prishet abdesti (pas hadethit)

Mensuri, duke transmetuar nga Ibrahimi, thotë: **"Nuk është gjë e keqe që në banjë të lexohet Kur'an dhe të shkruhet letër pa abdest"**.[48]

---

47 Nga hadithi mund të përfundohet:
- lejohet ndihma e tjetrit në marrje të abdestit;
- të kërkosh ndihmë për t'i larë disa pjesë ta caktuara të trupit është gjë mjaft e përbuzur, përveç në rast sëmundjeje. Muhammedi a.s. merrte abdest zakonisht vetë. Në udhëtimin e sipërshënuar Usamja i ka bërë shërbim, sepse ai ishte shumë i lodhur. Duke pasur parasysh këtë veprim fetar të Usames, dijetarët vijnë në përfundim se zëvendësimi mund të konsiderohet i vlefshëm edhe në veprat tjera të ngjashme fetare, përveç namazit.

48 Të lexuarit e Kur'anit në banjë, Ebu Hanifja e konsideron gjë të përbuzur. Banja është

Hammadi, duke transmetuar nga Ibrahimi, thotë: "**Nëse kanë** (si) **fustan** (veshje të gjatë), **përshëndeti ata, në të kundërtën, mos i përshëndet**"!

١٨٣ – حدثنا إسماعيلُ قال حدَّثني مالكٌ عن مَخْرَمَةَ بنِ سُلَيمانَ عن كُرَيبٍ مَولَى ابنِ عبّاسٍ أنَّ عبدَ اللهِ ابنَ عبّاسٍ أخبرَهُ أنه باتَ ليلةً عندَ مَيمونةَ زَوجِ النبيِّ ﷺ – وهيَ خالَتُهُ – فاضْطَجَعْتُ في عَرْضِ الوِسادةِ، واضْطَجَعَ رسولُ اللهِ ﷺ وأهلُهُ في طُولِها، فنامَ رسولُ اللهِ ﷺ، حتى إذا انْتَصَفَ الليلُ – أو قبلَهُ بقليلٍ، أو بعدَهُ بقليلٍ – استيقَظَ رسولُ اللهِ ﷺ، فجَلَسَ يَمسَحُ النومَ عن وَجهِهِ بيَدِه. ثمَّ قَرَأَ العَشْرَ الآياتِ الخَواتِمَ مِن سورةِ آلِ عِمرانَ. ثمَّ قامَ إلى شَنٍّ مُعلَّقةٍ فتَوَضَّأَ منها فأحْسَنَ وُضوءَهُ، ثمَّ قامَ يُصلِّي. قال ابنُ عبّاسٍ: فقمتُ فصَنَعتُ مِثلَ ما صَنَعَ، ثمَّ ذَهَبتُ فقُمتُ إلى جَنبِه، فوَضَعَ يدَهُ اليُمنَى على رأسي وأخَذَ بأُذُنِي اليُمنَى يَفتِلُها. فصَلَّى رَكعتَينِ، ثمَّ رَكعتَينِ، ثمَّ رَكعتَينِ، ثمَّ رَكعتَينِ، ثمَّ رَكعتَينِ، ثمَّ رَكعتَينِ، ثمَّ أوتَرَ. ثمَّ اضْطَجَعَ حتى أتاهُ المُؤَذِّنُ فقامَ فصلَّى رَكعتَينِ خَفيفتَينِ. ثمَّ خَرَجَ فصلَّى الصُّبحَ

183. Na ka treguar Ismaili, këtij Maliku, ky nga Mahreme b. Sulejmani, ky nga Kurejbi, rob i liruar i Ibni Abbasit, i cili tregon se Abdullah b. Abbasi e ka njoftuar atë se një natë ka bujtur te Mejmunja, bashkëshorte e Pejgamberit s.a.v.s., e ajo ishte hallë e tij (e Abdullah b. Abbasit):

"**U mbështeta përtej jastëkut, kurse Pejgamberi s.a.v.s. ra të flejë me bashkëshorten e vet, për së gjati. Kah mesi i natës, respektivisht, pak para, ose pas mesnatës, Pejgamberi s.a.v.s. u zgjua. Me dorën e tij e fërkoi fytyrën, për të larguar kotjen** (gjumin), **e pastaj i lexoi dhjetë ajetet e fundit të sures Ali Imran. Pastaj shkoi te ena me ujë që ishte e varur, me të mori abdest, duke i larë mirë pjesët e trupit** (të abdestit) **dhe u ngrit të falë namazin. U ngrita edhe unë, thotë Ibni Abbasi. Veprova ashtu si ai; shkova e qëndrova pranë tij. Atëherë, ai e vuri dorën e djathtë mbi kokën timë dhe më kapi për veshin e djathtë, më rrotulloi** (duke më

---

vend për mbeturina dhe gjëra të papastërta, thujase si nevojtorja, prandaj në të nuk duhet lexuar Kur'an.

hedhur) **në anën e tij të djathtë. Ai fali dy reqate namaz, përsëri edhe dy, përsëri edhe dy, prapë dy pastaj edhe dy, përsëri edhe dy, pastaj numër tek. Pastaj u mbështet derisa erdhi muezini.** (Kur erdhi muezini), **u ngrit dhe fali dy reqate të shkurtëra namaz, e pastaj shkoi** (në xhami) **për të falë namazin e sabahut".**[49]

بَابُ مَنْ لَمْ يَتَوَضَّأْ إِلَّا مِنَ الغَشْيِ المُثْقِلِ

١٨٤ – حَدَّثَنَا إسماعيلُ قال حدَّثني مالكٌ عن هِشامِ بنِ عُروَةَ عن امرأتِهِ فاطمةَ عن جدَّتِها أسماء بنت أبي بكرٍ أنها قالت : أتيتُ عائشةَ زوجَ النبيِّ ﷺ حينَ خَسَفَتِ الشمسُ ، فإذا الناسُ قِيامٌ يُصَلُّونَ ، وإذا هيَ قائمةٌ تُصَلِّي . فقلتُ : ما للناسِ ؟ فأشارتْ بيدِها نحوَ السماءِ وقالتْ : سُبحانَ اللهِ . فقلتُ : آيةٌ ؟ فأشارتْ أي نعم . فقمتُ حتى تَجلاَّنِي الغَشْيُ ، وجَعلتُ أُصُبُّ فوقَ رأسي ماءً . فلما انصرفَ رسولُ اللهِ ﷺ حَمِدَ اللهَ وأثنى عليه ثمَّ قال « ما مِنْ شيءٍ كنتُ لم أرَهُ إلاَّ قد رأيتُه في مَقامي هٰذا حتى الجنةَ والنارَ . ولقد أُوحِيَ إليَّ أنكم تُفتَنون في القبورِ مثلَ – أو قريبَ مِن – فتنةِ الدجالِ (لا أدري أيَّ ذٰلكَ قالتْ أسماء) يُؤتَى أحدُكم فيُقالُ : ما عِلمُكَ بهٰذا الرَّجُلِ ؟ فأمَّا المُؤمنُ (أو المُوقِنُ ، لا أدري أيَّ ذٰلكَ قالتْ أسماء) فيقول : هوَ محمدٌ رسولُ اللهِ ، جاءنا بالبيِّناتِ والهُدى ، فأجَبْنا وآمَنَّا واتَّبَعْنا . فيقال : نَمْ صالحاً ، فقد عَلِمْنا إنْ كنتَ لَمُؤمِناً . وأمَّا المُنافِقُ (أو المُرتابُ ، لا أدري أيَّ ذٰلكَ قالتْ أسماء) فيقولُ : لا أدري ، سَمِعتُ الناسَ يَقولونَ شيئاً فقلتُه

Abdestin duhet përsëritur pas humbjes së vetëdijes

184. Na ka treguar Ismaili, ky nga Maliku, ky nga Hisham b. Urve, ky nga bashkëshortja e vet Fatimja (vajza e Mundhirit), kjo nga gjyshja e vet Esmaja, vajzë e Ebu Bekrit, e cila ka thënë:

"Erdha te Aishja, te bashkëshortja e Pejgamberit s.a.v.s. kur perëndoi dielli dhe njerëzit ishin ngritur të falin namaz. Edhe Aishja u ngrit të falet.

---

49 Nga hadithi del:
- Kur'ani mund të lexohet dhe të mësohet pa abdest;
- është gjë e lavdueshme të lexohet Kur'an para dhe pas gjumit.

Unë e pyeta: **"Çka është me këtë popull"?** Ajo më sinjalizoi kah qielli dhe tha: **"Subhanallah"!** E pyeta: **"Ndonjë shenjë"?** Ajo më sinjalizoi me krye **"po"**. Atëherë edhe unë nisa të fal namazin, por filloi të më bie të fikët, prandaj fillova të derdh ujë në kokë.

Kur Pejgamberi s.a.v.s. e mbaroi namazin, e falënderoi All-llahun dhe tha:

"S'ka asgjë që më është treguar e të mos e kem parë, duke qenë në këtë pozitë, bile edhe Xhennetin dhe Xhehennemin. Më është shpallur se në varre do të jeni në sprovë, respektivisht afër sprovimit të Dexhallit. Nuk e di, thotë transmetuesi, cilën nga këto dy shprehje i ka përdorë Esmaja. Çdonjërit nga ju, thotë Esmaja, do t'i vijë dhe do ta pyesë:" Ç'di ti për këtë njeri"?

Besimtari ose muslimani, nuk e di, thotë transmetuesi, cilën nga këto dy shprehje i përdori Esmaja, do të thotë:

"Ai është Muhammadi, Pejgamberi i All-llahut, i cili na ka sjellur argumente të qarta dhe udhëzime. Ne jemi përgjigjur thirrjes së tij, e kemi besuar dhe jemi ithtarë të tij".

"Fli qetë! do t'i thuhet atij, e ne, edhe më herët kemi qenë në dijeni se ti je musliman i bindur".

Dyfytyrëshi, megjithatë, respektivisht, i luhatshmi në besim, nuk e di, thotë transmetuesi se cilën nga këto dy shprehje i ka përdorë Esmaja, do të thotë:

"Saktësisht nuk di asgjë, por kam dëgjuar që njerëzit flisnin diçka, prandaj edhe unë thoja të njëjtën".

بابُ مَسحِ الرأسِ كلِّهِ ، لقولِ اللهِ تعالى ﴿ وامسَحوا بِرءوسِكُم ﴾ [٦ المائدة]

وقال ابن المسيّبِ : المرأةُ بمنزلةِ الرَّجلِ تمسحُ على رأسِها

وسُئِلَ مالكٌ : أيُجزِىءُ أن يمسحَ بعضَ الرأسِ ؟ فاحتجَّ بحديثِ عبدِ اللهِ بنِ زيد

١٨٥ — حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرنا مالكٌ عن عَمرِو بنِ يحيى المازنيِّ عن أبيهِ أن رجلا قال لعبدِ اللهِ بنِ زيدٍ ـ وهو جدُّ عمرِو بن يحيى ـ أتستطيعُ أن تُرِيَني كيفَ كان رسولُ اللهِ ﷺ يتوضأُ ؟ فقال عبدُ اللهِ بنُ زيدٍ : نعم . فدعا بماء فأفرغَ على يديهِ فغسَلَ مرَّتين ، ثمَّ مضمضَ واستنثرَ ثلاثًا ، ثمَّ غسلَ يديهِ مرَّتينِ مرَّتينِ إلى المِرفقَينِ ، ثمَّ مسحَ رأسَهُ بيديهِ فأقبلَ بهما وأدبرَ : بدأ بمقدَّمِ رأسِهِ حتى ذهبَ بهما إلى قفاهُ ، ثمَّ ردَّهما إلى المكانِ الذى بدأ منهُ ، ثمَّ غسلَ رِجلَيهِ

Të dhënët mes-h kokës (fshirja e kokës me dorë të lagët)

All-llahu i Madhërueshëm lidhur me këtë ka thënë:

"... dhe fshinie kokën me dorë të lagët...".

(el-Mâide, 6)

Ibni Musejjebi ka thënë: **"Gruaja është në pozitë të njëjtë me burrin, prandaj edhe ajo e fshin kokën e saj me dorë të lagët** (i bën mes-h kokës).

Maliku është pyetur: **"A është e mjaftueshme të laget vetëm një pjesë e kokës"?** Këtë e arsyetoi me Hadithin që e transmetoi Abdullah b. Zejdi.

185. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Maliku, këtij Amr b. Jahja el-Maziniu, ky nga babai i vet se një njeri e ka pyetur Abdullah b. Zejdin, e ky është gjyshi i Amr b. Jahjait:

A mund të më tregosh praktikisht si ka marrë abdest Pejgamberi s.a.v.s.?

Abdullah b. Zejdi iu përgjigj, "po", prandaj kërkoi një enë me ujë: derdhi ujë në duart e veta dhe i lau nga dy herë, pastaj e lau gojën dhe hundën nga tri herë, e lau fytyrën tri herë, i lau krahët deri në bërryla nga dy herë, pastaj, me duar të lagura, e fshiu kokën (i dha mes-h), **duke e lagur edhe para edhe prapa, duke filluar nga pjesa e parme e kokës**

(prej ku fillojnë flokët) **dhe i çoi deri** (afër) **te qafa, e pastaj i ktheu deri te vendi nga ia filloi dhe në fund i lau këmbët".**[50]

بَابُ غَسْلِ الرِّجْلَيْنِ إِلَى الْكَعْبَيْنِ

١٨٦ – حدثنا موسى قال حدثنا وُهَيْبٌ عن عمرو عن أبيه قال : شهدتُ عَمْرَو بنَ أبي حَسَنٍ سأل عبدَ اللهِ ابنَ زيدٍ عن وُضوءِ النبيِّ ﷺ ، فدعا بتَوْرٍ مِن ماءٍ فتوضأ لهم وُضوءَ النبيِّ ﷺ : فأكفأ على يدِه مِنَ التَّوْرِ فغسلَ يديه ثلاثًا ، ثم أدخلَ يدَهُ في التَّوْرِ فمضمضَ واستنشقَ واستنثرَ ثلاثَ غَرَفاتٍ ، ثم أدخلَ يدَهُ فغسلَ وجهَهُ ثلاثًا ، ثم غسلَ يديه مرتين إلى المِرْفَقَيْنِ ، ثم أدخلَ يدَهُ فمسحَ رأسَهُ فأقبلَ بهما وأدبرَ مرةً واحدةً ، ثم غسلَ رِجْلَيْهِ إلى الكَعْبَيْنِ

Larja e këmbëve deri në nyje

186. Na ka treguar Musai, këtij Vuhejbi, ky nga Amri, e ky nga babai i vet i cili ka treguar:

"Kam qenë te Amr b. Ebu Hasani kur Abdullah b. Zejdi e pyeti për abdestin e Pejgamberit s.a.v.s. (Për këtë arsye) **ai kërkoi një enë me ujë dhe para tyre mori abdest, ashtu siç kishte marrë Pejgamberi s.a.v.s.: në dorën e vet derdhi nga ena ujë dhe e lau tri herë, përsëri e futi dorën në enë** (dhe pasi mori ujë në pëllëmbë) **e lau gojën dhe hundën nga tri herë, duke e nxjerrë ujin jashtë, pastaj, përsëri e futi dorën në enë dhe e lau fytyrën tri herë, pastaj krahët i lau deri në bërryla nga dy herë. Përsëri e futi dorën në enë dhe, me dorën e lagur, e fshiu kokën** (i dha mes-h kokës) **para dhe prapa një herë dhe në fund i lau këmbët deri në nyje".**

---

50 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- gjatë marrjes abdest, së pari duhet të lahen duart dy-tri herë deri në nyje.
- Davud b. Xherir Taberiu këtë veprim e konsideron vaxhib, kurse Maliku dhe Ebu Hanifja, praktikë të përhershme të Pejgamberit a.s.

بابٌ استعمال فَضلِ وَضوءِ الناسِ . وأمرَ جَريرُ بنُ عبدِ اللهِ أهلَهُ أن يتوضَّؤوا بفَضلِ سِواكِهِ

١٨٧ — حدَّثنا آدمُ قال حدَّثنا شُعبةُ قال حدَّثنا الحكَمُ قال سمعتُ أبا جُحَيفةَ يقول : خَرَجَ علينا رسولُ اللهِ ﷺ بالهاجِرةِ ، فأُتِيَ بوَضوءٍ فتوضَّأَ ، فجعلَ الناسُ يأخُذونَ مِن فَضلِ وَضوئِهِ فيَتمسَّحونَ به ، فصلَّى النبيُّ ﷺ الظُّهرَ رَكعتَينِ ، والعصرَ رَكعتَينِ ، وبينَ يدَيهِ عَنزةٌ

Përdorimi i ujit të mbetur nga abdesti edhe për njerëzit e tjerë

Xherir b. Abdullah i ka urdhëruar anëtarët e familjes së vet të marrin abdest me ujin e mbetur pas misvakut (pas larjes së dhëmbëve).[51]

187. Na ka treguar Ademi, këtij Shu'be, këtij Hakemi, i cili ka dëgjuar nga Ebu Xhuhejfi, duke thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. ka ardhë te ne. I është sjellur ujë për abdest. Ai aty mori abdest, kurse njerëzit shpejtuan të marrin abdest me ujin e mbetur nga abdesti i tij dhe të stërpiken me të. Pejgamberi s.a.v.s. e fali drekën dy reqate, pastaj iqindinë dy reqate, e para tij (e nguli) **shkopin e tij** (sutren)".[52]

١٨٨ — وقال أبو موسى : دَعا النبيُّ ﷺ بقَدَحٍ فيهِ ماءٌ فغَسَلَ يدَيهِ وَوَجهَهُ فيه ، ومَجَّ فيه ، ثم قال لهما : اشرَبا منهُ ، وأفرِغا على وُجوهِكُما ونُحورِكما

188. Ebu Musai ka thënë: **"Pejgamberi s.a.v.s. ka kërkuar një enë me ujë, nga ajo** (enë) **i pastroi duart dhe fytyrën dhe nxori ujin nga goja, e pastaj i tha Ebu Musait dhe Bilalit:**

"Pini këtë ujë, derdhni në fytyrat tuaja dhe te gishtërinjtë tuaj"!

---

51 Nga kjo thënie shihet se uji në të cilin laget misvaku është i pastër.

52 Nga hadithi shihet se:
- uji i mbetur nga abdesti, nga i cili është marrë më parë me duar të lara, është i pastër dhe mund të përdoret për t'u pastruar;
- namazet farz prej katër reqatesh në udhëtim mund të shkurtohen në dy reqate;
- kur njeriu falet në vend të hapët, para vetes duhet të vendosë sutren - të ngulë shkopin ose të ngjashme.

١٨٩ — حدثنا عليُّ بنُ عبدِ اللهِ قال حدثنا يعقوبُ بن إبراهيمَ بنِ سعدٍ قال حدثنا أبي عن صالحٍ عنِ ابنِ شهابٍ قال : أخبرني محمودُ بنُ الربيعِ قال : وهُوَ الذي مجَّ رسولُ اللهِ ﷺ في وجهِهِ وهُوَ غُلامٌ من بئرِهم . وقال عُروةُ عنِ المِسْوَرِ وغيرِه يُصدِّقُ كلُّ واحدٍ منهما صاحبَه ، وإذا توضَّأ النبيُّ ﷺ كادُوا يقتتِلونَ على وَضوئِه

189. Na ka treguar Ali b. Abdullahu, këtij i ka treguar Ja'kub b. Ibrahim b. Sa'di, këtij babai i vet, këtij Salihu, ky nga Ibni Shihabi, i cili ka thënë: Më ka njoftuar Mahmud b. Rebiu, duke thënë se ai është që Pejgamberi s.a.v.s. e ka stërpik me ujë në fëtyrë nga pusi i tyre kur ai ishte fëmijë.

Urve transmeton nga Misveri dhe nga të tjerët dhe çdonjëri nga ata e vërteton deklaratën e vet:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. ka marrë abdest (në Hudejbi), **As-habët gati janë përlarë për ujin e mbetur të abdestit të tij".**

١٩٠ — حدثنا عبدُ الرحمٰنِ بنُ يونُسَ قال حدثنا حاتمُ بنُ إسماعيلَ عنِ الجُعْدِ قال : سمعتُ السائبَ ابنَ يزيدَ يقولُ : ذهبتْ بي خالتي إلى النبيِّ ﷺ فقالت : يا رسولَ اللهِ إنَّ ابنَ أختي وَجِعٌ ، فمسحَ رأسي ودعا لي بالبَرَكةِ . ثمَّ توضَّأ فشربتُ من وَضوئِه ، ثمَّ قمتُ خلفَ ظَهرِه فنظرتُ إلى خاتمِ النبوَّةِ بينَ كتفيهِ مثلَ زِرِّ الحَجَلةِ

190. Na ka treguar Abdu-r-Rahman b. Junusi, këtij Hatim b. Ismaili, ky nga Xha'di, i cili ka thënë:

"E kam dëgjuar Sa'id b. Jezidin duke thënë: Kemi shkuar me tejzen te Pejgamberi s.a.v.s. Ajo e pyeti: O Resulullah, djali i motrës sime është shëndetlig. Ai (Pejgamberi) **më përkdheli në kokë dhe u lut për mua. Pastaj mori abdest. Unë e piva ujin e mbetur nga abdesti i tij. Qëndrova pas tij dhe pashë në mes shpatullave të tij vulën e pejgamberisë, sikurse veza e thëllënzës".**[53]

---

53 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- ndaj fëmijëve duhet të jesh i butë dhe i mëshirshëm;
- uji i mbetur në enë nga abdesti dhe lagështia në lëkurën e pjesëve të pastruara të trupit është i pastër, kurse uji i cili ndahet nga trupi dhe bie në vend tjetër është i papastër për pastrim sipas sheriatit.

باب مَن مَضْمَضَ وَاسْتَنْشَقَ مِن غَرْفَةٍ واحدة

١٩١ — حدثنا مُسَدَّدٌ قال حدثنا خالدُ بنُ عبدِ اللهِ قال حدثنا عَمرو بنُ يحيى عن أبيهِ عن عبدِ اللهِ بنِ زيدٍ أنه أفرَغَ مِنَ الإناءِ على يدَيه فغَسَلَهما ، ثمَّ غَسلَ أو مَضْمَضَ واستنشَقَ مِن كَفَّةٍ واحدةٍ فعلَ ذلكَ ثلاثاً . فغَسَلَ يَدَيهِ إلى المِرْفَقَينِ مرتينِ مرتينِ ، ومَسَحَ برأسِهِ ما أقبَلَ وما أدبَرَ ، وغَسَلَ رِجلَيهِ إلى الكَعبَينِ ، ثمَّ قال : هكذا وُضوءُ رسولِ اللهِ ﷺ

Larja e gojës dhe e hundës më një grusht ujë

191. Na ka treguar Museddedi, këtij Halid b. Abdullahu, këtij Amr b. Jahjai, ky nga babai i vet, e ky nga Abdullah b. Zejdi, **i cili derdhi ujë nga ena në duart e tij dhe i lau** (i pastroi). **Pastaj e lau, gjegjësisht, e shpërlau gojën dhe hundën me një grusht ujë. Këtë e bëri tri herë. Pastaj i lau duart dhe krahët deri në bërryla dy herë, pastaj e fshiu kokën me dorë të lagur** (i dha mes-h) **para dhe prapa. Pastaj i lau këmbët deri në nyje dhe tha: "Ja, ky është abdesti i Pejgamberit s.a.v.s.".**[54]

باب مسحِ الرأسِ مرَّةً

١٩٢ — حدثنا سليمانُ بنُ حربٍ قال حدثنا وُهَيبٌ قال حدثنا عَمْرُو بنُ يحيى عن أبيهِ قال : شَهِدتُ عَمرَو ابنَ أبي حسَنٍ سَألَ عبدَ اللهِ بنَ زَيدٍ عن وُضوءِ النبيِّ ﷺ ، فدَعا بتَوْرٍ من ماءٍ فتَوضَّأ لهم ، فكَفَأَ على يدَيهِ فغَسَلَهما ثلاثاً ، ثمَّ أدخَلَ يدَه في الإناءِ فمَضْمَضَ واستَنْثَرَ ثلاثاً بثلاثِ غَرَفاتٍ من ماءٍ ثمَّ أدخَلَ يدَهُ في الإناءِ فغَسَلَ وَجهَهُ ثلاثاً ، ثمَّ أدخلَ يدَهُ في الإناءِ فغسلَ يَدَيهِ إلى المِرْفَقَينِ مرتينِ مرتينِ ، ثمَّ أدخلَ يدَهُ في الإناءِ فمسحَ برأسِهِ فأقبَلَ بيدَيهِ وأدبَرَ بهما ، ثم أدخَلَ يدَهُ في الإناءِ فغسلَ رِجلَيهِ

وحدثنا موسى قال حدثنا وُهَيبٌ قال : مَسحَ رأسَهُ مرَّةً

Fshirja e kokës me dorë të lagët (dhënia mes-h) një herë

192. Na ka treguar Sulejman b. Harbi, këtij i ka treguar Vuhejbi, këtij ia ka transmetuar Amr b. Jahjai, ky nga babai i vet, i cili ka thënë:

---

54 Shpërlarja e gojës dhe e hundës mund të bëhet me një grusht ujë. Pjesa tjetër e ujit në dorë pas shpërlarjes së gojës është i pastër për pastrim sipas sheriatit.

"Kam qenë aty kur Amr b. Ebu Hasani e pyeti Abdullah b. Zejdin për abdestin e Pejgamberit s.a.v.s. Ai kërkoi një enë me ujë dhe para tyre mori abdest: derdhi pak ujë në duart e tij dhe i lau ato (duart) **tri herë. Pastaj, e futi dorën në enë** (pasi mori një grusht ujë) **e shpërlau gojën dhe hundën dhe e nxori ujin përsëri nga ato** (goja dhe hunda), **e kështu veproi tri herë. Përsëri e futi dorën në enë** (mori një grusht ujë) **dhe e lau fytyrën tri herë, prapë mori ujë nga ena dhe i lau krahët deri në bërryla nga dy herë. Pastaj e futi dorën e tij në enë** (dhe pasi e lagu) **ashtu me dorë të lagur e fshiu kokën** (i dha mes-h) **para dhe prapa. Në fund e futi dorën përsëri në enë (mori ujë) dhe i lau këmbët".**

Na ka treguar edhe Musai, këtij Vuhejbi, i cili ka thënë: **"... i dha mes-h kokës vetëm një herë...".**[55]

بابٌ وُضوء الرجُلِ مع امرأتِهِ ، وفضلِ وَضوءِ المرأةِ . وتوضّأ عمرُ بالحميمِ مِن بَيتِ نَصرانيّةٍ

١٩٣ — حدّثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرَنا مالكٌ عن نافعٍ عن عبدِ اللهِ بنِ عُمرَ أنه قال : كان الرجالُ والنساءُ يَتوَضّؤُنَ فى زَمانِ رسولِ اللهِ ﷺ جميعًا

Marrja abdest e çiftit bashkëshortor (nga një enë) dhe uji i mbetur i abdestit të gruas.

Umeri ka marrë abdest me ujë të ngrohtë nga një shtëpi krishtere.[56]

---

55 Shafiitë mendojnë se është sunnet t'i japësh mes-h kokës tri herë. Këtë mendim ata e mbështesin në një hadith që e transmeton Tirmidhiu se Uthmani, duke marrë abdest, të gjitha pjesët e trupit i ka larë nga tri herë, prandaj edhe kokën e ka përshkuar me dorë të lagur tri herë.
Hanefitë, ndërkaq, duke u mbështetur në praktikën e shumicës së As-habëve konsiderojnë se kokën duhet përshkuar me dorë të lagur (duhet dhënë mes-h) vetëm një herë. Sa i përket rastit të Uthmanit këta mendojnë se ekziston mundësia që të jetë ndonjë transmetim i gabueshëm i transmetuesit.

56 Përdorimin e ujit të ngrohtë për abdest e lejonë të gjithë dijetarët, përveç Muxhahidit. Shumë As-habë kanë marrë abdest dhe janë larë me ujin e ngrohur nga zjarri. Esla' b. Sheriku kishte ejakuluar një natë të ftohtë dhe duke u frikuar nga të ftohtët, qe larë me ujë të ngrohtë. Ky rast ka qenë shkak i shpalljes së ajetit për të marrë tejemmum në vend të larjes.
Me ujë të ngrohtë ka marrë abdest shpesh Umeri, Eslem b. Ekve, Ibni Abbasi.
Lejohet të përdoret uji nga shtëpia e jomuslimanëve, ndërsa shfrytëzimi i enëve të

193. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij i ka treguar Maliku duke transmetuar nga Nafiu, e ky nga Abdullah b. Umeri i cili ka thënë:

"Burrat dhe gratë (bashkëshortët), **në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. kanë marrë abdest së bashku** (nga një enë)".[57]

بَابُ صَبِّ النَّبِيِّ ﷺ وَضُوءَهُ عَلَى مَنْ أُغْمِيَ عَلَيْهِ

١٩٤ – حَدَّثَنَا أَبُو الْوَلِيدِ قَالَ حَدَّثَنَا شُعْبَةُ عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ الْمُنْكَدِرِ قَالَ سَمِعْتُ جَابِرًا يَقُولُ: جَاءَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَعُودُنِي وَأَنَا مَرِيضٌ لَا أَعْقِلُ فَتَوَضَّأَ وَصَبَّ عَلَيَّ مِنْ وَضُوئِهِ، فَعَقَلْتُ، فَقُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ لِمَنِ الْمِيرَاثُ، إِنَّمَا يَرِثُنِي كَلَالَةً؟ فَنَزَلَتْ آيَةُ الْفَرَائِضِ

Stërpikja e Pejgamberit s.a.v.s. me ujin e mbetur të abdestit atij që i ka rënë të fikët.

194. Na ka treguar Ebu-l-Velidi, këtij i ka treguar Shu'be, ky nga Muhammed b. Munkediri, i cili e ka dëgjuar Xhabirin, duke thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. erdhi të më vizitojë, kur unë isha shumë i sëmurë, bile qeshë pa vetëdije. Ai mori abdest dhe më stërpiku me ujin e mbetur të abdestit të tij. Atëherë, rashë në mend dhe e pyeta: "O Resulullah, kujt i takon pasuria? Mua do të më trashëgojë vetëm fruti i largët". Pastaj është shpallur ajeti për të drejtën e trashëgimisë.[58]

---

kuzhinës së tyre konsiderohet gjë e përbuzur. Shafiu mendon se nuk është gjë e përbuzur, nëse dihet se ena përkatëse është e pastër dhe nëse në të nuk shihen gjurma të papastërtisë.

57 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- i lejohet mashkullit të marrë abdest me ujin nga ena nga e cila ka marrë gruaja (duke e shti dorën brenda në enë). Bashkëshortet e Pejgamberit a.s. kanë marrë abdest së bashku me të, nga një enë.

58 Xhabir b. Abdullahu nuk ka patur fëmijë (trashëgimtarë); ka pasë shtatë motra dhe shumë të afërm të tjerë. Pas bisedës që pati Muhammedi a.s. me të, iu shpall ajeti 176 i sures en-Nisâ, i cili në përkthim është:
"Ata (As-habët) kërkojnë nga ti fetfa (vendim). Thuaju: All-llahu u jep vendim për njeriun që nuk le trashëgimtar as prind e as fëmijë. Nëse vdes njeriu që nuk ka fëmijë, por ka motër, atëherë asaj i takon gjysma e pasurisë nga ajo që ka lënë ai, e ai e trashëgon atë nëse ajo nuk ka fëmijë. Nëse janë dy motra, ato trashëgojnë dy të tretat nga ajo që ka lënë ai. Në qofshin trashëgimtarët vëllezër e motra, atëherë mashkullit i takon trashëgim

بَابُ الغُسْلِ وَالوُضُوءِ فِي المِخْضَبِ وَالقَدَحِ وَالخَشَبِ وَالحِجَارَةِ

١٩٥ — حَدَّثَنَا عَبْدُ اللهِ بْنُ مُنِيرٍ سَمِعَ عَبْدَ اللهِ بْنَ بَكْرٍ قَالَ حَدَّثَنَا حُمَيْدٌ عَنْ أَنَسٍ قَالَ : حَضَرَتِ الصَّلاَةُ ، فَقَامَ مَنْ كَانَ قَرِيبَ الدَّارِ إِلَى أَهْلِهِ وَبَقِيَ قَوْمٌ ، فَأُتِيَ رَسُولُ اللهِ ﷺ بِمِخْضَبٍ مِنْ حِجَارَةٍ فِيهِ مَاءٌ ، فَصَغُرَ المِخْضَبُ أَنْ يَبْسُطَ فِيهِ كَفَّهُ ، فَتَوَضَّأَ القَوْمُ كُلُّهُمْ . قُلْنَا : كَمْ كُنْتُمْ ؟ قَالَ : ثَمَانِينَ وَزِيَادَةً

Larja dhe të marrët abdest nga korita, shtamba ose nga sahani i drurit ose i gurit

195. Na ka treguar Abdullah b. Muniri, këtij Abdullah b. Bekri, ky nga Humejdi e ky nga Enesi i cili ka thënë:

"Filloi koha e namazit dhe kush ishte afër shtëpisë së vet, u ngrit dhe shkoi në shtëpi, kurse të tjerët mbetën aty. Pejgamberit s.a.v.s. ia sollën një enë guri me ujë. Ena ishte aq e vogël sa që mezi e shtiu dorën në të. Megjithatë, të gjithë të pranishmit morën abdest nga ajo.

"E sa qetë" pyetëm, tha Humejdi.

"Më shumë se tetëdhjetë", u përgjigj Enesi.[59]

---

sa dy femra (motra). All-llahu ju shpjegon këto, që të mos humbni rrugën ju. Se All-llahu, me të vërtetë, di çdo gjë".

Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- ndikimi i prekshëm i njerëzve të famshëm në të sëmurin, nëse ai është i volitshëm për të;
- ndikimi i duasë (lutjes) së Muhammedit a.s. në Xhabirin e sëmurë;
- ta vizitosh të sëmurin, sidomos të varfërin është virtyt islam dhe te All-llahu xh.sh. vepër e pranueshme.

59 Nga hadithi del se:

- ena është e pastër, pavarësisht nga cili material është i përbërë, prandaj ajo mund të përdoret. Ibni Sirini thotë se Hulefa-i-r-Rashidinët kanë marrë abdest nga sahani, kurse Hasan Basriu e ka parë halifen Uthman duke e përdorur ibrikun prej bakri. Aishja ka thënë se Muhammedi a.s. nganjëherë ka marrë abdest nga kusia e kallaisur me bakër.

Shafiu, Is-haku dhe Ebu Thevriu e mendojnë gjë të përbuzur të merret abdest me enë prej ari ose prej argjendi. Ebu Hanifja, ndërkaq, mendon se nuk është e pëlqyeshme të hajë e të pijë nga enët prej ari dhe prej argjendi, kurse të merret abdest me to, lejohet.

١٩٦ — حدثنا محمدُ بنُ العَلاء قال حدَّثنا أبو أسامةَ عن بُرَيدٍ عن أبي بُردةَ عن أبي موسى أنَّ النبيَّ ﷺ دعا بِقَدَحٍ فيه ماء فغَسَلَ يدَيهِ ووَجهَهُ فيه ومَجَّ فيه

196. Na ka treguar Muhammed b. el-Alai, këtij Ebu Usame, ky nga Burejdi, ky nga Ebu Burejdi, ky nga Ebu Musai, i cili tregon **se Pejgamberi s.a.v.s. ka kërkuar një shtambë me ujë, në të cilën i lau duart, fytyrën dhe në të stërpiku** (e hodhi ujin).[60]

١٩٧ — حدثنا أحمدُ بنُ يونُسَ قال حدَّثنا عبدُ العزيزِ بنُ أبي سَلَمةَ قال حدَّثنا عمرُو بنُ يَحيى عن أبيهِ عن عبدِ اللهِ بنِ زيدٍ قال: أتى رسولُ اللهِ ﷺ. فأخرَجْنا له ماء في تَورٍ مِن صُفْرٍ، فتوَضَّأ، فغَسَلَ وجهَهُ ثلاثاً، ويدَيهِ مرَّتينِ مرَّتين، ومَسحَ برأسِهِ فأقبَلَ به وأدبَرَ، وغَسلَ رِجلَيهِ

197. Na ka treguar Ahmed b. Junusi, këtij Abdu-l-Aziz b. Ebu Seleme, këtij Amr b. Jahjai nga babai i vet, e ky nga Abdullah b. Zejdi, i cili ka thënë:

"Erdhi te ne Pejgamberi s.a.v.s. e ne i nxorëm ujë në një enë prej bronzi. Ai mori abdest; e lau fytyrën tri herë, duart dhe krahët (deri në bërryla) **nga dy herë, kokën e fshiu me dorë të lagur** (i bëri mes-h), **duke e bërë atë para dhe prapa, kurse këmbët i lau".**

60 Mund të merret abdest me ujin nga ena në të cilën është stërpikur, respektivisht në enën në të cilën është stërpikur uji nga goja e njëriut të shëndoshë. Uji i tillë sipas sheriatit është i pastër dhe mund të përdoret për pastrim.

١٩٨ - حدثنا أبو اليمان قال أخبرنا شعيب عن الزهري قال أخبرني عبيد الله بن عبد الله بن عتبة أن عائشة قالت : لما ثقل النبي ﷺ واشتد به وجعه استأذن أزواجه في أن يمرض في بيتي ، فأذن له . فخرج النبي ﷺ بين رجلين تخط رجلاه في الأرض ، بين عباس ورجل آخر - قال عبيد الله : فأخبرت عبد الله بن عباس فقال : أتدري من الرجل الآخر ؟ قلت : لا . قال : هو علي - وكانت عائشة رضي الله عنها تحدث أن النبي ﷺ قال بعد ما دخل بيته واشتد وجعه ، هريقوا علي من سبع قرب لم تحلل أوكيتهن ، لعلي أعهد إلى الناس ، وأجلس في مخضب لحفصة زوج النبي ﷺ ، ثم طفقنا نصب عليه تلك حتى طفق يشير إلينا أن قد فعلتن . ثم خرج إلى الناس

198. Na ka treguar Ebu-l-Jemani, këtij i ka thënë Shu'be, ky nga Zuhriu, i cili ka thënë: më ka lajmëruar Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe se Aishja ka thënë:

"Kur Pejgamberit s.a.v.s. i ka rënduar sëmundja dhe i është keqësuar shëndeti, kërkoi leje nga bashkëshortet e tij që të dergjë në dhomën time. Ato e lejuan dhe Pejgamberi s.a.v.s. doli duke e tërhequr këmbën rrëshqanë, e duke u mbështetur në dy njerëz: në Ibni Abbasin dhe në një mashkull tjetër".

Ubejdullahu e pyeti: **"A e di kush qe ai tjetri"?**

"Jo", i thashë.

"Ai qe Aliu", u përgjigj ai.

Aishja tregoi se kur Pejgamberi s.a.v.s. hyri në dhomën e saj, edhe sëmundja iu keqësua. Pejgamberi s.a.v.s. tha:

Më lagni nga shtatë kacekë (shakuj, calike) **të vegjël, gjalmat e të cilëve ende nuk janë zgjidhur, që njerëzve të mund t'u jap udhëzim.**

Atëherë, e kanë ulur në koritën e Hafses, bashkëshorte e Pejgamberit s.a.v.s., dhe filluam ta lagim nga ata kacekë të vegjël, derisa filloi të na thotë mjaft. Pastaj doli para njerëzve (dhe mbajti fjalim).[61]

---

61 Të lagurit me ujë të ftohtë nga calikët e pazgjidhur ndikoi pozitivisht te Muhammedi a.s., prandaj ai doli para masës dhe u mbajti fjalim. Muhammedi a.s. kërkoi ujë pikërisht

باب الوضوء من التور

١٩٩ - حدثنا خالد بن مخلد قال حدثنا سليمان قال حدثني عمرو بن يحيى عن أبيه قال : كان عمي يكثر من الوضوء ، قال لعبد الله بن زيد : أخبرني كيف رأيت النبي ﷺ يتوضأ ؟ فدعا بتور من ماء فكفأ على يديه فغسلهما ثلاث مرار ، ثم أدخل يده في التور فمضمض واستنثر ثلاث مرات من غرفة واحدة ، ثم أدخل يده فاغترف بها فغسل وجهه ثلاث مرات ، ثم غسل يديه إلى المرفقين مرتين مرتين ، ثم أخذ بيديه ماء فمسح رأسه فأدبر به وأقبل ، ثم غسل رجليه قال : هكذا رأيت النبي ﷺ يتوضأ

Të marrët abdest nga ena (me ujë) - qypi

199. Na ka treguar Halid b. Mahledi, këtij i ka treguar Sulejmani ky nga Amr b. Jahjai, ky nga babai i vet, i cili ka thënë:

"Axha im rregullisht merrte abdest, prandaj Abdullah b. Zejdit i tha: Më trego si e ke parë Pejgamberin s.a.v.s. duke marrë abdest. Atëherë ai kërkoi një enë me ujë - një qyp. Derdhi (nga ena) **ujë në duart e veta dhe i lau tri herë. Pastaj e futi dorën në enë dhe me nga një** (grusht - pëllëmbë) **ujë e shpërlau gojën dhe hundën tri herë. Përsëri e futi dorën në enë** (mori ujë) **dhe i lau duart** (me krahët) **deri në bërryla, nga du herë. Pastaj, e futi dorën** (përsëri në enë) **dhe ashtu me dorë të lagët e fshiu kokën** (bëri mes-h), **duke e çuar dorën para e prapa kokës. Në fund i lau edhe këmbët dhe tha: "Kështu e kam parë Pejgamberin s.a.v.s. duke marrë abdest".**

---

nga shtatë calikë, për shkak respekti të numrit "shtatë", që vjen si shprehje në shumë rregulla islame dhe në disa lloje të krijimit të All-llahut xh.sh.

Numri "shtatë" është numër tek dhe si i tillë bie në grupin të cilit i takon numri tek "një" që është simbol i ekzistimit të All-llahut xh.sh., prandaj meriton respekt të veçantë. Është e dëshirueshme t'u jepet përparësi edhe të gjithë numrave tek.

Nga hadithi nxirret përfundimi:

- të rinjve duhet t'u jepen këshilla vazhdimisht, prandaj, edhe kur je i sëmurë;
- është e dobishme që të sëmurin ta lagësh me ujë të ftohtë dhe t'i vësh lecka (fasha) të ftohta;
- popullariteti i Aishes;
- sëmundja e rëndë e Muhammedit a.s. krahasohet me përgjegjësinë e madhe të pozitës së tij në këtë botë dhe shpërblimin e madh në botën tjetër.

٢٠٠ — حدثنا مُسَدَّدٌ قال حدثنا حَمَّادٌ عن ثابتٍ عن أنسٍ أنَّ النبيَّ ﷺ دعا بإناءٍ من ماءٍ ، فأُتِيَ بقَدَحٍ رَحْراحٍ فيه شيءٌ من ماءٍ ، فوضعَ أصابعَهُ فيه ، قال أنسٌ فجعلتُ أنظرُ إلى الماءِ يَنبُعُ من بينِ أصابعِهِ . قال أنسٌ فحزَزْتُ مَن توضَّأَ ما بينَ السَّبعينَ إلى الثمانينَ

200. Na ka treguar Museddedi, këtij Hammadi, këtij Thabiti, e ky nga Enesi, i cili tregon se Pejgamberi s.a.v.s. kërkoi një enë me ujë. ia sollën një kavanoz të gjerë në të cilin kishte pak ujë. Ai i shtiu gishtërinjtë në të. Enesi thotë:

"Kam vënë re sesi rridhte uji përmes gishtave të tij. Kam llogaritur se kishte aty shtatëdhjet-tetëdhjetë njerëz që merrnin abdest nga ajo enë".

بابُ الوُضوءِ بالمُدِّ

٢٠١ — حدثنا أبو نُعَيمٍ قال حدثنا مِسْعَرٌ قال حدثني ابنُ جَبْرٍ قال سمعتُ أنَسًا يقول : كان النبيُّ ﷺ يُغسِلُ — أو كان يَغتَسِلُ — بالصاعِ إلى خمسةِ أمدادٍ ، ويَتوضَّأُ بالمُدِّ

Të marrët abdest me një mudd (me ujë)

201. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi këtij i ka treguar Mis'ari, ky nga Ibni Xhebri, i cili e ka dëgjuar Enesin duke thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. pastrohej, ose lahej me një "sâ'" ujë, kurse merrte abdest me një "mudd" ujë".[62]

62 Muhammedi a.s. është larë së paku me një "sâ'" me ujë, e nganjëherë me një "sâ'" dhe me një litër ujë. Një "sâ'" i ka 8 litra ujë, sipas mednimit të Ebu Hanifes dhe Muhammedit. Muhammedi a.s. ka marrë abdest me një "mudd", e cila, sipas Ebu Hanifes i ka 2 litra ujë. "Mudd", sipas Sami Frashërit i ka plot dy grushta me ujë.

بَابُ الْمَسْحِ عَلَى الْخُفَّيْنِ

٢٠٢ - حدثنا أَصْبَغُ بْنُ الْفَرَجِ الْمِصْرِيُّ عَنِ ابْنِ وَهْبٍ قَالَ حَدَّثَنِي عَمْرٌو وَحَدَّثَنِي أَبُو النَّضْرِ عَنْ أَبِي سَلَمَةَ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمٰنِ عَنْ عَبْدِ اللهِ بْنِ عُمَرَ عَنْ سَعْدِ بْنِ أَبِي وَقَّاصٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ مَسَحَ عَلَى الْخُفَّيْنِ، وَأَنَّ عَبْدَ اللهِ بْنَ عُمَرَ سَأَلَ عُمَرَ عَنْ ذٰلِكَ فَقَالَ: نَعَمْ، إِذَا حَدَّثَكَ شَيْئاً سَعْدٌ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ فَلَا تَسْأَلْ عَنْهُ غَيْرَهُ

وَقَالَ مُوسَى بْنُ عُقْبَةَ: أَخْبَرَنِي أَبُو النَّضْرِ أَنَّ أَبَا سَلَمَةَ أَخْبَرَهُ أَنَّ سَعْداً . . . فَقَالَ عُمَرُ لِعَبْدِ اللهِ نَحْوَهُ

Dhënia mes-h (të lagurit) mbi meste (mbathje)

202. Na ka treguar Esbeg b. Ferexh el-Misriu, duke transmetuar nga Ibni Vehbi, këtij Amri, këtij Ebu Nadri, ky nga Ebu Seleme b. Abdu-r-Rahmani, ky nga Abdullah b. Umeri, ky nga Sa'd b. Ebu Vekkasi, i cili tregon se Pejgamberi s.a.v.s. i ka fshi mestet me dorë të lagur (u ka bërë mes-h). Abdullah b. Umeri e ka pyetur Umerin lidhur me këtë. Ai është përgjigjur: **"Po, sepse, kur Sa'di të transmeton diçka nga Pejgamberi s.a.v.s., atëherë, për atë çështje mos pyet tjetër** (është shumë i sigurtë)".

Edhe Musa b. Ukbe ka thënë: "Më ka njoftuar Ebu Nadri, këtë Ebu Seleme, se rastin e sipërshënuar ia ka treguar Sa'di, duke thënë se Umeri, gjithashtu, ia ka treguar Abdullahut.[63]

٢٠٣ - حدثنا عَمْرُو بْنُ خَالِدٍ الْحَرَّانِيُّ قَالَ حَدَّثَنَا اللَّيْثُ عَنْ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ عَنْ سَعِيدِ بْنِ إِبْرَاهِيمَ عَنْ نَافِعِ ابْنِ جُبَيْرٍ عَنْ عُرْوَةَ بْنِ الْمُغِيرَةِ عَنْ أَبِيهِ الْمُغِيرَةِ بْنِ شُعْبَةَ عَنْ رَسُولِ اللهِ ﷺ أَنَّهُ خَرَجَ لِحَاجَتِهِ فَاتَّبَعَهُ الْمُغِيرَةُ بِإِدَاوَةٍ فِيهَا مَاءٌ فَصَبَّ عَلَيْهِ حِينَ فَرَغَ مِنْ حَاجَتِهِ، فَتَوَضَّأَ وَمَسَحَ عَلَى الْخُفَّيْنِ

63 Fshirja e mesteve me dorë të lagur (dhënia mes-h) pranohet nga të gjitha shkollat juridike islame, përveç nga harixhinjtë. Hasan Basriu thotë se i ka mbajtur në mend 70 As-habë, pjesëmarrës në luftën e Bedrit, të cilët u kanë dhënë mes-h mesteve. Ebu Hanifja ka thënë se këtë qëndrim e ka përkrahur mu atëherë kur e ka kuptuar mirë. Kerbiu thotë se ai që e mohon këtë del nga Feja Islame.
- kishte As-babë që disa gjëra nuk i kishin kuptuar në mënyrë të qartë;
- deklarata e ndonjërit, të cilën e kanë përkrahur As-habët, është e vlefshme edhe për muslimanët tjerë.

203. Na ka treguar Amr b. Halid el-Haraniu, këtij ia ka transmetuar Lejthi, këtij Jahja b. Se'idi, këtij Sa'd b. Ibrahimi, ky nga Nafi' b. Xhubejri, ky nga Urve b. Mugire, e ky nga babai i vet, Mugire b. Shu'be r.a., i cili transmeton **se Pejgamberi s.a.v.s. ka dalë për të kryer nevojën, kurse Mugirja e ka përcjellur, duke mbajtur një enë të vogël prej lëkure me ujë. Kur Pejgamberi s.a.v.s. e kreu nevojën, Mugirja i shtiu ujë dhe ai mori abdest. Mestet, ndërkaq, i fshiu me dorë të lagur** (u dha mes-h)".[64]

٢٠٤ – حدثنا أبو نعيم قال حدثنا شيبانُ عن يحيى عن أبي سَلَمَةَ عن جَعفرِ بنِ عَمرِو بن أُمَيَّةَ الضَّمْرِيِّ أن أباهُ أخبرَهُ أنَّهُ رأى النبيَّ ﷺ يَمسَحُ عَلَى الخُفَّينِ . وتابعَهُ حَربُ بنُ شَدَّادٍ وأبانُ عن يحيى

204. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi, këtij Shejbani, ky nga Ebu Seleme, ky nga Xha'fer b. Amr b. Umejje ed-Damriu, e këtë e ka njoftuar babai i vet se **Pejgamberi s.a.v.s. i ka fshirë mestet** (mbathjen) **me dorë të lagur.**

Hadithin e sipërshënuar e transmeton edhe Harb b. Sheddadi dhe Ebani, ky nga Jahjai.

٢٠٥ – حدثنا عَبدانُ قال أخبرَنا عبدُ اللهِ قال أخبرَنا الأوزاعيُّ عن يحيى عن أبي سَلَمَةَ عن جَعفرِ بنِ عَمرٍو عن أبيهِ قال : رأيتُ النبيَّ ﷺ يَمسحُ على عِمامتِهِ وخُفَّيهِ . وتابعَهُ مَعمَرٌ عن يحيى عن أبي سَلَمَةَ عن عَمرٍو قال : رأيتُ النبيَّ ﷺ

205. Na ka treguar Abdani, këtij Abdullahu, këtij Evzaiu, ky nga Jahjai, ky nga Ebu Seleme, ky nga Xha'fer b. Amri, e ky nga babai i vet, i cili ka thënë:

"E kam parë Pejgamberin s.a.v.s. kur i jepte mes-h sarrëkut dhe mesteve të veta".

---

64 Stërgjyshët e Amr b. Halidit ishin nga qyteti i lashtë i Haranit, i cili shtrihet në mes Eufratit dhe Tigrit. Atëbotë, ky ishte një qytet i madh, vendlilndja e Ibrahimit a.s. dhe Jusufit a.s. Keramaniu mendon se këtë qytet e ka themeluar Nuhi a.s. kur doli nga anija, e sipas disa të tjerëve, Harani, daja i Jakubit a.s. dhe se lagjja quhet sipas emrit të tij.

Ma'meri pajtohet me Evzaiun, duke transmetuar këtë rast nga Jahjai, ky nga Ebu Seleme, e ky nga Amri, i cili thotë: **"E kam parë Pejgamberin s.a.v.s...."**.[65]

بَابُ إِذَا أَدْخَلَ رِجْلَيْهِ وَهُمَا طَاهِرَتَانِ

٢٠٦ – حَدَّثَنَا أَبُو نُعَيْمٍ قَالَ حَدَّثَنَا زَكَرِيَّاءُ عَنْ عَامِرٍ عَنْ عُرْوَةَ بْنِ الْمُغِيرَةِ عَنْ أَبِيهِ قَالَ : كُنْتُ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ فِي سَفَرٍ ، فَأَهْوَيْتُ لأَنْزِعَ خُفَّيْهِ فَقَالَ « دَعْهُمَا ، فَإِنِّي أَدْخَلْتُهُمَا طَاهِرَتَيْنِ » فَمَسَحَ عَلَيْهِمَا

Veshja e mesteve me këmbë të pastërta

206. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi, këtij Zekerijai, ky nga Amri, ky nga Urve b. Mugire, ky nga babai i vet, i cili ka treguar:

"Kam qenë me Pejgamberin s.a.v.s. në një ekspeditë. Desha që t'ia heq mestet, por ai më tha: "Lëreni, sepse i kam veshur me këmbë të pastra (me abdest)"! **Dhe, vetëm i përshkoi me duar të lagura** (u dha mes-h).[66]

---

65 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- dhënia mes-h mesteve është vepër e rregulluar me sheriat;
- dhënia mes-h sarrëkut me dorë të lagur nuk është e argumentuar sa duhet. Imam Ahmedi lejon t'i jepet mes-h sarrëkut, po qe se ai është vënë në kokë derisa njeriu ka qenë me abdest, pikërisht sikur dhënia mes-h mesteve. Ndërsa, juristët tjerë islamë, duke u mbështetur në ajet, këtë nuk e lejojnë.
Autori i "Mugnisë" lejon t'i jepet mes-h sarrëkut vetëm nën këto kushte:
a. që sarrëku të mbulojë tërë kokën deri nën mjekër;
b. të pambuluara mund të jenë ato pjesë që zakonisht nuk mbulohen si p.sh. balli, hunda, goja.
- dhënia mes-h nëpër kapelat e zakonshme nuk është e lejueshme. Nuk lejohet as dhënia mes-h në shaminë e mbështjellur, shallin e grave dhe nëpër pëlhura të ngjashme, sepse gruaja lehtë mund t'i zgjidhë e t'i mënjanojë skajet e mbështjellësve të tillë dhe kështu, sipas rregullit të caktuar, t'i japë mes-h kokës.

66 Ky rast ka ndodhur në muajin rexheb të viti 9 hixhri, në kohën e ekspeditës ushtarake në Tebuk.
Nga hadithi mund të vihet në përfundim:
- dhënia mes-h mesteve (përshkuarja me dorë të lagur) bëhet vetëm nëse ato janë veshur duke qenë me abdest. Këtë veprim udhëtari mund ta bëjë tri ditë e tri net, kurse të tjerët (që nuk jan udhëtar) vetëm një ditë e një natë, duke e llogaritur atë nga koha kur e ka prishur abdestin, e sipas mendimit të shafiive, nga momenti kur vishen mestet pas marrjes

باب مَن لم يَتوضأ من لحمِ الشاةِ والسَّويقِ
وأكلَ أبو بكرٍ وعُمرُ وعثمانُ رضيَ اللهُ عنهم فلم يَتوضَّئوا

٢٠٧ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسفَ أخبرنا مالكٌ عن زيدِ بنِ أسلمَ عن عَطاءِ بنِ يَسارٍ عن عبدِ اللهِ بنِ عباسٍ أنَّ رسولَ اللهِ ﷺ أكلَ كتِفَ شاةٍ ثمَّ صلَّى ولم يَتوضأ

Abdesti nuk përsëritet për shkak të ngrënies së mishit të deles dhe qullit (kaçamakut)

Ebu Bekri, Umeri dhe Uthmani r.a. kanë ngrënë dhe nuk e kanë përsëritur abdestin.

207. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Maliku, ky nga Zejdi b. Eslemi, ky nga Ata b. Jesari, ky nga Abdullah b. Abbasi, **i cili tregon se Pejgamberi s.a.v.s. ka ngrënë mish nga shpatulla e deles dhe pastaj e fali namazin, por nuk e përsëriti abdestin.**

٢٠٨ – حدثنا يحيى بنُ بُكيرٍ قال حدثنا الليثُ عن عُقيلٍ عن ابنِ شهابٍ قال أخبرني جعفرُ بنُ عمرِو ابنِ أميَّةَ أنَّ أباهُ أخبرَهُ أنه رأى رسولَ اللهِ ﷺ يَحتزُّ من كتِفِ شاةٍ ، فدُعِيَ إلى الصلاةِ فألقى السِّكينَ فصلَّى ، ولم يَتوضأ

208. Na ka treguar Jahja b. Bukejri, këtij i ka treguar Lejthi, ky nga Ukajli, ky nga Ibni Shihabi, i cili tregon se e ka njoftuar Xhafer b. Amr b. Umejje se e ka njfotuar babai i vet se **Pejgamberin s.a.v.s., kur ishte duke prerë mishin e shpatullës së deles, e thirrën për namaz. E hodhi thikën dhe fali namazin, kurse abdestin nuk e përsëriti.**[67]

---

së abdestit.

67 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- nuk përsëritet abdesti pas ngrënies së ushqimit;
- lejohet prerja (grimcimi) i mishit të pjekur me thikë;
- është e pëlqyeshme të njoftohet posaçërisht imami për fillimin e kohës së namazit.

بابُ مَن مَضْمَضَ مِنَ السَّوِيقِ ولم يَتوضَّأْ

٢٠٩ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرَنا مالكٌ عن يحيى بنِ سَعيدٍ عن بُشَيرِ بنِ يَسارٍ مولىٰ بني حارثةَ أنَّ سُوَيدَ بنَ النُّعمانِ أخبرَهُ أنه خَرَجَ مع رسولِ اللهِ ﷺ عامَ خَيبَرَ حتّى إذا كانوا بالصَّهباءِ – وهيَ أدنىٰ خَيبَرَ – فصلَّى العصرَ ثمَّ دَعا بالأزوادِ فلم يُؤتَ إلاّ بالسَّوِيقِ، فأمرَ بهِ فثُرِّيَ، فأكلَ رسولُ اللهِ ﷺ وأكلنا، ثم قامَ إلى المغربِ فمَضمَضَ ومَضمَضْنا، ثمَّ صلَّى ولم يَتوضَّأْ

(Shpër)larja e gojës pas ngrënies së qullit dhe mospërsëritja e abdestit

209. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij i ka treguar Maliku, këtij Jahja b. Se'idi, ky nga Bushejr b. Jesari, rob i liruar i Beni Harithes, ky nga Suvejd b. Nu'mani, i cili tregon se **Pejgamberi s.a.v.s. dhe ai, gjatë përgatitjes së aksionit luftarak për në Hajeber, kanë dalë, dhe, kur kanë arritur në Sahba' , në anën e poshtme të Hajberit, Pejgamberi s.a.v.s. e fali namazin e iqindisë. Pastaj, kërkoi ushqim dhe nga ushqimi që e kërkoi i sollën vetëm miell të pjekur. Pastaj, ai urdhëroi që ai të laget me ujë. Hëngri Pejgamberi s.a.v.s., por edhe ne. Mandej, u ngrit të falë akshamin, duke e larë gojën ai, por edhe ne. U falëm, kurse abdestin nuk e përsëritëm.**

٢١٠ – حدثنا أصبَغُ قال أخبرَنا ابنُ وهبٍ قال أخبرَني عَمرٌو عن بُكَيرٍ عن كُرَيبٍ عن مَيمونةَ أنَّ النبيَّ ﷺ أكلَ عندَها كَتِفاً، ثم صلَّى ولم يَتوضَّأْ

210. Na ka treguar Esbegu, këtij Ibni Vehbi, ky nga Amr b. Bukejri, ky nga Kurjebi, e ky nga Mejmunja, e cila tregon se **Pejgamberi s.a.v.s. ka ngrënë te ajo mish nga shpatulla dhe pastaj ka falë namazin, por nuk e ka përsëritur abdestin.**[68]

---

68 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- rekomandohet larja e gojës pas çdo ushqimi. Larja e gojës ka rëndësi të posaçme higjienike;
- pas ushqimit nuk duhet të përsëritet abdesti;
- lejohet ushqimi i përbashkët i bashkudhëtarëve. Dashamirësia dhe bashkimi i forcës është mëshirë e All-llahut xh.sh. dhe pikërisht këtu qëndron forca e madhe dhe përparimi

باب هل يُمَضْمِضُ مِنَ اللَّبَنِ

٢١١ – حدثنا يحيى بنُ بُكَيرٍ وقُتَيبةُ قالا حدثنا الليثُ عن عُقَيلٍ عن ابنِ شِهابٍ عن عُبَيدِ اللهِ بنِ عبدِ اللهِ بنِ عُتبةَ عن ابنِ عباسٍ أن رسولَ اللهِ ﷺ شَرِبَ لبناً فَمَضْمَضَ وقال « إنَّ لهُ دَسَماً »
تابعَهُ يونُسُ وصالحُ بنُ كَيْسانَ عن الزُّهريِّ

A duhet të shpërlahet goja pas (pirjes së) qumështit

211. Na ka treguar Jahja b. Bukejri dhe Kutejbe, këtyre Lejthi, ky nga Ukajli, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe, ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë se **Pejgamberi s.a.v.s. ka pirë qumësht, pastaj e ka shpërlarë gojën dhe ka thënë:**

"Qumështi përmban në vete yndyrë".

Në sendin tjetër të hadithit, Ukajli nga Junusi dhe Salih b. Kejsani, duke transmetuar nga Zuhriu.[69]

باب الوُضوءِ مِنَ النَّومِ ، ومَن لم يرَ مِنَ النُّعسَةِ والنُّعستينِ أو الخَفْقَةِ وُضوءاً

٢١٢ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرَنا مالكٌ عن هِشامٍ عن أبيهِ عن عائشةَ أن رسولَ اللهِ ﷺ قال « إذا نَعَسَ أحَدُكُم وهوَ يُصَلِّي فلْيَرْقُدْ حتى يَذهَبَ عنه النومُ ، فإنَّ أحَدَكُم إذا صلَّى وهوَ ناعِسٌ لا يَدرِي لَعَلَّهُ يَستَغفِرُ فيَسُبُّ نَفسَه »

Të merret abdest pas fjetjes

Këtë duhet ta bëjë edhe ai i cili nuk e ka parë të nevojshme ta përsërisë abdestin për shkak të një ose dy kotjeve ose lëkundjeve të kokës.

---

i shoqërisë;
Mahallebiu (lexo: Mahal-lebiu) konsideron se qeveritari ka të drejtë që në ditët e krizës ushqimore t'i urdhërojë shitësit ta shesin ushqimin me çmime më normale;
- ushqimi së pari u jipet më nevojtarëve dhe atyre që janë të furnizuar më pak.

69 Porostitet shpërlarja e gojës pas pirjes së qumështit dhe lëngjeve nga të cilat mund të mbetet mbeturina nëpër dhëmbë, ose në anët e gojës. Shembëllyeshëm me këtë, duhet të lahen duart para dhe pas buke.

212. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Maliku, ky nga Hishami, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Kur ndokush prej jush kotet duke falur namazin, le të bijë të flejë derisa t'i kalojë kotja (plogështia), **sepse çdonjëri prej jush, nëse falet duke u kotur, nuk e di, ndoshta, duke kërkuar falje, e urren dhe e mallkon veten".**

٢١٣ – حدثنا أبو مَعْمَرٍ قال حدثنا عبدُ الوارثِ حدثنا أيوبُ عن أبي قِلابةَ عن أنسٍ عنِ النبيِّ ﷺ قال « إذا نَعَسَ أحدُكم في الصلاةِ فليَنَمْ حتى يَعلمَ ما يقرأ »

213. Na ka treguar Ebu Ma'meri, këtij i ka treguar Abdu-l-Varithi, këtij Ejjubi, ky nga Ebu Kilabe, ky nga Enesi: se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Nëse dikush nga ju kotet në namaz, le të flejë, derisa të jetë në gjendje të kuptojë se çka po lexon".[70]

باب الوُضوءِ من غيرِ حَدَثٍ

٢١٤ – حدثنا محمدُ بنُ يوسُفَ قال حدثنا سُفيانُ عن عَمرِو بنِ عامرٍ قال : سمعتُ أنساً . ح

قال وحدثنا مُسَدَّدٌ قال حدثنا يحيى عن سُفيانَ قال حدثني عمرُو بنُ عامرٍ عن أنسٍ قال : كان النبيُّ ﷺ يتوضأُ عندَ كلِّ صلاةٍ . قلتُ : كيفَ كنتم تصنعونَ ؟ قال : يُجزِئُ أحدَنا الوُضوءُ ما لم يُحدِثْ

Marrja e abdestit pa paraqitjen e "hadethit" (element që e prish abdestin)

214. Na ka treguar Muhammed b. Jusufi, këtij i ka thënë Sufjani, ky nga Amr b. Amiri, ky nga Enesi, e sipas senedit tjetër, na ka treguar Museddedi, këtij Jahjai, këtij Sufjani, këtij Amr b. Amiri, ky nga Enesi, i cili ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. merrte abdest për çdo namaz".

---

70 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- personi i përgjumshëm duhet të ndërpresë namazin në ndenjën e parë, duke dhënë selam, e pastaj të shtrihet të flejë. Pasi të çohet nga gjumi, duhet ta përsërisë abdestin dhe ta falë namazin në kohë të duhur dhe në gjendje të kthjelltë dhe të vetëdijshme;
- kotja nuk e prish abdestin, por abdestin e prish gjumi i vërtetë;
- në namaz mund të lexohen tekste të ndryshme nga Kur'ani dhe në gjendje të kthjelltë.

"E, si keni vepruar ju"? e pyeta.

"Për ne ishte i mjaftueshëm abdesti i mëparshëm derisa nuk kishte ndonjë element të prishjes së tij".[71]

---

71 Këtë hadith e shpjegojnë në mënyra të ndryshme. Një grup i zahirive dhe shiive dhe disa As-habë, mendojnë se personi i cili nuk është udhëtar, duhet të marrë abdest për çdo namaz. Këtë mendim këta e mbështesin edhe te deklarata e Ebu Hurejres, i cili thotë se Muhammedi a.s. ka marrë abdest për çdo namaz farz, e vetëm në ditën e çlirimit të Mekkes, si udhëtar, i ka falur pesë namazet farz të ditës me një abdest.
Ibrahim Nehaiu mendon se me një abdest mund të falen më së shumti pesë namaz farze (sipas radhitjes së tyre).
Mendimi i pjesës dërrmuese të juristëve islamë të të katër shkollave (medhhebeve) dhe i shumicës së As-habëve është që abdesti nuk është i domosdoshëm të përsëritet për asnjë namaz vijues, përderisa njeriut nuk i paraqitet diçka që ia prish abdestin që e ka marrë më herët. Këta mbështeten në ajetin me të cilin kërkohet të merret abdest për faljen e namazit, nëse personi nuk ka marrë më herët.
Tahaviu mbështet në hadithin e sipërshënuar, duke theksuar se Muhammedi a.s. nuk ka marrë abdest për çdo namaz për shkak se është detyrim, por vetëm për shkak se është më mirë dhe për shëndetin më e dobishme. Tehaviu duke transmetuar nga Abdullah b. Umeri, ka thënë se Muhammedi a.s. është shprehur: "... atë që merr abdest mbi abdest, All-llahu xh.sh. do ta shpërblejë dhjetëfish". Për këtë arsye, fetarët e mëdhenj marrin abdest për çdo namaz posaçërisht, pavarësisht që kanë pasë prej më herët.
Tahaviu tërheq vërejtjen edhe me hadithin që e transmeton Enes b. Maliku, i cili është shprehur se me abdest mund të falen më shumë namaze. Ndoshta në ditët e para të paraqitjes së Islamit duhej të merrej abdest për çdo namaz veçanërisht, thotë Tahaviu, e kjo më vonë është deroguar. Në këtë supozim na udhëzon deklarata e Esmasë, vajza e Zejd b. Hattabit:
"Pejgamberi a.s. na urdhëroi të marrim abdest për çdo namaz (farz) veçanërisht, pavarësisht se personi ka pasë a nuk ka pasë abdest prej më parë. Mirëpo, kur e vërejti se kjo është e mundimshme, urdhëroi që para se të fillojë namazi të pastrohet me misvak vetëm goja".
Përtërirja e abdestit për çdo namaz është virtyt i lartë i muslimanëve, sepse me një abdest mund të falen disa namaze.

٢١٥ – حدثنا خالدُ بنُ مَخلَدٍ قال حدَّثنا سُليمانُ قال حدَّثني يحيى بنُ سَعيدٍ قال أخبرَني بُشَيرُ بنُ يَسارٍ قال أخبرَني سُوَيدُ بنُ النُّعمانِ قال : خَرَجْنا مع رسولِ اللهِ ﷺ عامَ خَيبرَ حتى إذا كنَّا بالصَّهباءِ صلَّى لنا رسولُ اللهِ ﷺ العصرَ ، فلمَّا صلَّى دَعا بالأطعمةِ فلم يُؤْتَ إلاَّ بالسَّوِيقِ ، فأكلنا وشربنا ، ثم قامَ النبيُّ ﷺ إلى المَغرِبِ فمَضمَضَ ثمَّ صلَّى لنا المَغرِبَ ، ولم يَتوَضَّأْ

215. Na ka treguar Halid b. Mahledi, këtij Sulejmani, këtij Jahja b. Se'idi, këtij Bushejr b. Jesari, ky nga Suvejd b. Nu'mani, i cili ka thënë:

" Në vitin e çlirimit të Hajberit, kemi dalur me Pejgamberin s.a.v.s., e kur gjindeshim në Sahba, Pejgamberi s.a.v.s. e fali namazin e iqindisë, së bashku me ne, e pasi u fal, kërkoi ushqim. I sollën vetëm qull (kaçamak)**. Hëngrëm dhe pimë, e pastaj Pejgamberi s.a.v.s. u ngrit të falë namazin e akshamit. E shpërlau vetëm gojën dhe na e fali namazin, ndërkaq, abdestin nuk e përsëriti.**

باب بيانِ الكبائرِ أنْ لا يَستَتِرَ من بولِهِ

٢١٦ – حدثنا عثمانُ قال حدَّثنا جَريرٌ عن مَنصورٍ عن مُجاهدٍ عن ابنِ عبَّاسٍ قال : مَرَّ النبيُّ ﷺ بحائطٍ من حِيطانِ المدينةِ – أو مكةَ – فسمِعَ صوتَ إنسانَينِ يُعذَّبانِ في قُبورِهما ، فقال النبيُّ ﷺ « يُعذَّبانِ ، وما يُعذَّبانِ في كَبيرٍ – ثم قال – بَلَى ، كان أحدُهما لا يَستَتِرُ من بولِهِ ، وكان الآخَرُ يَمشي بالنَّمِيمةِ » ثم دَعا بجَريدةٍ فكَسَرَها كِسرَتَينِ ، فوَضَعَ على كلِّ قبرٍ منهما كِسرَةً . فقيلَ له : يا رسولَ اللهِ لِمَ فعلتَ هذا ؟ قال « لعلَّهُ أنْ يُخفَّفَ عنهما ما لم تَيبَسا » أو « إلى أنْ يَيبَسا »

Të mos ruhesh nga urina (shurra) është nga mëkatet e mëdha

216. Na ka treguar Uthmani, këtij Xheriri, ky nga Mensuri, ky nga Muxhahidi, ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. ka kaluar pranë një muri nga muret e Medines, ose të Mekkes dhe ka dëgjuar zërin e dy personave të cilët vuanin në varret e tyre.

Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. tha: **"Janë në mundime, jo për shkak të ndonjë shkelje të rëndë"**, dhe vazhdoi: **"njëri prej tyre nuk është ruajtur nga shurra e tij, e tjetri ka folë gënjeshtra** (ka bërë shpifje)". Pastaj, kërkoi

një degë të hurmës, e theu në dy pjesë dhe, në çdo varr, e vuri nga një pjesë. Ne e pyetëm: **"O Resulullah, pse veprove ashtu"?** Ai na u përgjigj: **"Ndoshta ato do t'ua lehtësojnë** (mundimet) **derisa të thahen".**[72]

---

72 Në këtë hadith shihet pesha dhe domosdoshmëria e pastërtisë së trupit dhe të teshave edhe jashtë namazit. Mosruajtja nga shurra dhe nga nevoja e madhe deri-diku numërohet nga gjynahet e mëdha dhe muslimani i ndyrë me këto nuk mund t'i lutet All-llahut xh.sh., e si i tillë nuk është i mirëpritur edhe në shoqëri.

Buhariu dhe Muslimi theksojnë se Muhammedi a.s. ka thënë:

- Largohuni nga shtatë lloj të këqijave!

- Cilat janë ato, o Resulullah? pyeti njëri.

- Besimi në shumë zotëra, mbytja e njerëzve pa të drejtë, veprimtaria e fallxhorit, përdorimi dhe ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimëve, largimi nga fronti i luftës, shpifja ndaj muslimanes së ndershme.

Disa muhaddithë, hadithit të lartpërmendur i shtojnë edhe: ... mosdëgjimi i prindërve dhe përlyerja e Qabesë".

Ajniu *mendon se fjala gjynah* i madh është nocion i parëndësishëm. Nganjëherë shkelja e vogël e rregullave në raport me të tjerat mund të jetë e madhe dhe e nasjellta. Një nga As-habët i ka thënë Ibni Abbasit se ka shtatë lloj të gabimeve të mëdha, e ai i është përgjigjur:

- Po, shtatë, bile edhe shtatëdhjetë lloj.

Dënimi në varr është realitet. Ky është mendim dhe qëndrim i shkollave burimore islame. Bejhekiu thotë: "Sprovën në varr do ta hetojë çdo njeri, kurse dënimin e vërtetë do ta përjetojnë pabesimtarët dhe munafikët". Keramiu thekson se shpirti nuk është e domosdoshme të kthehet në trupin e të vdekurit që ta ndjejë dhembjen e dënimit. Të vdekurit këtë mund ta hetojnë edhe pa kurrfarë lidhjeje me gjallërimin.

Dhembjet e të vdekurit dhe situatën në varr njerëzit e gjallë të kësaj bote nuk mund t'i kuptojnë, ashtu siç nuk mund të vërehet përjetimi i mundimshëm i njeriut, i cili në gjumë sheh ëndërra të frikshme dhe të tmerrshme. Këtë e ndjen vetëm ai që ëndërron, e ne e kuptojmë atë vetëm kur na e përshkruan personi se çfarë mundimesh ka përjetuar.

Shurra e njeriut është e papastër. Stërpikjen e trupit ose të teshave me shurrën e njeriut në masën e dinarit (parasë) Ebu Hanifja e lejon, kurse dijetarët e Kufes, sa një pikë e imët si maja e gjilpërës.

Te dijetarët e shkollës malikite vlen rregulli: shurra dhe nevoja e madhe e njeriut janë papastërti të kategorisë së rëndë, e kafshët, mishi i të cilave, sipas sheriatit lejohet të hahet, janë të pastra, kurse kafshët, mishi i të cilave nuk është e lejueshme të hahet, janë të papastra dhe prej tyre duhet të ruhemi.

Gjaku i kujtdo qoftë, bën pjesë në kategorinë e papastërtisë së rëndë, përveç gjakut të menstruacioneve në tesha, në masën e dinarit (parasë).

Shumica e dijetarëve mendojnë se vepra e mirë dhe fetare e bërë para të vdekurit është e dobishme për të vdekurin, kurse Neveviu dhe dijetarët e shkollës shafiite mbajnë

بابٌ ما جاء في غسلِ البولِ

وقال النبيُّ ﷺ لصاحبِ القبرِ : كان لا يستترُ من بولِه . ولم يذكرْ سوى بولِ الناسِ

٢١٧ — حدثنا يعقوبُ بنُ إبراهيمَ قال حدثنا إسماعيلُ بنُ إبراهيمَ قال حدثني رَوحُ بنُ القاسمِ قال حدثني عطاءُ بنُ أبي ميمونةَ عن أنسِ بنِ مالكٍ قال : كانَ النبيُّ ﷺ إذا تبرَّزَ لحاجتِه أُتيتُه بماءٍ فيَغسِلُ به

Çka thuhet për larjen e shurrës

Pejgamberi s.a.v.s. për njeriun në varr ka thënë se nuk është ruajtur nga shurra e tij. Ai ka përmendur vetëm shurrën e njeriut.

217. Na ka treguar Ja'kub b. Ibrahimi, këtij i ka thënë Ismail b. Ibrahimi, këtij Revh b. Kasimi, këtij Ata b. Ebu Mejmune, ky nga Enes b. Maliku, i cili ka thënë:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. doli për nevojat e tij fiziologjike unë ia solla ujin, e ai u pastrua me të".

---

qëndrimin se ajo është e dobishme dhe sevap vetëm për të gjallin.

Njeriut i takon vetëm ajo që e bën vetë, vetëm se rrugët e realizimit të veprave të mira janë të llojllojshme: nganjëherë një vepër e mirë mund të bëhet personalisht, e nganjëherë me ndërmjetësimin e të tjerëve në të cilët ka bërë ndikim të madh. Kështu, fëmijët e edukuar me falënderim do t'i luten All-llaht për prindët dhe edukatorët e tyre. Ata u kanë borxh prindërve të tyre për mundin që e kanë dhënë ata gjatë kohës së tyre. Duaja (lutja) e trashëgimtarëve të tillë, fundja, është edhe duaja e tyre, ajo është prodhim i aktivitetit të edukatorit.

Shpërblimi për ndarjen e sadakasë, lënia vakuf dhe veprat tjera të mira dhe të dobishme, i llogariten atij në emër të të cilit dedikohen.

Në librin "Kitabu-l-kâdi" të Ebu-l-Husejn b. Ferexhit, theksohet se Enesi e ka pyetur Muhammedin a.s.:

- O Resulullah, nëse ne ndajmë sadaka për të vdekurit tanë ose bëjmë për ta haxhillëk ose lutemi për ata, a do t'u arrijë shpërblimi atyre?

- Po, - qe përgjigjur Muhammedi a.s. - Ajo i gëzon ata, sikurse që ju gëzon juve pjata plot me ushqim.

Të ruhesh nga papastërtia është detyrim (farz). Larja me ujë është pastrimi më ideal, e vetëm në rast mungese të ujit mund të përdoren gurët dhe mjetet tjera të përshtatshme.

٢١٨ – حدثنا محمدُ بنُ المُثنَّى قال حدَّثنا محمدُ بن خازمٍ قال حدَّثنا الأعمشُ عن مُجاهدٍ عن طاوُسٍ عن ابنِ عبّاسٍ قال : مرَّ النبيُّ ﷺ بقبرَينِ فقال « إنَّهما لَيُعذَّبان ، وما يُعذَّبانِ فى كبيرٍ : أمّا أحدُهما فكانَ لا يَستَتِرُ منَ البولِ ، وأمّا الآخرُ فكانَ يَمشى بالنَّميمةِ » ثمَّ أخذَ جَريدةً رَطبةً فشقَّها نِصفينِ ، فغرَزَ فى كلِّ قبرٍ واحدةً . قالوا : يا رسولَ اللهِ لِمَ فعلتَ هذا ؟ قال « لعلَّه يُخفَّفُ عنهما ما لم ييبسا »

قال ابنُ المُثنَّى : وحدَّثنا وَكيعٌ قال حدَّثنا الأعمشُ قال : سمعتُ مُجاهداً مِثلَه

218. Na ka treguar Muahmmed b. Muthennai, këtij i ka thënë Muhammed b. Hazimi, këtij A'meshi, ky nga Muxhahidi, ky nga Tavusi, e ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. kaloi pranë dy varrezave dhe tha:

"Ata të dy, me të vërtetë, janë në mundime, por nuk vuajnë për shkak të ndonjë shkelje të rëndë; njëri prej tyre nuk është ruajtur nga shurra e vet, e, sa i përket tjetrit, ai ka bartur fjalë (ka bërë shpifje duke gënjyer)". Pastaj, mori një degë të njomë, e theu (e nadu) në dy pjesë dhe, në të dy varret nguli nga një prej tyre. E pyetën: **"O Resulullah, pse veprove kështu"?** Ai u përgjigj: **"Ndoshta, derisa të thahen ato, do t'u zbutet** (lehtësohet) **mundimi".**

Ibni Muthennai dhe Vekiu tregojnë se e kanë dëgjuar A'meshin duke thënë: E kam dëgjuar Muxhahidin duke transmetuar të njëjtin tekst.

باب ترك النبيِّ ﷺ والناسِ الأعرابيَّ حتى فرَغ من بولِه فى المسجدِ

٢١٩ – حدثنا موسى بنُ إسماعيلَ قال حدَّثنا هَمّامٌ أخبرَنا إسحاقُ عن أنسِ بنِ مالكٍ أنَّ النبيَّ ﷺ رأى أعرابيًّا يَبولُ فى المسجدِ فقال : دَعوهُ . حتى إذا فَرَغَ دَعا بِماءٍ فصَبَّهُ عليه

Pejgamberi s.a.v.s. dhe të pranishmit e lanë të qetë beduinin të shurret në xhami derisa u shurr

219. Na ka treguar Musa b. Ismaili, këtij Hemmami, këtij Is-haku, këtij Enesi se Pejgamberi s.a.v.s. një ditë e pa një beduin duke e bërë shurrën në xhami. Me këtë rast tha:

"Lëreni atë"!, e kur mbaroi së shurruri, Pejgamberi s.a.v.s. kërkoi ujë dhe e derdhi në vendin që ishte me shurrë.[73]

باب صب الماء على البول في المسجد

٢٢٠ — حدثنا أبو اليمان قال أخبرنا شعيب عن الزهري قال أخبرني عبيد الله بن عبد الله بن عتبة بن مسعود أن أبا هريرة قال: قام أعرابي فبال في المسجد، فتناوله الناس، فقال لهم النبي ﷺ «دعوه، وهريقوا على بوله سجلا من ماء - أو ذنوبا من ماء - فإنما بعثتم ميسرين، ولم تبعثوا معسرين».

---

73 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- toka e fëlliqur me ndyrësinë e njeriut, bëhet e pastër posa të lahet, derisa ajo papastërti zhduket dhe e pi toka.

Ebu Hanife mendon se terreni i fortë, i rrafshë me ndyrësinë e tillë bëhet i pastër sapo të shtihet pak në dhe e pastaj të shpërlahet me ujë. Ai e mbështet këtë në hadithin që e transmetoi Tavusi dhe As-habët tjerë: "Një beduin u shurr në xhami dhe As-habët deshën ta sulmojnë".

- Lërëni atë! u tha Muhammedi a.s. Groponi atë vend dhe derdhni një kovë ujë mbi të! Mësoni njerëzit, lehtësoni, e mos i vështërsoni punët". (...)

- xhamitë duhet të ruhen nga çfarëdo papastërtie. Muhammedi a.s. në rastin e sipërpërmendur e thirri dhe i tha beduinit: "Xhamia nuk është vend për t'u shurrur dhe vend për kryerjen e nevojës, por vend për t'u lutur dhe për të mësuar Kur'an". Nga shprehja "për të mësuar Kur'an", nënkuptohet çdo mësim shkencor i dobishëm për njerëzit, vend për mbajtjen e këshillave, studimeve dhe për të kryer vepra të tjera fetare".

Shafiu, Ibni Musejjebi, Hasani dhe Atai lejojnë edhe të flihet në xhami, ndërsa, sipas mendimit të Evzaiut kjo është vepër e përbuzur.

Ibni Abbasi ka thënë: "Mos i ktheni xhamitë në vende fjetjeje"!

E, në një rast ka thënë: "Nëse të zë gjumi në xhami, duke pritur kohën e namazit, atëherë nuk ka gjynah".

Imam Ahmedi, Aliu, Ibni Umeri dhe shumë As-habë lejojnë që udhëtarët të kalojnë natën në xhami, por mos ta shfrytëzojnë si konak të përhershëm.

Lejohet të merret abdest në xhami, nëse ka kushte.

Lejohet ndenja në xhami: t'i shtrish këmbët ose të ulesh rrafsh;

- çdo musliman e ka për detyrë ta udhëzojë të padituritn në punë të mira, e ta largojë nga punët e këqija dhe të pahijshme;

- nga të gjitha të metat, duhet larguar, në radhë të parë ato nga të cilat janë më të dëmshme dhe më shkatërrimtare;

- ndaj njerëzve të paditur duhet të jesh i zellshem, i kujdesshëm dhe çdo punë duhet të thjeshtohet e jo të ngatërrohet;

- vepra e keqe duhet të largohet, posa të hetohet ajo.

Larja e shurrës me ujë në xhami

220. Na ka treguar Ebu-l-Jemani, këtij Shu'ajbi, ky nga Zuhriu, ky nga Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe b. Mes'udi, i cili ka dëgjuar Ebu Hurejren, duke thënë:

"Një person u ngrit dhe u shurr në xhami. Njerëzit u vërsulën kah ai, kurse Pejgamberi s.a.v.s. u tha: "Lëreni! por në shurrën e tij hudhni ujë të pastër ose një kovë ujë. Jeni të dërguar vetëm t'i lehtësoni, e jo t'i vështirësoni punët".

٢٢١ – حدثنا عبدانُ قال أخبرنا عبدُ اللهِ قال أخبرنا يحيى بنُ سَعيدٍ قال سمعتُ أنسَ بنَ مالكٍ عنِ النبيِّ ﷺ
باب : يُهريقُ الماءَ عَلَى البولِ * وحدثنا خالدٌ . قال وحدثنا سليمانُ عن يحيى بنِ سَعيدٍ قال : سَمعتُ أنسَ بنَ
مالكٍ قال : جاء أعرابيٌّ فبالَ في طائفةِ المسجدِ ، فزجَرَهُ الناسُ ، فنهاهُمُ النبيُّ ﷺ . فلمَّا قضَى بولَهُ أمرَ النبيُّ ﷺ
بذَنوبٍ منْ ماءٍ فأُهريقَ عليه

221. Na ka treguar Abdani, këtë e ka njftuar Abdullahu, këtë Jahja b. Se'idi, i cili ka thënë:

"E kam dëgjuar Enes b. Malikun, që transmeton nga Pejgamberi s.a.v.s...."

Derdhja e ujit në vendin me shurrë

221a. Na ka treguar edhe Halidi, këtij Sulejmani, ky nga Jahja b. Se'idi, i cili ka thënë, se e ka dëgjuar Enes b. Malikun duke thënë:

"Erdhi një person dhe u shurr në një skaj të xhamisë. Njerëzit filluan ta ndjekin atë, por Pejgamberi s.a.v.s. këtë ua ndaloi. Kur e kreu nevojën ai, Pejgamberi s.a.v.s. urdhëroi që në atë vend me shurrë të derdhet një kovë me ujë".

بابُ بَولِ الصِّبيانِ

٢٢٢ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يُوسفَ قال أخبرنا مالكٌ عن هِشامِ بنِ عُروةَ عن أبيهِ عن عائشةَ أمِّ المؤمنينَ
أنَّها قالتْ : أتَى رسولُ اللهِ ﷺ بصبيٍّ فبالَ عَلَى ثوبِهِ ، فدَعا بماءٍ فأتبَعَهُ إيَّاه

Shurra e fëmijës

222. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij i ka treguar Maliku, këtij Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja - nëna e besimtarëve - e cila ka thënë:

"E sollën një fëmijë te Pejgamberi s.a.v.s.. Ai iu shurr në tesha (Pejgamberit), **e Pejgamberi s.a.v.s. kërkoi vetëm ujë dhe e pastroi atë pjesë që ishte me shurrë".**[74]

---

74 Sipas mendimit të dijetarëve të shkollës shafiite, tesha që e shurr fëmija në gji (foshnja) nuk ka nevojë të fërkohet e të shtrydhet, por vetëm të derdhet ujë mbi të. Neveviu pohon se nuk ka kundërthënie në mes juristëve lidhur me shurrën e fëmijës, por vetëm për metodat e pastrimit të teshave të bëra me shurrë. Pikëpamjet më kryesore të juristëve të shkollës shafiite janë tri:

a. shurra e foshnjës mashkull mund të pastrohet me stërpikjen, respektivisht me derdhjen e ujit mbi sipërfaqen e lëndës së shurrur, kurse shurra e foshnjës femër largohet me larjen e lëndës së shurrur, sikurse çdo papastërti tjetër;

b. sipërfaqja e lëndës së shurrurr si nga foshnja mashkull si nga foshnja femër pastrohet vetëm duke derdhur ujë mbi të;

c. lënda e shurrur nga foshnja patjetër duhet të lahet me ujë.

Shafiu, Ahmedi, Is-haku dhe Ebu Thevriu, përveç hadithëve të përfshirë te Buhariu, mbështeten edhe në hadithe të tjerë, si: "Lënda e shurrur nga foshnja femër duhet të fërkohet dhe të lahet me ujë, kurse lënda e shurrur nga foshnja mashkull mundet vetëm të laget (të derdhet ujë mbi te)" dhe "Larja (duke e fërkuar) e lëndës bëhet vetëm për shkak të shurrës së foshnjës femër, kurse lënda e shurrur nga foshnja mashkull vetëm laget me ujë".

Ebu Hanife dhe Maliku nuk bëjnë kurrfarë dallimi në mes lëndës së shurrur nga foshnja femër dhe nga foshnja mashkull. Këtë mendim e mbështesin edhe: Ibrahim Nehaiu, Seid b. Musejjebi, Sufjan Thevriu dhe shumë bashkëkohanik të tyre. Këta e pranojnë besnikërinë e shprehjeve "ned-hun", "sabbun" dhe nganjëherë "reshshun", të cilat kanë kuptim "stërpik derdh, lag" me ujë vendin e bërë me shurrë. Megjithatë, këto shprehje arabët nganjëherë i përdorin me kuptim "gaslun", d.m.th. "laj dhe shpërlaj me ujë". Këtë e vërtetojnë edhe shumë hadithe. Ebu Davudi dhe Buhariu theksojnë se Mikdad b. Esvedi, pas sugjerimit të Aliut, e pyeti Pejgamberin s.a.v.s. se çka duhet bërë pas paraqitjes së mezisë (lëngut të paraqitur para polucionit).

- Nëse dikujt nga ju i ndodh ajo, le të bëjë "ned-h" sipërfaqen e hapur të organit gjenital, d.m.th. le ta pastrojë, e pastaj le të marrë abdest", u përgjigj Muhammedi a.s.

Buhariu, duke transmetuar rastin e njëjtë në Sahihun e tij, në vend të fjalës "ned-hun",

٢٢٣ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال : أخبرنا مالكٌ عن ابنِ شِهابٍ عن عُبَيدِ اللهِ بنِ عبدِ اللهِ بنِ عُتبةَ عن أمِّ قَيسٍ بنتِ مِحصَنٍ أنَّها أتتْ بابنٍ لها صَغيرٍ لم يأكُلِ الطعامَ إلى رسولِ اللهِ ﷺ فأجلَسَهُ رسولُ اللهِ ﷺ في حِجرِهِ، فبالَ على ثوبِهِ، فدعا بماءٍ فنضَحَهُ ولم يَغسِلْهُ

223. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtë e ka lajmëruar Maliku, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe, ky nga Ummu Kajs b. Mihsani, **se kjo ia solli Pejgamberi s.a.v.s. fëmijën e saj të vogël** (foshnjën) **që ende nuk kishte filluar të hajë ushqim** (gjellë). **Pejgamberi s.a.v.s. e mori atë në krah, por ai iu shurr në tesha. Atëherë, Pejgamberi s.a.v.s. kërkoi ujë dhe e derdhi në atë pjesë të teshave, por nuk e lau.**[75]

بابُ البولِ قائمًا وقاعدًا

٢٢٤ – حدثنا آدمُ قال حدثنا شُعبةُ عنِ الأعمشِ عن أبي وائلٍ عن حُذيفةَ قال : أتى النبيُّ ﷺ سُباطةَ قومٍ فبالَ قائمًا، ثم دعا بماءٍ، فجئتُه بماءٍ فتوضأَ

Të shurrurit duke qenë në këmbë dhe ulur

224. Na ka treguar Ademi, këtij Shu'be, këtij A'meshi, ky nga Ebu Vaili, e ky nga Hudhejfe, i cili ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. iu afrua një grumbulli të bërllokut, u shurr duke qëndruar në këmbë, e pastaj kërkoi ujë. Unë ia solla dhe ai mori abdest".[76]

---

e përdori fjalën "gaslun", që do të thotë "laj me ujë". Me këtë e vërtetoi qartazi qëndrimin e juristëve të shkollës hanefite.

Edhe fjala "reshshun" shpeshherë përdoret me kuptimin "laj". Këto janë kuptime të përgjithshme të këtyre fjalëve, prandaj, do të ishte më e sigurtë dhe më logjike të kuptohen si të përgjithshme.

75 Nga hadithi del se:
- vendi që e shurrë fëmija duhet të lahet, pavarësisht nga gjinia e foshnjës;
- sjellja e mirë ndaj fëmijëve është virtyt i lartë islam. Ai që nuk ka mëshirë ndaj të rinjve, nuk i takon mesit tonë, ka thënë Muhammedi a.s.;
- fëmijës duhet t'i vihet emri i bukur.

76 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- shurra mund të bëhet duke qëndruar pupas, ose në këmbë. Sipas Malikut nuk është e

باب البول عندَ صاحبِهِ ، والتَّستُّرِ بالحائطِ

٢٢٥ - حدثنا عثمانُ بنُ أبي شَيبَةَ قال حدثنا جَرِيرٌ عن مَنصورٍ عن أبي وائلٍ عن حُذَيفَةَ قال : رأيتُني أنا والنبيُّ ﷺ نَتماشى ، فأتى سُباطَةَ قومٍ خَلفَ حائطٍ ، فقامَ كما يقومُ أحدُكم فبال ، فانتبذتُ منه ، فأشارَ إليَّ بإصبَعِه ، فجئتُه ، فقمتُ عندَ عَقِبِه حتى فَرَغَ

Kryerja e nevojës së vogël duke u strehuar pas shokut ose pas murit

225. Na ka treguar Uthman b. Ebu Shejbe, këtij i ka treguar Xheriri, këtij Mensuri, ky nga Ebu Vaili, e ky nga Ebu Hurejre, i cili ka treguar:

"Sikur po e shoh veten dhe Pejgamberin s.a.v.s. kur ishim duke ecur. Ai iu afrua një grumbulli të një bërllogu pas gardhit (murit)**. Aty qëndroi dhe e kreu nevojën e vogël, ashtu siç do të vepronte çdonjëri prej jush. Unë u largova nga ai, e ai më sinjalizoi të afrohem. Unë erdha dhe qëndrova pas tij derisa e kreu nevojën e vogël.**[77]

باب البولِ عند سُباطةِ قومٍ

٢٢٦ - حدثنا محمد بن عَرْعَرَةَ قال حدثنا شُعبةُ عن مَنصورٍ عن أبي وائلٍ قال : كان أبو موسى الأشعريُّ يُشَدِّدُ في البولِ ويقولُ : إنَّ بني إسرائيلَ كانَ إذا أصابَ ثوبَ أحدِهم قَرَضَهُ . فقال حُذيفَةُ : ليتَهُ أمسَكَ ، أتى رسولُ اللهِ ﷺ سُباطةَ قومٍ فبالَ قائماً

---

pëlqyeshme që, pa ndonjë arsye, të shurresh prej në këmbë. Këtë qëndrim e përkrahin shumë dijetarë. Këta thonë se Muhammedi a.s. është shurrur prej në këmbë, sepse nuk ka mundur të ulet pupas, për shkak të mbeturinave të shumta dhe me qëllim që të ruhet nga stërpikja e shurrës.

Ibni Mundhiri ka thënë: "Për mua është më e përshtatshme të shurrem duke qëndruar pupas, por është e lejueshme edhe prej në këmbë".

Aishja i ka thënë Esvedit: "Kushdo që të thotë ty se Muhammedi a.s. është shurrur prej në këmbë, mos i beso, sepse unë e kam parë se ai shurrej prej ulur".

Abdullah b. Umeri ka thënë se Muhammedi a.s. e ka parë Umerin duke u shurrur prej në këmbë, prandaj i ka thënë: "O Umer, mos ashtu".

Edhe njëri edhe tjetri qëndrim i kanë arsyet e veta.

77 Nga hadithi shihet se:

- gjatë kryerjes së nevojës së vogël duhet qëndruar pas një perdeje.

Kryerja e nevojës së vogël pranë grumbullit të mbeturinave

226. Na ka treguar Muhammed b. Ar'are, këtij ia ka transmetuar Shu'be, ky nga Mensuri, ky nga Ebu Vaili, i cili ka thënë:

"Ebu Musa el-Esh'ariu ka qenë shumë i ashpër ndaj shurrës dhe thoshte se Israelitët, kur u binte shurrë në teshat e tyre, e prenin atë pjesë të teshës ku kishte rënë shurra".

Hudhejfja ka thënë: **"Ku të ishte fati, që Musa Esh'ariu t'i përmbahej kësaj! Pejgamberi s.a.v.s. erdhi pranë një grumbulli të mbeturinave dhe e kreu nevojën e vogël** (e bëri shurrën) **duke qëndruar në këmbë".**[78]

باب غسل الدم

٢٢٧ – حدثنا محمد بن المثنى قال حدثنا يحيى عن هشام قال حدثتني فاطمة عن أسماء قالت : جاءت امرأة النبي ﷺ فقالت : أرأيت إحدانا تحيض في الثوب كيف تصنع ؟ قال « تحته ثم تقرصه بالماء وتنضحه وتصلي فيه »

Larja e gjakut

227. Na ka treguar Muhammed b. Muthennai, këtij i ka treguar Jahjai, ky nga Hishami, ky nga Fatimja e kjo nga Esmaja, e cila ka treguar:

Erdhi te Pejgamberi s.a.v.s. një grua dhe e pyeti: **"Ç'mendon, kur ndonjë nga ne ka gjurmë gjaku të menstruacioneve në tesha, si të veprojë"?**

"Ta largojë atë njollë, pastaj, ta lajë me ujë, e pastaj të falet me të", iu përgjigj.[79]

---

78 Ebu Musa Eshariu është dijetar i njohur islam. Ai aq është ruajtur nga stërpikja e shurrës saqë me vete ka mbajtur vazhdimisht një shishe. Një herë, duke shkuar rrugës, e pa një njeri duke u shurrur prej në këmbë. I tha atij: "Mjerë ti që nuk je ulur pupas"! Pastaj ia tregoi zakonet e izraelitëve dhe e vazhdoi udhëtimin. Ai i është përmbajtur hadithit në mënyrë të përpiktë.

Muhammedi a.s. u ka thënë shokëve të vet: "A e dini ju se me çka kanë qenë të ngarkuar Musai dhe izraelitët" ata kanë qenë të detyruar ta presin atë pjesë të teshës në të cilën binte shurra, e kush nuk e bënte këtë, ka qenë i dënuar në varrin e tij".

79 Shafiu dhe Ibni Vehbi mendojnë se edhe një pikë gjaku në tesha duhet të lahet me ujë,

٢٢٨ — حدثنا محمد قال حدثنا أبو معاوية حدثنا هشام بن عروة عن أبيه عن عائشة قالت : جاءت فاطمة ابنة أبي حبيش إلى النبي ﷺ فقالت : يا رسول الله ، إني امرأة أستحاض فلا أطهر ، أفأدع الصلاة ؟ قال رسول الله ﷺ « لا . إنما ذلك عرق ، وليس بحيض . فإذا أقبلت حيضتك فدعي الصلاة ، وإذا أدبرت فاغسلي عنك الدم ثم صلي » قال : وقال أبي « ثم توضئي لكل صلاة حتى يجيء ذلك الوقت »

228. Na ka treguar Muhammedi, këtij Ebu Muavija, këtij Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

Erdhi te Pejgamberi s.a.v.s. Fatime b. Ebu Hubejshi dhe e pyeti:

"O Resulullah, unë jam grua me gjakderdhje të shpeshta të menstruacioneve (me hajz) **dhe nuk mund të pastrohem, prandaj, a ta lë namazin"?**

Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj asaj:

"Jo, (mos e lë)**; ai është gjak i kapilareve, e nuk është menstruacion** (hajz)**. Kur do të paraqitet ty menstruacioni, lëre namazin, e kur të ndërpritet, pastroje gjakun nga trupi yt dhe, atëherë, falu"!**

Babai im (thotë Hisham b. Urve) ka thënë dhe: **"Merr abdest për çdo namaz, kur të fillojë koha e tij".**[80]

---

kurse Ebu Hurejre mban qëndrim se një a dy pika gjak nga menstruacionet nuk janë pengesë për faljen e namazit.

Ibni Umeri e shtrydhi puçrrën nga fytyra e vet, nga e cila i doli një pikë gjak. Ai e fshiu vetëm me gisht atë dhe menjëherë e fali namazin.

Aliu dhe Ibni Mes'udi mendojnë se gjaku që del (shpërndahet në masë të dinarit), nuk e pengon faljen e namazit. Këtë mendim e mbajnë edhe dijetarët e shkollës hanefite.

Gjaku që rrjedh është i papastër dhe ai duhet patjetër të evitohet plotësisht nga lënda. Lënda, sidoqoftë, mund të përdoret pasi të lahet mirë nga gjaku.

80 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- i lejohet femrës të kërkojë dituri dhe për të të diskutojë me mashkullin;
- gruaja me menstruacione nuk mund të falet. Gruaja duhet të lahet menjëherë pas kryerjes së menstruacioneve, respektivisht pas ndërprerjes së gjakderdhjes. Shtyrja e larjes nuk lejohet.

باب غَسلِ المَنِيِّ وفَرْكِهِ ، وغَسْلِ ما يُصيبُ من المرأة

٢٢٩ — حدثنا عبدانُ قال أخبرنا عبدُ اللهِ قال أخبرنا عَمرُو بنُ مَيمونٍ الجَزَرِيُّ عن سُلَيمانَ بنِ يَسارٍ عن عائشةَ قالت « كنتُ أغسِلُ الجَنابةَ مِن ثَوبِ النبيِّ ﷺ ، فيَخرُجُ إلى الصلاةِ وإنَّ بُقَعَ الماءِ في ثَوبِهِ »

Larja e spermës (farës) dhe shkundja e saj dhe larja e sekrecionit të gruas

229. Na ka treguar Abdani, këtij i ka treguar Abdullahu, këtij Amr b. Mejmun el-Xhezeriu, ky nga Sulejman b. Jesari, e ky nga Aishja e cila ka thënë:

"Unë i kam larë gjurmët e papastërtisë (së spermës) **nga teshat e Pejgamberit s.a.v.s. dhe, edhe pse tesha dukej e lagur nga uji, ai shkoi të falë namazin".**[81]

٢٣٠ — حدثنا قتيبةُ قال حدثنا يَزيدُ قال حدثنا عَمرٌو عن سُلَيمانَ قال : سمعتُ عائشةَ ح

وحدثنا مسدَّدٌ قال حدثنا عبدُ الواحدِ قال حدثنا عَمرُو بنُ مَيمونٍ عن سُلَيمانَ بنِ يَسارٍ قال : سألتُ عائشةَ عنِ المَنِيِّ يُصيبُ الثَّوبَ فقالتْ « كنتُ أغسِلُهُ من ثَوبِ رسولِ اللهِ ﷺ ، فيَخرُجُ إلى الصلاةِ وأثَرُ الغَسلِ في ثَوبِهِ بُقَعُ الماءِ »

230. Na ka treguar Kutejbe, këtij Jezidi, ky nga Amri, ky nga Sulejmani, i cili ka thënë: **"E kam dëgjuar Aishen..."** e sipas një senedi tjetër: na ka treguar Museddedi, këtij Amr b. Mejmuni, ky nga Sulejman b. Jesari, i cili ka thënë: **E kam pyetur Aishen për spermën që bie në tesha, e ajo më është përgjigjur:**

"Unë e kam larë (atë pjesë) **të teshës së Pejgamberit s.a.v.s. në të cilën ka rënë sperma. Ai ka falur namazin, edhe pse tesha ishte ende e lagur nga uji".**

---

81 Sperma e lagur mënjanohet me larje, kurse e terura edhe me fërkuarje (me shkundje). Nga hadithi vihet në përfundim:
- materia e polucionit është e papastër;
- në përhapjen e diturisë duhet të angazhohen edhe mashkujt edhe femrat;
- bashkëshortja i bën shërbime bashkëshortit.

بابٌ إذا غَسَلَ الجَنَابَةَ أو غيرَها فلم يَذهبْ أثرُه

٢٣١ – حدثنا موسى بنُ إسماعيلَ المِنقريُّ قال حدثنا عبدُ الواحدِ قال حدثنا عَمرُو بنُ مَيمونٍ قال سمعتُ سُليمانَ بنَ يَسارٍ في الثوبِ تُصيبُه الجَنابةُ قال: قالت عائشةُ «كنتُ أغسِلُه من ثوبِ رسولِ اللهِ ﷺ ثم يَخرُجُ إلى الصلاةِ وأثرُ الغَسلِ فيه بُقَعُ الماءِ»

Larja e papastërtisë së spermës, ose të ngjashme, e gjurma e ujit ende duket

231. Na ka treguar Musai, këtij i ka treguar Abdu-l-Vahidi, këtij Amr b. Mejmuni, i cili ka thënë: E kam pyetur Sulejman b. Jesarin për teshën në të cilën bie sperma. Ai i transmetoi fjalët e Aishes:

"E kam larë papastërtinë e spermës nga teshat e Pejgamberit s.a.v.s., e ai doli të falë namazin, ndërsa në teshat e tij gjendej ende gjurma e ujit".

٢٣٢ – حدثنا عَمرُو بنُ خالدٍ قال حدثنا زُهيرٌ قال حدثنا عَمرُو بنُ مَيمونِ بنِ مِهرانَ عن سُليمانَ بنِ يَسارٍ عن عائشةَ أنها كانت تَغسِلُ المَنيَّ من ثوبِ النبيِّ ﷺ ثم أراهُ فيه بُقعةً أو بُقعًا

232. Na ka treguar Amr b. Halidi, këtij i ka treguar Zuhejri, ky ka dëgjuar nga Amr b. Mejmun b. Mihrani, këtij ia ka transmetuar Sulejman b. Jesari, e ky nga Aishja, **se ajo e ka larë spermën nga teshat e Pejgamberit s.a.v.s. dhe se ai e ka parë gjurmën e ujit në tesha, përkatësisht gjurmën e të larit.**

بابُ أبوالِ الإبلِ والدوابِّ والغنمِ ومَرابِضِها

وصلَّى أبو موسىٰ في دارِ البَريدِ والسِّرْقينِ، والبَرِّيَّةُ إلى جَنبِه فقال: ها هُنا وثَمَّ سَواءٌ

٢٣٣ ـ حدثنا سُلَيمانُ بنُ حَربٍ قال حدثنا حَمّادُ بنُ زَيدٍ عن أيوبَ عن أبي قِلابةَ عن أنَسٍ قال: قَدِمَ أُناسٌ مِن عُكْلٍ ـ أو عُرَينةَ ـ فاجْتَوَوُا المَدينةَ، فأمَرَهُم النبيُّ ﷺ بِلِقاحٍ، وأن يَشرَبوا مِن أبوالِها وأَلبانِها، فانطَلَقوا. فلمّا صَحُّوا قَتَلوا راعِيَ النبيِّ ﷺ، واستاقوا النَّعَمَ. فجاء الخبرُ في أوَّلِ النهارِ، فبَعَثَ في آثارِهم. فلما ارتَفَعَ النَّهارُ جِيءَ بهم، فأمَرَ فقَطَعَ أيدِيَهُم وأرْجُلَهم وسُمِرَتْ أعيُنُهم وأُلقوا في الحَرَّةِ يَستَسقونَ فلا يُسقَون

قال أبو قِلابةَ: فهؤلاءِ سَرَقوا، وقَتَلوا، وكَفَروا بعدَ إيمانِهم، وحارَبوا اللهَ ورسولَه

Shurra e deves, e bagëtisë së trashë e të imët dhe vathat e tyre

Ebu Musai është falur në mriz (vatha e kafshëve), në vendin e mbeturinave pranë të cilit kishte hapësirë dhe ka thënë: "(të falem) **këtu o atje** (jashtë) **është krejt njëlloj**".

233. Na ka treguar Sulejman b. Harbi, këtij Hammad b. Zejdi, ky nga Ejjubi, ky nga Kilabe, e ku nga Enesi, i cili ka treguar:

"**Kanë ardhë në Medine disa njerëz nga fisi Ukle ose Urejne** (për të jetuar), **por e përbuzën Medinen** (për shkak se u sëmurën). **Pejgamberi s.a.v.s.** (për t'u shëruar ata) **i urdhëroi të shkojnë te vatha e deveve qumështore** (ishte pronë shoqërore e muslimanëve) **dhe të pijnë shurrën dhe qumështin e tyre. Ata shkuan atje dhe kur u shëruan, e vranë çobanin e deveve të Pejgamberit s.a.v.s., kurse kafshët i vunë para** (për t'i grabitur). **Lajmi për këtë arriti që herët në mëngjes, prandaj Pejgamberi s.a.v.s. i lëshoi njerëzit pas tyre që t'i njekin. Kur zbardhi dita, i sollën ata. Atëherë, ai urdhëroi që t'u priten duart dhe këmbët; sytë t'u digjen dhe ata të nxirren nën rrezet e nxehta të diellit. Kanë kërkuar ujë, por nuk u është dhënë.**

Ebu Kilabe ka thënë: "**Ata janë njerëz që kanë vjedhur, kanë vrarë, janë kthyer në mosbesim, pasi kanë besuar dhe kanë luftuar kundër All-llahut dhe Pejgamberit të Tij**".[82]

---

82 Masakra e sipërpërmendur ka ndodhur në muajin shevval të viti 6 hixhri. Theksohet se nga fisi Urejne ishin 4 persona, kurse nga fisi Ukle ishin tetë. Ata e pranuan Islamin dhe

٢٣٤ – حدثنا آدمُ قال حدثنا شعبةُ قال أخبرنا أبو التَّيَّاحِ يزيدُ بنُ حُمَيدٍ عن أنسٍ قال: كانَ النبيُّ ﷺ يُصلِّي – قبلَ أن يُبنى المسجدُ – في مَرابِضِ الغَنَمِ

234. Na ka treguar Ademi, këtij ia ka treguar Shu'be, këtij Ebu Tejjah Jezid b. Humejdi, e ky nga Enesi i cili ka thënë:

"Para se të ndërtohej xhamia e tij, Pejgamberi s.a.v.s. falej në vathën e kafshëve".

باب ما يقعُ منَ النجاساتِ في السَّمنِ والماءِ

وقال الزُّهريُّ: لا بأسَ بالماءِ ما لم يُغيِّرْه طَعمٌ أو ريحٌ أو لونٌ. وقال حمّادٌ: لا بأسَ بريشِ الميتةِ. وقال الزُّهريُّ في عِظامِ الموتى – نحوَ الفيلِ وغيرِه – أدركتُ ناساً من سَلَفِ العُلماءِ يَمتَشِطونَ بها ويدَّهِنونَ فيها لا يَرَونَ به بأساً. وقال ابنُ سِيرينَ وإبراهيمُ: ولا بأسَ بتجارةِ العاجِ

Lidhur me papastërtinë e cila bie në yndyrë ose në ujë

Zuhriu ka thënë: **"Uji nuk është i papastër, përderisa nuk e ndërron shijen, erën dhe ngjyrën".**

---

qenë vendosur në Medine, por për shkak të nxehtësisë së madhe në qytet u sëmurën. Prandaj e lutën Muhammedin a.s. të shkojnë te kopeja e deveve në mesin e çobanëve. Muhammedi a.s. i udhëzoi ata të shkojnë te tufa e 15 deveve e cila ishte në kuliosë në afërsi të Kubâsë, gjashtë mila larg Medines.

Ata u shëruan atje dhe një ditë e sulmuan çobanin, Jaserin, rob i liruar i Muhammedit a.s., qumështarin dhe një shok tjetër të tij, i cili mezi arriti të ikë në Medine dhe i njoftoi për tërë rastin. Ata ia prenë Jesarit dorën dhe këmbën, kurse në gojë dhe në sy i kishin ngulur gjemba, prej të cilave vdiq menjëherë. Kopenë, ndërkaq, e kishin vënë përpara për ta çuar te fisi i tyre. Pas tyre u lëshuan 20 muslimanë, në krye të të cilëve ishte Seid b. Zejdi dhe Kurz b. Xhabiri. I kapën dhe i sollën para Muhammedit a.s. dhe u dënuan në mënyrë të njëjtë.

Nga hadithi mund të përfundohet:

- çdo sëmundje e ka ilaçin e vet, të cilin duhet hulumtuar dhe duhet përdorur deri në fund;
- lufta të zhvillohet jashtë qytetit dhe vendbanimit. Luftën në vendbanim nuk e lejojnë në asnjë mënyrë: Ebu Hanife, Shafiu dhe Maliku;
- lejohet që sulmuesin ta dënosh në mënyrë të njëjtë, që të shërbejë si shembull për të tjerët.

Hammadi qe shprehur në këtë mënyrë: **"Ujin nuk e dëmton të larët e kafshës së ngordhur".**

Për ashtin e kafshëve të mbytura, si p.sh. të elefantit e të ngjashme, Zuhriu ka thënë: **"Kam mbajtur në mend disa nga dijetarët e mëparmë se janë krehë nga ata** (me materialin e përbërë nga ato kafshë) **kurse me yndyrën e tyre kanë lyer, pra nuk e kanë konsideruar gjë të keqe.**

Ibni Sirini dhe Ibrahimi kanë thënë: **"Nuk ka gjë të keqe të bësh tregti me eshtrat e elefantit".**[83]

٢٣٥ — حدّثنا إسماعيلُ قال حدّثني مالكٌ عن ابنِ شِهابٍ عن عُبَيدِ اللهِ بنِ عبدِ اللهِ بنِ عُتبةَ بنِ مَسعودٍ عن ابنِ عباسٍ عن مَيمونةَ أنّ رسولَ اللهِ ﷺ سُئلَ عن فأرةٍ سَقطتْ في سَمنٍ ، فقال « ألقوها ، وما حولَها فاطْرَحوهُ ، وكلوا سَمنَكم »

235. Na ka treguar Ismaili, këtij ia ka transmetuar Maliku, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Ubejdullah b. Abdullahu, ky nga Ibni Abbasi, ky nga Mejmunja, e cila tregon se Pejgamberi s.a.v.s. qe pyetur njëherë, lidhur me miun që ka rënë në yndyrë. (Pejgamberi s.a.v.s.) ka thënë.

---

83 Thënia e Muhammed Zuhriut bazohet te një numër i madh i hadithëve të Muhammedit a.s., e sidomos në këtë hadith: "Ujin nuk e ndot asnjë gjë derisa ajo nuk mbizotëron në erën, shijën dhe në ngjyrën e tij".

Thënia e Hammadit dhe e Zuhriut bën me dije se ujin nuk e ndotin puplat e zogjve, e as shpezët me pupla, pavarësisht u hahet a nuk u hahet mishi, pastaj eshtrat e elefantit dhe të kafshëve të tjera, mishin e të cilave nuk e hamë, përveç derrit.

Sipas juristëve të shkollës hanefite, të pastër janë: brinjët, dhëmbët, eshtrat, thundrat, këmenda (lesh dhie) gishtat, leshi dhe krifat (kreshtat e kalit) me kusht që në to të mos ketë gjak.

Eshtrat, brinjët, thundrat, gishtat dhe dhëmbët e kafshëve të ngordhura janë të papastra sipas mendimit të Hasan Basriut, Malikut, Ahmedit dhe Is-hakut, kurse qimet, leshi, këmenda dhe puplat janë materiale të pastra.

Shafiu, ndërkaq, të gjitha materialet e sipërpërmendura të kafshës së ngordhur i konsideron të papastra, përveç qimeve.

Juristët e shkollës hanefite kanë mendim tjetër lidhur me përdorimin e mbeturinave të elefantit të ngordhur.

Imami Muhammed nuk e sheh të lejueshme tregtinë me eshtrat e elefantit të ngordhur, e as të përdoret lëkura e tij e regjur, kurse Ebu Hanife dhe Ebu Jusufi e lejojnë këtë.

"Hidheni atë (miun) **dhe atë që është rreth tij, të gjitha ato hidhni, e atëherë hani yndyrën që ka mbetur".**

٢٣٦ - حدثنا علي بن عبد الله قال حدثنا معن قال حدثنا مالك عن ابن شهاب عن عبيد الله بن عبد الله ابن عتبة بن مسعود عن ابن عباس عن ميمونة أن النبي ﷺ سئل عن فأرة سقطت في سمن فقال « خذوها وما حولها فاطرحوه » . قال معن : حدثنا مالك ما لا أحصيه يقول : عن ابن عباس عن ميمونة

236. Na ka treguar Ali b. Abdullahu, i cili ka thënë se i ka treguar Ma'ni, këtij Maliku, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe b. Mes'udi, ky nga Ibni Abbasi, ky nga Mejmunja, e cila tregon se kur qe pyetur Pejgamberi s.a.v.s. lidhur me miun që bie në yndyrë, është përgjigjur:

"Nxirreni atë dhe atë që është rreth tij, të gjitha ato hidhni"!

Ma'ni ka thënë: **"Këtë hadith na ka treguar Maliku, duke e përsëritur shpeshherë, e duke e transmetuar gjithnjë nga Ibni Abbasi, e ky nga Mejmunja".**[84]

٢٣٧ - حدثنا أحمد بن محمد قال أخبرنا عبد الله قال أخبرنا معمر عن همام بن منبه عن أبي هريرة عن النبي ﷺ قال « كل كلم يكلمه المسلم في سبيل الله تكون يوم القيامة كهيئتها إذ طعنت تفجر دما : اللون لون الدم ، والعرف عرف المسك

237. Na ka treguar Ahmed b. Muhammedi, këtë e ka njoftuar Abdullahu, këtë Ma'meri, ky nga Hammam b. Munebbihu, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. që ka thënë:

"Çdo plagë që e merr njeriu në rrugë të All-llahut, në Ditën e Gjykimit, ajo (plaga) **do ta ketë formën ashtu siç ka qenë kur është shpuar, gjaku që ka rrjedhur do ta ketë ngjyrën e gjakut të zakonshëm, kurse era e tij sikur era e parfumit".**[85]

---

84 Nga hadithi mund të shihet se:
- miun e ngordhur e të ngjashme si ky në yndyrën e fortë, në mjaltë, pekmez dhe në gjëra të tjera të ngjashme ushqimore duhet hedhur së bashku me materien rreth tij, deri ku ka mundur të depërtojë ndyrësira e tij, kurse pjesa e mbetur mund të përdoret për ngrënie. Gjërat e holla ushqimore bëhen të papastra tërësisht dhe nuk mund të përdoren.

85 Sipas deklaratave të mësipërme uji bëhet i papastër me ndërrimin e cilësisë së tij natyrore,

باب البول في الماء الدائم

٢٣٨ – حدثنا أبو اليمان قال أخبرنا شعيب قال أخبرنا أبو الزناد أن عبد الرحمن بن هرمز الأعرج حدثه أنه سمع أبا هريرة أنه سمع رسول الله ﷺ يقول « نحن الآخرون السابقون »

Shurra në uji që nuk rrjedh

238. Na ka treguar Ebu-l-Jemani, këtij Shu'ajbi, këtij Ebu-z-Zinadi se Abdu-r-Rahman b. Hurmuz el-A'rexhi ka treguar se e ka dëgjuar Ebu Hurejren, e ky Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

"Ne jemi të fundit (në këtë botë), **kurse të parët në botën tjetër".**[86]

---

siç është rasti me egërsirat e ngordhura, të cilat regjen në kripore, ose alkooli i cili me kriposjen kthehet në uthull. Materiet e këtilla as nuk i kanë cilësitë e tyre të mëparshme, e as emrat e tyre, prandaj mund të shfrytëzohen.

Analogjikisht me këtë që u tha më lart, gjaku i derdhur në emër të All-llahut xh.sh. bëhet i pastër; ai, shehidit (dëshmorit) do t'i shërbejë si nder dhe njoftim në Ditën e Gjykimit. Cilësia e gjakut të mëparshëm të shehidit, në përputhje me ligjet e botës dhe jetës tjetër, do të shndërrohet në erë të këndshme të parfumit dhe si i tillë do të jetë i këndshëm dhe i pastër.

Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- gjaku i muslimanit të vrarë në emër të All-llahut xh.sh. në Ditën e Gjykimit do të jetë argument i terrorit të vrasësit, por edhe argument për vetëmohimin dhe dëmtimin e besimtarit;
- gjaku i dëshmorit (shehidit) do ta tërheqë vëmendjen e të gjallëve dhe duhet ruajtur atë të mos e kap uji. Shehidi (dëshmori) varroset me atë gjak dhe me teshat që është vrarë, pa u la;
- plagët e marra do t'i shërbejnë shehidit në Ditën e Gjykimit si argument për veprën e tij jovetiake dhe si argument për rënien e tij në betejë për Fjalën e All-llahut xh.sh.

86 Nga hadithi merret vesh se muslimanët janë popolli i fundit i fesë së drejtë të All-llahut xh.sh., kurse në Ditën e Gjykimit do të ringjallen të parët. Tokës i kthehen çdo gjë, kryesisht, sipas rendit të ekzistencës së tyre. Të gjitha vendosen njëra pranë tjetrës dhe njëra mbi tjetrën. Kështu ndodh edhe me njerëzit. Llumi në sipërfaqen e tokës, çdo vit rritet me nga disa centimetra.

Ringjallja e njerëzve do të jetë sipas ligjeve të All-llahut xh.sh. dhe kushteve të jetës tjetër, sikurse gjallërimi i bimëve në ditët e pranverës. Fara e bimës më afër sipërfaqes së tokës, do të bulëzojë më parë dhe kështu bima do të gjallërohet më herët sesa ajo, fara e së cilës ka mbetur në thellësi të tokës dhe më larg sipërfaqes së tokës, mbi të cilën me kalimin e kohës janë shtresuar fara të tjera të llojllojshme, të përdredhura nga të reshurat

٢٣٩ ـ وبإسنادِه قال « لا يبولَنَّ أحدُكم في الماءِ الدائمِ الذي لا يجري ثم يغتسِلُ فيه »

239. I njëjti varg transmetusve (transmeton edhe këtë hadith):

"Askush nga ju, në asnjë rast të mos shurret në ujin e qetë, që nuk rrjedh, e pastaj me të të lahet"![87]

باب إذا ألقِيَ على ظهرِ المصلِّي قذَرٌ أو جيفةٌ لم تفسُدْ عليه صلاتُه

وكانَ ابنُ عُمرَ إذا رأى في ثوبِه دَمًا وهوَ يُصلِّي وضعَه ومَضى في صلاتِه. وقال ابنُ المُسيَّبِ والشَّعبيُّ: إذا صلَّى وفي ثوبِه دَمٌ أو جَنابةٌ أو لغيرِ القِبلةِ أو تيمَّمَ فصلَّى ثم أدركَ الماءَ في وقتِه لا يُعيد

Kur në shpinë të falësit hidhet ndyrësira ose ngordhësira, nuk i prishet atij namazi

Ibni Umeri, megjithatë, kur shifte në teshat e tij gjak gjatë faljes së namazit, i ndërronte teshat, e pastaj e vazhdonte namazin.

Ibni Musejjebi dhe Sha'biu kanë thënë: **"Kur njeriu fal namazin, e në tesha ka gjak ose mbeturinën e spermës, ose falet jo i kthyer kah Kiblja,**

---

atmosferike. Në mënyrë të njëjtë do të ringjallen dhe do të gjallërohen gjeneratat dhe popujt. Gjenerata e fundit është më afër sipërfaqes së tokës. Edhe kushtet për ringjallje te këta do të veprojnë më parë dhe më shpejt dhe kështu, këta do të paraqiten të parët mbi sipërfaqe të tokës.

87 Nga hadithi mund të nxirret edhe ky përfundim:

- hurdha me ujë, e ndotur me nevojën e madhe të njeriut nuk mund të shërbejë për abdest;
- bërja e shurrës në ujin e parrjedhshëm, po edhe në ujin e rrjedhshëm është gjë e përbuzur, e nëse me të uji dukshëm do të ndotet, atëherë, të shurrurit në të është rreptësisht e ndaluar. Ky është qëndrim i Neveviut, ndërsa juristët e shkollës hanefite, shurrjen në ujin e madh të parrjedhshëm e konsiderojnë gjë të përbuzur, kurse në ujin e vogël e të palëvizshëm, e konsiderojnë vepër të ndaluar rreptësisht.
- kryerja e nevojës së madhe në ujë dhe hedhja e mbeturinave të papastra në të, bën pjesë në veprat e ndaluara rreptësisht;
- nga shurra duhet të ruhemi me përpikëri, sepse, Muhammedi a.s. në mënyrë të prerë ka urdhëruar.

Uji i fëlliqur me shurrën dhe me nevojën e madhe të njeriut është plotësisht i papastër dhe nuk mund të përdoret për pastrim sipas sheriatit.

ose ka marrë tejemmum dhe e ka falur namazin, e më pastaj, gjatë kohës së tij ka gjetur ujë, nuk do ta përsërisë atë namaz".

٢٤٠ – حدثنا عبدانُ قال أخبرني أبي عن شُعبةَ عن أبي إسحاقَ عن عَمرو بنِ مَيمونٍ عن عبدِ اللهِ قال: بَينا رسولُ اللهِ ﷺ ع. قال وحدثني أحمدُ بنُ عثمانَ قال حدثنا شُريحُ بنُ مَسلمةَ قال حدثنا إبراهيمُ بنُ يوسُفَ عن أبيهِ عن أبي إسحاقَ قال حدثني عَمرُو بنُ مَيمونٍ أنَّ عبدَ اللهِ بنَ مَسعودٍ حدثَهُ أنَّ النبيَّ ﷺ كان يُصلِّي عندَ البيتِ وأبو جَهلٍ وأصحابٌ لهُ جُلوسٌ إذ قال بعضُهُم لِبعضٍ أيُّكُم يَجيءُ بسَلَى جَزورِ بَني فلانٍ فيَضَعُه على ظَهرِ مُحمدٍ إذا سَجَدَ. فانبَعَثَ أشقَى القومِ فجاء بِهِ، فنَظَرَ حتى إذا سَجَدَ النبيُّ ﷺ وضَعَهُ على ظَهرِهِ بينَ كَتِفَيهِ وأنا أنظُرُ لا أُغني شيئًا، لو كانت لي مَنَعةٌ. قال: فجَعَلوا يَضحكونَ ويُحيلُ بَعضُهم على بَعضٍ، ورسولُ اللهِ ﷺ ساجِدٌ لا يَرفَعُ رأسَه، حتى جاءَتهُ فاطمةُ فطَرَحَتْ عن ظَهرِهِ، فرَفَعَ رأسَه ثم قال «اللهمَّ عليكَ بقُريشٍ» ثلاثَ مرّاتٍ. فشَقَّ عليهم إذ دَعا عليهم. قال: وكانوا يَرونَ أنَّ الدَّعوةَ في ذلكَ البَلدِ مُستجابةٌ. ثم سَمَّى: «اللهمَّ عليكَ بأبي جَهلٍ، وعليكَ بعُتبةَ بنِ رَبيعةَ، وشَيبةَ بنِ ربيعةَ، والوَليدِ بنِ عُتبةَ، وأُميَّةَ بنِ خَلَفٍ، وعُقبةَ ابنِ أبي مُعَيطٍ» وعدَّ السابعَ فلم نَحفَظْهُ. قال: فوَ الذي نفسي بيدِهِ، لقد رأيتُ الذينَ عَدَّ رسولُ اللهِ ﷺ صَرعى في القَليبِ، قَليبِ بَدرٍ

240. Na ka treguar Abdani, këtij i ka treguar babai i vet, ky nga Ebu Is-haku, ky nga Amr b. Mejmuni, e ky nga Abdullahu, i cili ka thënë:

"Derisa Pejgamberi s.a.v.s. ishte në sexhde..., e sipas një senedi tjetër; më ka treguar Ahmed b. Uthmani, këtij Shurejh b. Mesleme, këtij Ibrahim b. Jusufi, ky nga babai i vet, ky nga Ebu Is-haku, ky nga Amr b. Mejmuni, ky nga Abdullah b. Mes'udi, **i cili ka treguar se Pejgamberi s.a.v.s. derisa falej pranë Qabes, Ebu Xhehli me shoqërinë** (bashkëmendimtarët) **e tij rrinin ulur aty. Në atë moment njëri nga ata u tha të tjerëve: Cili nga ju do ta sjellë lëkurën e deves së therur të filan filanit dhe t'ia hedhë në shpinë Muhammedit kur ai të bie në sexhde"?**

Më shpirtligu nga ata vrapoi me të shpejtë, e solli dhe priti derisa Pejgamberi s.a.v.s. ra në sexhde. Në atë çast ia hodhi në shpinë, në mes dy shpatullave.

Unë atë e vërejta, tha Abdullah b. Mes'udi, por nuk kam mundur të bëj gjë, bile të kisha të drejtë mbrojtjeje. Filluan ata të zgërdhihen dhe të hidhen

pupas kah njëri-tjetrit. Pejgamberi s.a.v.s. qëndroi në sexhde dhe nuk e ngriti kokën derisa i erdhi Fatimja dhe ia hoqi nga shpina. Atëherë, ai e ngriti kokën dhe tha tri herë:

"O Zot, zhduki kurejshitët pabesimtarë"! Ky mallkim i brengosi rëndë ata, thotë Abdullahu, sepse e kanë ditë se çdo lutje në këtë qytet, te All-llahu xh.sh. është e pranueshme.

Pastaj, (Pejgamberi s.a.v.s.) i emëroi me emër: **"O Zot, zhduke Ebu Xhehlin, zhduke Utbe b. Rebian, Shejb b. Rebian, Velid b. Utben, Umejje b. Halefin, Ukbe b. Ebu Muajtin. E numëroi edhe të shtatin, por nuk e kanë mbajtur në mend"**. tha (Abdullahu).

Betohem në atë (në All-llahun) **në duart** (fuqinë) **e të cilit është jeta ime** (tha Abdullah b. Mes'udi), **i kam parë ata të cilët Pejgamberi s.a.v.s. i ka numëruar, të hedhur në Kalibe, d.m.th. në gropën** (fushën) **e thatë të Bedrit"**.[88]

---

88 Gjëja e papastër e hedhur mbi falësin e namazit nuk ia prish atij namazin e filluar. Ky është qëndrim i Buhariut, Megjithatë, Abdullah b. Umeri, Ibni Musejjebi, Sha'biu dhe shumica e dijetarëve islamë kanë mendim tjetër.
All-llahu xh.sh. e pranoi lutjen e Muhammedit a.s. Ebu Xhehli, d.m.th. Amr b. Hishami b. Mugire u vra në luftën e Bedrit nga dora e Muadh b. Amrit. Ibni Mesudi, para se të vdesë, atij ia preu kokën me shpatën e tij personale dhe kokën ia dërgoi Muhammedit a.s., i cili u shpreh me këto fjalë: "O armik i All-llahut! Falënderimi i qoftë All-llahut që bëri që edhe koka yte të bie. Ky ka qenë, vërtet, njeriu më i keq dhe më injorant i kohës së vet dhe lider i udhëheqësve të idhujtarëve".
Pastaj Muhammedi a.s. ra në sexhde, iu falënderua All-llahut xh.sh. Ndërkaq, Ibni Mes'udit ia fali shpatën e Ebu Xhehlit.
Utbe b. Rebian e vrau Hamzai me Aliun, kurse vëllain e tij, Shejben, vetë Hamzai. Velid b. Utben e vrau Ubejd b. Harithi, sipas disave, Aliu. Umejje b. Halefi vdiq nga dora e Bilalit. Kur Bilali ishte në Mekke, Umejje e ka munduar dhe ka bërë terror ndaj tij. Për shkak të terrorizmit të tyre, është shpallur surja e shkurtër e Kur'anit "el-Humeze". Ukbe b. Muajtin e vrau Aliu, kurse Ummare b. Velidi iku në Abisini dhe atje vdiq.
Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- mëshira e Muhammedit a.s. ndaj çdo njeriu. Të keqen nuk e kthente me të keq, pra as idhujtarëve të lartpërmendur, por vetëm i mallkoi. Këtë nuk e bëri për shkak se e keqtrajtuan, por, pikërisht, se deshën t'ia pengojnë punën rreth Qabes.

بابُ البُزاقِ والمُخاطِ ونحوِهِ في الثَّوبِ

قال عروةُ عن المِسْوَرِ ومَروانَ : خرجَ النبيُّ ﷺ زَمَنَ حُدَيبيةَ . . فذكرَ الحديثَ :

وما تَنَخَّمَ النبيُّ ﷺ نُخامَةً إلا وَقعتْ في كفِّ رجُلٍ منهم فدَلَكَ بها وجهَهُ وجِلدَه

٢٤١ - حدثنا محمدُ بنُ يوسُفَ قال حدثنا سُفيانُ عن حُمَيدٍ عن أنسٍ قال : بَزَقَ النبيُّ ﷺ في ثَوبِهِ

وحَكَّهُ ابنُ أبي مريمَ قال : أخبرنا يحيى بنُ أيُّوبَ حدثني حُمَيدٌ قال : سمعتُ أنساً عن النبيِّ ﷺ

Pështyma, jargët e të ngjashme në tesha (në fasuletë)

Ka thënë Urve, duke transmetuar nga Mervani: **"Ka dalë Pejgamberi s.a.v.s. gjatë qëndrimit në Hudejbi, e pastaj,** (Urve) **i thotë këto fjalë: "Dhe nuk është kollitur** (teshur) **Pejgamberi s.a.v.s. me pështymë, përveç një rasti kur i ra njeriut në dorë** (...)".

241. Na ka treguar Muhammed b. Jusufi, këtij Sufjani, këtij Humejdi, këtij Enesi, i cili ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. ka pështyrë në teshën (fasuletën) **e tij".**

Këtë hadith, në variant të zgjeruar e jep Ibni Ebu Merjemi, ky nga Jahja b. Ejjubi, ky nga Enesi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s.

بابُ لا يَجوزُ الوُضوءُ بالنَّبيذِ ولا بالمُسكِرِ . وكَرِهَهُ الحسَنُ وأبو العالية

وقال عطاءٌ : التيمُّمُ أحبُّ إليَّ منَ الوُضوءِ بالنَّبيذِ واللَّبَنِ

٢٤٢ - حدثنا عليُّ بنُ عبدِ اللهِ قال حدثنا سُفيانُ قال حدثنا الزُّهريُّ عن أبي سَلَمَةَ عن عائشةَ عنِ النبيِّ ﷺ قال « كلُّ شَرابٍ أسكَرَ فهوَ حَرامٌ »

Nuk është e lejueshme të merret abdest me lëng dhe me pije të tjera (përveç ujit)

Hasani dhe Ebu-l-Alije këtë vepër e kanë konsideruar akt të shëmtueshëm, kurse Atai ka thënë: **"Më i dashur për mua është tejemmumi se abdesti me lëng ose me qumësht".**

242. Na ka treguar Ali b. Abdullahu, këtij Sufjani, këtij Zuhriu, ky nga Ebu Seleme, ky nga Aishja, e kjo nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Çdo pije që të deh është haram".[89]

بَابُ غَسْلِ الْمَرْأَةِ أَبَاهَا الدَّمَ عَنْ وَجْهِهِ . وَقَالَ أَبُو الْعَالِيَةِ : امْسَحُوا عَلَى رِجْلٍ فَإِنَّهَا مَرِيضَةٌ

٢٤٣ - حَدَّثَنَا مُحَمَّدٌ قَالَ أَخْبَرَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ عَنْ أَبِي حَازِمٍ سَمِعَ سَهْلَ بْنَ سَعْدٍ السَّاعِدِيَّ وَسَأَلَهُ النَّاسُ - وَمَا بَيْنِي وَبَيْنَهُ أَحَدٌ - : بِأَيِّ شَيْءٍ دُوِوِيَ جُرْحُ النَّبِيِّ ﷺ ؟ فَقَالَ : مَا بَقِيَ أَحَدٌ أَعْلَمُ بِهِ مِنِّي : كَانَ عَلِيٌّ يَجِيءُ بِتُرْسِهِ فِيهِ مَاءٌ ، وَفَاطِمَةُ تَغْسِلُ عَنْ وَجْهِهِ الدَّمَ . فَأُخِذَ حَصِيرٌ فَأُحْرِقَ ، فَحُشِيَ بِهِ جُرْحُهُ

Gruaja (bija) mund ta lajë gjakun nga fytyra e babait të saj

Ebu-l-Alije ka thënë: **"Ma lagni këmbën! E kam të sëmurë".**

243. Na ka treguar Muhammedi, këtij Sufjan b. Ujejne, ky nga Ebu Hazimi, ky nga Sehl b. Sa'd es-Sa'diu, i cili ka qenë prezent kur njerëzit e pyetën:

"Me çka i është shëruar varra Pejgamberit s.a.v.s."?

- Nuk ka asnjë që e di më mirë se unë, - tha Sehli. Aliu i solli ujë me mburojën e vet, e Fatimja ia lau gjakun nga fytyra. Pastaj u muar një shtroje (si hasër), **e dogjën dhe me hirin e saj iu mbush varra** (plaga).[90]

---

89 Abdest merret me ujë të pastër. Sipas mendimit të Buhariut, nuk mund të merret abdest me lëngje.
Juristët e shkollës hanefite, lejojnë të merret abdest me qumështin e përzier me ujë, kurse Ebu Hanifja lejon të merret abdest me lëngun e ëmbël, i cili gjatë larjes së organeve rrjedh sikur uji, e nëse ai humb shijen e tij (thartohet), atëherë ndalohet të përdoret.
Hasan Basriu, Evzaiu dhe Aliu lejojnë të merret abdest me lëng, kurse Ikrime dhe Ebu Hanife pajtohen me këta, vetëm në rast të mungesës së ujit".
Imam Maliku, Shafiu dhe Ahmedi mendojnë sikur Buahriu, d.m.th. nuk lejojnë të merret abdest me lëngje.

90 Në betejën në Uhud Muhammedit a.s. i janë thyer dy dhëmballë.
Nga hadithi shihet se:
- gruaja mund t'ia lidhë dhe t'ia shikojë plagën të afërmit të saj;
- duhet kërkuar shërim dhe duhet konsultuar mjekun.
- i sëmuri nuk duhet të dëshpërohet, por duhet t'i përdorë të gjitha mundësitë të shpëtojë.

بَابُ السِّوَاكِ . وَقَالَ ابْنُ عَبَّاسٍ : بِتُّ عِنْدَ النَّبِيِّ ﷺ فَاسْتَنَّ

٢٤٤ — حَدَّثَنَا أَبُو النُّعْمَانِ قَالَ حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ عَنْ غَيْلَانَ بْنِ جَرِيرٍ عَنْ أَبِي بُرْدَةَ عَنْ أَبِيهِ قَالَ : أَتَيْتُ النَّبِيَّ ﷺ فَوَجَدْتُهُ يَسْتَنُّ بِسِوَاكٍ بِيَدِهِ يَقُولُ « أُعْ ، أُعْ » وَالسِّوَاكُ فِي فِيهِ كَأَنَّهُ يَتَهَوَّعُ

Përdorimi i misvakut

Ibni Abbasi ka thënë: **"Kam kaluar natën te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e kam parë atë se i pastroi dhëmbët me misvak".**

244. Na ka treguar Ebu-n-Nu'mani, këtij i ka treguar Hammad b. Zejdi, ky nga Gajlan b. Xheriri, ky nga Ebu Burde, e ky nga babai i vet, i cili ka thënë:

"Erdha te Pejgamberi s.a.v.s. E gjeta atë duke i pastruar dhëmbët vetë me misvak, dhe duke e pasë misvakun ende në gojë, bënte "ua, ua", sikur do të villte".

٢٤٥ — حَدَّثَنَا عُثْمَانُ قَالَ حَدَّثَنَا جَرِيرٌ عَنْ مَنْصُورٍ عَنْ أَبِي وَائِلٍ عَنْ حُذَيْفَةَ قَالَ : كَانَ النَّبِيُّ ﷺ إِذَا قَامَ مِنَ اللَّيْلِ يَشُوصُ فَاهُ بِالسِّوَاكِ

245. Na ka treguar Uthmani, këtij Xheriri, ky nga Mensuri, ky nga Ebu Vaili, e ky nga Hudhejfe, i cili ka thënë:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. çohej natën, i lante dhëmbët me misvak".[91]

---

91 Nga hadithi mund të nxirret ky përfundim:

- pastrimi i dhëmbëve me misvak ka qenë praktikë e përhershme e Muhammedit a.s. Ai e ka bërë këtë edhe në ditët kur u sëmua e deri në momentin e fundit të jetës së vet.

Disa dijetarë mendojnë se është sunnet ta përdorësh misvakun me rastin e çdo abdesti, të tjerët, para faljes së çdo namazi. Ebu Hanife ndërkaq, ka thënë se kjo është çështje pastërtie që nuk duhet lënë pas dore.

Te Mugnije qëndron: "Dhëmbët duhet fërkuar, kurse gjuhën dhe anët e gojës duhet larë mirë, që të evitohen mbeturinat nga këta organe. Nëse nuk ka misvak, duhet të shërbehemi me gishta".

Ibni Dekiku porosit që dhëmbët të lahen çdo mëngjes, menjëherë pas gjumit, sepse gjatë natës grumbullohen në dhëmbë lloj-lloj mbeturinash që dalin nga barku.

- të gjithë anëtarët e familjes duhet të kenë mjetin e vet për larjen e dhëmbëve, kurse i tjetrit mund të përdoret pasi të jetë pastruar mirë.

باب دَفعِ السواكِ إلى الأكبر

٢٤٦ — وقال عفانُ : حدَّثنا صخرُ بنُ جُوَيريةَ عنْ نافعٍ عنِ ابنِ عُمرَ أنَّ النبيَّ ﷺ قال « أُرانى أتسوَّكُ بسواكٍ ، فجاءنى رَجُلانِ أحدُهما أكبرُ منَ الآخرِ ، فناوَلتُ السِّواكَ الأصغرَ منهما ، فقيلَ لى : كَبِّرْ ، فدفعتُهُ إلى الأكبرِ منهما » . قال أبو عبد الله : اختصرَهُ تميمٌ عنِ ابنِ المباركِ عن أسامةَ عن نافعٍ عنِ ابنِ عُمرَ

Misvaku i jipet më të vjetrit

246. Ka thënë Affani: Na ka treguar Sahr b. Xhuvejrije, ky nga Nafiu, duke transmetuar nga Ibni Umeri se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Kam ëndërruar se i laja dhëmbët me misvak. Më erdhën dy persona; njëri më i vjetër se tjetri. Unë ia ofrova misvakun më të riut. Atë moment më është thënë: "Jepja më të vjetrit"! Edhe unë ashtu veprova, ia dhashë më të vjetrit".

Ebu Abdullahu (Buhariu) ka thënë: **"Tekstin e këtij hadithi e ka shkurtuar Nu'mani, duke transmetuar nga Ibni Mubareku, ai nga Usamja, ky nga Nafiu, e ai nga Ibni Umeri".**

باب فَضْلِ مَن باتَ على الوضوء

٢٤٧ — حدثنا محمدُ بنُ مُقاتِلٍ قال أخبرَنا عبدُ اللهِ قال أخبرَنا سُفيانُ عن مَنصورٍ عن سَعدِ بنِ عُبيدةَ عن البَراءِ بنِ عازِبٍ قال : قال النبيُّ ﷺ « إذا أتيتَ مَضجَعَكَ فتوَضَّأْ وُضوءَكَ للصلاةِ ، ثمَّ اضطَجِعْ على شِقِّكَ الأيمَنِ ، ثمَّ قُلْ : اللّهمَّ أسلَمتُ وَجهى إليكَ ، وفوَّضتُ أمرى إليكَ ، وألجَأتُ ظَهرِى إليكَ ، رَغبةً ورهبةً إليكَ ، لا مَلجَأَ ولا مَنجا منكَ إلاَّ إليكَ . اللّهمَّ آمنتُ بكِتابِكَ الذى أنزَلتَ ، وبِنَبِيِّكَ الذى أرسلتَ . فإنْ مُتَّ مِن لَيلَتِكَ فأنتَ على الفِطرةِ . واجعَلهنَّ آخِرَ ما تتكلَّمُ به » . قال : فرددتُّها على النبيِّ ﷺ ، فلمَّا بلغتُ « اللّهمَّ آمنتُ بكِتابِكَ الذى أنزلتَ » قلت : وَرسولِكَ . قال « لا . ونبيِّكَ الذى أرسلتَ »

Vlera e abdestit për atë që e kalon natën me të

247. Na ka treguar Muhammed b. Mukatili, këtij i ka treguar Abdullahu, ky nga Sufjani, ky nga Mensuri, ky nga Sa'd b. Ubejde, ky nga Bera' b. Azibi, i cili tregon se Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë:

"Kur don të shkosh në shtratin tënd, merr abdest, ashtu sikurse merr për namaz, pastaj, bjer në anën (krahun) **e djathtë dhe thuaj:**

"All-llah! Ty të nënshtrohem dhe çdo punë timen Ty ta besoj. I frikësohem dënimit Tënd dhe Ty të bindem. Strehimi dhe shpëtimi është prej Teje, e vetëm te Ti. O Zot, e besoj Librin Tënd të cilin e ke shpallur dhe Pejgamberin të cilin e ke dërguar".

Nëse vdes atë natë, ke vdekur musliman. Çkado që të flasësh (tjetër), **përpiqu që në fund ta mbarosh me fjalët e sipërpërmendura!**

Unë, tha Berai, e përsërita tekstin para Pejgamberit s.a.v.s. dhe, kur arrita te fjalët: **"O Zot, besoj në Librin të cilin e ke dërguar"**, thashë dhe: **"të dërguarin Tënd** (duke e përdorur fjalën resul)", ai më tha: **"Jo ashtu, por edhe Pejgamberin** (duke e përdorur fjalën nebijj) **Tënd, të cilin e ke dërguar..."**.[92]

92 Pastërtia është bazë për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e trupit. Megjithatë, njeriu është bërë zotërues i botës, jo për shkak të zhvillimit të tij fizik, por për shkak të aftësisë së tij mendore dhe për shkak të cilësive të tij shpirtërore. Që të mos lihet anash kjo anë e njeriut, Muhammedi a.s. i dha udhëzime Berait për ngjitjen shpirtërore dhe për pastrimin e shpirtit nga veset e këqija të kësaj bote.

Pushimi i natës është fije e punës së përditshme, njëkohësisht fillimi i gjendjes së gjysmëvdekur të njeriut, prandaj porositet që në atë periudhë të jesh me abdest dhe ta lusësh Zotin xh.sh. për shpëtim dhe për fat në të dy jetët. Kalimi në botën e ëndërrave, simbolizon shkuarjen e njeriut në botën tjetër të përhershme dhe nevojën që për të të përgatitet.

Të biesh të flesh nga ana e djathtë është sunnet, sepse me të lehtësohet veprimi i zemrës, flen më këndshëm dhe i jipet përparësi dhe respekt anës së djathtë të trupit.

5. Larja - gusli

بسم الله الرحمن الرحيم

٥ - كتاب الغسل

وقولِ اللهِ تعالى ﴿ وإنْ كُنتمْ جُنُباً فاطَّهَّروا ، وإنْ كنتم مَرضى أو عَلَى سَفَرٍ أو جاء أحَدٌ مِنكمْ مِنَ الغائِطِ أو لامَستُمُ النساء فلم تجِدوا ماء فتيمَّموا صَعيداً طيِّباً فامْسَحوا بِوُجوهِكمْ وأيديكمْ منه ، ما يُريدُ اللهُ لِيَجعَلَ عليكمْ مِن حَرَجٍ ولَكنْ يُريدُ لِيُطَهِّرَكمْ ولِيُتِمَّ نِعمَتَهُ عليكم لَعلَّكمْ تشكُرون ﴾ [المائدة ٦] ، وقوله جَلَّ ذِكرُه ﴿ يا أيُّها الَّذينَ آمَنوا لا تَقْرَبوا الصلاةَ وأنتمْ سُكارَى حتى تَعلَموا ما تَقولونَ ولا جُنُباً إلا عابِري سَبيلٍ حَتَّى تَغتَسِلوا ، وإن كُنتمْ مَرضى أو عَلَى سَفَرٍ أو جاء أحَدٌ منكم مِنَ الغائِطِ أو لامَستُمُ النِّساء فلم تَجِدوا ماء فتَيَمَّموا صَعيداً طيِّباً فامْسَحوا بِوُجوهِكمْ وأيديكم ، إنَّ اللهَ كانَ عَفُوّاً غَفُورا ﴾ [النساء ٤٣]

Bismi-l-Lahi-r-Rahmani-r-Rahim!

5. Larja - gusli

All-llahu i Madhërueshëm (në Kur'an) thotë:

"... E, nëse jeni të papastër (xhunub), pastrohuni tërësisht! Por, nëse jeni të sëmurë (që mund t'ju dëmtojë uji), ose gjendeni në udhëtim, ose ndonjëri nga ju vie pas kryerjes së nevojës natyrore, ose nëse keni pasur marrëdhënie seksuale me gratë e nuk gjeni ujë, atëherë bëni tejemmum (gjeni dhé të pastër) dhe fshini fytyrat tuaja dhe duart tuaja me te. All-llahu nuk dëshiron t'u krijojë juve ndonjë

vështirësi, por dëshiron t'u pastrojë juve dhe t'i plotësojë dhuntitë e Tij ndaj jush, që të jeni falënderues".

(el-Mâide, 6)

All-llahu i Madhëruesh ëm thotë edhe:

"O ju besimtarë! Mos falni namaz kur jeni të dehur, përderisa të kthjelloheni e të dini se ç'flisni, as kur jeni të papastër** (xhunub), **përveç kur jeni udhëtarë, përderisa të laheni; e nëse jeni të sëmurë ose gjindeni në rrugë, ose keni kryer nevojën natyrore, ose u jeni afruar grave** (keni pasur marrëdhënie seksuale), **e nuk gjeni ujë, atëherë bëni tejemmum me dhé të pastër, dhe fërkoni** (me duar) **fytyrën tuaj dhe duart tuaja. Se, All-llahu, me të vërtetë është shlyes dhe falës i gabimeve (gjynaheve)".

(en-Nisâ', 43)

باب الوُضوء قَبْلَ الغُسْل

٢٤٨ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرنا مالكٌ عن هشامٍ عن أبيه عن عائشةَ زوجِ النبيِّ ﷺ أنَّ النبيَّ ﷺ كان إذا اغتَسَلَ من الجنابةِ بدأ فغسلَ يديه ، ثمَّ يتوضَّأُ كما يتوضَّأُ للصلاةِ ، ثمَّ يُدخِلُ أصابعَهُ في الماءِ فيُخَلِّلُ بها أصولَ شَعرِه ، ثمَّ يَصُبُّ على رأسِه ثلاثَ غُرَفٍ بيديه ، ثمَّ يُفيضُ على جِلدِه كلِّه

Abdesti para larjes së përgjithshme (guslit)

248. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij i ka treguar Maliku, ky nga Hishami, ky nga babai i vet, ky nga Aishja, bashkëshorte e Pejgamberit s.a.v.s., e cila ka treguar:

"Pejgamberi s.a.v.s. sa herë që lahej për të larguar papastërtinë nga xhunupllëku (polucioni) **fillonte dhe i lante duart, pastaj merrte abdest, ashtu siç merrte për namaz. Pastaj, i fuste gishtërinjtë në ujë dhe** (ashtu të lagur) **i përshkonte nëpër rrënjët e flokëve të veta, pastaj, derdhte tri grushta ujë nëpër kokë, e në fund derdhte ujë në gjithë trupin** (lëkurën).[1]

---

1 Larja e tërësishme pas polucionit (hedhjes së spermës) është detyrë e shkallës së parë (farz) për muslimanët. Marrja abdest mu para procesit të larjes së tillë, sipas Shafiut është sunnet, kurse sipas Ebu Davudit është detyrë e shkallës së dytë (vaxhib).

Numri më i madh i dijetarëve e ndajnë mendimin e Shafiut, duke thënë se ai abdest

٢٤٩ — حدثنا محمدُ بنُ يوسُفَ قال حدَّثنا سُفيانُ عنِ الأعمشِ عن سالمِ بنِ أبي الجَعْدِ عن كُرَيبٍ عنِ ابنِ عباسٍ عن مَيمونةَ زَوجِ النبيِّ ﷺ قالت : تَوَضَّأَ رسولُ اللهِ ﷺ وُضوءَهُ للصلاةِ غيرَ رِجلَيهِ ، وغَسَلَ فَرجَهُ وما أصابَهُ منَ الأذى ، ثمَّ أفاضَ عليهِ الماءَ ، ثمَّ نَحَّى رِجلَيهِ فَغَسَلَهما . هذه غُسلُهُ منَ الجنابةِ

249. Na ka treguar Muhammed b. Jusufi, këtij Sufjani, ky nga A'meshi, ky nga Salim b. Ebu-l-Xha'di, ky nga Kurejbi, ky nga Ibni Abbasi, ky nga Mejmunja, bashkëshorte e Pejgamberit s.a.v.s., e cila ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. merrte abdest para larjes së tërësishme (guslit), **ashtu sikurse merrte për namaz, përveç** (larjes) **së këmbëve. E lante *organin e tij gjenital dhe gjithçka që gjente në mes shalëve që duhej të* lahej, pastaj lëshonte** (derdhte) **ujë nëpër trup, e pastaj largohej anash dhe i lante këmbët. Kjo ishte larja e Pejgamberit s.a.v.s. pas xhunupllëkut** (polucionit).[2]

---

përfshihet në vetë larjen. Analogjikisht me këtë, edhe gruaja që derdhet (polucon) gjatë kohës së menstruacioneve, e që lahet pas ndërprerjes së menstruacioneve, pastrohet edhe nga polucioni dhe nuk ka nevojë të lahet dy herë.

Nga hadithi mund të nxirret edhe përfundimi:

- gjatë marrjes abdest, Muhammedi a.s. e ka praktikuar edhe larjen e këmbëve. Juristët e shkollës hanefite dhe malikite porosisin për këtë pastrim pas kryerjes së larjes, nëse uji i përdorur mblidhet te këmbët e larësit.
- gjatë larjes është vaxhib të pastrohen flokët me gishtat e lagur, e sunnet është gjatë marrjes abdest për namaz, së pari anën e djathtë, e pastaj anën e majtë. Kështu veprohet edhe me qimet e mjekrës së gjatë dhe të shpeshtë.
- gjatë larjes, duhet pastruar mirë sidomos kokën. Juristët e shkollës shafiite dhe malikite lagien e kokës tri herë dhe derdhjen e ujit tri herë në tërë trupin e konsiderojnë shumë të vlefshëm. Të fërkuarit e trupit e konsiderojnë gjë të rekomandueshme, e Malikitë, edhe të domosdoshme.

2 Hadithin e sipërshënuar Ibni Maxhe e transmeton në variantin vijues:
"*Muhammedi a.s. e anoi enën me dorën e majtë në të djathtë dhe ashtu i lau shuplakat* (duart) tri herë. Pastaj, derdhi ujë në organin gjenital dhe e lau; e fërkoi dorën për toke (muri), e pastaj tri herë e lau gojën, hundën, e lau fytyrën dhe duart deri në bërryla. Pastaj, derdhi ujë në tërë trupin. Në fund, u largua anash dhe i lau këmbët".

Nga hadithet e sipërshënuara dhe nga teksti i Kur'anit "fe-t-tahherû" - "pastrojuni mirë"! merret vesh se është vaxhib të larët e gojës, hundës dhe veshëve.

- pas larjes së organit gjenital, porositet larja e duarve me sapun, ose me diçka tjetër;
- bashkëshortja mund t'i ndihmojë bashkëshortit në larje;

باب غُسلِ الرجُلِ معَ امرأتِهِ

٢٥٠ — حدثنا آدمُ بنُ أبي إياسٍ قال حدثنا ابنُ أبي ذئبٍ عنِ الزُّهريِّ عن عُروةَ عن عائشةَ قالت : كنتُ أغتسِلُ أنا والنبيُّ ﷺ مِن إناءٍ واحدٍ ، مِن قدَحٍ يقالُ له الفَرَق

Larja e çiftit bashkëshortor njëkohësisht

250. Na ka treguar Adem b. Ebu Ijasi, këtij Ibni Ebu Dhi'bi, ky nga Zuhriu, ky nga Urve, ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Unë dhe Pejgamberi s.a.v.s. jemi larë nga një enë që quhej "ferek"".[3]

باب الغُسلِ بالصاعِ ونحوِه

٢٥١ — حدثنا عبدُ اللهِ بنُ محمدٍ قال حدثني عبدُ الصمدِ قال حدثني شُعبةُ قال حدثني أبو بكرِ بنِ حفصٍ قال سمعتُ أبا سَلَمةَ يقولُ : دخلتُ أنا وأخو عائشةَ على عائشةَ فسألها أخوها عن غُسلِ النبيِّ ﷺ ، فدعَتْ بإناءٍ نحوٍ من صاعٍ فاغتسَلَتْ وأفاضَتْ على رأسِها ، وبَيْنَنا وبينَها حجابٌ . قال أبو عبدِ اللهِ : قال يزيدُ بنُ هارونَ وبهزٌ والجَدِّيُّ عن شُعبةَ : قَدْرِ صاعٍ

- derdhja e ujit bëhet me të djathtën, kurse fërkuarja me të majtën;
- fshirja pas lamjes është e lejueshme, bile e rekomandueshme, me tekstil të pastër. Me peshkir janë fshirë: Uthmani, Hasan b. Aliu, Enesi, Maliku, Beshir b. Mes'udi dhe shumë As-habë të famshëm. Fshirjen pas larjes e kanë porositur: Hasan Basriu, Ibni Sirini, Alkame, Maliku, Thevriu, Ahmedi, Is-ahku dhe juristët e shkollës hanefite.

Muhammedi a.s. e refuzoi njëherë peshkirin që ia ofroi Mejmunja, sepse shpejtonte për namaz dhe për shkak se vërjeti në të mëndafsh të qëndisur.

3 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- çifti bashkëshortor mund të lahet me ujin nga një enë, qoftë njëkohësisht, qoftë njëri pas tejtrit dhe mund të shikojnë njëri-tjetrin;
- thëniet e pambështetura të të tjerëve duhet hedhur poshtë dhe atij që nuk është i njoftuar duhet treguar të vërtetën;
- nuk është mirë të shpenzohet shumë ujë, por është e rekomandueshme të shpenzohet për larje së paku tetë litra.

Larja me një "sâ'" ose të ngjashme me të

251. Na ka treguar Abdullah b. Muhammedi, këtij Abdu-s-Samedi, këtij Shu'be, ky nga Ebu Bekr b. Hafsi, i cili e ka dëgjuar Ebu Selemen, duke thënë:

"Unë dhe vëllai i Aishes kemi hyrë te Aishja. Vëllai i saj e pyeti atë (Aishen) **për larjen e Pejgamberit s.a.v.s.** (pas xhunupllëkut)**. Atëherë, ajo kërkoi një enë të ngjashme me "sâ'"-in, u la dhe derdhi ujë mbi kokën e saj, e në mes nesh dhe asaj kishte perde".**

Ebu Abdullahu ka thënë:

"Jezid b. Haruni dhe Xhudiu e kanë transmetuar Hadithin e sipërpërmendur nga Shu'be me fjalët: **"... sa madhësia e "sâ'"-it...".**[4]

٢٥٢ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ محمدٍ قال حدثنا يحيىٰ بنُ آدمَ قال حدثنا زُهيرٌ عن أبي إسحاقَ قال حدثنا أبو جعفرٍ أنه كان عندَ جابرِ بنِ عبدِ اللهِ هو وأبوهُ وعندَهُ قومٌ ، فسألوه عنِ الغُسلِ ، فقال : يكفيكَ صاعٌ . فقال رجُلٌ : ما يكفيني . فقال جابرٌ كان يكفي من هو أوفىٰ منكَ شَعراً وخيرٌ منكَ . ثم أمَّنا في ثوبٍ

252. Na ka treguar Abdullah b. Muhammedi, këtij Jahja b. Ademi, këtij Zuhejri, ky nga Is-haku, i cili tregon se Ebu Xha'feri ka thënë se ka qenë te Xhabir b. Abdullahu ai dhe babai i tij, kurse te ai kishin qenë edhe disa njerëz të tjerë të cilët e pyetën për larjen e tërësishme (guslin):

"Mjaft e ke një "sâ'" me ujë", u përgjigj Xhabiri.

"Për mua nuk është mjaft", tha një tjetër njeri.

Xhabiri iu përgjigj: **"Ka qenë e mjaftueshme edhe për atë që ka pasur flokë më të shpeshta dhe ka qenë më i plotë se ti, bile na është bërë imam me një veshje** (teshë si fustan)**".**

---

4 Sipas mendimit të Shafiut dhe juristëve të Hixhazit një "sâ'" i ka 5 litra e 1/3/ e litrit ujë, e sipas Ebu Hanifes dhe juristëve të Irakut i ka tetë litra ujë. "Fereku" i ka 3 "sâ'", pra 16 litra, sipas Shafiut e sipas Ebu Hanifes 24 litra.

٢٥٣ — حدثنا أبو نُعيم قال حدثنا ابنُ عُيينةَ عن عمرٍو عن جابرِ بنِ زيدٍ عنِ ابنِ عباسٍ أن النبيَّ ﷺ وميمونةَ كانا يغتسلانِ من إناءٍ واحدٍ . وقال يزيدُ بنُ هارونَ وبَهزٌ والجُدِّيُّ عن شعبةَ : قَدْرِ صاعٍ

253. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi, këtij Ibnu Ujejne, këtij Amri, ky nga Xhabir b. Zejdi, ky nga Ibni Abbasi, i cili ka dëgjuar se **Pejgamberi s.a.v.s. dhe Mejmunja** (bashkëshorte e tij) **janë larë nga një enë.**

Ebu Abdullahu (Buhariu) ka thënë

"Zejd b. Haruni, Behzi dhe Xhudiu, Hadithin e sipërshënuar e kanë transmetuar nga Shu'be: "**... ena e madhësisë së "sâ'"**-it...".

باب مَن أفاضَ على رأسِهِ ثلاثًا

٢٥٤ — حدثنا أبو نُعيم قال حدثنا زُهيرٌ عن أبي إسحاقَ قال حدثني سُليمانُ بنُ صُرَدٍ قال حدثني جُبيرُ ابنُ مُطْعِمٍ قال : قال رسولُ اللهِ ﷺ « أمّا أنا فأُفيضُ على رأسي ثلاثًا » وأشارَ بيَدَيهِ كِلتَيهِما

Derdhja (lëshuarja) e ujit mbi krye tri herë

254. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi, këtij Zuhejri, ky nga Ebu Is-haku, ky nga Sulejman b. Suredi, këtij Xha'fer b. Mut'imi, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili ka thënë:

"Sa më përket mua, unë mbi kokën time hedh tri herë ujë, duke treguar këtë edhe praktikisht me duart e veta".[5]

٢٥٥ — حدثني محمد بن بشّارٍ قال حدثنا غُندَرٌ قال حدثنا شُعبةُ عن مُخوَّلِ بنِ راشدٍ عن محمدِ بنِ عليٍّ عن جابرِ بنِ عبدِ اللهِ قال : كان النبيُّ ﷺ يُفرِغُ على رأسِه ثلاثًا

5 Nga hadithi merret vesh se:
- larja e disa pjesëve të trupit nga tri herë është sunnet, kurse larja e tyre nga një herë së bashku me tërë trupin është farz.
- larja, përkatësisht derdhja e ujit në kokë tri herë është gjë e rekomandueshme (e këshillueshme).

255. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari, këtij Gunderi, ky nga Shu'be, ky nga Mihvel b. Rashidi, ky nga Muhammed b. Aliu, ky nga Xhabir b. Abdullahu, i cili ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. derdhte mbi kokën e tij nga tri grushta (ujë)".

٢٥٦ – حدثنا أبو نُعيم قال حدثنا مَعْمَرُ بنُ يحيى بنِ سامٍ حدثني أبو جعفرٍ قال : قال لي جابرٌ : وأتاني ابنُ عمكَ – يَعرِضُ بالحسنِ بنِ محمدِ بن الحَنَفيَّةِ – قال : كيفَ الغُسلُ مِنَ الجنابةِ ؟ فقلتُ : كانَ النبيُّ ﷺ يأخُذُ ثلاثةَ أكُفٍّ ويُفيضُها على رأسِه، ثمَّ يُفيضُ على سائرِ جَسَدِهِ . فقال لي الحسنُ : إنِّي رجلٌ كثيرُ الشَّعرِ ، فقلت : كان النبيُّ ﷺ أكثرَ منكَ شَعراً .

256. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi, ky nga Ma'mer b. Jahja b. Sami, këtij Xha'feri, e këtij Xhabiri, i cili ka thënë:

"Më ka ardhë djali i axhës tënd, duke menduar në Hasan b. Muhammed b. Hanefijjen, i cili pyeti sesi bëhet pastrimi nga xhunupllëku (polucioni)"?

"Pejgamberi s.a.v.s. merrte tri grushta ujë dhe i derdhte mbi kokë, e pastaj derdhte ujë në tërë trupin e tij", iu përgjigja (tha Xhabiri).

Atëherë, Hasani më tha: **"Unë jam njeri me flokë të gjata"?**

"Pejgamberi s.a.v.s. kishte flokë më të gjata se ti", i thashë.[6]

بابُ الغُسلِ مرَّةً واحدةً

٢٥٧ – حدثنا موسى بنُ إسماعيلَ قال حدثنا عبدُ الواحدِ عنِ الأعمشِ عن سالمِ بنِ أبي الجَعدِ عن كُرَيبٍ عنِ ابنِ عباسٍ قال : قالت مَيمونةُ : وضعتُ للنبيِّ ﷺ ماءَ الغُسلِ فغسلَ يدَيهِ مرَّتينِ أو ثلاثاً ، ثمَّ أفرَغَ على شِمالِهِ فغسلَ مَذاكيرَهُ ، ثم مسحَ يدَهُ بالأرضِ ، ثمَّ مَضمَضَ واستنشَقَ ، وغسلَ وَجهَهُ ويَديهِ ، ثمَّ أفاضَ على جَسَدِهِ ، ثمَّ تحوَّلَ مِن مكانِهِ فغسلَ قدَمَيهِ

---

6 Për larjen e kokës mjaftojnë tri grushta ujë (duke i bashkuar duart), pavarësisht nga gjatësia e flokëve;
- kokën duhet larë para larjes së përgjithshme. Kështu ka vepruar Pejgamberi a.s.
- duhet hulumtuar dijeninë dhe duhet të pranohet mendimi i ekspertit.

Larja nga një herë

257. Na ka treguar Musai, këtij i ka treguar Abdu-l-Vahidi, ky nga A'meshi, ky nga Salim b. Ebu Xha'di, ky ga Kurejbi, e ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë se Mejmunja ka treguar:

"Ia përgatita ujin Pejgamberit s.a.v.s. për t'u larë. Së pari i lau duart dy a tri herë, pastaj derdhi ujë në dorën e majtë dhe e lau organin e tij gjenital dhe e fërkoi dorën për toke (dheu), **pastaj e shpërlau gojën dhe hundën** (dhe e nxorri ujin jashtë nga këto), **pastaj e lau fytyrën dhe duart deri në bërryla dhe derdhi ujë në tërë trupin. Në fund u largua pak anash dhe i lau këmbët".**

باب مَن بَدأ بالحِلابِ أوِ الطِّيبِ عند الغُسلِ

٢٥٨ — حدثنا محمدُ بنُ المثنّى قال حدّثنا أبو عاصمٍ عن حَنظَلةَ عن القاسمِ عن عائشةَ قالت: كان النبيُّ ﷺ إذا اغتسلَ من الجنابةِ دعا بشيءٍ نحوَ الحِلابِ فأخذَ بكفِّهِ فبدأ بشِقِّ رأسِهِ الأيمنِ، ثمَّ الأيسرِ، فقال بهما على رأسِهِ

Larja me një enë të vogël me ujë dhe parfumosja

258. Na ka treguar Muhammed b. Muthennai, këtij Ebu Asimi, ky nga Hanzale, ky nga Kasimi, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. deshti të pastrohej (lahej) **nga xhunupllëku** (polucioni) **kërkoi një enë të njëjtë si kova. E mori atë me dorën e vet dhe filloi të lahet nga gjysma e djathtë e kokës, pastaj nga ana e majtë, e pastaj me dy duart derdhi ujë në kokë".**

باب للمَضمضةِ والاستنشاقِ في الجنابةِ

٢٥٩ — حدثنا عمرُ بن حفصِ بنِ غياثٍ قال حدّثنا أبي حدّثنا الأعمشُ قال حدّثني سالمٌ عن كُريبٍ عن ابنِ عبّاسٍ قال حدّثتنا ميمونةُ قالت: صَبَبْتُ للنبيِّ ﷺ غُسلاً، فأفرغَ بيمينِهِ على يسارِهِ فغسلهما، ثمَّ غسلَ فرجَهُ، ثمَّ قال بيدِهِ الأرضَ فمسحَها بالترابِ، ثمَّ غسلَها، ثمَّ تمضمضَ واستنشقَ، ثمَّ غسلَ وجهَهُ وأفاضَ على رأسِهِ، ثمَّ تنحّى فغسلَ قدميهِ، ثمَّ أُتيَ بمنديلٍ فلم ينفُضْ بها

Të shtërit ujë në gojë dhe në hundë për shkak të xhunupllëkut (polucionit)

259. Na ka treguar Umer b. Hafs b. Gijathi, këtij babai i vet, këtij A'meshi ky nga Salimi, ky nga Kurejbi, ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë:

Na ka treguar Mejmunja duke thënë: **"I kam derdhë** (shtënë) **ujë Pejgamberit s.a.v.s. gjatë larjes** (nga xhunupllëku)**: së pari me dorën e djathtë derdhi ujë në të majtën dhe i lau që të dyja, pastaj, e lau organin e tij gjenital, e vuri dorën në tokë dhe e fërkoi në dhé, pastaj e lau. Pastaj, e lau gojën dhe hundën** (dhe e nxori ujin prej tyre)**, pastaj e lau fytyrën, e pastaj, derdhi ujë në kokë. Pas kësaj, u largua anash dhe i lau këmbët. Pasi u pastrua, i sollën një leckë** (peshkir)**, por ai me të nuk u fshi".**[7]

بَابُ مَسْحِ الْيَدِ بِالتُّرَابِ لِتَكُونَ أَنْقَى

٢٦٠ – حَدَّثَنَا عَبْدُ اللهِ بْنُ الزُّبَيْرِ الْحُمَيْدِيُّ قَالَ حَدَّثَنَا سُفْيَانُ قَالَ حَدَّثَنَا الْأَعْمَشُ عَنْ سَالِمِ بْنِ أَبِي الْجَعْدِ عَنْ كُرَيْبٍ عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ عَنْ مَيْمُونَةَ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ اغْتَسَلَ مِنَ الْجَنَابَةِ ، فَغَسَلَ فَرْجَهُ بِيَدِهِ ، ثُمَّ دَلَكَ بِهَا الْحَائِطَ ثُمَّ غَسَلَهَا ، ثُمَّ تَوَضَّأَ وُضُوءَهُ لِلصَّلَاةِ ، فَلَمَّا فَرَغَ مِنْ غُسْلِهِ غَسَلَ رِجْلَيْهِ

Fërkimi i dorës për dheu që të pastrohet më mirë

260. Na ka treguar Humejdiu, këtij Sufjani, këtij A'meshi, ky nga Salim b. Ebu Xha'di, ky nga Kurejbi, ky nga Ibni Abbasi, e ky nga Mejmunja, e cila ka thënë:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. është pastruar nga xhunupllëku (polucioni)**, së pari e ka larë organin e tij gjenital me dorë, pastaj dorën e ka fërkuar për muri** (ose për toke) **dhe e ka larë, pastaj ka marrë abdest, ashtu sikurse ka marrë për namaz, kurse këmbët i lante, pasi e lante tërë trupin".**

---

7 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- së pari lahet ana e djathtë e kokës, e pastaj ana e majtë. Kjo vlen edhe për pjesët tjera të trupit;
- renditja e paraqitur këtu, është praktikë e Muhammedit a.s.. Kështu duhet të veprojnë muslimanët;
- pas shpërlarjes së sekrecionit nga organi gjenital, dorën duhet larë mirë me ujë dhe me ndonjë mjet efikas (sapun, detergjent e të ngjashme).

باب هل يُدخِلُ الجُنبُ يدَهُ في الإناءِ قبلَ أن يَغسِلَها إذا لم يكُنْ على يدِهِ قذَرٌ غيرُ الجنابةِ . وأدخلَ ابنُ عمرَ والبَراءُ بنُ عازِبٍ يدَهُ في الطَّهورِ ولم يَغسِلْها ثمَّ توضَّأ . ولم يَرَ ابنُ عمرَ وابنُ عبَّاسٍ بأسًا بما يَنتضِحُ مِن غُسلِ الجنابةِ

A ka të drejtë "xhunubi" të marrë ujë me dorë nga ena para se ta lajë atë, edhe pse në të nuk ka ndyrësi, por vetëm për shkak se është derdhur (ejakuluar)

Ibni Umeri dhe Bera b. Azibi e kanë futur dorën në ujë të pastër para se ta lajnë atë dhe kanë marrë abdest.

Ibni Umeri dhe Ibni Abbasi nuk i konsiderojnë të dëmshme pikat e ujit të cilat bien (në enë) **nga personi i cili lahet për shkak të xhunupllëkut** (ejakulimit).

٢٦١ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ مَسلَمَةَ حدَّثنا أفلحُ عن القاسمِ عن عائشةَ قالت : كنتُ أغتَسِلُ أنا والنبيُّ ﷺ من إناءٍ واحدٍ نَختَلِفُ أيدِينا فيه

261. Na ka treguar Abdullah b. Mesleme, këtij Eflehu, ky nga Kasimi, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Unë dhe Pejgamberi s.a.v.s. jemi larë nga një enë në të cilën i përzienim duart tona".

٢٦٢ – حدثنا مسدَّدٌ قال حدَّثنا حمَّادٌ عن هِشامٍ عن أبيهِ عن عائشةَ قالت : كان رسولُ اللهِ ﷺ إذا اغتَسَلَ من الجنابةِ غسلَ يدَه

262. Na ka treguar Museddedi, këtij Hammadi, ky nga Hishami, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja e cila ka thënë:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. lahej për shkak të marrëdhënieve seksuale, më së pari e lante dorën e tij".

٢٦٣ – حدثنا أبو الوليدِ قال حدَّثنا شُعبةُ عن أبي بكرِ بنِ حفصٍ عن عُروةَ عن عائشةَ قالت : كنتُ أغتَسِلُ أنا والنبيُّ ﷺ من إناءٍ واحدٍ من جَنابةٍ . وعند عبدِ الرحمٰنِ بنِ القاسمِ عن أبيه عن عائشةَ مثلَه

263. Na ka treguar Ebu-l-Velidi, këtij i ka treguar Shu'be, ky nga Ebu Bekr b. Hafsi, ky nga Urve, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Unë dhe Pejgamberi s.a.v.s. jemi larë nga një enë, pasi kemi pasë marrëdhënie intime".

Në mënyrë të ngjashme me Shu'ben ka transmetuar edhe Abdu-r-Rahman b. Kasimi, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja.

٢٦٤ — حدثنا أبو الوليد قال حدثنا شعبة عن عبد الله بن عبد الله بن جبر قال : سمعت أنس بن مالك يقول : كان النبي ﷺ والمرأة من نسائه يغتسلان من إناء واحد . زاد مسلم ووهب عن شعبة : من الجنابة

264. Na ka treguar Ebu-l-Velid, këtij i ka treguar Shu'be, ky nga Abdullah b. Abdullah b. Xhebri, i cili ka thënë: E kam dëgjuar Enes b. Malilkun duke thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. dhe një grua nga bashkëshortet e tij janë larë nga një enë".

Muslim b. Ibrahimi dhe Vehb b. Xheriri, duke transmetuar të njëjtin hadith nga Shu'be, e kanë plotësuar: **"... për shkak të marrëdhënies seksuale".**[8]

باب تفريق الغسل والوضوء . ويذكر عن ابن عمر أنه غسل قدميه بعد ما جف وضوءه

٢٦٥ — حدثنا محمد بن محبوب قال حدثنا عبد الواحد قال حدثنا الأعمش عن سالم بن أبي الجعد عن كريب مولى ابن عباس عن ابن عباس قال : قالت ميمونة : وضعت لرسول الله ﷺ ماء يغتسل به ، فأفرغ على يديه فغسلهما مرتين أو ثلاثا ، ثم أفرغ بيمينه على شماله فغسل مذاكيره ، ثم دلك يده بالأرض ، ثم مضمض واستنشق ، ثم غسل وجهه ويديه ، وغسل رأسه ثلاثا ، ثم أفرغ على جسده ، ثم تنحى من مقامه فغسل قدميه

---

8 Deklaratat e shprehura të As-habëve tregojnë qartë se uji i pastër nuk ndotet nga dora e personit që e fut në të, i cili më parë ka patur marrëdhënie seksuale. Pikat e imta të ujit që bien nga trupi i atij që lahet nuk e bëjnë të papastër lëndën anash, sepse vësht iré është t'i ndalosh. Ebu Jusufi thotë: "Nëse falësin e namazit e stërpik ndonjë me shurrë, ajo nuk ia prish namazin, por ai atë namaz do ta mbarojë me selamin e parë, ta pastrojë shurrën dhe ta vazhdojë pjesën e mbetur të namazit.

Uji i mbetur në enë, në të cilën është marrë me dorë të pastër, është i pastër dhe mund të përdoret për nevoja të pastrimit sipas sheriatit. Muhammedi a.s., sipas hadithëve të shperhura, së pari i ka larë duart vetëm kur ka konsideruar se i ka të papastra.

Larja (gusli) dhe abdesti me ndërprerje

Nga Ibni Umeri përmendet se ai i ka larë këmbët e tij pasi që uji i abdestit i qe terë (në pjesët e tjera të trupit të larë).

265. Na ka treguar Muhammed b. Mahbubi, këtij i ka treguar Abdu-l-Vahidi, këtij A'meshi, ky nga Salim b. Ebu Xha'di, ky nga Kurejbi, rob i liruar i Ibni Abbasit, ky nga Ibni Abbasi, e ky nga Mejmunja, e cila ka thënë:

"I përgatita ujë Pejgamberit s.a.v.s. për t'u larë me të. Ai së pari derdhi ujë në duart e tij, të cilat i lau dy a tri herë, pastaj me të djathtën derdhi (ujë) **në të majtën dhe e lau organin gjenital, pastaj dorën e fërkoi për dheu, pastaj e shpërlau gojën dhe hundën, e lau fytyrën, duart** (dhe krahët deri në bërryla), **e lau kokën, të gjitha nga tri herë, pastaj derdhi ujë nëpër trupin e tij. Në fund u largua nga vendi** (ku lahej) **dhe i lau këmbët".**[9]

بَابُ مَنْ أَفْرَغَ بِيَمِينِهِ عَلَى شِمَالِهِ فِي الْغُسْلِ

٢٦٦ – حَدَّثَنَا مُوسَى بْنُ إِسْمَاعِيلَ قَالَ حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ حَدَّثَنَا الأَعْمَشُ عَنْ سَالِمِ بْنِ الْجَعْدِ عَنْ كُرَيْبٍ مَوْلَى ابْنِ عَبَّاسٍ عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ عَنْ مَيْمُونَةَ بِنْتِ الْحَارِثِ قَالَتْ : وَضَعْتُ لِرَسُولِ اللَّهِ ﷺ غُسْلاً وَسَتَرْتُهُ ، فَصَبَّ عَلَى يَدِهِ فَغَسَلَهَا مَرَّةً أَوْ مَرَّتَيْنِ – قَالَ سُلَيْمَانُ : لاَ أَدْرِي أَذَكَرَ الثَّالِثَةَ أَمْ لاَ – ثُمَّ أَفْرَغَ بِيَمِينِهِ عَلَى شِمَالِهِ فَغَسَلَ فَرْجَهُ ، ثُمَّ دَلَكَ يَدَهُ بِالأَرْضِ أَوْ بِالْحَائِطِ ، ثُمَّ تَمَضْمَضَ وَاسْتَنْشَقَ وَغَسَلَ وَجْهَهُ وَيَدَيْهِ وَغَسَلَ رَأْسَهُ ، ثُمَّ صَبَّ عَلَى جَسَدِهِ ، ثُمَّ تَنَحَّى فَغَسَلَ قَدَمَيْهِ ، فَنَاوَلْتُهُ خِرْقَةً فَقَالَ بِيَدِهِ هٰكَذَا ، وَلَمْ يُرِدْهَا

---

9 Nafiu transmeton se Abdullah b. Umeri ka marrë abdest në qytet dhe posa e lau fytyrën, duart dhe i dha mes-h kokës, qe thirrur në xhenaze. Ai menjëherë shkoi para xhamisë, atje u dha mes-h mesteve dhe fali namazin e xhenazes.

Larjen e disa pjesëve të trupit njëra pas tjetrës, Shafiu e konsideron vaxhib, e në rast të ndërprerjes së larjes së organeve, rekomandon përsëritjen e larjes së organeve të caktuara.

Maliku lejon ndërprerje të shkurtër aq sa uji në organet e tjera të lara nuk është terë, ndërsa këtë pa farë kushtesh e lejojnë: Ebu Hanife, Ibni Umeri, Ibni Musejjebi, Tavusi, Nehaiu, Hasan Basriu, Sufjan b. Seidi dhe shumë juristë të tjerë.

Derdhja e ujit me të djathtën në të majtën gjatë larjes

266. Na ka treguar Musa b. Ismaili, këtij Ebu Avane, këtij A'meshi, ky nga Salim b. Ebu Xha'di, ky nga Kurejbi, rob i liruar i Ibni Abbasit, e ky nga Mejmune b. Harithi, e cila ka thënë:

"I përgatita ujë për larje Pejgamberit s.a.v.s. dhe e mbulova. Ai derdhi në duart e tij dhe i lau një a dy herë".

Sulejmani ka thënë:

"Nuk e di se a e ka përmendur (Salim b. Ebu Xha'di) **tri herë ose jo".**

"Pastaj me të djathtën derdhi ujë në të majtën dhe e lau organin e tij gjenital, pastaj e fërkoi dorën e tij për dheu ose muri, pastaj futi ujë në gojë dhe në hundë (duke e nxjerrë ujin prej tyre), **e lau fytyrën dhe duart, e lau kokën dhe derdhi ujë nëpër trup, pastaj, u largua anash dhe i lau këmbët. Unë ia kapa leckën** (peshkirin) **e ai me dorën e tij më sinjalizoi "kështu" dhe nuk e deshi atë".**

بابٌ إذا جامَعَ ثُمَّ عادَ. وَمَن دارَ على نِسائِهِ فى غُسلٍ واحد

٢٦٧ - حدثنا محمدُ بنُ بَشّارٍ قال حدثنا ابنُ عَدِيٍّ ويحيى بنُ سَعيدٍ عن شُعبةَ عن إبراهيمَ بنِ محمدِ بنِ المُنتشِرِ عن أبيهِ قال: ذكرتُه لعائشةَ فقالت: يَرحَمُ اللهُ أبا عبدِ الرحمٰنِ كنتُ أُطيِّبُ رسولَ اللهِ ﷺ فيطوفُ على نِسائِهِ ثُمَّ يُصبِحُ مُحرِماً يَنضَخُ طِيباً

Një e larë për shumë marrëdhënie intime

267. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari, këtij i kanë thënë Ibni Ebu Abdiu dhe Jahja b. Se'di, ky nga Shu'be, ky nga Ibrahim b. Muhammed b. Munteshiri, e ky nga babai i vet, i cili tregon se ia ka përmendur Aishes thënien e Ibni Umerit. Ajo, ndërkaq, është përgjigjur:

"All-llahu e mëshiroftë Ebu Abdu-r-Rahmanin! Unë e kam bërë me parfum Pejgamberin s.a.v.s. dhe ai i ka vizituar (u është sjellur) **bashkëshortet e veta dhe, pastaj i ka zbardhur si muhrim i parfemosur".**[10]

٢٦٨ – حدثنا محمد بن بشار قال حدثنا معاذ بن هشام قال حدثني أبي عن قتادة قال حدثنا أنس بن مالك قال: كان النبي ﷺ يدور على نسائه في الساعة الواحدة من الليل والنهار وهن إحدى عشرة. قال: قلت لأنس: أوكان يطيقه؟ قال: كنا نتحدث أنه أعطي قوة ثلاثين. وقال سعيد عن قتادة إن أنسا حدثهم: تسع نسوة

268. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari, ky nga Muadh b. Hishami, ky nga babai i vet, ky nga Katade, ky nga Enes b. Maliku...

---

10 Ebu Davudi dhe Tirmidhiu transmetojnë përmes Enesit se Muhammedi a.s. i kishte vizituar njëherë bashkëshortet e pastaj qe larë vetëm një herë. Po këta muhaddithë transmetojnë se Muhammedi a.s. në një rast tjetër i kishte vizituar bashkëshortet e veta dhe te çdonjëra ishte pastruar. Në vërejtjen e Ebu Rafiut pse nuk u pastrua një herë, u përgjigj se bën gjithnjë atë që për pastërtinë e trupit dhe për shëndetin e njeriut është më mirë.

Larja ndërmjet shumë marrëdhënieve intime nuk është detyrim (farz), por vetëm porosi (rekomandim). Ibni Hazmi, Atai, Ibrahim Nehaviu, Hasan Basriu dhe Ibni Sirini konsiderojnë se në rastin e sipërpërmendur është më mirë të merret abdest, sepse Muhammedi a.s. ka thënë: "Nëse ndonjë prej jush ka pasë marrëdhënie seksuale me bashkëshorten e vet, e këtë dëshiron ta përsërisë në një distancë të shkurtër kohore, në mes këtyre veprimeve le të marrë abdest".

Besnikërinë e hadithit e pranojnë të gjithë juristët islamë, por përmbajtjen e tij e konsiderojnë si porosi (këshillë) e jo si urdhëresë sidomos duke u mbështetur në shprehjen e Aishes, e cila në një rast pat thënë se Muhammedi a.s. ka patur marrëdhënie intime, e më pastaj e ka përsëritur, e në mes tyre nuk mori abdest".

Ibni Umeri ka thënë: "Nuk di që ndonjë nga dijetarët ta ketë konsideruar larjen në mes marrëdhënieve seksuale njëra pas tjetrës të domosdoshme (vaxhib), përveç Zahariut".

- rekomandohet që haxhiu para se ta veshë ihramin të pastrohet mirë, sepse, pastaj si muhrim (haxhiu në ihram) nuk mund të rregullohet, e as të parfumoset.

- fërkuarja gjatë larjes nuk është e detyrueshme, e as që duhet të kryhet menjëherë pas marrëdhënies seksuale, nëse ka për qëllim ta përsërisë.

بابُ غَسلِ المَذي والوُضوءِ مِنهُ

٢٦٩ - حدثنا أبو الوَليدِ قال حدثنا زائدةُ عن أبي حَصينٍ عن أبي عبدِ الرحمٰنِ عن عليٍّ قال : كنتُ رجُلاً مَذّاءً ، فأمرتُ رجلاً أن يَسألَ النبيَّ ﷺ - لمكانِ ابنتِهِ - فسألَ ، فقال « توضأْ ، واغسلْ ذَكَرَكَ »

Larja e mezi-së (lëngu që del para spermës) dhe përsëritja e abdestit për shkak të tij

269. Na ka treguar Ebu-l-Vahidi, këtij Zaide, ky nga Ebu Hishami, ky nga Ebu Huseini, ky nga Abdu-r-Rahmani, e ky nga Aliu, i cili ka thënë:

"Unë jam njeri që, pas një nxitje të vogël të organit gjenital, më paraqitet mezia (lëngu). **E kam urdhëruar** (për këtë) **një njeri që ta pyes Pejgamberin s.a.v.s., se ashtu e kërkonte pozita e vajzës së tij".**

Ai e kishte pyetur, e Pejgamberi s.a.v.s. i qe përgjigjur:

"Laje organin tënd gjenital dhe merr abdest"![11]

بابُ من تطيَّبَ ثمَّ اغتسلَ ، وبقيَ أثرُ الطِّيبِ

٢٧٠ - حدثنا أبو النُّعمانِ قال حدثنا أبو عَوانةَ عن إبراهيمَ بنِ محمدِ بنِ المنتشرِ عن أبيهِ قال : سألتُ عائشةَ فذكرتُ لها قولَ ابنِ عُمرَ « ما أحبُّ أن أصبحَ مُحرِماً أنضَخُ طِيباً » فقالت عائشةُ : أنا طيَّبتُ رسولَ اللهِ ﷺ ، ثم طافَ في نِسائِهِ ، ثم أصبحَ مُحرِماً

Përdorimi i parfumit para larjes dhe gjurmët e parfumit

270. Na ka treguar Ebu-n-Nu'mani, ky nga Ebu Avane, ky nga Ibrahim b. Muhammed b. Munteshiri, e ky nga babai i vet, i cili ka thënë:

---

11 Larja (pastrimi) është detyrë e shkallës së parë (farz) pas marrëdhënies sekusale, kur sekrecioni ejakulon (gufon) me kënaqësi nga organi gjenital, qoftë edhe në ëndërr, ose kur personi i zgjuar e sheh në organin e tij gjenital, përkatësisht në tesha, bile edhe në qoftë se nuk mban në mend se ka ëndërruar për marrëdhënie seksuale.

Megjithatë, larja nuk është e domosdoshme pas ëndërrimit nëse nuk shihet (hetohet) gjurma e sekrecionit të polucionit, pas derdhjes së pahetueshme të mezisë (lëngut) të bardhë e të verdhë nga organi gjenital për shkak të ledhatimit, të puthjes ose të shikimit të organit të gjinisë së kundërt, pastaj pas lëngut që del nga organi gjenital pas shurrjes.

E kam pyetur Aishen dhe ia kam përmendur thënien e Ibni Umerit: **"Nuk dua të jem me ihramin nga i cili vjen era e parfumit".**

Aishja, ndërkaq, tha: **"Unë e kam parfumosur Pejgamberin s.a.v.s. dhe ai i ka vizituar bashkëshortet e veta, e pastaj,** (pas larjes) **e ka veshur ihramin".**

٢٧١ ـ حدثنا آدمُ قال حدثنا شُعبةُ قال حدثنا الحَكَمُ عن إبراهيمَ عنِ الأسودِ عن عائشةَ قالت : كأنّي أنظرُ إلى وَبيصِ الطِّيبِ في مَفرِقِ النبيِّ ﷺ وهو مُحرِمٌ

271. Na ka treguar Ademi, këtij i ka treguar Shu'be, këtij Hakemi, këtij Ibrahimi, ky nga Esvedi, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Sikur e shoh shkëlqimin e parfumit në flokët e Pejgamberit s.a.v.s. kur ishte i veshur me ihram (kur ishte muhrim)".

باب تَخليلِ الشَّعرِ ، حتّى إذا ظَنَّ أنه قد أروَى بَشَرَتَهُ أفاضَ عليه

٢٧٢ ـ حدثنا عَبدانُ قال أخبرَنا عبدُ اللهِ قال أخبرَنا هِشامُ بنُ عُروةَ عن أبيهِ عن عائشةَ قالت : كان رسولُ اللهِ ﷺ إذا اغتَسلَ منَ الجَنابةِ غسلَ يَدَيهِ ، وتَوضّأَ وُضوءَهُ للصلاةِ ، ثمّ اغتَسلَ ، ثمّ يُخَلِّلُ بيدِهِ شَعرَهُ ، حتّى إذا ظَنَّ أنّه قد أروَى بَشَرَتَهُ أفاضَ عليهِ للماءِ ثلاثَ مرّاتٍ ، ثمّ غَسلَ سائرَ جَسدِهِ

Flokët pastrohen derisa bindet se edhe lëkura është e lagur, e pastaj lahen me ujë

272. Na ka treguar Abdani, këtij i ka treguar Abdullahu, këtij Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, kurse ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. lahej për shkak të marrëdhënieve seksuale, së pari i lante duart, pastaj i lante pjesët përkatëse të trupit sikurse për abdest, pastaj lahej dhe i pastronte me dorë flokët në mënyrë që të ishte i sigurt se edhe lëkurën nën flokë e ka lagur mirë, pastaj derdhte ujë në kokë tri herë, e pastaj i lante pjesët e tjera të trupit".[12]

12 Në çdo larje të detyrueshme (gusël) duhet pastruar patjetër flokët. Në këtë larje ta lagësh lëkurën e kokës dhe lëkurën e mjekrës (nën qime) është detyrë e domosdoshme, kurse te abdesti, kjo vetëm rakomandohet.

٢٧٣ — وقالتْ : كنتُ أغتسِلُ أنا ورسولُ ﷺ مِنْ إناءٍ واحدٍ نَتعرفُ منه جميعاً

273. (Aishja) ka thënë (edhe këtë): **Unë dhe Pejgamberi s.a.v.s. jemi larë nga një enë dhe ujin e kemi marrë së bashku** (nga ajo enë).

باب مَن توضأ في الجنابةِ ثم غَسلَ سائرَ جَسدِهِ ولم يُعِدْ غَسلَ مَواضعِ الوُضوءِ مرةً أخرى

٢٧٤ — حدثنا يوسفُ بنُ عيسى قال أخبرنا الفضلُ بنُ موسى قال أخبرنا الأعمشُ عن سالمٍ عن كُرَيبٍ مَولى ابنِ عباسٍ عن ابن عباسٍ عن مَيمونةَ قالت : وَضعَ رسولُ اللهِ ﷺ وضوءَ الجنابةِ فأكفأ بيمينِهِ على شِمالِهِ مرتينِ أو ثلاثاً ، ثم غَسلَ فَرجَهُ ، ثم ضربَ يدَه بالأرضِ ـ أو الحائطِ ـ مرتين أو ثلاثاً ، ثم مَضمضَ واستَنشقَ وغسلَ وجهَهُ وذِراعَيهِ ، ثم أفاضَ على رأسِهِ الماءَ ، ثم غَسلَ جَسدَهُ ، ثم تنحى فغسلَ رِجلَيهِ . قالت : فأتيتُه بخِرقةٍ فلم يُرِدْها ، فجعلَ يَنفُضُ بيدِه

Abdesti për shkak të marrëdhënieve intime; larja e trupit, por pa i larë vendet e lara më parë, me rastin e marrjes së abdestit

274. Na ka treguar Jusuf b. Isai, këtij Fadil b. Musai, këtij A'meshi, këtij Salimi, ky nga Kurejbi, rob i liruar i Ibni Abbasit, ky nga Ibni Abbasi, e ky nga Mejmunja, e cila ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. kishte vënë ujë për vete, për t'u larë për shkak të marrëdhënieve seksuale dhe me dorën e djathtë derdhi ujë në dorën e majtë dy, ose tri herë, pastaj e lau organin gjenital dhe dorën e fërkoi për dheu ose për muri dy, ose tri herë; e shpërlau gojën dhe hundën (duke e xjerrë ujin përsëri jashtë nga këto); **e lau fytyrën dhe duart** (deri në bërryla). **Pastaj derdhi ujë nëpër kokë; e lau tërë trupin, pastaj u largua anash dhe i lau këmbët. Unë ia solla, thotë Mejmunja, një leckë** (peshkir), **por ai nuk deshti ta përdorë dhe filloi të fshihet me dorën e vet".**

بَابٌ إِذَا ذَكَرَ فِي الْمَسْجِدِ أَنَّهُ جُنُبٌ خَرَجَ كَمَا هُوَ وَلَا يَتَيَمَّمُ

٢٧٥ — حَدَّثَنَا عَبْدُ اللهِ بْنُ مُحَمَّدٍ قَالَ حَدَّثَنَا عُثْمَانُ بْنُ عُمَرَ قَالَ : أَخْبَرَنَا يُونُسُ عَنِ الزُّهْرِيِّ عَنْ أَبِي سَلَمَةَ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ : أُقِيمَتِ الصَّلَاةُ وَعُدِّلَتِ الصُّفُوفُ قِيَامًا ، فَخَرَجَ إِلَيْنَا رَسُولُ اللهِ ﷺ ، فَلَمَّا قَامَ فِي مُصَلَّاهُ ذَكَرَ أَنَّهُ جُنُبٌ فَقَالَ لَنَا « مَكَانَكُمْ » ثُمَّ رَجَعَ فَاغْتَسَلَ ، ثُمَّ خَرَجَ إِلَيْنَا وَرَأْسُهُ يَقْطُرُ ، فَكَبَّرَ فَصَلَّيْنَا مَعَهُ

تَابَعَهُ عَبْدُ الْأَعْلَى عَنْ مَعْمَرٍ عَنِ الزُّهْرِيِّ . وَرَوَاهُ الْأَوْزَاعِيُّ عَنِ الزُّهْرِيِّ

Kur njeriut i bie ndërmend në xhami se është xhunub le të dalë menjherë, e nuk do të marrë tejemmum

275. Na ka treguar Abdullah b. Muhammedi, këtij Uthman b. Umeri, këtij Junusi, ky nga Zuhriu, ky nga Ebu Seleme, e ky nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

U bë ikamet për namaz, xhemati ishte radhitur në safe dhe Pejgamberi s.a.v.s. doli (nga shtëpia e tij). **Pasi qëndroi në vendin në të cilin falej zakonisht, i ra ndërmend se kishte qenë xhunub, prandaj na tha: "Qëndroni në vendet tuaja!" Pastaj u kthye në shtëpi u pastrua, doli, e nga koka, duke i pikuar ende ujë, bëri tekbir** (për të hyrë në namaz), **dhe ne e falëm namazin me të".**

Uthman b. Umeri, në sendin tjetër, të të njëjtit hadith transmeton nga Abdu-l-Alai, ky nga Ma'meri, ky nga Zuhriu, por edhe Evzaiu drejtpërdrejt nga Zuhriu.[13]

---

13 Të pranishmit (xhemati) në xhami duhet të radhiten në safe para se të shprehet tekbiri fillestar. Të gjithë dijetarët islamë e rekomandojnë këtë, kurse Ibni Hazmi e konsideron këtë punë të domosdoshme.

Sipas Shafiut, të pranishmit çohen në këmbë posa muezini të mbarojë këndimin e ikametit. Enes b. Maliku çohej në këmbë, kur muezini gjatë këndimit të ikametit i thoshte fjalët "kad kâmeti-s-salâtu", d.m.th. "namazi po fillon"! Këtë e pranon edhe Imam Ahmedi.

Sipas juristëve të Kufës dhe të shkollës hanefite, xhemati ngrihet në këmbë (para fillimit të namazit) kur muezini shpreh fjalët "hajje ale-s-salatu"! d.m.th. "ejani në namaz", e kur thotë: "kad kameti-s-salâtu", d.m.th. "namazi po fillon", imami shpreh tekbirin fillestar të namazit.

Sipas malikive është sunnet që imami, pas mbarimit të ikametit, t'i thotë xhematit të

باب نَفْضِ الْيَدَيْنِ مِنَ الْغُسْلِ عَنِ الْجَنَابَةِ

٢٧٦ - حدثنا عَبْدَانُ قال أخبرنا أبو حمزة قال سمعتُ الأعمشَ عن سالمٍ عن كُرَيبٍ عن ابنِ عباسٍ قال : قالتْ مَيمونةُ : وَضعتُ للنبيِّ ﷺ غُسلاً فسترْتُه بثوبٍ وصبَّ عَلَى يدَيهِ فغسلَهما ثمَّ صبَّ بيَمينِهِ على شِمالِهِ فغسلَ فَرجَهُ فضربَ بيدِهِ الأرضَ فمسحَها ، ثم غسلَها ، فمضمضَ واستنشقَ وغسلَ وَجهَهُ وذراعَيهِ ، ثمَّ صَبَّ على رأسِهِ وأفاضَ على جَسدِهِ ، ثمَّ تنحَّى فغسلَ قدَمَيهِ ، فناولتُه ثوباً فلم يأخُذْهُ ، فانطلَقَ وهو يَنفُضُ يدَيهِ

Shkundja (fshirja) e ujit me duar, pas larjes nga xhunupllëku

276. Na ka treguar Abdani, këtij Ebu Hamzai, ky ka dëgjuar nga A'meshi, ky nga Salimi, ky nga Kurejbi, ky nga Ibni Abbasi, e ky nga Mejmunja, e cila ka thënë:

"**Ia kam përgatitur ujin Pejgamberit s.a.v.s. për t'u larë** (për shkak se ishte xhunub) **dhe e kam mbuluar me një pëlhurë. Më së pari, Pejgamberi s.a.v.s. ka derdhur ujë në duart e tij dhe i ka larë. pastaj, me dorën e djathtë, ka lëshuar** (derdh) **në të majtën, e lau organin gjenital, e lëshoi dorën në tokë, e fërkoi për dheu, pastaj e lau. Shtiu ujë**

---

radhiten dhe t'i plotësojnë safet, e pastaj të marrë tekbir për të falur namazin.

Imam Zuferi thotë: "Kur muezini thotë herën e parë "kad kâmeti-s-salâtu", çohu në këmbë, e kur këtë ta thotë herën e dytë atëherë filloni të falni namazin".

Imam Ebu Jusufi thotë se namazi fillon pasi të këndohet ikameti, që xhemati të ketë mundësi t'i përcjellë fjalët e muezinit. Këtë mendim e mbështesin edhe Imami Ahmedi dhe Shafiu;

- brenda në shtëpi duhet të ndërtohet banjë;
- xhemati e thotë tekbirin fillestar të namazit së bashku me imamin. Ky është mendim i Ebu Hanifes. Sipas Ebu Jusufit, Muhammedit, Malikut dhe disa juristëve të tjerë, xhemati e thotë tekbirin fillestar menjëherë pas imamit.
- kur personi heton se është xhunub, duhet të dalë menjëherë nga xhamia. Ndërkaq, Sufjani, Thevriu dhe Is-haku rekomandojnë që, për shkak respekti ndaj xhamisë, personi të marrë tejemmum dhe pastaj të dalë jashtë.

Ebu Hanifja thotë: "Udhëtari (xhunub), i cili dëshiron të hyjë në xhami, për të pirë ujë në çeshmen e saj, para se t'i afrohet xhamisë, të marrë tejemmum, e pastaj të hyjë brenda".

Në "Nevadiri" të Ebu Davudit qëndron: "Kush polucon (derdhet) në xhami, duke fjetur në të, duhet të marrë tejemmum menjëherë dhe të dalë nga xhamia".

në gojë dhe në hundë (pastaj e nxorri ujin nga këto), **e lau fytyrën dhe duart deri në bërryla. Pas kësaj, derdhi ujë në tërë kokën dhe i lau pjesët tjera të trupit. Pastaj, shkoi pak anash dhe i lau këmbët. Unë atëherë ia afrova leckën** (peshkirin), **e ai nuk e mori atë, po ia nisi ta shkund (ta heq) ujin nga trupi me dorën e vet".**

باب من بدأ بشق رأسه الأيمن في الغسل

٢٧٧ — حدثنا خلاد بن يحيى قال حدثنا إبراهيم بن نافع عن الحسن بن مسلم عن صفية بنت شيبة عن عائشة قالت: كنا إذا أصابت إحدانا جنابة أخذت بيديها ثلاثا فوق رأسها، ثم تأخذ بيدها على شقها الأيمن، وبيدها الأخرى على شقها الأيسر

Të filluarit nga ana e djathtë e kokës gjatë larjes nga xhunupllëku

277. Na ka treguar Hal-lad b. Jahjai, këtij Ibrahim b. Nafiu, ky nga Hasan b. Muslimi, ky nga Safija, vajza e Shejbes, e kjo nga Aishja, e cila ka thënë:

"Kur ndonjë nga ne kishte marrëdhënie seksuale, merrte ujë me dy duart dhe nga tri herë derdhte në kokë. Pastaj, me njërën dorë merrte për gjysmën e të djathtës dhe me të djathtën merrte për gjysmën e të majtës".

باب من اغتسل عريانا وحده في الخلوة، ومن تستر فالتستر أفضل

وقال بهز عن أبيه عن جده عن النبي ﷺ «الله أحق أن يستحيا منه من الناس»

٢٧٨ — حدثنا إسحاق بن نصر قال حدثنا عبد الرزاق عن معمر عن همام بن منبه عن أبي هريرة عن النبي ﷺ قال «كانت بنو إسرائيل يغتسلون عراة ينظر بعضهم إلى بعض، وكان موسى يغتسل وحده. فقالوا: والله ما يمنع موسى أن يغتسل معنا إلا أنه آدر. فذهب مرة يغتسل، فوضع ثوبه على حجر ففر الحجر بثوبه، فخرج موسى في إثره يقول: ثوبي يا حجر، حتى نظرت بنو إسرائيل إلى موسى فقالوا: والله ما بموسى من بأس. وأخذ ثوبه فطفق بالحجر ضربا» فقال أبو هريرة: والله إنه لندب بالحجر ستة أو سبعة ضربا بالحجر

Të larët duke qenë lakuriq e vetëm dhe të larët i mbuluar - më mirë është të mbulohesh

Behzi transmeton nga babai i vet, ky nga gjyshi i vet, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili ka thënë:

"Më drejtë është që njerëzit të turpërohen nga All-Ilahu".

278. Na ka treguar Is-hak b. Nasri, këtij Abdu-r-Rezaku, ky nga Ma'meri, ky nga Hammam b. Munebbihu, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

"Izraelitët janë larë lakuriq, duke e shikuar njëri-tejtrin, kurse Musai është larë gjithnjë vetëm. Ata bisedonin në mes tyre: Për Zotin, Musai i largohet larjes me ne, vetëm për arsye se është i dëkuar". Një ditë Musai kishte shkuar të lahet, kurse teshat i kishte lënë mbi një gur, i cili u zhduk bashkë me teshat e tij. Atëherë, ka dalë duke folur: **"O gur, teshat e mia, teshat e mia"!** Në këtë gjendje e panë Musain izraelitët dhe thanë: **"Për Zotin, Musai nuk ka diçka të mangët** (të meta fizike)". Më pastaj i rrëmbëu teshat e tij dhe filloi t'i përplasë për guri.

٢٧٩ – وعن أبي هُرَيرةَ عن النبيِّ ﷺ قال « بَينا أيُّوبُ يَغتَسِلُ عُرياناً خَرَّ عليه جَرادٌ من ذَهَبٍ ، فجَعَلَ أيُّوبُ يَحتَثي فى ثَوبِهِ ، فناداه ربُّه : يا أيُّوبُ ألَمْ أكُنْ أغنَيتُكَ عَمَّا تَرى ؟ قال : بَلَى وعِزَّتِكَ ، ولَـكن لا غِنىً بى عن بَرَكَتِكَ » . ورواه إبراهيمُ عن موسىٰ بنِ عُقبةَ عن صَفوانَ بنِ سُلَيمٍ عن عطاء بنِ يَسارٍ عن أبي هُرَيرةَ عنِ النبيِّ ﷺ قال « بَينا أيُّوبُ يَغتَسِلُ عُرياناً . . . »

279. Ebu Hurejre ka thënë edhe: **"Musai, për Zotin, duke i përplasur ato (teshat) për guri ka marrë 6 ose 7 plagë nga ai gur"**. Ebu Hurejre, transmeton nga Pejgamberi s.a.v.s. edhe këtë:

"Kur Ejjubi në një rast është larë lakuriq, te ai ka rënë një karkalec i artë (i shëndritshëm). **Ejjubi është kërrusur ta hedhë atë te teshat e veta, mirëpo Zoti i tij i thirri: "O Ejjub, a nuk të kam dhënë pasuri më të madhe se ai, të cilin ti tash po e sheh"! "Po, gjithsesi, pasha Lartmadhërinë Tënde, unë pa dëshirën Tënde nuk mund të jem i pasur"**, u përgjigj Ejjubi.

Këtë hadithi e ka transmetuar Ibrahim b. Tahmani, ky nga Musa b. Ukbe, ky nga Safvani, ky nga Ata b. Jesari, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. që ka thënë:

"Derisa Ejjubi lahej lakuriq...".[14]

بَابُ التَّسَتُّرِ فِي النُّسلِ عِندَ النَّاسِ

٢٨٠ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ مَسْلَمَةَ عن مالكٍ عن أبي النَّضْرِ مَولَى عُمَرَ بنِ عُبيدِ اللهِ أنَّ أبا مُرَّةَ مَولَى أُمِّ هانِئٍ بنتِ أبي طالبٍ أخبرَهُ أنَّهُ سَمِعَ أُمَّ هانِئٍ بنتَ أبي طالبٍ تقولُ : ذَهَبتُ إلى رسولِ اللهِ ﷺ عامَ الفتحِ فوَجَدْتُهُ يَغتَسِلُ وفاطمةُ تَستُرُهُ ، فقال : مَن هٰذِهِ ؟ فقلتُ : أنا أُمُّ هانِئٍ

Të mbuluarit dhe ruajtja nga njerëzit gjatë larjes

280. Na ka treguar Abdullah b. Mesleme, duke transmetuar nga Maliku, ky nga Ebu Nadri, rob i liruar i Umer b. Ubejdullahut, se Ebu Murre, rob i liruar i Ummu Haniut, vajzë e Ebu Talibit, e ka njoftuar këtë Ummu Hani, duke thënë:

"Në vitin e çlirimit të Mekkes kam shkuar të Pejgamberi s.a.v.s. dhe e kam gjetur duke u larë, kurse Fatimja e mbuloi (me perde të trashë)".

"Kush është"?, pyeti.

"Unë, Ummu Hani".[15] u përgjigja.

---

14 Lejohet larja pa brekë në vend të fshehtë dhe vetëm. Ibni Abbasi nuk ka dashur ta bëjë këtë as në det e as në lumë, duke thënë se edhe në ujë ka gjallesa.
Atija ka thënë: "Kush lahet jashtë, qoftë edhe natën, le të ketë kujdes në vendet e turpshme të trupit. Kush nuk e bën këtë, e pasi t'i ngjajë diçka e keqe, le të qortojë vetveten".
Ebu Davudi dhe Nesaiu në koleksionet e tyre të hadiheve theksojnë se Muhammedi a.s. e ka parë një njeri që lahej jashtë dhe pastaj hipi në minber; pasi e falënderoi All-llahun xh.sh. tha: "All-llahu është i gjallë dhe nga sytë e njeriut është i fshehur; Ai e do turpin dhe mbulesën, prandaj, kur ndonjë nga ju lahet, le të mbulohet dhe le të fshehet nga njerëzit"!
Sipas mendimit të Imam Ahmedit, është gjë e përbuzur të hyret në ujë pa brekë.

15 Nga hadithi shihet se:
- gjatë larjes duhet të fshehen organet e turpshme të trupit nga njerëzit;
- nuk është e lejueshme që pa nevojë t'ia tregosh tjetrit vendet e turpshme të trupit, e as të shikohen organet e turpshme të tjetrit, përveç çiftit bashkëshortor.

٢٨١ – حدثنا عبدانُ قال أخبرنا عبدُ اللهِ قال أخبرنا سُفيانُ عنِ الأعمشِ عن سالمِ بنِ أبي الجعدِ عن كُريبٍ عنِ ابنِ عباسٍ عن ميمونةَ قالتْ : سَتَرْتُ النبيَّ ﷺ وهوَ يَغتسِلُ منَ الجنابةِ ، فغسلَ يديهِ ، ثم صَبَّ بيمينِهِ على شمالِهِ فغسلَ فرجَهُ وما أصابَهُ ، ثمَّ مسحَ يدِه على الحائطِ أوِ الأرضِ ، ثم توضأَ وضوءَهُ للصلاةِ غيرَ رجليهِ ، ثمَّ أفاضَ على جسدِهِ الماءَ ، ثم تنحَّى فغسلَ قدميهِ . تابعهُ أبو عوانةَ وابنُ فُضيلٍ في الستْرِ

281. Na ka treguar Abdani, këtij i ka treguar Abdullahu, këtij Sufjani, ky nga A"meshi, ky nga Salim b. Ebu Xha'di, ky nga Kurejbi, ky nga Ibni Abbasi, e ky nga Mejmunja, e cila ka thënë:

"E kam mbuluar Pejgamberin s.a.v.s. kur pastrohej nga xhunubllëku (për shkak të marrëdhënies seksuale)**. Së pari i lau duart, pastaj, me dorën e djathtë derdhi ujë në dorën e majtë,e lau organin gjenital dhe gjithçka që gjeti ndërmjet shalëve, e pastaj dorën e tij** (të majtë) **e fërkoi për muri ose për dheu** (toke)**; mori abdest sikurse për namaz, përveç larjes së këmbëve; pastaj, i lau pjesët e tjera të trupit,** (pastaj) **u tërhoq anash dhe i lau këmbët".**

(Në sendin tjetër të hadithit) lidhur me çështjen e të mbuluarit, Sufjanin e ndjek Ebu Avane dhe Ibn Fudajli.

باب إذا احتلمت المرأة

٢٨٢ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسفَ قال أخبرنا مالكٌ عن هشامِ بنِ عُروةَ عن أبيهِ عن زينبَ بنتِ أبي سلمةَ عن أمِّ سلمةَ أمِّ المؤمنينَ أنها قالت : جاءت أمُّ سُليمٍ امرأةُ أبي طلحةَ إلى رسولِ اللهِ ﷺ فقالت : يا رسولَ اللهِ إنَّ اللهَ لا يستحيي من الحقِّ ، هل على المرأةِ من غُسلٍ إذا هيَ احتلمتْ ؟ فقال رسولُ اللهِ ﷺ : « نعمْ ، إذا رأتِ الماءَ »

Të derdhurit (polucioni) i gruas në ëndërr

282. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij ia ka transmetuar Maliku, ky nga Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, ky nga Zejnebe b. Ebu Seleme, kjo nga Ummu Selemja, nëna e besimtarëve, e cila ka thënë:

Te Pejgamberi s.a.v.s. erdhi Ummu Sulejmi, bashkëshorte e Ebu Talhait dhe e pyeti:

"O Resulullah, All-llahu nuk turpërohet nga paraqitja e së vërtetës, prandaj (edhe unë nuk turpërohem) **të pyes se a është e detyruar gruaja të lahet kur derdhet në ëndërr** (polucion)"?

"Po, kur sheh lëng (ujë)", u përgjigj Pejgamberi s.a.v.s.[16]

بابٌ عَرَقِ الجُنُبِ ، وَأَنَّ المُسْلِمَ لا يَنْجُسُ

٢٨٣ — حدثنا عليُّ بن عبدِ اللهِ قال حدَّثنا يحيى قال حدَّثنا حُميدٌ قال حدَّثنا بَكْرٌ عن أبي رافعٍ عن أبي هريرةَ أنَّ النبيَّ ﷺ لَقِيَهُ في بعضِ طُرُقِ المَدينةِ وهو جُنُبٌ ، فانْخَنَسْتُ منه ، فذهبَ فاغتسلَ ثمَّ جاء ، فقال : أينَ كنتَ يا أبا هُريرةَ ؟ قال : كنتُ جُنُبًا فكَرِهتُ أنْ أُجالِسَكَ وأنا عَلَى غيرِ طهارةٍ . فقال « سُبحانَ اللهِ ، إنَّ المُسْلِمَ لا يَنْجُسُ »

Djersa e xhunubi dhe, vërtet musliamni nuk është i papastër (i ndyrë)

283. Na ka treguar Ali b. Abdullahu, këtij Jahjai, këtij Humejdi, këtij Bekri, këtij Ebu Rafiu, ky nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë se më kë takuar Pejgamberi s.a.v.s. në një rrugë të Medines, e unë, duke qenë xhunub, u fsheha nga ai, tha Ebu Hurejre. Pastaj shkova, u pastrova dhe u ktheva. Pejgamberi s.a.v.s. më pyeti:

"Ku ishe, o Ebu Hurejre"?

"Qeshë xhunub dhe duke qenë i papastër, nuk e ndjeva veten të disponuar të të shoqërojë", u përgjigja, tha Ebu Hurejre.

---

16 Femra e moshës madhore mund të derdhet (polucion) në ëndërr, sikurse mashkulli. Personi, të cilit nuk i kujtohet ëndrra lidhur me marrëdhënien seksuale, e në tesha vëren gjurmën e polucionit, sipas mendimit të Ibni Abbasit, Sha'biut, Se'id b. Xhubejrit, Nehaiut dhe Ahmedit, duhet të lahet. Ky qëndrim është edhe i juristëve të shkollës hanefite. Ebu Is-haku mendon se larja është e nevojshme (e domosdoshme) vetëm atëherë kur personi bindet se ajo lagështi (ajo gjurmë) është nga polucioni, e sipas mendimit të Hatabiut, posa të vërejë gjurmën e lagështisë, qoftë edhe nëse personi nuk ka bindje të plotë se ajo gjurmë është nga polucioni.

"Subhanallah"! Muslimani në thelb nuk është i papastër" tha Pejgamberi s.a.v.s.[17]

بابُ الجُنُبِ يَخرُجُ ويَمشِي فِي السُّوقِ وغيرِهِ

وقال عطاء : يَحتجِمُ الجُنُبُ ويُقلِّمُ أظفارَهُ ويَحلِقُ رأسَهُ وإنْ لم يَتوَضَّأْ

٢٨٤ – حدثنا عبدُ الأعلَى بنُ حَمَّادٍ قال حدَّثنا يَزِيدُ بنُ زُرَيعٍ قال حدَّثنا سعيدٌ عن قتادةَ أنَّ أنسَ بنَ مالكٍ حدَّثهم أنَّ نبيَّ اللهِ ﷺ كان يَطوفُ عَلَى نِسائِهِ فِي الليلةِ الواحدةِ ، وله يومَئِذٍ تِسعُ نِسوةٍ

Xhunubi mund të dalë, të ecë nëpër qytet (treg) dhe në vende të tjera

Atai ka thënë: **"Xhunubi mund të lëshojë gjak** (mund të jep gjak), **mund t'i presë thonjtë dhe të rruajë kokën, bile edhe nëse nuk ka marrë abdest".**

284. Na ka treguar Abdu-l-A'la b. Hammadi, këtij Jezid b. Zurej', këtij Sa'idi, ky nga Katade se Enes b. Maliku u ka treguar atyre se Pejgamberi s.a.v.s. një natë i ka vizituar bashkëshortet e veta, e atëherë kishte nëntë.

٢٨٥ – حدثنا عيَّاشٌ قال حدَّثنا عبدُ الأعلَى قال حدَّثنا حُمَيدٌ عن بَكرٍ عن أبي رافعٍ عن أبي هُريرةَ قال : لَقِيَنِي رسولُ اللهِ ﷺ وأنا جُنُبٌ ، فأخَذَ بيدي فمَشَيتُ مَعَهُ حتى قعدَ ، فانسَلَلتُ فأتيتُ الرحلَ فاغتسلتُ ، ثمَّ جئتُ وهو قاعدٌ فقال : أينَ كنتَ يا أبا هِرٍّ ؟ فقلتُ له ، فقال « سُبحانَ اللهِ يا أبا هِرٍّ ، إنَّ المُؤمِنَ لا يَنجُسُ »

---

17 Në esencë muslimani nuk është i papastër. Ai është i pastër edhe me abdest edhe pa të. Ibni Abbasi transmeton hadithin: "Mos mendoni se të vdekurit tuaj janë të papastër. Muslimani në thelb nuk është i papastër, qoftë i gjallë qoftë i vdekur".

Ibni Abbasi ka thënë: "Nuk duhet të mendohet i papastër: muslimani xhunub, tesha të cilën ai e ka veshur, vendi të cilin e ka stërpikur duke u larë, e as uji i mbetur në enë, prej së cilës ka marrë me dorë gjatë pastrimit (larjes)".

Djersa e xhunubit është e pastër.

- njerëzit e dijshëm e të moralshëm duhet të respektohen posaçërisht. Kur hyn në shoqërinë e tyre, duhet të vishesh hijshëm, të jesh i pastër, i rruar dhe të sillesh mirë;
- dijetarët duhet t'i përcjellin dhe t'i përmirësojnë njerëzit që i kanë kuptuar gjërat gabimisht.
- larja e detyrueshme (gusli) mund të shtyhet deri kur të fillojë koha e namazit vijues.

285. Na ka treguar Ajjashi, këtij i ka treguar Abdu-l-A'lai, këtij Humejdi, ky nga Bekri, ky nga Ebu Rafiu, e ky nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

"Më ka takuar Pejgamberi s.a.v.s. si xhunub, më kapi për dore, e unë kam ecur me të derisa ai u ul, (pasi u ul) **u tërhoqa, shkova në shtëpinë time, u pastrova dhe përsëri erdha. Ai ende rrinte ulur".**

"Ku qe, Ebu Hurejre"?, më pyeti.

Unë ia tregova rastin tim, e ai më tha:

"Subhanallah! O Ebu Hirr, besimtari (muslimani) **në esencë nuk është i papastër".**[18]

باب كَيْنُونَةِ الْجُنُبِ فِي الْبَيْتِ إِذَا تَوَضَّأَ قَبْلَ أَنْ يَغْتَسِلَ

٢٨٦ – حدثنا أَبُو نُعَيْمٍ قَالَ : حَدَّثَنَا هِشَامٌ وَشَيْبَانُ عَنْ يَحْيَى عَنْ أَبِي سَلَمَةَ قَالَ : سَأَلْتُ عَائِشَةَ أَكَانَ النَّبِيُّ ﷺ يَرْقُدُ وَهُوَ جُنُبٌ ؟ قَالَتْ : نَعَمْ ، وَيَتَوَضَّأُ

Të ndenjurit e xhunubit në shtëpi kur merr abdest, e nuk lahet

286. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi, duke transmetuar nga Hishami dhe Shejbani, ky nga Jahjai, ky nga Ebu Seleme, i cili ka thënë:

E kam pyetur Aishen: **"A ka rënë të flejë Pejgamberi s.a.v.s. duke qenë xhunub"?**

"Po, por, ka marrë abdest", u përgjigj.

باب نَوْمِ الْجُنُبِ

٢٨٧ – حدثنا قُتَيْبَةُ قَالَ حَدَّثَنَا اللَّيْثُ عَنْ نَافِعٍ عَنِ ابْنِ عُمَرَ أَنَّ عُمَرَ بْنَ الْخَطَّابِ سَأَلَ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ أَيَرْقُدُ أَحَدُنَا وَهُوَ جُنُبٌ ؟ قَالَ : نَعَمْ ، إِذَا تَوَضَّأَ أَحَدُكُمْ فَلْيَرْقُدْ وَهُوَ جُنُبٌ »

---

18 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- xhunubi mund t'i kryejë punët e veta në shtëpi dhe jashtë saj;
- për shkaqe shëndetësore dhe fetare është e këshillueshme të merret abdest menjëherë pas marrëdhënies seksuale;
- kur largohesh nga shoqëria e dijetarëve duhet shprehur falënderim.

Të fjeturit xhunub

287. Na ka treguar Kutjebe, këtij Lejthi, ky nga Nafiu, ky nga Ibni Umeri se Umer b. Hattabi e kishte pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"A mund të flejë xhunub ndonjë nga ne"?

"Po, kur merr abdest si xhunub, atëherë le të flejë".[19] qe përgjigjur Pejgamberi s.a.v.s.

بَابُ الْجُنُبِ يَتَوَضَّأُ ثُمَّ يَنَامُ

٢٨٨ – حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ بُكَيْرٍ قَالَ حَدَّثَنَا اللَّيْثُ عَنْ عُبَيْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي جَعْفَرٍ عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ
مَنْ عُرْوَةَ عَنْ عَائِشَةَ قَالَتْ : كَانَ النَّبِيُّ ﷺ إِذَا أَرَادَ أَنْ يَنَامَ وَهُوَ جُنُبٌ غَسَلَ فَرْجَهُ وَتَوَضَّأَ لِلصَّلَاةِ

Xhunubi merr abdest, e pastaj flen

288. Na ka treguar Jahja b. Bukejri, këtij Lejthi, ky nga Ubejdullah b. Ebu Xha'feri, ky nga Muhammed b. Abdu-r-Rahmani, ky nga Urve, ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. donte të fle si xhunub, e lante organin e tij gjenital dhe merrte abdest, ashtu sikurse merrte për namaz".

---

19 Sufjani, Thevriu, Hasan Basriu, Ibni Musejjebi dhe Ebu Jusufi lejojnë që xhunubi të flejë edhe pa marrë abdest. Ata e arsyetojnë këtë mendim me thënien e Aishes: "Kur Pejgamberi a.s. e ndiente nevojën për marrëdhënie intime,e pasi e bënte këtë, ka fjetë edhe pa kërkuar ujë".

Evzaiu, Lejthi, Ebu Hanife, Ebu Muhammedi, Shafiu, Maliku, Ahmedi, Is-haku, Ibni Mubereku dhe shumë juristë të tjerë porosisin që xhunubi të marrë abdest para fjejtjes.

Lidhur me këtë çështje, megjithatë, mendimet janë të ndryshme.

Ebu Hanife, Sufjani Thevriu dhe shumë dijetarë të tjerë thonë se s'prish punë nëse xhunubi flen pa abdest, por është më mirë të marrë abdest, e para ngrënies, të lajë duart dhe gojën.

Evzaiu ka thënë: "Xhunubi dhe gruaja me menstruacione para ngrënies, duhet t'i lajë duart patjetër.

Ibni Hazmi ka thënë: "Është mirë që xhunubi të marrë abdest: para ngrënies, para fjetjes, para se të hyjë në shoqëri dhe para punëve të tjera të përditshme.

Aishja ka thënë se Pejgamberi a.s. kur nuk ka pasur ujë si xhunub merrte tejemmum para fjetjes.

٢٨٩ – حدثنا مُوسىٰ بنُ إسماعيلَ قال حدثنا جُوَيريةُ عن نافعٍ عن عبدِ اللهِ قال : استَفتىٰ عُمرُ النبيَّ ﷺ : أيَنامُ أحدُنا وهوَ جُنبٌ ؟ قال : « نَعمْ ، إذا تَوضَّأَ »

289. Na ka treguar Musa b. Ismaili, këtij Xhuvejriu, ky nga Nafiu, ky nga Abdullahu, i cili ka thënë:

"Umeri ka kërkuar nga Pejgamberi s.a.v.s. shpjegim se a mundet që ndonjëri nga ne të bie të fle xhunub"?

"Po, pasi të marrë abdest", i qe përgjigjur Pejgamberi s.a.v.s.

٢٩٠ – حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرَنا مالكٌ عن عبدِ اللهِ بنِ دِينارٍ عن عبدِ اللهِ بنِ عُمرَ أنه قال : ذَكرَ عُمرُ بنُ الخطّابِ لِرسولِ اللهِ ﷺ أنَّهُ تُصيبُهُ الجَنابةُ منَ الليلِ ، فقال له رسولُ اللهِ ﷺ « تَوضَّأْ واغسِلْ ذَكرَكَ ثُمَّ نَمْ »

290. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Maliku, ky nga Abdullah b. Dinari, ky nga Abdullah b. Umeri, ky nga Umer b. Hattabi, i cili i ka treguar Pejgamberit s.a.v.s. se ka polucion (është derdhur) gjatë natës.

Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë atij"

"Merr abdest, pastroje organin dhe fle"!

بابٌ إذا التقىٰ الختانانِ

حدثنا مُعاذُ بنُ فَضالةَ قال حدثنا هِشامٌ ح

٢٩١ – و حدثنا أبو نُعيمٍ عن هِشامٍ عن قتادةَ عن الحسَنِ عن أبي رافعٍ عن أبي هُريرةَ عن النبيِّ ﷺ قال « إذا جلَسَ بينَ شُعَبِها الأربعِ ثُمَّ جَهَدَها فقد وَجبَ الغُسلُ »

تابَعَهُ عمرُو بنُ مرزوقٍ عن شُعبةَ مِثلَهُ . وقال موسى حدثنا أبانُ قال حدثنا قتادةُ أخبرَنا الحسَنُ مِثلَهُ

Puthitja e dy organeve gjenitale (të bërë synnet)

291. Na ka treguar Muadh b. Fedale, këtij Hishami, dhe sipas sendit tjetër: na ka treguar Ebu Nu'ajmi, duke transmetuar nga Hishami, ky nga Katade, ky nga Hasani, ky nga Ebu Rafiu, ky nga Ebu Hurejre, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili ka thënë:

"Kur (mashkulli) **vendoset në mes katër pjesëve** (duarve dhe këmbëve) **të gruas dhe përpiqet rreth saj** (e vjen deri të puthitja e organit gjenital) **e ka për detyrë të lahet".**

Të njëjtin Hadith e transmeton Amr b. Merzuku, ky nga Hishami, ky nga Shu'be; edhe Musa b. Ismaili thotë:

"Neve na ka treguar Ebani, këtij Katade, duke thënë se për të njëjtin rast e ka njoftuar Hasani".[20]

---

20 Larja e përgjithshme (gusli) është e domosdoshme kur maja e organit gjenital të mashkullit hyn në organin gjenital të femrës. Mendim të kundërt lidhur me këtë kanë: Uthmani, Aliu, Zubjer b. Avvani, Talhai, Ebu Ejjub Ensariu, Ibni Abbasi, Zejd b. Thabiti, Sa'd b. Vekkasi, Ata b. Mes'udi, Rafi Ebu Seid el-Hudriu, Ubej b. Ka'bi etj. Këta janë mbështetur në hadithin të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi:

- E kam pyetur, thotë Ebu Ejjub Ensariu, Pejgamberin a.s. për njeriun të cilin e ka stërpikur sekreti i ejakulimit të gruas.

- vetëm ta lajë, e pastaj të marrë abdest, - u përgjigj.

Disa i janë përmbajtur hadithit: "el-mâu mine-l-mâi", d.m.th. "larja është vetëm për shkak të ujit (polucionit)".

Hazreti Umeri, Ebu Hudhejfe, Ebu Hurejre, Aishja, dhe disa As-habë kanë mendim tjetër. Këta mbështeten në thënien e Aishes, e cila i përgjigjet një personi me fjalët: "Unë dhe Pejgamberi a.s. e kemi patur atë rast, po megjithatë, jemi larë".

Juristët e shkollës hanefite mendojnë se hadithi në të cilin mbështetet grupi i parë i As-habëve është deroguar (është anuluar) me thënien e Ebu Hurejres, që Ebu Davudi e ka përfshirë në Sunenin e tij: "Ubej b. Ka'bi ka njoftuar se Muhammedi a.s. kështu ka vepruar në ditët e para të Islamit që atyre të cilët posa e kanë pranuar Islamin t'u jetë e lehtë feja, e më vonë bile ka urdhëruar që të lahen".

Ebu Davudi thekson më tutje se një njeri i ka thënë halifes Umer se Zejd b. Thabiti ka dhënë përgjigje për këtë rast sipas mendimit të vet.

- Ma sillni! - ka thënë Umeri. Pasi erdhi Zejdi, Umeri i tha:

"Ti je armik i vetvetes! Jam i njoftuar se ti u jep njerëzve vendime sipas gjykimeve tua"!

- O udhëheqës i muslimanëve! Për Zotin, unë nuk veproj ashtu, por sipas hadithit që e

بَابُ غَسْلِ مَا يُصِيبُ مِنْ فَرْجِ الْمَرْأَةِ

٢٩٢ - حدثنا أبو مَعْمَرٍ قال حدثنا عبدُ الوارثِ عن الحُسَيْنِ قال يحيى وأخبرني أبو سَلَمَةَ أَنَّ عطاءَ بْنَ يَسَارٍ أَخْبَرَهُ أَنَّ زَيْدَ بْنَ خَالِدٍ الْجُهَنِيَّ أَخْبَرَهُ أَنَّهُ سَأَلَ عُثْمَانَ بْنَ عَفَّانَ فقال : أَرَأَيْتَ إِذَا جَامَعَ الرَّجُلُ امْرَأَتَهُ فَلَمْ يُمْنِ ؟ قال عثمانُ « يَتَوَضَّأُ كَمَا يَتَوَضَّأُ لِلصَّلَاةِ وَيَغْسِلُ ذَكَرَهُ » قال عثمانُ : سَمِعْتُهُ مِنْ رسولِ اللهِ ﷺ . فسألتُ عن ذلك عليَّ بْنَ أَبِي طَالِبٍ والزُّبَيْرَ بْنَ الْعَوَّامِ وطلحةَ بْنَ عُبَيْدِ اللهِ وأُبَيَّ بْنَ كَعْبٍ رضي الله عنهم فأمروهُ بذلك . قال يحيى وأخبرني أبو سَلَمَةَ أَنَّ عُرْوَةَ بْنَ الزُّبَيْرِ أَخْبَرَهُ أَنَّ أَبَا أَيُّوبَ أَخْبَرَهُ أَنَّهُ سَمِعَ ذلك من رسولِ اللهِ ﷺ

Larja e sekrecionit që del nga organi gjenital i femrës

292. Na ka treguar Ebu Ma'meri, këtij Abdu-l-Varithi, ky nga Husejni, ky nga Jahjai, ky nga Ebu Seleme, ky nga Ata b. Jesari, ky nga Zejd b. Halid Xhuhejniu, i cili e ka pyetur Uthman b. Affanin:

Çka mendon kur njeriu ka marrëdhënie seksuale me gruan dhe nuk ejakulon (nuk derdhet)? Uthmani në këtë pyetje u përgjigj:

"Të marrë abdest sikurse merr për namaz dhe ta lajë organin gjenital. Kështu e kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s.".

Për këtë çështje e kam pyetur edhe Ali b. Ebu Talibin, Zubejr b. Avvamin, Talha b. Ubejdullahun dhe Ubejj b. Ka'bin r.a. Edhe këta kështu kanë urdhëruar.

---

kam dëgjuar nga babai im, ai nga Ebu Ejjub b. Ka'bi dhe nga Rufa b. Rafiu. Atëherë, Umeri iu drejtua Rufa b. Rafiut: "A të mos lahet personi pas marrëdhënies seksuale me bashkëshorten, nëse nuk ejakulon"?

- Kështu kemi vepruar në kohën e Muhammedit a.s. Ai për këtë nuk na ka penguar, e as që kemi dëgjuar ta ketë ndaluar këtë, iu përgjigj Ibni Rafiu.

Ndarjen e mendimeve të As-habëve Umeri e ndriçon në tubimin në Bedr, ku i urdhëroi njerëzit se duhet t'i përmbahen qëndrimit të Aliut dhe Muadhit, të cilët kanë thënë: "Larja është e domosdoshme (farz) posa të puqen organet gjenitale të mashkullit dhe të femrës".

Aliu propozi që të kërkohet edhe mendimi i Hafses. Meqë ajo nuk diti të jep përgjigje të caktuar, është pyetur edhe Aishja; përgjigja e së cilës ishte identike me thënien e Aliut dhe të Muadhit, prandaj Uemeri bërtiti: "Praj tash, kush vepron ndryshe, do t'i ndjejë dhembjet e ramjes"!

Jahjai ka thënë: "**Më ka njoftuar Ebu Selemja, ky nga Urve b. Zubejri se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë të njëjtën gjë**".

٢٩٣ – حدثنا مُسَدَّدٌ حدثنا يحيى عن هِشَامِ بنِ عُرْوَةَ قال أخبرني أبي قال أخبرني أبو أيوب قال أخبرني أُبَيُّ بنُ كعبٍ أنه قال: يا رسولَ اللهِ إذا جامَعَ الرَّجُلُ المَرْأَةَ فلم يُنزِلْ؟ قال: «يَغسِلُ ما مسَّ المرأةَ منهُ ثمَّ يتوضَّأُ ويُصلِّي». قال أبو عبدِ اللهِ: الغُسلُ أحوَطُ، وذاك الآخِرُ. وإنَّما بَيَّنَّا لاختلافِهم.

293. Na ka treguar Museddedi, këtij ia ka transmetuar Jahjai, ky nga Hisham b. Urve, i cili ka thënë:

"Më ka njoftuar babai im, këtë e ka njoftuar, Ubejj b. Ka'bi, i cili e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"O Resulullah, kur njeriu ka marrëdhënie seksuale me gruan, e nuk ejakulon (nuk derdhet)**, çka të bëjë"?**

"Ta lajë atë pjesë (të organit) **me të cilin e ka prekë bashkëshorten, pastaj të marrë abdest dhe të falet"**, që përgjigjur.

Ebu Abdullahu (Buhariu) ka thënë:

"Të larët (e tërësishëm) **është më i sigurtë. Ky është Hadithi i fundit** (i kësaj kaptine) **të cilin e kemi dhënë vetëm për të treguar mendimet e ndryshme të As-habëve"**.[21]

21 Krahas thënieve të sipërshënuara, në "Mugnije" theksohet: "Larja është e domosdoshme (farz) nëse maja e organit gjenital të mashkullit ka hyrë në organin gjenital të femrës, qoftë me dëshirë ose me dhunë, qoftë në ëndërr ose jo".
Puqja e organeve gjenitale nuk e detyron larjen, pos sipas mendimit të Ebu Hanifes dhe Ebu Jusufit duhet të marrë abdest.

6. Menstruacioni (hajzi)

بسم الله الرحمن الرحيم

٦ – كتاب الحيض

وقولِ اللهِ تعالى ﴿ وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْمَحِيضِ ، قُلْ هُوَ أَذًى فَاعْتَزِلُوا النِّسَاءَ فِي الْمَحِيضِ وَلَا تَقْرَبُوهُنَّ حَتَّىٰ يَطْهُرْنَ ، فَإِذَا تَطَهَّرْنَ فَأْتُوهُنَّ مِنْ حَيْثُ أَمَرَكُمُ اللَّهُ ، إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ التَّوَّابِينَ وَيُحِبُّ الْمُتَطَهِّرِينَ ﴾ [٢٢٢ البقرة]

Bismi-l-Lahi-r-Rahmani-r-Rahim

6. Menstruacioni (Hajzi)

All-llahu i Madhëruesheëm (në Kur'an) thotë:

"Dhe të pyesin ty për menstruacionin. Thuaju: "Ai është gjë i neveritshëm". Prandaj, gjatë periudhës së menstruacionit largohuni prej grave dhe mos ju afroni atyre** (mos kini marrëdhënie seksuale) **derisa të pastrohen. E pasi të pastrohen, atëherë afrohuni tek ato ashtu si ju ka urdhëruar All-llahu. Pa mëdyshje, All-llahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen".

(el-Bekare, 222)

باب كيفَ كانَ بَدءُ الحيضِ ، وقولُ النبيِّ ﷺ « هذا شيءٌ كَتَبَهُ اللهُ على بناتِ آدمَ وقالَ بعضُهم : كانَ أولُ ما أُرسِلَ الحيضُ على بني إسرائيلَ . وحديثُ النبيِّ ﷺ أكثرُ

Fillimi i paraqitjes së menstruacioneve

Fjala e Pejgamberit s.a.v.s. është:

"Ai (menstruacioni) **është diçka që All-llahu ua ka përshkruar (dhënë) bijave të Ademit".**

Disa kanë thënë: **"Të parat që u është dhënë menstruacioni janë israelitet".**

Ebu Abdullahu (Buhariu), ndërkaq, ka thënë: **"Hadithi i Pejgamberit s.a.v.s. është më i përgjithshmi dhe më i kuptueshmi".**[1]

بَابُ – الأَمْرِ بِالنُّفَسَاءِ إِذَا نُفِسْنَ

٢٩٤ – حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ عَبْدِ اللهِ قَالَ حَدَّثَنَا سُفْيَانُ قَالَ سَمِعْتُ عَبْدَ الرَّحْمٰنِ بْنَ الْقَاسِمِ قَالَ سَمِعْتُ الْقَاسِمَ يَقُولُ سَمِعْتُ عَائِشَةَ تَقُولُ : خَرَجْنَا لَا نَرَى إِلَّا الْحَجَّ . فَلَمَّا كُنَّا بِسَرِفَ حِضْتُ ، فَدَخَلَ عَلَيَّ رَسُولُ اللهِ ﷺ وَأَنَا أَبْكِي ، قَالَ : مَالَكِ ، أَنُفِسْتِ ؟ قُلْتُ : نَعَمْ . قَالَ « إِنَّ هٰذَا أَمْرٌ كَتَبَهُ اللهُ عَلَى بَنَاتِ آدَمَ ، فَاقْضِي مَا يَقْضِي الْحَاجُّ ، غَيْرَ أَنْ لَا تَطُوفِي بِالْبَيْتِ » قَالَتْ : وَضَحَّى رَسُولُ اللهِ ﷺ عَنْ نِسَائِهِ بِالْبَقَرِ

Gjendja e grave me menstruacione[2]

294. Na ka treguar Ali b. Abdullahu, këtij i ka treguar Sufjani, këtij Abdu-r-Rahman b. Kasimi, këtij Kasimi, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

---

1 Muslimi në Sahiun e vet thekson se gratë hebreje gjatë kohës së menstruacioneve kanë qenë të izoluara nga anëtarët e familjeve të tyre. Prandaj, muslimanët e kanë pyetur Muhammedin a.s. për mënyrën e qëndrimit me gratë e këtilla në bashkësinë islame. Përgjigja e kësaj pyetjeje, sikurse shihet në tekstin e sipërshënuar, jepet në Kur'an në suren el-Bekare në ajetin 222, 223, përkthimi i të cilëve është: "Të pyesin ty për menstruacionin. Thuaju: "Ai është gjë i neveritshëm". Prandaj, gjatë menstruacionit, largohuni prej grave dhe mos ju afroni (mos kini marrëdhënie seksuale) derisa të pastrohen. E pasi të pastrohen, atëherë afrohuni tek ato, ashtu si u ka urdhëruar All-llahu. Pa dyshim All-llahu i don ata që pendohen fort, dhe ata që pastrohen shumë". "Gratë tuaja janë arat tuaja, dhe afrohuni arave tuaja si të doni e paraqitni diçka për shpirtin tuaj. Dhe druajuni All-llahut dhe dijeni se do të takoheni me Të. Pra, përgëzoji besimtarët".

2 Në origjinal është përdorur shprehja, "nifas", që do të thotë "gjakderdhje pas lindjes".

"Kemi dalë me qëllim që të bëjmë vetëm haxhxhin. Kur arritëm në Serif, mua më erdhën menstruacionet. Pejgamberi s.a.v.s. hyri te unë, e unë qaja".

"Çka ke, a të kanë ardhë menstruacionet"?, më pyeti.

"Po", i thashë.

Pejgamberi s.a.v.s., atëherë, tha:

"Kjo është diçka që All-llahu i Madhëruesëm ua ka përshkruar (dhënë) **bijave të Ademit, prandaj bëre atë që e bën çdo haxhi, vetëm mos shko rreth e përqarak Qabes** (mos bën tavaf)"**!**

Pejgamberi s.a.v.s. ka prerë kurban lopën për bashkëshortet e veta, tha Aishja.[3]

باب غسل الحائض رأس زوجها وترجيله

٢٩٥ – حدثنا عبد الله بن يوسف قال حدثنا مالك عن هشام بن عروة عن أبيه عن عائشة قالت: كنت أرجل رأس رسول الله ﷺ وأنا حائض

Bashkëshortja me menstruacione ia lan dhe ia kreh kokën bashkëshortit të saj

295. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Maliku, ky nga Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Unë ia kam krehur flokët Pejgamberit s.a.v.s., duke qenë me menstruacione".

---

3 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- gruaja (haxhi) me menstruacione i kryen të gjitha detyrimet (farz) e haxhillëkut, përveç tavafit rreth Qabes, e nëse e tilla e bën tavaf Qaben, është e detyruar të ther kurban (deven) sikurse xhunubi ose sikurse gruaja me të larat pas lindjes, ndërsa personi pa abdest duhet të ndajë sadakë;
- kafsha e trashë (e rritur) mund të bëhet kurban për shtatë veta;
- haxhiu për bashkëshorten e vet nëse ajo bën haxhxhin e detyrueshëm (farz) mund të ther kurban me pëlqimin e saj, kurse në haxhxhin e padetyrueshëm (nafile) mund ta bëjë këtë edhe pa pëlqimin e saj.

٢٩٦ – حدثنا إبراهيم بن موسى قال أخبرنا هشام بن يوسف أن ابن جريج أخبرهم قال أخبرني هشام عن عروة أنه سئل: أتخدمني الحائض أو تدنو مني المرأة وهي جنب؟ فقال عروة: كل ذلك علي هين، وكل ذلك تخدمني وليس على أحد في ذلك بأس، أخبرتني عائشة أنها كانت ترجل – تعني رأس رسول الله ﷺ – وهي حائض ورسول الله ﷺ حينئذ مجاور في المسجد، يدني لها رأسه وهي في حجرتها فترجله وهي حائض

296. Na ka treguar Ibrahim b. Musai, këtij Hisham b. Jusufi, ky nga Ibni Xhurejxhi, ky nga Hishami, ky nga Urve, të cilin e kanë pyetur:

"A mund të më shërbejë gruaja me menstruacione, respektivisht a mund të më afrohet, duke qenë ajo xhunub"?

Urvja qe përgjigjur:

"Kjo për mua është e lehtë. Personat e këtillë mund të na shërbejnë dhe këtu për asnjë nuk ka farë të keqe. Aishja më ka treguar se, duke qenë me menstruacione, ia ka krehur flokët Pejgamberit s.a.v.s. kur ai ka qenë në i'tikaf në xhaminë e tij. Ai ia ka afruar kokën asaj, kur ka qenë në dhomën e saj, e ajo, ndonëse ka qenë me menstruacione e ka krehur".[4]

باب قراءة الرجل في حجر امرأته وهي حائض

وكان أبو وائل يرسل خادمه وهي حائض إلى أبي رزين فتأتيه بالمصحف فتمسكه بعلاقته

٢٩٧ – حدثنا أبو نعيم الفضل بن دكين سمع زهيراً عن منصور بن صفية أن أمه حدثته أن عائشة حدثتها أن النبي ﷺ كان يتكيء في حجري وأنا حائض ثم يقرأ القرآن

4 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- i'tikafi nuk prishet kur mu'tekifi e nxjerr nga ai dorën, këmbën ose kokën për një kohë më të gjatë;
- lejohet të preket bashkëshortja në ditët me menstruacione;
- gruaj me menstruacione nuk duhet të hyjë në xhami, për shkak të respektit ndaj saj;
- shërbimi dhe prekja e ndërsjellë e çiftit bashkëshortor nuk e prish abdesin që është marrë më parë.

Të lexuarit (Kur'an) duke qenë mbështetur në supat e bashkëshortes me menstruacione

Ebu Vaili e ka dërguar shërbetoren e vet te Ebu Rezini (për t'ia sjellur Mus-hafin). **Ndonëse ajo ishte me menstruacione, ia solli Mus-hafin, por duke e mbajtur për mbështjellëse** (të mbështjellur).

297. Na ka treguar Ebu Nu'ajm el-Fadl b. Dukejni, i cili e ka dëgjuar Zuhejrin, duke transmetuar nga Mensur b. Safija, të cilit i ka treguar nëna e tij, se Aishja ka thënë:

"Pejgamberi s.a.v.s. mbështetej në gjoksin tim dhe lexonte Kur'an, ndonëse unë isha me menstruacione".[5]

باب من سمّى النفاس حيضا

٢٩٨ — حدثنا المكيّ بن إبراهيم قال حدثنا هشام عن يحيى بن أبي كثير عن أبي سلمة أنّ زينب ابنة أمّ سلمة حدّثته أن أمّ سلمة حدّثتها قالت : بينما أنا مع النبيّ ﷺ مضطجعة في خميصة إذ حضت ، فانسللت فأخذت ثياب حيضتي . قال : أنفست ؟ قلت : نعم . فدعاني فاضطجعت معه في الخميلة

Ai që e quan nifasin hajz

298. Na ka treguar Mekijj b. Ibrahimi, këtij Hishami, ky nga Jahja b. Ebu Kethiri, ky nga Ebu Selemja, ky nga Zejnebja, vajzë e Ummu Selemes, kjo nga Ummu Selemja (nëna e vet), e cila ka thënë:

---

5 Gruaja me menstruacione dhe personi xhunub mund ta mbajnë Kur'anin vetëm të mbështjellur, në çantë, në kuti e të ngjashme.
Ibni Umeri, në një rast, si xhunub lexoi nga një letër e vogël një tekst të Kur'anit dhe në vërejtjen që i është bërë, që përgjigjur: "Unë mbaj me vete tesktin e Kur'anit më shumë se ky në këtë letër të vogël".
Ibni Hazmi ka thënë: "Citimi i tekstit të Kur'anit, të shprehurit e ndonjë duaje, bartja e Kur'anit të mbështjellur, lejohet, qoftë personi me menstruacione ose xhunub. Këtë mendim e mbështesin Rebia, Seid b. Musejjebi, Ibni Xhubejri, Ibni Abbasi dhe shumë bashkëkohanikë të tyre;
- lejohet të citohet Kur'ani në afërsi të vendit të papastër, ndonëse nga respekti ndaj Kur'anit, nuk duhet bërë këtë;
- i sëmuri kur falet mund të mbështetet në bashkëshorten e tij me menstruacione, nëse ajo i ka teshat e pastra.

"Rrija shtrirë pranë Pejgamberit s.a.v.s. Unë kisha veshur fustanin e qëndisur me gurë të çmueshëm (ar. hamîsa)**. Më erdhën menstruacionet dhe pa e bërë të madhe** (pa u dëgjuar)**, u tërhoqa anash dhe e vesha fustanin për menstruacione.**

"A ke gjakderdhje - menstruacione - (duke e përdorur fjalën me kuptim të gjakderdhjes pas lindjes, d.m.th. nifas)", pyeti.

"Po", i thashë.

"Pastaj, më thirri dhe rashë me të, duke u mbuluar me mbulojën prej kadifeje (ar. el-hamîle)".[6]

باب مُباشَرةِ الحائضِ

٢٩٩ – حدثنا قَبيصةُ قال حدثنا سُفيانُ عن مَنصورٍ عن إبراهيمَ عنِ الأسودِ عن عائشةَ قالت: كنتُ أغتَسِلُ أنا والنبيُّ ﷺ من إناءٍ واحدٍ كلانا جُنُبٌ

Prekja e gruas gjatë menstruacioneve

299. Na ka treguar Kabise, këtij Sufjani, këtij Mensuri, ky nga Esvedi, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Unë dhe Pejgamberi s.a.v.s. jemi larë së bashku nga një enë, kemi qenë të dy xhunub (të papastër)".

---

6 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- lejohet të flihet në shtrat me bashkëshorten me menstruacione.
- gruaj me menstruacione ose me gjakderdhje pas lidnjes nuk mund të falë namazin, nuk mund të agjërojë, nuk mund të lexojë tekste të gjata të Kur'anit, e as ta mbajë Kur'anin të pa mbështjellur;
- në një rast Ummu Selemja e ka pyetur Pejgamberin a.s.,
- sa zgjat gjakderdhja pas lindjes?
- Ajo zgjat dyzet ditë, po qe se nuk ndërpitet më herët - u përgjigj Muhammedi a.s.

Te "Kitabu-l-ahkam" të Ebu Ali Tavusit qëndron: "Të gjithë As-habët e ditur dhe gjenerata pas tyre mendojnë se gruaja nuk është e detyruar të falet dyzet ditë pas lindjes, e nëse gjakderdhja i ndërpitet më herët, mund të lahet dhe të fillojë të falet. Gruaj me gjakderdhje, pasi të kalojnë dyzet ditë, e ka statusin "sâhib-i udhûr" dhe duhet t'i kryejë detyrimit fetare.

٣٠٠ – وكانَ يأمُرُني فأتَّزِرُ فيُباشِرُني وأنا حائض

300. Ai më urdhëroi, pradnaj u mbulova me teshën e poshtme dhe, pastaj, ndonëse unë isha me menstruacione, ai filloi të më prekë.

٣٠١ – وكانَ يُخرِجُ رأسَهُ إليَّ وهوَ مُعتكِفٌ فأغسِلُهُ وأنا حائض

301. E, kur ishte në i'tikaf ma ka afruar kokën, e unë ia kam larë, ndonëse isha me menstruacione.[7]

٣٠٢ – حدثنا إسماعيلُ بنُ خَليلٍ قال أخبرَنا عليُّ بنُ مُسهِرٍ قال أخبرَنا أبو إسحاقَ – هوَ الشَّيبانيُّ – عن عبدِ الرحمٰنِ بنِ الأسودِ عن أبيهِ عن عائشةَ قالت : كانت إحدانا إذا كانت حائضاً فأرادَ رسولُ اللهِ ﷺ أن يُباشِرَها أمَرَها أن تَتَّزِرَ في فَورِ حَيضَتِها ثمَّ يُباشِرُها . قالت : وأيُّكُم يَملِكُ إربَهُ كما كانَ النبيُّ ﷺ يَملِكُ إربَه ! تابَعَهُ خالدٌ وجريرٌ عنِ الشَّيبانيِّ

302. Na ka treguar Ismail b. Halili, këtij Ali b. Mus-hiri, këtij Ebu Is-hak Shejbaniu, ky nga Abdu-r-Rahman b. Esvedi, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Kur ndonjëra nga ne ishte me menstruacione, e Pejgamberi s.a.v.s. dëshironte të bie në kontakt me të, e ka urdhëruar atë që në valën e gjakderdhjes (nga menstruacionet) **të mbulohet, e atëherë** (pasi mbulohej)

---

7 Nga këta hadithe mund të nxirret përfundimi:
- bashkëshortët mund të lahen me ujin e marrë nga një enë;
- lejohet argëtimi i ndërsjellë i burrit me gruan me menstruacione e nëse burri bën edhe marrëdhënie seksuale, është i detyruar të presë kurban për të varfërit, respektivisht t'i ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Ky është qëndrim i Katades, Evzaiut, Ahmedit, Is-hakut dhe Shafiut, ndërsa juristët e shkollës hanefite thëksojnë domosdonë e pendimit të sinqertë dhe të kërkojnë falje nga All-llahu xh.sh.
- i lejohet mashkullit ta prekë bashkëshorten me menstruacione por vetëm trupin mbi bel dhe nën gjunjë, kurse pjesët e trupit në mes belit dhe gjunjëve, vetëm po të jenë të mbuluara me veshje;
- gruaja me menstruacione mund t'i kryejë të gjitha punët shtëpiake dhe të mos ndahet nga burri dhe nga anëtarët tjerë të shtëpisë.

do ta prekte. Mirëpo, cili prej jush është në gjendje ta mbizotërojë epshin e tij, siç e ka mbizotëruar Pejgamberi s.a.v.s."? tha Aishja.

Në sendin tjetër pas Ali b. Mus-hirit vjen Halidi dhe Xheriri, të cilët të njëjtin hadith e transmetojnë nga Shejbaniu.

٣٠٣ ـ حدثنا أبو النعمان قال حدثنا عبد الواحد قال حدثنا الشيباني قال حدثنا عبد الله بن شداد قال سمعت ميمونة : « كان رسول الله ﷺ إذا أراد أن يباشر امرأة من نسائه أمرها فأتزرت وهي حائض ». ورواه سفيان عن الشيباني

303. Na ka treguar Ebu-n-Nu'mani, këtij Abdu-l-Vahidi, këtij Shejbaniu, ky nga Abdullah b. Sheddadi, i cili thotë se e ka dëgjuar Mejmunen, duke thënë:

"Kur Pejgamberi s.a.v.s. donte të ledhatohej me ndonjërën nga bashkëshortet e veta, po të ishte ajo me menstruacione, e urdhëronte të mbulohej me pjesën e poshtme të veshjes së saj".[8]

Hadithin e sipërshënuar e ka transmetuar edhe Sufjani nga Shejbaniu.

باب ترك الحائض الصوم

٣٠٤ ـ حدثنا سعيد بن أبي مريم قال أخبرنا محمد بن جعفر قال أخبرني زيد هو ابن أسلم عن عياض ابن عبد الله عن أبي سعيد الخدري قال « خرج رسول الله ﷺ في أضحى ـ أو في فطر ـ إلى المصلى ، فمر على النساء فقال : يا معشر النساء تصدقن ، فإني أريتكن أكثر أهل النار ، فقلن : وبم يا رسول الله ؟ قال : تكثرن اللعن ، وتكفرن العشير ، ما رأيت من ناقصات عقل ودين أذهب لب الرجل الحازم من إحداكن . قلن وما نقصان ديننا وعقلنا يا رسول الله ؟ قال : أليس شهادة المرأة مثل نصف شهادة الرجل ؟ قلن : بلى . قال : فذلك من نقصان عقلها . أليس إذا حاضت لم تصل ولم تصم ؟ قلن : بلى . قال : فذلك من نقصان دينها »

8 Nga hadithi del se:
- gjatë ditëve të menstruacioneve gruaja të veshet më thjeshtë, në mënyrë më modeste, që të mos ta provokojë burrin për marrëdhënie intime;
- argëtimi me bashkëshorten me menstruacione i lejohet atij që mund të përmbahet dhe e di me siguri që nuk do të bëjë marrëdhënie intime.

Gruaja me menstruacione nuk agjëron

304. Na ka treguar Se'id b. Ebu Mejremi, këtij i ka treguar Muhammed b. Xha'feri, këtij Zejdi, ky është Ibni Eslemi, ky nga Ijad b. Abdullahu, ky nga Ebu Se'id el-Hudriu, i cili ka thënë:

"Doli Pejgamberi s.a.v.s. në vendin ku zakonisht e falte namazin në ditën e Kurban-Bajramit ose Fitër-Bajramit. Kaloi pranë disa grave të cilat i pyeti: "O ju gra, a keni dhënë sadakë" Më ka rënë të vërej se shumica nga ju janë në xhehennem".

"Përse, O Resulullah"? pyetën ato.

Pejgamberi s.a.v.s. tha:

"Shpesh mallkoni dhe ndaj bashkëshortëve tuaj nuk jeni mirënjohëse. Unë nuk kam parë asnjë më mëndjelehtë dhe me besim më të mangët, e që ia merr mendjen edhe njeriut më të vendosur".

"Çka mungon në besimin tonë dhe në mendjen tonë, o Resulullah"? pyetën ato.

"A nuk është dëshmia e gruas sa gjysma e dëshmisë së burrit?", u përgjigj (Pejgamberi s.a.v.s.).

"Po", thanë ato.

"Pra, ajo rrjedh nga mangësia e mendjes suaj", tha.

"E, a nuk është gruaja me menstruacione ajo që nuk falet dhe nuk agjëron"?, tha (Pejgamberi s.a.v.s.)

"Po", thanë

"Kjo është pra, mangësia e besimit",[9] tha.

---

9 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- rekomandohet që namazi i Bajrameve të falet në vend të gjerë dhe të hapët. Kjo mënyrë e faljes së Bajrameve është praktikuar sidomos në shekullin e parë islam, e më vonë, ndonëse ka rënë pak, prapëseprapë vazhdon të qëndrojë edhe tash;
- sadakaja duhet të ndahet gjithnjë, në çdo kohë, e sidomos në ditët e Bajrameve. Ata që jetojnë në begati dhe jetë të mirë, janë të detyruar t'u ndihmojnë materialisht të varfërve;
- gratë mund të marrin pjesë na faljen e namazit të Bajrameve, përveç në ditët e rrezikshme. Aishja një herë ka thënë: "Po të shihte Pejgamberi a.s. se çka ngjet me gratë, ai do t'ua ndalonte atyre pjesëmarrjen në xhami, siç u qe ndaluar grave hebreje.
Ebu Bekri. Aliu, Ibni Umeri dhe disa As-habë të tjerë mendojnë se gratë janë të detyruara

باب تقضي الحائض المناسك كلها إلا الطواف بالبيت

وقال إبراهيم : لا بأس أن تقرأ الآية . ولم ير ابن عباس بالقراءة للجنب بأسا . وكان النبي ﷺ يذكر الله في كل أحيانه . وقالت أم عطية : كنا نؤمر أن نخرج الحيض فيكبرن بتكبيرهم ويدعون . وقال ابن عباس أخبرني أبو سفيان أن هرقل دعا بكتاب النبي ﷺ فقرأ فاذا فيه ﴿ بسم الله الرحمن الرحيم . ويا أهل الكتاب تعالوا إلى كلمة ﴾ الآية . وقال عطاء عن جابر : حاضت عائشة فنسكت المناسك غير الطواف بالبيت ولا تصلي . وقال الحكم : إني لأذبح وأنا جنب . وقال الله تعالى ﴿ ولا تأكلوا مما لم يذكر اسم الله عليه ﴾ [الأنعام ١٢١]

---

të shkojnë në musal-la të dëgjojnë ligjërata dhe të marrin pjesë në manifestimet festive. Ndërkaq, Urve, Kasimi, Jahja b. Seidi dhe Ebu Hanife e kushtëzojnë këtë me rrethanat e krijuara dhe me ngritjen morale të shoqërisë; ndërsa, Maliku dhe Ebu Jusufi u lejojnë plakave dhe grave të martuara, kurse vajzave ua ndalojnë.

Te Bedaiu qëndron kështu: "Dijetarët e shkollës hanefite mendojnë se vajzat nuk duhet të marrin pjesë në Bajrame, në xhuma dhe festa të tjera, sepse në Kur'an thuhet: "Ato le të qëndrojnë në shtëpitë e tyre! Prania e tyre mund të shkaktojë mosmarrëveshje dhe mund ta prishë etikën morale, për të cilin përpiqet çdo njeri".

Imam Ebu Jusufi mendon se gratë duhet të marrin pjesë në manifestimet dhe në mësimin e duave të imamit, për të shprehur kështu solidaritetin e përgjithshëm islam.

Buhariu dhe Muslimi në "Sahihun" e tyre theksojnë hadithin: "Mos i pengoni gratë nga faltoret e All-llahut"!

Qëndrimi i Ebu Hanifes për rastet e sipërpërmendura është:

- rekomandohet që të mësohen gratë, qoftë individualisht, qoftë kolektivisht;
- vetitë negative të njerëzve duhet nxjerrë në pah me maturi dhe me zë të fuqishëm qoftë në mënyrë të tërthortë qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- me sadaka arrihet mëshira, dashuria dhe falja e All-llahut xh.sh. për gabimet e vogla;
- është haram të mohohet mëshira e All-llahut xh.sh., e është gjë e përbuzur të jesh mosmirënjohës ndaj njerëzve që të bëjnë shërbime;
- është e ndaluar rreptësisht që në shoqëri të fliten fjalë të turpshme dhe të ashpra dhe t'i mallkosh njerëzit pa të drejtë. Ai që e bën këtë hyn në grupin e gabimtarëve (gjynahqarëve) të mëdhenj, të cilët All-llahu xh.sh. do t'i dënojë me dënimin e Xhehennemit;
- gabimet e mëdha nuk janë larg mosbeismit (qufrit);
- rinia duhet ta shfrytëzojë përvojën e të moshuarve;
- dëshmia e dy grave është e barabartë me dëshminë e një burri;
- në përmirësimin e gjendjes materiale të të varfërve duhet angazhuar maksimalisht dhe,
- femra me menstruacione është e liruar nga falja e namzit dhe nga agjërimi i Ramazanit.

Gruaja me menstruacione i kryen të gjitha detyrimet e haxhxhit, përveç tavafit rreth Qabes

Ibrahimi ka thënë: **"Nuk është gjynah që personi (me menstruacione) të lexojë Kur'an".**

Ibni Abbasi nuk e ka konsideruar diçka të keqe që xhunubi të lexojë Kur'an. Pejgamberi s.a.v.s. e ka përmendur All-llahun në çdo moment.

Ummu Atije ka thënë: **"Na është urdhëruar që të dalin** (në vendin e caktuar) **edhe personat me menstruacione, ta bëjnë tekbirin dhe t'i luten All-llahut".**

Ibni Abbasi ka thënë: "Më ka njoftuar Sufjani se Herakleu e kërkoi letrën e Pejgamberit s.a.v.s., në të cilën qëndronte: **Bismi-l-Lahi-r-Rahmani-r-Rahim dhe ajeti:**

"O ithtarët e Librit, kujtonie tregimin, që është për ne dhe për ju...".

(Ali Imrân 64).

Atai ka transmetuar nga Xhabiri: **"Aishja ka pasë menstruacione dhe, megjithatë, i ka kryer të gjitha obligimet e haxhillëkut, përveç tavafit rreth Qabes dhe faljes së namazit".**

Hakemi ka thënë: **"Unë ther** (bagëti) **duke qenë xhunub, sepse All-llahu ka thënë:**

"Mos e hani atë që është therë pa u përmendur emri i All-llahut...".

(el-En'âm, 121).

٣٠٥ ـ حدثنا أبو نُعيم قال حدثنا عبدُ العزيزِ بنُ أبي سَلَمةَ عن عبدِ الرحمٰنِ بنِ القاسمِ عن القاسمِ بنِ محمدٍ عن عائشةَ قالت: خَرَجْنا مَعَ النبيِّ ﷺ لا نذكُرُ إلا الحجَّ. فلمّا جِئْنا سَرِفَ طَمِثْتُ، فدخَلَ عَلَيَّ النبيُّ ﷺ وأنا أبكي، فقال: ما يُبكيكِ؟ قلتُ: لَوَدِدْتُ واللهِ أنّي لم أحُجَّ العامَ. قال: لَعَلَّكِ نُفِسْتِ؟ قلتُ: نعم. قال: «فإنَّ ذٰلكِ شيءٌ كتَبَهُ اللهُ على بناتِ آدمَ، فافعَلي ما يَفعَلُ الحاجُّ، غيرَ أنْ لا تَطوفي بالبيتِ حتّى تَطْهُري».

305. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi, këtij Abdu-l-Aziz b. Ebu Seleme, ky nga Abdu-r-Rahman b. Kasimi, ky nga Kasim b. Muhammedi, ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Kemi dalë me Pejgamberin s.a.v.s. të bëjmë haxhillëkun. Kur arritëm në Serif, mua më erdhën menstruacionet. Pejgamberi s.a.v.s. hyri te unë, dhe më gjeti duke qarë.

"Pse po qan"?, më pyeti.

"Për Zotin, do të dëshiroja të mos jem në haxhillëk këtë vit", i thashë.

"Ndoshta ke gjakderdhje sikur pas lindjes (duke menduar në menstruacione)"?, më pyeti dhe vazhdoi të thotë: **"Ai është diçka që All-llahu i Madhërueshëm ua ka përshkruar** (dhënë) **bijave të Ademit. Vepro, ashtu si veprojnë haxhillarët tjerë, vetëm mos bën tavaf rreth Qabes, derisa të pastrohesh"!**[10]

باب الاستحاضة

٣٠٦ — حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرنا مالكٌ عن هِشامِ بنِ عُروةَ عن أبيهِ عن عائشةَ أنها قالت : قالت فاطمةُ بنتُ أبي حُبَيْشٍ لرسولِ اللهِ ﷺ : يا رسولَ اللهِ إني لا أطهُرُ ، أفأدَعُ الصلاةَ ؟ فقال رسولُ اللهِ ﷺ « إنما ذلك عِرْقٌ وليسَ بالحيضةِ ، فإذا أقبلَتِ الحيضةُ فاتْرُكي الصلاةَ ، وإذا ذَهبَ قَدْرُها فاغسِلي عنكِ الدمَ وصَلِّي »

Gjakderdhja edhe pas menstruacioneve

306. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Maliku, ky nga Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

---

10 Xhunubi për nga papastërita është i barabartë me gruan me menstruacione. Për Ibni Abbasin nuk prish punë që xhunubi të lexojë 1-2 ajete, kurse Ahmedi dhe Maliku lejojnë të lexohet vetëm një ajet.

Përkthimi i ajetit 64 të surse "Ali Imrân", të cilin e shënoi Muhammedi a.s. në letrën që ia dërgoi Herakleut thekson: "Thuaj: O ithtarët e Librit, kujtonie treginin, që është për ne dhe për ju: T'i shërbejmë vetëm All-llahut që të mos i bëjmë Atij shok asgjë, që njeri-tjetrin në vend të All-llahut mos ta konsiderojmë për Zot.: E nëse ata kthehen nga kjo e vërtetë, thuaju atyre: "bëhuni dëshmitarë se ne jemi muslimanë"!

Muhammedi a.s. lejoi të shkruhet dhe t'i dërgohet teksti i ajetit të sipërpërmendur mbretit bizantin, duke e ditur se ai si jomusliman xhunub do ta lexojë atë. Kur Muhammedi a.s. ia lejoi këtë jomuslimanit, atëherë sigurisht i lejohet edhe muslimanit xhunub dhe personit me menstruacione.

Hakem b. Kutejbi tëreq vërejtjen se si xhunub e ka shprehur besmelen dhe tekbirin, e pastaj e ka prerë kafshën.

Fatime b. Ebu Hubejshi e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"O Resulullah, nuk mund të pastrohem! a ta lë namazin (të mos falem)"?

Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj: **"Ai është vetëm gjak i** (plasjes) **së kapilareve, e nuk janë menstruacione. Kur të të paraqiten ty menstruacionet, lëre namazin, e kur të kalojë afati i tyre, pastroje gjakun** (laju) **dhe falu"!**[11]

---

11 Këtë hadith e citojnë me pak ndyrshime edhe muhaddithë të tjerë, kurse Tirmidhiu e përfundon me fjalët: "... lahu pasi të mbarojnë menstruacionet, e pastaj merr abdest për çdo kohë të namazit"!

Tehaviu thekson: "... për shkak pastrimi lahu dhe merr abdest për çdo namaz"!

Në përmbledhjen e haditheve të Ahmed b. Hambelit qëndron: "... lahu dhe për çdo namaz merr abdest"!

Ebu Davudi, përmes Aishjs thekson se Ummu Habibe b. Xhahshi ka patur gjakderdhje të jashtëzakonshme afër shtatë vjet, prandaj erdhi te Pejgamberi a.s. dhe e pyeti për mënyrën e faljes së namazit: "Ato nuk janë menstruacione, por gjakderdhje e kapilareve. Lahu dhe fale namazin", i qe përgjigjur Muhammedi a.s. Ummu Habibja, pastaj, u kthye te motra e saj, Zejnebja, dhe u pastrua. Gjaku i kuq mbi sipërfaqen e ujit ishte mjaft i dukshëm.

Këtë mendim e mbështesin përfaqësuesit e shkollave burimore islame.

Ebu Davudi e tregon edhe rastin e Sehle b. Suhejlit të cilës Muhammedi a.s. i qe përgjigjur: "Lahu para faljes së çdo namazi"! Pasi ajo i shprehu pamundësi, Muhammedi a.s. i tha që të lahet para se të përfundojë namazi i drekës dhe ta falë këtë namaz, e pastaj, posa të fillojë koha e namazit të iqindisë, ta falë menjherë iqindinë, e para se të përfundojë namazi i akshamit, të lahet dhe ta falë namazin e akshamit, e pastaj, posa të fillojë koha e namazit të jacisë, ta falë namazin e jacisë dhe kështu të veprojë edhe me kohët tjera të namazit.

Kjo është mënyra më ideale e ruajtjes së pastërtisë, por vetëm ato që kanë kushte të nevojshme.

Ebu Hanifja mendon se koha e zgjatjes së abdestit të vlefshëm të gruas me gjakderdhje të jashtëzakonshme është e kufizuar me gjatësinë e zgjatjes së një kohe të namazit në të cilën gruaja mund t'i kryejë të gjitha detyrat e domosdoshme (farzet) dhe punët vullnetare fetare. Me përfundimin e kohës së namazit, në të cilën është marrë abdest, ndëpritet edhe plotëfuqishmëria (vlera) e atij abdesti.

Me ndërprerjen e gjakderdhjes së jashtëzakonshme, larja nuk është e domosdoshme, por vetëm e rekomandueshme.

بابُ غَسلِ دَمِ الحَيضِ

٣٠٧ - حدثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرنا مالكٌ عن هِشامٍ عن فاطمةَ بنتِ المُنذِرِ عن أسماءَ بنتِ أبي بَكرٍ أنها قالت : سألَتِ امرأةٌ رسولَ اللهِ ﷺ فقالت : يا رسولَ اللهِ ، أرأيتَ إحدانا إذا أصابَ ثوبَها الدَّمُ منَ الحيضةِ كيفَ تصنَعُ ؟ فقال رسولُ اللهِ ﷺ « إذا أصابَ ثوبَ إحداكُنَّ الدمُ منَ الحيضةِ فلْتقرُصْهُ ثُمَّ لِتنضَحْهُ بماءٍ ثُمَّ لتُصلِّ فيهِ »

Larja e gjakut të menstruacioneve

307. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Malíku, ky nga Hishami, ky nga Fatime b. Mundhiri, kjo nga Esma b. Ebu Bekri, e cila ka thënë:

"Një grua e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s. me këto fjalë:

"Çka mendon, o Resulullah, kur në teshat e ndonjërës nga ne bie gjaku i menstruacioneve, si të veprojë"?

Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj: **"Kur teshat tuaja stëpriken nga gjaku i menstruacioneve, le të pastrohen, duke i fërkuar derisa të evitohet njolla, pastaj le të lahen me ujë dhe me to të falet namazi"!**

٣٠٨ - حدثنا أصبَغُ قال أخبرَني ابنُ وَهبٍ قال أخبرَني عمرُو بنُ الحارثِ عن عبدِ الرحمٰنِ بنِ القاسمِ حدَّثَهُ عن أبيهِ عن عائشةَ قالت : كانت إحدانا تحيضُ ثُمَّ تَقْتَرِصُ الدمَ من ثوبِها عندَ طُهرِها فتَغسِلُه وتنضحُ على سائرِه ثُمَّ تُصلِّي فيه

308. Na ka treguar Asbegu, këtij Ibni Vehbi, këtij Amr b. Harithi, ky nga Abdu-r-Rahman b. Kasimi, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Kur ndonjë nga ne ka menstruacione, ajo para së gjithash e pastron (e largon) **gjakun duke e fërkuar teshën e saj, e lan atë pjesë, i lan edhe pjesët tjera që janë me gjak dhe me të mund të falë namazin".**

بابُ الاعتِكافِ للمُستَحاضةِ

٣٠٩ - حدثنا إسحاقُ قال حدَّثَنا خالدُ بنُ عبدِ اللهِ عن خالدٍ عن عِكرِمةَ عن عائشةَ أنَّ النبيَّ ﷺ اعتَكَفَ معَهُ بعضُ نسائِهِ وهيَ مُستحاضةٌ تَرَى الدمَ ، رُبَّما وَضَعَتِ الطَّسْتَ تحتَها منَ الدَّمِ . وَزَعَمَ أنَّ عائشةَ رأتْ ماءَ الصُّفرِ فقالت : كأنَّ هذا شيءٌ كانت فُلانةُ تَجِدُه

Qëndrimi në i'tikaf me gjakderdhje të çrregulluar

309. Na ka treguar Is-haku, këtij Halid b. Abdullahu, ky nga Halidi, ky nga Ikrime, e ky nga Aishja, e cila tregon se Pejgamberi s.a.v.s. kur shkonte të qëndrojë në i'tikaf e merrte me vete një nga bashkëshortet e veta, ndonëse ishte me gjakderdhje të çrregulluara. Ajo e hetonte gjakderdhjen e çrregulluar, dhe për këtë shkak, nganjëherë, vënte një tas (si legen) nën të.

(Ikrime) **thotë se, në të vërtetë, Aishja ka parë lëng të verdhë, por ka treguar se, gjoja, e ka pasë një** (bashkëshorte) **tjetër.**[12]

٣١٠ – حدثنا قتيبة قال حدثنا يزيد بن زريع عن خالد عن عكرمة عن عائشة قالت : اعتكفت مع رسول الله ﷺ امرأة من أزواجه فكانت ترى الدم والصفرة والطست تحتها وهي تصلي

310. Na ka treguar Kutejbe, këtij Jezid b. Zurej'u, ky nga Halidi, ky nga Ikrime, e ky nga Aishja, e cila ka treguar:

"Së bashku me Pejgamberin s.a.v.s. ka qëndruar në i'tikaf edhe një nga bashkëshortet e tij, e cila, ndonëse ka pasë gjak dhe lëng të verdhë (të gjakderdhjes së jashtëzakonshme), **e nën të legenin, ka falur namazin".**

٣١١ – حدثنا مسدد قال حدثنا معتمر عن خالد عن عكرمة عن عائشة أن بعض أمهات المؤمنين اعتكفت وهي مستحاضة

311. Na ka treguar Museddedi, këtij Mu'temiri, ky nga Halidi, ky nga Ikrime, ky nga Aishja, **e cila ka thënë se disa nga nënat e besimtarëve** (mendon në bashkëshortet e Pejgamberit a.s.) **kanë qëndruar në i'tikaf edhe me gjakderdhje të jashtëzakonshme.**

---

12 Gruaja me gjakderdhje të jashtëzakonshme (me istihad) mund të qëndrojë në xhami, mund të falet dhe mund t'i kryejë të gjitha punët tjera fetare. Statusi i saj është i njëjtë me statusin e personit që i rrjedh gjithnjë gjak nga hunda ose nga plaga gjatë tërë kohës së një namazi. Këtë gjakderdhje e ka patur Aishja, e cila ka vënë mbrojtje nën vete që gjaku mos t'ia stërpikë teshën ose vendin në xhami.
Kjo gjakderdhje nuk paraqet pengesë për marrëdhënie seksuale.

باب هل تصلي المرأة في ثوب حاضت فيه ؟

٣١٢ - حدثنا أبو نعيم قال حدثنا إبراهيم بن نافع عن ابن أبي نجيح عن مجاهد قال : قالت عائشة ما كان لإحدانا إلا ثوب واحد تحيض فيه فإذا أصابه شيء من دم قالت بريقها فقصعته بظفرها

A mund të falet gruaja me veshje me të cilën ka qenë gjatë menstruacioneve?

312. Na ka treguar Ebu Nu'ajmi, këtij i ka treguar Ibrahim b. Nafiu, ky nga Ibni Ebu Nexhihu, ky nga Muxhahidi, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"**Çdonjëra nga ne ka pasë vetëm nga një teshë** (veshje), **të cilën e veshte edhe gjatë kohës së menstruacioneve, dhe nëse në atë teshë binte çfarëdo lloj gjaku, e lagte me pështymën e saj, dhe e fërkonte** (e kruante) **me thonjtë e veta**".[13]

باب الطيب للمرأة عند غسلها من المحيض

٣١٣ - حدثنا عبد الله بن عبد الوهاب قال حدثنا حماد بن زيد عن أيوب عن حفصة - قال أبو عبد الله : أو هشام بن حسان عن حفصة - عن أم عطية عن النبي ﷺ قالت : كنا ننهى أن نحد على ميت فوق ثلاث ، إلا على زوج أربعة أشهر وعشرا ، ولا نكتحل ولا نتطيب ولا نلبس ثوبا مصبوغا إلا ثوب عصب . وقد رخص لنا عند الطهر إذا اغتسلت إحدانا من محيضها في نبذة من كست أظفار . وكنا ننهى عن اتباع الجنائز . قال : ورواه هشام بن حسان عن حفصة عن أم عطية عن النبي ﷺ

Gruaja mund të parfumoset gjatë larjes nga menstruacionet

313. Na ka treguar Abdullah b. Abdu-l-Vehhabi, këtij Hammad b. Zejdi, ky nga Ejjubi, ky nga Hafsa, - e Ebu Abdullahu (Buhariu) ka thënë: ose Hisham b. Hassani nga Hafsa -, kjo nga Ummu Atija, e kjo nga Pejgamberi s.a.v.s., e cila është shprehur me këto fjalë:

---

13 Bejhekiu, duke e shpjeguar hadithin e sipërpërmendur, thekson se Aishja ka menduar në pika të pakta (të vogla) të gjakut të menstruacioneve me të cilat ka mundur të falet edhe pa i pastruar, sepse nga hadithet tjera shihet se bashkëshortet e Muhammedit a.s. teshat e tyre të stërpikura me gjakun e menstruacioneve i kanë pastruar me kujdesin më të madh.

"Për ne ishte e ndaluar të qajmë të vdekurin më tepër se tri ditë, përveç burrit, të cilin e qajmë katër muaj e dhjetë ditë. (Në kohën e pikëllimit) **të mos pispillosemi** (t'i vizatojmë sytë), **të mos parfumosemi dhe të mos veshim tesha të ngjyrosura, përveç asb-it** (lloj stofi nga Jemeni). **Kur ndonjëra nga ne lahej për shkak të menstruacioneve ishte e lejueshme për ne të paktën të parfumosemi** me një **lloj parfumi të quajtur Kusti-azfar. Përcjellja e xhenazes për ne ishte e ndaluar.**

Hadithin e sipërpërmendur e ka transmetuar edhe Hisham b. Hasani ky nga Hafsa, kjo nga Ummu Atija, e kjo nga Pejgamberi s.a.v.s.[14]

باب ذلك المرأة نفسها إذا تطهرت من الحيض
وكيف تغتسل وتأخذ فرصة ممسكة فتتبع أثر الدم

٣١٤ – حدثنا يحيى قال حدثنا ابن عيينة عن منصور بن صفية عن أمه عن عائشة أن امرأة سألت النبي ﷺ عن غسلها من الحيض فأمرها كيف تغتسل قال « خذي فرصة من مسك فتطهري بها . قالت ، كيف أتطهر ؟ قال : تطهري بها . قالت : كيف ؟ قال : سبحان الله ، تطهري . فاجتذبتها إلي فقلت تتبعي بها أثر الدم

Gruaja pas menstruacioneve duhet të pastrohet mirë

Si të pastrohet dhe si ta përdorë mjetin e lagur me misk (parfum) dhe të largojë gjurmën e gjakut.

314. Na ka treguar Jahjai, këtij Ibni Ujejne, këtij Mensur b. Safija, ky nga nëna e vet, kjo nga Aishja, e cila tregon se një grua e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s. për larjen nga menstruacionet. Prandaj, ai i tregoi se si duhet të pastrohet, duke i thënë:

---

14 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- bashkëshortja ia mban nderin burrit katër muaj e dhjetë ditë që të shohë është a nuk është me barrë. Nëse ajo ka mbetur me barrë, këtë nder ajo e vazhdon deri në momentin e lindjes. Gjatë kohës që ia mban nderin bashkëshortit, bashkëshortja nuk duhet të stoliset dhe të marrë pjesë në gëzime, në ahengje; e vënia e vetullave nga ana e saj gjatë ditës, veshja e teshave me ngjyra tërheqëse, d.m.th. veshja provokuese dhe përdorja e kozmetikës janë vepra të ndaluar rreptësisht;
- gruaja me menstruacione, e sidomos gjatë larjes pas tyre, duhet të përdorë parfum që të neutralizojë erën e keqe të menstruacioneve.

"Merre një leckë të bërë me parfum dhe pastroju mirë me të"!

"Si të pastrohem me të"?, pyeti ajo.

"Pastroju me të", i tha.

"E si?" tha, përsëri ajo.

"Subhanallah! bërtiti ai, fërkoju me të"!

Atëherë e tëroqa nga vetja dhe i thashë (thotë Aishja):

"Çoje (dhe fërkoje) **nëpër gjurmën e gjakut"!**

باب غسل المحيض

٣١٥ – حدثنا مسلم قال حدثنا وهيب حدثنا منصور عن أمه عن عائشة أن امرأة من الأنصار قالت للنبي ﷺ: كيف أغتسل من المحيض؟ قال «خذي فرصة ممسكة فتوضئي ثلاثا» ثم إن النبي ﷺ استحيى فأعرض بوجهه أو قال: توضئي بها. فأخذتها فجذبتها فأخبرتها بما يريد النبي ﷺ

Pastrimi pas menstruacioneve

315. Na ka treguar Muslimi, këtij i ka treguar Vuhejbi, këtij Mensuri, ky nga nëna e vet, e kjo nga Aishja, se një grua Ensare e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"Si të lahem pas menstruacioneve"?

"Merre një pëlhurë të bërë me parfum dhe pastroju", duke i thënë tri herë.

Pastaj, Pejgamberi s.a.v.s. u turpërua, prandaj u kthye anash, e unë, tha Aishja, e tërhoqa kah vetja dhe ia shpjegova atë që dëshironte (t'i shpjegojë) Pejgamberi s.a.v.s.".[15]

---

15 Muslimi në Sahihun e vet shënon se pyetjet përkatëse Muhammedi a.s. ia ka shtruar Esmaja, vajza e Shekelit, e ai i është përgjigjur: "Çdonjëra prej jush duhet të marrë një leckë që me të të pastrojë gjakun, e pastaj të derdhë ujë në krye dhe të fërkohet që uji të depërtojë deri në lëkurë, pastaj ta lagë tërë trupin, e pastaj të fërkohet me leckë të lagur me parfum (sapun, shampon etj.)". Pas disa nënpyetjeve, Aishja i dha asaj shpjegime të hollësishme, duke i thënë: "Gratë ensare janë të zellshme dhe të mrekullueshme, ato nuk i pengon turpi në hulumtimin e diturisë".
Nga hadithi vihet në dukje se:

باب امتشاط المرأة عند غسلها من الحيض

٣١٦ - حدثنا موسى بن إسماعيل حدثنا إبراهيم حدثنا ابن شهاب عن عروة أن عائشة قالت : أهللت مع رسول الله ﷺ في حجة الوداع ، فكنت ممن تمتع ولم يسق الهدى . فزعمت أنها حاضت ولم تطهر حتى دخلت ليلة عرفة فقالت : يا رسول الله هذه ليلة عرفة ، وإنما كنت تمتعت بعمرة . فقال لها رسول الله ﷺ « انقضي رأسك وامتشطي وأمسكي عن عمرتك » ففعلت . فلما قضيت الحج أمر عبد الرحمن ليلة الحصبة فأعمرني من التنعيم ، مكان عمرتي التي أمسكت

Të krehurit e gruas me rastin e larjes nga menstruacionet

316. Na ka treguar Musa b. Ismaili, këtij i ka treguar Ibrahimi, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Urve, ky nga Aishja, e cila ka treguar:

"E kam veshur ihramin me Pejgamberin s.a.v.s. në Haxhxhin Lamtumirës (Haxhxhetu-l-Vedâ'). **Kam pasur ndërmend të bëj haxhillëk dhe kam qenë njëra nga ato që e kanë shfrytëzuar umren dhe që nuk kanë përgatitur** (siguruar) **kurban.**

(Aishja) ka menduar se i ka menstruacionet dhe nuk është pastruar derisa hyri nata e Arafatit. Tha: **"O Resulullah, kjo është nata e Arafatit, e unë e kam bërë vetëm Umren"?**

Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj: "(Që të pastrohesh) **shpërndaji flokët nëpër kokën tënde, krihu dhe përmbaju** (hiq dorë) **nga umreja"! Unë e bëra këtë. Kur e kreva haxhillëkun, e urdhëroi Abdu-r-Rahmanin në prag të natës së hasbetit-guralecave** (në el-Muhassab - vend në mes Mekkes dhe Mines, ku hidhen gurët), **e, më mundësoi të hyj në umre nga Ten'imi, në vend të umres sime të mëparshme të cilën e kisha filluar".**[16]

- biseda për organet gjenitale duhet të përdoret me alegori;
- njohja e pastërtisë është detyrë e veçantë e grave;
- rekomandohet që gruaja gjatë menstruacioneve të përdorë parfum;
- gjatë bisedës duhet të jesh i qartë dhe çdo pyetje e bashkëbiseduesit duhet të shpjegohet mirë;
- ndaj njerëzve duhet të jesh i kujdesshëm dhe i sjellshëm.

16 Aishja në një mënyrë kishte menduar ta bëjë haxhillëkun, por nuk e kishte siguruar kurbanin. Muhammedi a.s., jo larg Mekkes, shpalli se kush nuk ka kurban nuk e ka të

بابُ نَقضِ المرأةِ شعرَها عندَ غسلِ المحيضِ

٣١٧ - حدثنا عُبيدُ بنُ إسماعيلَ قال حدثنا أبو أسامةَ عن هِشامٍ عن أبيهِ عن عائشةَ قالت : خرجنا

مُوافينَ لهلالِ ذي الحِجَّةِ ، فقال رسولُ اللهِ ﷺ « مَن أحبَّ أن يُهِلَّ بعُمرةٍ فليُهِلَّ ، فإني لولا أني أهديتُ لأهلَلتُ بعُمرةٍ . فأهلَّ بعضُهم بعُمرةٍ ، وأهلَّ بعضُهم بحَجٍّ ، وكنتُ أنا ممَّن أهلَّ بعُمرةٍ . فأدركني يومُ عَرفةَ وأنا حائضٌ ، فشكَوتُ إلى النبيِّ ﷺ فقال « دَعي عُمرَتَكِ وانقُضي رأسَكِ وامتَشِطي وأهِلِّي بحَجٍّ . ففعلتُ . حتى إذا كان ليلةُ الحصبَةِ أرسلَ معي أخي عبدَ الرحمنِ بنَ أبي بكرٍ فخرجتُ إلى التنعيمِ فأهللتُ بعُمرةٍ مكانَ عُمرَتي . قال هِشامٌ : ولم يكنْ في شيءٍ من ذلكَ هديٌ ولا صومٌ ولا صدقةٌ

Gruaja duhet t'i derdhë flokët e veta gjatë larjes nga menstruacionet

317. Na ka treguar Ubejd b. Ismaili, këtij ia ka transmetuar Ebu Usame, ky nga Hishami, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Kur e pamë hënën e ré të muajit dhu-l-hixhxhe, dolëm me Pejgamberin s.a.v.s. (për të bërë haxhxhin), **e ai tha: "Kush dëshiron të paraqitet për të bërë umren, le të vendos për të, sepse edhe unë, po të mos kisha gjetur kurbanin, do të kisha vendosur të bëjë umren". Atëherë, disa nga shokët e Pejgamberit s.a.v.s. vendosën për umren, e disa për haxhxhin. Unë isha nga ata që u paraqitem për Umren. Dita e Arafatit më gjeti me menstruacione, prandaj, iu ankova Pejgamberit s.a.v.s., e ai më tha: "Lëre umren, derdhi flokët nëpër kokë, krihu dhe vendos** (përcaktohu) **për haxhxh"! Ashtu edhe kam vepruar. E, kur ishte nata e hasbetit - gurëve** (në el-Mahassab - vend në mes Mekkes dhe Mines), **e dërgoi me mua vëllain tim, Abdu-r-Rahmanin. Kam dalur me të deri te Ten'imi dhe atje, përsëri, u përcaktova për umren, në vend të umres sime të mëparshme".**

---

plotëfuqishëm vendimin për haxhillëk dhe i tilli duhet të vendosë të bëjë umren. Në mes tyre binte edhe Aishja, të cilës me të arritur në vendin e quajtur Seref i erdhën edhe menstruacionet, prandaj vendosi për umre. Me 9 dhu-l-hixhxhe, asaj iu ndëprenë menstruacionet dhe kështu e bëri haxhillëkun, e pastaj edhe umren.

Hishami ka thënë: **"Në raste të këtilla, nuk duhet prerë as kurban, as agjërim, e bile asfarë sadake".**[17]

بَابُ مُخَلَّقَةٍ وَغَيْرِ مُخَلَّقَةٍ

٣١٨ – حَدَّثَنَا مُسَدَّدٌ قَالَ حَدَّثَنَا حَمَّادٌ عَنْ عُبَيْدِ اللهِ بْنِ أَبِي بَكْرٍ عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ: «إِنَّ اللهَ عَزَّ وَجَلَّ وَكَّلَ بِالرَّحِمِ مَلَكًا يَقُولُ: يَا رَبِّ نُطْفَةٌ، يَا رَبِّ عَلَقَةٌ، يَا رَبِّ مُضْغَةٌ. فَإِذَا أَرَادَ أَنْ يَقْضِيَ خَلْقَهُ قَالَ: أَذَكَرٌ أَمْ أُنْثَى؟ شَقِيٌّ أَمْ سَعِيدٌ؟ فَمَا الرِّزْقُ، وَالْأَجَلُ؟ فَيُكْتَبُ فِي بَطْنِ أُمِّهِ

Formimi dhe joformimi

318. Na ka treguar Museddedi, këtij i ka treguar Hammadi, ky nga Ubejdullah b. Ebu Bekr, ky nga Enes b. Maliku, e ky nga Pejgamberi s.a.v.s., i cili ka thënë:

"All-llahu i Madhërueshëm çdo mitre ia ka besuar një melek, i cili thotë: O Zot, ky është embrioni i farës së njeriut, pastaj; O Zot, ky është gjaku i ngjizur; pastaj; O Zot, kjo është pjesa e mishit; e kur dëshiron t'ia japë formën e tij përfundimtare, meleku pyet: a është mashkull apo femër; i pafatshëm apo i fatshëm; si është rrisku dhe fati i tij i jetës? E gjithë kjo i shkruhet, përderisa është në barkun e nënës".[18]

---

17 Përmbajtja e hadithit vë theksin në domosdoshmërinë e mbajtjes së pastërtisë së trupit. Pastërtia dhe rregullimi janë të nevojshme për trupin, qoftë në shtëpi, qoftë jashtë.Hishami e paraqiti vërejtjen e sipërpërmendur, duke mos ditur se Muhammedi a.s. ka prerë kurban me atë rast për vete dhe për bashkëshortet e veta.

18 Shtatzënia nuk mund të ketë menstruacione, sepse, materia e saj është e domosdoshme për formimin dhe ushqimin e frutit. Aishja e cila është pyetur për gjakderdhjen e disa shtatzënëve, është përgjigjur: "Shtatzënia nuk mund të ketë menstruacione. Rekomandohet që ajo të lahet dhe rregullisht të falë namazin".

Në hadith janë shprehur fazat themelore të zhvillimit të jetës së njeriut dhe që All-llahu xh.sh. prej më parë di se çfarë do të jetë çdo njeri dhe prandaj edhe e përcakton fatin e tij.

Gruaja që e hedh fëmijën (aborton) ka të drejtë të quhet nënë. Evzaiu dhe Maliku i japin asaj këtë të drejtë nëse dështimi (abortimi) ka qenë në fazë të formimit në copë mishi pa qenë i formuar si person dhe pas dështimit të tillë gruaja i përmbahet ligjit të caktuar të pritjes (iddetit). Ibni Kasimi i jep këtë të drejtë gruas nëse dështimi ka qenë bile si gjaku i ngjizur.

باب كيف تُهِلُّ الحائضُ بالحجِّ والعُمرةِ ؟

٣١٩ — حدثنا يحيى بن بُكَيرٍ. قال حدثنا اللَّيثُ عن عُقَيلٍ عن ابنِ شهابٍ عن عُروةَ عن عائشةَ قالت : خرَجْنا مع النبيِّ ﷺ في حَجَّةِ الوَداعِ ، فمِنّا مَن أهَلَّ بعُمرةٍ ومِنّا مَن أهَلَّ بحَجٍّ . فقَدِمْنا مكةَ ، فقال رسولُ اللهِ ﷺ « مَن أحرَمَ بعُمرةٍ ولم يُهْدِ فلْيَحْلِلْ ، ومَن أحرمَ بعُمرةٍ وأهدَى فلا يَحِلُّ حتى يَحِلَّ بنَحْرِ هَدْيِهِ . ومَن أهلَّ بحجٍّ فلْيُتِمَّ حجَّه » . قالت : فحِضْتُ ، فلم أزَلْ حائضاً حتى كانَ يومُ عَرَفةَ ، ولم أُهْلِلْ إلا بعُمرةٍ ، فأمَرَنِي النبيُّ ﷺ أن أنْقُضَ رأسي وأمْتَشِطَ وأُهِلَّ بحجٍّ وأترُكَ العُمرةَ ، ففَعَلْتُ ذلك حتى قَضَيْتُ حَجّي ، فبعثَ معي عبدَ الرَّحمنِ ابنَ أبي بكرٍ وأمَرَني أن أعتمِرَ مكانَ عُمرَتي مِنَ التَّنعيمِ

Si e paraqet haxhxhin dhe umren personi me menstruacione?

319. Na ka treguar Jahja b. Bukejri, këtij Lejthi, ky nga Ukajli, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Urve, ky nga Aishja, e cila ka thënë:

"Kemi dalë me Pejgamberin s.a.v.s. në vitin e Haxhxhit Lamtumirës. Disa kishin ndërmend ta bëjnë umren, e disa haxhxhin". Kur erdhëm në Mekke, Pejgamberi s.a.v.s. tha: "Kush ka veshur ihramin për umren dhe nuk ka gjetur (nuk ka siguruar) **kurban** (për haxhillëk), **le ta heqë atë, e kush ka veshur ihramin me qëllim që ta bëjë umren dhe ka gjetur** (siguruar) **kurban, le të mos e zhveshë atë derisa ta ther kurbanin. Megjithatë, kush ka menduar ta bëjë haxhxhin, le ta bëjë atë të plotë"!**

"Mua, - thotë Aishja, - **gjatë udhëtimit më erdhën menstruacionet dhe kam qenë me menstruacione deri në ditën e Arafatit. Prandaj kam menduar ta bëj vetëm umren. Mirëpo, Pejgamberi s.a.v.s. më urdhëroi t'i derdh flokët nëpër kokë, të krihem dhe të vendos për ta bërë haxhxhin, e ta lë umren. Kështu veprova dhe e bëra haxhxhin** (haxhillëkun tim). **Pastaj, ai** (Pejgamberi s.a.v.s.) **e dërgoi me mua Abdu-r-Rahman b. Ebu Bekrin dhe më urdhëroi ta filloj umren nga Ten'imi, në vend të umres së mëparshme".**

Ebu Hanife, Shafiu dhe shumë juristë të tjerë islamë mendojnë se nocioni dhe emri "nënë" i takon femrës që dëshiron fëmijën në formën e pjesës së mishit që i dallohen sytë, gishtat dhe organet tjera pas të cilit i nënshtrohet pritjes (iddetit).

باب إقبالِ الحيض وإدبارِه

وكُنَّ نِساءٌ يَبْعَثْنَ إلى عائشةَ بالدُّرْجةِ فيها الكُرْسُفُ فيه الصُّفْرةُ فتقول : لا تَعْجَلْنَ حتى تَرَيْنَ القَصَّةَ البَيْضاءَ ، تُريدُ بذلكَ الطُّهْرَ مِنَ الحَيْضةِ . وبَلَغَ ابنةَ زَيْدِ بنِ ثابتٍ أنَّ نساءً يَدْعُونَ بالمَصابيحِ مِنْ جَوْفِ اللَّيْلِ يَنْظُرْنَ إلى الطُّهْرِ فقالت : ما كانَ النساءُ يَصْنَعْنَ هٰذا . وعابَتْ عليهنَّ

Paraqitja dhe ndërprerja e menstruacioneve

Disa gra ia kanë dërguar Aishes një kuti të vogël, në të cilën kishte pambuk të përlyer me gjak e qelb. Lidhur me këtë ajo tha: **"Le të mos shpejtojnë përderisa nuk e shohin pambukun të bardhë"!**, duke pasë për qëllim me këtë pastrimin nga menstruacionet.

Vajzës së Zejd b. Thabitit i është thënë se disa gra marrin kandilat (llampat) **dhe e shohin pastërtinë e leckave** (në organin e tyre gjenital). **E, përse ato gra veprojnë ashtu, tha ajo, dhe i qortoi ato.**

٣٢٠ – حدَّثنا عبدُ اللهِ بنُ محمدٍ قال حدَّثنا سُفيانُ عن هِشامٍ عن أبيهِ عن عائشةَ أنَّ فاطمةَ بنتَ أبي حُبَيْشٍ كانت تُستحاضُ ، فسألَتِ النبيَّ ﷺ فقال « ذٰلكِ عِرْقٌ وليست بالحيضةِ ، فإذا أقبلَتِ الحيضةُ فَدَعِي الصلاةَ ، وإذا أدبَرَتْ فاغْسِلِي وصلِّي »

320. Na ka treguar Abdullah b. Muhammedi, këtij Sufjani, këtij Hishami, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja, e cila tregon se Fatime b. Ebu Hubejshi ka pasë gjakderdhje të jashtëzakonshme, prandaj e pyeti Pejgamberin s.a.v.s.:

"Ai është gjaku i arterieve, e jo i menstruacioneve. Kur të të paraqiten ty menstruacionet, lëre faljen e namzit, e kur të ndërpriten lahu (pastrohu) dhe falu"!, iu përgjigj Pejgamberi s.a.v.s.[19]

---

19 Menstruacionet në fillim janë gjak i kuq, pastaj e marrin ngjyrën e kuqremtë, pastaj kalojnë në materie të turbullt në të bardhë, pastaj kalojnë në lëng të bardhë me ç'rast mitra pastrohet dhe menstruacionet ndërpriten.

Gruaja e cila në Ramazan nuk ka arritur të lahet deri në agim do ta agjërojë atë ditë, por, pas Ramazanit duhet ta kompenzojë atë ditë, nëse menstruacionet i kanë zgjatur më pak se dhjetë ditë, e nëse i kanë zgjatur plotë dhjetë ditë, nuk duhet ta agjërojë atë ditë. Ky është qëndrim i Ebu Hanifes dhe Evzaiut, ndërsa Maliku, Shafiu dhe Ahmedi, gruan e

باب لا تقضي الحائضُ الصلاةَ . وقال جابرٌ وأبو سعيدٍ عن النبيِّ ﷺ « تَدَعُ الصلاةَ »

٣٢١ - حدثنا موسى بن إسماعيلَ قال حدثنا همامٌ قال حدثنا قتادةُ قال حدثتني مُعاذةُ أنَّ امرأةً قالت لعائشةَ : أتجزي إحدانا صلاتَها إذا طَهُرَتْ ؟ فقالت : أحَرُورِيَّةٌ أنتِ ؟ كنا نَحيضُ مع النبيِّ ﷺ فلا يأمُرنا به . أو قالت : فلا نفعلُه

Gruaja me menstruacione nuk i bën kaza namazet që i kanë kaluar

Xhabiri dhe Ebu Se'idi kanë transmetuar nga Pejgamberi s.a.v.s.: **"E lënë** (nuk e falin) **namazin"**

321. Na ka treguar Musa b. Ismaili dhe tha se i ka treguar Hemmami, këtij Katade, këtij Muadhi, i cili tregon se një grua e ka pyetur Aishen r.a.:

"A t'i plotësojmë namazet e lëshuar kur të pastrohemi"?

"A je ti harurije"?, e ka pyetur (Aishja).

"Ne në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. kemi pasur menstruacione dhe ai për këtë nuk na ka urdhëruar", ose Aishja ka thënë, thotë transmetuesi: **"... edhe ne atë nuk e kemi bërë"**.[20]

---

tillë e trajtojnë sikurse xhunubi, i cili duhet të lahet dhe ta agjërojë ditën që agon, duke mos qenë i detyruar ta kompenzojë.

Ibni Ruzhdi në veprën e tij "Kavâid" thekson se një lagje dijetarësh afatin e fundit të menstruacioneve e llogarisin me paraqitjen e lëngut të bardhë, e lagjja tjetër, me ndërprerjen e tyre dhe me terjen e plotë.

20 Muslimi në "Sahihun" e tij thekson se Muadhi ka thënë:

- E kam pyetur Aishen: "Si të veprojë gruaja me menstruacione"?

- Ditët e lëshuara të agjërimit të detyrueshëm duhet të kompenzohen me agjërim, kurse namazet e kaluara nuk duhet kompenzuar. A je ti nga sekti harurije? - pyeti Aishja.

- Jo, nuk jam - iu përgjigja - por vetëm po pyes ta di.

- Kjo na ka ndodhur neve, - tha Aishja - dhe na është urdhëruar që ta kompenzojmë agjërimin, e nuk na është urdhëruar t'i plotësojmë namazet e kalaura.

Të gjithë përfaqësuesit e shkollave burimore islame vërtetojnë që gruaja me menstruacione, kur t'i ndërpriten ato, duhet ta kompenzojë agjërimin e ditëve të lëshuara të Ramazanit (ditë për ditë), kurse namazet e lëshuara nuk duhet t'i potësojë, sepse kjo do t'i shkaktonte vështirësi.

Në "Mun'jetu-l-Mufti" qëndron: "I rekomandohet gruas me menstruacione që kur të

باب النوم مع الحائض وهي في ثيابها

٣٢٢ — حدثنا سعد بن حفص قال حدثنا شيبان عن يحيى عن أبي سلمة عن زينب ابنة أبي سلمة حدثته أن أم سلمة قالت : حضت وأنا مع النبي ﷺ في الخميلة ، فانسللت فخرجت منها فأخذت ثياب حيضتي فلبستها ، فقال لي رسول الله ﷺ : أنفست ؟ قلت : نعم . فدعاني فأدخلني معه في الخميلة . قالت : وحدثتني أن النبي ﷺ كان يقبلها وهو صائم . وكنت أغتسل أنا والنبي ﷺ من إناء واحد من الجنابة

Të fejturit me gruan e cila i ka menstruacionet duke qenë ajo me teshat e saj

322. Na ka treguar Sa'd b. Hafsi, këtij Shejbani, këtë e ka njoftuar Jahjai, ky nga Ebu Seleme, ky nga Zejnebe b. Ebu Seleme, e cila tregon se Ummu Selemja i ka thënë:

"Më kanë ardhur menstruacionet. Kam qenë e veshur me fustanin prej kadifeje, e isha pranë Pejgamberit s.a.v.s. U tërhoqa disi dhe shkova e u vesha me tesha që janë të përshtatshme për menstruacione". Pastaj, Pejgamberi s.a.v.s. më pyeti: **"A të kanë ardhë menstruacionet"? "Po"**, i thashë. **Atëherë, duke qenë edhe me fustanin prej kadifeje më thirri dhe më mori pranë vetes.**

"Më ka treguar Ummu Selemja, thotë Zejenebja, se Pejgamberi s.a.v.s. i është afruar asaj (e ka ledhatuar) **edhe duke qenë si agjërues".** Pastaj, ka thënë edhe: **"Unë dhe Pejgamberi s.a.v.s. jemi larë për shkak të xhunupllëkut, nga një enë".**

---

fillojnë kohët e namazeve të detyrueshme të marrë abdest dhe me tespihët në dorë të lexojë atë që zakonisht e bën pas namazit, në kohëzgjatje të një namazi (farz).

Sekti harurije është formuar në kohën e hilafetit të Aliut dhe është ndarë menjëherë në gjashtë grupe: ezrekije, sufrije, nexhdije, uxharide, ibadije dhe tha'lebije. Të gjitha këto grupe kanë qenë me mësime konservative.

Haruritë, degë e harixhive me qendër në Harura, afër Kufes, mendojnë se gruaja me menstruacione duhet t'i plotësojë namazet e lëshuara.

باب مَنِ اتَّخذَ ثِيابَ الحيضِ سِوَى ثِيابِ الطُّهرِ

٣٢٣ — حدثنا مُعاذُ بنُ فَضالةَ قال حدَّثنا هِشامٌ عن يحيى عن أبي سَلَمَةَ عن زَينبَ ابنةِ أبي سَلَمَةَ عن أمِّ سَلَمَةَ قالت: بَيْنا أنا معَ النبيِّ ﷺ مُضْطَجِعةٌ في خَميلةٍ حِضتُ، فانسَلَلْتُ فأخَذْتُ ثِيابَ حِيضتي، فقال: أنُفِسْتِ؟ قلتُ: نعم. فدعاني فاضْطَجَعْتُ معه في الخميلةِ

Mbajtja e teshave të përcaktuara për menstruacion në vend të teshave të cilat mbahen kur gratë janë të pastra

323. Na ka treguar Muadh b. Fadale, këtij Hishami, ky nga Jahjai, ky nga Ebu Selemja, ky nga Zejnebe b. Ebu Seleme, e kjo nga Ummu Selemja, e cila ka thënë:

"Derisa rrija shtrirë pranë Pejgamberit s.a.v.s. dhe e veshur me fustan prej kadifeje, më erdhën menstruacionet. Pa u hetuar, u tërhoqa dhe i mora teshat që i kisha për menstruacione". A të erdhën menstruacionet"? më pyeti Pejgamberi s.a.v.s. **"Po"**, iu përgjigja. **Ai, pastaj më thirri pranë vetes. Rashë me të duke qenë e veshur me fustanin prej kadifeje.**

باب شُهودِ الحائضِ العيدَينِ ودَعوةَ المسلمينَ، ويَعتزِلْنَ المصلَّى

٣٢٤ — حدثنا محمد — هو ابنُ سلامٍ — قال أخبرَنا عبد الوهّابِ عن أيوبَ عن حَفصةَ قالت: كنّا نَمنعُ عَواتِقَنا أن يَخرُجْنَ في العيدَينِ، فقَدِمَتِ امرأةٌ فنزَلَتْ قَصرَ بني خَلَفٍ فحدَّثَتْ عن أختِها — وكان زوجُ أختِها غزا مع النبيِّ ﷺ ثِنتَي عشرةَ، وكانت أختي معه في سِتٍّ — قالت كنّا نُداوي الكَلْمى، ونقومُ على المرضى، فسألَتْ أختي النبيَّ ﷺ: أعلى إحدانا بأسٌ إذا لم يَكنْ لها جِلبابٌ أن لا تَخرُجَ؟ قال «لتُلبِسْها صاحبَتُها مِن جِلبابِها، ولْتَشهَدِ الخيرَ ودَعوةَ المسلمينَ». فلما قَدِمَتْ أمُّ عَطيةَ سألتُها: أسَمِعتِ النبيَّ ﷺ؟ قالت: بأبي نعم — وكانت لا تَذكُرُهُ إلّا قالت «بأبي» — سمعتُه يقول «يخرُجُ العَواتِقُ وذَواتُ الخُدورِ — أوِ العَواتِقُ ذَواتُ الخُدورِ — والحُيَّضُ، ولْيَشهَدْنَ الخيرَ ودعوةَ المؤمنينَ، ويَعتزِلُ الحُيَّضُ المصلَّى». قالت حفصة: فقلت «الحُيَّضُ»؟ فقالت: أليسَ تَشهَدُ عَرفةَ وكذا وكذا؟

Gruaja me menstruacione do të marrë pjesë në festat e Bajrameve dhe në thirrjet (duatë) e muslimanëve; por do të largohet nga falja e namazit

324. Na ka treguar Muhammedi, e ky është Ibni Selami, këtij Abdu-l-Vehhabi, ky nga Ejjubi, ky nga Hafsa, e cila ka thënë:

"Ua kemi ndaluar vajzave tona të dalin në festën e Bajrameve. Pastaj, na erdhi një grua, e cila ka qëndruar te shtëpia e Benu Halefit. Na tregoi kjo për motrën e vet, e burri i motrës së saj kishte marrë pjesë në 12 lufta, bashkë me Pejgamberin s.a.v.s., kurse motra ime në gjashtë, e cila ka treguar: "I kemi shëruar të plagosurit, e nganjëherë na agonte duke qëndruar mbi të sëmurët".

Edhe motra ime e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.: **"A është penguar të dalë ndonjëherë nga ne, nëse nuk e ka veshur gëzofin e femrave** (ar. xhilbabin - këmishë e gjërë dhe e gjatë)"?

"Le të vishet (le ta hedh krahëve) **shoqja e saj me gëzofin** (xhilbabin), **le të marrë pjesë në veprat e mira dhe t'i përgjigjet thirrjes së muslimanëve"**, u përgjigj.

Kur erdhi Ummu Attija, e pyeta: **"A e ke dëgjuar ti Pejgamberin s.a.v.s."?**

"Po, për nder të babait, tha Ummu Atija, e ajo betohej gjithnjë në babain, kur përmendej emri i Pejgamberit s.a.v.s. Kam dëgjuar kur ka thënë: "Do të dalin vajzat e moshuara dhe ato të tërhequra, përkatësisht vajzat e moshuara e të tërhequra (të rezervuara). **Le të marrin pjesë në punët e dobishme dhe në festën e muslimanëve edhe gratë me menstruacione, vetëm se gratë me menstruacione do të largohen nga vendet ku falet namazi".**

"A, vërtet edhe gratë me menstruacione"? e pyeta, thotë Hafsa.

"A *nuk ka qenë e tillë në Arafat, pastaj në Muzdelife dhe në lutjet* (për shi)", tha (Ummu Atija).[21]

---

21 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- femra me menstruacione nuk duhet t'i lëshojë veprat fetare të cilat kryehen zakonisht pa abdest. Hatabiu ka thënë: "Gruaja me menstruacione mund të marrë pjesë në tubimet

بابٌ إذا حاضَتْ في شهرٍ ثلاثَ حِيَضٍ ، وما يُصدَّقُ النساءُ في الحَيْضِ والحَبَلِ فيما يُمكِنُ من الحَيضِ، لقولِ اللهِ تعالى ﴿ ولا يَحِلُّ لهنَّ أن يَكتُمْنَ ما خَلَقَ اللهُ في أرحامِهنَّ ﴾ ، ويُذكَرُ عن عليٍّ وشُرَيحٍ : إنِ امرأةٌ جاءتْ ببَيِّنةٍ من بِطانةِ أهلِها ممَّن يُرضَى دِينُه أنَّها حاضَتْ ثلاثًا في شهرٍ صُدِّقَتْ . وقال عطاءٌ : أقْرَؤُها ما كانت . وبه قال إبراهيمُ . وقال عَطاءٌ : الحَيضُ يومٌ إلى خَمسَ عَشرةَ . وقال مُعمَرٌ عن أبيه : سألتُ ابنَ سِيرِينَ عنِ المرأةِ ترَى الدَّمَ بعدَ قُرئِها بخمسةِ أيامٍ ؟ قال : النساءُ أعلمُ بذلكَ

Nëse gruas i vijnë menstruacionet tri herë në muaj

Çka vërtetojnë gratë në menstruacione dhe në shtatzënësi dhe çka është e mundshme (të thonë) në atë që është te menstruacionet në bazë të fjalëve të All-llahut të Madhërueshëm:

"... dhe nuk u lejohet atyre të fshehin atë që All-llahu e ka krijuar në mitrat e tyre...".

(el-Bekare, 228)

Aliu dhe Shurejhu thonë: **"Nëse gruas ia vërteton shoqja** (mikesha) **e saj e besueshme, besimi i së cilës është i lakmueshëm se ajo ka pasë tri menstruacione brenda muajit, ajo edhe do t'i pranohet".**

Atai ka thënë: **"Menstruacionet në "iddet" janë të njëjtë sikurse që kanë qenë para "iddet-it"**. Këtë mendim e mbështet edhe Ibrahimi.

Atai ka thënë edhe këtë: **"Menstruacionet zgjasin prej një deri në pesëmbëdhjetë ditë".**

Mu'temiri transmeton nga babai i vet: E kam pyetur Ibni Sirinin për një grua e cila ka pasë gjakderdhje pesë ditë pas ndërprerjes së menstruacioneve.

"Gratë më së miri e dinë atë",[22] u përgjigj.

---

dhe këshillat fetare jashtë xhamisë".

Neveviu porosit pjesmarrjen e grave në manifestimet e Bajrameve, përveç atyre që me bukurinë dhe me veshjen e tyre mund t'ua tërheqin vëmendjen meshkujve dhe pastaj të shkaktojnë ndonjë veprim të padëshirueshëm.

Ebu Hanifja mendon se izolimin dhe emancipimin e grave duhet bërë në frymën e zhvillimit shoqëror-moral të shoqërisë.

22 Shtatzënësinë dhe menstruacionet e grave nuk duhet mohuar dhe nuk duhet nënçmuar, sepse prej tyre varet statusi i saj, e drejta dhe detyra në shoqëri.

٣٢٥ – حدثنا أحمد بن أبي رجاء قال حدثنا أبو أسامة قال سمعت هشام بن عروة قال أخبرني أبي عن عائشة أن فاطمة بنت أبي حبيش سألت النبي ﷺ قالت : إني أستحاض فلا أطهر ، أفأدع الصلاة ؟ قال « لا . إنما ذلك عرق . ولكن دعي الصلاة قدر الأيام التي كنت تحيضين فيها ، ثم اغتسلي وصلي »

325. Na ka treguar Ahmed b. Ebu Rexhai, këtij i ka treguar Ebu Usame, këtij Hisham b. Urve, këtij babai i vet, ky nga Aishja, e cila ka thënë se Fatime b. Ebu Hubejshi e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

"Kam menstruacione të jashtëzakonshme (të çrregulluara) **dhe, kur-rsesi nuk mund të pastrohem. A ta lë namazin"?**

"Jo, ajo është gjakderdhje e arterieve, tha ai. Ti lëre namazin aq ditë (brenda muajit) **sa të kanë zgjatur zakonisht menstruacionet e mëparshme, e atëherë, lahu dhe fale namazin"!**

Në kohën e hilafetit të Aliut një grua qe ankuar se burri e ka lëshuar duke vërtetuar se edhe pritja (iddeti) i ka përfunduar, prandaj, ajo do të duhet përsëri të martohej, sepse brenda një muaji i ka patur tri menstruacione. Aliu e urdhëroi Shurejbun që ta udhëheqë bisedën në mes tyre, prandaj ai kërkoi një grua të besueshme fetare e cila do të vërtetojë mundësinë e shkakut të shkurorëzimit, sepse është e panatyrshme që gruaja të ketë tri menstruacione brenda një mauji.

Ebu Hanifja mendon se menstruacionet zgjasin më së paku tri ditë e më së shumti dhjetë ditë, kurse sipas Ebu Jusufit ato mund të zgjasin më së paku dy ditë. Ebu Hanifja qëndrimin e tij e mbështet në shumë hadithe, prandaj edhe në këtë: "Menstruacionet zgjasin: tri, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë dhe dhjetë ditë, e mbi këtë kohë janë të lara të jashtëzakonshme".

Ebu Umame pohon se Muhammedi a.s. ka thënë: "Menstruacionet më të shkurtëra të vajzave dhe të të martuarave janë tri ditë, e më të gjata dhjetë ditë".

Muadh b. Xhebeli transmeton nga Pejgamberi a.s.: "Nuk ka menstruacione nën tri ditë, e as mbi dhjetë ditë. Kalimi nga ky përcaktim janë të lara (menstruacione) të jashtëzakonshme. Në fund të menstruacioneve të vërteta, gruaja le të marrë abdest për çdo namaz vijues. Pastrimi pas lindjes nuk mund të jetë më pak se dy javë, e më gjatë se dyzet ditë, e nëse gruaja pastrohet më herët, mund të falë namazin dhe të agjërojë, por nuk mund të ketë marrëdhënie seksuale derisa nuk kanë kaluar 40 ditë".

Ebu Se'id Hudriu thekson se Muhammedi a.s. ka thënë: "Menstruacionet zgjasin më së paku tri, e më së shumti dhjetë ditë".

Krahas këtyre qëndrimeve që u thanë më lartë, peshë vendimtare ka zakonshmëria te çdo grua.

بَابُ الصُّفْرَةِ وَالْكُدْرَةِ فِي غَيْرِ أَيَّامِ الْحَيْضِ

٣٢٦ - حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ بْنُ سَعِيدٍ قَالَ حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ عَنْ أَيُّوبَ عَنْ مُحَمَّدٍ عَنْ أُمِّ عَطِيَّةَ قَالَتْ: كُنَّا لَا نَعُدُّ الْكُدْرَةَ وَالصُّفْرَةَ شَيْئًا

Paraqitja e lënguat të verdhë dhe të bardhë jashtë kohës së menstruacioneve

326. Na ka treguar Kutejbe b. Se'idi, këtij i ka treguar Ismaili, këtij Ejjubi, ky nga Muhammedi, e ky nga Ummu Atija, e cila ka thënë:

"Lëngun e zverdhur dhe lëngun e bardhë nuk i kemi numëruar në asgjë".[23]

بَابُ عِرْقِ الِاسْتِحَاضَةِ

٣٢٧ - حَدَّثَنَا إِبْرَاهِيمُ بْنُ الْمُنْذِرِ قَالَ حَدَّثَنَا مَعْنٌ قَالَ حَدَّثَنِي ابْنُ أَبِي ذِئْبٍ عَنِ ابْنِ شِهَابٍ عَنْ عُرْوَةَ وَعَنْ عَمْرَةَ عَنْ عَائِشَةَ زَوْجِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّ أُمَّ حَبِيبَةَ اسْتُحِيضَتْ سَبْعَ سِنِينَ فَسَأَلَتْ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ عَنْ ذَلِكَ فَأَمَرَهَا أَنْ تَغْتَسِلَ فَقَالَ «هَذَا عِرْقٌ» فَكَانَتْ تَغْتَسِلُ لِكُلِّ صَلَاةٍ

Gjakderdhja e çrregulluar e arterieve

327. Na ka treguar Ibrahim b. Mundhiri, këtij i ka treguar Ma'ni, këtij ia ka transmetuar Ibni Ebu Dhi'bi, ky nga Ibni Shihabi, ky nga Urve, ky nga Amreja, e kjo nga Aishja, bashkëshortja e Pejgamberit s.a.v.s., e cila tregon se Ummu Habibja ka pasë gjakderdhje të çrregulluara shtatë vjet. Për këtë arsye e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s..

---

23 Të kulluarit e lëngut ngjyrë të verdhë në të bardhë dhe të bardhemë në ditët jashtë menstruacioneve, nuk duhet konsideruar në menstruacione.

Ebu Jusufi ka thënë: "Kjo dukuri që ka filluar para menstruacioneve nuk konsiderohet menstruacion, e nëse kjo është para ndërprerjes së menstruacioneve, llogaritet në menstruacione". Këtë mendim e ka përvetësuar edhe Ebu Thevriu, kurse Maliku e llogarit si menstruacione qoftë e lidhur ose e ndarë për to nga ana kohore.

Pejgamberi s.a.v.s. i ka rekomanduar që të lahet, e pastaj i ka thënë: **"Ai është gjak i kapilareve".** Ajo, prandaj, është larë për çdo kohë të namazit.[24]

باب المرأة تحيض بعد الإفاضة

٣٢٨ – حدثنا عبد الله بن يوسف أخبرنا مالك عن عبد الله بن أبي بكر بن محمد بن عمرو بن حزم عن أبيه عن عمرة بنت عبد الرحمن عن عائشة زوج النبي ﷺ أنها قالت لرسول الله ﷺ: يا رسول الله إن صفية بنت حيي قد حاضت. قال رسول الله ﷺ: لعلها تحبسنا، ألم تكن طافت معكن؟ قالوا: بلى. قال: فاخرجي

Gruaja të cilës i kanë ardhë menstruacionet pasi i ka kryer detyrimet rreth Qabes (pas kthimit nga Arafati)

328. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij ia ka transmetuar Maliku, ky nga Abdullah b. Ebu Bekr b. Muhammed b. Amr b. Hazmi, ky nga babai i vet, ky nga Amr b. Abdu-r-Rahmani, kjo nga Aishja, bashkëshorte e Pejgamberit s.a.v.s., e cila i ka thënë Pejgamberit s.a.v.s.:

"O Reulullah, Safije b. Hujejit i kanë ardhë menstruacionet. Ndoshta ajo do të na vonojë"?

"A nuk ka qarkulluar me ju rreth Qabes"?, e pyeti Pejgamberi s.a.v.s.

"Po", u përgjigjen ato.

"Atëherë, dil"!, tha ai.

٣٢٩ – حدثنا مُعَلَّى بن أسد قال حدثنا وُهَيب عن عبد الله بن طاوس عن أبيه عن ابن عباس قال: رُخِّصَ للحائض أن تَنفِرَ إذا حاضت

329. Na ka treguar Mual-la b. Esedi, këtij Vuhejbi, këtij Abdullah b. Tavusi, ky nga babai i vet, e ky nga Ibni Abbasi, i cili ka thënë:

---

24 Praktika e Ummu Habibes është anuluar me thëniet plotësuese të mëvonshme të Muhammedit a.s., sipas të cilave gratë e tilla kanë marrë vetëm abdest për çdo kohë të namazit.

"Gruas, së cilës i kanë ardhur menstruacionet, i është bërë e lejueshme të udhëtojë (të shkojë, nëse e ka bërë tavafin)".

٣٣٠ – وكان ابنُ عُمرَ يقولُ في أوَّلِ أمرِهِ إنها لا تَنفِرُ، ثم سَمِعتُه يقول : تَنفِرُ، إنَّ رسولَ اللهِ ﷺ رخَّصَ لهنَّ

330. Ibni Umeri në rastin e parë ka thënë: **"Ajo të mos udhëtojë** (të mos shkojë)", e pastaj e kam dëgjuar, duke thënë: **"le të shkojë", sepse këtë ua ka lejuar Pejgabmeri s.a.v.s.**[25]

بابٌ إذا رأتِ المستحاضةُ الطُّهرَ

قال ابنُ عبّاسٍ : تغتسِلُ وتُصلِّي ولو ساعةً . ويأتيها زوجُها إذا صلَّتْ ، الصلاةُ أعظمُ

٣٣١ – حدَّثنا أحمد بن يونُسَ عن زُهَيرٍ قال حدَّثنا هِشامٌ عن عُروةَ عن عائشةَ قالت : قال النبيُّ ﷺ

« إذا أقبلَتِ الحيضةُ فدَعي الصلاةَ ، وإذا أدبرَتْ فاغسِلي عنكِ الدَّمَ وصلِّي»

Gruaja me gjakdedhje të çrregulluara është e pastër

Ibni Abbasi ka thënë: **"Do të lahet dhe do të falë namazin, bile edhe nëse ajo periudhë** (ndërprerja e gjakderdhjes) **zgjat një orë. Burri mund t'i afrohet asaj** (për ta prekur) **kur ajo ta falë namazin, sepse namazi është më i madhërueshëm".**

331. Na ka treguar Ahmed b. Junusi, këtij Zuhriu, këtij Hisham b. Urve, ky nga Aishja, e kjo nga Pejgamberi s.a.v.s. i cili ka thënë:

---

25 Gruaja me menstruacione është e liruar nga tavafi lamtumirës i Qabes (tavafi veda), por jo edhe nga tavafi i vizitës (tavafi zijareti), i cili duhet të bëhet patjetër, bile edhe nëse duhet pritur ndërprerjen e menstruacioneve. Nëse gruaja e tillë ktheht në atdhe, duke mos e bërë këtë tavaf rreth Qabes, ajo nuk e ka kryer detyrimin e saj të haxhillëkut. Prandaj duhet të kthehet dhe ta kryejë këtë tavaf rreth Qabes.

Gruaja me menstruacione nuk mund të sillet rreth Qabes (të bëjë tavaf). Nëse e bën tavaf Qaben (sillet rreth Qabes) me rastin e ardhjes në Mekke, duhet të presë një dele për të varfërit, e nëse e bën tavaf gjatë kohës së Bajramit (tavafi zijaret), duhet të presë gjedhe (kafshë të trashë). Kështu do të verpojë edhe xhunubi.

"Kur të të fillojnë ty menstruacionet, lëre namazin, e kur të të ndërpriten, lahu, pastrohu dhe fal namazin".[26]

باب الصلاةِ على النُّفَساء وسُنَّتِها

٣٣٢ – حدثنا أحمدُ بن أبي سُرَيجٍ قال أخبرنا شَبابةُ قال أخبرنا شُعْبةُ عن حسينٍ المُعلِّمِ عن ابنِ بُرَيدةَ عن سَمُرةَ بنِ جندُبٍ أنَّ امرأةً ماتتْ في بَطْنٍ فصلَّى عليها النبيُّ ﷺ فقامَ وسَطَها

Namazi i xhenazes së gruas e cila ka vdekur nga "nifasi" dhe sunneti i tij

332. Na ka treguar Ahmed b. Ebu Surejxhi, këtij Shebabe, këtij Shu'be, ky nga Husejn el-Mual-limi, ky nga Ibni Burejde, ky nga Sumre b. Xhundubi, **i cili ka treguar se një grua ka vdekur për shkak të barkut** (gjakderdhjes në lindje). **Pejgamberi s.a.v.s. e fali namazin e xhenazes së saj, duke qëndruar në drejtim të mesit të trupit të saj.**[27]

باب * ٣٣٣ – حدثنا الحسنُ بنُ مُدرِكٍ قال حدَّثنا يحيى بنُ حمَّادٍ قال أخبرنا ابنُ عَوانةَ اسمُهُ الوَضّاحُ مِن كتابِه قال أخبرنا سُلَيمانُ الشَّيبانيُّ عن عبدِ اللهِ بنِ شدَّادٍ قال سمعتُ خالتي ميمونةَ زوجَ النبيِّ ﷺ أنها كانت تكون حائضًا لا تُصلِّي وهي مُفترِشةٌ بحذاءِ مَسجِدِ رسولِ اللهِ ﷺ وهو يُصلِّي على خُمرَتِهِ إذا سجدَ أصابني بعضُ ثوبِهِ

---

26 Përfaqësuesit e shkollës hanefite, Shafiu, Thevriu dhe shumë juristë të tjerë mendojnë se distanca më e shkurtër në mes dy menstruacioneve është 15 ditë, e disa e sjellin deri në 10 bile dhe në 8 ditë.

Gjatë ditëve të gjakderdhjes së jashtëzakonshme, gruaja mund t'i kreyejë të gjitha manifestimet fetare, madje mund të ketë edhe marrëdhënie seksuale.

27 Gjatë faljes së namazit të xhenazes së femrës, imami duhet të qëndrojë drejt mjedisit të trupit të saj, kurse sipas mendimit të juristëve të shkollës hanefite, në drejtim të gjoksit të të vdekurit, pavarësisht nga gjinia.

Në "Mugnije" qëndron se nuk prish punë që imami të qëndrojë kah gjoksi, shpatulla ose ka mjedisi i trupit të të vdekurit, sepse për këtë çështje nuk kanë qenë të qartë as juristët e shkollave burimore islame. Në "Mebsut" theksohet se është më mirë që imami të qëndrojë në drejtim të mjedisit të trupit të të vdekurit, sepse ai është mesi i tij, mbi të cilin janë duart dhe koka dhe nën të janë barku dhe këmbët.

Imam Ahmedi rekomandon që imami të qëndrojë kaj mjedisi i trupit të të vdekurit te gratë, kurse te mashkujt kah gjoksi.

333. Na ka treguar el-Hasan b. Mudriku, këtij Jahja b. Hammadi, këtij Ebu Avane, emri i të cili është el-Veddah, nga libri i tij ka thënë:

Na ka treguar Sulejman Shejbaniu, këtij Abdullah b. Sheddadi, duke thënë: **"E kam dëgjuar tezen time, Mejmunen, bashkëshorte e Pejgamberit s.a.v.s. se ajo, duke qenë me menstruacione, nuk e ka falur namazin, por, megjithatë, ka qëndruar afër vendit ku Pejgamberi s.a.v.s. ka bërë sexhde. Ai e ka filluar namazin në shallin e tij dhe, kur ra në sexhde, më ka prekur një pjesë e teshës së tij"**,[28] tha Mejmunja.

28 Namazi është i vlefshëm edhe kur kryeht në afërsi të drejtpërdrejtë me gruan me menstruacione. Nga modestia rekomandohet që namazi të falet në shtroje modeste. Të falurit në shtroje të mëndafshtë bën pjesë në veprat e përbuzura.

7. Tejemmumi

بسم الله الرحمن الرحيم

٧ - كتاب التيمم

قولُ اللهِ تعالى [٦ المائدة] ﴿ فلم تجدوا ماء فتيمّموا صعيداً طيّباً فامسحوا بوجوهكم وأيديكم منه ﴾

باب * ٣٣٤ - حدّثنا عبدُ اللهِ بنُ يوسُفَ قال أخبرنا مالكٌ عن عبدِ الرحمٰنِ بنِ القاسمِ عن أبيهِ عن عائشةَ زوجِ النبيِّ ﷺ قالت : خرَجْنا مع رسولِ اللهِ ﷺ في بعضِ أسفارِهِ حتّى إذا كنّا بالبَيْداءِ - أو بذاتِ الجيشِ - انقطَعَ عِقْدٌ لي ، فأقامَ رسولُ اللهِ ﷺ على التماسِهِ ، وأقامَ الناسُ معَهُ ، وليسوا على ماء . فأتى الناسُ إلى أبي بكرٍ الصدِّيقِ فقالوا : ألا ترى ما صنَعَتْ عائشةُ ؟ أقامتْ برسولِ اللهِ ﷺ والناسِ ، وليسوا على ماء وليس معهم ماء . فجاء أبو بكرٍ ورسولُ اللهِ ﷺ واضعٌ رأسَهُ على فخذي قد نام ، فقال : حبَسْتِ رسولَ اللهِ ﷺ والناسَ ، وليسوا على ماء وليس معهم ماء . فقالت عائشةُ : فعاتبني أبو بكرٍ وقالَ ما شاء اللهُ أنْ يقولَ ، وجعلَ يطعُنُني بيدِهِ في خاصرَتي ، فلا يمنعُني من التحرُّكِ إلاّ مكانُ رسولِ اللهِ ﷺ على فخذي ، فقامَ رسولُ اللهِ ﷺ حينَ أصبحَ على غيرِ ماء ، فأنزلَ اللهُ آيةَ التيمُّمِ ، فتيمّموا . فقال أسَيْدُ بنُ الحُضَيرِ : ما هيَ بأوّلِ بركَتِكم يا آلَ أبي بكرٍ . قالت : فبعثْنا البعيرَ الذي كنتُ عليهِ ، فأصَبْنا العِقْدَ تحتَهُ

Bismi-l-Lahi-r-Rahmani-r-Rahim!

7. Tejemmumi

Fjala e All-llahut të Madhërueshëm është:

"... e nëse nuk gjeni ujë, atëherë, bëni tejemmum (gjeni dhé të pastër) dhe fshini fytyrat tuaja dhe duart tuaja me të...".

(el-Mâide, 6)

334. Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, këtij Maliku, këtij Abdu-r-Rahman b. Kasimi, ky nga babai i vet, ky nga Aishja, bashkëshortja e Pejgamberit s.a.v.s., e cila ka thënë:

"Kam qenë me Pejgamberin s.a.v.s. në njërën nga ekspeditat e tij. Derisa kemi qenë në Bejda ose në Dhatu-l-Xhejsh, më ishte këputur gjerdani (qaforja). **Pejgamberi s.a.v.s. u ngrit dhe shkoi ta kërkojë atë. Me të shkuan edhe ca të tjerë. Meqë nuk kishin marrë ujë me vete, njerëzit erdhën dhe u ankuan te Ebu Bekr es-Siddiku, duke i thënë: "Ja, shih, çka bën Aishja! E ngriti Pejgamberin s.a.v.s., por edhe njerëzit e tjerë, e këtu nuk ka ujë, e as që kanë marrë me vete". Dhe, derisa Pejgamberi s.a.v.s. ende e mbante kokën në kofshën time dhe flente, erdhi Ebu Bekri dhe tha: "E ke ndaluar** (penguar) **Pejgamberin s.a.v.s. dhe njerëzit e tjerë, e këtu nuk ka ujë, e as që kanë marrë me vete".**

Ebu Bekri më qortoi, duke thënë gjithçka që All-llahu deshti të më thotë dhe filloi, thotë Aishja, të më shtyjë me dorën e tij për krahu që, vetëm pozita e Pejgamberit s.a.v.s. në kofshën time, më pengoi të mos lëviz nga vendi".

Agoi dita dhe Pejgamberi s.a.v.s. u ngrit. Meqë nuk kishte ujë, All-llahu xh.sh. shpalli ajetin për tejemmumin dhe ata morën tejemmum. Usejd b. Hujdari, atëherë, tha: **"Oj familja e Ebu Bekrit, tejemmumi nuk është dhurata e parë e juaja"! Më vonë, tha Aishja, e ngritëm devën me të cilën unë udhëtoja dhe, nën të e gjetëm gjerdanin tim.**[1]

---

1 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- lejohet t'i ankohesh babait për bijen e tij të martuar;
- u lejohet prindërve të hyjnë në dhomat e bijave të tyre të martuara në cfarëdo kohe, nëse nuk janë të zëna me marrëdhënie intime me burrat e tyre.
- prindërit duhet t'i edukojnë fëmijët e tyre edhe pasi ata të kenë formuar familjen e tyre;
- këmbëngulësia në punë është siguria më e mirë për përfundimin e saj të suksesshëm;
- të hulumtosh për ujë posa të fillojë koha e namazit;
- Muhammedi a.s. edhe më parë e kishte praktikuar të marrë tejemmum, e tash tejemmumi u bë i plotëfuqishëm me Kur'an;
- për marrjen tejemmum duhet bërë nijet;
- me tejemmum shërbehet çdo person në mënyrë të barabartë, si për larje (guslë) si për abdest;
- sipas mednimit të të gjithë juristëve islamë lejohet të merret tejemmum në udhëtim, e

٣٣٥ – حدثنا محمد بن سنان قال حدثنا هشيم . ع . قال : وحدثني سعيد بن النضر قال أخبرنا هشيم قال أخبرنا سيار قال حدثنا يزيد – هو ابن صهيب الفقير – قال أخبرنا جابر بن عبد الله أن النبي ﷺ قال « أعطيت خمساً لم يعطهن أحد قبلي : نصرت بالرعب مسيرة شهر ، وجعلت لي الأرض مسجداً وطهوراً فأيما رجل من أمتي أدركته الصلاة فليصل ، وأحلت لي المغانم ولم تحل لأحد قبلي ، وأعطيت الشفاعة ، وكان النبي يبعث إلى قومه خاصة وبعثت إلى الناس عامة »

335. Na ka treguar Muhammed b. Sinani, këtij Hushejmi, e sipas sendit tjetër, më ka treguar Se'id b. Nadri, këtij Hushejmi, këtij Sejjari, ky nga Jezid b. Suhejb el-Fakiri, këtij Xhabir b. Abdullahu se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Më janë dhënë mua pesë dhurata të cilat nuk i janë dhënë askujt para meje: fuqia për ta frikuar armikun nga një distancë të një ecjeje njëmujore; gjithë toka më është bërë vend për të bërë lutje (mesxhid) **dhe pastrim, prandaj, cilindo nga ithtarët e mi ta zë ndonjë namaz, le ta falë namazin aty** (në tokë të pastër); **më është bërë e lejueshme** (hallall) **pasuria e luftës, që nuk ka qenë e lejueshme për asnjë para meje; më është dhuruar mbrojtja** (shefaati) **në Ditën e Gjykimit: çdo Pejgamber ka qenë i dërguar vetëm për popullin e vet, kurse unë për gjithë njerëzimin".**[2]

Maliku këtë e lejon edhe në shtëpi kur nuk ka ujë ose kur nuk mund të përdoret uji për shkak të sëmundjes, të ftohtit të madh, ose për shkak të kalimit të kohës së namazit.

Ebu Hanife, Shafiu dhe Tehaviu lejojnë marrjen e tejemmumit në të gjitha rastet e lartpërmendura, përveç rastit të fundit, d.m.th. kalimit të kohës së namazit.

Imam Ebu Jusufi dhe Zubejri kanë thënë: "Nuk i lejohet të marrë tejemmum personi që është në shtëpi, as për shkak të sëmundjes, e as për shkak të frikës se do t'i kalojë koha e namazit", e Taberiu dhe Ebu Lejthi shtojnë: "... do të marrë tejemmum e do të falet, por atë namaz të falur do ta përsërisë kur të gjejë ujë".

- i lejohet bashkëshortes të shkojë në ekspeditë ushtarake me bashkëshortin e saj;
- pasurinë personale duhet ruajtur, e atë që e humb duhet kërkuar;
- lejohet të huazosh stolinë nga tjetri dhe me të të udhëtosh sikurse ka vepruar Aishja;
- lejohet, bile rekomandohet, që bashkëshortja ta zbukurojë dhe ta rregullojë bashkëshortin e vet;
- nuk është gjë e pahijshme që bashkëshorti të mbështesë kokën te kofsha, te këmba ose në krah të bashkëshortes.

2 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

باب إذا لم يجد ماء ولا ترابا

٣٣٦ – حدثنا زكرياء بن يحيى قال حدثنا عبد الله بن نمير قال حدثنا هشام بن عروة عن أبيه عن عائشة أنها استعارت من أسماء قلادة فهلكت، فبعث رسول ﷺ رجلا فوجدها، فأدركتهم الصلاة وليس معهم ماء، فصلوا، فشكوا ذلك إلى رسول الله ﷺ، فأنزل الله آية التيمم، فقال أسيد بن حضير لعائشة: جزاك الله خيرا، فوالله ما نزل بك أمر تكرهينه إلا جعل الله ذلك لك وللمسلمين فيه خيرا

Kur njeriu nuk gjen as ujë as dhé

336. Na ka treguar Zekerija b. Jahjai, këtij Abdullah b. Numejri, këtij Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, e ky nga Aishja, e cila tregon se ia ka marrë hua gjerdanin Esmasë, dhe ia ka humbur. Prandaj, Pejgamberi s.a.v.s. e dërgoi një njeri që ta kërkojë dhe e gjeti. Atëherë, erdhi edhe koha e faljes së namazit. Meqë nuk kishin ujë, u falen pa abdest. Më pastaj, iu ankuan për këtë Pejgamberit s.a.v.s., prandaj All-llahu i Madhëruesëm shpalli ajetin për tejemmum.

Më vonë Usjed b. Hudajri i ka thënë Aishes: **"All-llahu të ka shpërblyer me mirësi! Për Zotin, All-llahu asnjëherë nuk të ka dhënë ndonjë gjë të pakëndshme** (të papëlqyeshme), **e që në këtë nuk të ka dhënë edhe ty edhe muslimanëve ndonjë të mirë"**.[3]

- paralajmërimi se Islami do të zgjasë deri në Ditën e Gjykimit dhe se do ta pranojnë shumë popuj;
- të drejtë mbrojtje për gabimtarët (gjynahqarët) në Ditën e Gjykimit në radhë të parë i jepet Pejgamberit a.s.;
- namazi do të jetë i vlefshëm si me abdest, si me tejemmum;
- Maliku lejon të merret tejemmum me: dhé, rërë, trung të drutit, borë, gëlqere, dhe tulla, kurse Evzaiu lejon të merret tejemmum me gjithçka në tokë, sepse në Kur'an thuhet: "... sa'îden", d.m.th. me sipërfaqen e shtresës së sipërme të pastër të tokës".

Në "Mebsut" qëndron se për tejemmum nuk mund të shfrytëzohet sipërfaqja e xhamit të përpunuar, e arit, e argjendit, ndërkaq, mund të merret tejemmum me xehet në përbërjen e të cilave ka një pjesë të madhe të dheut (tokës);

- lejohet pasuria e luftës dhe fitimi i saj është i rregulluar me norma të caktuar të sheriatit.

3 Neveviu, duke u mbështetur në rastin e sipërpërmendur, thotë se personi duhet të falë namazin edhe kur nuk ka ujë për abdest ose dhé të përshtatshëm për tejemmum.
Disa juristë të shkollë shaffite mendojnë se personi i tillë duhet të falë namazin, por kur

بابُ التيمم في الحضر إذا لم يجد الماء وخاف فوت الصلاة ، وبه قال عطاء

وقال الحسنُ في المريض عنده الماء ولا يجدُ من يناوله : يتيمم

وأقبل ابنُ عمر من أرضه بالجُرف فحضرت العصرُ بمربد النعم فصلى ، ثم دخل المدينة والشمسُ مرتفعة فلم يعد

٣٣٧ — حدثنا يحيى بنُ بكير قال حدثنا الليثُ عن جعفرِ بنِ ربيعة عن الأعرج قال سمعتُ عُميراً مولى ابنِ عباسٍ قال : أقبلتُ أنا وعبدُ اللهِ بنُ يسارٍ مولى ميمونة زوج النبيِّ ﷺ حتى دخلنا على أبي جُهيم بنِ الحارثِ بنِ الصِّمَّةِ الأنصاريِّ ، فقال أبو الجُهيم « أقبل النبيُّ ﷺ من نحوِ بئرِ جَمَل فلقيه رجلٌ فسلَّم عليه فلم يَرُدَّ عليه النبيُّ ﷺ حتى أقبل على الجدارِ فمسح بوجهه ويديه ، ثم ردَّ عليه السلام »

Tejemmumi në shtëpi merret kur nuk ka ujë ose nga frika të mos kalojë koha e namazit

Këtë e ka thënë edhe Atai, kurse Hasani mendon se edhe i sëmuri (i palëvizshmi) **i cili ka ujë, por që nuk ka kush që t'ia japë, do të marrë tejemmum.**

Ibni Umeri është nisur për në Xhuruf, kurse koha e namazit të iqindisë e ka zënë në Merbedu-n-Na'amu (periferi e Medines). **Këtu ka falë namazin** (me tejemmum) **dhe ka hyrë në Medine. Edhe pse dielli ishte ende lart, ai nuk e përsëriti namazin.**[4]

---

të arrijë te uji, përkatësisht te toka e përshtatshme për tejemmum, duhet ta përsërit atë namaz; të tjerët mendojnë se nuk duhet të falet namazi pa abdest dhe pa tejemmum, por vetëm duhet kompenzuar (kaza), kur të krijohen kushtet. Këtë mendim e mbështet edhe Ebu Hanife, e disa të tjerë mendojnë se duhet të falet, e nuk duhet të kompenzohet (nuk duhet të bëhet kaza). Ky është mendim edhe i Imam Malikut.

Maliku ka thënë: "I burgosuri, i lidhuri ose i sëmuri rëndë, që nuk mund të përdorë as ujin e as tokën, nuk është i detyruar të falet, derisa të jetë në gjendje të përdorë ujin për abdest ose tokën për tejemmum. Këtë mendim e mbështet edhe Ebu Hanife.

Shafiu, Ebu Jusufi dhe Muhammedi mendojnë se personi i tillë duhet të falet, por edhe namazin duhet ta kompenzojë posa të mund të marrë abdest ose tejemmum.

4 Mendimi i plotë i Atait është: "Personit të cilit i fillon koha e namazit në shtëpi pa ujë, do të presë deri para përfundimit të asaj kohe, nëse edhe atëherë nuk gjen ujë, do të marrë tejemmum dhe do ta falë edhe namazin vijues".

Tehaviu lejon të merret tejemmum në qytet vetëm në rastet:

a. kur personit, po të marrë abdest, do t'i kalojë falja e xhenazes, ose namazi i Bajrameve

337. Na ka treguar Jahja b. Bukejri, këtij Lejthi, ky nga Xha'fer b. Rebi'a, ky nga A'rexhi, i cili tregon se e ka dëgjuar Umejrin, robin e liruar të Ibni Abbasit, duke thënë:

"Jemi nisur me Abdullah b. Jesarin, rob i liruar i Mejmunes, bashkëshortes së Pejgamberit s.a.v.s. dhe kemi hyrë te Ebu Xhuhejm b. Harith b. Simme Ensariu". Pastaj, Ebu Xhuhejmi tregon: **"Pejgamberi s.a.v.s. ka shkuar në drejtim të Bi'ri Xhemelit dhe në udhëtim e sipër atë** (Pejgamberin s.a.v.s.) **e ka takuar një njeri dhe e ka përshëndetur** (i ka dhënë selam). **Pejgamberi s.a.v.s. nuk ia ktheu selamin menjëherë, por u kthye në drejtim të një muri, i fërkoi duart** (për muri) **dhe e fshiu fytyrën dhe duart** (u dha mes-h), **e pastaj ia ktheu selamin"**.[5]

باب التيمم هل ينفخ فيهما ؟

٣٣٨ - حدثنا آدم قال حدثنا شعبة حدثنا الحكم عن ذر عن سعيد بن عبد الرحمن بن أبزى عن أبيه قال : جاء رجل إلى عمر بن الخطاب فقال : إني أجنبت فلم أصب الماء . فقال عمار بن ياسر لعمر بن الخطاب : أما تذكر أنا كنا في سفر أنا وأنت ، فأما أنت فلم تصل ، وأما أنا فتمعكت فصليت ، فذكرت للنبي ﷺ ، فقال النبي ﷺ « كان يكفيك هكذا » فضرب النبي ﷺ بكفيه الأرض ونفخ فيهما ، ثم مسح بهما وجهه وكفيه

---

dhe,

b. xhunubit i cili nuk guxon të lahet për shkak të ftohtit.

Tamertashiu nuk lejon të merret tejemmum në qytet, sepse në të mund të gjendet gjithnjë ujë i mjaftueshëm, ndërsa Shafiu mban mendim krejt tjetër.

Ibni Umeri, Atai, Hasan Basriu dhe Ebu Hanife lejojnë të merret (tejemmum në qytet, me kusht që uji të kërkohet dhe të pritet deri para përfundimit të kohës së namazit, e nëse konstatohet se uji nuk mund të gjendet deri në mbarim të asaj kohe, do të marret tejemmum që kur fillon koha e namazit dhe të falet namazi.

5 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:

- tejemmumi mund të merret edhe në shtëpi kur nuk ka ujë;
- tejemmumi mund të merret duke i fërkuar duart për guri, nëse në të ka dhé, ose së paku pluhur, kurse guri i lëmuar, krejtësisht i pastër, nuk mund të shërbejë për këtë qëllim. Tehaviu, Lejthi, Evzaiu dhe juristët e Kufes, lejojnë të merret tejemmum edhe nëse ka ujë, që të arrihet falja e namazit të xhenazes, kurse Maliku, Shafiu dhe Ahmedi nuk pajtohen me këtë mendim;
- tejemmumi i cili merret për të kryer ndonjë farz, vlen edhe për të gjitha detyrat tjera fetare në atë kohë.

A t'u fryejë duarve ai që merr tejemmum?

338. Na ka treguar Ademi, këtij Shu'be, këtij Hakemi, ky nga Dherri, ky nga Se'id b. Abdu-r-Rahman b. Ebzai, e ky nga babai i vet, i cili ka thënë:

"Erdhi një njeri te Umer b. Hattabi dhe tha: Unë jam bërë xhunub (kam polocuar) **dhe nuk kam gjetur ujë** (për t'u larë)". Atëherë Ammar b. Jasiri i tha Umer b. Hattabit: **"A nuk të kujtohet kur ne, unë dhe ti, kemi qenë në një ekspeditë ushtarake, e ti nuk e fale namazin, kurse unë jam fërkuar për toke dhe e fala namazin. Më vonë, këtë ia kam thënë Pejgamberit s.a.v.s.**, e ai më tha:

"Ka qenë e mjaftueshme (të veprosh) **vetëm kështu: i lëshoi Pejgamberi s.a.v.s. shuplakat** (pëllëmbat) **për dheu, fryu në to dhe, pastaj, me ta e fërkoi fytyrën dhe duart e tij".**[6]

باب التيمم للوجه والكفين

٣٣٩ - حدثنا حجاج قال أخبرنا شعبة أخبرني الحكم عن ذر عن سعيد بن عبد الرحمن بن أبزى عن أبيه قال عمار بهذا، وضرب شعبة بيديه الأرض، ثم أدناهما من فيه، ثم مسح وجهه وكفيه

وقال النضر أخبرنا شعبة عن الحكم قال سمعت ذراً يقول عن ابن عبد الرحمن بن أبزى قال الحكم وقد سمعته من ابن عبد الرحمن عن أبيه قال: قال عمار

---

6 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- Umeri nuk ka ditur se edhe xhunubi mund të përdorë tejemmumin, kurse Ammari nuk ka ditur si merret tejemmum;
- gjatë marrjes tejemmum duhet të lëshohen shuplakat (pëllëmbat) e duarve në tokë të pastër vetëm një herë dhe me to të fërkohet fytyra dhe duart (deri në bërryla). Ky është qëndrim i Atait, Sha'biut, Evzaiut, Ahmedit, Is-hakut dhe Taberiut. Megjithatë, Ebu Hanife, Maliku, Shafiu dhe Lejthi mendojnë se për fërkuarjen e fytyrës duhet të preket toka veçanërisht me shuplakat e duarve, e pastaj të preket veçanërisht për fshirjen e duarve deri në bërryla. Këta i përmbahen thënies dhe praktikës së Ibni Umerit, Xhabirit, Aishes dhe Aslesë, duke konsideruar se Muhammedi a.s. i ka treguar Ammarit vetëm në mënyrë të përgjithshme, e jo mënyrën e hollësishme të marrjes së tejemmumit;
- duke patur parasysh se Muhammedi a.s. u ka fryrë shuplakave të duarve (pasi i tërheq nga toka) dhe me këtë veprim e ka larguar pluhurin, Ebu Hanifja lejon të merret tejemmum duke e prekur shkëmbin ose gurin në të cilët nuk ka as dhé as pluhur;
- t'u frysh duarve për ta hequr pluhurin para se të fërkosh fytyrën dhe duart është sunnet.

Tejemmum është (prekja e tokës) veçanërisht për fytyrë e veçanërisht për duar (deri në bërryla)

339. Na ka treguar Haxhxhaxhi, këtij Shu'be, këtij Hakemi, ky nga Dherri, ky nga Se'id b. Abdu-r-Rahman b. Ebzai, ky nga babai i vet, këtij i ka treguar Ammari se Shu'bja i ka lëshuar duart në tokë, pastaj, i ka afruar ato te goja, e pastaj, me duar e ka fshirë fytyrën dhe duart (deri në bërryla).

Nadri ka thënë se e ka njoftuar këtë Shu'be, këtë Hakemi, këtë Dherri, ky nga Ibni Abdu-r-Rahman b. Ebzaiu. Hakemi, ndërkaq, ka treguar se e ka dëgjuar drejtpërdrejt nga Ibni Abdu-r-Rahmani, ky nga babai i vet, i cili ka thënë se Ammari i ka treguar këtij.

٣٤٠ – حدثنا سليمانُ بنُ حربٍ قال حدثنا شعبةُ عنِ الحكمِ عن ذرٍّ عنِ ابنِ عبدِ الرحمنِ بنِ أبزى عن أبيهِ أنه شهدَ عمرَ وقال له عمارٌ : كنا في سريةٍ فأجنبنا . وقال : تمعكَ فيها

340. Na ka treguar Sulejman b. Harbi, këtij Shu'be, ky nga Hakemi, ky nga Dherri, ky nga Ibni Abdu-r-Rahman b. Ebzai, ky nga babai i vet, i cili ka qenë i pranishëm te Umeri, kur Ammari i ka thënë (Umerit):

"Kemi qenë në të njëjtën njësi dhe jemi bërë xhunub..." dhe i tha edhe **"... ka fryrë në to** (në shuplaka)".

٣٤١ – حدثنا محمدُ بنُ كثيرٍ أخبرنا شعبةُ عنِ الحكمِ عن ذرٍّ عنِ ابنِ عبدِ الرحمنِ بنِ أبزى عن عبدِ الرحمنِ قال : قال عمارٌ لعمرَ : تمعكتُ فأتيتُ النبيَّ ﷺ فقال « يكفيكَ الوجهُ والكفانِ »

341. Na ka treguar Muhammed b. Kethiri, këtij Shu'be, këtij Hakemi, ky nga Dherri, ky nga Ibni Abdu-r-Rahman b. Ebzai, e ky nga Abdu-r-Rahmani, i cili i ka thënë Umerit:

"Jam fërkuar (jam shkrirë) **në tokë, e pastaj kam shkuar te Pejgamberi s.a.v.s.** (pasi i kam treguar se si kam vepruar) **ai më tha:**

"Ka qenë e mjaftueshme të fërkohet vetëm fytyra dhe duart (deri në bërryla)".

٣٤٢ ـ حدثنا مُسْلِمٌ حدثنا شُعبةُ عنِ الحكمِ عن ذَرٍّ عنِ ابنِ عبدِ الرحمٰنِ عن عبدِ الرحمٰنِ قال : شَهِدْتُ عمرَ فقال له عمّارٌ . . وساق الحديثَ

342. Na ka treguar Muslimi, duke transmetuar nga Shu'be, ky nga Hakemi, ky nga Dherri, ky nga Ibni Abdu-r-Rahmani, ky nga Abdu-r-Rahmani, i cili ka thënë:

"Kam qenë i pranishëm te Umeri, kur Ammari i tha (Umerit) **duke i sjellur si shembull hadithin e sipërshënuar".**

٣٤٣ ـ حدثنا محمدُ بنُ بَشّارٍ قال حدثنا غُنْدَرٌ حدثنا شُعبةُ عنِ الحكمِ عن ذَرٍّ عنِ ابنِ عبدِ الرحمٰنِ ابنِ أَبْزَى عن أبيهِ قال : قال عمّارٌ « فضَرَبَ النبيُّ ﷺ بيدِهِ الأرضَ فَمسحَ وجهَهُ وكفَّيهِ »

343. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari, këtij Gunderi, këtë e ka njoftuar Shu'be, ky nga Hakemi, ky nga Dherri, ky nga Ibni Abdu-r-Rahman b. Ebzai, ky nga babai i vet, i cili tregon se Ammari ka thënë: **"Dhe, pastaj Pejgamberi s.a.v.s. i lëshoi duart për toke dhe** (me to) **e fërkoi fytyrën dhe duart e veta".**

بابُ الصَّعيدُ الطيِّبُ وَضوءُ المُسلمِ يَكفيهِ منَ الماءِ . وقال الحسن : يُجزِئُهُ التيمُّمُ ما لم يُحدِثْ . وأمَّ ابنُ عبّاسٍ وهُو متيمِّم . وقال يحيىٰ بنُ سَعيدٍ : لا بأسَ بالصلاةِ عَلَى السَّبَخَةِ والتيمُّمِ بها

Sipërfaqja e pastër e tokës është ujë abdesti (pastrim) për muslimanët dhe ajo është e mjaftueshme (në vend të ujit)

Hasani ka thënë se për muslimanin është i mjaftueshëm tejemmumi derisa nuk i paraqitet ajo që ia prish.

Ibni Abbasi ka dalur imam duke qenë me tejemmum.

Jahja b. Se'idi ka thënë: **"Nuk prish punë që namazi të falet në tokë të pastër dhe me të të merret tejemmum".**[7]

٣٤٤ — حدثنا مُسَدَّدٌ قال حدثني يحيى بنُ سَعيدٍ قال حدثنا عَوفٌ قال حدثنا أبو رَجاءٍ عن عِمرانَ قال: كنّا في سَفَرٍ مع النبيِّ ﷺ، وإنّا أسْرَيْنا حتى إذا كنّا في آخرِ الليلِ وَقَعْنا وَقعةً ولا وَقعةَ أحلَى عِندَ المُسافِرِ منها، فما أيقظَنا إلاّ حَرُّ الشمسِ، وكان أوّلَ مَنِ استيقظَ فُلانٌ ثمّ فُلانٌ ثمّ فلان ـ يُسمّيهم أبو رَجاءٍ فنَسِيَ عَوفٌ ـ ثمّ عُمرُ بنُ الخطّابِ الرّابعُ، وكان النبيُّ ﷺ إذا نامَ لم يُوقَظْ حتى يَكونَ هُوَ يَستيقِظُ لأنّا لا نَدري ما يَحدُثُ له في نَومِه. فلمّا استيقظَ عمرُ ورأى ما أصابَ النّاسَ ـ وكانَ رجُلاً جَليداً ـ فكبّرَ ورَفَعَ صَوتَهُ بالتكبيرِ، فما زالَ يُكبّرُ ويَرفَعُ صوتَهُ بالتكبيرِ حتى استيقَظَ بصوتِهِ النبيُّ ﷺ، فلمّا استيقظَ شَكَوْا إليه الذي أصابَهم، قال: لا ضَيرَ ـ أو لا يَضيرُ ـ ارتَحِلوا. فارتحلَ، فسارَ غيرَ بَعيدٍ، ثمّ نزلَ فدعا بالوَضوءِ فتوضّأ، ونُودِيَ بالصلاةِ فصلّى بالناسِ، فلما انفتَلَ مِن صلاتِهِ إذا هُوَ برَجُلٍ مُعتزِلٍ لم يُصَلِّ مع القومِ، قال: ما مَنَعَكَ يا فلانُ أن تُصلّيَ مع القومِ؟ قال: أصابَتْني جَنابةٌ ولا ماءَ. قال: عليكَ بالصَّعيدِ، فانه يَكفيكَ. ثمّ سارَ النبيُّ ﷺ فاشتكى إليه الناسُ من العَطَشِ، فنزلَ فدعا فُلاناً ـ كان يُسمّيهِ أبو رجاءٍ نَسِيَهُ عَوفٌ ـ ودعا

---

7 Sipas mendimit të Hasan Basriut tejemmumi e ka vlerën e abdestit dhe me të mund të kryhen në mënyrë të plotëfuqishme të gjitha detyrimet fetare derisa të arrihet te uji. Ky qëndrim është edhe i juristëve të shkollës hanefite, kurse Shafiu, Maliku, Ahmedi dhe Is-haku lejojnë të kryhen vetëm veprat e detyrueshme fetare (farzet).

Muhammed b. Hasani dhe Hasan b. Hajji, ndërkaq, nuk lejojnë që personi me tejemmum të bëhet imam i xhematit me abdest, kurse Maliku dhe Abdullah b. Hasani këtë vepër e konsiderojnë të përbuzur (mekruh).

Rebi'a mednon se personi xhunub mund të bëhet imam me tejemmum vetëm për njerëzit me tejemmum, kurse Evzaiu thotë: "Personi i tillë nuk duhet t'i bëhet imam xhematit, vetëm nëse ai person është ndonjë udhëheqës". Këtë mendim e kanë përvetësuar Ibni Hazmi dhe Jahja b. Se'idi.

Ebu Talibi ka thënë se:

- E kam pyetur Abdullah b. Umerin për rastin e lartshënuar, e ai më është përgjigjur: Mundet, sepse Ibni Abbasi si xhunub, ka marrë tejemmum dhe u është bërë imam njerëzve, e kur është njoftuar Muhammedi a.s. për këtë rast, ai vetëm ka buzëqeshur (d.m.th. është pajtuar)".

عايا فقال :اذهبا فابتغيا الماء ، فانطلقا فتلقيا امرأة بين مزادتين ـ أو سطيحتين ـ من ماء على بعير لها فقالا لها : أين الماء ؟ قالت عهدي بالماء أمس هذه الساعة ، ونفرنا خلوفا . قالا لها : انطلقي إذا . قالت : إلى أين ؟ قالا : إلى رسول الله ﷺ . قالت الذي يقال له الصابئ . قالا : هو الذي تعنين ، فانطلقي . فجاءا بها إلى النبي ﷺ وحدثاه الحديث . قال : فاستنزلوها عن بعيرها ، ودعا النبي ﷺ بإناء ففرغ فيه من أفواه المزادتين ـ أو السطيحتين ـ وأوكأ أفواههما وأطلق العزالي ونودي في الناس : اسقوا واستقوا . فسقى من شاء واستقى من شاء ، وكان آخر ذاك أن أعطى الذي أصابته الجنابة إناء من ماء قال : اذهب فأفرغه عليك . وهي قائمة تنظر إلى ما يفعل بمائها . وايم الله لقد أقلع عنها وإنه ليخيل إلينا أنها أشد ملأة منها حين ابتدأ فيها . فقال النبي ﷺ : اجمعوا لها . فجمعوا لها ـ من بين عجوة ودقيقة وسويقة ـ حتى جمعوا لها طعاما ، فجعلوها في ثوب وحملوها على بعيرها ووضعوا الثوب بين يديها ، قال لها : تعلمين ما رزئنا من مائك شيئا ، ولكن الله هو الذي أسقانا . فأتت أهلها وقد احتبست عنهم . قالوا : ما حبسك يا فلانة ؟ قالت العجب ، لقيني رجلان فذهبا بي إلى هذا الذي يقال له الصابئ ، ففعل كذا وكذا ، فو الله إنه لأسحر الناس من بين هذه وهذه ـ وقالت بإصبعيها الوسطى والسبابة فرفعتهما إلى السماء تعني السماء والأرض ـ أو إنه لرسول الله حقا . فكان المسلمون بعد ذلك يغيرون على من حولها من المشركين ولا يصيبون الصرم الذي هي منه . فقالت يوما لقومها : ما أرى أن هؤلاء القوم يدعونكم عمدا ، فهل لكم في الإسلام ؟ فأطاعوها ، فدخلوا في الإسلام

344. Na ka treguar Museddedi, këtij Jahja b. Se'idi, këtij Avfi, këtij Ebu Rexhai, ky nga Imrani, i cili ka thënë:

"Kam qenë me Pejgamberin s.a.v.s. në një ekspeditë ushtarake. (Në kthim e sipër) **kemi udhëtuar tërë natën dhe kah fundi i natës ramë të flemë. Kemi ëndërruar, e nuk ka pasur ëndërr më të këndshme se ajo, sepse nuk ka mundur të na zgjojë asgjë, përveç diellit të fortë. I pari që u ngrit ishte filani, pastaj filani, pastaj filani. Ebu Rexhai të gjithë këta i numëroi me emra, por Avfi** (thotë transmetuesi) **i kishte harruar. I katërti që u ngrit ishte Umer b. Hattabi. Ndërkaq, kur Pejgamberi s.a.v.s. flente, atë nuk e zgjonin derisa zgjohej vetë, sepse nuk e dinim se çka i paraqitej atij gjatë të fjeturit" thonin As-habët.**

Pasi Umeri u zgjua dhe i pa njerëzit se çka po bëjnë, e ka qenë njeri i fuqishëm, bëri tekbir dhe këtë e bëri me zë të lartë dhe të fortë. E bëri me zë të lartë, saqë Pejgamberi s.a.v.s. u zgjua nga zëri i tij. Kur u zgjua, ata u ankuan te ai për atë që u kishte ngjarë. **"Nuk ka dëm, respektivisht, nuk**

prish punë", tha Pejgamberi s.a.v.s. **"Nisuni"! U nis, udhëtoi, por jo shumë, e pastaj u ul dhe kërkoi ujë për të marrë abdest. Pasi mori abdest dhe u bë ikamet për namaz, ai me njerëzit e tjerë, që ishin të pranishëm, e fali namazin. Pasi e fali namazin, u kthye prapa, e kur vërejti një njeri i cili nuk u fal me të, iu drejtua:**

"Çka të pengoi ty të mos falesh me ne"?

"Jam bërë xhunub (në ëndërr), **e ujë nuk ka"**, iu përgjigj.

"Shërbehu me sipërfaqen e pastër të tokës, ajo është e mjaftueshme", i tha (Pejgamberi s.a.v.s.)

Pastaj, Pejgamberi s.a.v.s. vazhdoi të udhëtojë, por njerëzit u ankuan nga etja. Ai u ul, e thirri filanin, emrin e të cilit Ebu Rexhai e ka përmendur, por Avfi e kishte harruar (thotë transmetuesi). E thirri edhe Aliun, të cilëve u tha:

"Shkoni dhe hulumtoni për ujë"!

Ata shkuan dhe u ndeshen në një grua e cila në dy barakaliqe, respektivisht në dy calikë që i kishte në deve kishte ujë.

"Ku është uji"? e pyetën (këta të dy).

"Unë dje, pikërisht në këtë kohë i kam mbushur me ujë, e shokët tanë mbetën pas", u tha ajo.

Kur i thanë ata **"Shko, nisu"**! ajo i pyeti: **"E ku"**? **"Te Pejgamberi s.a.v.s."**, i thanë. **"A te ai që i thonë sabejas** (i Sabejit)**?"** pyeti ajo. **"Mu ai është, për të cilin ti mendon"**, i thanë.

Atëherë, ajo u nis dhe e sollën te Pejgamberi s.a.v.s.. Ia treguan rastin Pejgamberit, dhe kërkuan nga ajo, thotë transmetuesi që të zbresë nga devja.

Pejgamberi s.a.v.s. kërkoi një enë dhe e vendosi në vendin e hapur të calikut, respektivisht aty ku caliku derdh ujë; i shtrëgnoi vendet e tjera të hapura, e lëshoi pipin e calikut dhe e thirri popullin me zë të lartë: **"Mbushni dhe pini"**! Piu dhe u ngop kush deshi. I fundit, të cilit i është dhënë ena me ujë, ishte ai i cili qe bërë xhunub (i papastër nga polucioni). Edhe këtij i tha Pejgamberi s.a.v.s.: **"Shko dhe laju"!**

Gruaja qëndroi dhe pa se çka u bë me ujin e saj: **"Për Zotin, gjithë ujin e nxorrën nga caliku"!** sikur tha në vete.

Neve na u duk se tash ishin të mbushura më shumë sesa që ishin më parë. Pejgamberi s.a.v.s. tha: **"Mblidhni për të gjithçka"**! Ata, atëherë, për të

mbolodhën hurma, miell, bile edhe kaçamak; ia mbështollën në pëlhurë dhe ia ngarkuan në deve, përpara saj. Pastaj, Pejgamberi s.a.v.s. i tha: **"Ta dish, ne nuk e pakësuam aspak ujin tënd, por All-llahu është Ai i cili na ngopi me ujë".**

Ajo, pastaj, shkoi te familja e vet, e meqë u vonua, e pyetën: **"Oj grua, pse u vonove aq shumë"? "Gjë e çuditshme"**, u përgjigj ajo. **Më takuan dy persona dhe më dërguan te ai, për të cilin flitet se është sabejas, i cili ka bërë këtë dhe këtë. Për Zotin, ai, ose është fallxhori më i madh në mes këtij dhe këtij", - duke treguar me dy gishtat e vet, me gishtin tregues dhe të mesmin, duke i ngitur ata kah qielli, duke pasë për qëllim me këtë qiellin dhe tokën, ose është me të vërtetë Pejgamber i All-llahut.**

Më vonë muslimanët u ndeshën në idhujtarët, por jo në lagjen nga e cila ishte ajo. Një ditë ajo i tha popullit të vet: **"Ajo që unë mendoj është se këta njerëz u kanë lënë juve të qetë me qëllim, prandaj, a doni të pranoni Islamin"? Ata e dëgjuan dhe e pranuan Islamin.**[8]

بابٌ إذا خافَ الجُنُبُ عَلَى نفسِهِ المرَضَ أو الموتَ أو خافَ العَطَشَ تيمَّمَ

ويُذكَرُ أنَّ عمرو بنَ العاصِ أجنَبَ في ليلةٍ باردةٍ فتيمَّمَ وتلا [٢٩ النساء] ﴿ ولا تَقتُلوا أنفُسَكُم إنَّ اللهَ كانَ بِكُم رَحيما ﴾ فذَكَرَ للنبيِّ ﷺ فلم يُعَنِّف

8 Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- në shoqërinë e ngritur për nga dituria duhet të udhëheqësh në mënyrë të njerëzishme;
- personi i ditur dhe me përvojë duhet t'i mësojë të tjerët me fjalë të mira dhe me zë të këndshëm, kurse fqinjtë t'i nxisësh për vepra të mira dhe të dobishme për shoqërinë;
- nuk duhet të qëndrosh gjatë kohë në vend të pamoralshëm dhe të pasigurtë;
- namazi që ka kaluar pa u falur, duhet të kompenzohet (të bëhet kaza). Është e këshillueshme të thirret edhe ezani;
- mund të kërkosh ujë nga tjetri, qoftë për pije, qoftë për nevoja të tjera;
- bamirësinë duhet kthyer me bamirësi;
- për nevojat shoqërore duhet njoftuar udhëheqësit e bashkësisë;
- detyra e pakryer vazhdon të mbetet detyrë derisa të kryhet;
- me fjalën "sabejas" mendohet në personin i cili e ka lëshuar fenë e idhujtarisë së Kurejshitëve dhe e ka pranuar Islamin. Disa historianë mednojnë se ata janë trashëgimtarë të Sabiut, djalit të Idrizit a.s., kurse disa thonë se ata janë trashëgimtarë të Ibrahimit a.s.

Xhunubi do të marrë tejemmum, nëse frikohet nga sëmundja nga vdekja ose nga etja

Thuhet se Amr b. Asi një natë të ftohtë ishte bërë xhunub (pati polucion) dhe kishte marrë tejemmum, duke u mbështetur në ajetin e Kur'anit, të cilin e citoi:

"... Mos e mbytni vetveten! All-llahu, me të vërtetë, ndaj jush është mëshirues".

(en-Nisâ', 29)

Më vonë, kjo i është përmendnur Pejgamberit s.a.v.s. dhe ai nuk e ka kundërshtuar me asgjë.[9]

٣٤٥ — حدثنا بِشْرُ بنُ خالدٍ قال حدثنا محمدٌ هو غُنْدَرٌ عن شُعبةَ عن سُلَيمانَ عن أبي وائلٍ قال : قال أبو موسى لِعبدِ اللهِ بن مَسعودٍ : إذا لم يَجِدِ الماءَ لا يُصلِّي . قال عبدُ اللهِ : لو رَخَّصتُ لهم في هذا كانَ إذا وَجدَ أحدُهمُ البَرْدَ قال هكذا ـ يعني تيمَّمَ ـ وصلَّى . قال : قلت : فأينَ قولُ عمَّارٍ لِعُمرَ ؟ قال : إني لم أرَ عُمرَ قَنِعَ بقولِ عمَّارٍ .

---

9 Amr b. Asi është nga fisi kurejsh. Islamin e ka pranuar në vitin 8 hixhri. Muhammedi a.s. e caktoi kryetar në Umman. Këtë detyrë e kreu derisa Muhammedi a.s. ishte gjallë. Nga ky person janë përcjellur 37 hadithe, prej tyre 3 i ka përfshirë Buhariu në "Sahihun" e vet. Nën komandën e tij qe nënshtruar Egjipti, ku udhëhoqi gjatë kohë dhe aty vdiq.
Ebu Davudi thekson se Amr b. Asi në fillim të vitit 8 hixhri qe nisur në një ekspeditë ushtarake dhe me ushtrinë pat bujtur në Dhat-i Thelathin, vend në veri të Medines. Një natë të ftohtë polucoi. Duke u frikuar nga të ftohtit, në vend që të lahet, mori tejemmum dhe me të (me tejemmum) ia fali namazin e sabahut njësisë së vet ushtarake. Muhammedi a.s. e pat thirrë Amr b. Asin, e ky ia tregoi rastin se pse nuk qe larë, e pastaj ia citoi ajetin e Kur'anit: "Mos e vritni veten tuaj! All-llahu ndaj jush është i mëshirshëm", në çka Muhammedi a.s. vetëm buzëqeshi.
Nga hadithi mund të nxirret përfundimi:
- në kohë shumë të ftohtë xhunubi mund të përdorë tejemmum;
- Maliku dhe Ebu Hanife i lejojnë tejemmum të sëmurit të cilit do t'ia keqësonte gjendjen dhe do t'ia hapte varrën. Megjithatë, në rastin e etheve, të dhembjes së kokës e të ngjashme, tejemmumi nuk mund të shërbejë në vend të abdestit;
- namazi i kryer me tejemmum në rastin e sipërpërmedur është i plotëfuqishëm dhe nuk duhet të përsëritet;
- tejemmumi përdoret në vend të abdestit ose larjes së përgjithshme (guslit) qoftë në shtëpi ose jashtë saj, kur nuk ka ujë ose kur larja e trupit e keqëson shëndetin e njeriut.

345. Na ka treguar Bishr b. Halidi, këtij Muhammed Gunderi, ky nga Shu'be, ky nga Sulejmani, ky nga Ebu Vaili, i cili tregon se Ebu Musai e ka pyetur Abdullah b. Mes'udin:

"Kur (xhunubi) **nuk gjen ujë, nuk do të falë namazin"**?, e ai u përgjigj: **"Po t'ua lejoja atyre këtë, do ta shfrytëzonte ndonjëri prej tyre edhe po të hetonte sado pak të ftohtë".**

Ashtu e ka transmetuar Ebu Musai, duke pasë për qëllim me këtë që xhunubi mund të marrë tejemmum dhe të falë namazin.

Ebu Musai ka thënë: **"E kam pyetur Abdullahun, e prej ku fjala e Ammarit, që ia ka drejtuar Umerit"?**

"Unë nuk kam vërejtur se Umeri ka qenë i kënaqur me fjalën e Ammarit (e jo që nuk e ka lejuar tejemmumin)", u përgjigj Abdullahu.

٣٤٦ – حدثنا عُمرُ بنُ حَفصٍ قال حدثنا أبي قال حدثنا الأعمشُ قال سمعتُ شَقِيقَ بنَ سَلَمَةَ قال: كنتُ عندَ عبدِ اللهِ وأبي موسى فقال له أبو موسى: أرأيتَ يا أبا عبدِ الرحمنِ إذا أجنبَ فلم يجدْ ماء كيفَ يصنعُ؟ فقال عبدُ اللهِ: لا يُصلِّي حتى يجدَ الماء. فقال أبو موسى: فكيفَ تصنعُ بقولِ عمارٍ حينَ قال له النبيُّ ﷺ: كان يكفيكَ؟ قال: ألم ترَ عمرَ لم يقنعْ بذلكَ؟ فقال أبو موسى: فدعنا من قولِ عمارٍ، كيفَ تصنعُ بهذهِ الآيةِ؟ فما درى عبدُ اللهِ ما يقولُ. فقال: إنا لو رخَّصنا لهم في هذا لأوشكَ إذا بردَ على أحدِهِمُ الماءُ أن يدعَهُ ويتيمَّمَ. فقلتُ لشقيقٍ: فإنما كرهَ عبدُ اللهِ لهذا؟ قال: نعم

346. Na ka treguar Umer b. Hafsi, ky nga babai i vet, ky nga A'meshi, ky nga Shekik b. Seleme, i cili ka treguar:

Kam qenë te Abdullahu dhe te Ebu Musai. Atij i tha Ebu Musai:

"Çka mendon o Ebu Abdu-r-Rahman, kur njeriu bëhet xhunub dhe nuk gjen ujë për t'u larë, çka të bëjë"?

"Nuk do të falë namazin derisa të gjejë ujë (dhe me të të lahet)", u përgjigj Abdullahu.

"E si të shpjegohet thënia e Ammarit, të cilit Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë: "Të mjafton (të fërkosh vetëm fytyrën dhe duart)", kishte vërejtur Ebu Musai.

"A nuk e kuptove që Umeri nuk qe i kënaqur me këtë", tha Abdullahu.

"Ta lëmë tash thënien e Ammarit! tha Ebu Musai, **por si vepron ti me ajetin e Kur'anit që flet për tejemmumin"?**

Abdullahu nuk diti si të përgjigjet dhe tha: **"Po t'ua lejonim atyre këtë, ndonjëri prej tyre, sado pak të ishte ftohtë, do të merrte tejemmum, e do ta lente ujin".**

Unë, (thotë A'meshi) i kam thënë Shekikut: **"Abdullahu e ka përbuzur** (tejemmumin) **vetëm për shkak se mund të keqpërdoret"?**

"Po", u përgjigj ai.

بابُ التيمُّمُ ضَربةٌ

٣٤٧ – حدثنا محمد بن سلام قال أخبرنا أبو معاوية عن الأعمش عن شقيق قال : كنتُ جالساً مع عبدِ اللهِ وأبي موسى الأشعريِّ ، فقال له أبو موسى : لو أن رجلا أجنبَ فلم يجدِ الماء شهراً أما كان يتيمَّمُ ويُصلِّي ؟ فكيفَ تصنعونَ بهذهِ الآيةِ في سورةِ المائدةِ ﴿ فلم تجدوا ماء فتيمَّموا صعيداً طيِّباً ﴾ ؟ فقال عبدُ اللهِ لو رُخِّصَ لهم في هذا لأوشكوا إذا بَرَدَ عليهم الماء أن يتيمَّموا الصَّعيدَ . قلتُ : وإنما كرهتُم هذا لهذا ؟ قال : نعم . فقال أبو موسى : ألم تسمعْ قولَ عمارٍ لعمرَ : بعثني رسولُ اللهِ ﷺ في حاجةٍ فأجنبتُ فلم أجدِ الماء فتمرَّغتُ في الصَّعيدِ كما تمرَّغُ الدابَّةُ . فذكرتُ ذلك للنبيِّ ﷺ فقالَ إنما كان يكفيكَ أن تصنعَ هكذا ـ فضربَ بكفِّهِ ضربةً على الأرضِ ثمَّ نفضَها ثمَّ مسحَ بهما ظهرَ كفِّهِ بشمالِهِ ، أو ظهرَ شمالِهِ بكفِّهِ ثمَّ مسحَ بهما وجهَهُ . فقال عبدُ اللهِ : أفلم تر عمرَ لم يقنعْ بقولِ عمارٍ ؟ وزاد يعلى عن الأعمشِ عن شقيقٍ : كنتُ مع عبدِ اللهِ وأبي موسى ، فقال أبو موسى : ألم تسمعْ قولَ عمارٍ لعمرَ إنَّ رسولَ اللهِ ﷺ بعثني أنا وأنتَ فأجنبتُ فتمعَّكتُ بالصَّعيدِ ، فأتينا رسولَ اللهِ ﷺ فأخبرناهُ فقال « إنما كان يكفيكَ هكذا » ومسحَ وجهَهُ وكفَّيهِ واحدةً

Tejmmumi është përplasje (fërkuarje) e shuplakave të duarve për toke

347. Na ka treguar Muhammedi, këtij Ebu Muaviu, ky nga A'meshi, ky nga Shekiku, i cili ka thënë:

Kemi ndenjur me Abdullahun dhe me Ebu Musa Eshariun. Ebu Musai tha: "Nëse një njeri bëhet xhunub (ejakulon) **dhe nuk gjen ujë**

gjatë një muaji, a të marrë tejemmum dhe të falë namazin dhe si do të veproni me ajetin në suren Maide?

"... dhe nëse nuk gjeni ujë, merreni tejemmum me dhé të pastër të tokës...".

(el-Mâide, 6)

Abdullahu u përgjigj: **"Po t'u lejohet kjo, ndoshta do të marrin tejemmum edhe kur uji do të jetë sado pak i ftohtë".**

"Ju po e përbuzni tejemmumin vetëm nëse xhunubi e shfrytëzon për këtë qëllim"? i thashë.

"Po", u përgjigj ai.

Pastaj, Ebu Musai pyeti: **"A nuk e ke dëgjuar thënien e Ammari që ia drejtoi Umerit: "Pejgamberi më ka dërguar për një punë e unë u bëra xhunub** (u bëra i papastër për shkak të ejakulimit), **e ujë nuk kam mundur të gjej, prandaj jam fërkuar për toke, ashtu sikurse shkrrihet kafsha. Këtë ia tregova Pejgamberit s.a.v.s.**, e ai më tha:

"Mjafton të veprosh kështu dhe i lëshoi pëllëmbët (shuplakat) **e duarve në tokë një herë, i shkundi dhe me dorën e majtë e fërkoi të prapmen e dorës së djathtë** (deri në bërryl), **respektivisht të prapmen e të majtës me të djathtën, e pastaj me këta e fërkoi fytyrën e vet".**

Abdullahu e qortoi (e kundërshtoi): **"A nuk ke vërejtur se Umeri nuk ishte i kënaqur me thënien e Ammarit"?**

Ja'lai shtoi, duke transmetuar nga A'meshi, e ky nga Shekiku:

"Kam qenë me Abdullahun dhe me Ebu Musain. Ebu Musai ka thënë:

"A nuk i ke dëgjuar fjalët e Ammarit, drejtuar Umerit: Pejgamberi s.a.v.s. na dërgoi mua dhe ty (për një punë). **Unë u bëra xhunub dhe u fërkova** (u shtriva) **në sipërfaqen e tokës. Pastaj erdhëm te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e njoftuam** (për këtë rast), **e ai tha:**

"Ishte e mjaftueshme vetëm kaq dhe i lëshoi shuplakat në tokë, e fërkoi (u dha mes-h) fytyrën dhe duart (deri në bërryla) nga një herë".

باب * ٣٤٨ - حدثنا عبدان قال أخبرنا عبد الله قال أخبرنا عوف عن أبي رجاء قال حدثنا عمران بن حصين الخزاعي أن رسول الله ﷺ رأى رجلا معتزلا لم يصل في القوم فقال: يا فلان ما منعك أن تصلي في القوم؟ فقال: يا رسول الله أصابتني جنابة ولا ماء. قال «عليك بالصعيد فانه يكفيك»

348. Na ka treguar Abdani, këtij Abdullahu, këtij Avfi, ky nga Ebu Rexhai, ky nga Imran b. Husejn el-Huzaiu, i cili tregoi se Pejgamberi s.a.v.s. e vërejti një njeri që nuk e fali namazin me të tjerët, prandaj e pyeti: **"Përse nuk u fale me të tjerët"**? Ai u përgjigj: **"Jam bërë xhunub, e ujë nuk ka"**. Pejgamberi s.a.v.s. i tha:

"Të mjafton ta shfrytëzosh sipërfaqen e tokës (për pastrim)**"**.

Shpjegime të disa termave islame

Shpjegime të disa termave islamë

A

Abdest: larja e detyrueshme (farz) e fytyrës, e duarve deri në bërryla, fshirja e pjesës së sipërme të kokës me dorë të lagur dhe larja e këmbëve deri në nyje.

Ahiret: Në Kur'an përdoret për të shprehur jetën tjetër, botën tjetër (pas vdekjes).

Ajet: *përdoret me disa kuptime: "argument, shenjë, simbol", "mrekulli", e kur është* fjala për përbërjen e Kur'anit, ajet do të thotë "fjali a tog fjalish në Kur'an".

As-hab: shokët besnikë të Muhammedit a.s. të cilët, ndër të tjera, kanë luajtur rol *të posaçëm në ruajtjen* dhe *në përcjelljen* e *hadithe*ve. Përdoret edhe varianti *sahabe*.

B

Bedel: zëvendës; si term islam përdoret për personin që shkon në haxhxh (haxhillëk) në vend të tjetrit.

Bejtu-l-Mukaddesi (ose **el-Mesxhidu-l-Aksa**)**:** Kibla e parë e muslimanëve dhe njëra ndër tri xhamitë më të çmuara; pra. Qabja; Bejtu-l-Mukaddesi (*el-Mesxhidu-l-Aksa*) dhe xhamia e Pejgamberit në *Medine*.

D

dua (dovë): *çdo lutje që i drejtohet All-llahut (ar. duâ').*

duha namaz: namazi i padetyrueshëm, që falet pas lindjes së diellit deri në kohën para namazit të drekës.

dhikër (ziqër): të përmendurit e emrit të All-llahut, ose tekste të tjera fetare-islame (ar. *dhikr*).

E

Ensar: banorët vendas të Medinës. Këta i kanë bërë pritje të jashtëzakonshme Muhammedi a.s. dhe muslimanëve të tjerë që u shpërngulën nga Mekka në Medine.

Ehlu-l-Kitab: hebrenjtë dhe të krishterët që besojnë në librat e shpallura para Kur'anit (në Tevrat dhe në Inxhil).

Ezan: njoftim; thirrje për namaz. Ezani thirret për çdo kohë të namazit dhe në gjuhën arabe. Ai që e thirr ezanin quhet *muezin*. (ar. *edhân*)

F

Fakih: ai që merret me shkencë e fikhut (sh.), njohës i mirë i fikhut.

Farz: (ar. **fard** turq. **farz**): Detyrim, detyrë e dorës së parë, që urdhërohet në mënyrë të prerë. Sipas Islamit janë dy lloj farzesh: farz-i ajn (ar. *fardu-l-'ajn*) që duhet ta kryejë çdo musliman personalisht (p.sh. namazi, agjërimi etj.) dhe farzi kifaje (ar. *fardu-l-kifaje*) "Farz i përbashkët", p.sh. falja e namazit të xhenazes. Nëse këtë namaz e falin një numër i caktuar i muslimanëve, shkarkohen të tjerët, e nëse nuk merr pjesë asnjë, atëherë janë të detyruar të gjithë muslimanët e atij rrethi.

Fetfa: përgjigje dhe vendime juridike islame të mbështetura në Kur'an dhe në Hadith. Këto përgjigje dhe vendime i jep shejhul-islami ose muftiu.

Fikh: në krye të herës është përdorur me kuptimin e përgjithshëm "dituri". Më vonë është ngushtuar kuptimi i kësaj fjale dhe është përdorur vetëm për të shprehur shkencat juridike islame.

G

Gus(ë)l: larja e detyrueshme (farz) e tërë trupit për xhunubin (sh.). Muslimani pasi ta largojë ndyrësirën nga ajo pjesë e trupit, duhet të përpiqet që ta lajë çdo pjesë të trupit, duke shtirë ujë edhe në gojë edhe në hundë.

Gj

Gjunah: faj, gjynah, keq, gabim, mëkat.

H

Hadeth: Dukuria që e prish abdestin.

Hadith: gjithçka që Muhammedi a.a. kë thënë, ka porosit, ka punuar dhe ka pëlqyer (kur diçka kanë punuar të tjerët).

hjaz: menstruacioni, pastrimi i femrës (java e gruas).

halife: kryetar, udhëheqës; trashëgimtar.

Hallall: çdogjë që është e lejueshme me rregullat dhe normat islame (me sheriatin islam).

Haram: çdo gjë që është e ndaluar rreptësisht me normat e sheriatit islam.

hatib: ai që mban ligjërata në namazin e xhumasë dhe në namazin e Bajrameve.

Haxhxh (haxhillëk): vizita e detyrushme e Qabes në Mekke (një herë në jetë) në dhjetë ditët e para të muajit të fundit sipas kalendarit hixhri (d.m.th. në

muajin dhu-l-hixhxhe) për ata që kanë pasuri të mjaftueshme dhe që janë të shëndoshë. Haxhxhi është një nga pesë shtyllat e Islamit.

Haxhxhetu-l-Veda: Haxhxhi Lamtumirës. Kështu quhet haxhxhi i fundit që e bëri Muhammedi a.s.

Hisbet: qëndrimi i haxhinjve në Muhassab, kur kthehen nga Mina.

Hixhri (ose **Hixhreti**)**:** shpërngulja e Pejgamberit a.s. nga Mekka në Medine në vitin 622. Hixhri ose hixhreti është fillimi i erës islame.

Hytbe: fjalim, këshillë, ligjëratë islame, që e mban imami në namazin e xhumasë dhe në namazin e Bajrameve nga minberi (sh.).

I

Ibadet: lutje, përkushtim; nënshtrim dëshirës së All-llahut. Çdo vepër islame që kryhet në emër të All-llaht është ibadet.

Iddet: periudha e caktuar kohore e pritjes së gruas prej 4 (katër) muaj e 10 (dhjetë) ditë, me rastin e vdekjes së bashkëshortit, kurse me rastin e çkurorëzimit kjo periudhë kohore zgjat 3 (tre) muaj. Sipas të drjetës së sheriatit, gruaja nuk mund të martohet në këto periudha kohore.

Iftar: me iftarin ndërpritet agjërimi i ditës së agjëruar.

Ihram: veshje e detyrueshme për haxhinjtë gjatë kryerjes së haxhxhit dhe të umres. Haxhinjtë e veshin këtë veshje para se të hyjnë në Mekke dhe e mbajnë derisa e kryejnë këtë detyrim islam.

Ikamet: njoftim për namazin që sapo fillon. Formula e ikametit është e njëjtë me të ezanit, përveç që, pas fjalëve "hajje ale-l-felâh" (dy herë) "eja në shpëtim", shtohen fjalët "kad kâmeti-s-selâtu) (dy herë), d.m.th. "Namazi fillon". Shprehet vetëm në gjuhën arabe.

Iqindi: namazi i detyrueshëm, koha e të cilit është pas përfundimit të kohës së drekës deri pak kohë para perëndimit të diellit.

Imam: përdoret me dy kuptime: 1. personi që e udhëheq faljen e namazit me xhemat, 2. titull nderi për dijetarët islamë, sidomos për themeluesit e shkollave burimore juridike islame, p.sh. Imam Ebu Hanife, Imam Shafiu, Imam Maliku, Imam Hambeliu etj.

Iman: besimi në All-llahun xh.sh.

I'tikaf: (ar. **i'tikâf**)**:** qëndrim i vetmuar i personit në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit (por edhe në kohët të tjera) në xhami. Gjatë kësaj kohe personi me tërë qenien e vet i kushtohet ibadetit: fal namaz, agjëron, lexon Kur'an. Jashtë del vetëm për nevoja fiziologjike..

J

Jetim: fëmija që nuk ka njërin a të dy prindërit, bonjak. Shumë ajete të Kur'anit dhe shumë hadithe të Pejgamberit a.s. flasin, përkatësisht urdhërojnë që ndaj jetimëve duhet patur shumë kujdes: të mos keqtrajtohen, të mos bëhet padrejtësi ndaj tyre, të mos keqpërdoret pasuria e tyre etj.

K

Kible: të kthyerit e muslimanit kah Qabja (në Mekke) me rastin e faljes së namazit. Të kthyerit kah Kibla bëhet edhe me rastin e therjes së kurbanit, por edhe të tjerave. Edhe të vdekurit kur varroset i kthehet koka kah Kibla. Kibla te ne është në drejtim jug-lindor.

Kijamet: Dita e shkatërrimit të kësaj bote - fundi i kësaj bote.

Kaza: (ar. **kadâ'**): ("plotësoj, kryej, kaloj"): plotësimi i të gjitha detyrimeve islame që nuk janë kryer në kohën e tyre të caktuar.

Kiraet: leximi dhe këndimi i Kur'anit në mënyrë të drejtë.

Kurban: bagëtia e imët ose e trashë që theret gjatë ditëve të Bajramit të Vogël me qëllim të kurbanit. Prandaj quhet Bajrami i Kurbanit ose Kurban-Bajrami (sipas ndikimit të turqishtes).

M

Mes-h: përshkuarja (fshirja) e kokës me dorë të lagur me rastin e marrjes abdest.

Meste: mbathje e thellë me gjonë të hollë pa thembra (pa take) të përpunuar nga lëkura e butë.

Mesxhid: xhamia që nuk ka minare dhe minber. Për këtë arsye, në mesxhid nuk mund të falet namazi i xhumasë dhe namazi i Bajrameve, përveç kur adaptohet.

Medhheb (mez-heb): shkollë juridike, politike, ose apologjetike islame; drejtim.

Mezi: lëngu që del nga organi gjenital pas një nxitje (provokimi) të vogël; lëngu që del para ejakulimit.

Mihrab: zbrazëtira që gjendet në mes të murit të xhamisë në të cilën qëndron imami para xhematit gjatë faljes së namazit. Mihrabi, njëherit, tregon drejtimin e Kibles në xhami.

Mikat: vend i caktuar afër Mekkes ku haxhinjtë veshin ihramin. Secila anë e ka mikatin e vet: medinasët e kanë Dhu-l-Hulejfen, sirijanët Xhuhfen, nexhdasit Karnin, jemenasit Jelemlemin, irakjanët Irkun. (ar. mîkât)

Minber: Vendi i ngitur në disa shkallë në xhami (në anën e djathtë të mihrabit), i ndërtuar prej muri ose prej druri, prej ku hatibi mban ligjëratën (hytben) në namazin e xhumasë dhe në namazin e Bajrameve.

Misvak: mjet për larjen e dhëmbëve. Është një llojë druri, brendia e të cilit përbëhet nga shumë fije të holla.

Mudd: enë që merr dy litra ujë.

Muezin: person që e thirr ezanin (ar. *mu'edhdhin*).

Muhaddith: ai që merret me shkencën e Hadithit; që ka njohuri të thella për Hadithin.

Muhrim: ai që e vesh ihramin (sh.).

Munafik: dyfytyrësh; që shprehet haptazi për diçka, kurse fshehurazi punon të kundërtën; që bëhet se është besimtar, e në të vërtetë nuk është besimtar; ngatërrestar. Munafikët janë kategori më e urrejtur te All-llahu xh.sh..

Murtedd: ai që e lëshon fenë islame, pasi e ka pranuar atë; tradhëtar.

Musal-la (lexo: **musal-la):** vend i caktuar në hapësirë, ku falet namazi me xhemat për tërë një lagje.

Mustehab: vepër e pëlqyeshme, e rekomandueshme.

Mushrik: që beson në shumë zotëra; që i bën shok All-llahut xh.sh..

Mutevatir (Hadithi mutevatir): që transmetohet nga disa sende dhe nga As-habët eminentë të Pejgameberit a.s.

N

Nafile: namzi jo i detyrueshëm; që falet vullnetarisht (edhe për këtë namaz vlejnë të njëjtat rregulla si për namazin e detyrueshëm.

Namaz: është detyrë për çdo musliman (fardu-l-'ajn). Brenda 24 orëve falen pesë namaze. Namazi përbehët prej dy e më shumë reqateve (sh.). Fjala namaz është e burimit persian, e është sinonim i fjalës arabe *salât.*

Nâmûs: Kështu quhej meleku që All-llahu xh.sh. ia dërgoi Musait a.s.

P

Pejgamber: lajmëtar i fesë; ai që e kumton Shpalljen e All-llahut xh.sh. Fjalë me burim persian. I përgjigjet fjalës arabe *nebijj.*

Q

Qabe: (ar. **Ka'be**) Quhet edhe Bejtull-llah. Tempulli i shenjtë i muslimanëve kah i cili drejtohen muslimanët gjatë faljes së namazeve, pavarësisht se në cilën anë të botës gjenden.

Qufër: mosbesim; largim nga feja islame.

R

Reqat: pjesë përbërëse e namazit. Përbëhet prej qëndrimit në këmbë (kijam), ruqusë (sh.) dhe sexhde-s (sh.).

Resulullah: I dërguari i All-llahut xh.sh.

Ruqu: pjesë përbërëse e reqatiti që bëhet duke përulur pjesën e sipërme të trupit në formë horizontale (koka të jetë në një nivel me shpinën), me ç'rast gjunjtë preken me duar (ar. *rukû'*).

S

Sâ': enë që merr 8-9 litra ujë.

Sadaka: çdo lloj pasurie që u jipet vullnetarisht të varfërve, ose në ndonjë vend tjetër; lëmoshë.

Sadaka-i fitr: sasi e caktuar materiale e cila ndahet sipas parimeve islame në Ramazan, para Bajramit të Madh. Sadaka-i fitri jipet për çdo anëtarë të familjes.

Sâhibi uzûr: ai që ka arsyetim për moskryerjen e një detyrimi islam.

Saf: rendi i xhematit kur falen pas imamit.

Salavat: lutje (dua) e posaçme në gjuhën arabe me të cilën përsoni i lutet All-llahut xh.sh. për Muhammedin a.s. dhe për familjen e tij. Ajo fillon me: "All-llahumme sal-li alà sejjidina Muhammedin..."

Selam: përshëndetje islame, shpëtim, paqë.

Sened: vargu i transmetuesve të Hadithit. Për të qenë Hadithi i vlefshëm, transmetuesit duhet të jenë të besueshëm.

Sexhde: pjesë përbërëse e reqatit. Kryhet pas ruqu-së në mëyrë që falësi lëshohet në tokë me ballë, me hundë, me duar dhe me gjunj. Namazi nuk është i vlefshëm pa e bërë sexhden.

Sofë: vendi i ngritur para ose brenda xhamisë, i ngjitur për murit të saj, që shërben për të faluar namazin, po qe se nuk ka vend brenda në xhami.

Sunnet: traditë, zakon. Në terminologjinë islame sunnet (synet) është sinonim i fjalës hadith (sh.).

Sutre: shkopi ose ndonjë mjet tjetër që e vendos falësi kur fal namazin në hapsirë.

Sh

Shefaat: mbrojtje, ndërmjetësim.

Shehadet: dëshmi, të dëshmuarit. Formula e shehadetit është: Eshhedu en là ilàhe il-la-ll-llah ve eshhedu enne Muhammeden Resulullah "Dëshmoj se nuk ka zot përveç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është Pejgamber i Tij".

Shirk: besimi në shumë zotëra; të bërët shok All-llahut xh.sh.

Sheriat: ligj islam, i bazuar në Kur'an dhe në Hadith.

T

Tahmid: të shprehurët e sintagmës: "el-hamdulil-Lâh. "Falënderimi i qoftë All-llahut".

Takva: që frikohet nga All-llahu. Takva quhet perosni i cili i kryen të gjitha detyrimet fetare-islame.

Tavaf: të sjellurit rreth Qabes (gjatë kohës së haxhxhit) sipas rregullave islame. Tavafi bëhet me abdest. Xhunubi dhe gruaja me menstruacione nuk mund ta bëjnë tavaf Qaben.

Tavafi zijaret: të sjellurit e detyrueshëm të haxhiut rreth Qabes gjatë ditëve të haxhillëkut.

Tejemmum: të pastruarit me dhé të pastër. Përdoret në vend të abdestit dhe guslit, nëse nuk ka ujë dhe në raste të tjera të jashtëzakonshme.

Tekbir: formula e tekbirit është: "All-llahu ekber", "All-llahu është më i madh", ndërsa në tërësi është: "All-llahu ekber, All-llahu ekber, lâ ilâhe il-la-llah, All-llahu ekber, All-llahu ekber, All-llahu ekber ve lil-lâhi-l-hamd" All-llahu është më i madh, All-llahu është më i madh! All-llahu është një. All-llahu është më i madh dhe Atij i takon çdo lavdim".

Telbije: formual e saj është: Lebbejke All-llahumme lebbejke, lebbejke la sherike leke lebbejke, inne-l-hamde ve-n-ni'mete leke ve-l-mulk la sherike leke. Lebbejke ve sa'dejke" d.m.th.: "O Zoti im jam i gatshëm t'i përgjigjem thirrjes Tënde..."

Tespih: kokrra prej druri ose prej materiali tjetër të radhitura në pe.

U

Umre: vizita e Qabes që mund të bëhet gjatë tërë vitit (përveç në katër ditët e Bajramit të Kurbanit).

V

Vaxhib: detyrim i dorës së dytë (menjëherë pas farzit). Juristët islamë (fakihët) e konsiderojnë detyrim në bazë të besnikërisë së tij. Sipas shkollës shafiite dhe shkollave të tjera islame, farzi dhe vaxhibi janë sinonime.

Xh

Xhemat: grup njerëzish që falen pas imamit. ar. *xhemâ'a*(tun)

Xhenaze: trupi i të vdekurit.

Xhunub: gjendja pas marrëdhënies seksuale, pas ejakulimit ose pas plucionit derisa të pastrohet sipas normave të caktuara islame (shih gusël); i papastër. Sipas normave islame, larja pas kësaj gjendje është e detyrueshme. (farz)

Z

Zeqat (Zekat): detyrim islam, që jepet për pasurinë e cila ka arritur shkallën e caktuar (nisabin). Zeqati është një nga pesë shtyllat e Islamit.

Shkurtimet

ar. - arabisht.

a.s. - alejhis-selâm "shpëtimi qoftë mbi te". Thuhet dhe shkurhet pas emrit të Pejgamberëve.

b. - *ibn* "i biri", ose *bint* "e bija".

r.a. - radijall-llahu anhu (ose anha: për gjininë femërore), d.m.th. "Zoti qoftë i kënaqur me te". Shqiptohet dhe shkurhet pas emrit të As-habëve të Pejgamberit a.s.

s.a.v.s. - sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, d.m.th. "Zoti e nderoftë dhe e shpëtoftë! përdoret sikurser shkrutesa a.s. (shih a.s.)

sh. - shih

turq. - turiqsht.

xh.sh. - xhel-le shânuhu!, d.m.th. "Lavdi Madhërisë së Tij!" Cilësi që shpreh Madhërinë e All-llahu xh.sh.

LITERATURA

فتح الباري ١

لشرح صحيح الإمام أبي عبد الله محمد بن إسماعيل البخاري للإمام الحافظ أحمد بن علي بن حجر العسقلاني ٧٧٣ - ٨٥٢ الجزء الأول

بيروت - لبنان

1. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe (grup autorësh),* Rilindja, Prishtinë 1981 (ribotim sipas botimit të Akademisë së Shkencave të RPSSH-Instituti i gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1980).
2. *Fjalor serbokroatisht-shqip (grup autorësh),* Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1974.
3. *Kur'ani i Madhëruar,* përktheu Hasan I. Nahi, Prishtinë, 1988.
4. *Kur'ani,* përktheu Feti Mehdiu, Prishtinë, 1985.
5. *Nerkez Smailagić*, Leksikon Islama, Sarajevo, 1990.
6. *Sahihu-l-Buhari, Buharijina zbirka Hadisa I,* përktheu Hasan Shkapur, Sarajevo, 1974.
7. *Sahih-i Buhari Muhtasarı Tecrid-i Sarih Tercemesi ve Şerhi 1-13,* përktheu (në turqishte) Ahmed Naim dhe Kâmil Miras, Ankara, 1984 (botimi i shtatë).
8. Shemseddin Sami (Sami Frashëri), *Kâmûs-i Turki,* Istambul, 1900 (ribotim, 1978).
9. Teufik Muftić, *Arapsko-srpskohrvatski rječnik I, II,* Sarajevo, 1973.
10. *Türkçe-Rusça Sözlük* (grup autorësh), Moskva, 1977.

Përmbajtja

Hadithi pas Kur'anit burim themelor i Islamit **5**
Buhariu dhe Sahiu i tij *20*
Disa shënime për përgatitjen e Librit të parë *25*
1. Fillimi i Shpalljes **31**
2. Besimi (Imani) **49**
Fjala e Pejgamberit s.a.v.s. "Islami është ngritur në pesë shtylla *49*
Lutja juaj është besimi juaj *52*
Pjesët përbërëse të besimit (imanit) *52*
Musliman është ai që nga gjuha dhe dora e tij janë të qetë muslimanët *54*
Cili musliman është më i vlefshëm? *55*
Të ushqesh të uriturit është pjesë e Islamit *55*
Është pjesë e besimit (imanit) t'ia dëshirosh vëllait tënd atë që ia dëshiron vetes *56*
Dashuria ndaj Pejgamberit s.a.v.s. është pjesë e besimit (imanit) *56*
Kënaqësia e besimit (imanit) *57*
Dashuria ndaj Ensarëve është shenjë e besimit *58*
Ikja nga ngatërresat është pjesë e besimit *60*
Fjala e Pejgamberit s.a.v.s. *60*
Kush urren që të kthehet në mosbesim (qufër), siç urren që të hidhet në zjarr, është pjesë e besimit (imanit) *62*
Shpërblimi i besimtarëve (bëhet) sipas veprave të tyre *62*
Turpi është pjesë e besimit *64*
"Nëse pendohen, nëse falin namazin, e nëse japin zeqatin, lërini të vazhdojnë rrugën e tyre" (et-Tevbe, 5) *64*
Besimi, pa dyshim, është punë *65*
Kur Islami (imani) nuk është i sinqertë, por sipërfaqësor, ose nga frika prej vdekjes *67*
Përshëndetja (dhënia selam) është pjesë e Islamit *69*
Mosrespekti (mosmirënjohja) ndaj bashkëshortit dhe gabimi i shkallës së lartë *70*

Gabimet që bartin karakteristika të xhahilijetit, atë që i bën këta, nuk e bëjnë pabesimtar, përveç idhujtarisë 72
"Nëse dy palë besimtarësh përleshen, ndërmjetësoni te ata" (el-Huxhurât, 9). 74
Zullumi më i madh 74
Shenja e dyfytyrësisë (munafikut) 75
Të bësh ibadet në Natën e Kadrit (Lejle-i Kadr) është pjesë e besimit 76
Lufta në rrugën e All-llahut është pjesë e besimit 77
Gjallërimi i muajit të Ramazanit është pjesë e besimit 78
Agjërimi i Ramazanit për shkak besimi (imani) dhe llogaritja (në shpërblimin e All-llahut) është pjesë e besimit 79
Feja është e lehtë 80
Namazi është pjesë përbërëse e besimit (imanit) 81
Mirësia e islamit ndaj njeriut 84
Vepra më e dashur te All-llahu xh.sh. është ajo që bëhet vazhdimisht në emër të tij 86
Të forcuarit dhe të dobësuarit e besimit 87
Zeqati është pjesë e Islamit 90
Përcjellja e xhenazes është pjesë përbërëse e besimit (imanit) 92
Frika e besimtarit (muslimanit), që të mos i rrënohen veprat, e ai të mos e hetojë, është pjesë e besimit 93
Xhibrili e pyet Pejgamberin s.a.v.s. për imanin, Islamin, mirësinë dhe Ditën e Kijametit 97
Virtyti i atij që përpiqet deri në fund ta ruajë pastërtinë e fesë së vet 101
Dhënia e një të pestës është pjesë e besimit 102
"Veprat çmohen sipas qëllimit dhe sinqeritetit" 105
"Fe (besim) është të mendosh sinqerisht All-llahun, Pejgamberin e tij, udhëheqësin e muslimanëve dhe popullin e tyre" 107
3. Dituria **113**
Vlera e diturisë (shkencës) 113
Ai që është pyetur për dituri 114
Ai që e ngre zërin e tij për dijeni 116
Shprehjet e muhaddithit 117
Të parashtruarit e pyetjeve para dëgjuesve për të provuar dijen e tyre . . . 119
Lidhur me diturinë (hadithin) 120
Transmetimi i hadithëve në mënyrë autoritative dhe të shkruarit e tyre . . . 124

Ai që ka arritë i fundit në një tubim shkencor dhe ai që ka parë vend të lirë në sallë dhe aty ulet 127
"Shumë nga ata të cilëve u tregohet diçka përmes tjetrit mund të kuptojnë më mirë se dëgjuesi i drejtpërdrejtë" 128
Dijenia para fjalës dhe punës 130
Si i pajiste Pejgamberi s.a.v.s. me këshilla dhe me dijeni, për të mos u shpërndarë ata 132
Të caktuarit e kohës së ligjëratës për dëgjues 133
Atij që All-llahu ia do të mirën e udhëzon në parimet e fesë 134
Të kuptuarit e shkencës 134
Kënaqësia në dijeni dhe në urtësi 135
Çka është thënë për shkuarjen e Musait s.a.v.a. nëpër det deri te Hidri . . . 136
Fjala e Pejgamberit s.a.v.s. "O Zot, mësoja atij librin (diturinë)" 138
Kur është i vlefshëm mendimi i të miturit? 139
Gjurmimi për dituri 141
Vlera e atij që mëson për (vete) dhe që i mëson të tjerët 142
Çrrënjosja e diturisë dhe paraqitja e mosdijes 143
Rëndësia e diturisë (shkencës) 145
Të dhënët përgjigje duke qenë hipur në deve ose në ndonjë kafshë tjetër . . 146
Të përgjigjurit, duke sinjalizuar me dorë dhe me krye 147
Ndikimi i Pejgamberit s.a.v.s. në delegacionin e Abdu-l-Kajsit t'i mbajë në mend parimet e besimit dhe të diturisë dhe t'i lajmërojë ata pas tyre . . 150
Udhëtimi për të gjetur përgjigje për pyetjet e dhëna dhe të mësuarit e familjes 151
Vizita e vazhdueshme (njëra pas tjetrës) për dituri (shkencë) 153
Zemërimi gjatë këshillimit dhe të mësuarit kur hetohet diçka e keqe 154
Rënia në gjunj para imamit ose ligjëruesit 157
Përsëritja e deklaratave tri herë me qëllim që të kuptohen më mirë 158
Detyra e njeriut për ta mësuar shërbetoren dhe familjen e tij 160
Mbajtja e ligjëratave para grave dhe të mësuarit e tyre 161
Dëshira e flaktë për ta mësuar Hadithin 162
Si ngushtohet (bie interesimi) shkenca 163
A mundet grave t'u caktohet kohë e veçantë për të fituar dituri 165
Kush ka dëgjuar diçka dhe e ka përsëritur derisa ta mësojë mirë atë 166
"I pranishmi le t'ia përcjellë diturinë atij që nuk është i pranishëm" 167
Gjynahu i atij që i bën shpifje (duke e bërë gënjeshtar) Pejgamberit s.a.v.s. 170
Të shkruarit e shkencës 173

Shkenca dhe këshillimi (ligjërata) gjatë natës 178
Diskutimi për dituri gjatë natës 179
Të mësuarit e diturisë përmendsh 181
T'i dëgjosh dijetarët 183
Kur dijetari pyetet "Ksh është më i dituri" është mirë që përgjigja t'i lehet All-llahut 185
Pyetësi që qëndron në këmbë, e pyet dijetarin që rri ulur 188
Pyetjet dhe përgjigjjet ku bëhet hudhja e guralecave 189
"Juve u është dhënë vetëm pak dijeni" (el-Isra',85) 190
Lënia anash e disa mendimeve nga frika se mos po kuptohen gabimisht dhe për shkak të pasojave të tyre 191
Interesimi për të njoftuar vetëm disa duke u frikuar që të mos e kuptojnë gabimisht disa të tjerë 192
Turpi gjatë zënies së diturisë 195
Ü turpërua të pyes, prandaj e urdhëroi tjetrin 196
Të dhënët mësim dhe shpjegime në xhami 197
Atij, që i ka interesuar, i është përgjigjur më gjërësisht se sa e ka pyetur . . 198
4. Abdesti **201**
Çka hyn në abdest 201
Namazi nuk pranohet pa abdest (pa qenë i pastër) 204
Vlera e abdestit dhe shkëlqimi i gjymtyrëve nga gjurmët e abdestit 204
Abdesti nuk merret për shkak të dyshimit, por për shkak të bindjes 205
Lehtësimi në abdest 206
Marrja e abdestit në mënyrë të drejtë (të plotë) 208
Larja e fytyrës me duar me një grusht ujë 209
Të thënët Bismi-l-Lahi... në çdo situatë, prandaj edhe para marrëdhënieve seksuale 211
Çka duhet thënë para hyrjes në nevojtore 211
Të vënët ujë në nevojtore 212
Gjatë kryerjes së nevojës së madhe dhe nevojës së vogël nuk kthehet kah Kiblja përveç kur është në ndërtesë, pas murit, e të ngjashme. 213
Kryerja e nevojës duke qëndruar pupas mbi dy qerpiçë (ose të ngjashme) . 214
Dalja e grave në vend të hapët 215
Kryerja e nevojës në shtëpi 217
Largimi i papastërtisë me ujë 217
Mbajtja e ujit me vete për t'u pastruar 218

Mbajtja e shkopit dhe e ujit për pastrim 219
Pastrimi me dorë të djathtë (pas nevojës), është i papreferueshëm (ndalohet) 219
Nuk mbahet me dorën e djathtë organi gjenital kur përmjerresh (kur shurresh) 220
Pastrimi (largimi) i ndyrësisë me gurë 221
Nuk bëhet pastrimi me bajgë 221
Të marrët abdest duke i larë gjymtyrët nga një herë 222
Pastrimi i gjymtyrëve (të abdestit) nga dy herë 222
Pastrimi (i gjymtyrëve të abdestit) nga tri herë 223
Thithja dhe nxjerrja e ujit nga hunda gjatë abdestit 225
Largimi i papastërtisë me gurë, me numër tek 226
Larja e këmbëve, e jo vetëm dhënia mes-h shputave 227
Larja (shpërlarja) e gojës gjatë abdestit 227
Larja e shputave (thembrave) 228
Këmbët duhet larë, e jo t'u jepet mes-h (të fshihen me dorë të lagët) mbi mbathje 229
Të fillluarit nga ana e djathtë gjatë marrjes së abdestit dhe gjatë larjes së përgjithshme (guslit) 230
Gjurmimi për ujë kur fillon koha e namazit 231
Uji me të cilin pastrohen flokët e njeriut 232
Ata që konsiderojnë se abdestin duhet përsëritur vetëm kur diçka del në njërën nga dy jashtëqitjet - prapa ose para 237
Ndihma ndaj tjetrit në abdest 242
Të lexuarit e Kur'anit pasi prishet abdesti (pas hadethit) 243
Abdestin duhet përsëritur pas humbjes së vetëdijes 245
Të dhënët mes-h kokës (fshirja e kokës me dorë të lagët) 247
Larja e këmbëve deri në nyje 248
Përdorimi i ujit të mbetur nga abdesti edhe për njerëzit e tjerë 249
Larja e gojës dhe e hundës më një grusht ujë 251
Fshirja e kokës me dorë të lagët (dhënia mes-h) një herë 251
Marrja abdest e çiftit bashkëshortor (nga një enë) dhe uji i mbetur i abdestit të gruas. 252
Stërpikja e Pejgamberit s.a.v.s. me ujin e mbetur të abdestit atij që i ka rënë të fikët. 253
Larja dhe të marrët abdest nga korita, shtamba ose nga sahani i drurit ose i gurit 254
Të marrët abdest nga ena (me ujë) - qypi 257

Të marrët abdest me një mudd (me ujë) 258
Dhënia mes-h (të lagurit) mbi meste (mbathje) 259
Veshja e mesteve me këmbë të pastërta 261
Abdesti nuk përsëritet për shkak të ngrënies së mishit të deles dhe qullit (kaçamakut) 262
(Shpër)larja e gojës pas ngrënies së qullit dhe mospërsëritja e abdestit . . 263
A duhet të shpërlahet goja pas (pirjes së) qumështit 264
Të merret abdest pas fjetjes 264
Marrja e abdestit pa paraqitjen e "hadethit" (element që e prish abdestin) . 265
Të mos ruhesh nga urina (shurra) është nga mëkatet e mëdha 267
Çka thuhet për larjen e shurrës 269
Pejgamberi s.a.v.s. dhe të pranishmit e lanë të qetë beduinin të shurret në xhami derisa u shurr. 270
Larja e shurrës me ujë në xhami 272
Derdhja e ujit në vendin me shurrë 272
Shurra e fëmijës 273
Të shurrurit duke qenë në këmbë dhe ulur 274
Kryerja e nevojës së vogël duke strehuar pas shokut ose pas murit 275
Kryerja e nevojës së vogël pranë grumbullit të mbeturinave 276
Larja e gjakut 276
Larja e spermës (farës) dhe shkundja e saj dhe larja e sekrecionit të gruas 278
Larja e papastërtisë së spermës, ose të ngjashme, e gjurma e ujit ende duket 279
Shurra e deves, e bagëtisë së trashë e të imët dhe vathat e tyre 280
Lidhur me papastërtinë e cila bie në yndyrë ose në ujë 281
Shurra në uji që nuk rrjedh 284
Kur në shpinë të falësit hidhet ndyrësira ose ngordhësira, nuk i prishet atij namazi 285
Pështyma, jargët e të ngjashme në tesha (në fasuletë) 288
Nuk është e lejueshme të merret abdest me lëng dhe me pije të tjera (përveç ujit) 288
Gruaja (bija) mund ta lajë gjakun nga fytyra e babait të saj 289
Përdorimi i misvakut 290
Misvaku i jipet më të vjetrit 291
Vlera e abdestit për atë që e kalon natën me të 291

5. Larja - gusli **295**
Abdesti para larjes së përgjithshme (guslit) *296*
Larja e çiftit bashkëshortor njëkohësisht *298*
Larja me një "sâ'" ose të ngjashme me të *299*
Derdhja (lëshuarja) e ujit mbi krye tri herë *300*
Larja nga një herë *302*
Larja me një enë të vogël me ujë dhe parfumosja *302*
Të shtërit ujë në gojë dhe në hundë për shkak të xhunupllëkut (polucionit) . *303*
Fërkimi i dorës për dheu që të pastrohet më mirë *303*
A ka të drejtë "xhunubi" të marrë ujë me dorë nga ena para se ta lajë atë, edhe pse në të nuk ka ndyrësi, por vetëm për shkak se është derdhur (ejakuluar). *304*
Larja (gusli) dhe abdesti me ndërprerje *306*
Derdhja e ujit me të djathtën në të majtën gjatë larjes *307*
Një e larë për shumë marrëdhënie intime *307*
Larja e mezi-së (lëngu që del para spermës) dhe përsëritja e abdestit për shkak të tij *309*
Përdorimi i parfumit para larjes dhe gjurmët e parfumit *309*
Flokët pastrohen derisa bindet se edhe lëkura është e lagur, e pastaj lahen me ujë *310*
Abdesti për shkak të marrëdhënieve intime; larja e trupit, por pa i larë vendet e lara më parë, me rastin e marrjes së abdestit *311*
Kur njeriut i bie ndërmend në xhami se është xhunub le të dalë menjherë, e nuk do të marrë tejemmum *312*
Shkundja (fshirja) e ujit me duar, pas larjes nga xhunupllëku *313*
Të filluarit nga ana e djathtë e kokës gjatë larjes nga xhunupllëku *314*
Të larët duke qenë lakuriq e vetëm dhe të larët i mbuluar - më mirë është të mbulohesh *315*
Të mbuluarit dhe ruajtja nga njerëzit gjatë larjes *316*
Të derdhurit (polucioni) i gruas në ëndërr *317*
Djersa e xhunubi dhe, vërtet musliamni nuk është i papastër (i ndyrë) . . . *318*
Xhunubi mund të dalë, të ecë nëpër qytet (treg) dhe në vende të tjera *319*
Të ndenjurit e xhunubit në shtëpi kur merr abdest, e nuk lahet *320*
Të fjeturit xhunub *321*
Xhunubi merr abdest, e pastaj flen *321*
Puthitja e dy organeve gjenitale (të bërë synnet) *323*
Larja e sekrecionit që del nga organi gjenital i femrës *324*

6. Menstruacionl (Hajzi) 329
Fillimi i paraqitjes së menstruacioneve 330
Gjendja e grave me menstruacione 330
Bashkëshortja me menstruacione ia lan dhe ia kreh kokën e bashkëshortit të saj 331
Të lexuarit (Kur'an) duke qenë mbështetur në supat e bashkëshortes me menstruacione 333
Ai që e quan nifasin hajz 333
Prekja e gruas gjatë menstruacioneve 334
Gruaja me menstruacione nuk agjëron 337
Gruaja me menstruacione i kryen të gjitha detyrimet e haxhxhit, përveç tavafit rreth Qabes 339
Gjakderdhja edhe pas menstruacioneve 340
Larja e gjakut të menstruacioneve 342
Qëndrimi në i'tikaf me gjakderdhje të çrregulluar 343
A mund të falet gruaja me veshje me të cilën ka qenë gjatë menstruacioneve? 344
Gruaja mund të parfumoset gjatë larjes nga menstruacionet 344
Gruaja pas menstruacioneve duhet të pastrohet mirë 345
Pastrimi pas menstruacioneve 346
Të krehurit e gruas me rastin e larjes nga menstruacionet 347
Gruaja duhet t'i derdhë flokët e veta gjatë larjes nga menstruacionet . . . 348
Formimi dhe joformimi 349
Si e paraqet haxhxhin dhe umren personi me menstruacione? 350
Paraqitja dhe ndërprerja e menstruacioneve 351
Gruaja me menstruacione nuk i bën kaza namazet që i kanë kaluar 352
Të fejturit me gruan e cila i ka menstruacionet duke qenë ajo me teshat e saj 353
Mbajtja e teshave të përcaktuara për menstruacion në vend të teshave të cilat mbahen kur gratë janë të pastra 354
Gruaja me menstruacione do të marrë pjesë në festat e Bajrameve dhe në thirrjet (duatë) e muslimanëve; por do të largohet nga falja e namazit . . . 355
Nëse gruas i vijnë menstruacionet tri herë në muaj 356
Paraqitja e lënguat të verdhë dhe të bardhë jashtë kohës së menstruacioneve 358
Gjakderdhja e çrregulluar e arterieve 358
Gruaja të cilës i kanë ardhë menstruacionet pasi i ka kryer detyrimet rreth Qabes (pas kthimit nga Arafati) 359

Gruaja me gjakdedhje të çrregulluara është e pastër 360
Namazi i xhenazes së gruas e cila ka vdekur nga "nifasi" dhe sunneti i tij . 361

7.Tejemmumi **365**
Kur njeriu nuk gjen as ujë as dhé 368
Tejemmumi në shtëpi merret kur nuk ka ujë ose nga frika të mos kalojë koha e namazit 369
A t'u fryejë duarve ai që merr tejemmum? 371
Tejemmum është (prekja e tokës) veçanërisht për fytyrë e veçanërisht për duar (deri në bërryla) 372
Sipërfaqja e pastër e tokës është ujë abdesti (pastrim) për muslimanët dhe ajo është e mjaftueshme (në vend të ujit) 373
Xhunubi do të marrë tejemmum, nëse frikohet nga sëmundja nga vdekja ose nga etja 378
Tejmmumi është përplasje (fërkuarje) e shuplakave të duarve për toke . . . 380

Shpjegime të disa termave islame **385**
Shkurtimet **393**
Literatura **395**
Përmbajtja **397**

Sahîhu-l-Buhâri në gjuhën shqipe
1

Për botuesin:
Mehdi Polisi

U shtyp në shtypshkronjën:
"TIMEGATE" - Prishtinë

Doli nga shtypi në mars 1995

Tirazhi: 1000 copë